

Instituti Shqiptar për Gjeopolitikë



GJEOPOLITIKA

Revistë shkencore

Nr. 3

ISSN

Prishtinë 2024

Drejtor & kryeredaktor

Dr. Sadri Ramabaja

Redaksia

Dr. Enika Abazi

Dr. Selim Ibraimi

Dr. Dritan Hoti

Dr. Gurakuq Kuçi

Këshilli botues

Dr. Odise Çaçi, universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë

Dr. Martin Berishaj, Universiteti i Lubjanës, ambasador

Dr. Venera Lllunji, Universiteti AAB, Prishtinë

Dr. Gjon Berisha, studiues, Instituti i Historisë, Prishtinë

Mr. sc. Stephan Lipsius, Kasel [D]

Emin Azemi, UEJ, Tetovë

Koordinator: Dr. Gurakuq Kuçi

Redaktore gjuhësore: Sevi Agolli

Revista “Gjeopolitika” botohet një herë në vit. Artikujt e paraqitur duhet të përmbajnë punime origjinale dhe të pabotuara më parë. Ata duhet të jenë në gjuhën shqipe ose angleze, të kompjuterizuar, numri i faqeve është i pakufizuar, me shkrim Times New Roman të madhësisë 12 dhe me hapësirë 1,5 ndërmjet rreshtave. Materialet që na dërgohen duhet të shoqërohen me një përmbledhje në gjuhën shqipe dhe/ose angleze dhe me referencat përkatëse, të cilat duhet të përmbajnë emrin e autorit, titullin e plotë të burimit (të librit ose artikullit), vendin dhe vitin e botimit, si dhe faqen referuese. E drejta e autorësisë për artikujt e botuar i takon Institutit Shqiptar për Gjeopolitikë, por autori është i lirë t’i përdorë materialet e tij edhe në botime të tjera, me kusht që referimet t’i bëhen revistës “Gjeopolitika”, si vendi i parë i botimit.

**INSTITUTI SHQIPTAR PËR GJEOPOLITIKË
ALBANIAN INSTITUTE FOR GEOPOLITICS**

Nr. 3

2024

ISSN: 3005-2777

Shtypur në shtypshkronjën: “LENA GRAFIK”

Përmbajtja:

Editoriali	7
I. SHQIPTARËT DHE GJEOPOLITIKA.....	11
1.1. Dr. Sadri RAMABAJA.....	11
Transformimi harmonik i Europës: Marrëveshja e Brukselit në dritën e konstelacionit gjeopolitik.....	11
Hyrje	13
1.2 Akademik Ksenofon KRISAFI	35
A mund (dhe a duhet) të bashkohen shqiptarët?	35
1.3 Shaban MURATI.....	50
Rusia, NATO-ja dhe prapaskenat e një konflikti të dhunshëm	50
1.4 Dr. Skënder DEMALIAJ	56
Politikat e Serbisë për “spastrimin etnik” të shqiptarëve të Kosovës në këndvështrimin psikologjik dhe gjeopolitik.....	56
1.5 Dr. Flora FERATI-SACHSENMAIER	86
Politikat pasivizuese të Serbisë ndaj pakicës shqiptare: Si po shndërrohet jugu i Serbisë në një zonë etnikisht serbe	86
Hyrje	87
1.6 Fatmir LEKAJ, politolog	148
Riaktivizimi toksik i debatit për “identitetin kosovar”	148
II. BASHKËSIA E KOMUNAVE SERBE NË KOSOVË DHE “BOTA SERBE”	173
2.1 Prof. dr. Mazllum BARALIU.....	173
Asociacioni i komunave me popullsi me shumicë serbe sipas projekt-statutit europiano-amerikan të Brukselit.....	173
2.2 Arbër ZAIMI, politolog	224
Shqiptarë e serbë: traditë e strategji	224
III. GJEOPOLITIKA RAJONALE.....	233
3.1 Dr. Daut DAUTI	233
Fajroni në kafenenë e të çmendurve të Ballkanit.....	233
3.2 Shaban MURATI	238
Ndërhyrja brutale e Vuçitit në formatimin e qeverisë së re në Malin e Zi ..	238
3.3 Prof. dr. Arben MALAJ	245
Ballkani Perëndimor, tri prioritetet për Procesin e Berlinit	245
3.4 Dr. Selim IBRAIMI, Uashington	249
Një kthesë ironike në kurriz të shqiptarëve dhe krijimi i aleancës serbo-maqedonase.....	249

3.5 Ante MIRIĆSTU, Zagreb.....	255
Humbja e SHBA-së në Mal të Zi apo rënia “hibride” e “skifterit të zi”.....	255
3.6 Dr. Dritë RAFUNA.....	265
Gjeopolitika dhe zhvillimi rajonal në Ballkan	265
IV. BOTA	283
4.1 Gjeneral Piro AHMETAJ	283
Mësime nga Ukraina: “7 kapacitetet kritike për fatin e luftërave të ardhshme”!	283
4.2 Ditmir BUSHATI	289
NATO-ja e së nesërme!	289
4.3 Prof. dr. Gazmend PULA	296
“Pax Americana” dhe fleksibiliteti i nevojshëm politik.....	296
4.4 Mario STEFANOV, Zagreb.....	303
Rusia përmes Serbisë po përpiqet të tërheqë Ballkanin në një luftë të përgjakshme	303
4.5 Peter MARKO TASE [Berat-Çikago].....	314
Paraguaj: Nepotizmi i Kaballeros shkërmoq burimet e universitetit “UNE”	314
V. GJEOEKONOMI	319
5.1 Akademik Anastas ANGJELI.....	319
Sfidat e BE-së për politikant antikrizë - përballë një recensionit të mundshëm	319
VI. HISTORI.....	327
6.1 Nga dr. Mark PALNIKAJ	327
Konferenca e Bujanit në historiografinë shqiptare dhe ndërkombëtare.....	327
Konferenca e Bujanit në arenën ndërkombëtare	340
VII. INTERVISTA	343
7.1 Albert V. NIKOLLA.....	343
Shqiptarët janë shumë të vjetër, në mos fillimi.....	343
8. KOMENTI	361
8.1 Akademik Artan BORIÇI*.....	361
Një komb një qëndrim, jo një komb e dy luftëra	361
8.2 Melazim KOCI.....	364
Athina dhe Beogradi synojnë përçarjen e faktorit shqiptar	364
8.3 Emin AZEMI	366

Perëndimi po ia vesh lëkurën e qengjit ujkut të dikurshëm të Millosheviqit!	366
IX. RECENSIONE	369
9.1 Dr. Elvis HOXHA	369
Për dijen autoktone të ambasadorit Shaban Murati	369
9.2. Prof. dr. Enika ABAZI	403
Një kontribut i rëndësishëm për mendimin strategjik.....	403
9.3 Dr. Sadri RAMABAJA	409
Kultura politike në ndryshim: një jetë në shërbim të Kombit.....	409
X: ANALYSIS IN ENGLISH	427
10.1 Dr. Sadri RAMABAJA	427
In The Trap Of Thucydides: The New Albanian-Serbian War? Regional Geopolitical Policy.....	427
10.2 Dr. Gurakuq KUÇI.....	448
Geopolitical Risks and Reconfigurations: Serbia and the Challenge to Montenegro's Stability.....	448

Editoriali

Në fillim të dhjetorit 2022, Shoqata për Gjuhën Gjermane (Gesellschaft für deutsche Sprache) kishte përzgjedhur si fjalë të vitit “Zeitenwende” (pikë kthese), që pasohet nga togfjalëshi “lufta për paqen”, dhe kompozitën “Gaspreisbremse” (frenimi i çmimit të gazit).

Po ta kishim ne shqiptarët një institucion të ngjashëm me këtë shoqatë gjermane, për vitin 2023, fare lehtë, do të mund të përzgjidhnim fjalën “koordinim” dhe antipodin e saj “moskoordinim”, tok me togfjalëshat “Ballkani i Hapur” dhe “Bota Serbe”. Natyrisht do të mungojë më tutje togfjalëshi me semantikën politike “Federata Shqiptare”, si kundërvënie e plotë e “Botës Serbe”. Këto nocione përfaqësojnë krizën që prek interesat e përditshëm dhe afatgjatë të qytetarëve shqiptarë në të dyja republikat tona dhe në të gjithë hapësirën shqiptare (në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi dhe në Serbinë e Jugut: Preshevë, Bujanoc, Medokë dhe Sanxhak). Sidoqoftë, togfjalëshi “Federata Shqiptare” ka të ardhmen e tij, jo thjesht si fjalë e vitit, por si shënjesë e shekullit të shqiptarëve, duke u imponuar si platformë politike e Kombit.

Lufta e agresionit rus në Ukrainë, e pasuar pas një pauze testuese të pushtimit të Krimesë [2014], tani me idenë për ta gllabëruar për pak javë të gjithë Ukrainën, më 24 shkurt 2022 shënon thyerjen e epokës në rendin ndërkombëtar, duke filluar edhe ndryshimin rrënjësor dhe afatgjatë në politikën europiane dhe ndërkombëtare të sigurisë.

Kjo luftë me kalimin e kohës reflektoi edhe në Europën Juglindore, si dhe në përkeqësimin e gjendjes së sigurisë edhe në Kosovë. Shërbimet serbo-ruse si për të dëshmuar praninë e tyre edhe në Kosovë, prodhuan 24 shtatorin e vitit 2023, si një test prove për rianeksimin e Kosovës ose, së paku, të veriut të saj.

Fakti se Rusia e Putinit po pretendon të rihapë frontit të dytë të luftës në Europë me zhvillimet e fundit në Bosnjë, Mal të Zi dhe Kosovë, duke shfrytëzuar satelitin e saj, Serbinë, tashmë është qartësuar shumë. Kjo intencë ndërlidhet ngushtësisht me interesat rusë dhe objektivin e saj për ripushtimin e plotë të Ukrainës, që do t'i hapte rrugë pastaj marshit drejt zonave që Moska i ka cilësuar në doktrinën e saj të sigurisë si “Novaja Rasia”. Në këto rrethana edhe përdorimi i armëve bërthamore taktike në frontin e luftës në Ukrainë nuk përjashtohet.

Rikthimi i këtij fronti tashmë duket më real jo vetëm nga studiuesit e fushës së sigurisë në nivel të Perëndimit, por edhe nga qendrat e vendimmarrjes politike. Institute me renome në lëmin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të sigurisë kanë paralajmëruar, se Serbia ka kohë që është përgatitur për një qasje të kësaj natyre, duke imponuar dhe bërë fakt të kryer krijimin e “Botës Serbe”.

Në këtë përshkallëzim krizash të mëdha, etnonacionalizmi në Europë sërish po hedh shtat, ndërkaq në Europën Juglindore, me theks në Serbi, ai ka përmasat e shovinizmit tipik dhe rrezikon seriozisht rendin dhe paqen europiane. Ky rrezik tashmë është evident si asnjëherë më parë, që nga përfundimi i procesit të shkërmoqjes së ish-Jugosllavisë dhe luftës në Bosnjë e Kosovë, që pati kulmuar me gjenocid ndaj boshnjakëve dhe shqiptarëve.

Ruajtja e sovranitetit dhe e integritetit të Republikës bashkë me sigurinë për qytetarët është një detyrë e rëndësishme themelore e politikës shtetërore. Në këto tri vite qeveria “Kurti” e ka shtrirë sovranitetin e saj në veriun e Republikës dhe po garanton integritetin e Republikës. Sidoqoftë, në aktualitetin që po jetojmë, politikat e sigurisë përfshijnë më shumë, sesa thjesht mbrojtjen e territorit të Republikës nga sulmet e jashtme, qofshin ato nga organizata terroriste apo shtete, siç është rasti i Serbisë, e cila ka

pretendime territoriale dhe nuk pranon as ekzistencën e Republikës së Kosovës.

Por siguri do të thotë gjithashtu, që individët, shoqëria si tërësi dhe shteti të gëzojnë gjendje të mirë ekzistenciale dhe prosperitet të plotë. Siguri do të thotë, para së gjithash, garantimi i jetës për qytetarët, i pasurisë së tyre, garantimi i rendit politiko-kulturor dhe shmangie e çfarëdo rreziku.

Në këtë plan, ndërtimi i kornizës së plotë të sigurisë kërkon koordinimin në fushat e sigurisë dhe të mbrojtjes, të politikës së jashtme dhe zhvillimit ekonomik etj. mes dy republikave tona dhe me aleatët tanë strategjikë.

Dr. Sadri RAMABAJA

Prishtinë, prill 2024

I. SHQIPTARËT DHE GJEOPOLITIKA

1.1. Dr. Sadri RAMABAJA

Transformimi harmonik i Europës: Marrëveshja e Brukselit në dritën e konstelacionit gjeopolitik

Abstrakt

Politika e BE-së në raport me Kosovën pretendon të jetë në përputhje me platformën e saj për transformim e saj harmonik.

Në këtë trajtesë vend qendror ka trajtimi i këtij transformimi dhe motivet e tejkalimit të gjeopolitikës klasike në përputhje me objektivat e gjeopolitikës kritike.

Por një vend meritor ka edhe hipoteza, se Marrëveshja e Brukselit [27 shkurt 2023], pas letrës që kryeministrja e Serbisë i dërgoi Shërbimit të Jashtëm të BE-së, mund të shkojë drejt nulifikimit dhe stivimit në arkivat e historisë. Në këtë kuadër zhvillimesh gjeopolitike, Europa Juglindore po përvijohet, duke kaluar nga korridoret e diplomacisë drejt betejave ushtarake. Marrëveshjen e Brukselit e kam trajtuar edhe si një nusprodukt të po së njëjtës mendësi politike, që dikur kishte prodhuar prototipin e “Komunës fashiste” të Kersten Knipp-it. Po e njëjta mendësi në prag të Luftës së Dytë Botërore kishte shfrytëzuar kombinimin e shumë prej atyre aspekteve kontradiktore të jetës reale, për të formuar një populizëm të rrezikshëm, masiv, psikotik, që lehtësisht do të mund të pasohet me fille të gabuara të shekullit XXI në Europën Juglindore, që duket se janë të ndërlidhura me platformën e ideologëve serbo-rusë për krijimin e “Botës Serbe”.

Në dritën e këtyre zhvillimeve, Marrëveshja e Brukselit gjithsesi fiton peshë specifike.

Fjalët kyç: *Marrëveshja e Brukselit, transformimi harmonik i Europës, “Komuna fashiste”, “Bota Serbe”, gjeopolitika kritike.*

Hyrje

Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, pas një dialogu intensiv, më 10 shtator 2010 miratoi rezolutën, që do t'u hapte rrugë bisedimeve direkte mes Kosovës dhe Serbisë, të parat që kur Kosova shpalli pavarësinë.

Rezoluta në fjalë ishte paraqitur nga vetë Serbia dhe që bashkësponsorizuar edhe nga Bashkimi Europian. Përmes saj mbështetej roli kryesor i Bashkimit Europian në ndërmjetësimin ndërmjet Serbisë dhe Kosovës.

Rezoluta u miratua pa votim nga 192 anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme, që kishte pranuar mendimin këshillues të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, ku pohohej taksativisht, se shpallja e Pavarësisë së Kosovës në vitin 2008 nuk shkel asnjë ligj ndërkombëtar. Rezoluta hoqi kërkesat e mëhershme të Serbisë për rihapjen e dialogut për statusin e Kosovës.

Rezoluta në fjalë, e amenduar, njohu gjykimin e Gjykatës Ndërkombëtare për Drejtësi, që thotë se shpallja unilaterale e Pavarësisë së Kosovës ishte e ligjshme. Ajo gjithashtu përshëndeste ofertën e Bashkimit Europian për të mundësuar dialogun mes Serbisë dhe Kosovës, si rrugë për anëtarësimin në të ardhmen në organizatë. Me këtë rezolutë iu hap rruga fillimisht dialogut teknik, por me kalimin e kohës, ai do të shndërrohej në dialog të pastër politik.

Politika e BE-së në raport me Kosovën, për interesa të pastër gjeopolitikë, duke investuar në shkëputjen e Serbisë nga orbita ruse, vazhdonte t'i bënte koncesione Serbisë në dëm të Kosovës, produkt i së cilave ishte marrëveshja e prillit 2013 dhe ajo e gushtit 2015, që do të degjeneronte në bisedime të fshehta për ndarjen e Kosovës në vitin 2018.

Politika europiane [e BE-së] në raport me Europën Juglindore nuk kishte gjasa të ndiqte doktrinën gjeopolitike amerikane të krijimit të një

“Lindjeje të Mesme të Re Demokratike”. Nëse do ta perifrazonim Josep Borrell, përfaqësuesin e lartë të BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, Brukseli nuk e bën dot mbarështrimin e Europës Juglindore, duke u kufizuar vetëm në mbarështrimin e punëve të kopshtarisë dhe pastrimit të xhunglës, me të vetmin paramendim, që “llava” e luftës së provokuar nga kanari i Francës, Serbia, të mos përhapet mbi gardhin e BE-së dhe të përmbysë sigurinë e kontinentit.

Marrëveshja Bazë e Brukselit vs gjeopolitikës kritike

Qëndrimi i boshtit *Berlin-Paris* ndaj Serbisë dhe me këtë edhe vetë Marrëveshja Bazë e Brukselit [shkurt 2023] ishte një përpjekje për ta tejkaluar gjeopolitikën klasike si traditë e realizmit politik në marrëdhëniet ndërkombëtare. Rrjedhimisht, Marrëveshja e Brukselit na rezulton si produkt i qasjes konform gjeopolitikës kritike. Kjo e fundit, siç dihet, është një ndërlidhje mes platformës së lirë të gjeografisë politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

Në themel të vetë marrëveshjes franko-gjermane duket se ishte parimi bazë i gjeopolitikës kritike, që ndërthen në vetvete interesat e boshtit në fjalë. Autorët e Marrëveshjes Bazë të Brukselit, me theks atë të Aneksit të saj të miratuar në Ohër [18 mars 2023], duke e shndërruar Kosovën në laborator eksperimental, përmes përkufizimit të *njohja faktike e Republikës së Kosovës*, sikur duan ta çmitizojnë gjeopolitikën klasike serbe, duke e vendosur atë në përputhje edhe me interesat e BE-së, plotësisht në kontekstin historik dhe perspektivën e rajonit si tërësi në BE. Gjeopolitika klasike përqendrohej kryesisht në katër elemente qenësore: *hapësirë, identitet, vizion dhe shtetbërje*.

Gjeopolitika kritike përqendrohet në *ndërtimin social të hapësirës* - mënyrën në të cilën hapësira është më kuptimplote dhe e qasshme nga shumë aktorë gjeopolitikë dhe idetë e tyre. Hapësira është thelbësore për gjeopolitiken kritike. Megjithatë, ndryshe nga gjeopolitika klasike dhe materializmi i saj shpesh i nënkuptuar, kjo shkarkon çdo marrëdhënie midis hapësirës gjeografike dhe politikës globale. Në vend të kësaj ajo heton ndërtimin social të hapësirës - mënyrën në të cilën hapësira bëhet kuptimplote nga një grup i gjerë aktorësh gjeopolitikë dhe idetë e tyre. [1]

Gjeopolitika kritike gjithashtu vë në dukje, se gjeopolitika historikisht ka shërbyer si një bazament qenësor i dijes, që mbetet e lidhur me lindjen e shtetit modern, pra si mjet i shtetbërjes. Procesi i shkërmoqjes së Jugosllavisë [1991-1999] duhet parë në dritën e transformimit të konceptimit të gjeopolitikës kritike në dobi të krijimit të shteteve të reja, rrjedhimisht edhe Republikës së Kosovës, në procesin e transformimit të plotë të Europës Juglindore. Në këtë proces të ri, në të cilin pretendohet të inkorporohet Europa Juglindore si tërësi, mund të ndihmojë fort gjeopolitika kritike, duke e shmangur vëmendjen nga temat klasike gjeopolitike, si dhe duke rikonceptuar tërësinë e saj dhe procesin integrues në BE dhe NATO. Si e tillë, gjeopolitika kritike, në rastin konkret, duke bërë përpjekje ta tejkalojë gjeopolitikën klasike, vë kështu në pyetje kufijtë e ngurtë midis identiteteve territoriale, duke sjellë në pikëpyetje edhe vetveten.

Letra e kryeministres serbe e rikthen marrëveshjen në pikën zero

Në samitin BE - Ballkani Perëndimor, që u mbajt në Bruksel në mes të dhjetorit 2023, që miratuar një deklaratë e përbashkët. Deklarata, mes të tjerash, u bënte thirrje të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor, që të vendosnin sanksione ndaj Rusisë dhe të punonin për të parandaluar

shmangien e masave kufizuese që Brukseli vendosi kundër Moskës, si përgjigje ndaj agresionit të saj kundër Ukrainës.

Në deklaratën në fjalë, përveç të tjerash, nënvizohej:

“Ne presim angazhim konstruktiv nga të dyja palët në mirëbesim dhe në frymën e kompromisit për të bërë progres të shpejtë në normalizimin e marrëdhënieve të tyre, gjë që është kritike për sigurinë dhe stabilitetin e të gjithë rajonit dhe për të siguruar që palët të mund të përparojnë në rrugëtimet përkatëse europiane”, – thuhet në deklaratën e Brukselit.

Kosovës dhe Serbisë iu bë thirrje ta zbatojnë plotësisht Marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve, Aneksin e saj, si dhe të gjitha marrëveshjet e mëparshme *“pa vonesa ose parakushte të mëtejshme”*. [2]

Por, pas publikimit të saj, i menjëhershëm ishte reagimi i Beogradit. Vetëm dy ditë para mbajtjes së zgjedhjeve, kryeministrja Bërnabiq i dërgon një letër Shërbimit të Jashtëm të BE-së.

*“Marrëveshja për rrugën drejt normalizimit të raporteve dhe Aneksi i zbatimit, siç i referohet në këtë deklaratë, konsiderohen të pranueshme vetëm në kontekstin në të cilin nuk përfshin **de facto** apo **de jure** njohjen e Kosovës”,* thuhet në dokumentin, ku Serbia ka shprehur qëndrimin e saj.

*“Republika e Serbisë nënvizon se kjo përshtatje nuk përfshin pranimin e anëtarësimit të Kosovës në OKB, në sistemin e organizatave të OKB-së dhe agjencive, e as të ashtuquajturin **integritet territorial të Kosovës**”,* thuhet më tej në letrën në fjalë, ku shtohet se kjo deklaratë konsiderohet si ligjërisht joobliguese dhe nuk e ka as peshën e marrëveshjes ndërkombëtare sipas së drejtës ndërkombëtare.

Më tutje, Serbia shprehet se *“Kosova është pjesë integrale e Republikës së Serbisë nën administrim ndërkombëtar, në përputhje me rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së”*. [3]

Por tashmë kanë kaluar javë dhe nga Brukseli nuk ka asnjë qëndrim konkret ndaj kësaj letre!

Pritej që në pjesën e dytë të janarit, kur u mbajtën takimet e strukturave të larta të BE-së (Komisionit, Këshillit të BE-së...), kjo letër, së paku, të trajtohej seriozisht. Përpjekja e zyrës së Borrellit për ta kaluar atë si të paqenë, lë shije të hidhur për frymën që dominon në Komisionin Europian.

Sidoqoftë, faktit se letra e kryeministres serbe e rikthen marrëveshjen në pikën zero, nuk mund t'i shmanget askush që ka parasysh rrjedhat e ngjarjeve nga 24 shtatori, kur kishim agresionin ushtarak serb në veri të Kosovës, e tutje deri në ditët e para të janarit të këtij viti, kur kryetëmë në qendrat e vendosjes po kthehet *siguria e rajonit*.

Kalimi nga korridoret e diplomacisë drejt betejave ushtarake

Gjithandej në BE, në mungesë të unitetit veprues për Europën Juglindore, rolin misionar për përgatitjen e publikut për ndryshimin e pritshëm ndërkohë, duket se do ta marrin forcat e majta liberale në koordinim me të djathtën konservatore. Projekti franko-gjerman, që u përvetësua nga blloku i BE-së dhe u mbështet edhe nga Britania e Madhe dhe SHBA-ja, i kopsitur në planin bazë të 27 shkurtit 2023, ishte produkt i këtij kompromisi. Sidoqoftë, ai nuk u nënshkrua nga presidenti serb. Ndërkaq, akti agresiv i Serbisë ndaj Kosovës më 24 shtator dhe letra e kryeministres së Serbisë, Ana Bërnabiq, drejtuar Këshillit të BE-së më 13 dhjetor, përmbys çdo gjë që ndërlidhet me marrëveshjen në fjalë.

Serbia ndërkohë, përveçse hedh poshtë katër pikat e para të marrëveshjes në fjalë, ajo vazhdimisht insiston se nuk do ta pranojë kurrë pavarësinë e Kosovës dhe se nuk e njeh integritetin territorial të Kosovës. Në përputhje me këtë qëndrim ishte akti agresiv i 24 shtatorit, por edhe qëndrimi

ndaj njësisë që ekzekutoi atë akt, dhe ndërkohë edhe përgatitjet intensive që po bën për ripërsëritjen e aktit në fjalë, meqë nuk heq dorë nga veriu i Kosovës. Të gjitha veprimet e tjera në raport me Kosovën, përfshi edhe njohjen e targave të automjeteve të Republikës së Kosovës, që po aplikohen nga 1 janari i 2024-ës, janë thjesht pjesë e taktikave dhe e manovrimit që bën lidershipi serb për t'u ikur sanksioneve të BE-së dhe masave që do të duhej të pasonin pas përfundimit të hetimeve rreth sulmit të 24 shtatorit 2023 në Banjë të Albanikut [Leposaviqit].

Europa Juglindore po përvijohet në rendin e ri, duke kaluar nga korridoret e diplomacisë drejt betejave ushtarake. Tri ngjarjet që shënjojnë këtë proces janë:

1. Agresioni ushtarak serb më 24 shtator 2023 në Banjë të Albanikut [Leposaviq];
2. Fluturimi i avionëve amerikanë F-16 më 6 janar 2024 mbi qiellin e Bosnjës në emër të sigurimit të sovranitetin e saj;
3. Vizita në Kosovë e ministrit të Jashtëm të Mbretërisë së Bashkuar, David Cameron, më 4 janar, me ç'rast ai e rikonfirmoi mbështetjen britanike ndaj Kosovës, respektivisht pozicionin e saj të qartë në rolin e protektorese së Kosovës.

Në këtë proces kalimtar, ngjashëm me kapërcyellin e shekullit XX, fitues janë ata që dinë të përzgjedhin aleancat dhe përcaktohen të rezistojnë.

Në procesin e transformimit harmonik të Europës dhe të integritetit të Europës Juglindore si tërësi në institucionet euroatlantike, me theks në NATO, rol të ndjeshëm, gjithësesi, pritet të ketë Britania e Madhe. Në këtë kuadër duhet parë edhe vizita e Sekretarit të Jashtëm britanik, David Cameron, në fillim të këtij viti në Prishtinë.

“Komuna fashiste serbe” alias Bashkësia Serbe në Kosovë

Në shtator të vitit 1919, saktësisht 2500 trupa këmishëzinjsh nën udhëheqjen e poetit ekscentrik dhe heroit të luftës, Gabriele D'Annunzio, pushtuan një qytet të vogël bregdetar kroat dhe themeluan Republikën e Fiumes (Rijekës) në rrënojat e Perandorisë Habsburge. Këtu ata shfaqën një spektakël të çuditshëm elementesh antagoniste: parada ushtarake, procesione me pishtarë dhe i kënduan himne luftës, të kombinuara me një orgji të pafundme të dashurisë së lirë, drogës dhe nudizmit.

Republika e Fiumes shënon fillimin e një shekulli dhune. Ajo bëhet laborator i estetik i fashizmit dhe një vend i hershëm i “antikulturës”, që do të promovohet në vitin 1968.

Në esenë e tij historike me titull sinjifikativ “Komuna fashiste”, Kersten Knipp përshkruan se si të gjitha këto aspekte kontradiktore kombinohen për të formuar një populizëm të rrezikshëm, masiv psikotik dhe tregon se si filloi ky episod mahnitës, që shënon fillimet e gabuara të shekullit XX.

Fashizmi modern serb gjatë procesit të shpërbërjes së Jugosllavisë e aplikoi këtë “kulturë” veprimi në Banjallukë, duke e shndërruar atë në epiqendrën kryesore të fashizmit serb.

Ideologët e “Botës Serbe” duke pretenduar ta kopjojnë suksesin e aplikuar në Banjallukë, ia kishin dalë të fitonin mbështetjen e qarqeve politike të veçanta të aleatëve të tyre tradicionalë, sidomos atyre francezë, që në përmbyllje të luftës në Kosovë [qershor 1999], të fillonin promovimin e “Komunës fashiste” në veriun e Mitrovicës, duke përfshirë në këtë kuadër tërë veriun e Republikës. Veriu i Republikës, edhe pas shpalljes së pavarësisë [17 shkurt 2008], do të mbetet oaza e eksperimentimit të fashizmit modern serb.

Zbulimi dhe mbyllja e 11 laboratorëve të drogës vetëm brenda dy viteve të fundit, 2022-2023, nga Policia e Kosovës; zbulimi dhe demolimi i

plotë i dhjetëra “laboratorëve” të tjerë të krijimit të kriptovalutave dhe një sërë “laboratorësh estetikë” të llojit të vet, që kishte inauguruar fashizmi serb përgjatë kohës nën regjinë e presidentit serb, Aleksandër Vuçiq, dhe dyshes së inkriminuar, Vulin-Radojçiq, është dëshmia më e mirë se çfarë do të mund të ishte Bashkësia e Komunave Serbe në Kosovë, në rast se ajo do të krijohej gjatë kohës, sa është në krye të pushtetit në Serbi kjo nomenklaturë fashistësh.

Në esenë e tij historike me titull sinjifikativ “Komuna fashiste”, Kersten Knipp përshkruan se si të gjitha këto aspekte kontradiktore kombinohen për të formuar një populizëm të rrezikshëm, masiv psikotik, dhe tregon se si filloi ky episod mahnitës, që shënon fillimet e gabuara të shekullit XX.

Po të mos ishte 14 shkurti i vitit 2021 dhe revolucioni demokratik i heshtur në Kosovë, që dërgoi në histori kolaboratorët dhe marionetat e fashizmit serb në Kosovë dhe aleatëve të tij, edhe brenda BE-së, fare lehtë do të mund të kishim një replikim të kësaj komune fashiste italiane në veriun e Republikës dhe hapjes së Kutisë së Pandorës, që do t’i paraprinte krijimit më të përshpejtuar të “Botës Serbe”.

Agjenda e krijimit të “Ballkanit të Hapur”, në themel të të cilit do të mund të ishte vetë krijimi i “Botës Serbe”, natyrisht mbi rrënojat e vendeve ku do të shtrihet ajo [Bosnjë e Mal të Zi], në emër të krijimit të korridoreve të lira e të sigurta drejt burimeve të energjisë, rrugëve të transportit dhe hyrjen e lirë të kapitalit perëndimor në tregun e Lindjes së Mesme dhe agjenda e forcimit të urës strategjike transatlantike të SHBA-së drejt Europës, me synimin e dominimit amerikan në çështjet europiane, përmbahen në projektin gjeostrategjik “New American Century” (Project for the New American Century - PNAC), botuar në vitin 1997, i cili në realitet u bë një dokument doktrinar i politikave të jashtme amerikane. [4]

Fashizmit të Vuçiqit pas 24 shtatorit i kanë rënë maskat. Vuçiqi përmes zgjedhjeve të 17 dhjetorit kërkoi të homogjenizojë gjithçka, duke shkatërruar të gjitha përjashtimet nga rregullat e tij, do të konkludonim, nëse perifrazojmë Mark Lipovetsky-in.

Ngjashëm si fashizmi rus, edhe fashizmi serb, me kohë, nuk i ka rezistuar dot infektimit nga idetë postmoderniste, që rezumojnë se ata që janë më të fuqishëm kanë gjithmonë të drejtë. Ky konkluzion, rrjedhimisht, e bën fashizmin serb “veçanërisht të rrezikshëm”, jo vetëm për kundërshtarët e tij politikë të brendshëm (rasti i Sanduloviqit), por edhe për rajonin.

“Serbia do të shpenzojë rreth 740 milionë euro vetëm këtë vit për blerjen e pajisjeve ushtarake dhe armatim”, – tha të shtunën presidenti serb, Aleksandër Vuçiq, në një konferencë për shtyp në Agjencinë për Siguri Ushtarake.

Këto komente kryefashisti serb Vuçiq i bëri vetëm dy ditë, pasi Shtetet e Bashkuara të Amerikës pranuan një kërkesë nga Kosova për blerjen e raketave antitanke “Javelin”, që ndërkohë do të shqyrtohet nga Kongresi Amerikan.

Sa herë që kryefashisti serb përballet me segmente të realitetit të ri në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, si dëshmi e funksionalizimit real të Republikës së Kosovës, ai i rikthehet Rezolutës 1244 të OKB-së, si fanatikët e religjioneve të “librit të shenjtë”. Duke komunikuar më shumë me publikun e brendshëm, ai në këtë komunikim publik, kësaj radhe, nuk kishte si të mos e shpërfaqte brengën e thellë për vendimin e SHBA-së, për t'i shitur Kosovës 246 raketa antitank të prodhimit amerikan, si dhe pajisje përcjellëse.

“Sipas Rezolutës 1244, nuk guxon të ketë asnjë grup të shqiptarëve të armatosur të Kosovës dhe ata krijuan një ushtri për ta dhe vazhdojnë ta krijojnë atë”[5], – tha Vuçiqi.

Kjo deklaratë e tij ndërlidhet kryekreje me teoritë mbi fashizmin modern.

“Postmodernizmi minon kundërshtimet binare, – thotë specialisti rus i kulturës në Universitetin e Kolumbisë. – Rrjedhimisht, postmodernizmi lufton edhe kundër esencializmit, idesë se ka disa kategori të përjetshme dhe të pazëvendësueshme që nuk i nënshtrohen kritikës.” (novayagazeta.eu/articles/2024/01/10/tsinicheskii-konsensus-golosuet-za-putina).[6]

Fashizmi që në zanafillën e tij ishte një ideologji politike dhe shoqërore. Që me shpërfaqjen e tij, ai bashkudhëtoi duke legjitimuar idetë mbi nevojën që ka shoqëria për liderin karizmatik, mbi bazat e një autoritarizmi të fortpërpunuar, nacionalizmi ekstrem, që do të kurorëzohej me krijimin e partive fashiste dhe shtetin fashist, që në krye do të promovonte diktatorë të tipit të Musolinit, Hitlerit, Millosheviqit, Putinit...

“Postmodernizmi” është një shkollë e mendimit, që ka përqafuar një qasje të veçantë ndaj shkencës, artit, filozofisë dhe kulturës në përgjithësi. Për shembull, ka theksuar relativizmin, skepticizmin ndaj narrativave absolute, dhe një ndjenjë të fragmentarizmit dhe ndryshueshmërisë në shoqëri. Prandaj fashizmi postmodern serb i ka rrënjët në mendimin politik që prodhoi Akademia e Arteve dhe e Shkencave, që do ta përgatiste opinionin për dekada me radhë, për gjenocidin serb në Kosovë, në përmbyllje të dekadës së aparteidit në shekullin XX.

Sipas Lipovetsky-t, “një komponent i rëndësishëm i të ashtuquajturit “fashizëm postmodern... është bërë një konsensus cinik, në të cilin fuqitë dhe shoqëria kanë arritur marrëveshje se nuk ka rregulla dhe se nuk ka nevojë t'i kërkojmë ato. Ekziston vetëm post-e-vërteta: kushdo që mund të gënjejë më

ashpër ka të drejtë. Në këtë rast, gënjeshtria si virtyt serb, siç e cilëson atë i ashtuquajtimi *baba i kombit serb*, Dobrica Qosiq, ngrihet në piedestalin e komunikimit publik.

Fashizmi postmodern serb shpërfaqet sot kudo në jetën shoqërore e politike, por ai kulmin e ka arritur në mënyrën e qeverisjes, ku dominon fryma autoritare, nacionaliste, me orientim të theksuar antishqiptar, i shoqëruar nga ndjesi të theksuara të fragmentarizmit, relativizmit ose përdorimit të teknologjisë dhe medieve moderne, për ta promovuar atë si ide për mbrojtjen e Serbisë dhe interesave nacionalë serbë!

Këtë stil të komunikimit në frymën e fashizmit postmodern fashizmi serb, po të përdornim konkluzionet e Lipovetsky-t për fashizmin rus, tipizohet me rritjen e agresivitetit brenda shoqërisë serbe, sidomos në raport me kundërshtarët politikë pas zgjedhjeve të 17 dhjetorit 2023, por edhe në raport me botën e jashtme, pavarësisht se ka nota ironie në fjalorin e kryefashistit serb.

“A jemi ne të fortë si Amerika, Anglia, Gjermania, Turqia? Nuk jemi. Por mund t’i tregojmë gjithë botës se kjo [armatimi i FSK- SR], në mënyrë brutale, shkel normat juridike ndërkombëtare”, shprehet Vuçiqi në fjalimin në fjalë. [7]

Kjo gjuhë pak dallon nga ajo e mercenarëve serbë, të cilët kanë shkuar në Donbas për të ndihmuar rusët në luftën kundër Ukrainës, që së fundmi kanë dalë edhe me një mesazh kërcënues për Kosovën. Në videon që po qarkullon në rrjetin social “X” shihet një mercenar serb, i cili para flamurit të Serbisë dhe Rusisë mban fjalim, ku paralajmëron se pas Donbasit, destinacioni tjetër është Kosova.

“Dëshirojmë të përshëndesim të gjithë vëllezërit në Kosovë dhe t’u bëjmë të ditur se nuk janë vetëm. Ne jemi sot këtu, në dashtë Zoti, për të hequr qafe okupatorët e NATO-s nga Kosova. Destinacioni tjetër është

Kosova!” *Kosova është Serbi*” [8], – deklaroi mercenari serb si një fashist tipik postmodern.

Fashizmi postmodern serb është “rezultat i këtij konsensusi cinik, pranimit të rregullave të lojës, sipas të cilave të fortët kanë gjithmonë të drejtë”. Por, si duket, Vuçiqi e ka të qartë se “*në një botë të tillë, pothuajse të gjithë janë më të fortë se disa dhe më të dobët se të tjerët, por të gjithë do të përpiqen t'i mashtrojnë të gjithë, se kështu është realiteti*” [9], prandaj ai vazhdon të luajë rolin e viktimës. Në këtë vazhdë është edhe mohimi i masakrës së Reçakut, edhe 25 vjet pasi ajo u krye nga forcat serbe.

“E vërteta e plotë për ngjarjen në fshatin Reçak, më 15 janar 1999, po i zbulohet botës. E vërteta, që unë atëherë e konstatova si gjykatëse hetuese, se nuk ka pasur masakër ndaj civilëve, por se ishte një veprim legjitim nga ana e policisë serbe kundër terroristëve të së ashtuquajturës Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK), kjo dihej, duke filluar nga ata që morën vendimin për bombardimin e Federatës së atëherëshme të Republikës së Jugosllavisë, por kjo nuk ishte në interesin e tyre”, [10] pohon për të përditshmen serbe “Novosti”, ish-gjykatësja hetuese për rastin e Reçakut, Danica Marinković.

Përpjekja për ta mohuar sërish dhe sërish masakrën e Reçakut, por edhe gjenocidin ndaj shqiptarëve, mbetet pjesë e strategjisë së fashizmit postmodern serb në dobi të selitjes më tutje të “konsensusit cinik”.

“Filozofi slloven, Slavoj Žižek, flet për konceptin e Jouissance-s, – thotë Lipovetsky, – ndjenjën që edhe të shtypurit ndiejnë kur janë në gjendje të mashtrojnë një mjeshtër ose të bëhen mjeshtër për ata që janë edhe më të dobët”. Duket se kjo është baza e konsensusit cinik të Vuçiqit me

bashkëmendimtarët e tij, me të cilët ai u ribashkua në prag të zgjedhjeve, sepse ky model i lejon të gjithë fashistët e të gjitha formateve të ndihen më të sigurtë në fitore, gjithsesi edhe më të lumtur, madje i bën ata më imunë dhe të gatshëm të përballen duke injoruar problemin real.

“Postmodernizmi shpesh barazohet me papërgjegjshmërinë, – thotë studiuesi i Kolumbisë, – por kjo nuk është e vërtetë. Është një art i përgjegjësisë: po, nuk ka të vërteta objektive, por kjo do të thotë se unë jam përgjegjës për ato të vërteta që njoh dhe promovoj. Kërkon që individi të jetë përgjegjës në matricën ku personi e konsideron veten pjesë”.

Prandaj Lipovetsky konkludon: *“Kërcimi nga një sistem koordinativ në tjetrin për arsye përfitimi, duke thënë se nuk ka të vërtetë dhe se nuk mund të ekzistojë ose paraqitja në mënyrë agresive e gënjeshtrove fare hapur si të vërteta, nuk do të thotë se është në përputhje me postmodernizmin, përkundrazi ai veprim është thjesht cinizëm”.* Ky konsensus cinik në Serbi përbën themelin e shtetit të Vuçiqit, që Perëndimi duhet ta sfidojë dhe, jo më tutje, të bëjë çdo gjë që ta shkëpusë nga orbita serbe dhe ta inkorporojë si pjesë të demokracive liberale.

Maqedonia e Veriut - paterica e “Ballkanit të Hapur”

Në një situatë gjeopolitike të ndryshuar, BE-ja vazhdon të mos ketë agjendë të qartë për perspektivën e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor. Në këto rrethana, bashkëpunimi i Serbisë, dhe jo vetëm asaj me Rusinë, ka marrë një kuptim të ri që nga fillimi i luftës në Ukrainë.

BE-ja ndërkohë ka pësuar humbje të ndjeshme të besueshmërisë, veçanërisht për shkak të statusit aktual të politikës së zgjerimit. Vështirë se ndonjë vend në Ballkanin Perëndimor beson që sot ka një mundësi reale për anëtarësim në një të ardhme të afërt, pavarësisht frazave të përsëritura shpesh, se e ardhmja e Ballkanit Perëndimor [BP] qëndron në Europë.

Gjashtë shtetet e BP-së, sidoqoftë, nuk pranojnë me dëshirë të ulen dhe të presin përgjithmonë në dhomën e pritjes së BE-së pa bashkëpunuar me aktorë të jashtëm, nga të cilët po marrin përfitime të drejtpërdrejta. Rusia, Kina, Turqia etj., janë fuqitë që kanë ndërhyrë thellë në ekonominë e BP-së dhe, gradualisht, ndikojnë edhe në agjendën e tyre politike. “Ballkani i Hapur” rezulton të jetë produkt i kësaj ndërhyrjeje dhe si zëvendësim i gjakimit për anëtarësim në BE.

Megjithëkëtë, rivalitetet gjeopolitike me Rusinë nuk duhet të çojnë në tejkalimin e reformave thelbësore në BP, me improvizime e zgjidhje *ad hoc*. Kjo do të thotë qartë se me Serbinë, që nuk vendos sanksione kundër Rosisë, nuk zgjidhet dot konflikti historik i Kosovës. Prandaj BE-ja dhe Perëndimi në tërësi duhet të punojnë më intensivisht në këto fronte. Perëndimi gjithashtu duhet të ndryshojë qasjen ndaj aktorëve lokalë, si Vuçiq ose Dodik, që tashmë janë shtytësit kryesorë të politikës proruse në Ballkan, në vend që të mbivlerësohet potenciali i Rosisë për ndërhyrje të mundshme.

Procesi i anëtarësimit për Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë ka hyrë në një rrugë me ndeshtrasha të reja. Me këtë akt Brukseli ka dërguar sinjale të gabuara në rajon. Reformat rezultojnë të parëndësishme sapa del në skenë një shtet anëtar i BE-së, që mund të bllokojë procesin e zgjerimit, siç është në këtë rast Bullgaria. Por ndërhyrja në këtë rast e Bullgarisë, me kushtëzimin që Maqedonia e Veriut të kryejë reformën e duhur kushtetuese, përmes së cilës do të pranohej ekzistenca e minoritetit bullgar, e ka rikthyer Maqedoninë e Veriut në vëmendjen e shteteve fqinje dhe jo vetëm.

Në këtë kuadër, Republika e Maqedonisë së Veriut ka një rëndësi jetike dhe mund të shërbejë si një faktor i rëndësishëm për paqen dhe stabilitetin në rajon, po aq sa mund të shndërrohet edhe në mollë sherri, për disa arsye:

1. Stabiliteti politik: Pas përplasjes mes shtetit dhe kryengritësve shqiptarë nën emblemën e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në vitin 2001, që qe përbyllur me Marrëveshjen e Ohrit, dhe hapjen e perspektivës së trajtimit të shqiptarëve si shtetas së Republikës, ka arritur të ndërtojë një stabilitet politik relativ. Përmirësimi i situatës politike dhe arritjet në integrimin europian kanë kontribuar në forcimin e institucioneve dhe rregullit të ligjit, duke krijuar një mjedis më të sigurt politik dhe shoqëror.

2. Diversiteti etnik dhe kulturor: Maqedonia e Veriut është një vend me një popullsi të shumëllojshme etnike dhe kulturore. Përkushtimi për të promovuar diversitetin dhe për të siguruar të drejta të barabarta për të gjitha grupet etnike në vend, ka hapur mundësinë e ndërtimit të një shoqërie të harmonishme dhe në zbutjen e tensioneve ndëretnike. Por ky proces nuk është i kënaqshëm për një pjesë të mirë të spektrin politik shqiptar në Maqedoninë e Veriut dhe për përfaqësuesit e minoritetit bullgar.

3. Roli gjeostrategjik: Maqedonia e Veriut ndodhet në një pozicion gjeostrategjik të rëndësishëm në Ballkanin Perëndimor. Si një vend tranzit, Maqedonia e Veriut ka një rëndësi të veçantë në lidhjet e tregtisë dhe transportit në rajon, duke lidhur Europën Qendrore dhe Lindore me Adriatikun dhe detin Egje. Stabiliteti dhe zhvillimi i këtij vendi mund të kontribuojë në rritjen e bashkëpunimit ekonomik dhe të sigurisë në rajon.

4. Integrimi në strukturat ndërkombëtare: Përpjekjet e Maqedonisë së Veriut për integrim në Bashkimin Europian dhe NATO kanë qenë një faktor stabilizues në rajon, sidomos aderimi i saj në NATO. Këto procese kanë kontribuar ndjeshëm në orientimin vizionar dhe në rritjen e shpresës për

pozicionim të shtetit në plane afatgjata, duke marrë në konsideratë edhe interesat gjeopolitikë të shqiptarëve. Maqedonia e Veriut, fundja, është interes jetik i shqiptarëve si Komb. Dy republikat tona ekzistuese, Shqipëria politike dhe Republika e Kosovës, e duan dhe e cilësojnë Maqedoninë e Veriut si një partner të rëndësishëm për paqen dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor.

5. Ndërhyrja e Serbisë dhe Ruisë: “Ballkani i Hapur” si projekt strategjik është produkt i interesave të Serbisë dhe Ruisë në rajon. Insistimi për ta rikthyer në jetë këtë projekt, edhe pas një largimi të heshtur të Shqipërisë, ka karakter të pastër gjeopolitik. Si i tillë, ky projekt bie ndesh jo vetëm me interesin e shqiptarëve, por edhe atë të BE-së.

Forcat politike në Maqedoninë e Veriut, që aktualisht janë në pushtet, duke përfshirë edhe BDI-në, janë viktimë e këtij kursi strategjik, që e ka shndërruar Republikën e Maqedonisë së Veriut në një patericë të “Ballkanit të Hapur”, alias Serbisë.

Fushata e zgjedhjeve në Maqedoninë e Veriut, tashmë në proces, do ta shpërfaqë edhe më shumë këtë ndarje me karakter të pastër gjeostrategjik. Rezultati i tyre, rrjedhimisht, ose do ta betonojë *status quo*-në, duke i lënë terren ndikimit serbo-rus, ose do ta orientojë Republikën e Maqedonisë së Veriut në një proces të ri politik, që e shndërron atë në një shoqëri plotësisht multietnike dhe demokratike, duke i hapur rrugë vetëvendosjes së brendshme të shqiptarëve dhe federalizimit të saj.

Serbia - peng i Ruisë

Serbia, sado e vogël që është, për shkak të pozicionit gjeostrategjik dhe lidhjeve tradicionale me Rusinë (në Lindje) dhe Francën (në Perëndim), duke qenë për kohë të gjatë bërthama dhe vetë zëri i Jugosllavisë, kishte “kaluar

ylberin” dhe mangësitë e imponueshme për secilin shtet të vogël, duke u shndërruar në një lloj xhandari për ish-Jugosllavinë dhe Ballkanin. Jo rrallë gjatë proceseve historike ia ka arritur të vendosë agjenda politike për rajonin, dhe kështu të ketë kapacitet të shtuar për të ndikuar ose modifikuar sjelljen e të tjerëve ndaj saj. [11]

Kjo përzgjedhje e Serbisë për rreshtim, dëshmon se ajo parapëlqen të maksimizojë më tutje ndikimin e saj, prandaj ka paralajmëruar një strategji të jashtme dhe sigurie të bazuar në pozicionimin e qartë të saj pro Ruisë.

Ja disa faktorë, të cilët kanë ndihmuar në forcimin e marrëdhënieve midis Serbisë dhe Ruisë:

1. Lidhjet kulturore dhe historike: Serbia dhe Rusia kanë një histori të përbashkët ortodokse dhe kanë pasuar një traditë të përbashkët kulturore. Kjo ka krijuar një ndjenjë të fortë të solidaritetit midis tyre.

2. Ndihma e Ruisë në institucionet ndërkombëtare: Rusia pothuajse përherë ka pasuar rolin e mentorit kujdestar të mbështetjes ndaj Serbisë në disa institucione e organizata me karakter ndërkombëtar dhe shtete specifike, sidomos në periudhën pas çlirimit të Kosovës [1999], duke u angazhuar tok për ruajtjes së *status quo*-së dhe mundësisht ndarjes së saj.

3. Politikat e jashtme të përbashkëta: Në disa raste, Serbia ka ndarë pozicionet me Ruisë në politikat ndërkombëtare, përfshirë pozitat e tyre në Kombet e Bashkuara dhe në forumet ndërkombëtare të tjera. Ndërkohë, Serbia po hedh hapin e parë drejt objektivit të shndërrimit të saj në shtet militar, duke mos ngurruar që të zbatojë detyrimin që ka marrë kundruall Ruisë: të rishikojë mundësitë e hapjes së frontit të dytë në Ballkanin Perëndimor. Kjo duhet të jetë arsyeja themelore, se përse Serbisë i duhet rekrutimi masiv i të rinjve serbë. Kësaj ideje i shërben aplikimi i shërbimit të detyrueshëm ushtarak, që u paralajmërua nga ministri serb i Mbrojtjes, Millosh Vuçeviq. Ai njoftoi se dokumenti gjegjës për këtë ka mbërritur në

kabinetin e Presidentit, ndërkaq pastaj ai i dërgohet kabinetit ushtarak dhe Kuvendit. Nëse rikthehet shërbimi ushtarak, propozimi është që të zgjasë deri në katër muaj, raporton “Pink”. [12]

“Pas 13 brezash dhe duke pasur parasysh rreziqet me të cilat po përballlet vendi ynë, Shtabi i Përgjithshëm i Serbisë dhe Ministria e Mbrojtjes iu drejtuan zyrtarisht dje Presidentit të Republikës dhe nisën nismën për rikthimin e shërbimit të detyrueshëm ushtarak”, ka thënë Vuçeviq [13]. Në traditën e marrëdhënieve mes Serbisë dhe Rusisë, bashkëpunimi në rrafshin ushtarak ka histori të veçantë.

Në fillim të vitit 1945, trupat sovjetike filluan marshimin drejt Ballkanit, duke përfshirë Jugosllavinë. Në prill të vitit 1945, forcat sovjetike bënë një “bashkim” të suksesshëm me Ushtrinë e Jugosllavisë, alias Serbisë. Ky “bashkëpunim” e lehtësoi marshimin e tyre drejt Beogradit dhe forcoi kapjen e qytetit.

Më 20 tetor 1944, pas një rezistence të fuqishme nga forcat gjermane, dy ushtritë, ajo ruse dhe jugosllave, do të çlironin Beogradin. Kjo ngjarje do të shënonte kulmin: ishte pjesë e një sekuence ngjarjesh, që çuan në varësinë e Jugosllavisë në raport me BRSS-në, deri në përplasjen e vitit 1948, kur Jugosllavia “do të shkëputej nga i ashtuquajtimi Bllok Socialist”. Sidoqoftë, kultivimi i raporteve mes Serbisë dhe Rusisë do të vazhdonte më tutje, sidomos në rrafshin ushtarak. Ndërkaq, pas shpërbërjes së Jugosllavisë [1990], e sidomos në dekadën e fundit [2012-2023], Serbia është shndërruar në një pengë i llojit të vet i Rusisë, duke u trajtuar intensivisht në tabelën e shahut gjeopolitik global e rajonal, siç do të thoshte gjeostrategu amerikan, Zbigniew Brzezinski.

Pas Luftës së Dytë Botërore, Europa pësoi një transformim të thellë, duke shënuar një periudhë të re në historinë e saj. Ky transformim u karakterizua nga ndryshimet politike dhe territoriale, që u pasua me formimin e bllokut të ri të fuqive në skenën ndërkombëtare. Ky transformim, veçmas në rrafshin e sigurisë, do të kurorëzohej me krijimin e aleancës më të madhe politiko-ushtarake NATO-s, pjesë e së cilës do të ishin pjesa më e madhe e shteteve të Europës Perëndimore. Ndërkaq, në rrafshin socio-ekonomik do të thellohet sidomos me krijimin e bërthamës së Bashkimit European. Serbia, si strumbullari i Jugosllavisë, ishte përfshirë në këtë proces të ndryshimit, duke gëzuar mbështetje të fuqishme ekonomike dhe politike.

Megjithatë, pas vdekjes së Titos në vitin 1980, dhe sidomos me fillimin e ndryshimeve në skenën ndërkombëtare, që do të shënjojë shembja e Murit të Berlinit dhe ribashkimi i Gjermanisë, Jugosllavia hyri në procesin e shpërbërjes së përgjakshme. Skenarët e tmerrshëm të katër luftërave dhe dy gjenocideve që do të shkaktojë Serbia në këtë proces, janë produkt i ideologëve serbë, që po shestonin krijimin e Serbisë së madhe, alias “Botës Serbe”.

Serbia dhe Kroacia përbënë dy aktorët kryesorë të këtij shpërthimi konfliktual, që çuan në ndarjen e Jugosllavisë. Ndërkaq, koston më të lartë për këtë proces zhbërjeje do ta shlyejnë dy popujt, ndaj të cilëve Serbia ushtroi edhe gjenocid, pra boshnjakët (BeH) dhe shqiptarët (Kosovë).

Lufta që Serbia imponoi në Kosovë deri në përmasat e gjenocidit [1998-‘99], shkaktoi ndërhyrjen ndërkombëtare në vitin 1999, me ç’rast, për ndaljen e gjenocidit në Kosovë, NATO-ja do të bombardonte caqet e ushtrisë serbe për plot 78 ditë, kur Beogradi do të pranonte kapitullimin dhe

nënshkrimin e Marrëveshjes së Kumanovës [9 qershor 1999], gjë që pasoi çlirimin e Kosovës nga trajtimi i saj kolonial për plot 87 vite [1912-1999].

Pas këtyre ngjarjeve, Serbia për një kohë të shkurtër pësoi një izolim ndërkombëtar, por pa u ndëshkuar siç do të duhej, respektivisht siç ndodhi me Gjermaninë naziste pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Madje pasoi një periudhë, kur Serbia po trajtohej si faktor stabiliteti dhe paqeje në rajon!

Në këtë kuadër ripozicionimi gjeopolitik i perëndimit ndaj Serbisë, sidomos në dekadën e fundit, ishte i ndërlidhur dhe i kalkuluar me ripozicionimin ndaj Federatës Ruse.

Dekada e fundit është periudha kur Serbia ka tentuar të ristrukturohet dhe të forcohet si një shtet i pavarur në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, duke përthithur financa nga të gjitha palët. Kjo përfshin edhe kuazipërprojekjet e saj për t'u integruar në strukturat euroatlantike dhe për të ndërtuar marrëdhënie më të mira me fqinjët e saj. Projekti për "Ballkanin e Hapur" kishte objektiv ristrukturimin e Jugosllavisë së Re [pa Slloveninë e Kroacinë, plus Shqipëria], duke pretenduar ta mbajë Kosovën në statusin e ngrirë, por, gjithsesi, kjo strukturë e re do të ishte nën drejtimin e Serbisë. Sidoqoftë, rifillimi i luftës në Ukrainë, në shkurtin e vitit 2022, do të ishte edhe fundi i këtij projekti ambicioz për Serbinë.

Përfundime

Bota gjatë vitit 2024 nuk do të gjejë paqe mes krizave dhe luftërave. Europa Juglindore në këtë mes, meqë Serbia është shndërruar në vasale-peng e Ruisë, ndodhet po ashtu mes krizave dhe luftës.

- Çfarë roli do të ketë BE-ja në ruajtjen e paqes në Ballkanin Perëndimor, i cili po këtë vit po përballlet me zgjedhjet, në koncertin e lojtarëve të mëdhenj,

e nëse do të luajë një rol, cili do të jetë ai rol? Janari për shumëçka mund të jetë vendimtar edhe në këtë plan.

Rënien e Jugosllavisë nuk mund ta venerojmë si duhet jashtë zhvillimeve gjeopolitike. Kjo shkërmoqje u pasua me krijimin e kaosit dhe shpërthimin e luftërave të programuara.

Fenomenin e krijimit të kaosit të programuar e ka studiuar mirë gjeopolitikani William Engdahl në librin e tij të famshëm, “Një shekull luftë”.

Thellimi i krizës në Ballkan duke imponuar “Komunën fashiste”, serbe alias Bashkësinë e Komunave Serbe, si uverturë të secesionit, shëmbëllim Republikës Serbe në Bosnjë dhe krijimi i kaosit të programuar, vështirë se do të kufizohej vetëm në Kosovë dhe Bosnjë.

Rirreshtimi i Serbisë sërisht në krah të Rusisë ose pozicionimi i saj në krah të Perëndimit mbetet i ndërlikuar me projektin e ideologëve serbë, që mban tiketën “Bota Serbe”. Në cilindo krah që do të pozicionohet Serbia ndërkohë, ajo do të shndërrohet në instrument të luftës së programuar, që gjithsesi do të përfundojë me krijimin e një harte të re politike në Europën Juglindore.

1 Shih: Dodds, K. & Sidaway, J. D. (1994), “Locating critical geopolitics”, *Environment and Planning D: Society and Space* 12: 515-524.

2. <https://www.evropaelire.org/a/perafrimi-i-politikes-se-jashtme-ne-qender-te-samitit-be-ballkani-perendimor/32728573.html>

3. <https://www.ishgj.org/aktualiteti/perfundon-samiti-be-ballkani-perendimor-te-gjitha-vendet-e-pranojne-deklaraten/>

4. <https://academic-accelerator.com/encyclopedia/project-for-the-new-american-century>

5. <https://www.evropaelire.org/a/vuciq-thote-serbia-shpenzoj-170-milion-pasisje-ushtarake/32773043.html>

6. Paul Goble: <https://www.eurasiareview.com/14012024-cynical-consensus-in-russia-makes-putins-fascism-especially-dangerous-oped/>

7. <https://www.evropaelire.org/a/vuciq-thote-serbia-shpenztoj-170-milion-pasisje-ushtarake/32773043.html>
8. https://twitter.com/DD_Geopolitics/status/1746372854961361111?ref_src=twsrc%5Etfw%7Ctwcamp%5Etweetembed%7Ctwterm%5E1746372854961361111%7Ctwgr%5Ece2a74c43a35692040ef8a4295e5ded28a407641%7Ctwcon%5Es1_&ref_url=https%3A%2F%2Fpamfleti.net%2Fprishtine%2Fkerce-nojne-mercenaret-serb-do-te-heqim-qafe-nato-n-destinacioni-i-radh-i207724
9. Paul Goble: <https://www.eurasiareview.com/14012024-cynical-consensus-in-russia-makes-putins-fascism-especially-dangerous-oped/>
10. <https://www.novosti.rs/drustvo/vesti/1322043/voker-lazirao-masakr-opravda-akciju-nato-proslo-25-godina-oruzanog-sukoba-selu-racak-koji-bio-povod-agresiju-srj?fbclid=IwAR2B0fbTfIpV8e13TXLF5CKzMkA6Ck4dP2N5GgNLx1zvKa4vKE3Bdx2qYP4>
11. Fendius Elman, Miriam (1995). “The Foreign Policies of Small States: Challenging Neorealism in Its Own Backyard”, *British Journal of Political Science*, 25, Issue 2, pp. 171-217.
12. <https://www.Kosova-online.com/vesti/politika/vucevic-srbija-pobedjuje-u-miru-ne-idemo-u-ratove-ali-morate-da-pratite-sta-se>
13. Po aty.

Kumtesë e mbajtur në tryezën shkencore “*Konstelacionet gjeopolitike në Ballkan në kontekst të Marrëveshjes së Brukselit [27 shkurt 2023] – Kosovë-Serbi*”, e organizuar nga Instituti Shqiptar për Gjeopolitikë, në ambientet e Institutit Albanologjik në Prishtinë, më 14.02.2024. [SR]

1.2 Akademik Ksenofon KRISAFI

A mund (dhe a duhet) të bashkohen shqiptarët?

Në vitin 1897, Abdyl Frashëri, një ndër shtetarët dhe diplomatët më të mëdhenj të trojeve shqiptare, i shkruante kryeministrit italian, arbëreshit Francesco Crispi:

“Në rast se fuqitë e mëdha do ta dënojnë këtë popull trim dhe liridashës të mbetet në robëri dhe ca më keq të copëtohet midis shteteve fqinje, Gadishulli Ballkanik nuk do të ketë kurrë qetësi, sepse shqiptarët nuk do të pushojnë asnjëherë së luftuari për të fituar pavarësinë e tyre kombëtare. Përkundrazi, në rast se shqiptarëve do t’u njihen të drejtat e tyre kombëtare, Shqipëria do të bëhet faktor i paqes dhe do të kthehet në një digë kundër ekspansionit carist, i cili rrezikon jo vetëm Gadishullin Ballkanik, por edhe Kontinentin European”.

Zhvillimet e deritanishme, përgjithësisht të karakterit toksik, e kanë provuar profecinë dhe aktualitetin e thënies së tij. Ballkani ka qenë dhe vazhdon të jetë “fuçi baruti”. Paqja vazhdon të mbetet seriozisht e kërcënuar nga padrejtësitë e ricikluara kohë pas kohe dhe rreziku rus sërish është i pranishëm si qëmoti.

Një ndër këto padrejtësi lidhet me moszgjidhjen e duhur të së ardhmes politike të shqiptarëve, e cila, siç thotë profesori i madh, Rexhep Qosja, *“pjesërisht është përmirësuar, pjesërisht është zgjidhur, por nuk mund të quhet historikisht e zgjidhur. E shikuar e shprehur në gjithë shtrirjen e saj gjeografike dhe demografike me mënyrën e jetës së tyre në trojet ku shqiptarët janë popullatë e vetme a shumicë etnike, çështja kombëtare mbetet edhe më tej çështje e rëndë kombëtare, një nga më të rëndat në Europë sot”.*

Ajo shtrohet në formën e pyetjes retorike: *Ç'do të bëhet me shqiptarët, një popull që, duke qenë të shpërndarë në 6 shtete të Gadishullit Ballkanik, përbëjnë një nga rastet më të rralla në Europë e në botë?*

Nga zgjidhja e saj me urtësi dhe sens objektiviteti do të varet jo vetëm e ardhmja e tyre, por edhe paqja dhe siguria në Ballkanin Perëndimor, zhvillimet dhe prosperiteti politik, ekonomik e social i popujve të tjerë në gadishull dhe në Europë.

Në vijim do të flitet shkurt për aspektet juridiko-ndërkombëtare të alternativave të mundshme për zgjidhjen e saj.

Konservimi i *status quo*-së aktuale do të nënkuptonte vazhdimin e politikave asimiluese ndaj shqiptarëve që nuk janë pjesë e Shqipërisë dhe Kosovës; do të inkurajonte për arbitraritete të tjera ata, të cilëve u mohuan gjuhën, përkatësinë etnike, u mbyllën shkollat, u prishën kishat dhe xhamitë, u ndërruan emrat, kombësinë, fenë, i dënuan me amnezi historike dhe kombëtare, çka nuk pajtohet me konceptet dhe sjelljet moderne të qytetërimit të sotëm.

Kjo çështje kombëtare, ende e pazgjidhur në formën e saj më të përshtatshme, pret ditë më të mira. Një ndër alternativat, e ndryshme nga ajo që u përmend më sipër, është organizimi i shqiptarëve në një shtet kombëtar, siç ka ndodhur me fqinjët rreth një shekull e gjysmë më parë.

Kjo është jashtëzakonisht e vështirë, në mos e pamundur, sepse mund të preken realitete, mund të cenohen tërësi territoriale shtetesh, mund të prishen ekuilibra gjeopolitikë që ekzistojnë prej rreth një shekulli dhe mund të hapen probleme të reja.

Prandaj, zgjidhja optimale, relativisht më pak e komplikuar dhe njëkohësisht më e mundshme nga pikëpamja gjeopolitike dhe juridiko-ndërkombëtare, do të ishte integrimi-bashkimi kombëtar Shqipëri-Kosovë, shoqëruar edhe me ndërhyrje të rëndësishme për përmirësimin e statusit të

shqiptarëve që mbeten jashtë këtij unioni. Është rekomanduar si një ndërmarrje, që mund të kontribuonte pozitivisht krijimi i një *commonwealth*-i ekonomik ballkanik, madje edhe shqiptar, por me sa duket jo i mirëpritur.

Kështu që diskutimet fokusohen te bashkimi Shqipëri-Kosovë, i përkufizuar butë si integrimi ose edhe vëllazërimi ndërshqiptar. Ai mund të shfaqet në dy variante:

- *Varianti i pari është i ashtuquajtur “bashkim në Bruksel”,* që mendohet se do të realizohet kur Shqipëria dhe Kosova, dhe bashkë me to edhe Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, ku jetojnë disa dhjetëra-mijëra shqiptarë, të anëtarësohen në BE.

Aty shqiptarët do të kenë mundësi të gjithë ta konsiderojnë veten qytetarë të Europës së Bashkuar, rrjedhimisht edhe pjesë të një Shqipërie të Bashkuar. Do të kenë mundësi që, si shtetas europianë, të lëvizin, të vendosen, të jetojnë, të punësohen, të shkollohen, të mjekohen etj. kudo, pra edhe në të gjitha territoret shqiptare në Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë e Veriut, Serbi, Mal të Zi, Greqi etj.

Ky bashkim do të ishte më i thjeshti dhe pa kosto. Por nga disa qarqe shqiptare, ai nuk konsiderohet si bashkim i mirëfilltë, si realizimi i plotë i përfytyrimeve dhe i dëshirës që kanë shqiptarët për të ardhmen e tyre politike. Dozat e mosbesimit shtohen sidomos nga qëndrimet e vazhdueshme kërcënuese të Beogradit, të përqendruara sistematikisht në veriun e Kosovës, ku ndonjëherë marrin trajta të qarta agresive, që rrezikojnë jo vetëm shqiptarët, por edhe paqen dhe sigurinë në rajon.

Dëshirën e shqiptarëve për krijimin e një atmosfere besimi me serbët e komprometojnë keqas sidomos përqendrimet e forcave ushtarake përreth Kosovës, si dhe rritja e konsiderueshme e dispozitivit luftarak nga Serbia, nëpërmjet blerjeve të armëve moderne në Rusi dhe vende të tjera dhe stacionimi i tyre në kufij me të.

Ato shtojnë pikëpyetjet te shqiptarët për efikasitetin e integritit ndërshqiptar në formën e lartpërmendur të anëtarësimit në strukturat e Brukselit të shteteve, në territoret e të cilëve banojnë shqiptarë. Në këto rrethana, ata preferojnë një bashkim më të ngushtë, mundësisht ndërshqiptar, i cili shoqërohet me shumë vështirësi. Më së paku, për zbatimin e tij duhen përballuar ky kushte, të lidhur dhe të kushtëzuar me njëri-tjetrin.

Kushti i parë ka të bëjë me përgatitjen e një mjedisi të përshtatshëm dhe të pranueshëm politik, i cili nuk varet vetëm nga faktori lokal, por domosdoshmërisht edhe nga pëlqimi, madje edhe nga konsensusi i ndërkombëtarëve. Zhvillime të tilla shoqërohen me reperkursionë të thella politike, ekonomike, sociale etj., rajonale, çka, veç pëlqimit të fqinjëve, kërkon detyrimisht edhe marrëveshjen me Fuqitë e Mëdha, sepse ato vazhdojnë të shfaqen në rolin e arbitrit suprem, duke mbajtur ekskluzivitetin e prerogativave të përcaktimit të zgjidhjeve të një rëndësie kaq madhore.

Për identifikimin e zgjidhjes së pranueshme mund të mbahen parasysht disa nga përvojat pozitive ndërkombëtare, si ato të bashkimit të Vietnamit, Jemenit dhe sidomos precedenti gjerman, që duket si më i përshtatshmi. Për të janë shprehur rezerva, me justifikimin se nuk ka ngjashmëri me rastin shqiptar, çka, sipas meje, nuk qëndron. Prej tij mësohet se duhen ndjekur paralel aspekti politiko-diplomatik dhe ai juridiko-ndërkombëtar.

Joshja e faktorit ndërkombëtar drejt zgjidhjeve të qëndrueshme lypset, sepse nuk përjashtohet që fuqi të interesuara të përdorin ndikimin e vet për ruajtjen e *status quo*-së në arkitekturën politike në Ballkanin Perëndimor ose të pranojnë vetëm ndryshime në dobi të tyre.

Nëse do të arrihet që kushti politik të realizohet me sukses, duhet përballuar i dyti.

Kushti i dytë është gjetja e argumenteve me karakter juridiko-ndërkombëtar, mbi të cilat duhet të mbështetet kërkesa e shqiptarëve për

afrim, integrim ose bashkim kombëtar. Doemos do të operohet nëpërmjet normave të së drejtës ndërkombëtare, e cila, ndryshe nga degët e tjera të së drejtës, është një *soft law*, efikasiteti i së cilës mbetet relativ, që do të thotë se shërbimi eventual i ofruar prej saj të mos pranohet nga të gjitha palët.

Sidoqoftë, duke i parë me optimizëm zhvillimet e kësaj çështjeje, bashkimin kombëtar të shqiptarëve, mundësitë, format dhe emërtimet etj., e drejta ndërkombëtare i trajton në kuadrin e bashkimeve juridike, ndër të cilat më kryesoret janë *bashkimi në formën e shtetit unitar, federal, unionit real, personal, konfederatës* etj.

- ***Varianti i dytë*** natyrisht është dhe varianti më i favorshëm: bashkimi i Kosovës dhe i Shqipërisë në formën e shtetit unitar ose shtetit federativ. Por kjo, në rrethanat aktuale, duket mjaft e vështirë. Prandaj zgjidhja e çështjes kombëtare të shqiptarëve, një hap të parë jo pa rëndësi, mund ta gjente në formën e konfederatës shqiptare, nëse nga faktori ndërkombëtar nuk do të pranohet alternativë tjetër, më e favorshme.

Ajo do të ishte më e mundshme, më pak “komprometuese”, sepse konfederata nuk është shtet i bashkuar, por bashkim politik shtetesh, aleancë ndërkombëtare, e krijuar nëpërmjet një traktati ndërkombëtar midis shteteve sovrane, për arritjen e një qëllimi të caktuar në fushën e politikës së mbrojtjes, asaj të jashtme, zhvillimit ekonomik etj. Konfederata është bashkim i përciptë, i paqëndrueshëm, i ndërmjetëm, që çon ose drejt shthurjes ose drejt një bashkimi më të ngushtë: federatës ose shtetit unitar. Është formë tipike e shekujve të mëparshëm, por ka pasur të tilla edhe më vonë. Në vitet 1981-1982 u krijua bashkimi konfederativ i Senegalit dhe Gambias, me emrin *Senegambia*.

Anëtarët e konfederatës mbeten subjekte të së drejtës ndërkombëtare, që do të thotë se Shqipëria dhe Kosova, por nuk përjashtohen as Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, nëse themelojnë konfederatën shqiptare, nuk do të shkrihen në një shtet.

Konfederata mund të shërbejë për lehtësimin juridiko-institucional të intensifikimit dhe zgjerimit të marrëdhënieve ndërmjet shqiptarëve, duke u dhënë atyre edhe mundësinë që të krijojnë bindje të qëndrueshme nëse e duan bashkimin Shqipëri-Kosovë, apo preferojnë të vijojnë rrugëtimin politik si dy shtete më vete. Ai mund të shërbejë gjithashtu, për të bindur ndërkombëtarët për ta pranuar, kushtëzuar ose për ta penguar dëshirën e tyre për bashkim, siç vepruan 110 vite më parë.

Avancimi i mëtejshëm në procesin e bashkimit Shqipëri-Kosovë si federatë, doemos në varësi të rrethanave, mund të ngjallte kundërshtimin e fqinjëve, ndoshta edhe të disa Fuqive të Mëdha. Nga pikëpamja formalo-juridike, ato mund të vepronin duke mos akorduar njohjen ndërkombëtare.

Shqiptarët janë të detyruar të shpresojnë, se faktori ndërkombëtar do të ndërgjegjësohet për domosdoshmërinë e bashkimit kombëtar Shqipëri-Kosovë në një formë të pranueshme për të gjithë faktorët e interesuar. Ata duhet gjithashtu të tregojnë mirëkuptimin e duhur, veçanërisht për qëndrimin e ndërkombëtarëve, të cilët i kanë dhënë provat e vlerësimit pozitiv të shqiptarëve, nëpërmjet kontributit vendimtar në çlirimin dhe pavarësinë e Kosovës.

Shqiptarët gjithashtu duhet të ndërgjegjësohen se nuk janë kërthiza e botës, dhe duhet të bëjnë kujdes që të mos këmbëngulin për adoptimin e zgjidhjeve që u interesojnë vetëm atyre.

Duhet t'i akomodojnë interesat e veta brenda realiteteve gjeostrategjike të krijuara, të ngurtësuara dhe të certifikuara prej kohësh. Shqipëria nuk i ka as fuqitë, as mundësitë, as kapacitetet, (pavarësisht se ka aleatë strategjikë të

mëdhenj, si SHBA-në dhe disa vende të fuqishme të BE-së, që janë të bindur në drejtësinë e kauzës shqiptare), prandaj hëpërhë këto kërkesa tonat mund të mos pranohen, sepse mund të konsiderohen si projekte që prishin ekuilibra dhe të përmbysin raporte forcash gjeopolitike.

Nuk duhet harruar gjithashtu fakti, që kur ëndrrat dhe aspiratat e saj të ligjshme mund të mbroheshin dhe të realizoheshin, ajo nuk mundi, sepse ndoshta ishte pa aleatë, e rrethuar nga armiq të egër ose edhe e pafuqishme. Dhe, megjithëse u përpoq, luftoi dhe derdhi gjak për mbrojtjen e trojeve të veta, ato ia morën, vendin e copëtuan, e përgjysmuan. Është fakt se ajo u çlirua e fundit nga zgjedha osmane. Dhe me keqardhje duhet pohuar, se kur shqiptarët fituan pavarësinë, e para gjë që bënë disa prej tyre, ishte kacafytja se kush do të qeveriste.

Pas krijimit të qeverisë së Vlorës nga Kuvendi Kombëtar, të tjerë shqiptarë krijuan edhe 5 të tjera, duke parcelizuar domenet e tyre. Një prej tyre ishte Esat Pasha, të cilit Ismail Qemali i besoi portofolin e ministrit të Brendshëm në Qeverinë e Vlorës. Disa muaj më pas, nën pretekstin e një inspektimi në rajonet e Shqipërisë së Mesme, ai u largua nga Vlora drejt Durrësit, ku më 12 tetor 1913 shpalli krijimin e Pleqësisë së Durrësit.

Siç u tha, qëndrime të tilla nuk mund të jenë pa kosto për paqen dhe sigurinë aktuale rajonale e më gjerë, prandaj lypset realizëm, mirëkuptim dhe prurëncë e madhe për opsionet që do të përzgjidhen.

Afrimi ose bashkimi i Shqipërisë me Kosovën, do të ndikonte, në radhë të parë, në të ardhmen politike, ekonomike, sociale etj., të shqiptarëve të të dy vendeve. Por ai do të krijonte situata të favorshme, që edhe çështja e statusit të popullsisë shqiptare shtetformuese në Maqedoninë e Veriut, ose e pakicave shqiptare në Kosovën Lindore (Lugina e Preshevës), Malin e Zi etj., të trajtohet më mirë, në kuadrin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Nën mbrojtjen e dy shteteve shqiptare, të cilat, të bashkuara në një formë të caktuar juridiko-ndërkombëtare, do të shfaqen me një zë më autoritar, ata do të kenë mundësi të deklarojnë lirshëm se ndihen shqiptarë, se duan të kenë institucionet e veta politike, arsimore, kulturore, fetare, se duan të flasin dhe të mësojnë gjuhën amtare.

Zgjidhjet bashkëkohore për ta dhe për rajonin vijnë vetëm nga forcimi i bashkëpunimit midis shteteve të tij, nga respektimi rigoroz i normave dhe i parimeve themelore të së drejtës ndërkombëtare. Mbështetja te Rusia, siç thoshte Abdyl Frashëri, është rrezik i përhershëm i lirisë dhe i pavarësisë së shqiptarëve, ballkanasve në përgjithësi dhe i Europës. Dëshmi janë zhvillimet tragjike të vitit 2022 në Ukrainë dhe situatat potencialisht eksplozive në veriun e Kosovës.

Vihet re se qarqe të ndryshme politike në disa nga shtetet fqinje, i intimidojnë shqiptarët, i akuzojnë se bashkimin e duan për të krijuar Shqipërinë e Madhe, gogolin e krijuar dhe të hedhur në qarkullim prej tyre, me qëllimin djallëzor të frikësimit të faktorit ndërkombëtar. Duket se, nisur nga shëmbëlltyrat e projektuara në shtetet e tyre, mendojnë se shqiptarët kërkojnë Shqipërinë e Madhe, që të hakmerren ndaj fqinjëve mëkatarë dhe të krijojnë probleme për ta dhe paqen ballkanike.

Ndërkohë, disa nga Fuqitë e Mëdha, teksa pa të drejtë u tërheqin vëmendjen shqiptarëve, heshtin për shkaktarët e vërtetë, serbët dhe të tjerët, për të mos thënë që ndonjëherë edhe i llastojnë. Shqiptarët dhe sidomos ata që janë në krye të tyre, nuk kanë arsye që të ngurojnë për ta shprehur haptas dëshirën për integrimin-vëllazërimin Shqipëri-Kosovë, si një ndër të drejtat e veta natyrore më sublimë. Përveçse realizim i pjesshëm i një aspirate legjitime, ai nuk drejtohet kundër fqinjëve. Nuk synohet që t'u prishen atyre shtetet e veta. Shqiptarët duan vetëm të restaurojnë, për aq sa është e mundur, brenda logjikës dhe arsyes, normave dhe parimeve themelore të së

drejtës aktuale ndërkombëtare, drejtësinë e dhunuar një shekull e ca më parë, të integrojnë dy hapësirat territoriale të banuara gati 100% nga popullsi autoktone kompakte shqiptare, që shtrihen në vazhdim të njëra-tjetrës.

Nëse realisht e dëshirojnë atë, ka ardhur koha që të përgatisin dhe të miratojnë zyrtarisht platformën strategjike të së ardhmes së vet politike, natyrisht jo si shëmbëlltjërë të “Megal Idesë” ose të “Naçertanias”, sepse ato janë ngritur dhe bazohen në politika agresive e ekspansioniste kundër fqinjëve. Platforma e tyre duhet të përshkohet nga integrimi ndërshqiptar, progresi ekonomik e social, garantimi i paqes dhe i sigurisë rajonale, fqinjësia e mirë, bashkëpunimi me fqinjët dhe shtetet e tjera etj.

Përgatitja e saj u duhet besuar politikanëve me integritet, të përkushtuar ndaj interesave kombëtarë shqiptarë, që vlerësojnë dhe ushqejnë respekt ndaj fqinjëve. Ata duhet të njohin shumë mirë historinë, realitetet aktuale, të shohin me largpamësi të ardhmen, të kenë dëshmuar mençuri, përgjegjshmëri, realizëm dhe mirëkuptim për bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar. Së bashku me ta duhen angazhuar edhe studiuesit, akademikët, specialistët më të spikatur në këtë fushë nga Shqipëria, Kosova, territoret shqiptare përreth dhe në diasporë, që të identifikojnë dhe të argumentojnë në çdo aspekt alternativat më të përshtatshme të zgjidhjes së çështjes shqiptare.

Ajo nuk u duhet lënë improvizimeve të imponuara nga entuziazmi folklorik, romantizmi nacionalist ose nga reagimet emocionale që mund të shkaktohen nga zhvillime ekstreme në kufijtë e Kosovës me Serbinë.

Në këtë mënyrë do të jetë më i lehtë adoptimi nga organet kompetente të shteteve shqiptare, fqinjëve dhe Fuqive të Mëdha, i një

zgjdhjeje të drejtë të një çështjeje që ekziston realisht. Kështu do të kontribuohet më mirë për arritjen e qëllimit të shqiptarëve, afirmimin e tyre ndërkombëtar, anëtarësinë e Shqipërisë dhe të Kosovës në BE, të Kosovës në OKB dhe në organizata të tjera ndërkombëtare etj. Do të kontribuohet edhe për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë në rajon e më gjerë.

Duke folur për këtë çështje është e domosdoshme të mos harrohet se, prej rreth dy shekujsh, historia ka dëshmuar që shqiptarët janë trajtuar si kurban i paqes dhe i stabilitetit rajonal e kontinental. Kështu veproi 110 vite më parë Konferenca e Ambasadorëve e Londrës. Më 12 gusht 1913, të nesërmen e përfundimit të punimeve të saj, Eduard Grei që e kryesonte, deklaroi: *“Unë e di fare mirë, se kur gjithçka do të bëhet e njohur, kjo zgjidhje në shumë pika do të japë shkas për kritika të forta nga kushdo që e njuh vendin dhe që e gjykon çështjen nga një pikëpamje e ngushtë lokale”*.

“Duhet të mos harrohet, se gjatë përpjekjeve për të gjetur një zgjidhje të tillë, qëllimi kryesor ka qenë që të ruhej marrëveshja midis vetë Fuqive të Mëdha dhe, në qoftë se vendimi mbi Shqipërinë e ka siguruar këtë, atëherë ai e ka bërë punën më të rëndësishme në dobi të paqes në Europë.”

Kjo frymë padrejtësie ka vazhduar dhe, për fat të keq, vazhdon të shfaqet sërish herë pas here. Shfaqet në kërkesat që u bëhen shqiptarëve për lëshime ndaj “më të fortëve” të gadishullit në emër të paqes dhe të sigurisë. Mendoj se qëndrimi skajshmërisht i përlulur ndaj thirrjeve të tilla, që mund të marrë trajtat e sakrifikimit të interesave dhe dinjitetit kombëtar, duhet të marrë fund.

Ndërkombëtarëve që ua kërkojnë paqen vetëm shqiptarëve, u duhet lënë të kuptojnë se paqja nuk u nevojitet vetëm atyre, por të gjithëve; u duhet

edhe fqinjëve, të cilët, prej rreth një shekulli e gjysmë, e turbullojnë dhe e shkatërrojnë atë, duke provokuar dhe sulmuar të tjerët, në mënyrë të veçantë shqiptarët, të cilët nuk kanë sulmuar asnjëherë të tjerët, por vetëm janë mbrojtur me heroizëm dhe dinjitet, siç bënë edhe në luftën e fundit të Kosovës.

Duke shpresuar dhe insistuar në mirëkuptimin e të interesuarve, duhet të thuhet pa asnjë ndjenjë kompleksiteti, se janë pikërisht fqinjët, ata që kanë detyrime ndaj paqes ballkanike. Nuk u lejohet që, me pretekste të rëndomta, të simulojnë, të intimidojnë, të kërcënojnë dhe të trazojnë Ballkanin. Atyre u duhet kërkuar që të kenë kurajën e duhur dhe të përballojnë, për aq sa u takon, kostot e së ashtuquajturës paqe, për të cilën flasin ndonjëherë pa u menduar shumë edhe disa nga funksionarët e Brukselit a të Nju-Jorkut.

E para gjë që ata duhet të bëjnë, është t'i lënë të qetë shqiptarët. Nuk ka pse në emër të një paqeje fiktive, të ndalohen shqiptarët të kenë shtetin e vet kombëtar, në formën më të përshtatshme të mundshme, në një kohë kur të tjerët i kanë krijuar shtetet “e veta”, madje “të mëdha”, madje edhe në shkelje të parimeve dhe normave themelore të së drejtës ndërkombëtare, duke aneksuar trojet e shqiptarëve.

Nuk ka arsye që ata të përmbushin kërkesat tekanjoze të prindërve dhe të pranojnë të cedojnë nga territori, sovraniteti, paqja dhe siguria e tyre kombëtare.

Nuk mund të mos vihet në dukje me kënaqësi, se paralel me diskutimet teorike, politike, diplomatike e juridike rreth bashkimit Shqipëri-Kosovë, prej afro 15 vjetësh ekziston dhe zhvillohet dita-ditës një realitet tjetër, i

pamohueshëm inkurajues, edhe pse i pacertifikuar zyrtarisht. Ai është bashkimi *de facto* i një lloji të veçantë i Kosovës me Shqipërinë. Kjo shprehet në faktin, që kufiri i tyre, sikurse edhe shumë barriera të tjera që ndajnë shtetet, janë hequr ose janë duke u hequr. Janë ndërmarrë hapa sistematikë, të konkretizuar në mbledhjet e përbashkëta të të dyja qeverive.

Madje këto ditë, me rastin e kremtimit të përvjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, pati një tjetër episod domethënës. Të dielën e 27 dhjetorit 2022, deputetët e të dyja shteteve shqiptare, Shqipërisë dhe Kosovës, zunë vend në sallën e Kuvendit të Shqipërisë, ku u zhvillua një seancë emocionuese, e pandodhur ndonjëherë më parë.

Ajo çka u pa në ekranet e televizioneve që e transmetuan, e çon kujtesën e cilitdo 110 vite më parë, në Kuvendin e Vlorës, të thirrur nga Ismail Qemali. Edhe atëherë, në pasditen e 28 nëntorit 1912, në shtëpinë e kushëririt të tij u mbledhën 37 veta, të cilët në ditët në vazhdim u bënë 63. Ishin drejtues ose veprimtarë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, që vinin nga të gjitha viset shqiptare, veçanërisht nga Kosova, Maqedonia, Çamëria etj. Nuk mbërritën dot Hasan Prishtina, Nexhip Draga, Idriz Seferi, Sait Hoxha etj., të burgosur në Beograd, si edhe Bajram Curri, që u penguan gjatë rrugës nga luftimet.

Pjesëmarrja në Kuvend e delegatëve nga të gjitha qytetet e Shqipërisë, të mandatuar në përshtatje edhe me rrethanat e kohës, si përfaqësues të të gjithë popullit shqiptar, duke përfshirë edhe rajonet “*që ndodheshin të pushtuara nga ushtritë serbe, malaziasë e greke, i dha atij karakterin e një asambleje kombëtare mbarëshqiptare. Kjo ishte njëherazi shprehje e vendosmërisë së të gjithë shqiptarëve për t’u bashkuar në shtetin e vet kombëtar, në të cilin do të përfshiheshin të gjitha viset shqiptare*”.

Përngjasimet kanë të bëjnë vetëm me simbolikën dhe jo me thelbin e ngjarjeve. Sepse në vitin 1912 përfaqësuesit e të gjithë shqiptarëve u

mblodhën në Vlorë, për ta bërë shtet gjithë Shqipërinë. Me shumë dhimbje dhe një peng të madh shpirtëror, e bënë vetëm në letër dhe në zemrën e tyre. Sepse diplomacia e Fuqive të Mëdha dhe fqinjët e penguan realizimin e projektit të tyre.

Mbledhja e përbashkët e dy kuvendeve shqiptare, në Tiranë, në nëntorin e vitin 2022, mund të interpretohet edhe si tregues, që ëndrra shekullore e shqiptarëve për bashkimin institucional të politikës në Shqipëri dhe në Kosovë, bëri një tjetër hap shumë të rëndësishëm. Për herë të parë deputetët e Parlamentit të Kosovës dhe ata të Shqipërisë, të ulur së bashku në sallën e kuvendit në Tiranë, u përcollën kancelarive vendimmarrëse botërore mesazhin e bashkimit jo thjesht në mënyrë simbolike. Transmetuan dëshirën e shqiptarëve për të menduar dhe për të gjetur zgjidhjen e duhur për çështjen shqiptare, ende të pazgjidhur.

Përvoja e tetë mbledhjeve të përbashkëta të qeverive u çua më përpara. Edhe pse arritjet nuk janë ato që do të dëshirohej, përsëri ka rezultate premtuese. Mund të përmenden: abetarja e përbashkët, puna për fjalorin enciklopedik, unifikimi i tregjeve të punës, angazhimet për unifikimin doganor dhe një sërë projektesh të tjera të rëndësishme.

Shqipëria dhe Kosova janë dy shtete sovrane, por askush nuk mund ta mohojë se në hapësirat e tyre territoriale jeton një komb, një popull, që flet një gjuhë, që ka një kulturë, një histori, një qëllim, një aspiratë, një të ardhme dhe një orientim strategjik afatgjatë euroatlantik. Aty mbizotëron ndjesia e përkatësisë së përbashkët etnike, shpirtërore, zakonore.

Pjesë të këtij kombi që ndodhen në Maqedoninë e Veriut dhe në Malin e Zi, po përjetojnë gjithashtu zhvillime pozitive, të cilat përfaqësojnë

realitete të paimagjinueshme deri para disa vjetësh. Përveç Shqipërisë dhe Kosovës, të cilat drejtohen nga shqiptarët, edhe në dy shtete të tjera në Ballkan në poste të larta drejtuese ka shqiptarë.

Në Mal të Zi kryeministri është Dritan Abazović; në Maqedoninë e Veriut shqiptari Talat Xhaferri drejton parlamentin, shqiptari tjetër Artan Grubi është zëvendëskryeministri i parë. Prania e tyre në drejtimin e organeve qendrore nuk mund të mos ndikojë pozitivisht në statusin e shqiptarëve që banojnë në trojet e veta në këto shtete.

Një tjetër zhvillim domethënës është edhe ai, që vërtetohet me shqiptarët që jetojnë jashtë trojeve të veta. Me prejardhje nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Lugina e Preshevës, Çamëria etj., ata mbledhen herë pas here së bashku për të kremtuar ngjarje të rëndësishme të historisë kombëtare ose Krishtlindjet e festa të tjera fetare. Të gjithë, edhe pse mund të kenë dekada që e kanë lënë vendin për arsye të ndryshme, ruajnë dashurinë për atdheun, vazhdojnë të ndihen shqiptarë, të orientuar fuqimisht nga shqiptaria, punojnë me aq sa munden për të kontribuar në të mirë të çështjes shqiptare, duke i dhënë një mësim të madh dhe shumë të çmuar politikës dhe politikanëve shqiptarë këtu në Ballkan.

Strategjia e përbashkët e zhvillimit ndërshqiptar nuk u kundërvihet bashkësive të tjera në rajon dhe në Europë. Përkundrazi, fryma emancipuese dhe qytetëruese që sjell në këto kohë politika shqiptare në rajon, nivelet e zhvillimit të shqiptarëve në rajon, i kontribuojnë qëndrueshmërisë së Ballkanit dhe të Europës. Disa prej fqinjëve të ngarkuar me makthe, për shkak të padrejtësive ndaj tyre, i shohin me frikë e dyshim, duke menduar se edhe shqiptarët për simetri udhëhiqen nga të njëjtat paudhësi.

Qëndrimet korrekte të të gjitha segmenteve të politikës shqiptare, si nga Tirana, Prishtina, Tetova etj., ndaj fqinjëve, të cilëve u kanë ofruar garanci për bashkëpunim, janë shndërruar në modele që kanë kontribuar për emancipimin e ndërgjegjes së kontinentit, për demokratizimin e rajonit për krijimin e një klime paqeje dhe sigurie rajonale.

Në raport me të huajt, por edhe me vetveten, shqiptarët kanë arritur nivele që nuk i kanë pasur kurrë më parë. Rrugëtimi historik i integrim-bashkimit kombëtar të shqiptarëve, ka filluar dhe nuk mund të ndalet. Le t'i besojmë Naim Frashërit, i cili një shekull e ca më parë thoshte gjithë shpresë, se “për Shqipërinë ditët e mira paskëtaj vijnë”. [DITA]

Bernë, nëntor 2022

* *Shkrimi mbështetet mbi referatin që autori mbajti në konferencën shkencore me temë “Sfidat e botës shqiptare në mileniumin e ri”.*

1.3 Shaban MURATI

Rusia, NATO-ja dhe prapaskenat e një konflikti të dhunshëm

Çfarë po synojnë shërbimet sekrete ruse me Veriun e Kosovës?

Një alarm i habitshëm disproporcional u ngrit në Moskë nga vendimi i NATO-s më 30 maj, për të dërguar një kontingjent shtesë prej 700 ushtarësh në përbërje të forcave të KFOR-it në Kosovë. Vendimi erdhi pas sulmeve të dhunshme të bandave të organizuara paramilitare serbe në Veriun e Kosovës kundër forcave të KFOR-it, si rezultat i së cilave u plagosën mbi 30 ushtarë të forcave paqeruajtëse ndërkombëtare.

Vendimi i NATO-s, që është brenda mandatit të saj juridik ndërkombëtar, të firmosur edhe nga Rusia, ishte i papritur për Kremlinin, që po priste shndërrimin e trazirave të reja serbe në Kosovë në një konflikt të armatosur.

Më 1 qershor 2023, në faqen zyrtare të MPJ-së së Rosisë janë publikuar deklaratat e ambasadorit rus në Beograd, Aleksandër Bocan-Harçenko, i cili e sulmon vendimin e NATO-s për të dërguar një kontingjent shtesë forcash në Kosovë si *“joadekuat dhe jonormal për ngjarjet dhe kjo forcon praninë e forcave atlantike në Kosovë”*. Ambasadori rus shkoi edhe më tej, duke akuzuar forcat paqeruajtëse të KFOR-it si *“shtesë e shkallëzimit të tensionit”*.

Reagimi zyrtar rus ishte jashtë çdo logjike diplomatike. Rusia ngre alarmin për një kontingjent shtesë prej 700 vetash në forcat e KFOR-it, në një kohë që në Kosovë janë të pranishme mbi katër mijë forca ushtarake paqeruajtëse të KFOR-it. Nuk e shpjegoi as ambasadori rus dhe as Ministria

e Jashtme ruse, se çfarë kishte për t'u shqetësuar për 700 ushtarët shtesë të misionit paqeruajtës të KFOR-it në Kosovë.

Alarmin e saj të hiperbolizuar diplomatik dhe ushtarak Moska e shtriu në krejt propagandën e saj ndërkombëtare, me qëllim që të krijonte një tymnajë të re mbi të ashtuquajturin rrezik, që përfaqësuaka NATO-ja në Ballkan!

Më 3 qershor, gazeta proqeveritare ruse “Izvestia” shkruante: *“NATO-ja po ndjek qëllimet e saj për destabilizimin e Ballkanit. Qëllimi i fundit është shkëputja e plotë e Serbisë nga Rusia, nga ortodoksizmi dhe nga faktori sllav, kalimi në anën e Perëndimit dhe njohja e Kosovës”*.

Më 30 maj, drejtori i Institutit rus të Zhvillimit Aktual Shtetëror, Dmitri Sollonikov, me kompetencën e shkencëtarit zyrtar analizonte dërgimin e kontigjentit shtesë të NATO-s në Kosovë dhe e çonte fantazinë në një shkallë sipërore: *“NATO-ja po përgatit grusht shteti në Serbi. Batalioni shtesë i NATO-s në Kosovë mund të çojë në grusht shteti në Serbi”*.

Më 5 qershor, koordinatori i Këshillit rus të Politikës së Jashtme, M. Lazoviç, duke pompuar alarmin zyrtar për kontigjentin shtesë të NATO-s në Kosovë, deklaronte se *“Perëndimi po ngre shkallën e tensionit, duke u përpjekur të detyrojë Beogradin për skenarët e forcës në zgjidhjen e problemit kosovar”*.

Sipas imagjinatës deformuese të diplomacisë ruse, një kontigjent shtesë prej 700 ushtarësh në forcat ekzistuese të KFOR-t prej 4 mijë vetash në Kosovë, qenka një komplot për një grusht shteti në Beograd. Ky nuk është vetëm një alarm fals ushtarak, diplomatik dhe propagandistik rus për të krijuar në audiencën ruse, serbe apo bjelloruse imazhin e Ruisë si mbrojtëse e Serbisë nga grushti i shtetit, që do të bëka në Beograd kontigjenti prej 700 ushtarësh shtesë të NATO-s.

Përtej një naiviteti diplomatik dhe propagandistik, alarmi i ri rus për forcat shtesë të NATO-s në Kosovë dëshmon shqetësimin e madh të Kremlinit, se zhvillimet e fundit në Veriun e Kosovës dhe në Ballkanin Perëndimor nuk po ecin në drejtimin e planifikuar nga Rusia. Kremlini shpresoi që, nëpërmjet provokacioneve të qëllimshme të presidentit serb Vuçiq në Veriun e Kosovës, me intrigën e tij bizantine “ngriva-shkriva” të tensioneve në Veri, do të arrihej qëllimi strategjik rus i shkaktimit të një konflikti të armatosur midis Serbisë dhe NATO-s në Kosovë.

Në funksion të këtij plani rus, bandat paramilitare të policisë serbe dhe të shërbimit sekret serb në Veriun e Kosovës ndërmorën sulme të dhunshme masive kundër forcave të KFOR-it. Sipas planifikimeve ruse, këto sulme të dhunshme serbe do të shërbenin si pretekst i ndërhyrjes ushtarake të Serbisë në Kosovë, sepse jo rastësisht presidenti serb Vuçiq kishte dislokuar paraprakisht forca të mëdha ushtarake në kufirin me Kosovën. Për rrjedhojë, kjo do të çonte në një konflikt të armatosur me forcat e KFOR-it dhe me NATO-n.

Qëllimi strategjik i Ruisë është që t'i hapë NATO-s një vatër lokale lufte me konflikt të armatosur midis Kosovës dhe Serbisë. Kjo i duhet Moskës në këtë periudhë krize ushtarake dhe vështirësish të panumërta që po kalon, për shkak të agresionit të gjatë rus në Ukrainë dhe për të dobësuar NATO-n në prapavijat e saj ballkanike, që NATO-ja të mos jetë në gjendje të vazhdojë të ndihmojë ushtarakisht Ukrainën për mbrojtjen nga pushtimi rus.

Jo rastësisht një javë para këtij tensionimi të ri, një nga krerët e shërbimeve sekrete ruse, Nikollaj Patrushev, zhvilloi bisedime të fshehta me shefin e agjencisë serbe të spiunazhit, Aleksandër Vulin. Rusia priste konfliktin e armatosur dhe ambasadori rus në Beograd e deklaroi hapur më 1 qershor: *“Njësitë ushtarake serbe pranë vijës kufitare mes Serbisë dhe*

Kosovës u vunë në gjendje gatishmërie të plotë luftarake, sepse natyrisht nuk duhet përjashtuar skenari i forcës”.

Gazeta proqeveritare ruse “Vzgljad” më 5 qershor e shprehte pa doreza strategjinë agresive ruse dhe e këshillonte Beogradin të ndjekë shembullin rus të pushtimit të Donbasit, që sipas saj është “mobilizimi i përgjithshëm në Serbi dhe marshimi i ushtrisë serbe në Kosovë”.

NATO-ja e kuptoi strategjinë me qitje të largët të Rusisë për luftë lokale në Veriun e Kosovës dhe menjëherë, qysh të nesërmen e sulmeve të dhunshme serbe dhe plagosjes së forcave të KFOR-it, shpalli dërgimin e kontigjentit shtesë prej 700 ushtarësh dhe vuri në gatishmëri luftarake një batalion tjetër rezervë për çdo eventualitet të përkeqësimit të situatës së sigurisë dhe të konfliktit në terren.

Me vendimin e tanishëm për dërgimin e një kontigjenti shtesë të forcave të KFOR-it, NATO-ja prishi planin strategjik rus të provokimit të një konflikti të ri të armatosur lokal në Kosovë. Vendimi atlantik është një mesazh i ri, i qartë force, në adresë të Rusisë, për t’i treguar që NATO-ja nuk do të lejojë asnjë lloj konflikti të armatosur në Ballkan.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, e afishoi pa ekuivok në deklaratën e tij më 1 qershor, se dërgimi i forcave shtesë të NATO-s është *“për të siguruar që ne kemi forcat, për të cilat kemi nevojë në çdo kohë”*. Mesazhi atlantik u bën të qartë planifikuesve rusë të strategjisë së tensionit në Ballkan, se NATO-ja është e përgatitur të zmbropsë dhe të likujdojë çdo kërcënim dhe rrezik konflikti të armatosur, që vjen nga Rusia në rajonin e Ballkanit.

Vendimi i NATO-s për kontigjentin shtesë në forcat e saj në Kosovë përbën një mesazh force edhe për presidentin putinist të Serbisë, Vuçiq, se NATO-ja nuk do të lejojë që bandat dhe njësitë speciale të policisë serbe të provokojnë konflikt të armatosur në Kosovë. Është një mesazh direkt për

presidentin serb Vuçiq, i cili duke qenë i implikuar si menaxher i tensioneve në Veri të Kosovës, nuk i dënoi fare sulmet e dhunshme të bandave serbe pas plagosjes së dhjetëra ushtarëve të KFOR-it.

Histeria e re anti-NATO e diplomacisë dhe e propagandës zyrtare ruse u fry aq shumë, saqë mori edhe forma komike. Fushata e sulmeve ruse ndaj vendimit të NATO-s për kontingjentin shtesë të forcave të KFOR-it u shoqërua me një fushatë të re të befasishme ruse kundër Turqisë, sepse ajo dërgoi tani në Kosovë një batalion të 500 forcave komandës si pjesë e këtij kontingjenti shtesë.

Dislokimi tani, pas tensioneve në Veri, i batalionit të forcave speciale turke nuk ka domethënie të re ushtarake, sepse forcat turke janë që prej fillimit të misionit të KFOR-it pjesë e forcave paqeruajtëse ndërkombëtare. Vetëm një logjikë e çakorduar mund të shkruajë se forcat turke shtesë të KFOR-it tregojnë që “Turqia po hyn në konfliktin ballkanik”, siç alarmonte media ruse “fortpost-sevastopol.ru” më 4 qershor.

Politologu rus, Dmitri Rodionov, thellohej edhe më shumë më 5 qershor në medien “life.ru” me pyetjen e madhe: *“Pse Erdogani u dakordua të luftojë kundër sllavëve në Ballkan?”*. Dhe përgjigjej po vetë: *“Përgjigjja e shpejtë e Ankarasë ndaj propozimit të NATO-s për të shkuar në Kosovë sulmon sërish interesat e Rusisë”*.

Ofensiva alogjike diplomatike dhe propagandistike ruse shpreh qartë, se i gjithë mllef i tanishëm zyrtar i Moskës ndaj dislokimit të forcës shtesë të NATO-s në Kosovë vjen prej dështimit të planit strategjik rus për ndezjen e një lufte lokale në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor.

NATO-ja e prishi këtë plan dhe Rusia, bashkë me Serbinë, e mësuan se NATO-ja nuk do të lejojë bandat, spiunët dhe mercenarët serbë, që të provokojnë konflikt të armatosur lokal. Nuk do të ndihmojnë dot të arrihet ky synim rus as mercenarët rusë të kompanisë kriminale të shërbimit sekret

ushtarak rus “Wagner”, të cilët, sipas burimeve diplomatike, janë përzier me bandat dhe njësitet speciale civile të policisë serbe në Veri të Kosovës.

Nuk duhet harruar se një nga pikat kryesore të marrëveshjes, që bëri presidenti serb Vuçiq me kompaninë “Wagner”, kur në dhjetor të vitit të kaluar i lejoi asaj hapjen në Beograd të një qendre rekrutimi mercenarësh për në Ukrainë, ishte që në shkëmbim, kompania “Wagner” do të dërgonte mercenarë në Veriun e Kosovës. Kjo shënonte një implikim direkt të shërbimit sekret ushtarak rus në trazirat në Veri të Kosovës.

Dërgimi i forcës ushtarake shtesë të NATO-s në Kosovë është gjithashtu shprehje e një angazhimi më të fortë të NATO-s në përkrahje të rrugës politike të normalizimit të marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë, për zbatimin e plotë të marrëveshjeve të Brukselit të 27 shkurtit dhe të Ohrit të 18 marsit, sepse vetëm normalizimi mbi bazën e formulës “Bajden” të njohjes reciproke të të dy shteteve e zhdruk përfundimisht rrezikun e një konflikti të armatosur.

Kjo strategji paqeje dhe stabilizimi e NATO-s në Ballkan i djeg shumë Ruisë, ndaj ajo u tremb dhe ngriti një stuhi artificiale për kontigjentin shtesë të NATO-s në Kosovë. Ndaj edhe zëdhënësja e MPJ-së të Ruisë, Maria Zaharova, më 6 qershor, nëpërmjet agjencisë shtetërore ruse të lajmeve “Ria Novosti”, i bënte thirrje presidentit Vuçiq, që të mos zbatojë marrëveshjet europiane të shkurt-marsit për dialogun Serbi-Kosovë, sepse *“janë ekskluzivisht verbale dhe nuk imponojnë detyrime legale”*.

Lëvizja e tanishme e NATO-s në Kosovë duhet lexuar si lëvizje e SHBA-së, sepse kuptohet që, pa miratimin e Uashingtonit, nuk mund të bëhet një hap i tillë nga aleanca atlantike. Kjo ngjall besim të zhvillimet e pritshme dhe të strategjia afatgjatë e SHBA-së në Ballkan.

1.4 Dr. Skënder DEMALIAJ

Politikat e Serbisë për “spastrimin etnik” të shqiptarëve të Kosovës në këndvështrimin psikologjik dhe gjeopolitik

Hyrje

Gjeopolitika përpiket të shpjegojë zhvillimin politik e shoqëror të një vendi me kushtet gjeografike dhe të përligjë politikën agresive e pushtuese me mospërputhjen e popullsisë me hapësirën gjeografike. Sipas Klaus Dodds: *“Gjeopolitika fokusohet te roli i territoreve, resurseve dhe gjeografisë fizike në formimin dhe zhvillimin e shteteve”*¹.

Të udhëhequr nga këto formulime teorike, shteti serb ka pushtuar dhe tjetërsuar territore shqiptare që nga viti 1862 e në vazhdim. Këtë e ka realizuar me metoda brutale, nisur nga parimi famëkeq i Çubrilloviqit: *“Kur fuqia e një shteti dëshiron të ndërhyjë në interes të elementit të vet në luftën për tokën, kjo mund të ketë sukses vetëm kur veprohet brutalisht”*².

Kosova është e pasur me minerale të çmuara dhe të shumëllojshme, ka tokë pjellore, fusha dhe rezerva të mëdha hidroenergjetike. Burimet natyrore dhe ushqimore janë elemente kyç në përcaktimin e gjeopolitikës dhe në sigurimin e interesave ekonomikë dhe strategjikë të vendit. Për shtetin serb, spastrimet etnike ishin mjeti kryesor për të realizuar programin për një “Serbi të Madhe” dhe “të pastër etnikisht”. Vetëm të bashkuar, me dhunë, me gjak, me metodat më antihumane, të ngjashme me ato të regjimit hitlerian për shfarosjen e hebrenjve do të realizonin pastrimin etnik të shqiptarëve në

¹ Dodds, Klaus. (2019). *Gjeopolitics*. Oxford: Univrsity Press, f. 23-27.

² Grmek, Mirko, Gjidara, Marc & Šimac, Neven. *Spastrimi etnik*, Tiranë, 55, f. 157.

Kosovë. Simboli i tyre ishte: një kryq dhe katër shkronja **S**: “Samo sloga Srbina sprasova” (Vetëm bashkimi i shpëton serbët).

Foljen “Oçestiti”, *me pastrue*, emrin - *të pastruarit* e ka përdorur Vuk Karaxhiq për të treguar shfarosjen dhe dëbimin e popullatës joserbe. **Konventa për parandalimin dhe dënimin e krimit të gjenocidit**, adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 9 dhjetor 1948, përcakton veprimet, të cilat përbëjnë krimin e gjenocidit. Sipas saj, (neni 2) ***gjenocid konsiderohet cildo nga veprimet e mëposhtme, i kryer me qëllim që të zhduket plotësisht ose pjesërisht një grup kombëtar, etnik, racor ose fetar.*** Këtu bën pjesë:

- vrasja e anëtarëve të grupit,
- lëndimi i rëndë fizik ose mental i anëtarëve të grupit,
- vënia e grupit qëllimisht në aso kushte të jetës, që sjellin zhdukjen e plotë fizike ose të pjesshme të tij,
- ndërmarrja e masave për të penguar lindjet brenda grupit,
- transferimi i dhunshëm i fëmijëve nga një grup në tjetrin.

Pra, gjenocidi është shkatërrimi i grupeve të njerëzve për shkak të racës, fesë, kombësisë dhe prejardhjes etnike. Në Fjalorin Sociologjik gjenocidi përkufizohet si “shkatërrim strukturor” dhe “*sistematik i njerëzve të pafajshëm nga një aparat burokratik shtetëror*”³.

Konventa mbi Pengimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit e vitit 1948, gjenocidin e përkufizon në mënyrë të hollësishme dhe teknike, *si krimi kundër së drejtës ndërkombëtare, duke pranuar se “në të gjitha periudhat historike gjenocidi ka shkaktuar humbje të mëdha të njerëzve*⁴.

³ Marshall, Gordon; (2009). *Fjalori sociologjik i Oksfordit*. Tiranë: IDK, f. 120.

⁴ Schabas A, William; (2003). *Gjenocidi në të drejtën ndërkombëtare*. Prishtinë: FINISH UNHCHR Human Rights Support Programime - Kosovo, f. 31.

Gjenocidi përmbledh të tria të këqijat: *racizmin, dhunën për shkak të ndryshimit mes palëve dhe dhunën si pasojë e mendjengushtësisë...*

*Çfarë krimi mund të jetë më i tmerrshëm sesa gjenocidi? Nëse nuk e dallojmë zhdukjen e planifikuar të një populli si tmerrin e tmerreve, atëherë cili është qëllimi i shekullit të njëzetë?*⁵

Gjatë luftërave që serbët kanë zhvilluar, ka përlindur koncepti dhe programi koherent dhe ambicioz i shtrirjes tokësore. Spastrimi është një nga mjetet e përdorura për të zbatuar programin dhe për të realizuar një Serbi “homogjene” dhe “të pastër e të kulluar”. Sipas Ilia Garashaninit: *“Historia na e thotë dhe na e tregon, se për t’i salduar më mirë territoret e aneksuara, për të realizuar një bashkim sa më homogjen që të jetë e mundur, ky operacion na paraqitet në dy etapa: fillimisht ekspansioni, pastaj homogjenizimi”*⁶. Edhe memorandum i ASHS-së i vitit 1986 sugjeronte që serbët duhet të jetonin në një vend unik dhe të vetëm.

Në të gjitha platformat serbe prevalon ideja, se vetëm “pastërtia etnike” mund të sigurojë paqen dhe progresin e Serbisë. Për Dobrica Qosiçin jo vetëm paqen, por edhe demokracinë. Në librin e tij “Çështja serbe”, botuar në vitin 1991 në Francë thuhet: *“Me fjalën “demokraci” kupton të drejtën e “popullit serb”... në realizimin e qëllimit të tij final dhe historik “unifikimin e të gjithë serbëve në një shtet të vetëm”*⁷.

Objektivi nuk është vetëm të mbrohet serbizimi, por edhe të spastrohet territori nga elementi joserb, sepse kështu realizohet aspirata për një shtet serb të fortë dhe të zgjeruar.

⁵ Carter I, Stephe;. (2008). *Integriteti*. Tiranë: Vernon Publishing, f. 272-274.

⁶ Grmek, Mirko, Gjidara, Marc & Šimac, Neven; *Spastrimi etnik*. Tiranë: 55, f. 55.

⁷ Grmek, Mirko, Gjidara, Marc & Šimac, Neven; *Spastrimi etnik*. Tiranë: 55, f. 246.

Sipas ish-kryeministrit kuisling, Milutin Nedić: “Kur vihemi të studiojmë popullin serb nga pikëpamja e shtrirjes tokësore që ai banon, si edhe marrëdhëniet e tij me pozicionin dhe me popujt fqinjë, menjëherë të bie në sy thërrmijezimi i tij nga pikëpamja etnografike, hallakatja e tij, si edhe përzjerja e tij me popujt e tjerë. Kjo shpërndarje e madhe gjeografike është një gjë shumë shqetësuese, sepse kjo është baza e shkapërderdhjes së madhe kombëtare të serbizimit”⁸. Nisur nga kjo, ai jep edhe si duhet vepruar në të ardhmen:

1. “Duhet përcaktuar hapësirat dhe territoret që i përkasin popullit serb, duke marrë në konsideratë si forcën e tij numerike, ashtu edhe shpërndarjen gjeografike, duke mbajtur gjithashtu parasysh popujt, me të cilët ai jeton i përzjer apo pranë e pranë.
2. Duhet të përpiqemi që të sjellim në këto vende serbët, që do të mbeteshin jashtë kufijve të shënuar, dhe elementët e huaj që jetojnë aktualisht e që duhet t’i përkasin popullit serb”⁹.

Përgatitja psikologjike e strukturave paraushtarake dhe ushtarake serbe për të realizuar me sukses gjenocidin ndaj shqiptarëve të Kosovës

Gjenocidi nuk mund të kryhet pa krijimin paraprak të një gjendjeje të caktuar të mendjes njerëzore. Që të arrihet një shpërngulje në masë, si kusht i parë është krijimi i një psikoze të përshtatshme, e cila mund të krijohet në shumë mënyra¹⁰. Në vazhdim të punimit do të japim shembuj të shumtë se si është realizuar.

⁸ Grmek, Mirko, Gjidara, Marc & Šimac, Neven; *Spastrimi etnik*. Tiranë: 55, f. 172.

⁹ Grmek, Mirko, Gjidara, Marc & Šimac, Neven; *Spastrimi etnik*. Tiranë: 55, f. 174.

¹⁰ Çubrilloviqi, Vaso; (2015). *Shpërngulja e shqiptarëve*. Tiranë: Klubi i Poezisë, f. 49-50.

Pushtetarët serbë, propaganduesit e krijimit të “Serbisë së Madhe”, Kisha, Akademia e Shkencave kanë shtruar pyetjen: *“Përse populli serb duhet të ushqejë urrejtje për fqinjët e tij ballkanikë (ku bëjnë pjesë edhe shqiptarët), në qoftë se nuk ia ushqejnë këtë ndjenjat e tij?”*

Akuzat dhe fyerjet që u janë bërë shqiptarëve që nga shekulli XVIII e në vazhdim, janë të ngjashme me propagandën e Gebelsit, sipas së cilës *“duhet ta diskreditosh oponentin deri në absurd”*¹¹. Shqiptarët në Kosovë janë paraqitur nga propaganda serbe si *“popull që dhunon murgesha, që rrënon varre, dhunon Martinoviça, dhunon sytë e vizatuar të Sinomidës nëpër manastire”*. Historiani Hakif Bajrami tregon: *“Në vitin 1983 në kabinetin tim erdhi një gazetar gjerman. U prezantua si Heiko Fillotau. Pyetja e parë e tij ishte: “Ku jetojnë shqiptarët që kafshojnë njerëz?”*¹²

Në vitin 1899 Mbretëria e Serbisë kishte përgatitur ndaj shqiptarëve të Vilajetit të Kosovës një akuzë, atë për “terrorizëm”, që e drejtoi në Gjykatën Ndërkombëtare në Hagë. Aty shqiptarët paditeshin për 132 “vrasje terroriste”, me qëllim që të përgatitej opinioni europian, që Vilajeti i Kosovës mund të “civilizohet” vetëm nëse e okupon Serbia. Stambolli ngriti një komision, në përbërje të të cilit ishin: ministri i Punëve të Brendshme, Valiu i Kosovës, dy nëpunës të nahisë, një prift serb dhe një serb vendas për të vërtetuar akuzat, por nuk gjetën asnjë provë se janë vrarë serbë nga shqiptarët. Gjykata Ndërkombëtare shkurt theksoi: “132 akuza - 132 rrena”. Ky dokument u botua më 1889 dhe u ribotua më 1989 me urdhër të Millosheviqit. U përsërit e njëjta akuzë, drejtuar Parisit, Moskës, Londrës etj. Shqiptarët në Kosovë janë akuzuar nga pushteti serb, se “kanë bashkëpunuar me fashizmin” gjatë Luftës së Dytë Botërore, edhe pse mbi 53 mijë kosovarë

¹¹ Revista “Kosova”, (2003). nr. 22/23. Prishtinë: Instituti i Historisë, f. 38.

¹² Radio “Kosova e Lirë”, 8 gusht 2016.

ishin në llogoret e luftës kundër fashizmit. Kurrë nuk është lejuar që të bëhen publike faktet, se Serbia ka likuiduar 11 000 hebrenj deri më 1943¹³.

Në konceptin e filozofisë perëndimore, natyra e njeriut është dualiste. Pranë Abelit, të mirës, te ne jeton Kaini, dhuna dhe e keqja. Pa dyshim lufta bën pjesë në anën e errët të gjinisë njerëzore¹⁴. Luftërat e serbëve në Slloveni, Kroaci, Bosnjë-Hercegovinë, në Kosovë e dëshmojnë më së miri këtë. Sociologë, politologë, politikanë kanë shpjeguar: *“Të paktën kur veprojnë kolektivisht, atyre (autorëve të gjenocidit) u nevojitet ideologjia për të legjitimuar sjelljen e vet, sepse pa këtë ata, vetveten dhe njëri-tjetrin, do të detyroheshin ta shihnin, ashtu siç në të vërtetë janë: hajna të zakonshëm dhe vrasës”*¹⁵.

Sipas Norman Cigar-it: *“Për realizimin e gjenocidit, zhvillimi i ideologjisë është veçanërisht i rëndësishëm në atë masë, sa janë të nevojshëm udhëheqësi dhe arsytimi”*¹⁶.

Ideologët serbë prej shekujsh kanë punuar intensivisht me platforma e objektiva të qartë e konkretë, për të përgatitur psikologjikisht popullin e tyre e të gjitha strukturat shtetërore për gjenocidin ndaj shqiptarëve.

Publicisti serb, Miroslav Filipoviqi, shkruan: *“Është e vështirë të gjendet institucion kombëtar, që të jetë munduar ta ruajë popullin serb nga kryerja e krimeve. Në veçanti është e vështirë të gjenden institucione që nuk e kanë nxitur popullin serb të kryejë krime. Ku ka qenë Akademia e Shkencave, ku ka qenë Kisha, ku ka qenë Universiteti, ku kanë qenë partitë*

¹³ Radio “Kosova e Lirë”, 8 gusht 2016.

¹⁴ Pasini, Scognomiglio. Parlo; (1999). *Lufta e Kosovës*. Tiranë: Geer, f. 238.

¹⁵ Kuper, Leo; (1981). Genocidi: “It’s political rise in the twentieth contry”. Pelican Books, f. 84.

¹⁶ Cigar, Norman; (2003). *Roli i orientalistëve serbë për justifikimin e gjenocidit ndaj myslimanëve në Ballkan*. Tiranë: “Logos - A”, f. 54.

politike?”¹⁷. Për këtë qëndrim objektiv dhe kurajoz u dënua me 7 vjet burg nga Gjykata Ushtarake e Nishit.

Në memorandumimin e Akademisë së Shkencave të Serbisë theksohet: *“Përfshirja në gjirin tonë e territoreve etnikisht të pastra, duke vënë në përdorim mjetet e luftës”*¹⁸.

Akademiku Dobrica Qosiç (President i Jugosllavisë) thoshte: *“Krimet që janë bërë kundër nesh ne po u përgjigjemi me krime. Objektivin nuk është vetëm që të mbajmë serbizimin, por edhe të spastrojmë territorin, që të mund të kemi një shtet etnikisht të pastër”*¹⁹.

Duke folur rreth mitit të Kosovës, ai deklaroi se *“Kosova është vend i shenjtë serb, që do të mbrohet nëse është nevoja, edhe me armë”*²⁰.

Patriku Pavël, duke iu referuar Ungjillit, u drejtohet besimtarëve ortodoksë serbë me fjalët: *“Ka luftëra të drejta dhe të padrejta. Mbrojtja e Kosovës është luftë e drejtë, prandaj me çdo mjet dhe në çdo kohë duhet të dëbohet pushtuesi shqiptar”*²¹.

Murgu serb, Filloret, i cili para kamerave televizive dilte me një mitraloz të lehtë dhe mbante gjithmonë me vete simbolet e vdekjes, të nesërmen që ra Vukovari, ku serbët masakruan kroatët, shfaqti keqardhje të madhe: *“Nuk gjenden më shumë Sheshela dhe Arkanër për të mbrojtur interesat e popullit serb”*²². Ndërsa peshkopi serb, Nikollaj Velimiroviq, deklaronte me entuziazëm: *“Meriton respekt prijësi i tanishëm gjerman*

¹⁷ Revista “Republika”; (2000). Nr. 263. Nish, f. 27-28.

¹⁸ Grmek, Mirko, Gjidara, Marc & Šimac, Neven; . *Spastrimi etnik*. Tiranë: 55, f. 274.

¹⁹ Po aty, f. 247.

²⁰ Islami, Hivzi; (2005). *Studime demografike, 100 vjet të zhvillimit të demografisë së Kosovës*. Prishtinë: ASHAK, f. 307.

²¹ Delvina, Sherif; (2000). *Kosova - një mit serb apo një realitet shqiptar*. Tiranë: *Eurorilindja*, f. 130.

²² Grmek, Mirko, Gjidara, Marc & Šimac, Neven; *Spastrimi etnik*, Tiranë: 55, f. 236-237.

(Hitleri), i cili ka parë se nacionalizmi pa fe është një anomali, një mekanizëm i ftohtë, jo i sigurt”²³.

Mirko Dordeviq deklaroi: “Vetë kisha jonë e ka krijuar nacionalizmin. Ishte kisha dhe klerikët e saj mitkrijues, që mbajtën gjallë flakën e nacionalizmit serb gjatë shekujve të pushtimit osman, kur shteti i Serbisë pushoi së ekzistuari. Ishte kisha, që i bëri luftëtarët shenjtore. Kjo e kaluar e mitizuar dhe e lavdishme i ka inkurajuar serbët të shpresojnë për një Serbi të Madhe. Ishte ëndrra e kishës, që të gjithë serbët të jetonin në një shtet të vetëm. Prandaj ardhja në pushtet e Millosheviqit në fund të viteve 1980 u prit me aq entuziazëm”²⁴.

Që kur u dyndën drejt Gadishullit Ilirik, serbët patën si objektiv kryesor të shfarosnin sistematikisht vendasit ilirë, arbër dhe shqiptarë, duke i vrarë dhe duke i dëbuar me forcë nga trojet e tyre. Patrioti Haxhi Kadriu, thoshte: “Programi i Serbisë është me farue racën shqiptare”²⁵. Garashanin (ministër i Brendshëm i Serbisë), projektuesi i Serbisë së Madhe, më 1844 i përshkruan shqiptarët si fise të egra, si asimilues e vrasës të serbëve. Ai i rekomandonte shtetit të vet, që të mos bënte asnjë aleancë mbi baza të barabarta me shqiptarët. Teza e tij kryesore ishte: “Serbia duhej të bindej, se është ende e vogël”²⁶. Nënteksti: të rritej, të zmadhohej duke ua marrë tokat shqiptarëve.

Për princin Milan Obrenoviq: “Sa më tepër shqiptarë të largohen nga Sanxhaku i Nishit, aq më tepër do të mbeten meritat tuaja para atdheut”²⁷.

²³ Krasniqi, Mark; (2002). Rrënjët etnike. Prishtinë: Redaksia e Botimeve e Partisë Shqiptare Demokristiane të Kosovës, f. 58.

²⁴ Gazeta New York Times, 4 korrik 1999.

²⁵ Baleta, Abdi;. (1999). Kosova nga Dejtoni në Rambuje. Tiranë: Koha, f. 145.

²⁶ Grmek, Mirko, Gjidara, Marc & Šimac, Neven; Spastrimi etnik. Tiranë: 55, f. 57.

²⁷ Raça, Shkëlzen; (2009). Gjurmime në historinë shqiptare. Prishtinë: Instituti Albanologjik, f. 378.

Më tej e plotësonte mendimin e tij: “*Serb i mirë dhe patriot është ai që ndjek më shumë shqiptarë*”²⁸.

Autoritetet e larta shtetërore serbe në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX e presin serbin me pyetjen: “*Ku je, more trim, a preve mjaft koka të turkut e të shqiptarëve?*”.

Ideja e Beogradit që në këtë kohë ka qenë: të kolonizojnë Kosovën me serbë, të zaptojnë qendrat më të mira të Shqipërisë së Veriut, të sjellin fëmijët e tyre, të blejnë mall dhe, më në fund, të bëhen vendas.

Sipas gjeografit serb Cvijiç (rektor i Universitetit të Beogradit), “*shqiptarët janë kombi më i rrezikshëm, përderisa ata janë raca më e përhapur në Ballkan*”²⁹. Absurditeti i këtij pseudohistoriani arrin deri aty, sa shprehet: “*Serbia ka të drejtë të pretendojë territore që kurrë nuk i ka pasur*”³⁰. Dhe bën thirrje të hapur për gjenocid ndaj shqiptarëve: “*Sa më shumë shqiptarë të vrisni, aq më shumë do të shtoheni ju, serbët*”³¹. Për serbët, shqiptari më i mirë do të ishte shqiptari i vdekur.

Nikolla Pashiçi (kryeministër) porosiste: “*Shteti serb nuk duhet të shpenzojë para për të lehtësuar jetën e shqiptarëve, por për t'i bërë të nisen sa më shpejt*”³². Serbët me Pashiçin në krye parashtruan para Fuqive të Mëdha tezën se çështja shqiptare, kur ajo të ndahet në disa pjesë, nuk do ta shqetësonte më Europën. Pashiçi dëshironte dhe ëndërronte një Shqipëri të pavarur, por të dobët dhe me grindje të përhershme brenda për brenda³³. Ideja e tij antihumane, antishqiptare, ka qenë: “*Ne do t'i serbizojmë*

²⁸ Grup autorësh, 1999. *Gjenocidi serb në Kosovë*. Tiranë: Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, f. 37.

²⁹ Rullman Peter, Hans; (1997). *Ikje masive*. Tiranë: *Lilo*, f. 7.

³⁰ Cvijiç, Jovan; (1908). “*Aneksija Bosne i Hercegovine i srpsko pitanje*”. Reprinted in *Govori i Clanci I*, Beograd: 1921, f. 202.

³¹ Çina, Pandeli; (2001). *Ballkani i trazuar dhe shqiptarët*. Tiranë: *Horizonti*, f. 19.

³² Uruçi, Dashamir; (2001). *Kosova dhe e drejta e vetëvendosjes*. Shkodër: *Shtjefni*, f. 29.

³³ Grup autorësh; (1999). *Gjenocidi serb në Kosovë*. Tiranë: Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, f. 29.

shqiptarët dhe nëse nuk do të serbizohen, ne do t'i dëbojmë dhe nëse do të rezistojnë e nuk do të mundim t'i dëbojmë, ne do t'i vrasim ata”.

Mbreti i Serbisë, Petar i Karagjorgjeviq, pas betejës së Kumanovës, më 1912 u drejtohet eprorëve të tij ushtarakë me fjalët: *“Çfarë dobie paraqesin këta njerëz për mua? Duhet t'i mbysni, jo me pushkatim, sepse kjo do të jetë humbje e municionit, por me shpatë”*³⁴.

Në një kishë në Pejë janë të gdhendura me shkronja serbe fjalët: *“O Zot! Na ndihmo të shfarosim shqiptarët!”*. Në muret e xhamisë në fshatin Mushtisht është shkruar në gjuhën serbe: *“O Zot! Na ndihmo të shfarosim shqiptarët!”*³⁵

Një oficer i lartë nga dera e Petroviçëve mburrej kur thotë: *“Brenda dy vjetëve asnjë njeri në tokat e pushtuara nuk do të guxonte të fliste atë gjuhë të ndyrë, shqipen”*. Komandanti i Zonës së Tretë, gjeneral Cemerkiç, kërkonte që në rajon, ku popullsia shqiptare përbënte 80-90% të banorëve, si në Rahovec, Prizren, Dragash, Suharekë, Podujevë, Vuçiternë, Gjilan, Kaçanik të krijoheshin garnizone të reja ushtarake, që të mund të zbatoheshin më mirë procesi i kolonizimit sllav dhe shpërngulja e shqiptarëve.

Kur Krajl Aleksandri shkoi për vizitë në Istog të Pejës, ai pyeti kryetarin e bashkisë: *“Sa shqiptarë ka këtu?”*. Ai u përgjigj: *“95%”*. Krajl Aleksandri e pështyu 95 herë, duke i thënë: *“Ç’ke bërë ti, që këtu të mos ketë 95% shqiptarë, por 95% serbë dhe 5% shqiptarë?”*³⁶. Akademiku kroat Josif Ham tregon: *“Drejtori i gjimnazit në Prishtinë më tha: “Profesor Ham, në klasën tuaj, ku ju do të jeni kujdestar, janë edhe 2-3 nxënës arnautë (nënkuptohet shqiptarë). Ata, kurrsesi, nuk duhet të kryejnë klasën pa marrë*

³⁴ Rushiti, Liman;(2004). *Ndarja territoriale dhe rregullimi administrativ i Kosovës*. Prishtinë: Instituti i Historisë, f. 65-67.

³⁵ Loli, Pirro & Shllaku, Primo; (2002). *Saga e Ballkanit*. Shkodër: Camaj-Pipa, f. 29.

³⁶ *E vërteta mbi gjendjen e shqiptarëve*. (1960). Tiranë: Naim Frashëri, f. 28-29.

*parasysh dijet e tyre. Këtë duhet ta kuptoni dhe ta zbatoni*³⁷. Zbatimi pikë për pikë i Doktrinës së Pashiçit ishte: *“Torturoji, rrihi, mos i lër të mësojnë shqiptarët*”³⁸.

Gazeta franceze *“La Crois”*, më 22 qershor 1935 shkruante se terrori po vazhdonte të bënte kërdrinë. Kjo gazetë pra, ka parasysh edhe terrorin serb ndaj shqiptarëve të Kosovës. Në letrën e Drazha Mihailloviqit dërguar Budo Dobriçit, më 15.03.1944 thuhet: *“Çështja e Kosovës, e Metohisë dhe e Kolashinit, si dhe e Serbisë Jugore mund dhe duhet të zgjidhen vetëm me pastrimin e turqve dhe të shqiptarëve*”³⁹. Svetozar Vukmanović-Tempo, udhëheqës politik dhe ushtarak i lartë, tërhoqte vërejtjen për autoritetet ushtarake pse akoma mbahen njerëz në kampe (jo për t'i lënë të shkojnë në shtëpitë e tyre), por për t'i qëruar sa më shpejt, për t'i vrarë të gjithë⁴⁰.

Në Kosovë, në vitet 1919-1941 u shpronësuan 192 mijë ha tokë. 250 mijë shqiptarë u shpërngulën në periudhën midis dy luftërave botërore. Gjenocidi ndaj shqiptarëve merrej për krenari dhe sukses nga ushtria, policia dhe organet e shtetit serb. Kjo i shumëfishonte krimet e tyre: torturat, burgosjet, vrasjet dhe shpërnguljet me dhunë nga vendi i të parëve të tyre denbabaden. Gjatë periudhës 1946-1999 janë masakruar mbi 20 mijë shqiptarë, janë shpërngulur në mënyrë të dhunshme nga Kosova mbi 800 mijë shqiptarë.

Vojislav Sheshel që më 1996 deklaronte: *“Do t'i përzë shqiptarët përtej Bjeshkëve të Nemuna*”⁴¹. Qëllimi ka qenë: *shuarja e jetës shqiptare me çdo kusht e me çdo mjet.*

³⁷ Krasniqi, Mark; (2002). *Rrënjët etnike*. Prishtinë: Redaksia e Botimeve e Partisë Shqiptare Demokristiane të Kosovës, f. 63.

³⁸ Revista *Kosova*; (2003). nr. 22/23. Prishtinë: Instituti i Historisë, f. 235.

³⁹ Hoti, Izber; (1997). *Çështja e Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore*. Prishtinë: QIK, f. 18.

⁴⁰ *E vërteta mbi gjendjen e shqiptarëve*. (1960). Tiranë: Naim Frashëri, f. 25.

⁴¹ Sinani, Shaban; (1998). *Kosova në gjeopolitikë*. Tiranë: Dritëroi, f. 109.

Çfarë emri mund t'i vësh tjetër këtij, veç gjenocid?! Projekt i regjimit të Millosheviqit ishte: Të gjithë serbët në një shtet të vetëm!

Njohëse e mirë e psikologjisë së popullit serb, Edith Durham arrin në përfundimin: *“Nuk ka dyshim se në zemrën e çdo njeriu është fshehur një bishë. Dhe ajo mund të flejë gjatë kohës së shumë brezave, por në barkun e sllavëve të Jugut, të secilit prej tyre, as që i ka shkuar mendja të kotet ndonjëherë”*⁴².

Millosheviqi me “Ungjillin” e Çubrilloviqit e të ideologëve të tjerë shovinistë serbë, ndër të cilët Dobrica Qosiç (babai shpirtëror i Millosheviqit), i hyri spastrimit etnik të Kosovës

Ardhja e Millosheviqit në krye të Partisë Komuniste serbe dhe më vonë të shtetit serb ndezi epshet serbe për të filluar spastrimin etnik nga elementi joserb. Simboli rreth të cilit u bashkuan jo vetëm serbët në Kosovë, por edhe nga vise të tjera u bënë mitingjet në Fushë-Kosovë. Më 24 prill 1987, Millosheviqi iu drejtua serbëve: *“O voj narod vise nikod ne sme da bije”*. E përkthyer në shqip do të thotë: *“O populli im, askush nuk do t'ju godasë më!”*⁴³. Për të përgatitur psikologjikisht serbët për aksionin e spastrimit etnik, ata po paraqiteshin si viktima në Jugosllavinë Federative. Millosheviqi, më 19 qershor 1988, para 300 mijë vetave në Beograd deklaronte: *“Çdo komb ka një dashuri që ngroh përjetësisht zemrën e tij. Për Serbinë kjo dashuri quhet Kosovë”*⁴⁴. Më 28 qershor 1989, në 600-vjetorin e Betejës së Fushë-Kosovës, turma serbe me thirrje hysterike u

⁴² Qosja, Rexhep; (2014). *Dëshmitarë në kohë historike (1979-1981), Ditar III*. Tiranë: “Toena”, f. 354.

⁴³ Boriçi, Gjon; (2008). *Lufta për paqen në ish-Jugosllavi*. Tiranë: “Geer”, f. 41.

⁴⁴ *Tanjug*, 19 qershor 1988, Beograd.

drejtohej të gjithë serbëve, kudo që ndodheshin: “*Sot, 600 vjet më vonë, ne po luftojmë përsëri. Beteja të reja na presin*”. E turma serbe në Fushë-Kosovë bëhej edhe më e papërmbajtur kur dëgjonte Millosheviqin: “*Serbia ndodhet përpara betejave të reja, jo me armë, edhe pse këto të fundit mund të mos përjashtohen*”⁴⁵.

Kujtesa, si një nga simptomat populiste, e përdorur me mjeshtëri nga propaganda e Millosheviqit, shërbeu si mjet për përgatitjen psikologjike të serbëve për luftë kundër popujve joserbë në Jugosllavi për të realizuar Serbinë e Madhe.

Populli serb po përgatitej për agresion ushtarak edhe ndaj popujve joserbë. Vite më vonë në shënjestrën e tij do të ishin shqiptarët e Kosovës: “*Në daçim t'i gjunjëzujmë shqiptarët, duhet t'u hyjmë në fshatra e t'ua derdhim miellin nga magjet*”⁴⁶. *Toka, Mielli (Buka), Besa* janë të shenjtë për shqiptarët. Përbetimi i tyre është: “*Për këtë dhé!*”, “*Për këtë bukë!*”, “*Për këtë besë!*”... Me këto lidhet ekzistenca dhe mbijetesa e tij në shekuj.

Në gojën e serbëve buçiste kënga: “*O vëllezër dhe heronj, në Fushë-Kosovë prapë do të dalë Serbi!*”. Poeti serb Branko Rodiçeviç do të thurte vargjet: “*Dhe po ju them / do të kalojnë 100 vjet / dhe ne do të lëvizim pa pushim / nga Kosova Polje në Kosova Polje / dhe nuk do të kenë fund nisjet dhe rikthimet. / Kurrë nuk do të kenë fund, / sepse është Kosova / vendi ku mbaron dhe nuk mbaron kurrë Serbia*”⁴⁷.

Ideja për dëbimin e shqiptarëve nga Kosova për në Shqipëri daton që në vitin 1988 dhe është miratuar nga Millosheviqi. Nga qyteti serb Apatan, Millosheviqit i është dërguar një letër. Përmbajtja e saj është e mbushur me propozime për një luftë kundër shqiptarëve, për vrasjen dhe dëbimin e

⁴⁵ *Tanjug*, 28 qershor 1989, Beograd.

⁴⁶ Zaço, Malko; (2004). *Kosova nga lufta te pavarësia*. Tiranë: “Skanderbeg Books”, f. 69.

⁴⁷ Polovina, Ylli; (2000). *Ditari i Romës, Libri i parë*. Tiranë: “Mësonjëtorja e Parë”, f. 177-178.

tyre për në Shqipëri. Letra është lexuar nga Millosheviqi dhe në anën e prapme është shkruar mbështetja e tij⁴⁸.

Siç e theksuam edhe më lart, tashmë është më se e qartë, se objektivi i Millosheviqit ka qenë spastrimi etnik, shndërrimi i Kosovës në një provincë 100% serbe dhe ortodokse, ku të mos mbesë këmbë myslimani e shqiptari⁴⁹.

Për të argumentuar këtë, po parashtrojmë objektivat e mëposhtëm:

Më 25 tetor 1998, Gjenerali Klark, bashkë me Naumanin, u takuan në Beograd me Millosheviqin, i cili me gjakftohtësi, vendosmëri dhe cinizëm u tha: *“Ju e dini, Gjeneral Klark, se ne duhet t'i qërojmë hesapet me shqiptarët, me këta vrasës, me këta dhunues, me këta vrasës të fëmijëve të tyre! Përpara ne jemi kujdesur për ta!... Në Drenicë, më 1946 ne i kemi vrarë ata. I kemi vrarë që të gjithë!”*⁵⁰

Edhe Hitleri para gjeneralëve të tij në Obsersalsberg, më 22 gusht 1939 deklaronte: *“... i kam dërguar njësitet e mia të vdekjes në Lindje, me urdhër që të vrasin pa mëshirë burra, gra, fëmijë të racës dhe të gjuhës polake”*⁵¹.

Edhe Hans Frank, në dhjetor 1941, porosiste: *“Ne duhet t'i asgjësojmë hebrenjtë kudo që t'i gjejmë dhe kudo që të jetë e mundur, në mënyrë që atje të bëjmë strukturën e Rajhut si tërësi”*⁵².

Plani B i Millosheviqit parashikonte që, në momentin kur numri i refugjatëve do të arrinte shifrën 1 milion, bombardimet do të ndërpriteshin. Ai do të lejonte kthimin e menjëhershëm të refugjatëve, të cilët ishin strehuar në Maqedoni, ndërsa për ata që ishin larguar drejt Shqipërisë, do të

⁴⁸ Jashari, Ruzhdi; (2013). *Dosje e dokumenteve dhe dëshmi sekrete serbe*. Prishtinë: “Shkrola”, f. 108.

⁴⁹ Grup autorësh; (2001). *Lufta kundër luftës*. Tiranë: “Ora”, f. 19.

⁵⁰ Clark, Wesley; (2003). *Të bësh luftë moderne*. Prishtinë: “Zëri”, f. 187.

⁵¹ Daves, Norman; (1997). *A History*. Londër: “Pimlicio”, f. 909.

⁵² Po aty.

vendosej një “sistem verifikimi”, që do të thotë: **nuk do të kishte rikthim të tyre asnjëherë**. Pra, banorët e Drenicës, Dukagjinit dhe Mitrovicës do të mbeteshin përgjithmonë jashtë Kosovës. Këto metoda kishin përdorur serbët edhe më parë. Kam parasysh urdhëresën e qeverisë serbe, që popullata e Lugut të Drinit, e shpërngulur gjatë djegies së vitit 1919, duhej të kthehej në afatet e përcaktuara nga kjo urdhëresë, në të kundërt humbisnin të drejtën e pronave. Realisht u penguan me gjithfarëlloj mënyrash e justifikimesh të pabazuara dhe pa kuptim.

Autoritetet e larta shtetërore serbe kishin planifikuar që, në momentin e ndërprerjes së bombardimeve dhe fillimit të Rambujesë 3, në Kosovë do të hynin 200 deri në 300 mijë refugjatë serbë nga krahina e Kroacisë dhe do të vendoseshin në pjesët, prej së cilave përfundimisht ishin përzënë shqiptarët. Millosheviqi në këto kushte ka qenë i gatshëm të pranojë madje, edhe ka dëshiruar një prani ushtarake nën flamurin e OKB-së, që sipas planit të tij do të kishin ruajtur paqen dhe do ta kishin betonuar gjendjen e krijuar si në Bosnjë, me pastrim etnik *de facto* dhe të legjitimuar nga bashkësia ndërkombëtare⁵³.

Synimi i Millosheviqit ishte:

- Të realizonte politikën e faktit të kryer, duke dëbuar të gjithë shtetasit me kombësi shqiptare.
- Të shkaktonte një krizë në Maqedoni e Shqipëri, ku ishin pjesa më e madhe e refugjatëve.
- Të shkaktonte një krizë politike në Greqi, Itali e vende të tjera të NATO-s, pranë zonës në luftë e që ishin më pak të vendosura për të mbështetur sulmet e NATO-s.

⁵³ Gazeta “Ekspres”, 3 janar 2014. Prishtinë.

Milloseviqi vendosi të kalonte në veprime të dhunshme, duke shtuar forcat ushtarake, policore dhe paraushtarake të pranishme në Kosovë, duke u besuar këtyre të fundit detyrën që të vrisnin, të digjinin dhe të tmerrnin popullsinë kosovare⁵⁴.

“*Bomba etnike*” që Milloseviqi hodhi nuk kishte goditur në shenjë. 1 milion qenie njerëzore që u dëbuan me forcë, gjetën strehë dhe ushqim në Shqipëri e Maqedoni, duke shmangur katastrofën dhe kaosin. Plani i Milloseviqit u cilësua si “*bumerang vigan*”.

Presidenti Klinton në mars të vitit 1999 pati deklaruar për një TV amerikan: “*Shikoni hartën e Kosovës. Kosova është një vend i vogël, por është një urë lidhëse mes Europës, Azisë, Lindjes së Mesme dhe vendtakim i Islamit dhe i degëve Katolike e Ortodokse të Krishterimit. Atje janë aleatët tanë, Turqia dhe Greqia, pastaj aleatë të tjerë përreth Kosovës. Ka vende të vogla demokratike, që kanë sfidat e veta politike dhe ekonomike. Të gjitha parakushtet për një luftë të gjerë janë atje: konflikte të vjetra, demokraci të brishta dhe në qendër diktatori në Serbi, që nuk ka bërë gjë tjetër, që nga fundi i Luftës së Ftohtë, përveç fillimit të luftërave të reja dhe derdhjes së benzinës në ndarjet etnike e religjioze*”⁵⁵.

Pasojat e këtyre luftërave dihen tashmë...

Gazeta “*Courier International*”, më 31 maj 1999 shkruante: “... është tmerr në Kosovë. Është kulmi i krimit, i shpërnguljes, i përdhunimit të grave e të vajzave, i hakmarrjes meskine serbe kundër shqiptarëve. Propaganda serbe kërkon të përlligjë masakrën ... Ajo kërkon të përlligjë sidomos famëkeqin “*spastrim etnik*”, sepse ky i fundit i kujton gjithë botës holokaustin kundër hebrenjve.

⁵⁴ Pasin, Scognomiglio; (1999). *Lufta e Kosovës*. Tiranë: “Geer”, f. 122.

⁵⁵ Dodds, Klaus; (2019). *Gjeopolitics*. Oxford: “University Press”, f. 20.

Sipas uluranacionalistit serb Sheshel: *“Maqedonia do të zhdukej nga harta dhe shtetet e tjera fqinje do të jenë në luftë me Serbinë. Në Kosovë do të vdesin shumë serbë, por nuk do të mbeten më shqiptarë”*⁵⁶.

Arkan, udhëheqësi ushtarak i paramilitarëve serbë, në një intervistë të tij thotë: *“Millosheviqi i zgjoi serbët. Ai më zgjoi nga gjumi edhe mua”*⁵⁷.

Organizatrat sekrete dhe paramilitare kanë vepruar në Serbi që në fillim të shekullit XX, me mision vrasjen dhe dëbimin e shqiptarëve. Parulla e tyre ka qenë: *“Do istrashe nashe ili vashe!”* (Deri në shfarosje, o ne, o ju!) Pra, çetnikët dhe grupet paramilitare duhet të ishin krahu i armatosur, që të goditnin këdo që do të pengonte realizimin e një *“Serbie të Madhe dhe homogjene”*. Në vitin 1993, një diplomat kroat, i cili zhvilloi negociata të fshehta me Millosheviqin, e pyeti këtë të fundit rreth Arkanit. Ai vuri buzën në gaz dhe u përgjigj: *“Edhe unë duhet të kem dikë, që të kryejë disa punë për mua”*⁵⁸. Pra, Arkani ishte dora e zgjatur dhe e sigurtë e krimit për Millosheviqin.

Personalitete të shquara politike, të letërsisë dhe artit botëror, shkencëtarë, demaskuan krimet e Millosheviqit në Kosovë dhe bënë portretin e tij, ashtu siç ishte: kriminel, diktator, demagog dhe mediokër.

Warren Zimmerman, ambasador i SHBA-së në Beograd (1989-1992) shkruan: *“Është njeriu më i akullt që kam takuar ndonjëherë. Për mendimin tim, ka qenë pikërisht kjo ftohtësi ogurzezë, që ia ka lehtësuar punën kur ka urdhëruar vrasjet masive, që i dhanë një vend në histori”*⁵⁹.

Sipas Vaclav Havel-it, president i Çekosllovakisë: *“Millosheviqi i ka duart tepër të ndotura me gjak”*⁶⁰. Vetëm një mediokër që bën krime të

⁵⁶ Danaj, Pëllumb; (2005). *Kosova dhe NATO-ja*. Tiranë: “Toena”, f. 122.

⁵⁷ *The Independent*, 17 janar 2000. Londër.

⁵⁸ Hrvoje, Sarinic; (1998). *Svi moji tajni pregovori sa Slobodanom Miloševićem: između rata i diplomacije, 1993-1995* (1998).

⁵⁹ *News week*, 19 prill 1999. Nju Jork.

⁶⁰ Grup autorësh; (2001). *Lufta kundër luftës*. Tiranë: “Ora”, f. 40.

paimagjinueshme për gati një dekadë, nuk e kupton dështimin dhe fundin e tij të turpshëm. Politikës shfarosëse të hebrenjve nga Hitleri iu kundërvunë shumica e intelektualëve gjermanë, ndërsa shumica e intelektualëve serbë u vunë në shërbim të Millosheviqit.

Në Memorandumin e Akademisë serbe nënvizohet me forcë ideja, se *“Serbia nuk duhet të ishte pasive dhe të priste çfarë do të thoshin të tjerët, siç është vepruar shumë herë në të kaluarën”*⁶¹. Ky memorandum ishte në një vijë me Millosheviqin, që serbët duhet të marrin në dorë fatin e tyre. Madje në Memorandumin e Akademisë serbe shkruhet tekstualisht: *“Përfshirja në gjirin tonë e territoreve etnikisht të pastra, duke vënë në përdorim mjetet e luftës”... “Fati i Kosovës mbetet një çështje jetësore për të gjithë serbët e Kosovës”*⁶².

Memorandumi përbën pikënisjen e një koalicioni: parti-akademi-ushtri-shkrimtarë dhe kisha. Serbia në këtë memorandum vajton se dikush po përpiqet t’ia mbjellë ndjenjën e fajit e të përgjegjësisë historike! Natyrisht, kjo ankesë vetëmbrojtëse është vetëm në dukje. Faktikisht ajo është shumë agresive, sepse synon që, me lirim nga *“komplekset e fajit e të përgjegjësisë historike”*, t’i hapet rruga hegjemonisë së re serbe!⁶³

Një intelektuale serbe, kur u pyet nga ambasadori amerikan, se çfarë mendonte për shqiptarët, ajo u përgjigj: *“Fare e thjeshtë, të mbështeten të gjithë për muri e të pushkatohen”*⁶⁴.

Dr. Bogdanoviç flet për mbijetesën e kombit serb: *“Tani është çështja e mbijetesës së krejt kombit serb. Nuk është çështja e fatit të kombit shqiptar që riskohet, por e atij serb... Kujtesa historike e një populli të tërë po fshihet, themelit të vërtetë të ndërgjegjes së tij kombëtare po i gërryhen*

⁶¹ Grmek, Mirko, Gjidara, Marc & Šimac, Neven; *Spastrimi etnik*. Tiranë: 55, f. 227.

⁶² Po aty, f. 215.

⁶³ Agani, Fehmi; (1994). *Demokracia, kombi, vetëvendosja*. Pejë: “Dukagjini”, f. 145.

⁶⁴ Danaj, Pëllumb; (2005). *Kosova dhe NATO-ja*. Tiranë: “Toena”, f. 206-207.

themelet”⁶⁵. Qëllimi i tij dhe i historianëve të tjerë serbë është të mobilizojnë serbët për të pastruar Kosovën nga shqiptarët, të cilët sipas tyre rrezikojnë mbijetesën e kombit serb. Për mbijetesë luftohet me të gjitha mjetet, mobilizohen të gjitha resurset e mundshme dhe sakrifikohet edhe jeta. Propaganda serbe gjithnjë ka paraqitur dhe po paraqet edhe sot raste të dhunimit, të persekutimit të serbëve nga shqiptarët, madje sipas saj, edhe varret serbe përdhuheshin nga shqiptarët.

Qeveritë serbe morën masa, nxorën ligje, dekrete dhe vendime, që t’ua bënin sa më të vështirë jetën shqiptarëve të Kosovës. Ndër këto masa mund të përmendim:

- Aksioni për mbledhjen e armëve në Kosovë (nëntor 1955 - mars 1956) e përshpejtoi procesin e shpërnguljes së shqiptarëve.
- Ushtrimi i dhunës fizike dhe psikologjike të vazhdueshme, që e detyruan popullin të largohet nga Kosova.
- Në Fakultetin Teknik në vitin 1965-1966, nga 153 studentë të regjistruar vetëm 42 ishin me kombësi shqiptare; në vitin 1970-1971, nga 587 studentë në vitin e parë të regjistruar, ishin 373 me kombësi shqiptare, edhe pse popullsia shqiptare ishte mbi 80%.
- Në vitin 1966 në 100 banorë ishin të punësuar 7,2% shqiptarë, 14,3% serbë dhe malazezë; më 1986 ishin të punësuar 12,5% shqiptarë, 23,1% serbë, 24,9% malazezë. Deri në shpërbërjen e Jugosllavisë ishin të punësuar në Kosovë 1 ndër 12 shqiptarë, 1 ndër 4 serbë dhe 1 ndër 3 malazezë.
- Nga marsi 1981-tetor 1989 u keqtrajtuam 584 373 shqiptarë. Deri në fund të vitit 1992 numri i shqiptarëve që kaluan në policinë serbe,

⁶⁵ *Богдановић, Димитрије.*(1985). *Књига о Косову*. Београд: Српска Академија Наука И Уметности Посебна Издања, f.283.

? *Gazeta "Bota e re"*, (1970), nr. 17/18, f. 7, Prishtinë.

arriti shifrën prej 900 mijë vetash. Më 1981 nga policia serbe janë vrarë 12 shqiptarë, më 1989 - 25 shqiptarë dhe më 1990 - 28 shqiptarë. Në vitin 1989 u dënuan 237 intelektualë shqiptarë. Janë 115 deri 125 shqiptarë të vrarë në kazermat serbe. 200 mijë fëmijë shqiptarë janë helmuar në vitet 1988-1990 nga shërbimet sekrete serbe. Gjatë shpjegimit të shkronjës “Sh” në një shkollë, një nxënës tha fjalën “Shqipëri”. Nxënësi që ishte pranë tij i tha: “*Mos e përmend atë fjalë, se të merr policia*”.

Pas ngjarjeve të pranverës së vitit 1981 deri në vitin 1990 u përzunë nga puna 70 mijë punëtorë, pjesëmarrës në greva e protesta kundër amendamenteve kushtetuese. Numri i shqiptarëve në Universitetin e Prishtinës u ul në masën 60%. Nga puna dhe nga shkollat u dëbuan dhjetëra mësues e nxënës, sepse nuk pranuan të punonin me planprograme serbe, të hartuara nga organet e dhunshme⁶⁶. Gjatë viteve 1998-1999 janë vrarë 13 500 shqiptarë dhe mbi 1300 fëmijë. Janë dëbuar nga tokat e tyre 1 milion shqiptarë, si dhe janë djegur e shkatërruar qytete e fshatra të tëra.

Gjorgje Martinoviç, 56 vjeç, fermer nga fshati Shillovë i Gjilanit, i punësuar civil në ushtrinë jugosllave, u dërgua urgjentisht në spitalin e Prishtinës, ku mjekët hoqën nga anusi i tij një shishe birre të thyer. Sipas tij, shishen ia kishin vendosur dy shqiptarë me maska, me qëllim që ta detyronin të largohej nga Kosova. Për këtë u botua një libër me 485 faqe në 50 mijë kopje, i përkthyer edhe në anglisht. U organizuan dy mbledhje të Kuvendit Federativ të Jugosllavisë. Nga konsultat mjekësore u vërtetua përfundimisht, se ai e kishte provokuar vetë këtë akt të turpshëm.

Gazeta “*Borba*” shpalli si fotografi të vitit atë të *Mile Jelesijeviç*, një nënë serbe “heroinë” me pushkë në dorë, me një fëmijë në grykë dhe me një tjetër të kapur për dore, duke ikur nga Kosova, gjoja nga torturat shqiptare.

⁶⁶ Reka, Blerim; (1991). *Vitet e shpresës*. Prishtinë: “Rilindja”, f. 25.

Gjithashtu përmendim edhe rastin “Panda” në vitin 1999 në Pejë, i cili është tejet rrëqethës. Në një kafene në qytet u vranë 6 të rinj serbë. Shteti inskenoi çdo gjë. Burgosi e dënoi të rinj shqiptarë si kryerës së këtij akti terrorist. Pas luftës, vetë presidenti serb, Aleksandër Vuçiq, e pranoi se rasti ka qenë inskenim nga ana e vetë shtetit!⁶⁷

Po kështu, për të sensibilizuar serbët, që të qëndrojnë në Kosovë e në Kroaci, janë përdorur fushata me kufoma si në kohën e Mbretërisë Jugosllave, ashtu edhe në kohën e Millosheviqit. Kryeministri i Mbretërisë, Svetozar Pribiçević, i kishte propozuar mbretit Aleksandër, që eshtrat e Shën Savës të silleshin rreth e qark Kroacisë për të mobilizuar elementin serb, kundër një fitoreje eventuale kroate në zgjedhjet që do të pasonin. Mirëpo zgjedhjet nuk u mbajtën, sepse më 8 gusht 1928 u vra kryetari i Partisë Fshatare Kroate, Stjepan Radiçi. Po kështu, në fund të vitit 1989, nën mbikëqyrjen e Kishës Ortodokse Serbe dhe me miratimin e autoriteteve më të larta në Beograd, u bë rivarrimi i eshtrave të Carit Llazar të Serbisë. Eshtrat e tij u bartën rreth e qark Serbisë, për të thirrur “*eshtrat e vërteta të serbizimit*”, para se të rivarroseshin sërish.

Simbioza politike aktuale Qosiç-Millosheviq është pasoja logjike e bashkësisë së interesave të të dyve dhe e plotësimit të ndërsjellët të aftësive të tyre: ideologu e kishte gjetur, më në fund, njeriun e veprimit të kallëpit të tij. Në një roman të tijin, ngjarjet e të cilit zhvillohen gjatë Luftës së Dytë Botërore, në gojën e personazhit kryesor të tij, me të cilin përcjell mesazhet e tij, ai shkruan: “*Nuk duhet harruar se ne, serbët, me anë dyndjesh të mëdha kemi marrë drejtimin e Veriut dhe të Perëndimit. Jam i bindur se vetëm në këtë drejtim dhe përgjithmonë e ka sensin rruga jonë, si edhe*

⁶⁷ <https://telegrafi.com/bradhyl-mahmuti-vet-shefi-sherbimit-sekret-te-serbise-e-tha-se-vrasjet-ne-panda-te-pejes-bene-beretat-e-kuqe-te-ulemek-legias/>

objektivat tanë kombëtarë”. Duke gënjyer pa pikë turpi (e thotë vetë se ne gënjejme në një mënyrë krijuese, imagjinuese dhe shpikëse), ai thotë se shteti ynë është transformuar në një vend fatkeqësish dhe turpi, se fqinjët tanë u bënë përsëri persekutorët dhe vrasësit tanë. Arrin në përfundimin, se jemi të dënuar t’i nënshtrohemi një kalvari të gjatë, një poshtërimi, një eksodi dhe asimilimi. U bën thirrje serbëve të rrokin armët, *“sepse krimeve që janë bërë ndaj nesh, ne po u përgjigjemi me krime*”. Duke i paraqitur serbët viktimë *“të vrasësve shqiptarë”*, të poshtëruar deri në atë shkallë, sa të mos e njohin dot veten, duke kritikuar strukturat shtetërore serbe për qëndrim të butë, tolerancë ndaj shqiptarëve, për ngathtësi në veprimet e tyre kundër *“terroristëve shqiptarë”*, ai kërkon mobilizim total të të gjithë serbëve *“për t’u vetëmbrojtur*”. Kërkon t’i prekë në sedër, por në të njëjtën kohë t’i justifikojë ata për gjenocidin ndaj shqiptarëve. Këtë e thotë hapur, por edhe me finesë: *“Gjendja depressive në të cilën ndodhet sot populli serb, si edhe shfaqjet gjithnjë e më të forta të shovinizmit dhe serbofobisë në disa mjedise, e favorizojnë shprehjen përditë e më radikale të sensibilitetit të popullit serb, si dhe reagimet që mund të jenë pasionante, domethënë të rrezikshme”*⁶⁸.

Sheshel, ultranacionalist serb, e vizaton kështu hartën e Serbisë së Madhe: *“Do t’i përkasin Serbisë, veç provincave të Vojvodinës dhe Kosovës, republikat e Bosnjë-Hercegovinës, të Maqedonisë dhe të Malit të Zi, plus krahinat e Kroacisë, të banuara këto nga serbët, sipas kufijve të linjës Karlobag-Karlovac-Vitrovitica”*⁶⁹.

Vuk Drashkoviçi u bën thirrje serbëve që *“të luftojnë për të gjitha ato toka të Jugosllavisë, ku të ketë një varr serb”*⁷⁰. Edhe paqja, edhe demokracia, edhe progresi te serbët janë të lidhura me *“spastrimin etnik”* të

⁶⁸ Grmek, Mirko, Gjidara, Marc & Šimac, Neven; *Spastrimi etnik*. Tiranë: 55, f. 226.

⁶⁹ Gazeta *Der Spiegel*, 6 gusht 1991, Gjermani.

⁷⁰ Grmek, Mirko, Gjidara, Marc & Šimac, Neven; *Spastrimi etnik*. Tiranë: 55, f. 263.

trojeve josllave. Qëllimi nuk duhet të jetë vetëm mbrojtja e serbizimit, por spastrimi i territoreve, që të ketë një shtet serb etnikisht të pastër.

Çubrilloviqi, Millosheviqi dhe pranvera e vitit 1999 në Kosovë

Vaso Çubrilloviqi (historian, politikan, akademik serb, i dekoruar me dekoratën e Federatës Jugosllave për praktikimin e Doktrinës së Shenjtë Serbe) i udhëzoi dhe i mësoi strukturat shtetërore serbe se çfarë duhet të bënin që të kishin sukses në spastrimin etnik të Kosovës: *“Kolonizimi nuk mundi të pengojë shtimin më të madh natyror të arnautëve ndaj serbëve, sepse qeveria nuk pati kurs të vendosur lidhur me arnautët dhe nuk u mori atyre tokën më pjellore... Të rikapitulojnë arnautët është e pamundshme, por t'i asgjësojmë vetëm nëpërmjet kolonizimit. Kur nisemi nga pikëpamja se eliminimi gradual i arnautëve me kolonizimin tonë të shkallëzuar është joefikas, mbetet vetëm shpërngulja e arnautëve në masë”*⁷¹. Për Çubrilloviqin, rruga e vetme efikase për pastrimin e Kosovës nga elementi shqiptar është shpërngulja masive.

- *A nuk u veprua kështu në pranverën e vitit 1999?*

Çubrilloviqi ka imagjinuar një skenar prej ferri, që ka mbetur nga shtrydhja e të gjitha praktikave të ekspansionit dhe të homogjenizimit të Beogradit deri më sot. Sipas tij: *“Në rast se duam me të vërtetë që Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia të jenë të lidhura ndërmjet tyre, Kosova dhe Metohia duhet të ndryshojnë fund e krye nga pikëpamja e përbërjes etnike... Kolonizimi i fshatrave dhe i qyteteve të braktisura nga këto popullata ka një rëndësi të dorës së parë”*⁷².

⁷¹ IU, Beograd, Arkivi i ish-Ushtrisë Jugosllave, dokumenti M.6-F, arka 69.

⁷² Grmek, Mirko, Gjijara, Marc & Šimac, Neven; *Spastrimi etnik*. Tiranë: 55, f. 191-192.

Në zbatim të kësaj direktive Millosheviqi kishte vendosur, që serbët e shpërngulur nga luftërat në Kroaci dhe Bosnjë-Hercegovinë të vendosen menjëherë në Kosovë, pas dëbimit të shqiptarëve atje.

Çubrilloviqi nuk flet për shpërnguljen e disa shqiptarëve të Kosovës nga trojet e tyre, por për dëbime masive, të cilat gjejnë miratim dhe pëlqim. E për t'ia dalë mbanë kësaj, kushti paraprak është krijimi i një psikoze të përshtatshme, për të bërë të pamundur ekzistencën e shqiptarëve. Porosia e tij është: *“T’u vihet zjarri në fshehtësi fshatrave dhe rrethinave të qyteteve shqiptare. Kjo është praktika e përdorur me sukses pas vitit 1978”*⁷³.

Më 1999 ushtria serbe dogji fshatrat dhe qytetet e Kosovës në sytë e botës, pa iu dridhur dora dhe pa iu trembur syri. Në projektin e vitit 1937, *“Shpërngulja e shqiptarëve”*, Vaso Çubrilloviqi theksonte: *“Veçanërisht të rrezikshme janë ato blloqe të pakicave etnike, atëherë kur ato kufizohen me vendet amë të popujve fqinjë”*⁷⁴.

Regjimi i Beogradit shpërnguli me dhunë kryesisht popullsinë në kufi me Shqipërinë: Gjakovën, Pejën, Deçanin dhe Prizrenin. U shpërngulën në mënyrë kolektive, duke ua grabitur të gjitha pasuritë. U shpërngulën fillimisht fshatrat, pastaj qytetet, sepse fshatrat sipas doktrinës së Çubrilloviqit, janë më kompakte dhe paraqesin rrezik⁷⁵.

Duke mbrojtur projektin e 7 marsit 1937, duke analizuar ngjarjet politike dhe zhvillimet historike në Europë e në Jugosllavi, Çubrilloviqi, projektin e dytë, më 3 nëntor 1944, e pasuroi me ide dhe rekomandime të reja. Sipas këtij dokumenti: *“Çështja e pakicave me anë të shpërnguljes zgjidhet më lehtë në kohën e luftërave, siç është tani... Çështja për*

⁷³ Çubrilloviqi, Vaso; (2015). *Shpërngulja e shqiptarëve*. Tiranë: Klubi i Poezisë, f. 52.

⁷⁴ Çubrilloviqi, Vaso; (1981). *Shpërngulja e shqiptarëve*. Prishtinë: Liria, f. 24.

⁷⁵ Po aty, f. 26.

*zgjdhjen e secilës në kohë paqeje mund të duhen dhjetëra vjet ose shekuj, në kohë të luftës mund të zgjidhet për ndonjë muaj a vit*⁷⁶.

Edhe në planet e regjimit Tito-Ranković ishte spastrimi etnik i Kosovës nga shqiptarët në periudhën nëntor 1944 - maj 1945, por dështoi, sepse në frontin e luftës kundër fashizmit ishin mbi 53 mijë luftëtarë kosovarë. Mosrealizimi i këtij projekti u kompensua me gjenocidin ndaj shqiptarëve, duke vrarë e burgosur me mijëra, jo se “ishin reaksionarë e bashkëpunëtorë me fashizmin”, siç propagandonte regjimi i Beogradit, por vetëm e vetëm se ishin shqiptarë. Si në kohën e regjimit Tito-Ranković, ashtu edhe nga Millosheviqi u përdorën çetnikët (më 20 nëntor 1944 Titoja i amnistoi ata), paramilitarët, bandat e Sheshelit e të Arkanit. Në hapësirat serbe dëgjoheshin thirrjet e Arkanit: *“Luftojmë për fenë tonë, për kishën tonë ortodokse, për shtetin e madh dhe unik serb! Besojmë në Zotin serb*⁷⁷. Si në kohën e regjimit Tito-Ranković, i cili e gjeti momentin e masakrave në muajt e fundit të Luftës së Dytë Botërore, ashtu edhe Millosheviqi gjeti momentin, kur NATO-ja nisi sulmin kundër ushtrisë serbe.

Masakra e Tivarit, nga më të përgjakshmet, u realizua një muaj para se të kapitullonte Gjermania hitleriane. Dhimbja për njerëzit që u vranë në Tivar e ka frymëzuar poetin kosovar të shkruajë: *“Deti ndërroi fytyrën / Pulëbardha të kuqe / Plisa të kuq / Deti ndërroi ngjyrën. / Në kryq të tri kontinenteve / Homeri u fsheh pas shtatë bjeshkësh / Nga frika / Mos po i rikthehen sytë*⁷⁸.

Ushtria si në kohën e regjimit Tito-Ranković, ashtu edhe në kohën e regjimit të Millosheviqit ishte në krye të detyrës për spastrimin etnik. Komandanti i Divizionit XVIII serb më 1944 pohon me gojën e tij: *“Kam*

⁷⁶ Çubrilloviçi, Vaso; (2015). *Shpërngulja e shqiptarëve*, Tiranë: Klubi i Poezisë, f. 91.

⁷⁷ Marashi, Ardian & Kulla, Ndrëçim; (2009). *Mendimi shqiptar dhe shkolla shqipe*, doracak, Konferencë Shkencore Mbarëkombëtare. Tiranë: *Plejad*, f. 46.

⁷⁸ Rukiqi, Adem; (1995). *Frymëmarrje e lashtë*, Tiranë: *Lilo*, f. 22.

*urdhër të vrasim 50% të shqiptarëve*⁷⁹. Urdhri i Millosheviqit ishte t'i vrisnin pa mëshirë shqiptarët, të cilët, sipas tij, “*janë vrasës dhe dhunues*”.

Të gjitha këto shkojnë në zbatim të porosive të Çubrilloviqit: “... *ushtria, qysh në kohën e operacioneve luftarake, duhet t'i spastrojë me plan dhe në mënyrë të pamëshirshme nga pakicat kombëtare ato vise, që dëshirojmë t'i kolonizojmë me elementin tonë kombëtar. Ushtria është ajo që duhet të përdorë fuqinë e armës me rastin e dëbimit të pakicave nga shteti ynë*”⁸⁰.

Këshilla e Çubrilloviqit ishte: “*Që tokat e braktisura nga pakicat të punohen sa më parë, ato duhet të kolonizohen me njerëzit tanë*”⁸¹. Vendosja e kolonëve serbë nga krahinat e banuara me serbë jashtë Serbisë në Kosovë, dëshmon besnikërinë e Millosheviqit ndaj mësuesit të tij shpirtëror, Çubrilloviqit, për të zbatuar të gjitha detyrat e lëna prej tij.

Fjalimet dhe mitingjet e Millosheviqit me serbët kishin si synim *vendosjen e urave të komunikimit midis dy palëve, për të shpalosur edhe vizionin e tij për të ardhmen: populli ka folur, populli është qytetari më i mirë, populli nuk mund të vuajë më, populli e di të vërtetën, populli e ka kuptuar*⁸². Prandaj duhet ta dëgjojmë, të realizojmë aspiratat e tij kombëtare, t'i prijme në luftëra të reja, në beteja të reja! Për një Serbi të Madhe e Homogjene!

Si gjithnjë, në zbatim të ideve të mësuesit të tij, Çubrilloviqit, Millosheviqi shprehet: “*Ai pezmatim shumë i madh, që është mbledhur në shpirtin e popujve tanë gjatë kësaj lufte kundër pakicave kombëtare, për shkak të krimeve që kanë bërë kundër nesh, manifestohet në të gjitha krahinat tona kundër këtyre pakicave. Kjo urrejtje dhe dëshirë e pashuar e*

⁷⁹ Gazeta e studentëve “*Bota e re*”, 15 shtator 1990, f. 12. Prishtinë.

⁸⁰ Çubrilloviqi, Vaso; (2015). *Shpërngulja e shqiptarëve*. Tiranë: *Klubi i Poezisë*, f. 99, 106.

⁸¹ Po aty, f. 102.

⁸² Gazeta *Tema*, 21 qershor 2012, f. 9. Tiranë.

masave tona, që t'i spastrojmë hesapet me pakicat, duhet shfrytëzuar në mënyrë konstruktive”⁸³.

Përfundime

Nisur nga përmbajtja e këtyre përkufizimeve dhe realiteti politik e historik në Kosovë në shekujt XIX dhe XX, arrijmë në përfundimin, se *pushteti serb ka ushtruar gjenocid ndajshqiptarëve sistematikisht, me platforma politike, me qëllim shkatërrimin e popullsisë shqiptare në Kosovë!*

Politikanë e historianë serbë si pikë referimi për “*Serbinë e Madhe*” kanë Perandorinë Serbe të shekujve XII-XIV, si dhe historinë e saj të pasur e të lavdishme.

Roli sublim i mitit lidhet drejtpërdrejt me idenë e kombit dhe krijimin e nacionalitetit serb. Beteja e Kosovës identifikohet si ngjarja më e rëndësishme dhe më fatale e të gjithë historisë serbe. Miti rreth kësaj beteje u bë instrumenti kryesor për nxitjen e vetëdijes kombëtare dhe u ngrit në lartësinë e kodit më të lartë moral të kombit. Ky mit është bërthama e historisë dhe e idesë së Serbisë së Vjetër, ku bën pjesë Kosova. *Për serbët, Kosova është vendi ynë. Nëse Kosova dhe Metohia nuk janë serbe, atëherë nuk kemi ndonjë truall që të jetë prona jonë*⁸⁴. Sipas Milovan Gjilasit: *“Fshije Kosovën nga kujtesa dhe shpirti serb dhe ne nuk jemi më. Nëse s’do kishte pasur betejë në Kosovë, serbët do ta kishin shpikur atë për vuajtjet dhe heroizmin e saj*”⁸⁵.

Teza se “*territoret e Kosovës ishin djepi i tyre*” është e pabazuar, sepse “*nuk ka vazhdimësi mes shtetit serb mesjetar dhe Serbisë së sotme,*

⁸³ Çubrilloviqi, Vaso; (2015). *Shpërngulja e shqiptarëve*. Tiranë: Klubi i Poezisë, f. 109-110.

⁸⁴ Peticion i serbëve nga Kosova; (1995). “Silber & Little. *The Death of Yugoslavia*”. Londër, f. 33.

⁸⁵ Vickers, Miranda; (2004). *Midis serbëve dhe shqiptarëve*. Tiranë: Toena, f. 261.

*ashtu siç nuk ka midis Perandorisë Bizantine dhe Greqisë*⁸⁶. Gjithashtu, edhe kërkimet historike tregojnë se Kosova ka një identitet gjeografik të qëndrueshëm.

Nacionalizmi kërkon të bësh fort diçka që duket sheshit se nuk është. Kështu ka ndodhur me nacionalizmin serb lidhur me Betejën e Fushë-Kosovës në vitin 1389, me tezën antihistorike, se Kosova është Serbia e Vjetër. Për disa grupe ndoshta do të ishte mençuri politike që të kërkohej një armik, në mënyrë që uniteti i grupit të jetë i efektshëm dhe që grupi të jetë i ndërgjegjshëm që ky unitet ka rëndësi jetike për të⁸⁷. Për serbët, armiku kryesor janë shqiptarët, që u kanë zaptuar tokat, sipas tyre, dhe që pengojnë arritjen e objektivave të tyre gjeopolitike. Për t'i sensibilizuar serbët në këtë drejtim, për t'i mbajtur të bashkuar në luftën për dëbimin e shqiptarëve janë shpikur lloj-lloj epitetesh fyese e poshtëruese për shqiptarët.

Për Vllado Gjorgjeviqin *“shqiptarët janë njerëz me bisht”*, për Dobrica Qosiçin *“shqiptarët janë fundërrina sociale, politike dhe morale të Ballkanit barbar”*.

Sipas një anketimi të bërë vite më parë nga psikologu serb Dragan Popadiç, serbët te shqiptarët *“nuk shohin asnjë veti pozitive, prandaj duhen përzënë sa më parë”*. Një peshkop serb shprehej: *“Më në fund ne kemi një udhëheqës, i cili përmbush nevojat e kombit serb”*⁸⁸. Është fjala për kasapin e Ballkanit, Slobodan Millosheviqin, i cili i pyetur për spastrimet etnike, përgjigjet: *“Spastrimin etnik nuk e kanë shpikur serbët, madje as kroatët e myslimanët. Këtë praktikë në këto hapësira e kanë shpikur shqiptarët, të cilët kanë dëbuar nga Kosova disa dhjetëra e mijëra serbë.*

⁸⁶ Malcolm, Noel; (1998). *Kosovo: A Short History*. New York: New York University Press, f. 37.

⁸⁷ Hobsbawm, J. Eric; (1996). *Kombet dhe nacionalizmi që nga viti 1780 - a*. Tiranë: Toena, f. 12.

⁸⁸ Gazeta *“The Independent”*, 9 janar 1989, f. 5. Londër.

*Ata kanë rrënuar varrezat serbe dhe kanë marrë shtëpitë dhe pronat serbe. Kosova është dhe patjetër duhet e do të mbetet serbe*⁸⁹.

Doktrina filozofike, politike dhe sociale, e cila i konsideronte shqiptarët “*bagëti që njohin vetëm forcën, prandaj me ta duhet të flitet me forcë*”, ishte frymëzuesja e terrorit mbi shqiptarët në vitet 1913-1941 pas Luftës së Dytë Botërore nga regjimi i Titos dhe Rankoviçit, pastaj nga Millosheviqi.

Elitat politike sunduese serbe kanë qenë të bashkuara dhe në unison për sa i përket qëndrimit ndaj shqiptarëve të Kosovës. Asnjëherë prej tyre nuk ka pasur reflektim, ndjesë. Madje as sot, çka të bën të supozosh se ato përsëri përgatisin platforma për të marrë Kosovën e për t'i dëbuar nga trojet e tyre të gjithë shqiptarët.

Studiuesit e gjeopolitikës kanë arritur në përfundimin, se ai që do të kontrollonte Kosovën, do të kontrollonte qasjen strategjike në Bosnjë e në Shqipërinë e Veriut. Mungesa e kontrollit është një kërcënim real për të prerë lidhjen midis Serbisë, Maqedonisë e Rajonit të Egjeut. Është kjo arsyeja, që serbët duan një Kosovë të pastër etnikisht, pa shqiptarë, vetëm me serbë. Territori si një faktor konstant ndikon në rrjedhjen e ngjarjeve njerëzore dhe historike. Fuqia dhe hapësira janë të rëndësishme për vetë ekzistencën e një shteti.

Ngjarjet e pranverës së vitit 1999 në Kosovë ngjajnë me një film tragjik, me skenar të shkruar nga Çubrilloviqi dhe Dobrica Qosiq, me regjisor Millosheviqin, me aktorë gjeneralë e ushtarakë serbë e pjesëmarrës policie, ushtarë serbë e forcat më ekstreme shoviniste serbe, me qëllimin dhe objektivin e përbashkët: *pastrimin etnik të shqiptarëve të Kosovës, krijimin e Serbisë së Madhe e të Serbisë Homogjene, vetëm e vetëm me serbë*.

⁸⁹ Revista amerikane, *Verity fear*, maj 1994, f. 159-160.

Duke folur për raportin shqiptaro-serb, duke analizuar këto marrëdhënie, akademiku Gazmend Zajmi parashtron idenë e rëndësishme: *“Në këtë figuracion të Ballkanit, çështja e Kosovës dhe raporti shqiptaro-serb i përgjithshëm në Ballkan, ku me tërë logjikën dhe realitetin e çështjes paraqiten si një nga nyjat, sfidat dhe gurët e sprovës kryesore të drejtësisë dhe principalitetit interetnik si në mikroplan, ashtu dhe në makroplan të Ballkanit”*⁹⁰.

* Autori është Pedagog në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë

⁹⁰ Zajmi, Gazmend; (1997). *Vepra 1*. Prishtinë: ASHAK, f. 182.

1.5 Dr. Flora FERATI-SACHSENMAIER

Politikat pasivizuese të Serbisë ndaj pakicës shqiptare: Si po shndërrohet jugu i Serbisë në një zonë etnikisht serbe

Abstrakt

Në këtë punim shkencor do të hulumtojmë zbatimin e *Ligjit për Vendbanim dhe Vendqëndrim* nga ana e Serbisë, ligj ky i cili siguron bazën juridike për rregullimin e statusit të qëndrimit për qytetarët e Serbisë. Duke u bazuar në një punë të gjerë në terren në jug të Serbisë, do të tregojmë se autoritetet serbe kanë abuzuar me *Ligjin për Vendbanim dhe Vendqëndrim*, duke synuar zonat me popullsi shqiptare, me qëllim të një pezullimi selektiv dhe masiv të adresave të përhershme. Kjo masë administrative, e njohur edhe si politika e “pasivizimit të adresave”, ka krijuar pasoja të rënda për të drejtat themelore qytetare dhe politike të mijëra pjesëtarëve të pakicës shqiptare në Serbi. Bazuar në të dhënat e shumta parësore që kam mbledhur në tri komuna, konstatoj se si pasivizimi ka ulur numrin e votuesve shqiptarë ndër vite, duke dëmtuar në masë të madhe përfaqësimin e tyre politik në nivelet lokale dhe duke rrezikuar në thelb, qasjen e tyre në shërbimet sociale, ekonomike dhe shëndetësore në vend. Për më tepër, argumentoj se, përderisa pasivizimi i adresave të përhershme ka ndodhur në pjesë të tjera në Serbi, modeli i pasivizimit që çon në papërshtatshmëri shtetërore (heqje të shtetësisë) mund të gjendet vetëm në mesin e pakicës shqiptare në Serbinë Jugore.

Fjalët çelës: *pakica shqiptare, Serbi, Lugina e Preshevës, pasivizimi i adresave, papërshtatshmëria shtetërore, tjetërsim etnik, diskriminim i pakicave.*

Hyrje

Pjesa më jugore e Serbisë është një rajon i populluar kryesisht nga shqiptarët, që përfshin tri komuna të shtrira përgjatë kufirit me Kosovën. Në këto tri komuna bashkë, në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc, shqiptarët përbëjnë rreth 70 për qind të popullsisë. [1]

Shqiptarët kanë një prani të gjatë historike në këtë rajon. Megjithatë, në periudha të ndryshme gjatë shekullit XX, shqiptarët që jetojnë në Serbinë e sotme Jugore kanë qenë subjekt i diskriminimit shtetëror, persekutimit, si dhe i fushatave të shpërnguljes së popullsisë me forcë. [2] Konflikti më i ri, që solli zhvendosjen e madhe të popullsisë shqiptare në jug të Serbisë, ndodhi ndërmjet viteve 1999 dhe 2001. Edhe pse ka një histori të gjatë të diskriminimit të pakicës shqiptare në Serbi, situata politike u përkeqësua veçanërisht gjatë viteve '90-të duke u vulosur nga represioni politik shtetëror dhe duke u ngjasuar masave politike dhe formave të represionit, sikur ato të drejtuara kundër shqiptarëve të Kosovës. Si rezultat, vlerësohet se në kulmin e Luftës së Kosovës në vitin 1999, *“përafërsisht një e treta e popullsisë etnike shqiptare u largua nga tri komuna, për shkak të frikës së një konflikti në përshkallëzim, si dhe në disa raste si përgjigje ndaj trajtimit nga forcat shtetërore”*. [3] Pas ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë dhe tërheqjes së forcave serbe dhe jugosllave nga Kosova në qershor të vitit 1999, situata e sigurisë arriti një pikë tjetër të ndjeshme për shqiptarët që jetonin në Serbinë Jugore: një numër i konsiderueshëm i forcave ushtarake dhe paramilitare serbe/jugosllave, të cilat u detyruan të largoheshin nga Kosova, u zhvendosën në tri komunat me popullsi me shumicë shqiptare në Serbinë Jugore.

Vazhdimi i tensioneve politike, shkelja e të drejtave të njeriut dhe militarizimi i hapur i rajonit kulmoi me një konflikt të armatosur të kryengritjes shqiptare, pra midis Ushtrisë Çlirimtare të Preshevës,

Medvegjës dhe Bujanocit (UÇPMB) dhe forcave shtetërore jugosllave dhe serbe. Gjatë një periudhe 17-mujore luftimesh, që zgjati nga viti 2000 deri në vitin 2001, të paktën njëqind njerëz u vranë, një numër i konsiderueshëm i shtëpive të shqiptarëve u shkatërruan dhe u plaçkitën, si dhe rreth 12 500 shqiptarë nga të tri komunat e përmendura ikën, si rezultat i pasigurisë dhe i dhunës. Sipas një raporti të misionit faktmbledhës nga Misioni Ndërmjetësues i Drejtuar nga OKB-ja në jug të Serbisë në vitin 2001, edhe pse disa nga refugjatët u kthyen nëpër shtëpitë e tyre, llogaritet se rreth 15 000 shqiptarë të zhvendosur nga Serbia Jugore mbetën në Kosovë; prej tyre 5000-6000 janë me origjinë nga komuna e Medvegjës. [4] Që nga përfundimi i konfliktit të armatosur me ndihmën ndërmjetësuese të NATO-s, i cili përfundoi zyrtarisht me Marrëveshjen e Konçulit në vitin 2001, çështja e pakicës shqiptare në Serbi ka qenë e lënë plotësisht jashtë vëmendjes së komunitetit ndërkombëtar dhe politikave ballkanike.[5]

Dy dekada më vonë, premtimet e qeverisë serbe për integrimin e shqiptarëve, të cilat ishin të përshkruara në të ashtuquajturin “Plani Çoviq”, nuk janë realizuar. [6] Trupi koordinues [7], një mekanizëm kryesor shtetëror i krijuar për të zbatuar “Planin Çoviq” në zonat me popullsi shqiptare, nuk ka arritur as të adresojë disa nga ankesat më të theksuara e që prekin pakicën shqiptare [8], dhe as të sigurojë ndihmë në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror në jug, që etnikisht është e përfshirë. [9] Shqiptarët janë ende të papërfaqësuar dhe të nënvlerësuar në institucionet kryesore publike, përfshirë gjyqësorin, dhe shpesh bëhen objekt i fjalëve të urrejtjes në medie dhe përballen me mundësi të kufizuara të arsimit në Serbi. [10]

Për më tepër, për shkak të papunësisë së lartë në rajon, migrimi i të rinjve shqiptarë dhe fuqisë punëtore shumë të kualifikuar po rezulton me ikje të intelektualëve (ikjen e trurit). Megjithatë, problemet me të cilat përballet pakica shqiptare në jug të Serbisë ka prekur edhe një pikë tjetër të ulët. Në

vitet e fundit, autoritetet serbe kanë intensifikuar fushatën e pezullimit masiv të adresave të përhershme të shqiptarëve në jug të Serbisë, duke shpopulluar në mënyrë efektive një numër të madh shqiptarësh nga komuna e Medvegjës, përmes një praktike të njohur edhe si *pasivizimi i adresave të përhershme*.

Në të njëjtën kohë, numri i shqiptarëve të pasivizuar ka arritur në nivele alarmante në komunën tjetër, po ashtu e banuar kryesisht nga popullsi shqiptare, në atë të Bujanocit dhe, në një masë më të vogël, në Preshevë. Sipas autoriteteve serbe, *pasivizimi i vendbanimit* zbatohet nëse zyrtarët përgjegjës nuk mund të përcaktojnë se vendbanimi i përhershëm i një qytetari paraqet “qendrën e aktiviteteve jetësore të tij/saj dhe lidhjet profesionale dhe ekonomike”. [11] Nga pikëpamja juridike, çështja se çfarë përbën një vendbanim të përhershëm është përcaktuar lirshëm dhe është lënë në diskrecionin e autoriteteve shtetërore. Një paqartësi e ngjashme mund të vërehet në formulimin ligjor të asaj që përbën “një fakt”, kur përcaktohet vlefshmëria e një adrese të përhershme.

Sipas kësaj, kjo u lë hapësirë autoriteteve shtetërore që të manipulojnë me kriteret dhe faktet dhe t'i ngushtojnë mundësitë që qytetarët e pasivizuar të apelojnë me sukses rastet e tyre para gjykatave në Serbi. Nga pikëpamja politike, një nga pasojat e menjëhershme të pasivizimit të statusit të banorit në Serbi është se ndikon në të drejtat e individëve për të votuar në zgjedhjet lokale. Në Republikën e Serbisë, neni 6 i *Ligjit për Zgjedhjet Lokale* parashikon se mundësia për të votuar në zgjedhjet lokale është e kushtëzuar nga fakti, që qytetari ka një banim të përhershëm dhe të vlefshëm në një vend të caktuar. [12] Nëse ligji zbatohet në mënyrë të barabartë dhe të drejtë për të gjithë qytetarët e shtetit, ky mund të jetë një vendim i përkohshëm: qytetarët mund të pasivizohen dhe të aktivizohen. Në një pasivizim të mirëfilltë të vendbanimit të përhershëm, qytetari zakonisht është plotësisht i vetëdijshëm për të drejtat e tij/saj individuale, pasojat dhe

procedurat ligjore që rrjedhin nga shpërngulja e tij/e saj në një pjesë tjetër të vendit ose nga qëndrimi jashtë vendit dhe pasivizimi i tij/i saj. Ajo që ka ndodhur në Serbinë Jugore që nga viti 2011, vit kur hyri në fuqi *Ligji për Vendbanim dhe Vendqëndrim*, është e kundërta e një procesi të rregullt pasivizimi. Menjëherë pas miratimit të ligjit, qytetarët nga pakica shqiptare filluan të ankoheshin se po pasivizoheshin pa kritere objektive dhe nuk mund të rinovonin letërnjoftimet dhe pasaportat. Gjithashtu, qytetarët u ankuan se statusin e tyre të pasivizuar e mësuan në mënyrë të papritur, kur p.sh., mbaheshin zgjedhjet lokale, kur ishin shtruar në spital ose kur shkonin për të regjistruar një makinë. Përgjigjja më e shpeshtë që ata morën nga institucionet përkatëse në Serbi ishte: “Nuk jeni më në sistem” dhe “Kontrolloni statusin tuaj në Ministrinë e Punëve të Brendshme.” [13] Në atë moment, megjithëse pasivizimi po ndodhte në nivel vendi, kishte indikacione se ai po prekte pakicën shqiptare në një mënyrë specifike dhe të njëjtat politika nuk po zbatoheshin në të njëjtën mënyrë për pjesët e tjera të popullsisë në Serbisë.

Ky artikull synon të nxjerrë në pah përvojat e shqiptarëve të pasivizuar nga kjo periudhë. Përveçse është një rast studimi në vetvete, ky artikull synon gjithashtu të japë një kontribut në korpusin e shkencës që merret me të drejtat e pakicave në periudhën pas sundimit të Millosheviqit në Serbi. [14]

Për sa i përket pakicës shqiptare në Serbi, ajo do të thotë se në epokën pas Millosheviqit, qeveria serbe jo vetëm që ka dështuar të demonstrojë interesa të sinqertë për të integruar pakicën e saj shqiptare në jug, përkundrazi ajo ka minuar sistematikisht përfaqësimin e tyre politik, ka shkelur të drejtat e tyre individuale dhe kolektive dhe e ka mbajtur rajonin të pazhvilluar ekonomikisht. Artikulli do të argumentojë se, edhe pse pasivizimi si një politikë i ka fillimet e tij në vitin 2012, ai intensifikohet gjatë periudhës kur fillojnë të qarkullojnë vizionet të reja politike për

ridefinimin e kufijve kombëtarë në Ballkanin Perëndimor. Për të qenë më të saktë, në gusht 2018, Presidenti i Kosovës ka shfaqur idenë e “korrigjimit të kufijve”, ku zonat e banuara nga shqiptarët në Lugina e Preshevës [15] do të bashkoheshin me Kosovën dhe sugjeroi se katër komuna serbe në veri të Kosovës mund të bashkoheshin me Serbinë. [16] Homologu i tij serb, Presidenti i Serbisë, po aq i paqartë në mesazhet e tij politike, siguroi se tri komuna me popullsi me shumicë shqiptare në jug, do të mbeten në Serbi, por pyeti se cili do të ishte çmimi i një shkëmbimi të tillë territorial. Ndërsa forcat politike vendase dhe disa qendra të pushtetit ndërkombëtar vazhduan debatin rreth mundësisë së realizimit të propozimit për “shkëmbim terrioresh” si një udhërrëfyes i mundshëm për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, autoritetet serbe e intensifikuan fushatën e tyre të pezullimit masiv të adresave të përhershme të shqiptarëve në Serbinë Jugore.

Megjithatë, ndërsa debatet politike u konsumuan me çështjen e “shkëmbimit të terrioreve”, vështirë se dikush po fliste se si pasivizimi i adresave të përhershme e kishte bërë të pamundur jetën për shumë shqiptarë në Serbinë Jugore.

Zbatimi dhe metodologjia

Duke u bazuar në punën e bërë në terren, ky artikull hedh dritë mbi efektet e politikave të pasivizimit ndaj pakicës shqiptare në jug të Serbisë. Ai ofron analizën e parë të përgjithshme të pasivizimit të adresave të banimit në jug të Serbisë, dhe e bën këtë duke u bazuar gjerësisht në rezultatet e një sondazhi me 1 000 shqiptarë të pasivizuar, intervistave personale me aktorë të ndryshëm, përgjigjet e zyrtarëve shtetërorë në Serbi dhe korin diplomatik ndërkombëtar. Në këtë punim janë shfrytëzuar edhe burime të tjera. Me qëllim të gjenerimit të të dhënave të besueshme për pasivizimin në tri

komunat e caktuara në Serbinë Jugore, ky studim paraqet statistikat e para zyrtare të bazuara në analizën e dokumenteve që kam mundur të marr nga politikanët e BE-së, përfaqësuesit politikë shqiptarë në Serbi, si dhe aktorë të tjerë politikë relevantë në rajon. Studimi i kontekstualizon këto raporte zyrtare duke analizuar atë që raportohet, si është raportuar ndër vite dhe kujt i është raportuar. Punimi paraqet numrin e përgjithshëm të rasteve të pasivizuara për qytete/komuna të ndryshme anembanë Serbisë dhe krahason numrin e qytetarëve të pasivizuar në komunat me popullsi kryesisht serbe me tri komunat me popullsi shumicë shqiptare në pjesën jugore të vendit. Analiza më pas kalon në një studim të thelluar të komunës së Medvegjës dhe shqyrton ndikimin e pasivizimit në të drejtën e votës në periudhën 2012-2019. Studimi vijon më tej duke paraqitur disa rrëfime personale të shqiptarëve me status të pasivizuar, të cilat përfaqësojnë jo vetëm raste individuale, por edhe kategori pasivizimi, dhe jep njohuri se si autoritetet kompetente e zbatuan ligjin në praktikë. Për të vlerësuar gjetjet kryesore nga anketa, të dhënat e mbledhura nga puna në terren, si dhe raportet zyrtare të autoriteteve shtetërore, studimi ofron një analizë të shkurtër të ligjeve përkatëse të Republikës së Serbisë dhe pyet nëse ekziston një bazë ligjore për t'u mohuar qytetarëve të Serbisë shërbime dhe të drejta, duke iu referuar statusit të tyre të rezidentit të pasivizuar.

Në fund kam theksuar gjetjet kryesore rreth praktikës së pasivizimit në Serbinë Jugore në një kontekst më të gjerë politik gjeopolitik. Punimi është i përshtatur nga disa çështje dhe pyetje të ndërlydhura.

Së pari, pyes se kur dhe në çfarë rrethanash janë pasivizuar këta qytetarë, si e kanë mësuar statusin e tyre dhe si ka ndikuar statusi i pasivizimit në jetën e tyre. Bazuar në të dhënat e mbledhura nga një anketë, ofroj statistika se sa qytetarëve u janë lëshuar vendime me shkrim për pasivizim nga organet kompetente në Republikën e Serbisë, si dhe hulumtoj

se cilat institucione ua kanë mohuar shërbimet publike për shkak të statusit të tyre të pasivizuar dhe cilat janë rezultatet ligjore në ato pak raste, kur shqiptarët me status të pasivizuar e kundërshtuan vendimin e autoriteteve zyrtare. Më pas ofroj statistika se sa prej 1000 shtetasve të Serbisë, të përkatësisë etnike shqiptare, që ishin subjekt në këtë studim, iu refuzuan letërnjoftimet dhe pasaportat dhe përfundimisht mbetën *de facto* pa shtetësi, për shkak të pasivizimit të vendbanimit të tyre.

Grupi i të anketuarve të pasivizuar e të rekrutuar për këtë studim përfshin 500 shqiptarë nga komuna e Medvegjës, 450 shqiptarë nga Bujanoci dhe 50 shqiptarë nga Presheva. Pjesëmarrësit ishin nga 33 fshatra dhe banesa të ndryshme të qyteteve të Serbisë Jugore, ishin të moshës midis 16 dhe 75 vjeç, dhe nga gjithsej 1 000 pjesëmarrës, 60 për qind ishin meshkuj dhe 40 për qind ishin femra. Një metodë kryesore për të rekrutuar pjesëmarrësit për studim ishte një anketë që përmbante gjithsej 14 pyetje. Për këtë qëllim, për të siguruar një shpërndarje të gjerë të sondazhit, kam shfrytëzuar platformat e medieve sociale, lidhjet personale, liderët e komunitetit shqiptar, aktivistët politikë dhe OJQ-të që punojnë me pakicën shqiptare në Serbi.

Në fazën fillestare të mbledhjes së të dhënave, arrita që, për këtë studim, të rekrutoj qytetarë të pasivizuar, dhe kjo në bashkëpunim me dy OJQ: AFEDS (Forumi Shqiptar për Zhvillim Ekonomik në Serbi), që operon nga komuna e Medvegjës dhe “Vatra”, e bazuar në Gjilan, Kosovë, një OJQ që përfaqëson refugjatët shqiptarë nga jugu i Serbisë në Kosovë, të cilët u detyruan të largoheshin nga jugu i Serbisë gjatë konfliktit të armatosur në vitin 2000-2001.

Në fazën e dytë, mblodha të anketuar me status të pasivizuar, përmes metodës së kampionimit të quajtur “topa bore” ose teknikës së referimit “zinxhiror”, derisa të arrihej përmbushja e të dhënave, ndërsa mbledhja/kodimi i mëtejshëm i të dhënave nuk ishte i nevojshëm. Pjesa e

parë e anketës parashtroi pyetje të përgjithshme për të anketuarit, si: emri, datëlindja dhe vendi i lindjes në Republikën e Serbisë. Pas kësaj u vazhdua me pyetje, si: emri i komunës ku ishin pasivizuar, data, muaji dhe viti (nëse dihej) kur ishin pasivizuar, ose si kishin mësuar për statusin e tyre të pasivizuar. Për të kuptuar më mirë se si pasivizimi i adresës së përhershme ka ndikuar te pjesëtarët e pakicës shqiptare, anketa ka bërë pyetjen e mëposhtme:

- Çfarë shërbimesh iu refuzuan për shkak të pasivizimit të adresës së përhershme në Republikën e Serbisë?

Anketa i dha çdo të anketuari më shumë se një mundësi për të zgjedhur si përgjigje, duke përfshirë: *a) të drejtën për të marrë dokumente personale dhe dokumente udhëtimi, b) të drejtën për të votuar, c) të drejtën për të blerë ose shitur pasuri të paluajtshme, ç) të drejtën e marrjes së pensionit/kryerjen e veprimtarive bankare, d) udhëtimin jashtë Serbisë, dhe dh) tjetër.*

Gjithashtu, pjesëmarrësit u pyetën se si kishte ndikuar pasivizimi në jetën e tyre të përditshme dhe të familjes së tyre në përgjithësi, si dhe u pyetën nëse kishin depozituar ankesa kundër vendimit të autoriteteve në institucionet relevante në Serbi. Së fundi, u kërkua të tregonin se cilat institucione kishin më shumë gjasa të adresonin ankesat e tyre në lidhje me pasivizimin e adresave të tyre të përhershme: *a) forcat politike kombëtare shqiptare, b) përfaqësuesit politikë vendas shqiptarë, c) organizatat joqeveritare, ose d) institucionet e tjera.* Pyetja e fundit në anketë i pyeste pjesëmarrësit se ku jetonin aktualisht. Emrat e qytetarëve me status të pasivizuar janë anonimizuar sistematikisht dhe janë ndryshuar edhe vendqëndrimet e qyteteve të tyre, për të shmangur mundësinë e gjurmimit të tyre nga autoritetet shtetërore. [17]

Përveç mbledhjes së të dhënave përmes një ankete, për këtë studim kam kryer 100 intervista personale gjysmë të strukturuar, gjatë periudhës

nga nëntori 2019 deri në korrik 2021. E bëra këtë në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht, me pjesëmarrës të ndryshëm, duke filluar që nga qytetarët me status të pasivizuar, përfaqësues të OJQ-ve në Serbi, gazetarë, aktivistë politikë, policë dhe akademikë. Në disa raste kam kryer më shumë se një intervistë me të njëjtin të anketuar me status të pasivizuar dhe intervistat janë kryer kryesisht me telefon ose me email. Intervistat janë transkriptuar dhe kodifikuar në përputhje me pyetjet kryesore të kërkimit dhe dizajnin e përgjithshëm të kërkimit për studimin. Të dhënat e mbledhura përmes intervistave vërtetojnë të dhënat statistikore në këtë studim, pasi ofrohen informacione se si ligji që rregullon statusin e rezidencës në Serbi, pra politika e pasivizimit, është zbatuar në praktikë. Ai mundëson një studim të thellë se si ligji ka ndikuar në kategori të ndryshme të qytetarëve në Serbinë Jugore, si: qytetarët me gjendje të rëndë shëndetësore, studentët që studiojnë në Kosovë, individët me kontrata të përkohshme pune në Europën Perëndimore, profesionistët shqiptarë me arsim të lartë që punojnë jashtë vendit, si dhe shqiptarët e zhvendosur nga Serbia Jugore me banim në Kosovë. Në fund, kam aplikuar një analizë të përmbajtjes për interpretimin e materialeve të mbledhura.

Numrat e pasivizimit: dëshmi nga burime të ndryshme

Në anketën time, më shumë se 80 për qind e pjesëmarrësve (813 persona) raportuan se pasivizimi ka shkaktuar pasoja të rënda në të drejtat e tyre themelore qytetare dhe politike në Serbi. Për shumicën dërrmuese të të anketuarve (950 individë), pasivizimi i vendbanimit zakonisht çoi në: a) pezullimin e adresës së tyre të përhershme, b) heqjen nga listat e zgjedhësve pa u njoftuar për këtë, c) pamundësinë për të ushtruar të drejtën e votës në zgjedhjet lokale dhe parlamentare, ç) humbjen e së drejtës për kujdes social

dhe shëndetësor, dhe d) pamundësinë për të rinovuar letërnjoftimet dhe dokumentet e udhëtimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Serbisë. Të dhënat e mbledhura nga anketa me 1000 shqiptarë nga tri komunat në Serbinë Jugore tregojnë se pasivizimi ka pasur një ndikim të dëmshëm veçanërisht për dy të drejtat themelore të shtetasve, të garantuara me Kushtetutë: *të drejtën për të votuar dhe zgjedhur në zgjedhjet lokale, dhe të drejtën për t'u lëshuar një kartë identiteti (letërnjoftim) dhe pasaportë.*

Në anketën time, mbi 90 për qind e të anketuarve (902 individë) treguan se kishin humbur të drejtën e tyre për të votuar në zgjedhjet lokale në vendlindjet e tyre, për shkak të pasivizimit të adresave të tyre të banimit. Rreth 50 për qind e të anketuarve (510 individë) deklaruan se aktualisht nuk zotëronin letërnjoftim të vlefshëm dhe as pasaportë, sepse Ministria e Brendshme e Serbisë kishte refuzuar t'ua rinovojë letërnjoftimet dhe dokumentet e udhëtimit e skaduara, duke pretenduar se ata “nuk jetojnë më në Serbi”. Rreth 25 për qind (240 të të anketuarve) ende kishin një letërnjoftim/kartë identiteti të vlefshme nga Republika e Serbisë, por ishin ende me status të pasivizuar, prandaj nuk patën mundësi të votonin në zgjedhjet lokale të fundit që u zhvilluan në qytetet e tyre. Pjesa tjetër prej 25 për qindësh (250 të të anketuarve) që e plotësuan pyetësorin, deklaruan se ende kishin letërnjoftime të vlefshme dhe pasaportë. Megjithatë, ende ishin me status të pasivizuar dhe të pasigurt nëse ishin ende të regjistruar në Regjistrin e Votuesve. Nëse politika e pasivizimit vazhdon të zbatohet kështu siç ka ndodhur deri më tani, të gjithë këta qytetarë të Serbisë, por me etni shqiptare, nuk do të kenë më dokumente të vlefshme udhëtimi nga Republika e Serbisë deri në vitin 2030. Një nga qëllimet kryesore të anketës ishte jo vetëm të pyeste për shkallën e pasivizimit në jug të Serbisë, por gjithashtu të analizonte se si u zbatua kjo politikë në praktikë nga autoritetet shtetërore. Në këtë kontekst, të anketuarve iu parashtruan pyetje si: *si kanë mësuar për*

statusin e tyre të pasivizuar, si ua kanë komunikuar autoritetet vendimin e pasivizimit këtyre qytetarëve, dhe nëse kanë ndërmarrë hapa ligjorë për riaktivizimin e adresës së tyre të banimit.

Të dhënat e mbledhura nga anketa tregojnë se autoritetet kompetente kryesisht e kanë dhënë informacionin mbi pasivizimin qytetarëve të prekur përmes njoftimit gojor. Për të qenë më të saktë, nga gjithsej 500 shqiptarë të Medvegjës e me status të pasivizuar, vetëm 20 kanë marrë vendime zyrtare me shkrim, ku informoheshin se janë me status të pasivizuar. Departamenti kompetent i Ministrisë së Brendshme serbe e ka komunikuar informacionin gojarisht për 480 qytetarë të tjerë e me status të pasivizuar.

Dega e sapothemeluar e Këshillit Kombëtar Shqiptar (KKSH) në Medvegjë, e cila filloi të funksionojë në dhjetor 2020 dhe e bëri regjistrimin e anëtarëve me status të pasivizuar të pakicës shqiptare si aktivitet të saj kryesor, vërejtji modele të ngjashme në shpërndarjen e informacionit te shqiptarët me status të pasivizuar nga kjo komunë. Sipas përfaqësuesve të saj, në shtatë muajt e parë, një numër i madh personash me status të pasivizuar erdhën për t'u regjistruar në zyrë: *“Gjithsej 1470 shqiptarë, por vetëm 173 prej tyre kishin marrë vendim përfundimtar me shkrim për pasivizim nga Ministria e Punëve të Brendshme të Serbisë. Autoritetet thjesht refuzuan të jepnin vendim me shkrim, pa dhënë ndonjë arsye të veçantë. Në disa raste, individëve të pasivizuar u kishin bërë pyetje si: Për çfarë ju nevojitet dokumenti? Kush ju këshilloi të vini këtu etj.”* [18]

Në komunën e afërt, Bujanoc, shqiptarët pjesëmarrës në anketë raportuan për probleme të ngjashme. Nga 450 pjesëmarrës, vetëm 115 raportuan se kishin marrë një vendim zyrtar me shkrim. Por, çuditërisht, shqiptarët e Preshevës nuk kanë hasur në të njëjtën pengesë, sepse të paktën 30 nga 50 pjesëmarrës kanë raportuar se i kanë marrë vendimet e tyre të pasivizimit me shkrim, pa pengesa të mëdha administrative, në stacionin

policor lokal. Sa i përket Preshevës, studimi nuk mund të konkludojë nëse kjo është për shkak të numrit relativisht të vogël të të anketuarve nga kjo komunë që kanë marrë pjesë në studim, apo për shkak se ka më shumë shqiptarë që punojnë në administratën lokale të Ministrisë së Punëve të Brendshme në Preshevë. Megjithatë, ajo që bie në sy është se nga 165 vendime zyrtare (në serbisht: *rešenje*) që u janë dhënë shqiptarëve të pasivizuar nga të tri komunat, autoritetet nuk kanë përmendur asnjëherë se këtyre qytetarëve u është refuzuar letërnjoftimi dhe pasaporta për shkak të pasivizimit të adresave të tyre të përhershme të banimit. Format zyrtare të komunikimit për pasivizim mund të vlerësohen edhe nga këndvështrime të tjera. Përderisa të dhënat nga anketa ofrojnë perspektivë mbi mënyrën se si autoritetet lokale kanë ndërvepruar me shqiptarët e pasivizuar në jug të Serbisë, ato nuk përgjigjen në pyetjen se si nivelet institucionale të ndryshme në Republikën e Serbisë raportuan për pasivizimin. Në këtë kontekst, të paktën, mund të vërehen tri forma/modele:

- ***Së pari***, zyrtarët shtetërorë serbë kanë qenë të interesuar të theksojnë se një pasivizim i drejtë ligjor ka ndodhur në të gjithë Serbinë, prandaj as komunat me popullsi shqiptare si shumicë në jug nuk janë një përjashtim. Megjithatë, të dhënat zyrtare sugjerojnë ndryshe. Siç shihet në tabelën 1, numrat zyrtarë të pasivizimit të raportuar për komunat me popullsi shumicë shqiptare, Medvegjë dhe Bujanoc, janë dukshëm më të lartë se për qytetet/komunat me shumicë serbe në pjesë të tjera të Serbisë. [19]

Tabela 1. Republika e Serbisë: Numri i rasteve të pasivizuara dhe numri i popullsisë sipas komunave (2011-2021).

Komuna	Numri popullsisë	i Rastet pasivizuara	e Përqindja
Medvegjë	7.44	1782	23,96%
Bojnik	11.1	59	0,53%
Lebane	22	35	0,16%
Bujanoc	18.07	560	3,09%
Pirot	57.93	63	0,1%
Leskovc	144.21	366	0,25%
Smederevë	108.21	86	0,07%
Krushevc	128.75	628	0,48%
Suboticë	141.55	1216	0,85%
Beogradi i Ri	214.51	1555	0,72%

(Burimi: Përmbledhje e autorit bazuar në të dhënat e marra nga *Republički Zavod za Statistiku (2014). 2011 Popis stanovništva, domaćinstava i stanova 2011. u Republici Srbiji: Uporadni pregled broja stanovnika 1948, 1953, 1961, 1971, 1981, 1991, 2002 i 2011, godine;* dhe Adresat e Pasivizuara në Serbi, raporti i ambasadorit të Serbisë për Anëtarin e Parlamentit Europian dhe Raportuesin e Përhershëm të KE-së për Kosovën, Ms. Viola von Cramon).

- **Së dyti**, autoritetet shtetërore serbe kanë dhënë të dhëna jokonsistente për pasivizimin e komunave me popullsi shumicë shqiptare. Në nëntor 2020, disa muaj pasi aktivistët nga Medvegja [20] bënë fushatë lidhur me masivizimin, duke e shndërruar në çështje kryesore politike, përfaqësuesi i sapozgjedhur nga pakica shqiptare në Kuvendin e Serbisë, z. Shaip Kamberi,

pyeti ministrin e Punëve të Brendshme të Serbisë për numrin e përgjithshëm të adresave të përhershme të pasivizuara për komunën e Medvegjës.

Me shumë takt ai kërkoi numrat për ato zona ku shqiptarët përbënin shumicën kryesore të popullsisë në këtë komunë dhe kjo për periudhën nga viti 2017 deri në vitin 2020. Më 9 dhjetor 2020, ministri i Punëve të Brendshme të Serbisë, Aleksandar Vulin, iu përgjigj me një letër zyrtare, në të cilën deklaroi se *“bazuar në informacionet e ministrisë, kishte 1751 persona me status të pasivizuar për zonat e kërkuara për periudhën nga 1 janari 2017 deri më 26 nëntor 2020”*. [21]

Pak muaj më vonë, zoti Kamberi i bëri ministrit të Brendshëm të njëjtën pyetje, për të njëjtat zona, për të njëjtën komunë, por për periudhën 2011-2017. Sipas përgjigjes së dytë të ministrit Vulin, nuk ka pasur raste pasivizimi të raportuara për këto vite. Më saktësisht, ai në përgjigjen e tij ka shkruar se, *“në bazë të informacioneve të ministrisë nuk ka pasur asnjë adresë të vetme të përhershme të pasivizuar në këto vendbanime specifike për vitet e kërkuara dhe nuk ka pasur asnjë rast të iniciuar për momentin, që ishte në pritje të vendimit për pasivizim të adresave të përhershme në ato zona”*. [22]

Natyrisht, informacioni i zotit Vulin nuk ishte i saktë. Së pari, nivelet e tjera institucionale në Serbi kanë ofruar statistika të ndryshme nga ministri Vulin. Në fillim të vitit 2020, kur fushata kundër pasivizimit masiv dhe selektiv të shqiptarëve po fillonte të merrte hov, kryetari i Preshevës, z. Shqiprim Arifi, pyeti autoritetet për numrin total të rasteve të pasivizuara në zonat me popullsi shqiptare. Megjithatë, ai nuk iu drejtua autoriteteve lokale në qytetin e Medvegjës dhe as Ministrisë së Punëve të Brendshme në Beograd. Në vend të kësaj, ai bëri kërkesë te drejtoria rajonale e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, në Leskovc, një institucion i ndërmjetëm, por që ka kompetenca mbi autoritetet lokale në komunën e

Medvegjës. Në përgjigjen zyrtare për kryetarin Arifi, zëvendës drejtori i Policisë së Departamentit të Ministrisë së Punëve të Brendshme në Leskocv tha: *“Në bazë të verifikimit të informatave [nëpër sektorë të ndryshëm] konfirmojmë se nga departamenti i policisë në Leskocv, policia në Medvegjë ka pasivizuar, që nga data 29.11. 2011, kur hyri në fuqi Ligji për Vendbanim dhe Vendqëndrim, deri më 12.03. 2020, me vendim të formës së prerë, 4214 persona, në territorin e komunës së Medvegjës”.* [23]

Megjithatë, deri në mars të vitit 2021, zyrtarët shtetërorë serbë raportuan shifra të ndryshme për pasivizim. Me kërkesë të Viola von Cramon-Taubadel, eurodeputete dhe Raportuese e Përhershme e Parlamentit Europian për Kosovën, vetëm disa javë para miratimit të “Raportit të Komisionit 2019-2020 për Serbinë” në Parlamentin Europian, ambasadori serb u dha eurodeputetëve një dokument/listë gjithëpërfshirëse me titull: “Adresa të pasivuara në Serbi”. Për tri komunat më jugore, ambasadori serb në Bruksel raportoi: a) 1782 raste për komunën e Medvegjës, b) 570 për Bujanocin dhe c) 92 për Preshevën. Me pak fjalë, zyrtarët shtetërorë serbë raportuan të dhëna mjaft të sakta për pasivizimin përpara se çështja të bëhej e njohur gjerësisht, por i ulën shifrat deri në momentin kur ai arriti nivelet e politikëbërjes ndërkombëtare, siç është Parlamenti Europian. [24]

- **Së treti**, zyrtarët shtetërorë në Serbi nuk janë marrë me pyetjen se si pasqyrohet pasivizimi në listat e votuesve në Serbinë Jugore. Në Republikën e Serbisë, meqenëse e drejta e qytetarëve për të votuar në zgjedhjet lokale varet nga të pasurit e një adrese të përhershme të regjistruar në njësinë vetëqeverisëse, listat e votuesve janë dëshmi e qëndrueshme për statusin e pasivizimit. Me fjalë të tjera, pasivizimi masiv dhe selektiv pothuajse gjithmonë shoqërohet me një rënie të theksuar të numrit të votuesve. Në të vërtetë, duke parë komunën e Medvegjës, nga viti 2012 deri në vitin 2019 numri i votuesve të regjistruar është zvogëluar nga 10 102 në 6 602. [25]

Dhe vetëm gjatë një periudhe katërvjeçare, mes viteve 2015-2019, numri i këshilltarëve shqiptarë nga 8 ra në 3. [26]

- ***Së fundmi***, autoritetet serbe nuk kanë ofruar të dhëna të ndarjes etnike, as për rastet e pasivizuara dhe as për votuesit, të cilët janë hequr nga lista e votuesve që nga viti 2011. Duke u nisur nga rezultatet e anketës sime, ku 90 për qind e 500 të pasivizuarve nga Medvegja pretenduan se nuk patën të drejtë të votonin gjatë zgjedhjeve lokale të mbajtura në vitin 2019, kreu një analizë në dy nivele të listave të votuesve për këtë komunë. *Së pari* analizova numrin total të votuesve të regjistruar për ciklin e zgjedhjeve lokale të mbajtura në vitin 2012 dhe 2019. Kjo do të thotë se hulumtova se si ndryshoi numri i votuesve të regjistruar në këtë komunë që nga hyrja në fuqi e *Ligjit për Vendbanim dhe Vendqëndrim* në vitin 2011. Në *hapin e dytë* krahasova uljen e numrit të votuesve shqiptarë dhe serbë në fshatrat/vendbanimet ku ata përbënin shumicën absolute të popullsisë (mbi 95% e popullsisë). Siç tregon edhe krahasimi i tabelave 2 dhe 3, ndërmjet periudhës 2012-2019, numri i votuesve shqiptarë të hequr nga lista e votuesve në komunën e Medvegjës ishte 61,58%, ndërsa ai i serbëve ishte 14%. Në studimin tim me qytetarët e prekur, zbulova një korrelacion të fortë midis shqiptarëve të pasivizuar dhe heqjes së tyre nga lista e votuesve. Të paktën për rastin e komunës së Medvegjës isha në gjendje të vlerësoja në mënyrë të pavarur pretendimet e pjesëmarrësve në anketë, rreth pamundësisë së tyre për të ushtruar të drejtën e votës në zgjedhjet lokale në vitin 2019. Duke pasur qasje të plotë në listat e votuesve nga ky vit, të cilat këshilltarët politikë shqiptarë i bënë të disponueshme për këtë studim, mund të identifikoja të pasivizuarit që ishin hequr nga lista e votuesve deri në kohën kur u mbajtën zgjedhjet lokale, në shtator 2019. Gjithashtu zbulova se mbi 90 për qind e 500 shqiptarëve të pasivizuar nga kjo komunë, që morën pjesë në këtë studim, ishin hequr nga

lista e votuesve pa u njoftuar për këtë. 10 për qind e mbetur ende figuronin në listat e votuesve. [27]

Edhe pse autoritetet shtetërore kanë insistuar se pasivizimi po bëhet në mënyrë të barabartë në të gjithë Serbinë, të dhënat tregojnë se komunat me popullsi shumicë shqiptare kanë saktësisht numrin më të lartë të qytetarëve të pasivizuar në Republikën e Serbisë. Gjithashtu, siç tregon rasti i Medvegjës, komunë me numrin më të lartë të qytetarëve të pasivizuar në Serbi, pasivizimi masiv i shqiptarëve çoi në një zvogëlim drastik të numrit të votuesve shqiptarë, si dhe zvogëlim të numrit të këshilltarëve politikë shqiptarë.

Tabela 2. Pasivizimi dhe zvogëlimi i votuesve shqiptarë në Medvegjë” (2012-2019)

Fshatra/vendbanime me shumicë shqiptare	Votues regjistruar 2012	Votues regjistruar 2019	Rënia në numër votuesve shqiptarë/ Përqindja
Gjylekreshtë	7.44	1782	23,96%
Kapit	11.1	59	0,53%
Tupallë	22	35	0,16%
Sijarinë	18.07	560	3,09%
Sfricë	57.93	63	0,10%
Ramabajë	144.21	366	0,25%
Starabajë	108.21	86	0,07 %
Gërbac	128.75	628	0,48 %

(Burimi: Përmbledhje e autores nga të dhënat zyrtare të marra nga “Spisak Upisanih Biraca/ Rezultati Lokalnih Izborâ, Opstina Medvegja/Medvedja, 24

qershor 2012” dhe “Spisak Upisanih Biraca/Rezultati Lokalnih Izbora, Opstina Medvegja/ Medveđa, 08.09.2019”.

Rënia e votuesve në përqindje është vlerësim imi.

Tabela 3. *Pasivizimi dhe zvogëlimi i votuesve serbë në Medvegjë (2012-2019)*

Fshatra/vendbanime me shumicë serbe	Votues regjistruar Viti 2012	të	Votues regjistruar 2019	të	Rënia në numër e votuesve Rënia në përqindja
Donji Bucumet	198		155		-21,7%
Lece	275		237		-13,81%
Gazdare	382		374		-2,09%
Negosavlje	306		303		-0,98%
Macedonce	158		128		18,98%
Rujkovac	270		200		-25,92%
Stublla	118		105		-11,01%
Tullare	152		144		-5,26%

(Burimi: Përmbledhje e autores nga të dhënat zyrtare të marra nga “Spisak Upisanih Biraca/ Rezultati Lokalnih Izbora, Opstina Medvedja, 24 qershor 2012”, [Lista e votuesve të regjistruar/rezultatet e zgjedhjeve lokale, komuna e Medvegjës], dhe “Spisak Upisanih Biraca/Rezultati Lokalnih Izbora, Opstina Medvedja, 08.09.2019” [Lista e votuesve të regjistruar/rezultatet e zgjedhjeve lokale, komuna e Medvegjës].

Rënia e votuesve në përqindje është vlerësim imi.

Si ndikoi politika e pasivizimit te qytetarët e rregullt në Serbinë Jugore

Statistikat për statusin e pasivizimit janë thelbësore për çështjen nëse institucionet shtetërore kanë vepruar me mirëbesim gjatë zbatimit të *Ligjit për Vendbanim dhe Vendqëndrim* në Serbi. Ato jo vetëm që na tregojnë për *modus operandi* të institucioneve të ndryshme shtetërore, por gjithashtu mund të specifikojnë forma dalluese të diskriminimit dhe shënjestrimin e grupeve të veçanta etnike. Megjithatë, sado që statistika të jetë e rëndësishme, debati mbi statusin pasvizues nuk mund të përmbillet me statistika. Pas çdo numri pasvizimi fshihet një përvojë e veçantë dhe personale e shtetasit të Serbisë. Deri më tani nuk u është kushtuar vëmendje e mjaftueshme betejave individuale të shqiptarëve të pasvizuar nga Serbia Jugore. As në media dhe as në mjediset akademike nuk është ngritur pyetja se si ndikon pasvizimi te këta individë dhe familjet e tyre, në aspekt afatshkurtër dhe afatgjatë. Përderisa ka një referencë në lidhje me faktin që shqiptarët mund të ankohen kundër vendimit të autoriteteve brenda 8 ditësh, siç parasheh ligji, ata nuk arrinin ta bënin këtë, sepse autoritetet nuk i njoftonin ata me kohë për vendimin e nxjerrë. Pothuajse nuk u është dhënë asnjë vëmendje atyre rasteve, kur shqiptarët kanë nisur procedurat kundër autoriteteve serbe, me qëllim të rikthimit të statusit të adresave të tyre të banimit. Ndoshta edhe më e habitshme është situata, që pothuajse fare nuk ka pasur debat për ndikimin e pasvizimit mbi individët me sëmundje kronike, të pensionuarve dhe grupet e tjera të ndjeshme të Serbisë Jugore.

Të dhënat nga anketimi im tregojnë se autoritetet kompetente serbe nuk kursyen pasvizimin as për kategoritë më të rrezikuara të qytetarëve në jug të Serbisë. Në disa raste, jo vetëm që autoritetet kompetente kanë pasvizuar anëtarë të rrezikuar të pakicës shqiptare, por ata ishin edhe anëtarët e vetëm nga e gjithë familja, të cilët ishin pasvizuar. Në vijim kam

ofruar shënime nga një gamë përvojash personale dhe betejash të shtetasve të Serbisë me etnicitet shqiptar ndaj politikave të pasivizimit që nga viti 2011. Çdo rast i paraqitur reflekton më shumë se një përvojë personale në përballje me pasojat e pasivizimit; ai reflekton një kategori të qytetarëve të pasivizuar në jug të Serbisë. Për shkak se fokusi është në përvojën e individëve, metoda ime e kërkimit dhe e analizës së të dhënave kalon në një studim antropologjik. Për shembull, për të marrë të dhënat që nuk janë nxjerrë nga statistikat, kam kryer më shumë se një intervistë të thelluar me secilin pjesëmarrës gjatë një periudhe 15-mujore. U bëra atyre mbi njëzet pyetje të hapura. Kam mbajtur shënim procedurat e tyre ligjore të nisura në Serbi, përgjigjet e zyrtarëve të cilat i kanë pranuar dhe kam bërë analiza tekstuale bazuar në dokumentet zyrtare, që qytetarët e pasivizuar i kanë vënë në dispozicion për këtë studim. Të dhënat e fituara nga studimi im tregojnë se nuk kishte kritere objektive në procesin e vendimmarrjes për pasivizim të personave nga komuniteti shqiptar në Serbinë Jugore.

Pasivizimi i shqiptarëve nuk ishte aspak i kategorizuar. Autoritetet po pasivizonin qytetarë të rinj dhe të moshuar, qytetarë të shëndetshëm dhe të sëmurë. Ata po pasivizonin njerëz që punonin për administratën lokale të komunës në jug të Serbisë, studentë shqiptarë nga jugu i Serbisë që studionin në Kosovë, si dhe individë që ishin me punë të përkohshme në Europën Perëndimore. Ata, pra, po pasivizonin këdo që kishte regjistruar tek autoritetet në Serbi qëndrimin e vet afatgjatë jashtë vendit. Në vijim do të sjell shembuj nga çdo kategori.

- **Kategoria e parë** e shqiptarëve të pasivizuar nga Serbia Jugore janë ata që punojnë përkohësisht në Europën Perëndimore. Për shkak të shkallës së lartë të papunësisë në tri komunat më jugore të Serbisë, dhe duke shfrytëzuar faktin se Serbia ka një marrëveshje për lirim vizash me Zonën Shengen, shumë shqiptarë nga rajoni përfunduan duke u marrë punë sezonale në

Zvicër dhe Gjermani. Edhe pse ata vazhdojnë të kenë pronë në emër të tyre në jug të Serbisë dhe nuk kanë kontrata pune afatgjata në vendet e huaja, autoritetet patën tendencë të çaktivizojnë sistematikisht adresat e tyre të qëndrueshme në vendlindje. Në këtë mënyrë, ata po e trajtonin këtë kategori të qytetarëve si shtetas të huaj ose si individë, të cilët heqin dorë nga shtetësia e tyre serbe për të marrë një shtetësi tjetër të huaj dhe, me shumë gjasa, nuk do të ktheheshin kurrë për të jetuar në Serbinë Jugore. Në praktikë, kjo nuk është domosdoshmërisht e vërtetë. Punëtorët sezonalë shqiptarë nga jugu i Serbisë nuk fitojnë automatikisht qëndrime të qëndrueshme në Europën Perëndimore ose shtetësi të vendeve pritëse. Përgjithësisht, ata angazhohen në migrim qarkullues, por statusi i pasivizuar bën që të jetë më vështirë për ta të kthehen në vendlindjet e tyre në jug të Serbisë.

Një shqiptar me status të pasivizuar, nga një prej fshatrave të Medvegjës, duke kujtuar përvojën e tij të këtij procesi, më tregoi historinë e tij në një intervistë personale: *“Shkova për ta vazhduar pasaportën time të skaduar në vitin 2014, në departamentin e Ministrisë së Punëve të Brendshme në qytetin tonë, pas një viti që kisha kaluar në Gjermani, dhe ishte vetëm atëherë që mësova se isha pasivizuar. Zyrtari i policisë më tha se jam fshirë, nuk jam më në bazën e të dhënave, dhe për këtë arsye nuk mund të merrja një pasaportë të re. Që atëherë, nuk kam një pasaportë të vlefshme dhe letërnjoftimi më ka skaduar, gjithashtu. Nuk kam më asnjë dokument të vlefshëm nga Republika e Serbisë. Kjo ma bën të pamundur jetën në Medvegjë. Herën e fundit që isha atje, nuk munda të blija një numër telefoni në vendlindjen time, aty ku kam lindur, për shkak të mungesës së një letërnjoftimi të vlefshëm. Pastaj ma ndërpreu edhe energjinë elektrike, sepse nuk kisha letërnjoftim të vlefshëm kur shkova për të paguar faturat mujore. Kjo është një situatë jashtëzakonisht shqetësuese”.* [28]

- **Kategoria e dytë** kryesore e shqiptarëve të pasivizuar nga jugu i Serbisë janë ata, të cilët aktualisht punojnë në Kosovë. Në një rast bisedova me një të ri shqiptar nga një fshat në Bujanoc, i cili ishte me status të pasivizuar në vitet e fundit. Familja e tij kishte një sipërfaqe të madhe toke, që ia kishin dhënë atij. Ai paraqiti dëshmi të certifikatës së lindjes, certifikatës së shtetësisë dhe pagesat e taksave, që i kishte bërë rregullisht ndaj qeverisë serbe. Ai fliste disa gjuhë dhe ishte i arsimuar. Megjithatë, kurrë nuk kishte gjetur punë në Serbi. Disa vite më parë ai gjeti një punë me pagesë të mirë në Kosovë, ku punoi për një kompani ndërkombëtare, por pjesën më të madhe të fundjavëve i kalonte me prindërit e tij në fshatin e tij në Serbinë Jugore. Duke kujtuar betejën e tij shtatëvjeçare me institucionet shtetërore serbe kundër pasivizimit, në një intervistë personale më tha: *“Kur më skadoi letërnjoftimit personal në vitin 2014, autoritetet serbe më thanë se nuk mund ta vazhdonin, sepse nuk ishte ajo adresa ku unë jetoja përherë”*. [29] Ai më pas paraqiti një ankesë, që e dërgoi në autoritetin më të lartë kompetent në Beograd, por pa rezultat. *“Më pasivizuan jo vetëm adresën e përhershme, por edhe ankesën time”*, më tha ai gjatë intervistës. Pas më shumë se shtatë vjetësh beteja ligjore, ai u bë *de jure* një person pa shtetësi. Ndërkohë, letërnjoftimi i tij personal dhe pasaporta i skaduan dhe autoritetet refuzojnë vazhdimisht kërkesat e tij për ripërtëritjen e tyre. Si në çdo rast tjetër të pasivizimit që kam hetuar, Ministria e Brendshme serbe siguroi që të mos linte asgjë në shkrim, që do të tregonte se ata refuzuan t’i jepnin dokumente udhëtimi. Duke lexuar vendimin zyrtar, më bën përshtypje se qytetari thjesht nuk arriti “t’i bindë” autoritetet, se ai ka synim të jetëjetësuar përgjithmonë në vendlindjen e tij. Në të vërtetë, megjithatë, atij iu hoqën të gjitha të drejtat themelore qytetare dhe shtetërore në Serbi nga autoritetet shtetërore.

- **Kategoria e tretë** kryesore e shqiptarëve që po pasivizohen në Serbi janë të rinjtë që studiojnë në Kosovë ose Shqipëri. Bazuar në rrëfimet që kam bërë

me qytetarët e prekur, faktet objektive nuk luajtën rol në këto raste për autoritetet serbe. Ja si shpjegoi në një mënyrë të ndjeshme një student shqiptar nga komuna e Bujanocit, që studion mjekësi në Prishtinë: *“I informova autoritetet serbe se do të studioja për mjekësi në Kosovë; se vitin vijues do ta filloja rezidencën time mjekësore, që do të thotë se do të kaloja edhe katër vite të tjera kryesisht në Kosovë [...] Jam pasivizuar që nga viti 2015. Nuk kam asnjë letërnjoftim apo dokument tjetër të vlefshëm që nga ai vit. Faktikisht jam bërë qytetar i huaj në vendlindjen time. Aplikova tri herë për ta ripërtërirë letërnjoftimin tim në departamentin e Ministrisë së Punëve të Brendshme në Bujanoc [...] Madje njëherë më gjetën në shtëpi kur erdhën të kontrollonin nëse jetoja në adresën time të regjistruar si adresë të përhershme, por megjithatë më pasivizuan”.*

- A mund të imagjinohet një gjë e tillë të ndodhë sot kudo në Europë, që ta humbni identitetin shtetëror; sepse punoni ose studioni në një vend tjetër?[30]

Ekzistojnë prova të forta, që tregojnë se personeli i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë i pasivizoi gjithashtu shqiptarët nga jugu i Serbisë, të cilët ishin në gjendje të rëndë shëndetësore. Në komunën e Medvegjës ka pasur një rast, ku një qytetar i pasivizuar vuante nga një sëmundje e rrallë, e cila e kishte lënë në karrocë për një kohë të shkurtër. Ai kishte mjekët e tij jashtë vendit, ku shkonte për kontrolle të rregullta dhe për të marrë pjesë në provat klinike që nga vera e vitit 2010. Ajo që binte në sy në këtë rast familjar, ishte se Ministria e Brendshme e Serbisë “verifikoi vendbanimin e tij” tri herë dhe inspektorët e policisë e gjenin çdoherë në shtëpi gjatë vitit 2020. Megjithatë, departamenti përgjegjës refuzoi të njihje vlefshmërinë e adresës së tij të përhershme. Akoma më shqetësues është fakti, se i njëjti institucion u lëshoi pasaporta të reja prindërve, nga të cilët personi në karrige varej për aktivitetet e tij të përditshme, si dhe dy

vëllezërve e motrave të tij, por jo atij. Ky i ri shqiptar i pasivizuar, i cili kishte studiuar në SHBA për katër vite para se të sëmurej, dha një rrëfim të detajuar në sondazh, duke thënë ndër të tjera: *“Do të më kenë pasivizuar pak para se të mbaheshin zgjedhjet lokale në vitin 2019 në Medvegjë ose, të paktën, atëherë mësova për këtë, sepse kur autoritetet sollën listat e zgjedhësve, emri im nuk ishte në të”*. [31] Në atë kohë, megjithëse ky qytetar i pasivizuar ende kishte një letërnjoftim personal të vlefshëm kur u mbajtën zgjedhjet lokale, ai u pasivizua pa marrë kurrë njoftim për këtë, dhe më pas u fshi nga lista e votuesve pa e ditur për këtë. Ai bëri ankesë në departamentin përgjegjës për Ministrinë e Punëve të Brendshme në vendlindjen e tij, por autoritetet refuzuan t'i jepnin një vendim me shkrim, që konfirmonte se ai në të vërtetë ishte pasivizuar. [32] Në vend të kësaj, ata i komunikonin të gjitha në mënyrë verbale. Pavarësisht kërkesës së tij për të riaktivizuar adresën e tij të qëndrueshme, autoritetet nuk i dhanë kurrë asnjë përgjigje. Në një nga pyetjet e anketës, qytetari i pasivizuar, i cili vuan nga sëmundja e rëndë kujton:

“Autoriteti kompetent, në zyrën e tyre, më tha vetëm me fjalë se jam pasivizuar, nuk ma dhanë asgjë në shkrim... Ishte një ndjenjë shumë e vështirë për mua... Ishte një diskriminim i rëndë, që Republika e Serbisë bëri ndaj meje, sepse isha thjesht një qytetar normal i këtij vendi dhe paguaja rregullisht taksa në këtë vend.

Kanë kaluar dy muaj, që kur e apelova këtë vendim të padrejtë dhe jonjerëzor, por nuk mora asnjë përgjigje nga autoritetet. Fakti që jam në karrige me rrota dhe në mes të pandemisë duket se nuk i prek aspak ata.”[33]

Në nëntor të vitit 2020, ndërsa ende pritej një përgjigje nga Ministria e Punëve të Brendshme serbe, qytetari në karrocë, i cili ishte pasivizuar padrejtësisht, u sëmur rëndë dhe u dërgua me urgjencë në spitalin e

Beogradit. Atë ditë, që ai u pranua në Njësinë e Emergjencës në Beograd, nuk kishte pasaportë të vlefshme, nuk kishte sigurim shëndetësor dhe nuk kishte vendbanim të përhershëm të pranuar nga autoritetet shtetërore të Serbisë. [34] Vetëm për shkak të presionit të madh mbi autoritetet lokale, ata i dhanë një kartelë të përkohshme të sigurimit shëndetësor, dhe atë me kohëzgjatje vetëm për dy muaj, e cila i mundësoi familjes të mbulojë shpenzimet e faturave mjekësore, që shumë lehtë mund të kishin qenë disa mijëra euro. Ai vdiq tri javë më vonë. Dhe Ministria e Brendshme serbe nuk e ripërtëriu kurrë pasaportën e tij. [35] Nëse ky 30-vjeçar do të kishte nevojë për një operacion të ndërlikuar në një vend tjetër, nuk kishte një pasaportë të vlefshme për t'u larguar nga shteti.

- **Kategoria e katërt** kryesore e shqiptarëve të pasivizuar nga jugu i Serbisë përfshin të moshuarit dhe pensionistët. Përveç të sëmurëve kronikë, zbulova se ky ishte një nga grupet më të ndjeshme shoqërore ndër shqiptarët e pasivizuar në jug të Serbisë. Në komunën e Medvegjës bisedova me një grua 70-vjeçare, që më tregoi për betejën e saj të gjatë kundër statusit të saj të pasivizimit në Serbi. Ajo e kujtoi ngjarjen gjatë një interviste personale: *“Ishte thjesht një ditë e zakonshme në jetë”*. Kishte një takim me mjekun në klinikën në vend, kur inspektorët e policisë kishin shkuar për ta kontrolluar në shtëpinë e saj. Kur ishte kthyer në shtëpi, fqinji i saj i kishte treguar se policia kishte qenë dhe kishin pyetur për vendndodhjen e saj, duke pyetur edhe *“sa kohë kalonte në apartamentin e saj, si dhe ku i jetonin fëmijët”*. [36]

Kur e intervistova, më tha se ishte me shëndet të dobët, jetonte vetëm dhe më nuk kishte pasaportë të vlefshme. Pas një pasivizimi të padrejtë në vitin 2017, ajo u fshi nga lista e votuesve dhe, si pasojë e kësaj, nuk kishte mundur të votonte në zgjedhjet lokale që u mbajtën në Medvegjë në vitin 2019. Kur e pyeta se si kishte ndikuar pasivizimi në jetën e saj, ajo më tha:

“Isha i detyruar të ngujohesha në shtëpinë time për një vit [...] Pasi mësova se më kishin pasivizuar, bëra një ankesë për vendimin dhe iniciova një procedurë ligjore për të riaktivizuar vendbanimin tim të përhershëm. Ata gjetën çdo justifikim të mundshëm, nga më absurdet që mund të imagjinoi, vetëm që të mund ta zgjasnin procesin. Madje angazhova një avokat serb, por Departamenti Rajonal i Ministrisë së Punëve të Brendshme në Leskoc nuk i mori parasysh argumentet e mia.”[37]

E mbetur vetëm me një dokument të vlefshëm, letërnjoftimin personal, frika më e madhe për këtë grua shqiptare nga Medvegja, e pensionuar dhe e pasivizuar, ishte se nuk do të mund ta merrte pensionin edhe për shumë kohë. Duhej një dokument i vlefshëm për të hapur një llogari bankare dhe për të marrë pension në Serbi. Si masë parandaluese, ajo mendoi se mund të ishte zgjidhje e mençur të autorizonte njërën nga vajzat e saj për ta marrë pensionin për të. Në këtë mënyrë, nëse autoritetet nuk ia zgjatnin letërnjoftimin personal, dikush nga familja do të kishte të drejtë ta merrte pensionin e saj mujor. Por as ky plan nuk funksionoi, siç e tregoi në intervistë personale: *“Duke qenë me status të personit të pasivizuar dhe në shëndet të dobët, vendosa të ndërmarr hapat e nevojshëm, që të autorizoja vajzën time të vogël që ta merrte pensionin tim. Shkuam në Leskoc, ku ndodhet zyra rajonale që rregullon çështje të tilla. Vajza ime ka shtetësinë e Kosovës, pra nuk ka pasaportë serbe. Fillimisht, zyrtari serb në Leskoc më tha se nuk është aspak problem ta autorizoj vajzën time për ta marrë pensionin tim, por në momentin kur pa letërnjoftimin e vajzës sime nga Kosova, tha “prisni një moment” dhe shkoi për t’u konsultuar me kolegun e vet. Kur u kthye, më tha në serbisht: ‘Ne može’... që do të thotë ‘Nuk bën’... Kështu e trajton sot Serbia pakicën shqiptare”. [38]*

Gruaja e pensionuar apeloj kundër vendimit për pasivizim në departamentin përgjegjës në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Serbisë në

Medvegje dhe Leskovc. Pasi priti pothuajse një vit për një përgjigje, institucionet përkatëse refuzuan ankesën dhe e argumentuan se *“gjatë procesit të verifikimit, autoritetet e policisë kanë konstatuar se personi në fjalë nuk jeton në adresën e deklaruar të banimit dhe se adresa e përhershme e banimit të saj të deklaruar nuk paraqet qendrën e aktiviteteve të saj jetësore”*. Edhe pse e pazakontë, këto institucione dhanë dy komente shtesë në vendimin përfundimtar. Ata përmendën se e kishin gjetur gruan e pensionuar në shtëpi dy herë gjatë vizitave të papritura të policisë, por theksuan *“ne e refuzojmë ankesën, sepse bazuar në dëshmitë elektronike të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, mund ta vërtetojmë se ajo vinte vetëm herë pas here në territorin e Republikës së Serbisë dhe se shumicën e kohës e kalonte në territorin e 'Kosovës dhe Metohisë”*.

Letra zyrtare bëri një referencë tjetër të pazakontë, që tregon se praktika e pasivizimit mund të vendosë një komunitet të tërë nën presion. Në vendimin përfundimtar, ata argumentuan se kishin pyetur fqinjët për vendndodhjen e pensionistes me status të pasivizuar, dhe përgjigjja e tyre pretendohet se ishte, që ajo e kalonte shumicën e kohës me bijtë e saj në Prishtinë, Kosovë. [40] Pas një beteje prej mbi një viti me Ministrinë e Punëve të Brendshme serbe, e pensionuara jo vetëm që nuk arriti ta riaktivizojë adresën e saj të banimit, por atë e hoqën edhe nga lista e votuesve pa vullnetin e saj, dhe pasaporta e saj ka skaduar gjatë kësaj kohe. Autoritetet kompetente të Ministrisë së Punëve të Brendshme serbe, natyrisht, refuzuan ta ripërtërijnë pasaportën e saj.

- **Kategoria e pestë** e shqiptarëve të pasivizuar janë anëtarët e komunitetit shqiptar me adresa të përhershme të regjistruara jashtë vendit. [41] Në qershor të vitit 2020, Haki Emini, një aktivist i njohur për të drejtat e njeriut nga Medvegja, shkroi një letër të hapur proteste për institucionet serbe, e cila u botua në gazetën e përditshme “Danas” në Serbi. Në letër, z. Emini ka

shpjeguar se, edhe pse e kishte regjistruar siç duhet vendbanimin e tij jashtë shtetit pranë autoriteteve serbe dhe kishte të drejtë të votonte rregullisht për vite me radhë në konsullatën serbe në Bernë, Zvicër, ai papritmas dhe në mënyrë të paligjshme u pasvizua dhe më pas e larguan nga lista zgjedhore në vitin 2019. Në letrën me titull “Pastrimi etnik administrativ kundër shqiptarëve”, ai theksoi se mijëra bashkëvendës të tij ballafaqoheshin me vendime të ngjashme të paligjshme dhe diskriminuese nga autoritetet serbe. [42]

Rasti i Haki Eminit është një rast konkret dhe i rëndësishëm në disa aspekte. Së pari, tregon se pasvizimi u zgjerua, për të përfshirë ata shqiptarë të Serbisë Jugore, me vendbanime të regjistruara, siç duhet në Europën Perëndimore ose më gjerë. Ai gjithashtu ilustron se, edhe nëse shtetasit e Serbisë, por të përkatësisë etnike shqiptare, e kanë regjistruar siç duhet vendbanimin e tyre të ri jashtë vendit, në përputhje me dispozitat e nenit 19 të Ligjit për Vendbanim dhe Vendqëndrim, por kjo përfundimisht nuk i mbron ata nga pasvizimi i autoriteteve serbe.

Pasvizimi i shqiptarëve nga Serbia Jugore, të cilët kanë qëndrim të përkohshëm jashtë vendit, pak ka të bëjë me shqetësimet për rezultatet e zgjedhjeve. Sepse, zakonisht, pjesëmarrja e votuesve shqiptarë në zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale në Serbi ka qenë tradicionalisht e ulët. Në vend të kësaj, duke bërë pasvizimin e pjesëtarëve të komunitetit shqiptar me kualifikime të larta dhe situatë të mirë financiar meqë që punojnë jashtë vendit, autoritetet serbe duket se kanë qëllime të tjera në mendje. Qëllimi i tyre është t’i parandalojnë shqiptarët e arsimuar në nivel të lartë të formojnë çfarëdolloj lidhjeje të vlefshme me vendin e tyre të origjinës. Në fund të fundit, qofshin shqiptarët me status të pasvizuar duke jetuar në Bujanoc apo duke studiuar përkohësisht në San Francisko, pasojat janë të njëjta dhe kjo praktikë prek njësoj të dy kategoritë e qytetarëve. Ky veprim i pengon ata të

kenë të drejtën për të votuar, për të punuar ose për të punësuar dikë në vendlindjet e tyre, dhe forcon largimin e elitës shqiptare, duke i penguar qytetarët e pasur të kthehen në shtëpi dhe të bëjnë investime në jug të Serbisë.

- **Kategoria e gjashtë** e shqiptarëve të pasivizuar përbëhet nga femrat shqiptare nga tri komunat e Serbisë Jugore, të cilat janë të martuara me meshkuj shqiptarë kosovarë dhe femra nga Kosova të martuara me shqiptarë nga jugu i Serbisë. Këta njerëz, nëpërmjet lidhjes së martesës, shpesh ndajnë kohën e tyre midis dy vendeve. Teuta Fazliu, e lindur në Bujanoc, e martuar me një shqiptar nga Kosova dhe zyrtare në Ministrinë e Administratës Lokale në Kosovë, ishte njëra prej tyre. Ajo ishte në muajin e nëntë të shtatzënisë, duke qëndruar te prindërit në Bujanoc, në mes të pandemisë, kur nuk pati zgjidhje tjetër, përveçse ta linte vendlindjen e saj, për ta lindur fëmijën e parë në Prishtinë, Kosovë. [43] Në një intervistë personale, ajo shpjegoi se, pasi mësoi për statusin e saj të pasivizuar dhe pasi u largua nga lista e votuesve, ajo depozitoi një ankesë kundër vendimit. *“Ka kaluar gati një vit, por nuk kam marrë përgjigje prej tyre”*, shpjegoi ajo. Duke qenë se Teuta është shtetase e Serbisë, vajza e saj e porsalindur ka të drejtë të marrë nënshpëtimin serbe, por statusi i saj i pasivizuar e bën të pamundur realizimin e kësaj të drejte për vajzën e saj. Se si ndikon statusi i pasivizimit të prindërve shqiptarë nga jugu i Serbisë në të drejtat e fëmijëve të tyre të mitur, është një pyetje tjetër, me të cilën zyrtarët serbë nuk janë marrë deri më tani.

Ajo që tregon rasti i Teuta Fazliut, është se një person i pasivizuar nuk do të thotë domosdoshmërisht një adresë e përhershme e pasivizuar. Sepse, në ato raste kur kryefamiljarët pasivizoheshin, politika kishte implikime të drejtpërdrejta edhe për fëmijët e tyre të mitur. Në terma afatshkurtër, prindërit shqiptarë të pasivizuar në Serbi përballen me pengesa,

që variojnë nga marrja e certifikatave të lindjes për fëmijët e tyre të mitur e deri te pamundësia për t'i regjistruar në institucione specifike në Serbi. Në planin afatgjatë, shumica e prindërve shqiptarë me status të pasivizuar, pa letërnjoftime të vlefshme, kanë deklaruar në anketë, se kanë frikë që fëmijët e tyre do të hiqen nga lista e votuesve dhe do t'u refuzohen përfundimisht dokumentet e identifikimit nga autoritetet shtetërore serbe.

Si rezultat i kësaj, çështja e qasjes në pronë i preokuponte të gjitha këto kategori me status të pasivizuar. Ekziston një pasivizim *par excellence* ndër gjenerata, që po ndodh në jug të Serbisë. Ky studim tregoi se ka një korrelacion të fortë midis shqiptarëve me status të pasivizuar ose të lënë pa shtetësi dhe refuzimit nga autoritetet serbe për të lëshuar dokumente identiteti dhe pasaporta shtetërore për fëmijët e tyre të lindur në Kosovë, e drejtë kjo e garantuar për ta nga *Ligji për Shtetësinë e Republikës së Serbisë*, mbështetur në arsyen se njëri nga prindërit e tyre është i lindur në Serbi dhe ka shtetësinë serbe. Megjithatë, prindërit vështirë se mund ta vërtetojnë se autoritetet serbe kanë refuzuar shtetësinë për fëmijët e tyre, për shkak të statusit të tyre të pasivizimit. Kjo ndodh, sepse autoritetet këtë informacion ua komunikojnë vetëm gojarisht familjeve shqiptare.

Në këtë moment kohor, ky studim zbuloi se të paktën 850 shqiptarë nga jugu i Serbisë janë regjistruar si persona pa ndonjë dokument identiteti në Kosovë. [44] Sipas përfaqësuesit të Zyrës për Preshevën, Medvegjën dhe Bujanocin, zyrë kjo që vepron brenda Zyrës së Kryetarit të Komunës së Gjilanit në Kosovë, “*kjo situatë krijon një numër të pazgjidhshëm problemesh për ta dhe familjet e tyre. Fëmijët e tyre, edhe pse mund të kenë lindur në Kosovë, nuk mund ta fitojnë shtetësinë kosovare, sepse prindërit e tyre nuk kanë lindur në Kosovë. Megjithatë, ata nuk mund të marrin as dokumente identiteti të Serbisë, për shkak të statusit të pasivizimit të motivuar etnikisht*”. [45] Ky seksion e bën të qartë, se shqiptarët nga Serbia

nuk po humbasin vetëm të drejtat e tyre themelore qytetare dhe politike, për shkak të pasivizimit të adresave të tyre banimi, por ata po ndalohen sistematikisht nga Ministria e Punëve të Brendshme serbe për të marrë dokumente shtetërore identifikuese. Nuk ka një kategori të qartë të shqiptarëve që po pasivizohen, por autoritetet kanë synuar pasivizimin masiv dhe selektiv, veçanërisht për shqiptarët që jetojnë aktualisht në Kosovë për shkak të punës, studimeve ose sepse kanë arritur atje si persona të zhvendosur brenda vendit gjatë konfliktit të armatosur në vitin 2000-2001.

Megjithatë, një pyetje themelore që duhet ngritur është kjo: *A ekziston një bazë*

ligjore në Serbi për t'i refuzuar dokumentet e identitetit të shtetasve bazuar në statusin e adresës së banimit? Dhe a ka ankesa sikur këto të shqiptarëve te grupet e tjera pakicë dhe popullata shumicë në Serbi?

Këto janë dy pyetjet që do t'i diskutojmë në vijim.

Politikat e pasivizimit nga ana e Serbisë ndaj pakicës shqiptare: shfaqja e një politike të pasivizimit të etnizuar

Kuvendi i Serbisë shpalli *Ligjin e ri për Vendbanim dhe Vendqëndrim të Qytetarëve* më 17 nëntor 2011. Siç përcaktohet në nenin 1, qëllimi i ligjit ishte të rregullonte regjistrimin dhe çregjistrimin e adresave të banimit brenda vendit dhe të mbante një regjistër të adresave të përkohshme të banimit jashtë vendit për qytetarët e Serbisë, me qëllim mbajtjen e regjistrave të saktë. [46] Në këtë mënyrë, neni 3 e përcakton kuptimin e termit “qytetar” si vijon: “*Termi ‘qytetar’ nënkupton shtetasin e Republikës së Serbisë*”, dhe vendbanimi është “*vendi ku qytetari është vendosur me qëllim që të jetojë përgjithmonë, d.m.th. vendi i cili është qendra e veprimtarisë së tij jetësore, marrëdhënieve profesionale, ekonomike, sociale dhe të tjera, të cilat*

dëshmojnë lidhjen e përhershme të tij me vendin ku është vendosur". [47] Në të njëjtën paragraf, termi "*pasivizimi i adresës*" shfaqet dhe përcaktohet si "*një tregues në regjistrat e autoritetit kompetent, se qytetari nuk jeton në adresën e banimit të regjistruar ose në adresën e banimit të përkohshëm*". [48]

Së fundi dhe lidhur me këtë, ligji përcakton një term tjetër kyç, "autoritet kompetent", si "*njësi organizative rajonale kompetente territoriale e ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme*". Nga një përkufizim ligjor rezulton se kategoria e vendbanimit të përhershëm nuk përcaktohet si një kategori formale apo administrative e caktuar. Përkundrazi, është shumë më tepër se një kategori që varet nga vlerësimi i disa kriterëve nga autoritetet shtetërore, duke përfshirë kontrollin nëse një qytetar mund të demonstrojë "*lidhjen profesionale, ekonomike, sociale dhe të tjera*" me adresën aktuale të regjistruar të banimit, si dhe synimin të vendoset përgjithmonë aty. Në këtë mënyrë, ligji përfundimisht ua lë autoriteteve të interpretojnë dhe vërtetojnë faktet për vlefshmërinë e një vendbanimi të përhershëm. Ai u jep atyre fuqinë për të gjykuar për vlefshmërinë e një adrese banimi në të tashmen dhe probabilitetin që një individ të banojë atje në të ardhmen.

Kjo thuhet qartazi në ligj, kur përcakton kërkesën e "*vërtetimit të lidhjes së tij ose të saj të përhershme me vendin [...] dhe qëllimin e jetesës aty përgjithmonë*". [49] Gjithashtu, kompetencën e fundit të autoriteteve shtetërore e përcakton në nenin 13 të ligjit, i cili thotë qartazi, se "*autoriteti kompetent do të refuzojë regjistrimin e banimit të përhershëm me një vendim, nëse nuk mund të përcaktohet qëllimi i qytetarit për të banuar përgjithmonë në adresën që ai/ajo po regjistron*". [50]

Për sa i përket pasivizimit të banimit të përhershëm, ky proces rregullohet nga Neni 18 i të njëjtit Ligj, që përcakton se "me kërkesë të gjykatës, autoritetit të administratës shtetërore, ndonjë autoritetit tjetër ose

organizate, si dhe një personi tjetër juridik ose fizik e që ka një interes ligjor të arsyetuar, do të verifikojë vërtetësinë e banimit të përhershëm ose të banimit të përkohshëm në adresën e regjistruar nga qytetari.” [51] Nëse ndonjë nga përfaqësuesit e autoriteteve të mësipërme vijnë në përfundim se “qytetari nuk jeton në adresën ku e ka regjistruar banimin e përhershëm ose atë të përkohshëm... ose nëse ai/ajo ka dhënë informacion të rremë gjatë regjistrimit... autoriteti kompetent do të lëshojë një vendim për pasivizimin e adresës së banimit të përhershëm.” [52] Një koncept tjetër relevant që është përcaktuar qartazi në Ligj është procesi i lëshimit të vendimeve për pasivizimin e banimit. Neni 18, paragrafi 3, thotë se “autoritetet kompetente duhet të lëshojnë një vendim për pasivizimin e adresës” dhe bën një referencë në të edhe kur bëhet fjalë për të drejtën për t’u ankuar kundër vendimit për pasivizim. Në këtë mënyrë, neni 18 parashikon që qytetari të informohet siç duhet për pasivizimin dhe parashikon se kundër vendimit mund të bëhet ankesë në departamentin përgjegjës për punët e brendshme, *“brenda tetë ditësh nga marrja e vendimit për pasivizimin e vendbanimit”*.

Pasivizimi i banimit të përhershëm mund të ketë pasoja të mëdha në të drejtën e votimit në zgjedhjet lokale në Serbi dhe, për më tepër, edhe në përfaqësim politik. Neni 6 i *Ligjit për Zgjedhjet Lokale* përcakton se të gjithë qytetarët e moshës madhore, me të drejtë juridike, mund ta shfrytëzojnë të drejtën për të votuar në zgjedhjet lokale në Republikën e Serbisë. Megjithatë, e drejta për të votuar në zgjedhjet lokale është lidhur me obligimin, që qytetari të ketë një banim të përhershëm të regjistruar në një zonë të caktuar. Për këtë, neni 6 i *Ligjit për Zgjedhjet Lokale* bën të qartë, se e drejta për të zgjedhur këshilltarin lokal varet nga banimi i përhershëm në territorin e njësisë së vetëqeverisjes përkatëse lokale. Ndoshta më pak befasues është fakti, se ky ligj përcakton të njëjtat parakushte për mundësinë për të kandiduar si këshilltar politik në zgjedhjet lokale. [53]

Kështu që, nëse ka pasivizim me motivacion politik, i cili do të synonte një grup të veçantë të pakicave, ai do të ndikonte pothuajse gjithmonë në zvogëlimin e numrit të votuesve dhe këshilltarëve nga ky grup pakicash, çka nënkupton se do të dëmtonte rëndë përfaqësimin e tyre politik. Megjithatë, *Ligji për Vendbanim dhe Vendqëndrim të Qytetarëve të Serbisë* nuk thotë shprehimisht, se qytetarët duhet të kenë një vendbanim të përhershëm të regjistruar për të marrë letërnjoftim personal ose pasaportë. [54] Në fakt, neni 17 i ligjit thotë se, nëse një qytetar me të drejtën për një dokument identiteti nuk ka një adresë të përhershme dhe nuk mund të përcaktohet banimi i tij ose i saj me një vendim në përputhje me nenin 11 të ligjit, atëherë banimi i tij/i saj i përkohshëm do të përcaktohet me një vendim “për qëllim të marrjes së një dokumenti të identitetit personal”. [55] Në Republikën e Serbisë, e drejta për të marrë dokument identiteti dhe pasaportë është një e drejtë themelore kushtetuese e siguruar për të gjithë qytetarët. Ajo vjen nga të drejta e shtetësisë, e cila përcaktohet nga kriteret e shtetësisë. Nëse e drejta për t’u pajisur me letërnjoftime shtetërore është një e drejtë kushtetuese e garantuar për qytetarët e Serbisë, nëse nuk ka bazë ligjore për t’iu mohuar kartat e identitetit personal në bazë të *Ligjit për Vendbanim dhe Vendqëndrim*, atëherë si ka mundësi që autoritetet shtetërore serbe ta zbatojnë këtë ligjshmëri në zonat me popullsi shumicë shqiptare në Serbinë Jugore?

Për të kuptuar motivimet e autoriteteve për të shmangur ligjin, është e domosdoshme të merret parasysh konteksti më i gjerë politik. Kur Serbia adoptoi *Ligjin për Vendbanim dhe Vendqëndrim* në vitin 2011, një nga argumentet kryesore të përdorura në favor të këtij ligji ishte se do të ndihmonte në përcaktimin e numrit objektiv të qytetarëve që jetojnë në një zonë të caktuar të vendit. Kjo ishte e rëndësishme për qeverinë, me qëllim mbledhjen e taksave dhe shërbimeve sociale.

Përveç kësaj, ligji gjithashtu u përshëndet si një mekanizëm i dobishëm, që do të forconte demokracinë serbe, pasi do të ndihmonte në “pastrimin” e listave të votuesve, të cilat, sipas pretendimeve, nuk paraqisnin numrin real të votuesve në njësitë e ndryshme të vetëqeverisjes në vend. [56] Në atë kohë, politikanët serbë dhe diplomatët ndërkombëtarë në Serbi nuk kishin ndonjë shqetësim për pasojat e mundshme negative, qofshin ato në rajonet ekonomikisht të dobëta të Serbisë, prej nga ku kishte migrim të konsiderueshëm të përkohshëm drejt qyteteve, ose në ato zona të vendit, të dominuara nga një grupi i pakicës etnike.

Ata e shihnin ligjin si të nevojshëm për mbajtjen e regjistrave të rëndësishme, dhe pritej që impakti i përgjithshëm i ligjit të ishte pozitiv. Megjithatë, nuk pati diskutime për mundësinë e (keq)përdorimit të ligjit, me synim pasivizimin masiv të një grupi social ose të pakicave etnike në Serbi. Megjithatë, pothuajse një vit pas hyrjes në fuqi të ligjit, ankesat e para për një praktikë të parregullt dhe arbitrare pasivizimi filluan të vinin nga Serbia Jugore. Shqiptarët nga komuna e Medvegjës dhe e Bujanocit ishin të parët që raportuan se Ministria e Punëve të Brendshme të Serbisë po vinte në dyshim vlefshmërinë e vendbanimeve të tyre të përhershme dhe ekzistuese dhe, më pas, po i pasivizonte dhe refuzonte t'u jepte letërnjoftime dhe pasaporta. [57] Për më tepër, deri në vitin 2012, kur u mbajtën zgjedhjet e para lokale në komunën e Medvegjës pas hyrjes në fuqi të *Ligjit për Vendbanim dhe Vendqëndrim*, një numër shqiptarësh raportuan se ishin të befasuar kur mësuuan se ishin larguar edhe nga lista e votuesve. Për të qenë të sigurt, numrat e rasteve të pasivizimit në jug të Serbisë në fillim ishin të vegjël, por shpejt u bë i qartë modeli i një pasivizimi me motivacion etnik: *autoritetet serbe po pasivizonin adresat e përhershme të shqiptarëve, po refuzonin të ripërtërinin dokumentet e tyre personale dhe pasaportat, dhe i largonin ata nga listat e votuesve*. Qytetarët e hequr nga regjistrat ankoheshin po ashtu, se

autoritetet përgjegjëse nuk u ofronin asnjë përgjigje të detajuar lidhur me procedurën. [58]

Në komunën e Medvegjës, ku shqiptarët përbëjnë shumicën e popullsisë në disa fshatra dhe vendbanime, shpejt u bë e qartë se politika e re e pasivizimit po zbatohet në mënyrë të pabarabartë për dy grupet kryesore etnike. [59] Ndërsa disa serbë të pasivizuar lokalë u ankuan për pengesat administrative si pasojë e statusit të pasivizimit, shqiptarët me status të pasivizuar ankoheshin për pamundësinë për të vazhduar jetën në vendet e tyre, për shkak të letërnjoftimeve të skaduara, të cilat autoritetet refuzuan t'ua jepnin. [60]

Paralelisht me këtë, duke filluar nga viti 2015, figurat politike me ndikim në Serbi, si dhe medie të ndryshme pranë qeverisë së Serbisë filluan ta quanin Medvegjën si “komunë serbe”. Pas vdekjes së papritur të kryetarit të kësaj komune, Slobodan Drašković, në shtator të vitit 2015 u mbajtën zgjedhjet e parakohshme. [61] Këto zgjedhje ishin, në shumë mënyra, një moment i rëndësishëm në fushatën e pasivizimit në jug të Serbisë. Së pari, vetëm dy ditë para ditës së zgjedhjeve, përfaqësuesit politikë shqiptarë miratuan deklaratën për krijimin e “Asociacionit të komunave me shumicë shqiptare në Luginën e Preshevës”, e cila sipas tyre do të ketë të njëjtat kompetenca gjyqësore dhe politike s. “Asociacioni i Komunave Serbe”, që Beogradi kërkonte ta krijonte në Kosovë. [62] Dhe, së dyti, mijëra shqiptarë praktikisht nuk u lejuan të votojnë në zgjedhjet lokale të vitit 2015 në Medvegjë. Më konkretisht, më 14 shtator 2015, një numër i madh i shqiptarëve të Medvegjës të shpërngulur gjatë konfliktit të vitit 2001 në Kosovë, si dhe profesionistë të rinj nga rajoni që punojnë në Prishtinë, studentë shqiptarë, si dhe pjesëtarë të diasporës shqiptare, u organizuan në një numër të madh për të votuar në zgjedhjet lokale në vendlindjen e tyre. Megjithatë, ata u ndalën në pikën kufitare “Mutivode”, mes Serbisë dhe

Kosovës, dhe nuk u lejuan të hyjnë në Republikën e Serbisë. Afërsisht “2000 shqiptarë të Medvegjës ishin organizuar në 28 autobusë dhe 250 mjete të tjera, kurse 63 mbetën duke pritur gjatë gjithë ditës në pikën kufitare “Mutivode”, dhe policia kufitare serbe nuk i lejoi të hyjnë në Serbi dhe, në fund, u detyruan të ktheheshin në Kosovë”. Shpjegimi zyrtar ishte se sistemi elektronik ishte ndërprerë, por arsyet e vërteta ishin politike dhe jo teknike, siç do të tregohet në javët dhe muajt e ardhshëm. Në vitin 2015, jo vetëm që zgjedhjet lokale në Medvegjë u mbajtën pa pjesëmarrjen e mijëra anëtarëve të pakicës shqiptare, por Partia Progressive Serbe (SNS), e cila kishte fituar vetëm 12% të votave në zgjedhjet e mbajtura në vitin 2012, tani fitoi një 65 për qindësh mbresëlënëse të votave të përgjithshme në vitin 2019.

Nebojsa Stefanoviq, ministri i Brendshëm i Serbisë, duke komentuar rezultatet e zgjedhjeve të parakohshme, deklaroi triumfalisht: *“Kjo është një fitore e madhe për ne. Realiteti është se Medvegja është komunë serbe në Republikën e Serbisë dhe do të qëndrojë atje”* dhe theksoi se interesat kombëtarë u mbrojtën në maksimum dhe ai ishte i kënaqur për këtë. [64] Në të njëjtën kohë, ministri Stefanoviq iu referua qytetarëve të Serbisë me përkatësi etnike shqiptare, të cilët u penguan të votojnë në vendlindjen e tyre, thjesht si *“njerëzit që u sollën nga Kosova me autobusë për të votuar”* dhe si *“persona pa letërnjoftime të vlefshme”*. Në këtë mënyrë ai e zhvendosi debatin nga vënia në pikëpyetje e legjitimitetit të zgjedhjeve, në vënie në dyshim të “autenticitetit” të votuesve të pakicës shqiptare. Ky diskurs i politikanëve të lartë serbë, që e paraqesin Medvegjën si një komunë “serbe” dhe propaganda e hapur në disa medie serbe për pretendimet e shqiptarëve për të ndryshuar strukturën kombëtare në jug, vazhdoi deri në vitin 2020. Mesazhi kryesor i transmetuar ishte, se shqiptarët ishin një kërcënim për Serbinë. Për shembull, shtëpitë që disa shqiptarë po ndërtonin në fshatrat e tyre, riparimet e rrugëve të vetëfinancuara e që

financoheshin kryesisht nga anëtarët e pasur të diasporës vendase shqiptare, të gjitha këto projekte u etiketuan si para që vinin nga “klane shqiptare”. Kishte edhe raporte të pabazuara rreth ndërtimit të xhamive të reja kudo, dhe paralajmërimet se po krijoheshin vendbanime të reja shqiptare në jug, me mbështetjen logjistike të politikanëve shqiptarë nga Tirana dhe Prishtina. [65]

Në shtator 2019, kur u mbajtën zgjedhjet e reja lokale në Medvegjë, një numër i madh i shqiptarëve nuk figuronte fare në listat e votuesve, për shkak të statusit të tyre të pasivizuar. Dragan Shormaz, një politikan i nivelit të lartë serb brenda Partisë Progresive Serbe (SNS), festoi fitoren historike të partisë së tij, duke theksuar në një status në “Twitter”: *“SNS-ja fiton mbi 65% të votave në Medvegjë! Dëshmi që shqiptarët nuk jetojnë më në Medvegjë, është se dy listat e tyre politike fituan me vetëm rreth 7% të votave”*. [66]

Pasivizimi i shqiptarëve në jug të Serbisë dhe kontekstet më të gjera gjeopolitike

Sipas ish-kryetarit të komunës së Preshevës, Shqiprim Arifi, pasivizimi masiv i shqiptarëve në Serbinë Jugore duhet kuptuar në kontekstin e planit të Serbisë për “shkëmbim tokash” dhe planeve të saj për të rishikuar kufijtë kombëtarë në Ballkan në përgjithësi. Sipas mendimit të tij, Serbia ka tentuar ta ulë numrin e shqiptarëve në jug përmes “pasivizimit” të adresave të tyre të banimit, me qëllim parandalimin e kërkesave politike të Kosovës lidhur me pakicën shqiptare në Luginën e Preshevës. Sipas tij, Serbia ka vite që ka bërë përpjekje për të krijuar Asociacionin e Komunave Serbe në Kosovë dhe pasivizimi masiv i shqiptarëve në jug të Serbisë ishte një masë parandaluese, që u përdor për t'i penguar ata të bënin të njëjtën kërkesë politike. “Në rast se Kosova do të dilte me kërkesë për Asociacionin e Komunave Shqiptare në

Serbinë jugore, Serbia dëshiron të jetë në gjendje të thotë: *“Cilët shqiptarë të Medvegjës, nuk kanë mbetur shqiptarë atje... dhe në lidhje me Bujanocin, statistikat tona tregojnë numra shumë më të ulët të shqiptarëve sesa po pretendoni”*. [67]

Në një intervistë të fundit me radion “Europa e lirë”, kryetari Arifi shpjegoi më tej këtë pikë, duke argumentuar: *“Nëse kthehemi pas në vitin 2011, vit kur filloi pasivizimi dhe deri në vitin 2018, kur filloi të qarkullonte ideja për rihartimin e kufijve, shihet qartë arsyeja pse autoritetet serbe synuan veçanërisht Medvegjën, dhe pse kjo është një komunë me numrin më të lartë të adresave të pasivizuara të banimit [në Serbi]. Ata e bënë këtë, thjesht për të thënë se në vitin 2019 kjo zonë specifike nuk është populluar nga shqiptarët, dhe në qoftë se janë, numri i tyre është shumë i ulët. Ky ishte një veprim i mirëplanifikuar kundër dialogut, jo vetëm kundër shqiptarëve në Luginën e Preshevës, por kundër dialogut [me Kosovën], sepse qëllimi ishte të forconte pozitën e Serbisë në tryezën e bisedimeve në Bruksel”*. [68]

Megjithatë, nuk ishin vetëm disa politikanë shqiptarë, që panë pasivizim masiv të shqiptarëve në Serbi në këtë kontekst. Aktivistja e njohur serbe për të drejtat e njeriut, Sonja Biserko, argumentoi: *“Për qeverinë serbe, Serbia Jugore është pjesë e historisë së Kosovës: Serbia dëshiron ta ulë numrin e shqiptarëve në jug me çdo mjet. Kjo është vetëm një vazhdimësi e një politike të vjetër”*. [69] Sipas mendimit të saj, jugu i Serbisë është një rajon gjeostrategjik i rëndësishëm për Serbinë. Prandaj, i gjithë debati për “shkëmbimin e Luginës së Preshevës në veri të Kosovës, ishte thjesht një parandalim për ta bërë idenë e ndryshimeve të kufijve të besueshëm, sepse Serbia nuk do t’i kishte dorëzuar tri komuna të jugut, ku është e përqendruar pakica shqiptare, për shkak të rëndësisë gjeostrategjike. Qëllimet e vërteta territoriale të qeverisë së Serbisë ishin veriu i Kosovës dhe Republika Serbe. [70] Një mënyrë tjetër për të menduar për pasivizimin e shqiptarëve në Serbi

është që të krahasohet me pakicat e tjera në vend. Serbia i ka njohur zyrtarisht 19 komunitete pakicash, që tradicionalisht gëzonin statuse të ndryshme në vend. Për këtë studim u konsultova me Këshillin Kombëtar të Pakicës Hungareze në Serbi, dhe i pyeta ata, nëse anëtarët e këtij komuniteti pakicash janë përballur me problemet e pasivizimit të vërejtura në mesin e shqiptarëve në Serbi.

Nevojitet një studim më i detajuar, por deri më tani përfaqësuesit e pakicës hungareze u përgjigjën duke thënë, se *“pasivizimi i adresave të përhershme nuk ishte një nga problemet, dhe ata nuk regjistruan asnjë rast, ku anëtarëve të komunitetit të tyre iu refuzuan kartat e identitetit ose pasaportat nga Ministria e Punëve të Brendshme”*. [71] Përveç kësaj, organizatat e njohura të të drejtave të njeriut në Serbi, siç janë Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi dhe përfaqësuesit e OSBE-së, gjithashtu deklaruan, se *“asnjë grup tjetër pakicash, përveç shqiptarëve, nuk iu afrua atyre me ankesa në lidhje me pezullimin e adresave të përhershme dhe refuzimin e autoriteteve shtetërore për t'u lëshuar letërnjoftimet dhe pasaportat”*. [72]

Përfundime

Ky artikull hulumtoi politikën e Serbisë për statusin pasivizues të pakicës shqiptare në jug të Serbisë. U analizua se si *Ligji për Vendbanim dhe Vendqëndrim* u zbatua në zonat ku kishte popullsi kryesisht shqiptare dhe ofroi njohuri në përpjekjet e qytetarëve të pasivizuar, për t'i riaktivizuar adresat e tyre të përhershme të banimit. Bazuar në të dhënat që nxora nga anketimi me 1 000 shqiptarë me status të pasivizuar dhe mbi njëqind intervistime individuale me aktorë të ndryshëm, konkludoj se autoritetet serbe synuan pasivizimin masiv dhe selektiv, veçanërisht në komunën e Medvegjës dhe të Bujanocit dhe në një masë më të vogël në Preshevë. Ky

studim tregoi se pasivizimi i adresave të përhershme të banimit në zonat shqiptare në jug të Serbisë ka qenë masiv dhe sistematik. Ai ka ndodhur paralelisht me bisedimet e ndihmuara nga BE-ja, midis Kosovës dhe Serbisë, për normalizim të marrëdhënieve, dhe u intensifikua pas propozimit për shkëmbim territoresh në periudhën 2015-2019. Duket se jo vetëm që zonat me popullsi shqiptare kanë shkallën më të lartë të statusit të pasivizimit në Republikën e Serbisë, por rasti i Medvegjës tregon se ky proces u shoqërua nga një pastrim masiv i votuesve shqiptarë nga listat e votuesve, duke ulur kështu shumë përfaqësimin e tyre politik në të gjitha nivelet. Ky veprim për pasivizim të adresave të përhershme, që është zbatuar nga Ministria e Punëve të Brendshme të Serbisë, po bën shumë shqiptarë në jug të Serbisë që të konsiderohen, faktikisht, si persona pa shtetësi.

Ka shumë prova që flasin se institucionet kryesore shtetërore po veprojnë në një mënyrë të koordinuar në këtë proces: Ministria e Brendshme, gjykatat, komisioni zgjedhor, si dhe media e afërme me qeverinë. Sikurse tregoi ky artikull, *Ligji për Vendbanim dhe Vendqëndrim*, i cili rregullon statusin e qëndrimit për qytetarët e Serbisë, nuk është domosdoshmërisht diskriminues. E thënë thjesht, diskriminimi nuk konstatohet në ligj, por në mënyrën se si po zbatohet nga organet kompetente shtetërore. Shqiptarët jo vetëm që po pasivizohen pa e ditur, por po u refuzohet vendimi zyrtar me shkrim nga Ministria e Brendshme dhe nuk po u jepen letërnjoftime të reja nga shteti. Nga 1 000 shqiptarë me status të pasivizuar, më pak se 18% kanë marrë një vendim me shkrim për pasivizim. Edhe në ato raste, autoritetet nuk përmendin se shqiptarëve u janë refuzuar letërnjoftimet dhe pasaportat. Megjithatë, në realitet, mbi 500 të anketuar deklaruan se nuk kanë mundur t'i ripërtërinin letërnjoftimet e veta, për shkak të statusit të pasivizuar. Për më tepër, raportet e autoriteteve shtetërore për status pasivizues nuk janë koherente dhe nuk paraqesin gjendjen faktike në terren. Ata dhanë të dhëna

mjaft të sakta, kur pasivizimi nuk ishte një problem, dhe ulën shifrat në momentin kur ai arriti në Parlamentin Europian. Për shkak se fushata e pasivizimit ka shënjestruar dhe prekur shqiptarët në një mënyrë të veçantë, autoritetet as nuk kanë dhënë një ndarje etnike të rasteve të pasivizuara dhe as nuk i kanë vënë listat e votuesve në dispozicion për shqyrtim për vëzhguesit e pavarur. Listat e votuesve janë, megjithatë, dëshmi të rëndësishme për pasivizim, sepse ato paraqesin numrin më të afërt të qytetarëve faktikisht të pasivizuar, në jug të Serbisë.

Megjithatë, ato nuk ofrojnë numrin e plotë të rasteve të pasivizuara, ashtu siç tregoi ky studim, sepse Ministria e Punëve të Brendshme ka fshirë adresat edhe të atyre shqiptarëve që kishin regjistruar vendbanimet e tyre jashtë vendit tek autoritetet relevante shtetërore të Serbisë. Numrat janë më të lartë, sepse shpeshherë fëmijët shqiptarë janë fshirë bashkë me prindërit e tyre nga regjistri civil. Si Kosova, ashtu edhe Shqipëria, nuk e kanë adresuar pasivizimin sistematik të pjesëtarëve të pakicës shqiptare në Serbi. Në fakt, Kosova dhe Shqipëria kanë ndjekur një politikë të vakët në lidhje me angazhimin ndaj pakicës shqiptare në Serbi që nga përfundimi i Luftës së Kosovës në vitin 1999. [73] Për më tepër, Prishtina dhe Tirana e kanë inkurajuar pakicën shqiptare në Serbi që të kërkojë integrim në institucionet shtetërore serbe pas përfundimit të Luftës së Kosovës, meqë shpresonin se kjo do të zbuste rezistencën e pakicës serbe ndaj shtetit të pavarur të Kosovës. Në vitin 2018, kur ish-presidenti i Kosovës dhe presidenti i Serbisë filluan të flasin hapur në favor të “shkëmbimit të territoreve”, si pjesë e së cilës zonat e banuara me shqiptarë nga jugu i Serbisë supozohej se do t'i bashkoheshin Kosovës dhe pjesë të veriut të Kosovës, të dominuara nga serbët, do t'i bashkoheshin Serbisë, shumë shqiptarë në Serbinë Jugore ishin në mëdyshje.

Në këtë moment, mijëra prej tyre ishin tashmë me status të pasivizuar pa e ditur, kurse nga Ministria e Punëve të Brendshme serbe u refuzohej dhënia e letërnjoftimit personal dhe pasaporta. Në të vërtetë, ky studim zbuloi po ashtu se, megjithëse disa aktivistë politikë shqiptarë nga jugu i Serbisë i kishin informuar rregullisht zyrtarët e shteteve të Kosovës dhe të Shqipërisë për sfidat e tyre me politikën e pasivizimit në Serbi, asnjëra palë nuk pranoi t'i njihte këto probleme për vite të tëra dhe nuk u ofroi asnjë lloj ndihme ligjore ose financiare për t'i adresuar ato deri në vitin 2022. [74]

Shënim: Ky studim është publikuar nga instituti “Max Planck” për studime të diversitetit fetar dhe etnik”, Göttingen, në anglisht. Ndërkaq, përkthimin në shqip e mbështeti KKSH në Serbi.

Dy fjalë për autoren

Flora Ferati-Sachsenmaier aktualisht është pedagoge në Universitetin e Göttingen-it, në programin për eurokulturë: *Shoqëria, politika dhe kultura në kontekstin global*. Përqendrimi kryesor kërkimor i saj përfshin dinamikat e konfliktit, proceset e ndërtimit të paqes në territore politikisht të kontestuara dhe ndërveprimet e shoqërisë civile globale dhe lokale në shoqëritë pas konflikteve. Dr. Ferati-Sachsenmaier ka fituar gradën e doktoratës në temën “Qeverisja globale dhe integrimi rajonal” në *Bremen International School, Graduate School of Social Sciences* (BIGSSS) në vitin 2015. Po atë vit, ajo u bë pedagoge në Institutin e Sociologjisë, në Universitetin e Göttingen-it, si dhe e ftuar, bashkëpunëtoare akademike në institutin “Max Planck” për studime të diversitetit fetar dhe etnik, ku kreu kërkime dhe ligjëroi në lëndët që trajtonin përpjekjet për pajtim ndëretnik në Ballkan, ndryshimet në rolin e lëvizjeve të grave në Ballkan, dhe tjetërsimin fetar. Dr. Flora Ferati-Sachsenmaier ka lindur në Topallë [Medokë / Medvegjë] dhe jeton në Göttingen [Gjermani].

Fusnota

1. Sipas regjistrimit të vitit 2002, i cili njihet si regjistrimi i fundit i besueshëm, në Serbi jetonin 61647 shqiptarë.
2. Shih, për shembull: *Fond za Humanitarno Pravo*. (2003). Albanci u Srbiji: Peševo, Bujanovac i Medveđa [Albanians in Serbia - Peševo, Bujanovac and Medveđa]. <http://www.hlc-rdc.org/?p=13395>; Human Rights Watch. (2008). Hostages of Tension: Intimidation and Harassment of Ethnic Albanians in Serbia after Kosova's Declaration of Independence. <https://www.hrw.org/reports/2008/serbia1108/>; Helsinki Committee for Human Rights in Serbia. (2009). Annual Report: Serbia 2009. Human Rights, Democracy and Violence.

<http://www.helsinki.org.yu/doc/Report2008.pdf>; Helsinki Committee for Human Rights in Serbia. (2021). Albanian Minority on Hold: Preševo, Bujanovac and Medveđa as Hostages of the Serbia and Kosova Relations. <https://www.helsinki.org.rs/doc/izvestaj%20presevo%20eng.pdf>.

3. Shih raportin *UN Inter-Agency Assessment Mission to Southern Serbia-Serbia*, f. 17.
4. Për detaje më të plota, shih *Misionin vlerësues ndërmjet agjencive të OKB-së në jug të Serbisë*, f. 17-18.
5. Marrëveshja e Konçulit është nënshkruar ndërmjet Shefqet Musliut (Komandant i UÇPMB-së) dhe Shawn F. Sullivan (Shef i Zyrës së NATO-s në RFJ), më 20 maj 2001.
6. Plani Çoviq e mori emrin sipas Nebojshta Çoviqit, atëherë ishte zëvendëskryeministër i Serbisë. Plani synonte të adresonte diskriminimin institucional të shqiptarëve në Serbi dhe t'u ofronte atyre një plan për integrim në Republikën e Serbisë. Plani kishte katër shtylla kryesore: 1) “eliminimin” e kërcënimeve ndaj sovranitetit të shtetit dhe integritetit territorial, 2) sigurinë, lirinë e lëvizjes dhe të drejtën për kthim në Luginën e Preshevës (një term tjetër i përdorur për t’iu referuar tri komunave me popullsi kryesisht shqiptare në jug të Serbisë), të kushtëzuara me çarmatim dhe shpërbërje të UÇPMB-së; 3) zhvillimin e një shoqërie shumë-etnike dhe shumëkonfesionale; dhe 4) zhvillimin ekonomik dhe shoqëror.
7. Trupi Koordinues ishte mekanizmi kryesor institucional i Beogradit, i cili u lansua në vitin 2000, me qëllim zbatimin e “Planit Çoviq” në jug të Serbisë. Në vitet e para, ai u drejtua nga vetë Nebojshta Çoviq dhe për një periudhë kohore personeli i tij përbëhej vetëm nga zyrtarë të lartë serbë/jugosllavë dhe përfshinte gjashtë gjeneralë. Roli kryesor i

tij ishte të parandalonte kthimin e një konflikti të armatosur në rajon dhe të koordinonte politikën e shtetit në jug në të gjitha fushat e jetës, duke përfshirë kulturën dhe menaxhimin e forcave të sigurisë në terren.

8. Këtu përfshiheshin çështje të tilla, si mosnjohja e diplomave të shqiptarëve nga Serbia që studiojnë në universitetet e Kosovës, deri në lehtësimin e kthimit të të zhvendosurve shqiptarë nga Serbia Jugore, që aktualisht banojnë në Kosovë.
9. ICG raportoi në vitin 2006, se Trupi Koordinues ka shpërndarë buxhetin e tij të zhvillimit ekonomik dhe investimeve haptazi në bazë të etnicitetit. Në mënyrë të veçantë, ICG zbuloi se Trupi Koordinues kishte shpërndarë 178 euro për banor në komunën e Medvegjës, ku serbët përbëjnë mbi 60 për qind të popullsisë; 43 euro për banor në komunën e Bujanocit, ku serbët janë 34 për qind të popullsisë, dhe në komunën e Preshevës/Preševës, ku serbët përfaqësojnë mbi 8 për qind të popullsisë, ka shpërndarë vetëm 31 euro për banor. Për më shumë shih detaje, Grupi Ndërkombëtar i Krizave (ICG). “Southern Serbia: in Kosova’s Shadow.” Policy Briefing: Europe Briefing No 43, Belgrade/Pristina/ Brussels, 27 June 2006.
10. Sipas një studimi të kryer nga Këshilli Kombëtar Shqiptar në Serbi, i publikuar në janar 2022, shqiptarët ishin të nënvlerësuar në të gjitha nivelet e institucioneve publike, si dhe në të gjitha ndërmarrjet e shtetit që operonin në jug të Serbisë. Për shembull, ata zbuluan se, edhe pse shqiptarët përbëjnë shumicën e popullsisë në komunat e Preshevës/Presheves dhe Bujanocit/Bujanocit, asnjë shqiptar i vetëm nuk u emërua prokuror; vetëm 13 nga 91 doganierë të punësuar ishin shqiptarë; në resortet shëruese, si në Banja e Sijarinës dhe Banja e Bujanocit, vetëm katër nga gjithsej 150 punëtorë ishin shqiptarë,

ndërsa në kompaninë shtetërore të komunikacionit “Srbija Putevi”, vetëm 6 nga 67 persona të punësuar ishin shqiptarë. Të dhënat janë vënë në dispozicion për këtë studim nga Këshilli Kombëtar Shqiptar në Serbi. Për një studim të ngjashëm krahasues, shih *International Crisis Group*. “*Southern Serbia: in Kosova’s Shadow*”, Policy Briefing: Europe Briefing No 43, Belgrade/Pristina/Brussels, 27 qershor 2006.

11. Sipas definicionit të dhënë të nenit 3, paragrafi 2, i *Ligjit për Vendbanim dhe Vendqëndrim*. Shih për më shumë hollësi: *Ligji për Vendbanim dhe Vendqëndrim 2011*. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë, numër 87/2011) neni. 3.2 & neni. 18 (përkthim nga SRB).
12. Shih *Ligjin mbi Zgjedhjet Lokale 2007*. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë, nr. 129/2007, e amenduar për herë të fundit 2020) neni 6.1 (përkthim nga SRB.). Prandaj, për shembull, adresa e përhershme është një nga tri të dhënat e detajuara, që figurojnë në listat e votuesve dhe pranë tyre është shënuar emri i secilit qytetar, që ka të drejtë të votojë në zgjedhjet lokale në Republikën e Serbisë.
13. Në Republikën e Serbisë, letërnjoftimet dhe pasaportat lëshohen nga departamenti i caktuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Serbisë.
14. Shih Zan Strabac and Marko Valenta. (2016). *Social Distance Toward Ethnic Minorities in Croatia, Serbia, Montenegro, Macedonia and Kosova: A Comparative Analysis*. In S. P. Ramet et al. (Eds.), *Ethnic Minorities in Post-Socialist Southeastern Europe* (Cambridge, UK: Cambridge University Press). Iliry Zylfiu, Dukagjin Leka, Valbona Ahmeti Zylfiu. (2017). Albanian Minority in Serbia. *Acta Universitatis Danubius: Relationes Internationales*, 10 (2), 60-75; Acta Abdullah Sencer Gözübenli. (2019). Border Vs. Numbers: Albanian National

Minority in the South Serbia Between Nation Building in Kosova and EU Member Building. KNUV, 2 (60), 81-100; Beáta Huszka. (2007). The Presevo Valley of Southern Serbia alongside Kosova: The Case for Decentralization and Minority Protection. CEPS Centre for European Policy Studies, 1 (12), 01-11. Jasemine Kamberi. (2019). 'The Other' of Serbia: The Albanians. INSAMER, 23.10; Ljubica Djordević. (2020). Legal Aspects of Processing of National Affiliation Data in Serbia. Journal on Ethnopolitics and Minority Issues in Europe, 19 (2), 76-106.

15. Toponimi “Lugina e Preshevës” është mjaft i ri dhe përdoret kryesisht nga shqiptarët. Ata e përdorin toponimin “Lugina e Preshevës” për të nënkuptuar karakterin shqiptar të rajonit, i cili në kuptimin e tyre kolektiv ka tri tipare kryesore: homogjenitetin etnik të popullsisë shqiptare, historinë e përbashkët, identitetin, kulturën dhe ndjenjën e përkatësisë politike për të tria komunat. Serbët shmangin përdorimin e toponimit “Lugina e Preshevës” dhe në vend të saj përdorin “Lugina e Moravës”.
16. Presidenti Hashim Thaçi tha se vetëm Lugina e Preshevës do t'i bashkohet Kosovës dhe përsëriti se Kosova as nuk do të ndahet dhe as serbët e Kosovës nuk do të marrin autonomi, e megjithatë në të njëjtën kohë foli edhe për nevojën e “kompromiseve të dhimbshme”.
17. Megjithatë, emrat e të anketuarve janë zbuluar dhe pikëpamjet e tyre janë prezantuar hapur në artikull, me pëlqimin e të anketuarve. Për më tepër, në këto raste dalin me status të pasivizuar shqiptarët, të cilët kanë shkruar për sfidat e tyre në gazetata e përditshme.
18. Komunikimi personal, përfaqësues i degës së Këshillit Kombëtar Shqiptar (KKS) në Medvegjë, 17 korrik, 2021.

- 19.** Numrat zyrtarë të popullsisë për komunat e listuara i kam marrë nga Enti Statistikor i Republikës së Serbisë. Shih hollësitë: *Republika Srbija: Republički Zavod za Statistiku (2014). 2011 Popis stanovništva, domačinstava i stanova 2011*, u Republici Srbiji: Uredni pregled broja stanovnika 1948, 1953, 1961, 1971, 1981, 1991, 2002 i 2011, godine [Byroja e Statistikave të Republikës (2014). Censusi i Popullsisë, Shtëpive dhe Banesave 2011 në Republikën e Serbisë]. Marrë nga <https://pod2.stat.gov.rs/ObjavljenePublikacije/Popis2011/Knjiga20.pdf>. mun Kërkuar së fundmi me: 10 shtator 2021.
- 20.** *Zëri i Amerikës*. (2019, October 13). *Jeta e shqiptarëve në komunën e Medvegjës* [Life of Albanians in the Municipality of Medvegja], [Video]. <https://www.youtube.com/watch?v=uHvc7ZluIQU>; Euronews Albania (2020, 24 November). Shpopullimi i shqiptarëve të Medvegjës, Muharrem Salihu: Kosova dhe Shqipëria të mos ndalen në deklaratat [The Depopulation of Albanians of Medvegja, Muharrem Salihu: Kosovo and Albania to do more than Issue Statements]. Euronews Albania. <https://euronews.al/al/rajoni/2020/11/24/shpopullimi-ishqiptareve-te-medvegjes-muharrem-salihu-kosova-e-shqiperia-te-mos-ndalen-ne-deklarata/>. Në gjysmën e dytë të vitit 2020, përfaqësuesit politikë shqiptarë nga komuna e Bujanocit dhe e Preshevës filluan ta ngrenë çështjen e pasivizimit shumë më shpesh në media, shih për shembull: *Koha Ditore*. (22 nëntor 2020). Kamberi: *Pasivizimi i adresave të shqiptarëve po ndryshon strukturën etnike në Luginën e Preshevës* [Passivization of Addresses of the Albanians is Altering Ethnic Structure in the Presevo Valley]. *Koha Ditore*.
- 21.** Letra zyrtare u bë e disponueshme për këtë studim nga përfaqësuesit politikë shqiptarë. Ajo mund të kërkohet nën numrin 01-8409/20-2, më 9 dhjetor, 2020. Ministarstvo Unutrašnjih Poslova Srbije,

Narodnoj Skupštini: Narodnom Poslaniku Šaipu Kamberiju [Ministria e Punëve të Brendshme të Serbisë, Kuvendi i Serbisë: Deputeti i Kuvendit, Shaip Kamberi].

22. Përgjigjja e dytë e ministrit të Punëve të Brendshme të Serbisë për z. Shaip Kamberi mund të gjendet nën numrin 01-8409/20-4, më 6 prill 2021. Ministarstvo Unutrašnjih Poslova Srbije, Narodnoj Skupštini: Narodnom Poslaniku Šaipu Kamberiju [Ministria e Punëve të Brendshme të Serbisë, Kuvendi i Serbisë: Deputeti i Kuvendit, Shaip Kamberi].
23. Letra u bë e disponueshme për mua nga zyra e Kryetarit të Preshevës, Shqiprim Arifi. Përgjigjja zyrtare mund të kërkohet nën numrin e mëposhtëm: 205-1259/20, 13 prill 2020. Ministarstvo Unutrašnjih Poslova: Direkcija Policije, Policijska Uprava Leskovac: Opština Preševo, Kabinet Predsednika Opštine [Ministria e Punëve të Brendshme: Drejtoria e Policisë, Administrata e Policisë Leskovc: Komuna e Preshevës, Zyra e Kryetarit të Komunës].
24. Në fakt, një grup eurodeputetësh kishin parë prova të mjaftueshme, prandaj propozuan një amendament/rezolutë për “Raportin e Komisionit 2019-2020 për Serbinë”, i cili dënonte problemin e pasivizimit selektiv të adresave të banimit dhe shënjestrimin e pjesëtarëve të pakicës shqiptare në Serbi. Shih për më shumë detaje rezolutën e 54-t të “Raportit të Komisionit 2019-2020 për Serbinë”.
25. Të dhënat shifrore i kam nxjerrë nga Enti Statistikor i Republikës së Serbisë.
26. Si rezultat, shqiptarët, për herë të parë, mbetën jashtë pushtetit lokal në Medvegjë.
27. Kjo ndoshta ndodhi, sepse informacioni i rëndësishëm për statusin e adresave të tyre të përhershme të banimit nuk u dërgua në Regjistrin e

Votuesve. Disa aktivistë politikë shqiptarë, megjithatë, e panë këtë gjithashtu si një strategji të autoriteteve shtetërore për të krijuar konfuzion në mesin e anëtarëve të pakicës shqiptare, si dhe për të bërë gjithë procesin, vështirë të kuptueshëm.

- 28.** I anketuari shqiptar nga Medgjeva [78], komunikim personal, 18 shkurt 2021.
- 29.** Participant 24, Albanian from a village of Bujanoc/Bujanovac, 24 October 2020.
- 30.** I anketuari 5, shqiptar nga Bujanoci, komunikim personal, 15 maj 2020. E kam ndryshuar vitin e pasivizimit për këtë rast, në mënyrë që të parandalohet ndjekja e mundshme nga autoritetet serbe.
- 31.** I anketuari 31, komunikim personal, 13 maj 2021.
- 32.** Duke qenë se kisha veçanërisht njohuri për këtë rast familjar, arrita ta marr ankesën me shkrim drejtuar autoriteteve, të cilën personi në karrocë e kishte shkruar me dorë. Në të, ai theksonte gjendjen e tij shëndetësore dhe përshkruante në hollësi se si statusi i tij i pasivizuar kishte ndikuar tek e gjithë familja.
- 33.** I anketuari 30, qytetar shqiptar nga një fshat në Medvegjë/Medveđa, komunikim personal, 15 korrik 2021.
- 34.** Ai kishte ende një kartelë personale të vlefshme.
- 35.** Pata mundësinë ta vërtetoj, se personi me sëmundje kronike vërtet ishte pezulluar nga lista zgjedhore në vitin 2019 për zgjedhjet lokale që u mbajtën në komunën e Medvegjës.
- 36.** I anketuari 5, shqiptar nga Medvegja, komunikim personal, 2020.
- 37.** I anketuari 5, shqiptar nga Medvegja, komunikim personal, 2020.
- 38.** I anketuari 5, shqiptar nga Medvegja, komunikim personal, 2021.
- 39.** Përgjigje zyrtare për të anketuarin 5.

40. Megjithatë, sipas rrëfimit të pensionistes, fqinjët e saj kishin rrëfyer se policia nuk i kishte bërë kurrë këto pyetje.
41. Gjatë punës sime në terren, kam folur me dhjetëra shqiptarë të pasivizuar nga ky rajon, të cilët kishin qëndrim të përkohshëm jashtë vendit ose studionin jashtë Serbisë. Ata të gjithë shprehën dëshirën për të mbajtur nënshtetësinë serbe, dhe ishin të shqetësuar veçanërisht për qasjen në pronën e tyre në Serbinë Jugore për një periudhë afatgjatë.
42. Shih H.D. (2020, June 18). Administrativno Etnčko Čišćenje Albanaca [Pastrimi etnik i shqiptarëve përmes masave administrative]. Danas. <https://www.danas.rs/drustvo/administrativno-etnicko-ciscenje-albanaca/>; dhe Helsinski Odbor za Ljudska Prava u Srbiji (2020, June 17). Otvoreno Pismo Povodom Nezakonitog Brisanja iz Biračkog Spiska Većeg Broja Gradana Albanske Nacionalnosti na Teritoriji Opštine Medveda [Letër e hapur lidhur me fshirjen e paligjshme nga lista zgjedhore e një numri të madh shtetasish me përkatësi etnike shqiptare në territorin e komunës së Medvegjës. Marrë nga https://www.helsinki.org.rs/serbian/aktuelnosti_t447.html.
43. Shih “Serbia vazhdon pasivizimin e adresave të shqiptarëve në Luginën e Preshevës” [Serbia Continues to Passivize Albanians of the Presevo Valley], 3 nëntor 2020, *Telegrafi*, qasur në <https://telegrafi.com/serbia-vazhdon-pasivizimin-e-adresave-te-shqiptareve-ne-luginen-e-presheves-teuta-fazliuviktima-e-radhes/>.
44. Sipas të dhënave të marra nga OJQ “Trojet”, e cila përfaqëson shqiptarët e zhvendosur brenda vendit nga Luginës së Preshevës në Kosovë, dhe bazuar në komunikimin me përfaqësuesit e Zyrës për Preshevën, Medvegjën dhe Bujanocin në komunën e Gjilanit.
45. Intervista personale, përfaqësues i Zyrës për Preshevën, Medvegjën dhe Bujanocin në Gjilan, Kosovë, më 5 korrik 2021.

46. Shih *Gazeta Zyrtare* e RS-së, nr. 87/2011, neni 1.
47. Shih për hollësi *Gazeta Zyrtare* e RS-së, nr. 87/2011, neni 3, paragrafët 1 dhe 2.
48. Po aty, neni 5.
49. Kjo është parashikuar në nenin 2, paragrafi 2 i *Ligjit për Vendbanim dhe Vendqëndrim*.
50. Po aty, neni 13.
51. Po aty, neni 19.
52. Po aty, neni 19, paragrafi 2.
53. Shih për më shumë hollësi “Pravno Informacioni Sistem Republike Srbije,” Zakon o Lokalnim Izborima [Ligji mbi Zgjedhjet Lokale], neni 6, paragrafët 1 dhe 2, marrë nga: <https://www.pravno-informacioni.sistem.rs/SIGlasnikPortal/eli/rep/sgrs/skupstina/zakon/2007/129/3/reg>.
54. Ligji nuk i referohet këtij skenari.
55. Shih *Gazetën Zyrtare* të RS-së, nr. 87/2011, neni 17, përkthim i autores.
56. Shih Marinković, D. (2015, 9 shtator). *U Medveđi Duplo Više Glasaca Nego Stanovnika* [Në Medvegjë - votues dy herë më shumë se banorë]. *Južne Vesti*. Marrë nga: <https://www.juznevesti.com/Drushtvo/U-Medvedji-duplo-vise-glasaca-nego-stanovnika.sr.html>.
57. Intervistë personale me Femi Behën, këshilltar politik shqiptar nga Medvegja, 2020. Për të mësuar më shumë se si anëtarët e pakicës shqiptare e shprehnin betejën e tyre kundër statusit të pasivizimit në pesë vitet e para, shih: *Al Jazeera Balkans*. (2016, qershor 16). *Pasiviziranje Prebivališta Albancima iz Medvede [Pasivizimi i*

adresave të banimit të shqiptarëve nga Medvegja. [Video]. YouTube.
<https://www.youtube.com/watch?v=rRJWp1-gsWs>.

58. Intervistë personale me një ish-këshilltar komunal.
59. Shqiptarët përbëjnë shumicën e popullsisë në fshatrat e mëposhtme të Medvegjës: Tupallë, Gjylekreshtë, Llapashticë (e Epërme dhe e Poshtme), Kapit, Sijarinë, Rama Banjë, Stara Banjë, Svircë, Gërbac, si dhe në pjesë të qytetit të Banjës së Sijarinës dhe Medvegjës.
60. Pjesëmarrësi 52, shqiptar nga Medvegja, komunikim personal, 2019
61. Sllobodan Drašković kishte një mandat të gjatë politik në Medvegjë. Ai ishte në pushtet për gati 15 vjet. Ndonëse ishte i afërt me qarqe të ndryshme qeveritare në Beograd, në zgjedhjet lokale ka marrë pjesë kryesisht si kandidat jopartiak. Kjo e bëri atë kandidat të favorshëm për kryetar bashkie në mesin e shqiptarëve vendas, me të cilët krijonte shpesh koalicione qeverisëse, në pjesën më të madhe të mandatit të tij politik. Partitë nacionaliste serbe, si SNS (Partia Progressive Serbe), e akuzonin shpesh për “afërsinë me shqiptarët”.
62. Shih hollësitë, Zijadin Gashi, (12 shtator 2015). *Lugina voton për Asociacionin e Komunave Shqiptare* [The Presevo Valley Votes for Association of Albanian Municipalities]. Radio *Europa e Lirë*.
<https://www.evropaelire.org/a/27243833.html>.
63. Komunikim personal me Femi Behën, këshilltar politik shqiptar në komunën e Medvegjës.
64. Shih Stefanović: *Medveđa se nalazi u Republici Srbiji i tu će i ostati* [Stefanović: Medvegja ndodhet në Republikën e Serbisë dhe aty do të mbetet, (14 shtator 2015). TRT.
<https://www.trt.net.tr/bosanski/region/2015/09/14/stefanovic-medveda-se-nalazi-u-republicisrbiji-i-tu-ce-i-ostati-1-52420>

- 65.** Për njohuri mbi fushatën kundër shqiptarëve në jug të Serbisë që nga viti 2015, shih për shembull, debatin mes kryetarit të qytetit të Leskovcit, Goran Cvetanoviq, dhe këshilltarit politik nga opozita, Nenad Zdravkoviç: Dragan Marinkoviç. (14 dhjetor 2018). O Kosovu i u Leskovačkoj Skupštini: Mi smo sledeći, Albanci već kupuju parcele u Lebanu da grade džamije! [Debati për Kosovën në Kuvendin e Leskocit: *Ne e kemi radhën, shqiptarët tashmë po blejnë tokë në Lebanë, për të ndërtuar xhami!*]. *JuGmedia*. <https://jugmedia.rs/o-kosovu-i-u-leskovackoj-skupstini-mi-smo-sledeci-albanci-veckupuju-parcele-u-lebanu-da-grade-dzamije/>; Jug Srbije na večitom udaru Albanca: Vijore zastave, gradi džamija i sve to pred vratima srpskog naroda [Jugu i Serbisë është nën kërcënim të vazhdueshëm nga shqiptarët: Flamujt valojnë, një xhami po ndërtohet dhe e gjithë kjo në pragun e popullit serb]. (28 gusht 2020). *Srbija Danas*. <https://www.srbijadanas.com/vesti/info/jug-srbije-na-vecitom-udaru-albanaca-vijore-se-zastave-gradidzamija-i-sve-pred-vratima-srpskog-2020-08-28>.
- 66.** Shih Dragan Shormaz [@dragansormaz]. (8 shtator 2019). #SNS preko 65% u Medvedji! Dokaz da Albanci više ne žive u Medvedji je to što su dve list dobile oko 7%. Izašlo 66%, što je u realnosti (oni koji se vode u spisku, a negde su u inostranstvu poslom naravno nisu glasali) preko 80%. Toliko u bojkotu! [SNS fitoi më shumë se 65% të votave në Medvegje! Një provë se shqiptarët nuk jetojnë më në Medvegje është se dy prej listave të tyre arritën të marrin vetëm rreth 7% të votave. Pjesëmarrja e votuesve ishte 66%, por në realitet ishte mbi 80% (duke marrë parasysh se ata që ende janë në listë, por janë jashtë vendit për shkak të punës, nuk votuan natyrisht). Kaq sa i përket bojkotit”. *Twitter*. <https://twitter.com/dragansormaz/>

status/1170769135137107970?F; and Lokalni Izbori u Medvedi. Naprednjaci: Osvojili smo više od 65 odsto glasova [Zgjedhjet Lokale në Medvegjë. Partia Progressive Serbe fiton mbi 65 për qind të votave]. (9 shtator 2019). Blic. <https://www.blic.rs/ vesti/politika/lokalni-izbori-u-medvedji-naprednjaci-osvojili-smo-vise-od-65-odsto-glasova/c9p7t80>.

67. Korrespondencë personale me Shqiprim Arifi, kryetar i komunës së Preshevës, 19 shkurt 2021
68. Branko Vučković, (26 janar 2021). Presdsednik Opštine Preševo: Brisanje prebivališta Albancima u Srbiji moralni zločin [Kryetari i Komunës së Preshevës: Fshirja e adresave banuese të shqiptarëve në Serbi është një krim moral]. Radio *Europa e Lirë*. <https://www.slobodnaEuropa.org/a/šciprim-arifi-politika-brisanja-prebivalištaalbancima-u-srbiji-moralni-zločin/31069346.html>.
69. Intervistë individuale me Sonja Biserkon, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi, 2 qershor 2021.
70. Intervistë individuale me Sonja Biserkon, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi, 2 qershor 2021.
71. Korrespondencë individuale, Emir Suljagic, Këshilli Kombëtar Hungarez në Serbi, 11 tetor, 2021.
72. Korrespondencë individuale me Sonja Biserkon, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi, 2 qershor 2021; dhe përfaqësues të OSBE-së në Serbi, 19 shkurt 2020.
73. Me përjashtim të disa projekteve *ad hoc*, ata nuk ofruan ndihmë të dukshme për zhvillimin e kulturës, sportit dhe infrastrukturës për pakicën shqiptare në Serbi.

Referenca

1. *Al Jazeera Balkans*. (2016, June 16). Pasiviziranje Prebivaliŝta Albancima iz Medvede. [Video]. YouTube. <https://www.youtube.com/watch?v=rRJWp1-gsWs>.
2. *Koha Ditore*. (22 November, 2022). Kamberi: Pasivizimi i adresave tē shqiptarēve po ndryshon strukturēn etnike nē Luginēn e Preshevēs. *Koha Ditore*. <https://www.koha.net/arberi/246712/kamberi-pasivizimi-i-adresave-te-shqiptareve-po-ndryshon-struk-turen-etnike-ne-luginen-epresheves/>.
3. Djordeviċ, Ljubica. (2020). Legal Aspects of Processing of National Affiliation Data in Serbia. *Journal on Ethnopolitics and Minority Issues in Europe*, 19 (2), 76-106.
4. Euronews Albania (24 November 2022). *Shpopullimi i Shqiptarēve tē Medvegjēs*, Muharrem Salihu: Kosova dhe Shqipēria tē mos ndalen nē deklarata. *Euronews Albania*. <https://euronews.al/al/rajoni/2020/11/24/shpopullimi-i-shqiptareve-te-medvegjes-muhar-rem-salihu-kosova-e-shqiperiate-mos-ndalen-ne-deklarata/>.
5. Fazliu, Teuta; (3 nēntor 2020). *Serbia vazhdon pasivizimin e adresave tē shqiptarēve nē Luginē tē Preshevēs*. *Telegrafi*. <https://telegrafi.com/serbia-vazhdon-pasivizimin-e-adresave-teshqiptareve-ne-luginen-e-presheves-teuta-fazliu-viktima-e-radhes/>.
6. Fond za Humanitarno Pravo. (2003). Albanci u Srbiji: Peŝevo, Bujanovac i Medveĝa [Albanians in Serbia - Preŝevo, Bujanovac and Medveĝa. <http://www.hlc-rdc.org/?p=13395>. Gashi, Zijadin. (2015, September 12). Lugina voton pēr Asociacionin e Komunave Shqiptare [The Presevo Valley Votes for Association of Albanian Municipalities]. *Radio Europa e Lirē*. <https://www.evropaelire.org/a/27243833.html>.

7. Gözübenli, Abdullah Sencer. (2019). Border Vs. Numbers: Albanian National Minority in the South Serbia Between Nation Building in Kosova and EU Member Building. *KNUV*, 2 (60), 81-100.
8. H.D. (June 18, 2020). Administrativno Etnčko Čišćenje Albanaca. *Danas*. <https://www.danas.rs/drustvo/administrativno-etnicko-ciscenje-albanaca/>.
9. Helsinski Odbor za Ljudska Prava u Srbiji (2020, June 17). Otvoreno Pismo Povodom Nezakonitog Brisanja iz Biračkog Spiska Većeg Broja Gradana Albanske Nacionalnosti na Teritoriji Opštine Medveda. https://www.helsinki.org.rs/serbian/aktuelnosti_t447.html.
10. Helsinki Committee for Human Rights in Serbia; (2021). Albanian Minority on Hold: Preševo, Bujanovac and Medveđa as Hostages of the Serbia and Kosova Relations. <https://www.helsinki.org.rs/doc/izvestaj%20presevo%20eng.pdf>.
11. Human Rights Watch; (2008). Hostages of Tension: Intimidation and Harassment of Ethnic Albanians in Serbia after Kosova's Declaration of Independence. <https://www.hrw.org/reports/2008/serbia1108/>.
12. Huszka, Beáta; (2007). The Presevo Valley of Southern Serbia alongside Kosova: The Case for Decentralization and Minority Protection. *CEPS Centre for European Policy Studies*, 1 (12), 01-11.
13. International Crisis Group. "Southern Serbia: in Kosova's Shadow." Policy Briefing: Europe Briefing No 43, Belgrade/Pristina/Brussels, 27 June 2006.
14. Jug Srbije na večitom udaru Albanaca: Vijore zastave, gradi džamija i sve to pred vratima srpskog naroda. (August 28, 2020). *Srbija Danas*. <https://www.srbijadanas.com/vesti/info/jugsrbije-na-vecitom-udaru-albanaca-vijore-se-zastave-gradi-dzamija-i-sve-pred-vratima-srpskog-2020-08-28>.

15. Kamberi, Jasemine; (2019). 'The Other' of Serbia: The Albanians. INSAMER, 23.10.
16. Law on Residence and Temporary Residence of Citizens 2011. (Official Gazette of the Republic of Serbia, no. 87/2011)
17. Law on Local Elections 2007. (Official Gazette of the Republic of Serbia, no. 129/2007, last amended in 2020.
18. Lokalni Izbori u Medveđi. Naprednjaci: Osvojili smo više od 65 odsto glasova. (September 9, 2019). Blic. <https://www.blic.rs/vesti/politika/lokalni-izbori-u-medvedji-naprednjaci-osvojili-smo-viseod-65-odsto-glasova/c9p7t80>.
19. Marinković, D; (2015, September 9). U Medveđi Duplo Više Glasaca Nego Stanovnika. Južne Vesti. <https://www.juznevesti.com/Drushtvo/U-Medvedji-duplo-vise-glasaca-negostanovnika.sr.html>.
20. Marinković, Dragan; (December 14, 2018). O Kosovu i u Leskovačkoj Skupštini: Mi smo sledeći, Albanci već kupuju parcele u Lebanu da grade džamije!. JuGmedia. <https://jugmedia.rs/o-kosovu-i-u-leskovackoj-skupstini-mi-smo-sledeci-albanci-vec-kupuju-parcele-u-lebanu-da-gradedzamije/>
21. Ministarstvo Unutrašnjih Poslova: Direkcija Policije, Policijska Uprava Leskovac: Opština Preševo, Kabinet Predsednika Opštine. Official response: subject matter 205-1259/20, April 13, 2020.
22. Ministarstvo Unutrašnjih Poslova Srbije, Narodnoj Skupštini: Narodnom Poslaniku Šaipu Kamberiju. Official response: subject matter 01-8409/20-2, December 9th 2020.
23. Ministarstvo Unutrašnjih Poslova Srbije, Narodnoj Skupštini: Narodnom Poslaniku Šaipu Kamberiju. Official response: subject matter 01-8409/20-4, April 6th, 2021.

24. National Albanian Council (ANC) branch office in Medvegja/ Medveđa, personal communication, July 17, 2021.
25. Office for Presheva, Medvegja, and Bujanoc in the city of Gjilan (Kosova), personal communication, July 5th, 2021.
26. Participant 5, Albanian from Bujanoc/Bujanovac, personal communication, 15 May, 2020.
27. Participant 24, Albanian from a village of Bujanoc/Bujanovac, 24 October 2020.
28. Participant 30, Albanian citizen from a village in Medvegja/Medveđa, personal communication, July 15, 2021.
29. Participant 31, personal communication, May 13th , 2021.
30. Participant 52, Albanian from Medvegja/Medveđa, personal communication, 15 October, 2019.
31. Participant 78, Albanian from Medvegja/Medveđa, personal communication, 18 February, 2021.
32. Personal interview with Sonja Biserko, Helsinki Committee for Human Rights in Serbia, June 2, 2021.
33. Personal correspondence, Emir Suljagic, Hungarian National Council in Serbia, October 11, 2021.
34. Serbia Ambassador's Report to the European Parliament Member and EP Standing Rapporteur for Kosova, Ms. Viola von Cramon. Passivated Addresses in Serbia. Retrieved on February 12, 2021.
35. Šormaz, Dragan. [@dragansormaz]. (September 8, 2019). Twitter. <https://twitter.com/dragansormaz/status/1170769135137107970?F>.
36. Spisak Upisanih Biraca/Rezultati Lokalnih Izbora, Opština Medveđa, 24 June 2012.
37. Spisak Upisanih Biraca/Rezultati Lokalnih Izbora, Opština Medveđa, 08.09.2019.

38. Stefanović, Nebojsa. (September 2015, 2015). Medveđa se nalazi u Republici Srbiji i tu će i ostati. TRT. <https://www.trt.net.tr/bosanski/region/2015/09/14/stefanovic-medve-da-se-nalazi-u-republicisrbiji-i-tu-ce-i-ostati-1-52420>.
39. Strabac, Zan and Valenta, Marko. (2016). Social Distance Toward Ethnic Minorities in Croatia, Serbia, Montenegro, Macedonia, and Kosova: A Comparative Analysis. In S. P. Ramet et al. (Eds.), *Ethnic Minorities in Post-Socialist Southeastern Europe* (Cambridge, UK: Cambridge University Press).
40. Republika Srbija: Republički Zavod za Statistiku (2014). 2011 Popis stanovništva, domaćinstava i stanova 2011. u Republici Srbiji: Upporedni pregled broja stanovnika 1948, 1953, 1961, 1971, 1981, 1991, 2002 i 2011, godine. Retrieved from <https://pod2.stat.gov.rs/ObjavljenePublikacije/Popis2011/Knjiga20.pdf> un Last accessed on 10 September 2021.
41. UNCT Serbia & Montenegro. (April 11, 2001). Inter-Agency Assessment Mission to Southern Serbia-Serbia. <https://reliefweb.int/report/serbia/report-un-inter-agency-assessment-mission-southernserbia>.
42. Vučković, Branko. (Januar 26, 2021). Presdsednik Opštine Preševo: Brisanje prebivališta Albancima u Srbiji moralni zločin. Radio *Slobodna Europa*. <https://www.slobodnaevropa.org/a/šćiprim-arifi-politika-brisanja-prebivališta-albancima-u-srbiji-moral-ni-zločin/31069346.html>.
43. *Zëri i Amerikës*. (October 13, 2019). *Jeta e shqiptarëve në komunën e Medvegjës*, [Video]. <https://www.youtube.com/watch?v=uHvc7ZIUlQU>.

1.6 Fatmir LEKAJ, politolog

Riaktivizimi toksik i debatit për “identitetin kosovar”

Debati për kombin në ndërlidhje me debatin për “identitetin kosovar” po riaktualizohet herë pas here në mediet televizive, mediet sociale etj., madje ky debat duke u zhvilluar në negacion shpeshherë po rezulton me tendenca destruktive dhe përçarëse. Rrjedhimisht, edhe pse kjo është një temë e gjerë dhe e ndërlikuar, do të përqipem në këtë shkrim të kufizuar për këtë temë, të bëj një përmbledhje të shkurtër rreth çështjes substanciale të fenomenit “komb” në ndërlidhje me “identitetin kosovar”. Që në fillim vlen të theksohet se është për të ardhur keq, kur modelet/qasjet për organizimin e bashkësive politike perceptohen dhe paraqiten (në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, me vetëdije apo pa vetëdije të plotë) si të vërteta të plota empirike për kombin. Për shembull, duke bërë thjeshtëzime të tilla, si: kombi politik ose qytetar (në Francë), kombi kulturor ose etnik (në Gjermani) dhe kombi multikulturor (në Kanada) etj. Empirikja e fenomenit të kombit është e ndërlikuar në atë masë, sa që nuk mund të konkludohet se ndonjëri prej këtyre modeleve e përshkruan në mënyrë ekuivalente realitetin empirik të një kombi. Njëkohësisht, duhet pasur parasysh se këto modele janë të domosdoshme për ta studiuar dhe analizuar empirikën komplekse të fenomenit *komb*. Kjo është edhe një ndër arsyt kryesore pse studiuesit e çështjes së kombit i operacionalizojnë këto modele dhe nëpërmjet tyre bëjnë matjen e një kombi të caktuar (ose në mënyrë krahasuese të kombeve të caktuara) se sa është komb qytetar, sa është komb kulturor dhe sa është komb multikulturor. Cili nga këta gjedhe për kombin përkon më shumë me empirinë komplekse të një kombi, kjo varion prej kombit në komb. Por, në përgjithësi, mund të thuhet se këto modele për *kombin/et* janë të pranishme së bashku

pothuajse te çdo komb, por duke variuar në kohë, hapësirë dhe në kualitet e kuantitet. Studime dhe analiza të tilla kryesisht kanë për qëllim avancimin epistemologjik për ontologjinë e fenomenit *komb* dhe, rrjedhimisht, të fitojmë dituri më të mëdha për mundësitë e të organizuarit më të drejtë të bashkësive politike.

Modeli i kombit kulturor ose etnik nënkupton se kombi është pikënisje për shtetin. Ky model përmban dy variante: variantin e moderuar dhe variantin radikal. Varianti i moderuar ka gjuhën dhe bashkësinë historiko-kulturore si pikënisje për shtetin. Varianti radikal ka popullin në kuptimin biologjik si pikënisje për shtetin. Varianti radikal në rrafshin empirik për kombet konsiderohet si i paqenë (në veçanti në shtetet perëndimore). Me fjalë të tjera, pikënisje e modelit të kombit kulturor për organizimin e bashkësive politike është, së pari, mirënjohja e identitetit kulturor, në kuptimin se për autoritetet shtetërore, përmbajta e identitetit kombëtar janë gjuha, historia, religjioni etj. të shumicës së popullsisë. Pragu për integrimin e minoriteteve etnike varion: mund të jetë i ulët, për shembull, një person me prapavijë etnike minoritare të flasë rrjedhshëm gjuhën e shumicës; ose pragu mund të jetë i lartë, për shembull, një person me prapavijë etnike minoritare duhet të jetë gjenerata e katërt e paraardhësve të tij që kanë jetuar në një shtet, që të mund të perceptohet si pjesë e bashkësisë kombëtare e atij shteti. Tradicionalisht, referencë e modelit të kombit kulturor ka qenë kombi gjerman, mirëpo ky konstatim është më shumë një kategori historike, duke marrë parasysh se në kohën që po jetojmë, kombi gjerman njëkohësisht përmban në vetvete shumë elemente të kombit qytetar.

Modeli i kombit politik ose qytetar nënkupton se shteti është pikënisje për kombin. Pra, është shteti që u jep qytetarëve një identitet të përbashkët kombëtar nëpërmjet institucioneve dhe simboleve shtetërore. Tradicionalisht, referencë e modelit të kombit qytetar, i quajtur edhe modeli

politik i kombit, ka qenë Franca. Megjithatë, kombi francez nuk ka mundur të vendosë një neutralitet të plotë ndaj cilësive të veta etnike si një grup kulturor dominues/shtetformues (cilësitë e kombit kulturor). Në vazhdimësi, shteti francez ka qenë gjithëpërfshirës në njohjen dhe garantimin e barazisë formale në hapësirat publike për të gjithë qytetarët si individë. Por, njëkohësisht, duke mos njohur në hapësirën publike identitetin kulturor, etninë dhe gjuhën e individëve që i përkasin një grupi kulturor joshtetformues. Kështu që, shumica franceze (grupi dominues shtetformues) ka të drejtën ekskluzive të shprehjes etnike dhe gjuhësore në hapësirën publike dhe, njëkohësisht, ka pritjet e veta që qytetarët që i takojnë një grupi kulturor joshtetformues të kenë sjellje franceze në jetën publike, (njohuri për kodet e kulturës franceze, të komunikohet në gjuhën frënge në vendet publike, në punë etj.). Një ndër shembujt e hershëm në lidhje me këtë qasje franceze është edhe deklarata e Clermont Tonnerre në asamblenë franceze në vitin 1790, dhe përkatësisht shprehja e tij: *“Hebreut si individ ne i japim gjithçka, hebreut si hebre asgjë”* [1]. Kjo formë e organizimit të bashkësisë politike franceze konsiderohet nga njëra anë si asimiluese ndaj individëve me identitet kulturor që i përkasin grupit apo grupeve joshtetformuese. Nga ana tjetër, kjo konsiderohet si një domosdoshmëri e organizimit politik për ta mbajtur shoqërinë/shtetin të bashkuar, që të mos fragmentohet mbi bazën e identiteteve kulturore.

Prandaj, në rrafshin empirik, nuk mund ta përkufizojmë përmbajtjen komplekse të kombit thjesht dhe vetëm në kuptimin kulturor/etnik, as vetëm në kuptimin politik, bazuar thjesht dhe vetëm në shtetësi/qytetari ose vetëm në kuptimin juridik. Për shembull, bazuar thjesht dhe vetëm në anëtarësi në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB). Në mënyrë metaforike mund të konkludohet se, në rrafshin empirik, modeli i kombit kulturor ose etnik dhe modeli i kombit qytetar ose politik janë si vëllezërit siamezë, në veçanti

te shtetet unitare. Madje, sipas politologes dhe studiueses së nacionalizmit, Elisabeth Bakke, as kombet “qytetare” e as kombet “etnike” nuk janë veçanërisht voluntariste, dhe se e vetmja pjesë e dikotomisë midis kombit qytetar dhe kombit etnik që ka ndonjë rëndësi, është aspekti që ka të bëjë me përmbajtjen kombëtare në kuptimin e gjërave që ndajnë kombet veç e veç, sa i përket ndjenjës së përkatësisë së përbashkët. Kjo pjesë e dikotomisë është e dobishme për të përshkruar variacionin mes kombeve, gjithashtu është edhe më e dobishme ta shqyrtojmë kombin “qytetar” dhe kombin “etnik” si pika përfundimtare të një kontinuiteti shkallë-shkallë dhe jo si forma të pastra (të papërziera) të kësaj dikotomie, sepse nuk ekzistojnë si forma të pastra në realitet. Prandaj, përshkrimi i kombeve “qytetare” si kombe gjithëpërfshirëse (të hapura), voluntariste dhe liberale, dhe i kombeve “etnike” si përjashtuese (të mbyllura), jovoluntariste dhe autoritare (ose joliberale), është çorientues [2], sepse: “...anëtarësimi në kombe është më shumë çështje e identifikimit dhe e pranimi/njohjes së ndërsjellë sesa zgjedhje individuale”. Pas formimit të plotë të kombit, hapësira për zgjedhje është mjaft shumë e kufizuar për shumicën. Në fazat e hershme të procesit të kombformimit, hapësira për zgjedhje është më e madhe si në aspektin e përmbajtjes së propozuar të identitetit, po ashtu edhe për sa i përket zgjedhjes individuale ndërmjet projekteve të kombit. Ngjashëm, minoritetet dhe imigrantët mund të zgjedhin midis identitetit të tyre origjinal dhe (pjesërisht) përshtatjes me identitetin e majoritetit, por ndryshimi i identitetit nuk është kurrë i lehtë dhe kërkon njohjen/pranimin prej të tjerëve. Kombet “qytetare” janë më pak voluntariste dhe kombet “etnike” janë më pak jovoluntariste, sesa sugjeron dikotomia. Në të dy rastet, gjatë formulimit të përmbajtjes kombëtare, elitës kombformuese i është dashur të theksojë elementet e konsideruara përbashkuese për anëtarët e një kombi dhe, në të dy rastet, kriteret e anëtarësimit përcaktojnë kufizimet për përfshirje dhe, si rrjedhim, për zgjedhje individuale. Disa kriterë

“qytetare” për anëtarësim mund të jenë po aq të vështira për t’u realizuar sa kriteret “etnike” (p.sh., vlerat). Prandaj dikotomia midis identiteteve “qytetare” si gjithëpërfshirëse dhe identiteteve “etnike” si përjashtuese është tepër fikse. Kombet “qytetare” nuk janë të hapura për të gjithë dhe kombet “etnike” shumë rrallë janë çështje e karakteristikave gjenetike. Asnjë komb nuk është plotësisht i hapur ose i mbyllur për anëtarët e rinj, dhe shkalla e hapjes nuk përkon domosdoshmërisht me etiketime të tilla, si kombi “qytetar” ose kombi “etnik”. Për më tepër, ne duhet të bëjmë dallimin midis botëkuptimit nacionalist (edhe nëse i përshkruajnë kombet si entitete organike ose asociacione voluntariste) dhe këtij realiteti: asimilimi ose integrimi në një komb tjetër është i mundur. Shtrohet pyetja: në cilat rrethana?

Një komb kryesisht “etnik” më herët do të jetë më i hapur për të huajt në procesin e kombformimit sesa më vonë, dhe kombet me identitet kombëtar të kontestuar mund të jenë më të hapura sesa kombet, ku përmbajtja kombëtare është fare mirë e definuar. Sa i hapur apo i mbyllur është një komb, kjo është një pyetje empirike, dhe jo diçka që mund të përcaktohet në bazë të një etikete”. [3]

Rrjedhimisht, kombi në radhë të parë është kategori historike dhe kolektive dhe, në radhë të dytë, konjitive dhe individuale, dhe mundësia për riinterpretimin/ridefinimin e përmbajtjes kombëtare është e kufizuar. Kështu, një ndër sfidat kryesore për korrigjim janë elementet anakronike në kuadër të përmbajtjes kombëtare në kombinim me zotërimin e kritereve të ashpra kombëtare për anëtarësim, që përcaktojnë kufizimet për përfshirje dhe, si rrjedhim, për zgjedhje individuale. Njëherësh vlen të theksohet, se disa kombe karakterizohen më shumë si asociacione voluntariste sesa si entitete organike. Për shembull, në dallim nga vendet fqinje, ku nacionalizmi u ngrit kryesisht mbi bazën religjioze (Serbi, Greqi, Bullgari etj.), nacionalizmi

shqiptar, duke qenë më shumë i inspiruar nga idetë kombformuese të shteteve perëndimore, dhe veçanërisht për shkak të rrethanave historike, u ngrit kryesisht bazuar në histori, gjuhë dhe harmoninë/respektin ndërfetar. Kështu që, krahasuar me kombet fqinje që janë më të mbyllura, kombi shqiptar është komb më i hapur në kuptimin e përmbajtjes kombëtare (i karakterizuar më shumë si asociacion voluntarist sesa si entitet organik), sepse një fe e caktuar nuk është kriter gjithëpërfshirës dhe përjashtues i të qenit anëtar i kombit shqiptar. Madje si anëtar i kombit shqiptar cilësohen dhe pranohen të gjithë pasardhësit iliro-shqiptarë që, për shkak të rrethanave historike, janë detyruar të asimilohen gjuhësisht, por që kanë arritur ta ruajnë kujtesën për të kaluarën dhe trashëgiminë e tyre. Gjithashtu vlen të theksohet, se është për keqardhje kur disa fanatikë antifetarë, fanatikë fetarë dhe fanatikë provincialë shqiptarë në negacion e cenojnë këtë nivel/dimension të rëndësishëm të kombit shqiptar si asociacion voluntarist që, në fakt, duhet ta kemi për mburrje kombëtare në raport me kombet e tjera. Ndaj duhet t'i jemi mirënjohës elitës kulturore dhe politike shqiptare të Rilindjes Kombëtare (duke përfshirë prijësit fetarë shqiptarë, pavarësisht prej dallimeve fetare), që e kanë vulosur se çfarë do të thotë të jesh anëtar i kombit shqiptar (më shumë si një asociacion voluntarist sesa si një entitet organik), dhe që nënkupton se një shqiptar/e është një anëtar/e i/e kombit shqiptar që përfshin disa fe, ku gjuha si kriter objektiv dhe historia si kriter “subjektiv” kanë legjitimitet kolektiv/kombëtar. Fetë si të veçanta nuk kanë legjitimitet kolektiv/kombëtar. Vetëm nëpërmjet një komplementariteti ndërfetar brendakombëtar, që rezulton në tolerancën/harmoninë ndërfetare brendakombëtare dhe ndarjen e fesë nga shteti, edhe fetë bashkërisht arrijnë legjitimitetin kolektiv/kombëtar. Po ashtu, ky nivel/dimension i rëndësishëm i kombit shqiptar si asociacion voluntarist krijon mundësinë e duhur për një integrim më të balancuar të minoriteteve etnike në Shqipëri dhe në Kosovë si

në kuptimin e mundësisë për ruajtjen e identitetit të minoriteteve etnike, por sidomos në kuptimin e mundësisë më të lehtë, që minoritetet etnike t'i përshtaten shumicës shqiptare.

Modeli i kombit multikulturor, përkatësisht multikulturalizmi si projekt politik, nënkupton përpjekjet për organizimin/riorganizimin më të drejtë të bashkësive politike mes shumicës dhe minoriteteve, bazohet kryesisht në tri argumentime.

- ***Së pari***, bazuar në padrejtësitë historike që u janë bërë minoriteteve që nga fillesa e epokës së nacionalizmit, veçanërisht pas Revolucionit Francez, që nuk ishte vetëm revolucion socio-politik, por edhe revolucion nacional, dhe që rezultoi fuqishëm me parimin e sovranitetit të popullit si parim për legjitimitetin e shtetit/kombit. Parimi i sovranitetit të popullit barti me vete edhe implikime praktike, sepse shtetet nuk ishin tërësisht homogjene, përveç ndonjë shembulli të izoluar (duke përfshirë edhe zonat nën sundimin e perandorive të ndryshme, që pretendonin të bëheshin shtete, në të shumtën e rasteve ishin të përbëra nga shumica dhe minoritetet), prandaj u shfaq edhe domosdoshmëria për një politikë ndaj minoriteteve. Në këtë vazhdë, shtetet që kanë qenë të ndikuara më shumë nga modeli kulturor ose etnik i kombit, kanë rezultuar më shumë dhe më pak me segregimin e minoriteteve brenda këtyre shteteve. Ndërsa shtetet që kanë qenë të ndikuara më shumë nga modeli politik ose qytetar i kombit, kanë rezultuar më shumë dhe më pak me asimilimin e minoriteteve brenda këtyre shteteve. Për më tepër, sipas filozofit Will Kymlicka, (përfaqësuesit më të spikatur të modelit multikulturalist për organizimin e bashkësive politike), ka mjaft raste të dhimbshme të padrejtësive historike që u janë bërë minoriteteve kombëtare, në kuptimin e përpjekjeve të shumicave kombëtare (grupeve kulturore të shumicës shtetformuese), për arritjen e homogjenizimit kulturor brenda shtetit gjatë historisë. Kjo ka rezultuar me politika dhe konsekuenca të

ndryshme ndaj minoriteteve kombëtare, përveç të tjerash, me eliminimin e tyre fizik, dëbimin (pastrimin etnik) dhe gjenocidin. Në disa raste me asimilim të dhunshëm dhe detyrim për ta pranuar gjuhën, religjionin dhe zakonet e shumicës. Dhe, në raste të tjera, duke i trajtuar si banorë të huaj, në kuptimin e segregimit fizik, diskriminimit ekonomik, dhe duke ua mohuar të drejtat politike. [4]

Megjithëkëtë, në të shumtën e rasteve minoritetet kombëtare kanë arritur ta mirëmbajnë identitetin e tyre dhe kjo, sipas Kymlicka-s, dëshmon se identiteti në kuptimin e ndjenjës së të qenit një kulturë e veçantë kombëtare, është treguar historikisht i qëndrueshëm, prandaj duhet të kihet parasysh se, pasi të jetë formuar një identitet kombëtar, është jashtëzakonisht e vështirë, për të mos thënë e pamundur (përveç gjenocidit total) për ta zhdukur. Për këtë qëndrueshmëri identitare të minoriteteve kombëtare ka mjaft shembuj nëpër botë (në kohë dhe hapësirë), si përpjekjet e pasuksesshme në Kanada dhe Amerikë, ku qeveritë herë pas here i kanë përdorur të gjitha mjetet në dispozicion të tyre për zhbërjen e ndjenjës së identitetit të veçantë të minoriteteve të tyre kombëtare, nëpërmes shkollave rezidenciale për fëmijët indianë dhe ndalimin e zakoneve tribale, deri në ndalimin e shkollave në gjuhën frënge ose spanjolle. Ngjashëm, përpjekjet për ta zhdukur gjuhën dhe identitetin e minoriteteve kombëtare, kurdëve, baskëve etj., kanë pasur pak ose aspak sukses. Duke përfshirë dështimin e regjimeve diktatoriale dhe autoritare (edhe pse kanë pasur monopolin e plotë mbi arsimin dhe medien), për t'i bërë, për shembull, kroatët, sllovakët, ukrainasit etj., ta ndiejnë veten e tyre së pari si *jugosllavë, çekoslllovakë, sovjetikë* etj. Gjithashtu, përpjekjet për të promovuar “panlëvizjet” (shtetet pansllave, shtetet panarabe etj.), me qëllim të zhdukjes së identiteteve kombëtare, kanë rezultuar me dështim. [5]

- **Së dyti**, një pikënisje objektive për kombin është se nuk ka komb/shtet neutral, sepse çdo komb/shtet është i formuar nga një grup kulturor shtetformues. Pra, nga një grup kulturor i shumicës që dominon dhe kontrollon pushtetin, gjuhën dhe simbolet shtetërore (kjo vlen në veçanti për shtetet unitare). Në lidhje me këtë argumentim, Kymlicka në analizën e tij për kombin brenda teorisë normative politike pohon se pushteti shtetëror nuk mund të jetë neutral, ngaqë, sipas tij, pushteti shtetëror në mënyrë aktive e stimulon gjuhën e përgjithshme (gjuhën e grupit kulturor shtetformues), njëkohësisht stimulon një kulturë shoqërore (“societal culture”), që asociohet me kulturën nacionale, duke zgjedhur ditët e festave zyrtare, planprogramet arsimore në shkollat publike, ndarjen e subjekteve politike etj. Dhe më tutje pohon se gati të gjitha shtetet moderne në mënyrë aktive stimulojnë kombndërtimin nëpërmjet një gjuhe dominuese, simboleve nacionale etj. Ky kombndërtim favorizon anëtarët e kulturës shumicë. Pakicat e kanë zgjedhjen ose të integrohen në kulturën shumicë, ose ta zhvillojnë kulturën e tyre shoqërore që asociohet me kulturën e tyre nacionale. [6]

- **Së treti**, shumica e shteteve në botë janë *de facto* shtete multikombëtare dhe jo siç rëndom proklamohen si shtete unikombëtare (shtet-komb), meqë brenda kufijve të tyre kanë më shumë dhe më pak edhe minoritete kombëtare. Në lidhje me këtë Kymlicka shkruan: *“Një burim i diversitetit kulturor është bashkekzistenca brenda një shteti të caktuar e më shumë se e një kombi, ku “komb” do të thotë një komunitet historik me një gjuhë dhe kulturë të veçantë, më shumë ose më pak institucionalisht e kompletuar, që përmbush një territor ose atdhe të caktuar. Në këtë kuptim sociologjik, një “komb” është i lidhur ngushtë me idenë e një “populli” ose një “kulture”. Në fakt, këto koncepte shpesh definoohen në lidhje me njëri-tjetrin. Prandaj, një vend që përmban më shumë se një komb nuk është një shtet-komb, por*

një shtet-multikombëtar, edhe kulturat më të vogla formojnë “minoritetet kombëtare...” [7]

Me këtë pikënisje, multikulturalizmi si projekt politik parasheh institucionalizimin e grupeve kulturore joshtetformuese, sidomos të minoriteteve kombëtare (grupet: kulturore-historiko-geografike brenda një shteti të caktuar). Më konkretisht, sa i përket institucionalizimit të minoriteteve kulturore, Kymlicka argumenton nëpërmes ndarjes analitike “mbrojtjen nga jashtë dhe restriksioneve të brendshme” (“external protections, and internal restrictions”), ku shpjegon se si mund të mbahet balanca mes të drejtave individuale dhe të drejtave grupore. “Mbrojtja nga jashtë” (“external protections”) përfshin të drejtat që i mbrojnë minoritetet, politikisht dhe ekonomikisht nga shumica, dhe kanë të bëjnë me të drejtat për arsimin, gjuhën, kulturën, territorin dhe resorët. Duke përfshirë edhe të drejtat e reprezentimit politik për minoritete, sepse procesi politiko-demokratik nuk është i mjaftueshëm për ta pasqyruar tërë popullin, dhe të drejtat e reprezentimit për minoritete, ato kontribuojnë që të mos injorohen minoritetet gjatë vendimmarrjes në nivel vendor. Rrjedhimisht, për të bërë diçka në këtë drejtim, minoriteteve duhet t’u jepen të drejtat e reprezentimit special, për shembull, duke i ndryshuar barrierat strukturore; nominimi në listat partiake, rezervimi i një numri të caktuar të ulëseve në kuvend për minoritetet etj. Këto të drejta vlejné, në radhë të parë, për minoritetet kombëtare, por nuk përjashtohet mundësia që të drejtat në kuadër të “mbrojtjes nga jashtë” deri në një shkallë të mund të vlejné edhe për grupet etnike si rezultat i migrimin, për shembull, për ta mbrojtur të drejtën e mësimin në gjuhën amtare, praktikat religjioze etj. Në këtë mënyrë, të drejtat në kuadër të “mbrojtjes nga jashtë” konsiderohet se kontribuojnë për t’i barazuar grupet e ndryshme kulturore me pjesën tjetër të popullsisë dhe për ta shkurtuar pushtetin e shumicës. Ndërsa kur bëhet fjalë për “restriksionet e

brendshme”, kjo ka të bëjë me kërkesën e grupeve minoritare (në raport me shoqërinë si tërësi në kuadër të shtetit), që t’u vënë frerë anëtarëve të vet, në kuptimin e ushtrimit të pushtetit dhe përcaktimit të rregullave ndaj anëtarëve të vet, edhe pse kjo mund të shkojë në dëm të të drejtave të autonomisë individuale të anëtarëve të grupeve minoritare. Shembull për restriksione të tilla, që e kufizojnë të drejtën individuale, mund të jetë ndalimi i anëtarëve të grupit minoritar për të marrë pjesë në zgjedhjet kombëtare, ndalimi i anëtarëve të grupit minoritar (për shembull vajzave) për të shkuar në shkollë etj. Sipas Kymlicka-s, asnjë shtet liberal nuk duhet të lejojë që t’u jepet e drejta për restriksione të brendshme grupeve minoritare, që shkojnë në dëm të autonomisë individuale të anëtarëve të grupeve minoritare. Por bën thirrje vetëm për të drejtat në kuadër të “mbrojtjes nga jashtë” dhe konsideron se kërkesa për këto të drejta është legjitime, në mënyrë që grupet minoritare të jenë të mbrojtura nga normat, idealet dhe vendimet politike të shumicës. [8]

Kymlicka është kritikuar për konceptin e tij normativ të multikulturalizmit, për faktin se institucionalizmi i esencjalizmit grupor mbi bazën kulturore fragmenton bashkësinë politike në një shtet. Pyetja brengosëse është se çfarë e mban të lidhur një bashkësi politike, që ka bazë institucionalizmin e esencjalizmit kulturor? Sipas Kymlicka-s, lidhja e një bashkësie politike të këtillë është fakti se, duke pranuar të tjerët, pranohesh edhe vetë ai që je. Kjo është një kontratë shoqërore, që individët e grupeve të ndryshme kulturore e bëjnë mes tyre, dhe mundësia për një patriotizëm të përbashkët mbikulturor brenda shtetit është i mundshëm në një bashkësi të këtillë politike. Përndryshe, sipas Kymlicka-s, alternativa e një pjese të liberalëve dhe socialistëve, që parasheh asimilimin e minoriteteve ose eliminimin e ndjenjës së identitetit të veçantë të minoriteteve, nuk është e mundur edhe nëse ka qenë dikur e mundshme. Njëherësh vlen të theksohet, se Kymlicka nuk e shpërfill situatën sfiduese në praktikë në lidhje me

organizimin e bashkësive politike mes shumicës dhe minoriteteve dhe nuk pretendon se e ka gjetur zgjidhjen në kuptimin final, por konsideron se kjo sfidë kërkon menaxhim paqësor dhe korrekt, duke përfshirë parakushtin e njëfarë niveli të vullnetit të mirë. Për më tepër, Kymlicka në lidhje me sfidat e organizimit të bashkësive politike bazuar në multikulturalizëm si projekt politik, përveç të tjerash, shkruan: *“Fakti që dy grupe kombëtare ndajnë të njëjtat vlera ose parime të drejtësisë, nuk u jep domosdoshmërisht ndonjë arsye të fortë për t’u bërë (ose të qëndrojnë) bashkë, sesa të mbesin (ose të ndahen në) dy vende të ndara”*. Çfarë më shumë, ose çfarë tjetër nevojitet për unitetin social? Elementi përbërës që mungon duket se është ideja e një identiteti të përbashkët. Një konceptim i përbashkët i drejtësisë në kuadër të bashkësisë politike nuk gjeneron domosdoshmërisht një identitet të përbashkët e lëre më identiteti i përbashkët qytetar, që mëton të zëvendësojë identitetet rivale kombëtare. Njerëzit vendosin me kë duan të ndajnë një vend, duke pyetur se me kë identifikohen, me kë ndiejnë solidaritet etj. Ajo që i mban amerikanët së bashku, pavarësisht prej mungesës së vlerave të tyre të përbashkëta, është fakti se ata bashkëndajnë një identitet si amerikanë. Anasjelltas, ajo që i mban ndaras suedezët dhe norvegjezët, pavarësisht prej pranisë së vlerave të përbashkëta, është mungesa e një identiteti të përbashkët. Nga vjen ky identitet i përbashkët? Në shtet-kombe, përgjigjja është e thjeshtë: identiteti i përbashkët rrjedh nga bashkësia historike, gjuhësore dhe, mbase, fetare! Por këto janë pikërisht gjërat që nuk janë të përbashkëta në shtetet multikombëtare. Nëse shikojmë vendet me fuqi patriotike, por me diversitet kulturor, si Shtetet e Bashkuara ose Zvicra, baza e një identiteti të përbashkët shpesh duket të jetë krenaria për arritjet e caktuara historike (p.sh., themelimi i Republikës Amerikane). Kjo krenari e përbashkët është një nga bazat e ndjenjës së fortë të identitetit politik amerikan, e përforcuar vazhdimisht në literaturën e tyre të qytetarisë dhe

kurrikulën shkollore. Por në shumë vende multikombëtare historia është një burim i indinjatës dhe ndarjes midis grupeve kombëtare, dhe jo burim i krenarisë së përbashkët. Njerëzit dhe ngjarjet që ngjallin krenari mes shumicave kombëtare, e gjenerojnë shpesh sensin e tradhtisë në mesin e minoriteteve kombëtare. Për më tepër, mbështetja në histori kërkon shpesh shumë selektim, madje përsëritjen manipuluese të saj.

Ernest Renan thoshte se identiteti kombëtar përfshin harrimin e së kaluarës po aq shumë, sa edhe të kujtuarin e saj. Për të ndërtuar një ndjenjë të identitetit të përbashkët në një shtet multikombëtar, ndoshta kërkon një kujtesë edhe më selektive të së kaluarës. Vlerat e përbashkëta dhe një histori inspiruese padyshim ndihmojnë në mbajtjen e solidaritetit në një shtet multikombëtar, por vetvetiu është e pasigurt dhe jo e mjaftueshme. E, pra, si mund të ndërtohet një identitet i përbashkët në një vend, i cili përmban dy ose më shumë komunitete, që e konsiderojnë veten si kombe vetëqeverisëse? Variacioni i madh në situatat historike, kulturore dhe politike në shtetet multikombëtare, sugjeron që çdo përgjigje e përgjithësuar në këtë pyetje, ka të ngjarë të mbivlerësohet. Ajo që është e qartë, mendoj unë, është se, nëse ekziston një mënyrë e zbatueshme për të promovuar ndjenjën e solidaritetit dhe qëllimit të përbashkët në një shtet multikombëtar, kjo do ta përfshijë më shumë akomodimin sesa vartësinë e identiteteve kombëtare. Njerëzit nga grupe të ndryshme kombëtare do ta ndajnë besnikërinë ndaj një forme shtetërore më të madhe, vetëm nëse e shohin atë si kontekstin brenda të cilit ushqehet identiteti i tyre kombëtar, në vend që të nënshtrohet. Kjo është mjaft e vështirë në një vend, i cili thjesht përmban dy kombe (p.sh., Belgjika). Kjo bëhet shumë më e ndërlikuar në vendet, të cilat nuk janë vetëm multikombëtare, por edhe polietnike, të përbëra nga disa grupe kombëtare dhe indigjene, shpesh me përmasa shumë të pabarabarta, si dhe nga emigrantët nga çdo pjesë e botës...

Siç e kam përmendur më herët, disa shtete multikombëtare e kanë sensin e fortë të identifikimit të përbashkët. Kjo është e vërtetë në mënyrë të dukshme në rastin e zviceranëve. Edhe kanadezët e kanë një sens me bazë të fortë solidariteti. Për shembull, përderisa mbi gjysma e kubekianëve i japin përparësi vetidentifikimit me statusin e tyre si qytetarë të Kubekut, krahasuar me më pak se 30%, të cilët i japin përparësi shtetësisë kanadeze. Ende 70% e kubekianëve thonë se do të ishin të gatshëm të bënin sakrifica personale në dobi të kanadezëve jashtë Kubekut. Kjo siguron një nivel të vullnetit të mirë, që nuk është i pranishëm në shtetet e tjera multikombëtare. Dhe fokusi në vlerat e përbashkëta, historinë mitike ose ngazëllimin e diversitetit të thellë, mund të ndihmojë në mbajtjen e këtij niveli të solidaritetit. Por nuk është e qartë se si shtetet e tjera multikombëtare do të mund të provojnë të krijojnë një nivel të tillë solidariteti, kur nuk ekziston paraprakisht. Nëse dy ose më shumë grupe kombëtare thjesht nuk duan të jetojnë së bashku, mund të jetë e pamundur të krijohet solidariteti nga fillimi... Prandaj, sfida themelore me të cilën përballen teoricienët liberalë është identifikimi i burimeve të unitetit në një shtet demokratik multikombëtar”. [9]

Në rastin e organizimit të bashkësisë politike në Kosovë, ka pasur dhe vazhdon të ketë vështirësi, për shkak të zhvillimeve në të kaluarën. Gjithashtu, përveç të tjerash, edhe për shkak të mospërkushtimit të duhur të liderëve politikë shqiptarë të Kosovës (pas çlirimit të Kosovës në vitin 1999), për të ofruar ndonjë alternativë/platformë të vetën të përbashkët për organizimin e brendshëm të bashkësisë politike në Kosovë mes shumicës shqiptare dhe minoritetit serb etj. Në këtë vazhdë, UNMIK-u nëpërmes kornizës kushtetuese të vitit 2001, përcaktoi të drejta të veçanta për minoritetet, sidomos për minoritetin serb, që në literaturën e multikulturalizimit si projekt politik quhen “të drejta për mbrojtjen e minoriteteve nga jashtë”. Përkatësisht, në kreun IV dhe IX të kornizës

kushtetuese u përfshinë të drejtat shtesë për minoritetet, duke përfshirë të drejtat e përfaqësimit të veçantë të minoriteteve në nivel vendor, në Kuvendin dhe Qeverinë e Kosovës.[10] Njëherësh (në linjë me qasjen multikulturaliste për organizimin e bashkësive politike) për gjetjen e një balance mes të drejtave individuale, të drejtave kolektive dhe parandalimit të “restrikcioneve të brendshme ndaj individëve”, në kuadër të minoriteteve, në mënyrë që minoritetet të mos mund t’u vënë frerë anëtarëve të vet dhe, rrjedhimisht, të mos dëmtohet e drejta e autonomisë individuale e anëtarëve të grupeve minoritare. Në kreun IV të kornizës kushtetuese është e precizuar se “askush nuk do të detyrohet të deklarojë se cilit komunitet i përket ose të deklarohet anëtar i ndonjë komuniteti. Nuk ka asnjë pengesë nga ushtrimi i së drejtës së individit që të deklarohet ose të mos deklarohet anëtar i një komuniteti”. [11]

Pas trazirave të marsit të vitit 2004 u forcua bindja e faktorëve ndërkombëtarë, duke përfshirë këtu sekretarin e përgjithshëm të OKB-së, Kofi Annan etj., se në Kosovë është i domosdoshëm edhe decentralizimi në vija etnike në nivel lokal, që të mund të sigurohet jetesa për minoritetin serb në Kosovë. Konkretisht, nga këndvështrimi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB-së), trazirat në Kosovë më 17 dhe 18 mars u panë si një dështim i madh i udhëheqësve politikë shqiptarë të Kosovës. 19 persona vdiqën gjatë trazirave (11 shqiptarë dhe 8 serbë të Kosovës) dhe 954 persona u lënduan gjatë përleshjeve. Përveç kësaj, u lënduan edhe 65 policë ndërkombëtarë, 58 policë lokalë dhe 61 ushtarë të KFOR-it. Sipas raportit të sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, të datës 30 prill 2004, trazirat e marsit ishin të motivuara etnikisht dhe kjo konsiderohej si një prapakthim në përpjekjet për të ndërtuar një Kosovë demokratike dhe shumetnike. Raporti konstatonte se trazirat ishin tregues, që në kuadër të një pjese të madhe të popullit shqiptar të Kosovës, ende ekzistonte një mungesë e përkushtimit për

krijimin e një shoqërie të vërtetë shumetnike në Kosovë, se politikanët duhet të mbajnë përgjegjësi, se ekstremizmi duhet luftuar dhe dhuna nuk duhet shpërblyer. [12]

Kështu më tutje, përfaqësimi i veçantë i minoriteteve në nivel vendor, në Kuvendin dhe Qeverinë e Kosovës, i bazuar në kornizën kushtetuese dhe decentralizimi në nivel lokal, u bënë bazë për negociatat e mëtejshme në Vjenë, që me disa shtesa rezultuan me të ashtuquajturin *Plani i Martti Ahtisaari-t*, si plan përfundimtar për organizimin e bashkësisë politike në Kosovë. Në fakt, nga 15 takimet e drejtpërdrejta midis palëve (gjatë negociatave në Vjenë, në vitin 2006), 13 nga 15 takimet negociuese kishin të bënin me minoritetet (8 takime për decentralizimin, 3 takime për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare, 2 takime për të drejtat e minoriteteve), dhe një takim për çështjet ekonomike.[13]

Rrjedhimisht, Plani i Ahtisaari-t për organizimin e bashkësisë politike në Kosovë nuk ka pikënisje modelin kulturor (që si parësore parasheh se përmbajtja e bashkësisë politike duhet të bazohet në gjuhën, kulturën dhe historinë e shumicës) dhe as modelin qytetar (që si parësore sheh njohjen/përparësinë e identitetit qytetar mbi identitetet grupe), por ka pikënisje modelin multikulturalist, ku bashkësia politike bazohet kryesisht në institucionalizimin dhe mirënjohjen reciproke të grupeve kulturore. E veçanta e këtij plani, është se e tejkalon edhe modelin multikulturalist sa i përket përcaktimit të të drejtave për minoritetet kombëtare brenda një shteti, në kuptimin që bën dallim në të drejta mes minoritetit serb dhe minoriteteve të tjera në Kosovë. Për këtë nuk mund të fajësohet Martti Ahtisaari, sepse në kuadër të kontekstit politik të Kosovës, është përpjekur dhe ka arritur të gjejë zgjidhjen më të mirë të mundshme për organizimin e bashkësisë politike në Kosovë drejt legjitimitit të pavarësisë së Kosovës. Në fakt, dallimi në të drejta mes minoritetit serb dhe minoriteteve të tjera në Kosovë kryesisht

është rezultat i dy faktorëve. Nga njëra anë, Organizata e Kombeve të Bashkuara (madje edhe Unioni European) ende nuk kanë arritur të përcaktojnë dhe të zbatojnë një standard të njëfishtë për të drejtat e minoriteteve kombëtare, pavarësisht nëse ka një minoritet kombëtar në afërsi të vendit amë ose jo. Përndryshe, nëse minoritetet kombëtare që kanë në afërsi vendet amë, duhet të kenë të drejta më të veçanta sesa minoritetet e tjera kombëtare (që nuk i kanë në afërsi vendet amë, ose që nuk kanë fare vende amë), atëherë të drejta të njëjta duhet të vlejnë për të gjitha minoritetet kombëtare, që i kanë në afërsi vendet amë, dhe jo vetëm për një grup të caktuar, sikurse rasti i serbëve në Kosovë.

Nga ana tjetër, liderët shqiptarë të Kosovës, përveçse nuk janë treguar vigjilentë për të parandaluar trazirat e marsit 2004, por nuk janë treguar as paraprakisht (që nga viti 1999) të përgjegjshëm, unikë dhe kreativë për të përpiluar dhe ofruar një platformë serioze negociuese për organizimin e bashkësisë politike në Kosovë mes shumicës shqiptare dhe minoriteteve, dhe nuk bën dallim në të drejta mes minoriteteve të tjera dhe minoritetit serb, siç bën dallim Plani i Ahtisaari-t. Njëherësh, është hipokrizi që parimi për përfaqësimin e minoriteteve në Kuvend, që përfshin edhe minoritetet që nuk kufizohen me vendet amë, ose që nuk kanë fare vende amë, për shembull sikurse minoriteti romë etj., të vlejë si parim vetëm në Kosovë si shembull i izoluar (bazuar në Planin e Ahtisaari-t). Dhe ende ky parim (në fakt parim i drejtë) nuk vlen për Serbinë, që ka një numër më të madh të romëve sesa në Kosovë, ose për Rumaninë, që ka një numër edhe më të madh të romëve sesa në Serbi dhe që, njëkohësisht, është edhe shtet anëtar i BE-së etj.

Njëkohësisht është e çuditshme se, sipas Planit të Ahtisaari-t, bashkësia politike në Kosovë mbetet *de jure* pa grup kulturor shtetformues (komb titullar). Madje, sipas këtij plani, Kosova nuk përkufizohet as si shtet i shqiptarëve (apo shqiptaro-kosovarëve) dhe i grupeve të tjera etnike që

jetojnë në të. Reduktimi i mbi 90 për qind të shqiptarëve nga *de facto* një grup kulturor shtetformues në *de jure* një minoritet sikurse minoritetet e tjera në Kosovë, nuk ka referencë empirike as në shtetet perëndimore më të përparuara demokratike. Nëse qëllimi i organizimit të bashkësisë politike në Kosovë ka qenë drejtësia (dhe jo vetëm stabiliteti politik), atëherë pse edhe grupet e tjera shtetformuese në shtetet e tjera perëndimore nuk e reduktojnë statusin e tyre në minoritet për shkaqe drejtësie? Pse, për shembull, shumica e shteteve perëndimore kanë flamuj etnikë, madje edhe të bashkëdyzuar etniko-religjiozë, që përjashtojnë simbolikisht dhe emocionalisht grupet e tjera kulturore joshtetformuese në këto shtete? Pse nuk i bëjnë flamujt shtetërorë gjeografikë si në Kosovë edhe shtetet e tjera, kur kjo i shërben një drejtësie mbinacionale, në mënyrë që asnjë qytetar të mos e ndiejë veten të përjashtuar simbolikisht dhe emocionalisht nga simboli shtetëror?

Njëherësh, duhet të kihet parasysh se nuk ka qenë e mundur ngritja e një identiteti të përbashkët kombëtar kosovar, që është më i fortë se identiteti kombëtar i shumicës shqiptare në Kosovë, dhe që është më i fortë se identiteti kombëtar i minoritetit serb në Kosovë. Sepse parë nga këndvështrimi qoftë i qasjes teorike etnosimboliste të kombformimeve, qoftë i qasjes teorike moderniste të kombformimeve, nuk ka qenë e mundur të organizohet përmbajtja e bashkësisë politike në Kosovë në kuptimin e një identiteti të përbashkët kombëtar kosovar, pasi për etnosimbolistët si Anthony D. Smith etj., parakusht i rëndësishëm për ngritjen e identitetit kombëtar është prania e trashëgimisë së përbashkët kulturore e bazuar te mitet, kujtimet dhe simbolet e përbashkëta. [14] Në rastin e organizimit të bashkësisë politike në Kosovë, nuk ka qenë e pranishme një trashëgimi e tillë e përbashkët kulturore, që do të mund të bashkidentifikonte/gjithëpërfshinte shumicën shqiptare, minoritetin serb dhe minoritetet e tjera në Kosovë. Në këtë kuadër, edhe pse kriteri i modernistëve për trashëgiminë e përbashkët

kulturore është më i ulët sesa kriteri i etnosimbolistëve, nuk ka qenë e mundur të zbatohet në rastin e organizimit të përmbajtjes së bashkësisë politike në Kosovë. Për shembull, pikënisja teorike e Ernest Gellner-it, për ngritjen e “kulturës së madhe” (kulturës kombëtare) bazuar në një gjuhë të përbashkët (bashkësinë e përbashkët gjuhësore) dhe në sistemin e përgjithshëm dhe të standardizuar arsimor [15], nuk ka mundur të shërbejë si pikënisje për organizimin e përmbajtjes së bashkësisë politike në Kosovë, sepse s’ka pasur gjasë që minoriteti serb, shumica shqiptare dhe minoritetet e tjera në Kosovë të pajtohen për një gjuhë të vetme, ose eventualisht t’i zëvendësojnë gjuhët e tyre me një gjuhë të vetme, që do të shërbente edhe për konsolidimin e një sistemi të përbashkët dhe të standardizuar arsimor në nivel të Kosovës, si bazë për ngritjen e një identiteti kombëtar kosovar. Ngjashëm, në kuadër të qasjes moderniste, edhe studiuesi Benedict Anderson parasheh ngritjen e bashkësisë së imagjinuar (kombit) nëpërmjet një bashkësie komunikuese të bazuar në gjuhën e përbashkët. Por vlen të saktësohet se Anderson, me përkufizimin e tij për kombet si bashkësi të imagjinuara, i jep më shumë rëndësi dimensionit subjektiv sesa dimensionit objektiv të kombit, kështu që kriteri i tij për gjuhën është më shumë veçori funksionale sesa veçori përkufizuese e kombit. [16] Kjo nënkupton se veçoria përkufizuese e kombit është, në radhë të parë, korniza e referencave të përbashkëta brenda një bashkësie të imagjinuar, që vlen edhe për bashkësitë e imagjinuara shumëgjuhëshe, për shembull sikurse rasti i kombit zviceran. Madje Anderson është eksplisit në lidhje me këtë, kur shprehet: *“Në një botë, në të cilën shteti kombëtar është normë dërrmuese, e gjithë kjo do të thotë se kombet tani mund të imagjinohen pa bashkësinë gjuhësore”*. [17] Megjithëkëtë, në rastin e organizimit të përmbajtjes së bashkësisë politike në Kosovë nuk ka pasur gjasë të arrihet pajtueshmëria mes minoritetit serb, shumicës shqiptare dhe minoriteteve të tjera në Kosovë për

ndërtimin e një kornize me referenca të përbashkëta nëpërmes arsimimit të standardizuar etj. Gjithashtu, edhe pikënisja teorike e Eric Hobsbawm-it (në kuadër të qasjes moderniste) në lidhje me ngritjen e identitetit kombëtar nëpërmes shpikjes së traditave të përbashkëta [18], nuk ka qenë e mundur të zbatohet, në kuptimin e shpikjes së traditave të përbashkëta, që bashkëidentifikojnë/gjithëpërfshijnë, sidomos që pranohen bashkërisht nga minoriteti serb, shumicën shqiptare dhe minoritetet e tjera në Kosovë. Parë edhe nga këndvështrimi praktik, nuk ka qenë i mundur organizimi i përmbajtjes së bashkësisë politike në Kosovë, në kuptimin e një identiteti kombëtar kosovar, sepse, përveç të tjerash, shqiptarët e Kosovës përgjatë pothuajse më shumë se gjysmës së kufirit të tyre, kufizohen me shqiptarët në Shqipëri, me shqiptarët në Maqedoninë e Veriut, me shqiptarët në Serbi dhe me shqiptarët në Mal të Zi. Gjithashtu, një pjesë e serbëve të Kosovës kufizohen me serbët në Serbi. Dhe, për më tepër, as kombi serb si tërësi dhe as kombi shqiptar si tërësi nuk kanë pësuar qasje brendakombëtare në të kaluarën, të tilla siç është shembulli i kombit bullgar etj., nga i cili ka rezultuar kombi “bullgar-maqedonas” ose kombi “maqedonas-bullgar” në Maqedoninë e Veriut.

Rrjedhimisht, duke marrë parasysh aspektin teorik dhe praktik, si dhe kontekstin historiko-politik të Kosovës në përgjithësi, mundësia e vetme më reale për organizimin e bashkësisë politike në Kosovë ka qenë modeli multikulturalist (ku bashkësia politike bazohet kryesisht në institucionalizimin dhe mirënjohjen reciproke të grupeve kulturore). Parë nga këndvështrimi i qasjes multikulturaliste për organizimin e bashkësive politike, nuk do të ishte krejtësisht e pamundur ngritja e një identiteti të përbashkët deri në një nivel të patriotizmit shtetëror kosovar, sikur Serbia ta pranojë Planin e Ahtisaari-t dhe të mos e pengojë pavarësimin e Kosovës (duke përfshirë anëtarësimin e Kosovës në OKB). Në kuptimin e një

identiteti, në një mënyrë ose tjetër kishte arritur deri në një masë, sa ta ushqente identitetin kombëtar të shumicës shqiptare, identitetin kombëtar të minoritetit serb dhe të minoriteteve të tjera në Kosovë. Me fjalë të tjera, një identitet shtetëror që mirënjeh, respekton dhe promovon trashëgiminë kulturore iliro-dardane të shqiptarëve të Kosovës që nga antikiteti, dhe trashëgiminë kulturore kishtarë të serbëve të Kosovës që nga Mesjeta (që njëkohësisht është edhe trashëgimi kulturore e shqiptarëve të Kosovës) dhe trashëgimitë kulturore të minoriteteve të tjera në Kosovë. Edhe pse ky identitet (deri në një nivel të patriotizmit shtetëror kosovar), vështirë se do të mund të fuqizohej në atë masë, sa të bëhet më i fortë se identiteti kombëtar i shumicës shqiptare në Kosovë, dhe më i fortë se identiteti kombëtar i minoritetit serb në Kosovë.

Pas kërkesës së Qeverisë së Beogradit, që të bëhet vlerësimi i shpalljes së Pavarësisë së Kosovës nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND), dhe pas konstatimit të kësaj gjykate, se shpallja e pavarësisë së Kosovës ishte e ligjshme [19], në vend që t'i bëhej presioni i duhur Serbisë (për ta njohur Pavarësinë e Kosovës), 27 shtete të Bashkimit Europian (BE), plus Serbia, e sponsoruan rezolutën, e cila u miratua nga OKB-ja më 9 shtator 2010 dhe përcaktoi nisjen e një dialogu mes Kosovës dhe Serbisë nën regjimin e BE-së, duke rezultuar fillimisht si dialog teknik. Më pas, nga fundi i vitit 2012 u shndërrua në dialog politik, i karakterizuar në vazhdimësi nga mungesa e transparencës dhe e llogaridhënies, dhe rezultoi me nënshkrimin e marrëveshjes për asociacionin e komunave me shumicë serbe, marrëveshje e cila ishte në kundërshtim me kushtetutën e Kosovës. Sikur të udhëhiqej dialogu i palës shqiptare të Kosovës bashkërisht si pozitë-opozitë (me vigjilencë dhe transparencë), nuk do të bëhej një gabim i tillë, duke nënshkruar një asociacion të tillë në kundërshtim me kushtetutën e Kosovës. Për më tepër, nuk duheshin bërë lëshime/gabime të tilla, duke marrë parasysh

se, paraprakisht, edhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND) e kishte legjitimuar Pavarësinë e Kosovës. Rrjedhimisht, Kosova asnjëherë nuk kishte qenë në pozicion më të favorshëm negociator në përballje me Serbinë.

Në fakt, pas nënshkrimit të asociacionit të komunave me shumicë serbe nga pala e Kosovës, dhe sidomos pas zhvillimeve gjeopolitike (luftës në Ukrainë etj.), dhe shtimit të përpjekjeve të faktorëve ndërkombëtarë-perëndimorë për ta ndarë Serbinë përgjithmonë nga Rusia, Serbia po shfrytëzon rastin të manovrojë me çështjen e asociacionit, sepse: e ka parasysh se Kosova me 90% shqiptarë dhe me karakter unitar të organizimit shtetëror, *de facto* është shtet i shqiptarëve, dhe se ky shtet edhe nëse nuk e arrin bashkimin klasik me Shqipërinë (pavarësisht anëtarësimit të Kosovës në OKB), do të arrijë të ketë një lloj bashkimi/integrimi me Shqipërinë, më të fortë se me çfarëdo shteti tjetër, sidomos duke përfshirë unifikimin e institucioneve kulturore dhe sportive gjithëshqiptare, dhe se forca politike e minoritetit serb në Kosovë me vetëm 5% do të zbehet me kohën. Prandaj Serbia përpiqet me çdo kusht, që përtej Pakos së Ahtisaari-t, nëpërmes asociacionit me kompetenca ekzekutive ta federalizojë Kosovën dhe, rrjedhimisht, nëpërmes minoritetit serb në Kosovë të bëhet bashkëpronare e barabartë me shqiptarët, e karakterit shtetëror të Kosovës dhe e identitetit kosovar, pavarësisht dallimit të 5% serbëve versus 90% shqiptarëve në Kosovë. Përndryshe, duket se tashmë Serbia nuk po vazhdon të joshet as nga aneksimi i një “cope të vogël të Kosovës” (edhe sikur faktorët ndërkombëtarë perëndimorë ta mbështetnin idenë e ndarjes/shkëmbimit territorial mes Kosovës dhe Serbisë), sepse me aneksimin/shkëmbimin territorial do të humbte përgjithmonë çfarëdolloj bashkëpronësie të karakterit organizativ të shtetit të Kosovës dhe të identitetit kosovar. Rrjedhimisht, është jetike që pozita dhe opozita politike shqiptare e Kosovës të mos merren tani me fajësime mes tyre, por të unifikohen dhe të gjejnë zgjidhjen më të

mirë të mundshme në lidhje me çështjen e asociacionit, dhe bashkërisht të marrin përgjegjësinë për Kosovën.

Referencat:

1. Anthony D. Smith (2008): Nationalism; Theory, Ideology, History. Cambridge Polity Press, f. 41.
2. Elisabeth Bakke (2000): How voluntary is national identity? Conference paper, the 8. National Political Science Conference, Tromsø2000:http://folk.uio.no/stveb1/How_voluntary.pdf, f. 1, 12
3. Po aty, f. 1.
4. Will Kymlicka (1995): Multicultural Citizenship. A liberal theory of minority rights. New York: Oxford University Press, f. 2.
5. Po aty, f. 184-185.
6. Will Kymlicka (2001): Politics in the Vernacular: Nationalism, Multiculturalism, and Citizenship. Oxford University Press, f. 25-38.
7. Will Kymlicka (1995): Multicultural Citizenship. A liberal theory of minority rights. New York: Oxford University Press, f. 11
8. Po aty, f. 34-38.
9. Po aty, f. 188-189, 191, 192.
10. Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, 2001: f. 10-12, 19-20, 27-28: http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/FrameworkPocket_ALB_Dec2002.pdf
11. Po aty, f. 11.
12. Report of the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosova, 2004: 1, 14-16: <https://undocs.org/en/S /2004/348>

13. UNOSEK report (2007): The Status Process: <http://www.unosek.org/> dhe <https://www.unosek.org/the-status-process/>
14. Anthony D. Smith (2008): Nationalism; Theory, Ideology, History. Cambridge Polity Press., f. 78-86 Shih edhe: Anthony D. Smith (2006): Nationalism and Modernism. Oxon Routledge, f. 190-19.
15. Ernest Gellner (1998): Nasjonalisme. Spartacus Forlag, f. 39-43, shih edhe: Ernest Gellner (2006): Nations and Nationalism. Black well Publishing Ltd., f. 33, 36-37.
16. Benedict Anderson (2006): Imagined Communities. Verso., f. 9-36, 37-43, 44-46.
17. Po aty, f. 135.
18. Eric Hobsbawm & Terence Ranger (2012): The Invention of Tradition. Cambridge University Press, f. 1-14, 263-264.
19. International Court of Justice (2010), f. 53: <https://www.icj-cij.org/files/casereLATED/>
20. 141/141-20100722-ADV-01-00-EN.pdf

II. BASHKËSIA E KOMUNAVE SERBE NË KOSOVË DHE “BOTA SERBE”

2.1 Prof. dr. Mazllum BARALIU

Asociacioni i komunave me popullsi me shumicë serbe sipas projekt-statutit europiano-amerikan të Brukselit

Efektet negative dhe pasojat

Motot e punimit

E vërteta dhe drejtësia janë mbi të gjitha, sepse vetëm prej tyre varet madhështia e kombit.

(Emil Zola)

Tërbimi që kaloi në këto brigje nuk njohu masë, nuk njohu as ligje...

(Dhimitër Shuteriqi)

Kush mbjell virtytin, korr lavdinë.

(Leonardo da Vinçi)

Nuk mund të ndërtohet një komunitet politik, pa ndërtuar më parë një komunitet moral.

(Hegeli)

Brendia e mirëfilltë e një qeverisjeje demokratike konsiston në sovranitetin absolut të shumicës.

Prelogomena e sfondit historik të problematikës

Pas luftës së fundit në Kosovë, rrjedhimisht pas administrimit eksperimental ndërkombëtar dhe pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, bashkësia ndërkombëtare konsideronte se duhej të zhvillohej një proces dialogimi mes Kosovës dhe Serbisë për shtrimin, diskutimin dhe zgjidhjen e problemeve ndërshtetërore mes tyre.

Sipas disa burimeve, kinse më kredibile, për ta mënjanuar apo t'ia pamundësuar Ruisë që të ketë rol interferues, ndikim apo edhe të shfaqë pengesa në këtë proces, bashkësia ndërkombëtare, me ndikim “në punë të mëdha”, ia mori këtë kompetencë a mundësi Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe në mbledhjen e Asamblesë së përgjithshme të OKB-së, në Nju Jork, këtë detyrë ia barti Bashkimit Europian. Pra, që BE-ja të merrte detyrën e mediatorit në bisedimet apo dialogun teknik, siç thuhej e quhej ai atëherë, mes Kosovës dhe Serbisë.

Fatkeqësisht, për shkak të lëshimeve dhe gabimeve tona, pra të qeverive tona dhe për shkak të kinse qëllimeve strategjiko-gjeopolitike të asaj që quhej Bashkësia Ndërkombëtare dhe BE - dialogu i ashtuquajtur teknik apo për çështje bilaterale teknike mes Kosovës dhe Serbisë, i cili përfshin edhe më shumë se 6 (gjashtë) pikat e papranueshme të Ban Ki Munit, derivoi për të kaluar në formatin e bisedave - deri në negociata - përsëri tejet të dëmshme e të papranueshme politike dhe diplomatike. Për më keq, ky proces i dialogut vazhdoi përmbi 13 vjet dhe gjatë gjithë kohës mes palëve dhe ndërmjetësve të tyre u diskutua dhe kinse u dakordua kryesisht për çështje e tematika të brendshme e sovraane të Kosovës.

Njëra prej shumë marrëveshjeve (të cilat as sot e kësaj dite nuk dihet se sa janë arritur saktësisht në Bruksel), e cila është konsideruar gabimisht ose qëllimisht si *marrëveshje e normalizimit me Serbinë* e vitit 2013, është ajo për asociacionin e komunave me shumicë të popullsisë serbe në Kosovë.

Një tjetër marrëveshje fatkobe dhe fatale (ashtu sikurse edhe e para) për kinse parimet e asociacionit, është lidhur mes të dy vendeve në gusht të vitit 2015. Kështu, dialogu i ashtuquajtur me Serbinë edhe pas edhe 13 vjetësh ishte një histori dështimi, sepse nuk solli pothuajse asnjë rezultat me rëndësi në përmirësimin esencial të marrëdhënieve e sidomos në lidhjen e një traktati a marrëveshjeje përfundimtare, e cila në brendinë e saj do të kishte njohjen reciproke ndërmjet dy vendeve: Kosovës dhe Serbisë.

I ashtuquajturi BE apo më saktë dy përfaqësuesit e dy shteteve kryesore të BE-së me iniciativën frënge jashtë institucioneve zyrtare dhe jashtë hierarkisë së BE-së, kinse për ta intensifikuar dhe rezularizuar dialogun në vitin 2023, do të hartojnë të ashtuquajturin “Plani franko-gjerman”, me qëllim arritjen kinse të një “marrëveshjeje normalizimi” mes dy shteteve.

Kjo, thuajse kuazimarrëveshje ndërkohë, më saktë gjatë vitit 2023, prodhoi apo nxori në sipërfaqe edhe të ashtuquajturin *annex* apo *udhërrëfyes zbatimor* të marrëveshjes së Brukselit, nga Ohri.

Pa dashur që të kridhemi gjerë e gjatë në këto akte, ndryshe të paprecedentë në analet e së drejtës ndërkombëtare, pikërisht të tilla çfarë mund dhe duhet të cilësohen edhe ato 39 apo 40 kinse marrëveshje të arritura më parë në dialogun (përgjatë 13 vjetëve) në Bruksel, sepse nuk janë objekt i drejtpërdrejtë i trajtimit dhe analizës në këtë shkrim. Megjithatë, lypset domosdoshmërisht këtu të theksohet fakti notar, akribor dhe i pakontestueshëm, se këto akte të sipërpërmendura, pashembullsisht u janë imponuar palëve, posaçërisht Kosovës (madje të patrajtuar si palë e barabartë), pa marrë parasysh se ato nuk janë marrëveshje *par exelance*, me tiparet e duhura dhe të kërkuara ndërkombëtarisht dhe as që janë nënshkruar sipas uzuseve ndërkombëtare, që do të thotë se as nuk janë pranuar

shprehimisht dhe *de lege artis*, ashtu siç kërkohet me rregullat dhe parimet e së drejtës ndërkombëtare.

Meqë produkt i drejtpërdrejtë, po ashtu edhe imponues për Kosovën i këtyre dy akteve të sipërpërmendura, tashmë rezultoi të jetë edhe i ashtuquajtur *Plani Franko-Gjerman* ose *European* i Brukselit, si dhe *Projekt-statuti europiano-amerikan* për asociacionin e komunave me shumicë të popullsisë serbe dhe meqë ajo materie që është normuar në këtë projektstatut, tenton të përcaktojë ose më saktë të imponojë edhe strukturën vertikale dhe atë horizontale të asociacionit, në vazhdim do të përpiqemi të analizojmë, shkoqisim dhe pranojmë pikërisht përmbajtjen, zgjidhjet kryesore, objektivat, karakterin dhe arkitekturën rregullative të asociacionit përmes këtij projekt-statuti, kuptohet së bashku edhe me efektet eventuale negative dhe pasojat e tij.

Le të fillojmë nga preambula

Tabloja etiologjike e inicimit dhe e ecurisë zhvillimore të problematikës së asociacionit për të cilin po flasim nuk do të ishte e plotë, në qoftë se, paraprakisht, nuk flitet shkurt për ecurinë dhe tablonë etiologjike të problematikës. Në të vërtetë, negociatorët tanë që kishin shkuar të bisedonin për procesin e decentralizimit në Kosovën e ardhshme të pavarur, sovrane dhe demokratike, në rrethana sa specifike, po aq edhe infantile, lehtë e shkarazi kishin pranuar propozimin e të jashtëmëve dhe të fuqishmëve, që komunat me shumicë të popullsisë serbe, të kishin të drejtë të krijojnë asociacionin e tyre specifik dhe special në Kosovë.

Në një kinse proces negociator, por realisht në një proces perfid, fillimisht kinse teknik, por realisht në vijim edhe politik e diplomatik, në të cilin Serbia fshihej prapa shpinës së Rusisë dhe kishte hyrë për të nxjerrë sa

më shumë koncesione pa marrë obligim për pothuajse për asgjë, negociatorët serbë kishin arritur që të futin në agjendë rrafshin e tretë të pushtetit në Kosovë. Një pushtet toksik, monstruoz dhe frankenshtajn, që nuk ishte instaluar kurrë dhe askund deri atëherë, pra as në rregullimet kushtetuese të Kosovës e as në projektin, për të cilin negociohej, për një kushtetutë të re të një Kosove të pavarur e demokratike. [1]

Propozimi inicial për asociacionin, që më vonë do të paraqitet si “cung në derë të kovaçit apo edhe thembër e Akilit”, që delegacionit tonë i ishte ofruar nga një diplomat gjerman anonim, periferik e irrelevant, të cilin, si duket, me ironi, por gjithsesi edhe me pezëm, autori i botimit të *Emrit të Autonomisë*, z. Veton Surroi, diplomat in në fjale, si me shpoti e ironi, do ta quante herë Krono Berger, herë Shllapter Berger. [2]

Fillimisht, kinse në mbështetje të nenit 10 të Kartës Europiane, i sipërpërmenduri *Shllapter Berger* pati kërkuar nga negociatorët kosovarë në Vjenë, që i ashtuquajturin konsorcium (që më vonë do të bëhej *asociacion i komunave me shumicë të popullsisë serbe*), të formohej në baza etnike, ndonëse as në nenin 10 të Kartës Europiane nuk ekziston ai formulim dhe as në Këshillin e Europës e as në organet e tij po ashtu nuk ekzistonte një lloj obligimi i tillë. Përkundrazi, në Këshillin e Europës ekzistojnë përcaktime të qarta të Këshillit të Europës kundër diskriminimit në baza etnike.

Për më tepër, delegacioni ynë as nuk vrau mendjen fare, që të mos pranonte konsorciumin, kur dihej qartë se Kosova atëherë, si një vend pa subjektivitet ndërkombëtar dhe pa sovranitet, ende nuk ishte anëtare (as sot nuk është) e Këshillit të Europës, kështu që, rrjedhimisht, nuk kishte asnjë obligim që t’u nënshtrohej rregullave të këtij Këshilli. [3]

Më vonë, megjithatë, “fjala apo nocioni *konsorcium* me kompetencë shtesë”, dhe më vonë në Pakon e Ahtisaari-t edhe si asociacion (me “a” të

vogël), do të ketë kompetenca shumë të reduktuara, gjithsesi jo kompetenca ekzekutive në fushën e pushtetit lokal”. [4]

Në proces e sipër, krijesa surrogate, frankenshtajne dhe toksike si entitet legal, që u formua me pajtimin e të dy qeverive (të Beogradit dhe Prishtinës), në të vërtetë ishte një autonomi territoriale, politike dhe administrative e serbëve të Kosovës. Pra, në asociacion interesat e serbëve të Kosovës marrin formën territoriale, apo të “promovimit të interesave të serbëve të Kosovës, kundruall autoriteteve qendrore”. Brenda territorit të asociacionit, autoritetet e saj do të kenë mbikëqyrje të plotë dhe kompetenca në:

- zhvillimin ekonomik;
- planifikimin hapësinor rural dhe urban;
- arsimin,
- shëndetësi dhe në fusha e veprimtari të tjera, me peshë dhe relevancë parësore.

Vlen të përmendet këtu, se në diskursin politik serb, të paktën që nga koha e diktatorit Millosheviq në Serbi, filloi paraloja e vazhdimit të territorializimit të të drejtave serbe e që është quajtur kinse “mbrojtje nga majorizimi”. Kjo kinse ide prijëse, përndryshe megalomane, irreale dhe irracionale deri në absurd, mbështetet në kinse fundamentin premisor, se serbët nuk duhet assesi të trajtohen si minoritet, rrjedhimisht nuk mund dhe nuk bën kurrësi të majorizohen nga ndonjë shumicë tjetër votuese mbi ta, qoftë ajo edhe shumicë demokratike.

Pra, sipas tyre, ata do të duhej që, me çdo kusht dhe në çdo rrethanë, të jenë të mbrojtur territorialisht dhe kolektivisht nga “majorizimi” i të tjerëve, [5] ndërkohë që sipas tyre, është krejt normale, e arsyeshme dhe e drejtë që ata t’i majorizojnë dhe territorialisht t’i mbizotërojnë të tjerët, qoftë

edhe në tokat dhe ambientet e tyre historikisht autoktone, kompakte, pandane dhe historike. Pikërisht si kërkesë për kinse mosmajorizimin e serbëve në Bosnjë-Hercegovinë, atje ka rezultuar krijesa malinje dhe toksike e entitetit të ashtuquajtur *Republika Serbe*.

Doemos lypset theksuar këtu, se insistimi kontinuiv inkriminues deri në gjenocid i regjimeve barbare serbe për territorialitet (që sipas tyre mbase do të thotë të kesh hapësirë më të gjerë racionale dhe utilitare) e kinse jo të pretendosh e të luftosh për majorizim, si duket është produkt historik i afshit deri në sindromën për predominim, për supremaci dhe hegjemoni të serbëve ndaj të tjerëve. Mbase orekse të tilla si më sipër kanë rezultuar dhe janë kurorëzuar, fatkeqësisht, me luftëra, fatkeqësi, tragjedi dhe krime gjenocidale, që serbët u kanë shkaktuar popujve të tjerë rreth e rrotull ose përreth tyre, sidomos shqiptarëve, boshnjakëve, por edhe kroatëve, hungarezëve, bullgarëve dhe të tjerëve.

Vijimësia e oreksit patologjik, e shprehur dhe e insistuar edhe në qarqet ndërmjetësuese e lehtësuese diplomatike në rastin e bisedave për kinse decentralizimin, për asociacion e diplomacisë dhe të shtetit serb me metoda perfide e bizantine ka funksionuar edhe në retorikat mbi Kosovën dhe rreth saj edhe sa i përket decentralizimit dhe asociacionit.

Naiviteti deri në servilitet, injorancë dhe padurimi i përfaqësuesve tanë në bisedat në Vjenë lidhur me Planin e Ahtisaari-t dhe në përpilimin e Kushtetutës së re, padyshim që e kanë fuqizuar deri në lehtësim, rrjedhimisht edhe në kurorëzim final, punën dhe pabesinë diplomatike serbe në proces. Ky fenomen është karakteristik, veçanërisht në rastin tonë sa i përket dialogut për dy marrëveshjet për asociacionin e komunave me popullsi shumicë serbe në Bruksel.

Me propozim-planin euroamerikan, përndryshe tejet i dëmshëm e me pasoja të pakompensueshme, i ashtuquajtur Plan gjithëpërfshirës i Ahtisaari-

t, siç ishte atëherë dhe është edhe tani evidente e qartë dhe sigurt se u krijua një asimetri që dëmtonte shtyllat kryesore të funksionalitetit të shtetit, veçmas në nivelin vendor, me marrëveshjet e ashtuquajtura “historike” të Brukselit, tashmë në Kosovë potencialisht janë instaluar dy “entitete”, me po ashtu dy “sisteme” menaxhimi. Njëri që është i Republikës së Kosovës dhe pretendon të ekzistojë dhe të funksionojë si një republikë qytetare dhe shumëkombëshe, dhe tjetri, ai i asociacionit të komunave me popullsi shumicë serbë, një territor autonom dhe një etnik, që potencialisht do të ngërthente, prezantonte dhe, pa mëdyshje, edhe të promovonte vetëm ose parësisht interesat serbë paralelisht me ata të të tjerëve ose të veçuar (në kontingjent) nga ata të të tjerëve në Kosovë. [6]

Sistemi menaxhues njëetnik i asociacionit që nga emri, përmbajtja e deri te simbolikat e tij (flamuri, stema etj.) është mohim i sistemit tonë të Republikës së Kosovës me projeksionin e tij shumëtnik, me flamurin dhe himnin pa tekst. Është premisë e mirënjohur doktrinare dhe reale, se tejkalimi gjeneroz i kufirit të të drejtave (edhe) specifike ndaj pakicave në një shtet, në një gamë, masë, vëllim, peshë etj., duhet të konsiderohet seriozisht nga shtetbërësit e diplomacibërësit, sepse disbalancat premisore, sa i përket qarkut, standardeve dhe rezervave shtetërore (*reason d'etat*) dhe (*reason d'etre*), shkaktojnë edhe disfunksionalitetin e shtetit deri në zhbërje të tij, në vend të ndërtimit dhe forcimit perspektiv e afatgjatë të tij. Në raste të tilla, tepria e disbalancimi në zgjerimin (fare irracional) jashtë standardeve të qarkut të të drejtave minoritare, kur dëmtohet shteti ose thjesht nuk funksionon mirë e me sukses, dhe nuk kanë as rëndësi, as jetëgjatësi, as stabilitet funksional, as të drejta, as qenësi, as perspektivë të të drejtave minoritare në vendin a kohën e caktuar historike. [7] Pse? Sepse në vend të zgjidhjes së problemeve, krijohen probleme edhe më të mëdha, më të ndërlikuara dhe ndrydhen perspektivat e një vendi. Madje krijohen edhe

probleme e konflikte të tjera potenciale, kolaterale, rajonale dhe më gjerë. “Dy atllarë me një mullar nuk mund të lidhen”, thotë një urti e popullit tonë. “As dy kafshata nuk futen në një gojë në të njëjtën kohë, sepse kolaboron qenia”!

Prandaj, lidhur me temën tonë, kur përpiluesve të propozimit gjithëpërfshirës të Ahtisaari-t iu shpjeguan argumentet se përse nuk kishte mundësi të kombinohen të gjitha parimet kontradiktore të të drejtave minoritare, pra ato joterritoriale me ato territoriale, ata zotërinj pa një, pa dy theksuan njëzëri: “*Nuk e kemi ndër mend atje, pra në Kosovë, të formojmë një Frankenstein*”. [8] Fjala ishte për asociacionin e pretenduar të komunave me popullsi shumicë serbe. Por, ja që, fatkeqësisht, diplomacia europiane, fare padrejtësisht, nën ndikimin e lojërave të pista dhe kombinatorikave bizantiniste serbiane dhe europiane synonin pikërisht krijimin e një krijese monstruoze dhe juridikisht frankeshtajne, siç do të ishte asociacioni, e bënë asociacionin!

Por, si e bënë? E bënë përmes kinse marrëveshjeve të mëhershme dhe atyre më të reja të Brukselit e të Ohrit, por edhe me ndihmësen e përfaqësuesve tanë injorantë nga Kosova, duke imponuar çdo gjë, madje deri edhe projektstatutin sipas modelit më antidiplomatik, antikorrek, antiparimor dhe antisovran: “Merre ose lëre“! Pikërisht për këtë model-statut të imponuar nga brendi euro-amerikan i Brukselit do të bëhet fjalë më hollësisht në vijim të këtij punimi apo kumtese:

AD 1. Pjesa hyrëse, prelogomenale ose edhe preambulore, sido që ta quash, në projektstatut që quhet *statut*, duhet të jetë e pazakonshme dhe në shpërputhje me metodat dhe modelet e përgatitjes juridike dhe nomoteknike të akteve të ndryshme juridike, qofshin ato edhe nënligjore, ajo që do të duhej të ishte edhe ky akt. Pra, parahyrja ose preambula e projektstatutit

është inkorporuar pas titullit të tij, që është një veprim model dhe modul i pazakonshëm, madje jo i duhur.

AD 2. Në po këtë pjesë hyrëse pa vend dhe me hile, ndër të tjera përmendet edhe Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, rezolutë e cila, pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, pas njohjes së kësaj pavarësie nga mbi 117 vende të botës, si dhe pas kalimit të periudhës kohore prej 16 vjetësh pas shpalljes së pavarësisë, është edhe e tejkaluar dhe pa kuptim sa i përket qëllimit eventual apo edhe vendit e kohës, në të cilat është përdorur kjo sintagmë për një rezolutë tashmë tërësisht dhe qëmoti të tejkaluar!

AD 3. Në pjesën preambulare është përdorur fjalia "*...dhe në respekt të pavarësisë, autonomisë dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës*". Fjala "autonomi" në mes të kësaj fjalie është e pavend dhe e panevojshme, për më tepër edhe qëllimkeq. Kosova është shtet i pavarur dhe përmendja e autonomisë paraqitet si një "mish i huaj në palcë". Kjo, sepse autonomia ngërthen në vete një nivel më të ulët të qeverisjes, të administrimit a vetëvendosjes sesa pavarësia e një vendi. Pra, termi "autonomi" këtu është dukshëm më relativizues dhe më minimizues sesa niveli i pavarësisë, ndaj nuk ka as vend, as nevojë, as bazë e as arsye fare, që ky term të përdoret në tekstin e këtij projektstatuti.

AD 4. Projekt-teksti i statutit nuk ka as nënshkrim autorial, as datë të përpilimit, as autor përpilues nominativ, përveçse ka referimet e Republikës, e cila sipas tekstshkruesit "të fshehtë" e miraton statutin e asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë".

AD 5. Në këtë projekt-tekst të statutit, preambulës së tij i mungon fjala "sovrانيتet" ose në "respekt të sovranitetit" të Republikës së Kosovës". Ndaj vendosja e fjalës "autonomi" dhe mungesa e fjalës "sovrانيتet" në fakt flet për mungesë serioziteti ose të synimit të mirë e pozitiv të përpiluesit të tekstit të këtij projektstatuti.

NENI 1. Interpretimi i lëndës së pretenduar rregullative

AD 1. Termi nën (b) “Serbia”, “Republika e Serbisë”, në këtë projektstatut, pra që është vetëm një akt nënligjor i Republikës së Kosovës, nuk ka as nevojë, as arsye, as bazë për t’u futur në të.

AD 2. Edhe termi “Autoritetet Qendrore” nën (d), në kuptim të institucioneve qendrore të Kosovës, është term jokushtetues, që bie ndesh me kushtetutën, ndaj është i pavend dhe i papërdorshëm si i tillë në legjislacionin e Republikës së Kosovës.

AD 3. Togfjalëshi “e drejta e aplikueshme” (e), në radhë të parë i vendos (me prioritet kronologjik dhe bazik) traktatet dhe konventat ndërkombëtare e më pas ligjet e Kosovës. Shtrohet pyetja legjitime: përse dhe në çfarë baze u dashka, që në një akt nënligjor të një “OJQ”-je (pa kompetenca ekzekutive, siç na thoshin publikisht dhe në shkundje të së vërtetës objektive disa përfaqësueses kinse diplomatikë ndërkombëtarë), e cila duhet të themelohet dhe të funksionojë sipas legjislacionit tonë, ndërkohë që në preambulën e këtij projektstatuti as nuk përmendet fare askund “Ligji mbi asociimin në OJQ” në Kosovë?!

AD 4. Po në pikën (e) të nenit 1, të projektstatutit që po trajtojmë, në vazhdim të tekstit, pas pjesës “ligjet e Kosovës”, thuhet “... dhe legjislacioni tjetër i zbatueshëm në Kosovë”. Shtrohet pyetja: për cilin legjislacion flitet, sepse në Kosovë ka vetëm një legjislacion në fuqi dhe vetëm legjislacioni i Kosovës zbatohet?”. Kësaj pyetjeje qeveria jonë dhe ndërmjetësit duhet t’i përgjigjen!

NENI 2. Interpretimi i dispozitave, rrjedhimisht i lëndës së pretenduar rregullative

AD 1. Përpiluesit e tekstit të projektstatutit european-amerikan kanë manipuluar 100 për qind me tekstin e paragrafit 1 të nenit 2 të projektstatutit,

si dhe me dispozitat e nenit 57 të Kushtetutës së Kosovës. Pse? Sepse bëhet përpjekje e pabazuar dhe e paargumentuar, që veçohet në trajtim (privilegjuet e favorizues të komuniteti serb në Kushtetutë), gjë që nuk është e vërtetë. Pra, këtu kemi të bëjmë me keqinterpretim të dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Neni 57 njësoj dhe barbarisht i trajton (edhe në të drejta dhe detyrime) qytetarët e Kosovës, si dhe ata të komuniteteve pakicë. Pra, si në të drejta, ashtu edhe në detyrime i trajton barbarisht, duke i përfshirë të gjithë dhe i quan *grup kombëtar ose etnik*. Ndërkohë që përpiluesi i tekstit të paragrafit I (1) të nenit 57 i diskriminon pozitivisht dhe i favorizon pjesëtarët e komunitetit serb, gjë që është normë antikushtetuese! Aq më tepër, kur dihet se dispozita e nenit 3 të Kushtetutës sonë, Republikën e Kosovës e trajton si shoqëri multietnike dhe vend të qytetarëve të saj dhe jo të etnive!
[9]

AD 2. Sa u përket “të drejtave të veçanta” apo specifike, komuniteti serb deri më tani si në nivel të pushtetit vendor apo lokal, edhe në nivel të parlamentit dhe të qeverisë, veçanërisht ai komunitet i ka dhe i gëzon ato të drejta. Në nivel lokal, për shembull, e drejta për arsim të lartë, në policinë e Kosovës; në shëndetësi etj. Ndërsa në nivel qendror në Kuvend, komunitetet pakicë në Kosovë kanë vendet e garantuara dhe të rezervuara, si dhe të drejtat e vetos në Kuvendin e Republikës së Kosovës, po ashtu edhe vendet e rezervuara dosido në qeveri (pra edhe pa koalicione qeverisëse) me partitë shqiptare gjatë qeverisjes atje!

Pra, ky shtet në baza etnike u dhuron të drejta specifike komuniteteve pakicë pa dallim! Dhe asociacioni po pretendohet të formohet në baza etnike, gjë që është kryekëput në kundërshtim me parimet bazë, mbi të cilat është themeluar ky shtet dhe në kundërshtim me dispozitat e sipërpërmendura dhe të tjera të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

AD 3. Edhe dispozita e paragrafit 3 të këtij neni të projektstatutit ofron një kornizë vetëmenaxhuese për komunitetin serb të Kosovës, që është antikushtetuese edhe ofron kompetenca ekzekutive shtesë në krahasim me komunitetin anëtarë të asociacionit. Pra, shkurt e shqip, përpiluesit e projektstatutit, më shumë se herëve të tjera, kësaj radhe me këto dispozita, minoritetit serb në Kosovë ua dhurojnë në pjetë jo vetëm një “kornizë vetëmenaxhuese, por një multistrukturë shtetërore, një model shteti paralel, tandem e konkurrent me strukturën shtetërore të Kosovës, së cilës i bën jo vetëm karshillëk si strukturë multifunksionale dhe jashtë kushtetuese, por edhe si pushtet vetëmenaxhues etatist, i cili hyn si në një derë të vogël, por ia mbyll derën e madhe pothuajse përgjithmonë Republikës sonë, duke e paaftësuar dhe invalidizuar atë deri në asfiksi totale, rrjedhimisht deri në zhbërje.

Ky model i imagjinuar si faktik dhe patologjik (i cili po pretendohet të implementohet edhe juridikisht) i një shteti artificial, i imponuar dhunshëm në shtetin legal, legjitim dhe autentik, ekzistues e juridikisht autokton të Kosovës, me tentakulat, objektivat dhe përmbajtjet tekstuale që përmban brenda, pa dyshim me shtytje dhe stimulim permanent, pa vonesë shtesë e me më shumë siguri e siguresë, do ta shpërbëjë shtetin e Kosovës, parësinë, qeverisjen dhe qenësinë e tij mbi dhé! Ky biçim shteti në shtet jo vetëm që është kundër dhe antikushtetues, por është plotësisht i pavarur nga Republika e Kosovës, nga sistemi ynë kushtetues juridik e administrativ, por për më tepër edhe e rrezikon deri në zhbërje atë sistem shtetëror, pra të Republikës së Kosovës. Madje rreziko, jo vetëm tërë Kosovën, por edhe tërë rajonin e shumë më gjerë!

Por, si e rrezikon? Fillimisht përmes marrëveshjeve të Brukselit të viti 2013 dhe 2015, pastaj përmes marrëveshjes së Brukselit të vitit 2023 dhe asaj plotësuese të Ohrit të po këtij viti, por sidomos edhe përmes

projektstatutit të pretenduar e të ashtuquajtur euroamerikan. Në funksion dhe shpjegim më hollësisht të kësaj që u tha dhe u shkrua më sipër, gjithkush e di tashmë se Serbia, në varësi nga rrethanat, kushtet dhe mundësitë, por edhe nga konstelacionet ndërkombëtare gjeopolitike dhe gjeostrategjike të marrëdhënieve ndërkombëtare, do të synojë e iniciojë përmes asociacionit, si dhe do të vazhdojë deri në riokupim të Kosovës dhe jo vetëm.

Prandaj nuk qëndron në asnjë tentakulë stabile botëkuptimi a këndvështrimi politik, se kinse Serbia nuk e do asociacionin. Ajo sa për fillim e do asociacionin (nëse i nevojitet në çastin e dhënë gjeopolitik dhe gjeostrategjik), që ta shfrytëzojë si kapisllë iniciale, për të vazhduar strategjinë e saj të rikthimit (në vendin e kriminit) me metoda të kombinuara hibride të luftës ose, nëse duhet, edhe me agresion a invazion klasik, që ta rimarrë a rikthejë nën sovranitetin e saj sërish të gjithë territorin e Kosovës. Por kjo në planimetrinë e botës me litarë serbë dhe rusë do të ishte dhe është fare pak dhe e pamjaftueshme. Ajo do të vazhdonte sërish më në perëndim, por edhe në jug për t'u rikthyer në kohën dhe çastin e duhur e të përshtatshëm për të aneksuar edhe Kroacinë, Malin e Zi, Bosnjë-Hercegovinën dhe Slloveninë, e në jug Kosovën, Maqedoninë e Veriut etj.

Pra, militarizmi aktual serb, me ndihmën dhe për interes edhe të atij rus, me politikat hegjemoniste dhe neokolonialiste, dëshiron të krijojë Serbo-Sllavinë e re, ashtu siç Putini me planin e tij të megaloidesë greko-bizantine, dëshiron të rithemelojë apo ta rikthejë Rusinë e vjetër cariste, rrjedhimisht perandorinë carëve rusë me seli në Kremlin, pikërisht ashtu siç shëmbëllen qartë e çiltër me shembullin flagrant dhe brutal të invazionit rus në Ukrainë, i cili para syve të Europës demokratike dhe të të gjithë botës bashkëkohore neoliberale fatkeqësisht po ndodh edhe sot e kësaj dite.

Pra, instalimi i asociacionit të komunave me shumicë të popullsisë serbe në Kosovë do të thotë *jo integrim të komunitetit pakicë serb në*

institucionet e Kosovës, por dezintegrimit i tyre dhe *destabilizimit të Kosovës*. Druhemi se mbase do të thotë edhe konflikti i pashmangshëm, rrjedhimisht luftë në Kosovë dhe luftë në Ballkan, pse jo edhe më gjerë! Prandaj dilema a pikëpamja se e do apo jo Serbia asociacionin në Kosovë, nuk është krejtësisht reale, sepse ajo e do, sigurisht në kontekstin, relacionin a momentin e preferuar dhe të përshtatshëm për realizimin e synimeve, planeve dhe objektivave të saj potencialisht neokoloniale ndaj fqinjëve të vet, së pari ndaj Kosovës, por edhe ndaj të tjerëve në fqinjësinë ballkanike. Rasti i Banjës, më datë 24 shtator, pa asnjë dyshim na jep sqarime dhe përgjigje të mjaftueshme faktike dhe juridike, se çfarë është në gjendje Serbia politike dhe militariste të bëjë në dëm të Kosovës, paqes dhe stabilitetit në Ballkan dhe Europë.

AD 4. Le të kthehemi të kompetencat e asociacionit

Asociacioni sipas këtij projektstatuti evropian do të mund të ketë jo vetëm kompetenca ekzekutive, pra vendimmarrëse, por edhe të tilla puro shtetërore. Ndaj ky shtet i dyfishtë mund të rezultojë të krijohet, pra të shndërrohet në një shtet tjetër pandam e rival (në mos edhe armiqësor) autentiko-juridik, do të ketë jo vetëm hallka të mirëfillta vetëmenaxhuese e vetëvendosëse brenda territorit të asociacionit, por edhe kompetenca ekzekutive me autoritet e mekanizma vendimmarrës të tipave të: kompetencave ekzekutive, mundësi, vendosje, mendim, vlerësim dhe vlerësim pozitiv, togfjalësha këta që janë evidentuar disa herë në tekstin e projektstatutit evropiano-amerikan! E që në një mënyrë a një tjetër janë karakteristika dhe autorizime veçorizuese shtetërore dhe jo të një kinse asociacioni OJQ, siç pretendojnë në mënyrë tejet naive të na e paketojnë e reprezentojnë disa kinse ambasadorë, përfaqësues të disa vendeve, madje edhe mike të Kosovës.

Është uzus pothuajse ndërkombëtar, pra universal, është parim shekullor dhe është rregulle elementare biznesore dhe diplomatike, që miqtë mes tyre solidarizohen, ndihmohen, përkrahen e fuqizohen dhe nuk ndëshkohen, as nuk plandosen ekonomikisht dhe as politikisht (pamëshirshëm) për tokë. Miqësia (përveçse kur është jo e sinqertë dhe me interes e qëllim malinj) edhe me kujdes kultivohet dhe mbrohet e assesit nuk goditet mortalisht edhe pse ne mendojmë se është interes i jashtëzakonshëm dhe i pazëvendësueshëm strategjik përkrahja e Kosovës tani dhe gjithnjë, pikërisht siç është relevante deri në pedestal respektimi dhe ruajtja me çdo çmim e miqësisë dhe krijimi i një partneriteti strategjik të shteteve të KVINT-it dhe të gjithë Perëndimit me Kosovën dhe të gjithë shqiptarët në Ballkan dhe në botë. Është evident i pamohueshëm dhe i parrëzueshëm fakti, se vetëm faktori shqiptar në Ballkan dhe gjetiu është dëshmuar si aleati më i sigurt dhe më besnik ndaj Perëndimit dhe veçmas ndaj SHBA-së. Kjo duhet të vlerësohet, çmohet dhe respektohet e jo të margjinalizohet, minimizohet dhe nënçmohet deri në kundër efektin domino-metastazues malinj dhe pasojave të pariparueshme strategjike dhe politike për Perëndimin, që nëse vazhdon ky trend i politikës defaktorizuese dhe abandonuese të Perëndimit deri në mospërfillje flagrante ndaj faktorit shqiptar e veçmas ndaj Kosovës parimore, qëndresëtare dhe piemontiane, druajmë se mund të ketë pasoja të pamenaxhueshme dhe afatgjata.

NENI 3. Interpretimi i lëndës së pretenduar rregullative

AD 1. Në paragrafin 1 të këtij neni, përpiluesit e projektstatutit edhe më shumë se në paragrafin 4 të nenit paraparak, i vënë plotësisht në spikamë jo vetëm intencat dhe objektivat e asociacionit por edhe “kompetencat, fushëveprimin e punës, organizimin dhe funksionimin e organeve, si dhe të

gjitha punët e tjera të asociacionit (neni 3, paragrafi 1 i projektstatutit të asociacionit).

AD 2. Projektuesit e këtij statuti nuk e kanë parashikuar situatën juridike në të cilën, për shembull, verdikti i Gjykatës Kushtetuese mund të ishte negativ për asociacionin ose nëse jashtë afateve ligjore do të mund të ndodhte që gjykata kushtetuese me muaj e vite, siç ndonjëherë po ndodh fatkeqësisht edhe tani, të mos nxjerrë verdikt, pra të mos jap mendim as pozitiv dhe as negative për një hark kohor relativisht dhe paarsyetueshmërisht të gjatë. Çka dhe si të veprohet më tutje në situata të tilla për shembull?

Paragrafi 4 i nenit 1 të projektstatutit taksativisht flet vetëm për vlerësimin pozitiv të gjykatës kushtetuese, që ndërlidhet me simbolet e asociacionit, asgjë tjetër dhe asgjë më tepër! Po çka dhe si, në rast të një vlerësimi tjetër eventual, që realisht dhe objektivisht mund të rasisë të vijë nga një institucion i pavarur kushtetues, siç është gjykata kushtetuese?!

NENI 5. Interpretimi i lëndës së pretenduar rregullative

AD 1. Dispozita e paragrafit 3 të nenit 5 të projektstatutit garanton *moscenueshmërinë e kompetencave ekskluzive të komunave*, kompetenca këto që ato komuna i kanë të garantuara me nenin 40,2 të ligjit për vetëqeverisje lokale.

Nga kjo dispozitë ligjërisht rezulton se kompetencat dhe autoriteti i fituar më parë me ligjet e Kosovës nga BE-ja nuk preken në asnjë element, në asnjë pjesë a segment të tyre, kur ato komuna anëtarësohen në asociacion. Përkundrazi, të drejtat individuale dhe ato kolektive të komunitetit serb në komunat veriore, pa diskutim përkundër parimeve, orientimeve, diskutimeve dhe politikave në asociacion do të mbrohen efektivisht me çdo kusht dhe gjithanshmërisht!

AD 2. Pra, nga sa u tha më sipër, pa diskutim të mëtejshëm, na rezulton se, përveç të drejtave ekskluzive dhe specifike të komunave me shumicë serbe në shkallë lokale, në nivel të asociacionit, i cili këtu gjithsesi na rezulton si një pushtet autoritar, i ndërmjetëm, vetëmenaxhues i asociacionit, që nuk është as pushtet a strukturë lokale dhe as qendrore, por një strukturë qeverisëse dhe një pushtet i ndërmjetëm, nëse doni derivativ, alternativ apo edhe faktik e juridik, pra një shtet në shtet. Pra pushtet i dyzuar, jo i degëzuar.

Pra, këtu kemi shumëfishim të korpusit të të drejtave të një komuniteti pakicë, kuptohet ky korpus i paprecedent i të drejtave të njeriut, reflektohet negativisht dhe në dëm të komuniteteve të tjera pakicë në Kosovë. Kështu, të gjithë diskriminohen, vetëm dikush (komuniteti pakicë serb në Kosovë) është favorizuar nga pushteti për kaq vite, por për më keq edhe tani, pra me dispozitat e këtij projektstatuti, po ai komunitet pakicë, në këtë rast komuniteti serb privilegjohet, sikurse me pakot e mëparshme, edhe me punën dhe përpjekjet aktuale, pra edhe me asociacionin e komunave me popullsi shumicë serbe në Kosovë.

AD 3. TR. Sipas paragrafit 8 të nenit 5 të projektstatutit, shpërndarja e asociacionit mund të bëhet vetëm me vendim të Kuvendit, të miratuar me shumicë votash prej 2/3 të delegatëve të saj.

Pra, askush, as Qeveria dhe as Parlamenti i Kosovës dhe askush tjetër, nuk ka të drejtë që, në një qaste tjetër në kohë, pavarësisht çka bën dhe si sillet asociacioni me organet e tij, po këtë asociacion nuk mund ta shpërbëjë ose ta shkarkojë.

NENI 6. Interpretimi i dispozitave, rrjedhimisht i lëndës së pretenduar rregullative

AD 1. Sipas kësaj dispozite të projektstatutit “europiano-amerikan”, vetëm organet e asociacionit dhe komunat anëtare të tij kanë të drejtë të propozojnë ndryshime të çfarëdo natyre qofshin ato në këtë projektstatut.

Mungesa e së drejtës së organeve qendrore, posaçërisht e Qeverisë së Kosovës, që edhe ajo sipas nevojës dhe interesit qytetar e shtetëror të japë propozime të tilla, flet edhe për mëvetësinë “sovrane” të asociacionit dhe organeve të tij sa u përket kompetencave, funksioneve dhe vendimmarrjes, por edhe sa u përket pabarazimeve, të paktën në veprime të tilla initiale, por edhe vendimmarrëse mes asociacionit dhe Qeverisë së Kosovës.

AD 2. Sa i përket paragrafit 2 të nenit 6 të projektstatutit, vlerësimi pozitiv i gjykatës kushtetuese mund të sigurohet pa vonesa ose pengesa të mëdha, kur dihet se Gjykata Kushtetuese e Kosovës politikisht është e ndikuar shumë ose mjaftueshëm, si nga qarqet me ndikim të jashtëm, ashtu edhe nga stabilizimi politik i Kosovës nga brenda.

NENI 7. Interpretimi i lëndës së pretenduar rregullative

Asociacioni sipas paragrafit 1 të nenit 7 të projektstatutit ngërthen në juridiksionin e tij të gjithë kufijtë administrativë të komunave anëtare të tij. Pra, ndonëse gjeografikisht të ndarë, këta kufij të komunave anëtare, përbëjnë kufirin unik (siç) të të gjithë territorit të asociacionit.

Në këtë rast, meqë sipas ligjit për kufijtë të komunave të Kosovës, po ky ligj sipas kushtetutës nuk mund të ndryshohet as plotësohet pa 2/3 e komiteteve pakicë edhe në kuptim të kufijve komunalë, atëherë rezulton se institucionet qendrore të vendit edhe këtu nuk kanë autoritet për ndryshimin eventual të kufijve administrativë të asociacionit.

NENI 8. Interpretimi i lëndës së pretenduar rregullative

AD 1. Edhe në këtë nen të projektstatutit reflektohet sheshazi karakteri etnik i asociacionit, edhe pse me disa gjimnastika e floskula nomoteknike, përpiluesit e projektstatutit përpiqen që, në paragrafin pasues, të intonojnë ca broçkulla pa kripë, pa yndyrë dhe sidomos të pabazuara!

NENI 9. Interpretimi i lëndës së pretenduar rregullative

AD 1. Me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, asociacioni është pajisur edhe me subjektivitet, pra edhe me status juridik (me personalitet juridik) dhe me kapacitetin juridik të nevojshëm.

Sipas interpretimit logjik dhe teologjik, këtu kemi të bëjmë me një substrat-entitet, shtet të veçantë, i cili posedon dhe ushtron të gjitha kompetencat dhe autoritetin e mundshëm të një entiteti-shtet (brenda kufijve të vet, madje edhe jashtë tyre [10] të këtij projektstatuti), si dhe me ekzistimin dhe funksionimin e këtij entiteti-shtet (asociacionit), si një substrat juridik-politik të mëvetësishëm, rivalizues dhe paralel, por në kushte, marrëdhënie dhe rrethana gjithnjë, ose potencialisht gjithnjë e më toksike, konkurruese, rivalizuese deri në konflikte kompetencash [11] dhe më shumë se kaq, përplasje ligjesh [12] ose jo kohabituese me një entitet tjetër në të njëjtin habitat, por me çdo gjë dhe në çdo gjë veç e veç dhe ndryshe-ndryshe nga njëri-tjetri!

AD 2. Me këtë dispozitë, anëtarëve të asociacionit, që mund të jenë vetëm komunitat me shumicë serbe, iu është mundësuar që, përveç të drejtave specifike themelore, që kanë sipas kushtetutës dhe ligjeve në fuqi të Kosovës, të mund të kenë dhe të shfrytëzojnë edhe të drejta të tjera shtesë, të cilat atyre iu garantohen nëpërmjet asociacionit.

Kjo zgjidhje është fare e padrejtë, sepse krijon epërsi dhe pabarazi kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve të këtyre komunave, duke u njohur

atyre edhe një nivel të tretë (përveç atij lokal dhe qendror - kujto përfaqësimin në Kuvend dhe Qeveri - si dhe të drejtën e vetos p.sh.).

Ndërkohë, kjo zgjidhje e propozuar ngërthen në vetvete një formë a model skajshmërisht diskriminues ndaj qytetarëve të tjerë, në format e tjera pa shumicë popullore serbe. Madje, mungesë e njohjes apo mohim i të dy të tretave (2/3) të vëllimit dhe nivelit të të drejtave të tyre, apo më keq, edhe diskriminim në baza ekskluzivisht etnike, që paraqet shkelje direkte të Kushtetutës së vendit dhe ligjeve të Republikës së Kosovës.

NENI 10. Interpretimi i lëndës së pretenduar rregullative

AD 3. Paragrafi 3 i këtij neni në brendinë e tij përmbajtjesore vë në pozitë të pabarabartë dhe diskriminuese përfaqësimin e komuniteteve të tjera në organet e asociacionit ASK.

Formulimi i kësaj dispozite është bërë në mënyrë të papajtueshme, perfide dhe shpërfillëse ndaj të tjerëve. Kjo sepse kinse reflektimi i diversitetit etnik nuk është garanci e barazisë në përfaqësim dhe vendimmarrje. Për të mos lejuar krijimin e një republike tjetër me serbët etnikë, në rast të formimit, do të duheshin aplikuar këtu mekanizma të duhur kushtetues si vijon:

Në kuvendin dhe organet e tjera të asociacionit, pa marrë parasysh numrin e komuniteteve dhe as të votave që fitojnë, një numër proporcional me numrin që krijon balancë 50 me 50% me numrin e përfaqësuesve të komunitetit serb, të rezervohet dhe garantohet në përfaqësim dhe vendimmarrje edhe për komitetet e tjera në asociacion.

NENI 11. Interpretimi i lëndës së pretenduar rregullative

AD 2. Paragrafi 2 i këtij neni do të duhej të jetë: *Simbolet e asociacionit (flamuri, stema etj.) përveç të drejtës së secilit komunitet me simbolin e vet, asociacioni do të duhet të ketë edhe një simbol të përbashkët të tij, i cili do të*

simbolizonte dhe përfaqësonte secilin komunitet të asociacionit në një simbol të përbashkët, unik, pra, për të gjitha komunitetet që përfaqësohen në kuvendin e asociacionit, si dhe në institucionet e tjera të tij.

AD 3. Zgjidhja nga paragrafi paraparak në organet kompetente vendimmarrëse të asociacionit duhet të kërkohet dhe arrihet ekskluzivisht me konsensus.

AD 4. Në qoftë se nuk arrihet konsensusi apo derisa të mbërrihet konsensusi, përfaqësuesit e komiteteve të tjera pakicë në asociacion do të duhej të kenë të drejtë vetoje.

NENI 12. Interpretimi i lëndës së pretenduar rregullative

AD 1. Aludimi formulativ sa i përket bashkëpunimit “me ligjin në fuqi”, është mjaft konfuz, ambiguitiv dhe i papërcaktuar! Me të drejtë shtrohet pyetja: *Cilit ligj i referohen përpiluesit e këtij projektstatuti?* Sidoqoftë, duke pasur mundësi të hapur e të lirë bashkëpunimi brenda dhe jashtëinstitucional edhe jashtë shtetit të Kosovës, madje rezulton që edhe në këtë fushë veprimtarie, asociacionit me projektstatut i janë dhënë kompetenca, që në marrëdhëniet ndërkombëtare zhvillohen ndërmjet shteteve. Pra, edhe këto kompetenca të asociacionit përngjasojnë me ato kategori që quhen attribute shtetërore!

AD 2. Donacionet e mallrave dhe të pajisjeve, si dhe pajisjet sipas dispozitave të këtij paragrafi, nuk i nënshtrohen asnjë lloj takse ose detyrimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

AD 4. Projektstatuti mundëson krijimin e marrëdhënieve dhe hyrjen në marrëveshje bashkëpunimi edhe me asociacione të tjera vendore e ndërkombëtare, me autoritetet lokale, ato rajonale dhe të njësisive të tjera të vetëqeverisjes lokale në shtetet e tjera, në pajtim me ligjin në fuqi.

AD X. Të gjitha këto kompetenca në fushën e marrëdhënieve reciproke e ndërkombëtare, në të vërtetë, paraqesin ingerenca me peshë e rëndësi primare dhe u jepen për menaxhim vetëm shteteve ose autoriteteve politiko-territoriale, respektivisht etniteteve me ingerenca të caktuara edhe shtetërore.

NENI 13. Interpretimi i lëndës së pretenduar rregullative

AD 1. Dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni promovojnë dhe mbrojnë gjithë korpusin kolektiv dhe individual të të drejtave të serbëve në asociacion, si dhe i koordinojnë ato brenda po këtij asociacioni, i cili do të veprojë në këtë favor, si një formë e bashkëpunimit ndërkomunal.

AD 2. Mirëpo një veçori tjetër tepër interesante dhe me interes e dispozitave të këtij neni, është se i gjithë ky korpus i siguruar i të drejtave në asociacion, në asnjë mënyrë nuk do t'i zvogëlojë, zëvendësojë dhe as përjashtojë të drejtat dhe interesat e subjekteve të tjera juridike, që përfaqësojnë komunitetin serb të Kosovës, për të ndjekur të njëjtat qëllime.

Pra, asociacioni ofron, garanton dhe siguron një korpus të plotë e të tërë të drejtash specifike dhe speciale, të drejtash kolektive po për këtë komunitet, por tani në një nivel tjetër të pushtetit-shtetit, që po vendoset ndërmjet nivelit lokal dhe atij qendror të pushtetit, thënë më mirë në një shtet paralel jashtë orbitës institucionale dhe shtetërore të Kosovës dhe jashtë kornizës kushtetuese dhe legjislative të saj.

AD 3. Për ta lehtësuar ushtrimin e kompetencave përkatëse ekzekutive dhe vendimmarrëse, sipas dispozitës së paragrafit 4 të nenit 13 të projektstatutit, organet e asociacionit kanë të drejtë të nxjerrin dhe miratojnë:

1. rregullore
2. vendime
3. deklarata
4. rregullore të punës
5. udhëzime.

AD 4. Në mënyrë plotësisht të pavarur (jo vetëm autonome) paragrafi 5 i nenit 13 i mundëson asociacionit që “të menaxhojë institucionet arsimore dhe shëndetësore, të cilat financohen drejtpërdrejt nga Serbia. Ja, pra, një model sallamadi i sistemit anadollak midis Kosovës, pa mbikëqyrjen dhe kontrollin e saj!

AD 5. Me parë në paragrafin 2 të nenit 13 në këtë projektstatut është thënë se “nuk do të zëvendësohen, përjashtohen ose as të zvogëlohen të drejtat – të drejtat dhe interesat e subjekteve të tjera juridike, që përfaqësojnë komunitetin serb të Kosovës; ndërkohë që, në paragrafin 6., të po këtij neni, po ky asociacion “do të mbështet ushtrimin edhe të drejtave të zgjeruara” të anëtarëve (që dmth. të komunave) të saj.

AD 6. Sipas dispozitës së paragrafit 7 të nenit 13, i mundësohet që të ushtrojë edhe kompetenca të tjera shtesë, të cilat do të mund të delegohen ndërkohë nga institucionet qendrore. Kjo tregon qartë dhe çiltër jo vetëm konfiguracionin fleksibil dhe dinamik, por edhe juridiksionin fluid dhe të brishtë (në kuptim të metamorfozave eventuale-avancuese të pozitës juridiko-kushtetuese; organizative dhe funksionale drejt një entiteti-shtet (Serbia në Kosovë) dhe shumë më të fortë e të qëndrueshëm të asociacionit republikë në të ardhmen!

NENI 14. Interpretimi i lëndës së pretenduar rregullative

AD 1. Me dispozitat e këtij neni, institucionet arsimore dhe shëndetësore serbe në Kosovë do të mund të jenë plotësisht dhe tërësisht të pavarura:

1. do të financohen nga Serbia;
2. do të mund të kenë rrjetin e tyre të pavarur, të quajtur “Rrjeti arsimor dhe rrjeti shëndetësor serb” në Kosovë;

3. do të kenë zyrat kryesore të ofruesve të arsimit, që do të jenë vendosur në Serbi;
4. do të menaxhohen nga asociacioni;
5. do të licencohen;
6. në territorin e anëtarëve të asociacionit, ofruesit e arsimit dhe shëndetësisë do të mund të përdorin objektet publike të krijuara dhe të bashkëfinancuara nga Serbia;
7. do të mund të lirohen nga dogana dhe të gjitha detyrimet e tjera, derisa të ofrojnë shërbime për interesin publik etj.

Shtrohet një pyetje skajshmërisht logjike: *si është e mundur, që ofruesit privatë të arsimit dhe të shëndetësisë të ofrojnë shërbime në interes publik e, për më tepër, edhe të lirohen nga të gjitha obligimet e tyre që kanë ndaj shtetit?* Precedente dhe eksperimente tepër të rrezikshme po bën ajo që quhet *bashkësi ndërkombëtare*, veçmas BE-ja në Kosovë dhe me Kosovën!

Një propozim i tillë, për të qenë një herë edhe solucion juridik, nuk është më pak sesa një precedent i paprecedent dhe një absurd i paimagjinueshëm dhe i papranueshëm juridik.

AD 2. (h). Sipas kësaj dispozite të pikës h, të nenit 14, të projektstatutit, rrjetet arsimore dhe ato shëndetësore serbe mund të autorizohen për të ofruar shërbimet e tyre edhe në territoret e komunave joanëtare. Kjo do të thotë se territori dhe organizimi e shtrirja administrativo-territoriale e asociacionit, në asociacion, nuk kufizohet vetëm brenda territorit të tij, por gjithandej Kosovës! Pra, asociacioni tashmë ka shtrirje kompetencash dhe operimi realisht dhe praktikisht në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Megjithatë, për të përdorur objektet publike (shkollat dhe qendrat e kujdesit shëndetësor), këta ofrues të kujdesit shëndetësor dhe arsimor shkruan në projektstatut: duhet të marrin leje nga përgjegjësit e komunës përkatëse dhe shërbimet e ofruara, duhet të jenë brenda kompetencave

ekzistuese të komunës etj. Mirëpo edhe ky formulim, kjo dispozitë pra, është mjaft problematike për interpretim, mbase edhe e paqartë sa duhet, ndaj si e tillë lejon mundësi eventuale të keqpërdorimeve dhe manipulimeve në praktikë.

AD 3. (i) Sipas dispozitës së pikës i të projektstatutit, i ashtuquajhuri *rrjeti arsimor serb* do të lëshojë diploma të dyfishta, me dizajn marrëveshtor special nga të dy vendet. Diploma të dyfishta do të lëshojë edhe i ashtuquajhuri institucioni themelues në Serbi. Është jo vetëm e pazakonshme, e pabazuar dhe e çuditshme se si është propozuar një dispozitë e tillë, por e njëjta qoftë si model, qoftë si formulim apo edhe zgjidhje e përfunduar, është edhe jonormale, edhe e papranueshme. Pse? Pikërisht për shkak të absurditetit formulativ, për shkak të mosfunksionimit si zgjidhje dhe sidomos për shkak të pasojave dhe përvojave që mund të prodhojë kinse një zgjidhje e tillë.

Edhe teksti i kësaj pike, sikundër edhe i gjithë teksti në mbarë projektstatutin euro-amerikan, padyshim se është tejet konfuz, shumëkuptimësh dhe mjaft dromcor në të njëjtën kohë. Mirëpo ajo që bie edhe më shumë në sy në këtë kontekst, është fakti se me të vërtetë kemi të bëjmë me propozime dhe kinse zgjidhje jo vetëm malicioze, por edhe të tërthuruara, të çuditshme dhe, gjithsesi, edhe të papranueshme. Prandaj, lidhur me këtë çështje nuk mund të nxirret asnjë konkludim tjetër, përveçse të thuhet me plot gojën, se teksti i propozuar këtu është sa joprofesional, po aq edhe qëllimkeq. Këtu, sikurse edhe në pjesët e tjera të projektstatutit, rezulton intenca e qartë e përpiluesve, që të projektojnë dhe zbatojnë dy sisteme plotësisht të pavarura, antinome dhe antipode, por me theks të veçantë e favorit, që sistemi bazik-inicial serb arsimor të jetë në një shtet tjetër, të gatuhet edhe të kornizohet e përmbajtjesorët atje, pra në Serbi, e pastaj pa asnjë koordinim me këtë sistemin tjetër antinomik dhe antipode të

Republikës së Kosovës e duke u imponuar mbi të, pa asnjë koordinim e as mbikëqyrje të zbatohet në parimin e “lamës së djallit” në Kosovë.

Përndryshe, për të qenë edhe më korrektë dhe konkretë, këtu kemi të bëjmë me ndarje të sovranitetit të Kosovës me Serbinë. Më saktë se kaq, këtu kemi të bëjmë madje me sovranizimin serb të sistemit (edhe ashtu të ashtuqajturin *sistem serb* në Kosovë, ashtu sikurse edhe me dispozitat përkatëse të këtij projektstatuti, është propozuar mëvetësi e plotë dhe sovrane edhe në shëndetësi, edhe në ekonomi, edhe në mbi tetë fushë-veprimtari të tjera jetike (të gjitha këto fushë veprimtari janë shtetërore për nga përmbajtja, natyra dhe karakteri) dhe janë të ndryshme e të ndërduarta, për sa u përket kompetencave dhe autoritetit të tyre.

AD 3. (j). Sipas dispozitës së pikës **j** të këtij projektstatuti, qytetarët e përkatësive të ndryshme etnike mund të marrin shërbimet përkatëse (qoftë nga sistemi serb i arsimit të Kosovës, qoftë nga ai i arsimit serb të shëndetësisë), edhe nga komunat e tjera që janë jashtë qarkut të asociacionit.

Kjo në fillim duket si një mosdiskriminim, por në fakt ndërthur deri në rrëmujë e stërkeq të dy sistemet në një sistem, le të themi unik dhe të tërësishëm, për të krijuar në këtë mënyrë kontradikta, paqartësi, mosmarrëveshje, rrjedhoja e pasoja, si dhe anarki në të dy sistemet shtetërore të Kosovës, dhe atë të Serbisë apo sistemit serb në Kosovë, sistemit zyrtar e shtetëror të shumicës dërmuese në Kosovë dhe atij, pra sistemit realisht, por në të vërtetë artificialisht dhe të pashembullt të instaluar: sistemit shtetëror serb të Serbisë në Kosovë!

NENI 15. Interpretimi i lëndës së pretenduar rregullative

Me dispozitat e nenit 15 dhe nenit të 14 të këtij projektstatuti, jo vetëm që Kosovës i merren të gjitha prerogativat kompetente dhe autorizimet kushtetuese e ligjore në fushën e arsimit për t’u bartur ato në asociacion, por

po kjo fushë-veprimtari, duke u konstituuar në një sistem krejt tjetër dhe ndryshe me emër e me përmbajtje, pra në sistemin serb të arsimit, posaçërisht bazuar në pikën a paragrafin (j) të nenit 15, që ndërlidhet (dhe varet plotësisht) nga sistemi amë a themelues i Serbisë (saqë për më tepër edhe në tekst thuhet) “i Serbisë për Kosovën”.

NENI 16. Interpretimi i lëndës së pretenduar rregullative

I njëjti konstatim nga neni paraprak, pra neni 15, vlen edhe për sa i përket këtij neni.

Pra, sistemi i krijuar apo i lejuar serb i shëndetësisë, kujdesit social dhe atij shëndetësor, sipas po këtij projektstatuti, është sistem, i cili në tërësinë e tij është krejtësisht i mëvetësishëm nga ai i Kosovës e shumë më tepër i ndërlidhur dhe i ndërvarur nga sistemi inicial apo bazë i Serbisë në Kosovë!

NENI 18. Interpretimi i lëndës së pretenduar rregullative

AD 1. Sipas dispozitave të këtij neni, asociacionit i barten të gjitha kompetencat ekzekutive dhe vendimmarrëse edhe në fushën e kulturës dhe atë të trashëgimisë kulturore.

AD 3. Sipas paragrafit 3 të këtij neni, asociacionit i jepet kompetenca të ofrojë këshilla teknike, ligjore dhe profesionale jo vetëm për komunitat anëtare të ASK-së, por edhe ndaj autoriteteve qendrore (siç thuhet në projektstatut të ASK-së). Pra, shtrohet pyetja: *ku mbetet sovraniteti i një qeverie a parlamenti, i cili duhet të marrë këshilla të detyrueshme përmes një projektstatuti të asociacionit, nga një strukturë jo vetëm specifike, artificiale, imponuese e amorfe, por edhe hierarkisht dhe formalisht e dizajnuar dhe e përfaqësuar si një organizëm a strukturë kinse e subordinuar?*

Në fakt, ky asociacion përfaqëson në vetvete një strukturë komplekse surrogate, super dhe ekstraindependente si për nga natyra, ashtu edhe për nga subjektiviteti juridiko-kushtetues.

NENI 20. Interpretimi i lëndës së pretenduar rregullative

AD 1. Sipas dispozitave të nenit 20 të projektstatutit, asociacioni ushtron funksione dhe mbikëqyrje të plotë edhe në fushën e planifikimit urban dhe rural!

AD 2. Për më tepër asociacioni (pika b) ka të drejtë të përfaqësojë interesat e komunave anëtare të asociacionit, para “Autoriteteve Qendrore” për sa u përket problematikave të planifikimit urban dhe atij rural!

NENI 21. Interpretimi i lëndës së pretenduar rregullative

AD 1. Për herë të parë në këtë projektstatut, rrjedhimisht me dispozitat e nenit 21 është parashikuar ndërmarrja e masave nga ana e asociacionit edhe për kthimin e qëndrueshëm edhe të refugjatëve në Kosovë. Serbia vlerësohet të ketë rreth mbi 1 milion refugjatë nga të gjitha vendet ish-jugosllave, ku ka pasur luftë më parë. Me këtë dispozitë, këtyre refugjatëve dhe familjeve të tyre u jepet mundësia që, duke u kthyer në Kosovë, Kosova të rikolonizohet dhe ta ndryshojë konfiguracionin demokratik e demografik, por edhe atë gjeopolitik e politik!

AD 2. (p.d.) Bashkëfinancimin e programeve të integrimi socio-ekonomik për të kthyerit nëpërmjet anëtarëve.

AD 3. (d) Edhe Kuvendi, gjithashtu, mund të ofrojë forma të tjera të ndihmës financiare dhe materiale për të kthyerit.

NENI 22. Interpretimi i lëndës së pretenduar rregullative

AD 1. Sipas dispozitës së paragrafit 1 të këtij neni të projektstatutit, asociacioni ka të drejtë të ushtrrojë (kryejë), koordinojë dhe lehtësojë aktivitetet e kërkimit dhe të zhvillimit brenda kompetencave të anëtarëve të tij. Fushë-veprimtaria e zhvillimit dhe e kërkimit ngërthen në brendi të saj mjaft kompetenca, kuptohet në të gjitha dimensionet dhe komponentët zhvillimorë të një shteti a një shoqërie të caktuar.

AD 2. Për më tepër asociacioni, sipas dispozitës së paragrafit 2 të këtij neni, mund të promovojë dhe avokojë çështje me interes të përbashkët të anëtarëve të tij, si dhe t'i përfaqësojë komunat anëtare edhe pranë autoriteteve qendrore të Republikës së Kosovës.

NENI 23. Interpretimi i lëndës së pretenduar rregullative

AD 1. Asociacioni në emër të lirisë së veprimit dhe në interes të anëtarëve të vet mund të themelojë edhe ndërmarrje të përbashkëta publike. Sa për ilustrim, OJQ-të, sipas legjislacionit tonë në fuqi, deri më tani nuk kanë as të drejtë të përfaqësojnë komunat tona dhe as të themelojnë ndërmarrje të përbashkëta për komuna!

NENI 24. Interpretimi i lëndës së pretenduar rregullative

AD 1. Me këtë nen të projektstatutit është parashikuar struktura e asociacionit, e cila përbëhet nga 6 (gjashtë) struktura organizative institucionale, të cilat me ndryshimet dhe plotësimet e statutit të asociacionit mund të avancohen, fuqizohen dhe kompletohen edhe më shumë.

Baza juridike për këto ndryshime, plotësime e avancime paraprakisht është siguruar në dispozitat e nenit 6 dhe 25 të projektstatutit në trajtim.

NENI 25. Interpretimi i lëndës së pretenduar rregullative

AD 1. (pika c). Sipas kësaj pike të projektstatutit të asociacionit, Kuvendi i Asociacionit mund të miratojë:

1. rregullore;
2. rregullore speciale;
3. rregullore të punës;
4. vendime;
5. qëndrime dhe deklarata.

Fakti që projektstatuti parasheh miratimin e tri llojeve të rregulloreve me emërtime të ndryshme, flet mjaft qartë e çiltër, se kemi të bëjmë me përmbajtje, por edhe destinime të ndryshme, të po këtyre rregulloreve. Duke e pasur parasysh fluiditetin, shumëkuptimësinë dhe gjuhëdrunjësinë e përdorur në këtë tekst të projektstatutit, ka shumë mundësi që po kjo gjuhë fluide, drunjësore, ambivalente dhe shumëkuptimshme, në praktikën juridike të keqpërdoret dhe të interpretohet gabimisht ose në mënyrë joadekuate në asociacion!

AD. 2. Kuvendi i asociacionit, sipas pikës (g) të nenit 25 të projektstatutit është i autorizuar, që të miratojë dhe të rishikojë marrëveshje të ndryshme të bashkëpunimit me palët e treta.

Është fakt notar, që në tekst të projektstatutit nuk është saktësuar se me cilat palë të treta asociacioni mund të bashkëpunojë. Mirëpo, përmes interpretimit të dispozitave këtij projektstatuti, lehtë mund të nënkuptohet që, po ai, pra asociacioni, mund të bashkëpunojë edhe me palët e treta jashtë Republikës së Kosovës. Pra, asociacioni, pa asnjë mëdyshje ka autoritet dhe kompetenca edhe për bashkëpunim ndërkombëtar.

NENI 26. Interpretimi i lëndës së pretenduar rregullative

AD 1. Përmendja e togfjalëshit “diversitet etnik”, për sa i përket përfaqësimit në Kuvendin e Asociacionit, është i gabuar, i pamjaftueshëm dhe i padrejtë si zgjidhje. Përfaqësimi etnik i delegatëve në Kuvendin e Asociacionit, potencialisht nëse bëhet, do të duhet të bëhet sipas parimit të paritetit, që do të thotë 50% e delegatëve në Kuvend duhet të delegohen nga komunat, nga komuniteti serb i çdo komune dhe 50% nga delegatët e komuniteteve të tjera pakicë, që jetojnë nëpër ato komuna në proporcion me përqindjen reale të tyre demografike nëpër ato komuna. Nëse flasim për barazi, ajo së pari do të duhej të reflektohej në përfaqësimin demokratik në institucionet përkatëse, në këtë rast të asociacionit në fjalë. Ndryshe, pa barazi përfaqësuese nuk mund të ketë as demokraci, por tirani të shumicës ndaj pakicës asociative.

NENI 27. Interpretimi i lëndës së pretenduar rregullative

AD 1. (pika 6). Në paragrafin 6 të këtij neni (27) saktësisht thuhet se të gjitha vendimet e Kuvendit të Asociacionit do të zbatohen nga anëtarët e asociacionit, ndërsa në fund të këtij paragrafi, ndër të tjera, thuhet: “Çdo anëtar i asociacionit ka të drejtë edhe të mos i zbatojë vendimet e Kuvendit të Asociacionit”. Në këtë rast, si duket, sikurse edhe në shumë raste të tjera në këtë projektstatut kemi të bëjmë një “*Contradictio in Adjecto*” - *sui generis*!

NENI 38. Interpretimi i lëndës së pretenduar rregullative

AD. 1. (paragrafi 3). Buxheti i asociacionit dhe shpenzimet e tij, sipas projektstatutit europiano-amerikan i nënshtrohen një periudhe pesëvjeçare të mbikëqyrjes nga Bashkimi European.

Pas periudhës pesëvjeçare, BE-ja do të bëjë vlerësimin, nëse mbikëqyrja duhet të vazhdojë apo të ndërpritet! Nëse njëra nga të dyja palët (që do të thotë autoritetet qendrore) dhe asociacionit kërkon që mbikëqyrja të

vazhdojë, BE-ja do të vazhdoj këtë funksion edhe për pesë (5) vjet të tjera. Pas kësaj periudhe shtesë, mbikëqyrja e Bashkimit European do të ndërpritet.

AD X. Por pse mbikëqyrje? Mbikëqyrje do të thotë kontroll, do të thotë varësi, e varësia dhe mbikëqyrja bashkë do të thonë mungesë apo në rastin tonë konkret me Kosovën, do të thotë humbje e sovranitetit dhe e pavarësisë nga të tjerët! Këto dispozita të këtij neni të projektstatutit të asociacionit drejtpërdrejtë ndërhyjnë, cenojnë, godasin dhe dëmtojnë sovranitetin e Republikës së Kosovës.

AD X. Për më tepër, qartë e çiltër asociacioni i komunave me popullsi shumicë serbe në mënyrë absolute njëjtësohet si palë e barabartë (domethënë si shtet me shtet, apo shtet në shtet) me Republikën e Kosovës. Madje, asociacionit i jepet epërsi selektive dhe dominancë mbi Republikën e Kosovës! Ky është rast i pashembullt, ndërsa edhe si zgjidhje a propozim është rrënuese-kapitulluese për Republikën tonë të shenjtë. Edhe kjo dispozitë, si edhe të gjitha të përmendurat e tjera më parë në këtë projektstatut, është e papranueshme dhe fyese në njëren anë, por edhe porealizueshme dhe e pazbatueshme, në anën tjetër. Pse? Sepse pas 16 vjetësh pavarësi të shtetit tonë do të na kërkohet dorëzimi i sovranitetit, madje edhe përmes poshtërimit të shtetit, duke i dhënë epërsi dhe predominancë një surrogati antijuridik dhe antilogjik, siç është substrati i ashtuquajtur *asociacion*, nuk ka as kuptim dhe as miratim nga askush. Mbase duhet bërë me dije e vënë në spikamë, se këtë “ofertë” diabolike edhe shumica demokratike e popullsisë në Kosovë nuk e ka pranuar asnjëherë deri më tash dhe as që do ta pranojë, as sendërtojë ndonjëherë. Kjo siç thamë edhe pak më sipër, nuk ka askund precedent të mundshëm, që të ketë ndodhur në botën e avancuar demokratike.

AD 6. Sipas dispozitës së paragrafit 6 të këtij neni, asociacioni eventual “do të përjashtohet nga detyrimet dhe taksat në përmbushjen e objektivave të tij, madje në të njëjtën bazë, sikurse edhe komunitat anëtare të asociacionit.

AD 9. Dispozita e paragrafit 9 të këtij neni ia mundëson kurdo edhe çfarëdo financimi shtesë për asociacionin, duke kërkuar miratim specifik, madje edhe përtej buxhetit të integruar vjetor (të dhënë më parë) për asociacionin. Që të dy paragrafët e sipërpërmendur nën AD 6 dhe AD 9, paraqesin shkelje drastike të Kushtetutës dhe legjisllacionit tjetër të Republikës së Kosovës.

NENI 39. Interpretimi i lëndës së pretenduar rregullative

AD 2. Dispozita e paragrafit 2 të nenit 39 e sposton dhe e degradon gjuhën shqipe nga emërtimi enumerativ i parë si gjuhë e parë zyrtare në Republikën e Kosovës. Gjuha shqipe këtu diskriminohet dhe ndonëse me Kushtetutë është normuar si gjuhë kryesore në gjithë territorin e vendit, në territorin e asociacionit ajo figuron e nënçmuar si gjuhë dytësore, pas gjuhës serbe.

Edhe kjo është një shkelje tjetër kushtetuese dhe ligjore, të cilën e predikon projektstatuti i asociacionit!

NENI 40. Interpretimi i lëndës së pretenduar rregullative

AD 1+2. Nuk përkojnë me të vërtetën as dispozita e paragrafit 1 dhe as ajo e paragrafit 2 të këtij neni të projektstatutit. E kundërta është e vërtetë. Më parë, së paku tangjencionalisht, është përmendur deri në elaborat sintetik, se asociacioni, me aktivizimin e tij eventual, gjithsesi e rregullon deri në mbivendosje dhe anashkalim autoritetin dhe kompetencat kushtetuese dhe ligjore të komunave anëtare të tij.

NENI 41. Interpretimi i lëndës së pretenduar rregullative

AD 1. Është për të ardhur keq për nivelin kaq të mjerë intelektual e profesional ose edhe ekstramalicioz të përpiluesve të këtij projektstatuti në përgjithësi e të këtyre dispozitave të paragrafit 1 të nenit 41 në veçanti! Si është e mundur që një shteti sovran në relacion me një laborator toksik socio-inxhinierik e me një monstrum të paprecedentë majdan, (siç është ky asociacion i pretenduar) t'i bëhen këso stërkëmbësesh; labirinte e salto mortale fatale, pa asnjë miligram konsiderate për një popull të tërë të shumëvuajtur e për një shtet. Të mos ketë asnjë masë dhe peshë të mirëfilltë të sjelljes demokratike dhe të mos ketë as drejtësi dhe as vrarje ndërgjegjeje as minimale?! Njerëzit tanë kanë të drejtë plotësisht që të pyesin dhe qortojnë vendimmarrësit metropolitanë, se mos duan të përsëritin gabime, padrejtësitë historike dhe mëkatet e pashlyera, që na i kanë bërë gjatë shekujve të kaluar, duke na dëmtuar, gjymtuar e dënuar përjetësisht si “cungun në derë të kovaçit”, siç thotë shpesh në përditshmërinë e tij të vuajtur po ky popull martir!

Si është e mundur që dikush të merr a të ketë guxim e kurajë, që të provojë të imponojë zgjidhje kaq morbide përmes këtij kinse projektstatuti, sikur ky popull shumicë në Kosovë, bashkë me komunitetet e tjera pakicë, të ishte një “fermë zoon-politikon” sikur të ishte pa fare mend në kokë, pra injorant kolektivisht, sikur të ishte i pavend e i paatdhe, pra pa shtetësi dhe i pafe njëkohësisht!

Pra, kjo dispozitë jo vetëm që cenon deri në flagrancë kushtetutën dhe ligjet e vendit, duke shpërfytyruar rendin, nderin publik, interesin utilitar publik të shumicës dërmuese dhe dinjitetin deri në antilogjikë e deri në absurd, duke e dorëzuar në duar të “djajve” edhe sovranitetin, edhe shtetin, por edhe çekuilibrimin pozicional deri në mbivlerësim, mbiçmim e mbivendosje predominante të një pale të imagjinuar (si asociacion në

asociacion), si palë edhe në këtë situatë juridike, siç e etablon paskrupullsisht dhe antilogjikisht përpiluesi euro-amerikan i këtij projektstatuti!

AD 4. Sipas dispozitës së paragrafit 4 të nenit 41, asociacioni ka të drejtë të ndërmarrë edhe nisma e propozime legislative; të marrë pjesë aktive në seanca publike (si palë e autorizuar) dëgjimore lidhur me legjislacionin e ri të Republikës së Kosovës ose me ndryshim plotësimin e atij ekzistues.

AD 6. Asociacioni, për më tepër, sipas kësaj dispozite, ka të drejtë edhe të iniciojë ose edhe të marrë pjesë në procedurat përkatëse para gjykatave kompetente të Republikës së Kosovës, duke përfshirë këtu edhe Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës!

AD 7. Asociacionit çuditërisht, me dispozitat e paragrafit 7 të nenit 41 i jepet e drejta që të iniciojë procedurë edhe para Gjykatës Kushtetuese, kur asociacioni, si person juridik, mund të pretendojë se është viktimë e shkeljes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë. Me këtë dispozitë qytetarët e komunitetit pakicë serb vihen në një pozicion të jashtëzakonshëm të privilegjuar e të favorizuar në raport me të tjerët, të cilët diskriminohen, sepse nuk e kanë këtë të drejtë aktualisht. Pra, me këtë dispozitë, asociacioni vihet në pozicion pariteti dhe partneriteti maksimal me: Kuvendin e Kosovës, Presidencën, Qeverinë dhe Avokatin e Popullit, për sa i përket të drejtës së iniciativave dhe parashtrimeve kushtetuese drejt Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

AD 8. Asociacioni ka të drejtë sipas paragrafit 8 të nenit 41, që të emërojë përfaqësuesit e vet në organet kompetente, siç thuhet në tekst, tek “autoritetet qendrore të Kosovës”!

AD 10. Sipas kësaj dispozite, asociacioni i zgjidh mosmarrëveshjet e qytetarëve të tij në mënyrë vetjake brenda territorit të vet. Pra, sipas tekstshkruesve, atij asociacioni nuk i duhen as ligjet, as gjykatat dhe as

organet dhe institucionet e tjera relevante të Kosovës, për t'i zgjidhur problemet dhe mosmarrëveshjet eventuale në mes tyre!

Asociacioni mund të miratojë edhe procedura përkatëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve brenda asociacionit. Kjo do të thotë, që asociacioni ndërkohë mund të nxjerrë akte edhe me fuqi ligjore, me të cilat do të zgjidhë mosmarrëveshjet e qytetarëve të vet, brenda territorit të vet e të mos ketë fare nevojë (pra t'i përjashtojë ligjet dhe kushtetutën tonë!) për ligjet dhe as kushtetutën formale të Republikës së Kosovës, e cila aktualisht është në fuqi te ne!

NENI 42. Interpretimi i lëndës së pretenduar rregullative

Arbitrazhi ndërkombëtar - humbje totale e sovranitetit

AD 1. Një çështje tjetër jashtëzakonisht e diskutueshme, e ndjeshme dhe përfundimisht e papranueshme, sipas dispozitës së paragrafit 1 të nenit 42, është konstrukti gangrenoz dhe tejet toksik i arbitrazhit. Pra, zgjidhja e kinse mosmarrëveshjeve ndërmjet “asociacionit dhe autoriteteve qendrore” të Kosovës si “palë të barabarta”, sipas propozimit të projektstatutit, pos aktivizimit a funksionalizimit të asociacionit, do të duhej të bëhej përmes, siç thuhet në tekst, një komisioni të arbitrazhit.

AD 2. (2) Gjatë intervalit kohor prej tre muajsh, secila palë në mosmarrëveshje nuk arrin të emërojë arbitrin e vet, ose nëse palët në mosmarrëveshje, nuk arrijnë të bien dakord për emërimin e kryetarit të komisionit të arbitrazhit, po ai arbitër ose kryetar, me kërkesën e secilës palë të marrëveshjes, do të emërohet nga Bashkimi Europian. Pra, asociacionit si palë e barabartë i njihet pozicioni dhe cilësia e shtetit të veçantë në një raport kontraktual me një shtet tjetër me Kosovën!

Kjo dispozitë jo vetëm që paraqet ndërhyrje të paskrupullt dhe klasike në sovranitetin e Kosovës dhe pavarësinë e saj, por gjithsesi dhe për më tepër,

paraqet fyerje dhe cenim të dinjitetit dhe integritetit shtetëror të Republikës së Kosovës. Si e tillë edhe kjo dispozitë, si edhe të gjitha të tjerat të këtij projektstatuti të asociacionit, është totalisht e papranueshme nga qytetarët e Republikës së Kosovës.

AD 4. (4) Vendimi i arbitrazhit, sipas dispozitës së paragrafit 4 të nenit 42 të projektstatutit, është edhe përfundimtar, edhe i detyrueshëm. Pra, precedenti i paprecedent, i një kinse modeli kaq monstruoz, i një kinse organizmi okziliar teknik, komisionit të arbitrazhit, të ideohet e më pas edhe të miratohet si një mekanizëm imponues dhe detyrues ndaj një shteti sovran, siç është Kosova, është edhe skajshmërisht ofendues, injorues e minimizues, që padyshim shpie deri në dëmtim fatal e në zhbërje, rrjedhimisht rrënim të piramidës shtetformuese të Kosovës.

III. Përfaqje rikapitulluese bazuar në efektet dhe pasojat e asociacionit në shtetkonsolidimin dhe përparimin e Republikës së Kosovës

- Si reflektohet dhe çfarë rrjedhosh mund të sjellë (apo prodhojë) asociacioni, (nëse pranohet dhe zbatohet projektstatuti euro-amerikan) për shtetin e Kosovës?

Nga e gjithë lënda e eksplikuar dhe e veçorizuar në pjesën e parë të këtij punimi e që rezulton nga përmbajtja e dispozitave relevante të projektstatutit euro-amerikan, në këtë pjesë të punimit, pa vështirësi të mëdha, mund të konkludohet, se projektstatuti euro-amerikan për asociacionin, për shtetësinë dhe popullsinë e Kosovës (kuptohet nëse pranohet të zbatohet), do të ketë refleksione edhe efekte të jashtëzakonshme negative, por edhe rrjedhoja të shumta, shumëdimensionale dhe të pariparueshme! Le të vazhdojmë me radhë:

1. Asociacioni do ta dëmtojë, cenojë dhe rrezikojë deri në substancë e mosfunksionim shtetin dhe shtetësinë e Kosovës e brenda saj edhe rendin tonë kushtetues, juridik dhe demokratik të Republikës, të ndërtuar me mund, djersë, gjak e sakrifica të jashtëzakonshme ndër vite. Pandam me rendin tonë, asociacioni i komunave me popullsi shumicë serbe krijon një rend tjetër të ri e specifik dhe ka një kushtetutë tjetër materiale.

Primati i vullnetit të popullit është dhe do të duhej të ishte vullnet mbi të gjitha vullnetet, në një ambient kushtetues, juridik dhe demokratik të mirëfilltë. Po ky primat i vullnetit të popullit, analizuar nga këndvështrimi historik, i shprehur në nenin 28 të kushtetutës frënge të vitit 1793, nënkupton faktin, se çdo popull në botë ka të drejtë ta revidojë, reformojë dhe ta ndryshojë në çdo kohë kushtetutën e vet dhe se asnjë gjeneratë nuk mund t'ua nënshtrojë atë as tekave dhe as ligjeve të saj në gjeneratat e ardhshme. Megjithëkëtë, demokracia konstitucionale paraqet jo vetëm fjalën, mendimin dhe kohezionin e ndërtuar me kohë të shumicës, por, gjithsesi, edhe fuqinë dhe aksionin a veprimin e koncentruar dhe të organizuar të po asaj shumice. Në të kundërtën, gjithnjë do të kemi të bëjmë me tiraninë dhe padrejtësinë a diskriminimin e pakicës ndaj shumicës, që është edhe e padrejtë, por, mbi të gjitha, edhe e papranueshme për çdo popull shumicë, në relacion me cilëndo pakicë, në fjalë.

Revizioni i parimeve supreme kushtetuese duhet të përjashtohet për të ruajtur dhe për të mbrojtur *sovrانيتin popullor*, si dhe fuqinë dhe epërsinë substanciale të shumicës omnipotente!

Garancionet kushtetuese do të duheshin kuptuar kudo dhe kurdo vetëm si garancione të fortësisë kushtetuese, të normativitetit kushtetues. Garancionet kushtetuese (primare dhe sekondare) garantojnë normativitetin dhe efektivitetin e kushtetutës së një vendi. Në rast të çdo absence a mungese

të instituteve të sipërpërmendura, brenda një shoqërie mund të paraqiten konflikte, kundërshti dhe antinomi të caktuara [13].

Paradigma konstitucionale është model normativ kompleks, i cili kurrë nuk është sendërtuar në tërësi, madje konsiderohet se as që është e mundur që të realizohet. Pse? Paqësisht, për shkak të ndërinterferimit apo edhe shkumbëzimit virtual, që ekziston mes normativitetit, realitetit dhe efikasitetit. Mirëpo le të thuhet këtu, se moslegjitimiteti virtual mund të jetë njëherazi edhe përparësi e demokracive kushtetuese!

Të përmendim këtu faktin notar, se edhe garancitë kushtetuese mund të prodhojnë shkallë a gamë të caktuar mosefikasiteti dhe mosefektiviteti. Kjo mbase ndodh edhe si rrjedhojë e manifestimit të ilegalitetit. Ky ilegalitet shprehet përmes prishjes apo edhe shkeljes së garancioneve ose edhe si pasojë e defekteve të legalitetit, i cili po ashtu kryesisht shprehet si rrjedhojë e mungesës së garancioneve, por jo gjithmonë, assesi dhe jo me çdo kusht!

Pikërisht, zhvillimi i ilegalitetit dhe defektet e legalitetit (të cilat shprehen në mungesë të garancioneve e që kanë të bëjnë me pushtetin publik), krijojnë hapësirë për *antinomi* dhe zbrazëtira. Kjo sot po ndodh edhe në nivelin shtetëror, edhe atë ndërkombëtar. Prandaj, gjithandej kemi kriza e vatra krize. Kemi krizë edhe të legalitetit ndërkombëtar. Pikërisht nën ndikimin e kësaj natyre, nga veprimi, ardhur së pari nga bizantinizmi lindor (veçmas nga Rusia e Serbia) të segmenteve dominuese të komunitetit serb në Kosovë, nuk po dobësohet sindromi i supremacisë, i majorizimit, i shovinizmit, i territorializmit, i eksploatimit dhe predominimit të të tjerëve (madje nga pakica simbolike ndaj shumicës absolutë) edhe në Kosovë!

Kjo gjendje fillimisht duhet të shpjegohet mirë dhe në detaje, duhet të kuptohet nga ata që pretendojnë se meritojnë supremativisht më shumë se të tjerët dhe të ndryshohet gjendja e raporteve për t'u krijuar një situatë,

rrjedhimisht zgjidhje reale dhe të merituar shumicë-pakicë, zgjidhje pa asnjë diskriminim dhe as pa favorizim të askujt.

Prandaj, edhe pas 25 vjetësh të lirisë e të pavarësisë së Kosovës, serbët lokalë (në shumësi, pra pjesa dërmuese e tyre), nuk duan ose nuk kanë mundur si duket ta kuptojnë plotësisht realitetin dhe të integrohen në shoqërinë kosovare. Dëshira për supremaci, injorim, shtypje dhe predominim të të tjerëve deri në pastrim etnik etj., si duket është ende e pranishme te disa qarqe dhe kategori njerëzish edhe aktualisht.

2. Asociacioni sipas projektstatutit euro-amerikan, rezulton të jetë një entitet-shtet në shtet, që me kompozicionin e tij special dhe specifik (për nga veçoritë dhe karakteristikat) u kundërvihet parimeve kryesore kushtetuese ekzistuese në të cilat është instituar shteti i Kosovës e që janë unitariteti dhe multietniciteti i shtetit tonë të përbashkët dhe i të gjithëve dhe për të gjithë.

3. Asociacioni, sipas projektstatutit, do të mund të konstituohet në entitet etnik-juridik, publik e shtetëror të mëvetësishëm dhe me primesa puro etatiste-administrative e në pikëpamje territoriale, plotësisht autonom dhe, madje, edhe më shumë se kaq! Struktura dhe karakteri i asociacionit është paraparë të jetë i tillë, që i kundërvihet plotësisht dispozitave të nenit 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe frymës së saj.

4. Në të vërtetë, përbërja e projektstatutit të asociacionit paraqet në vetvete një strukturë specifike me substancë kushtetuese, pra një kushtetutë materiale, që si në thelb, karakter, por edhe për nga brendia i kundërvihet Kushtetutës formale ekzistuese të Republikës së Kosovës.

Por, le të shohim shkurtimisht, se ç'është ajo e ashtuquajtura kushtetutë materiale.

Kushtetuta materiale i ngërthen në vete dy elemente, si cilësi dalluese në relacion me kushtetutat e tjera:

- *Elementi i parë* është ai normativ material, i cili konsiston në sanksione të një konfiguracioni të dhënë të pushtetit, që reflekton fuqinë dhe organizimin relativ të grupit të dhënë shoqëror (popull, komb, pjesë e kombit ose e popullit, sekt fetar, grup gjuhësor, klasor etj.). Ky konfiguracion çdoherë është shprehje e marrëdhënieve të pushtetit, ku një ose më shumë grupe shoqërore arrijnë të kuptojnë vetveten në raport me të tjerët. Ky grup, me fjalë të tjera, arrin ta formësojë qëllimin e vet politik të përcaktuar me kushtetutën formale, i jep vetvetes dhe konfiguracionit të pushtetit një substancë tjetër normative kushtetuese, që më ndryshe dhe në kundërshtim absolut me kushtetutën formale në fuqi, e bën statut këtë apostafat për serbët e Kosovës, si grup i posaçëm etnik dhe shoqëror.

- *Elementi i dytë*. Krahas këtij elementi normativ material, kushtetuta materiale ka edhe një cilësi tjetër. Kjo cilësi ka të bëjë me përmbajtjen e saj esenciale. Ndërkohë që elementi normativ material ka të bëjë me marrëdhëniet materiale, që qëndrojnë në themel të çdo strukture normative kushtetuese (formale ose joformale), përmbajtja esenciale e kushtetutës materiale tregon se cila është përmbajtja (esenca apo thelbi) e normave materiale që krijohen, domethënë kush e bën, çfarë dhe cilat janë raportet me niveleve të ndryshme të pushtetit, cili është roli dhe pozita e individit dhe e grupit shoqëror në shoqëri e kështu me radhë.

Ky element (përmbajtja esenciale e kushtetutës) vepron si një qendër unifikimi për jetën e komunitetit, në këtë rast atij serb, që e dallon atë komunitet duke e mbrojtur nga bota e jashtme, më saktë nga komunitetet e tjera, që jetojnë në hapësira të tjera, si dhe duke organizuar nga brenda interesat e kundërt të komunitetit, madje edhe përmes dhunës, përmes saktësisimit dhe mbrojtjes së interesave, që konsiderohen si më subline në raport me të tjerat.

Përmbajtja esenciale e kushtetutës materiale jo vetëm që shpreh parimin fundamental të rendit tjetër kushtetues të komunitetit politik, i ndryshëm nga kushtetuta formale në fuqi dhe i kundërt me të, por edhe e institucionalizon marrëdhënien e re mes forcave shoqërore dhe qeverisë dhe forcon shoqëritë e qeverisura. [14]

Të gjitha këto që u thanë më sipër, janë të pranishme dhe reflektuese qartë në pothuajse secilën dispozitë të projektstatutit euro-amerikan. Për shembull, ndërlidhur edhe me Marrëveshjen e Brukselit për normalizim ka ndodhur rihapja e statusit të Republikës së Kosovës përmes *mosparagjykitit të statusit të Kosovës*, në raport me Serbinë dhe në këtë mënyrë përfaqësuesit tanë në dialog sikur kanë hequr dorë nga njohja reciproke si parakusht thelbësor i domosdoshëm dhe imperativ i të gjithë imperativëve për Kosovën.

Projektstatuti në dispozicion, fatkeqësisht edhe europian, edhe amerikan, është një kuazidokument, i cili buron nga marrëveshja e Brukselit dhe Aneksi i Ohrit dhe që pa asnjë bazë e asnjë arsye mbështetet edhe në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Inkorporimi i kësaj rezolute në preambulën e projektstatutit të asociacionit tregon jokorrektësinë dhe qëllimet morbide të përpiluesve të tij, sepse po kjo rezolutë e afirmon kontentialisht sovranitetin e ish-Jugosllavisë (lexo të Serbisë mbi Kosovën “autonome”). Pra, futja e rezolutës së sipërpërmendur në tekstin e projektstatutit e përmbush në tërësi qëllimin parësor edhe të Serbisë, për ta rikthyer “statusin” e Kosovës në fillimet e tij, në mënyrë që edhe kjo të ishte (siç pretendon dhe vepron edhe tani), hisedare në proces, sepse kinse Kosova nuk qenka shtet i pavarur! (siç!).

Mirëpo e vërteta është se Rezoluta 1244 qëmoti është tejkaluar dhe zhvlerësuar deri në masën e inekzistencës ose invaliditetit të saj total. Përse?

Sepse nga data e kësaj rezolute, ish- Jugosllavia si palë në objektiv nuk ekziston, ndërkaq Kosova ka përparuar dhe është transformuar shumëfish. Ajo sot është shtet i pavarur, e njohur nga rreth 117 vende sovrane të botës. Kështu që këtu kemi të bëjmë për një kuazidokument a kuazirealitet inekzistent dhe asgjë më shumë!

Por, fatkeqësisht, në projektstatut të asociacionit po kjo rezolutë na vjen e paraqitet si një bazë materiale juridike e bashkësisë së komunave me popullsi shumicë serbe. Pra, një formulim i tillë malicioz, me të cilin pretendohet që, përmes përmendjes së rezolutës Kosovën, ta kthejnë mbrapa dhe në një mënyrë apo tjetër ta shndërrojnë në një mjet a monedhë për kusuritje. Kjo, gjithsesi, se nuk do të ketë sukses dhe kurdoherë është dhe do të jetë e papranueshme.

Me dispozitat e projektstatutit, asociacionit i janë vënë në dispozicion më shumë kompetenca vendimmarrëse sesa me marrëveshjet e vitit 2013 dhe 2015 të Brukselit. Prandaj gjimnastikat diplomatike dhe miksimet politike të të ashtuquajturit ambiguitet konstruktiv vetëm sa e kanë komplikuar (me qëllim ose jo) edhe tekstin, edhe procesin, edhe ecurinë dhe brendinë dialoguese mes palëve. Ndërkaq, këto lloj manovrimesh Kosovën, duhet thënë dhe përsëritur, e dëmtojnë dhe rrezikojnë deri në substancë. Projektstatuti i propozuar euro-amerikan nuk normon, as rregullon marrëdhëniet në një asociacion, por në stilin e vendosjes së vezës së qyqes në fole të huaj.

Sidoqoftë, kuptohet se me dispozitat e këtij projektstatuti rregullohet statusi politik- juridik i një bashkësie të tërë të komunave me popullsi shumicë serbe si një entitet-shtet në shtet, me subjektivitet të plotë *sui generis*, vetëmenaxhues dhe shtetformues në shtetin pandam rival Republikën e Kosovës.

Substrati paralel e surrogat i shtetit në shtet, pra i asociacionit, i cili është projekt në tentativë, fillimisht i marrëveshjes së Brukselit të vitit 2013, pastaj të 2015-ës, si dhe i projektstatutit që po trajtojmë, krijon një rend tjetër të ri e të mëvetësishëm nga Republika e Kosovës, si një krijesë gangrenoze pandam të saj. Në fakt është një rend i mbyllur hermetikisht juridik-kushtetues, i cili nuk mund të ndikohet, as ndryshohet, as plotësohet nga jashtë, (pra, as nga organet dhe institucionet e Kosovës) pa pëlqimin e organit të tij përfaqësues Kuvendit të Bashkësisë së Komunave me Popullsi Shumicë Serbe.

Pamundësia e interferimit demokratik dhe mundësia maksimale dhe absolute e vendimmarrjes vetjake dhe autentike i sovranizojnë maksimalisht ingerencat vendimmarrëse të asociacionit deri në një ndërtrim, trajtim dhe prezantim të tij, si një organizëm multifunksional shtetëror në një tjetër shtet, në këtë rast në shtetin e Kosovës.

Me marrëveshjet e Brukselit dhe të Ohrit, Kosova me dije, me vetëdije apo pa të, qoftë edhe **in** tacite, ka pranuar krijimin e saj, që në të drejtën kushtetuese njihet si *kushtetutë materiale*. Kjo, rrjedhimisht, do të thotë se Kosova edhe me marrëveshjen e Brukselit ka lejuar rihapjen e çështjes së statusit të Kosovës, në mos edhe hapjen e saj sërish nga fillimi, gjë që ka qenë prirje dhe kërkesë e vazhdueshme strategjike e Serbisë dhe e përfaqësuesve të saj që nga fillimi i bisedimeve kinse teknike të saj me Kosovën.

Më sipër është sqaruar shkurtimisht çka nënkupton *kushtetuta materiale*, me elementet e saj. Kësodore, siç thamë edhe më parë, me marrëveshjen e Brukselit dhe të aneksit të Ohrit, duke marrë parasysh, ndër të tjera, edhe klauzolën: *të ashtuquajtur pa paragjykim ndaj statusit*, Kosovës faktikisht i është imponuar kthimi mbrapa dhe rihapja e statusit të saj që nga fillimi, gjë të cilën Serbia, që nga koha e presidencës së

Koshtunicës, Tadiqit dhe të tjerëve pas tyre e ka kërkuar dhe ka insistuar në të edhe politikisht. Me pranimin e marrëveshjeve të Brukselit dhe Ohrit e, në kuadër të tyre, edhe të projektstatutit që po trajtojmë, Kosova ka bërë gabimet e radhës, që janë të pafalshme dhe të papranueshme, ngase me këtë vijafakti ka pranuar edhe në një mënyrë a tjetër zhvleftësimin e fuqisë juridike, validitetin e kapacitetit juridik dhe efektiv të opinionit këshillëdhënës, por jashtëzakonisht të rëndësishëm dhe verdikt të GJND-së për Kosovën.

Pranimi i asociacionit as me njohje dhe as pa njohje reciproke me Serbinë, por edhe pa njohje as në qendër e as në periferi, madje edhe me mohim e kërcënim të sovranitetit dhe të integritetit territorial, mund të jetë gabim fatal dhe i pariparueshëm për Kosovën e, madje, edhe më gjerë! Me marrëveshjet e fundit të Brukselit dhe të Ohrit me asociacion brenda, përmes këtij projektstatuti, Kosova jo vetëm që rrezikohet deri në asgjësim, por edhe retrogradohet, duke u rikthyer në fillim në gjendjen para shpalljes së pavarësisë së saj për sa i përket statusit të saj.

Asociacioni me projektstatutin dhe themelimin e tij në brendi, jo vetëm që do të pamundësojë zgjidhjen e problemeve dhe çështjeve ndërmjet komuniteteve atje dhe në të gjithë Kosovën, por do të krijojë e ndërlikojë situata e konteste qoftë edhe të inskenuara e të trilluara, të cilat do të mund ta vështirësonin deri në acarim e rrezikim gjendjen e tërësishme, e sidomos atë të sigurisë dhe të stabilitetit në Kosovë.

Për më tepër, asociacioni në një Kosovë martire, unike dhe unitare, të vuajtur e të shtypur që kaq kohë nga hegjemonizmi dhe egërsia serbo-sllave, në një Kosovë e etshme për liri dhe e ballafaquar sërish me pangopësinë, shovinizmin, epërsinë me ndikim dhe hegjemoninë serbe, nuk do të mund të duronte të qëndronte pa luftë, e cila do të mund të përhapej në të gjithë Siujdhesën ilirike të Ballkanit. Pra, ASK-ja nuk pritet (mënduar e

racionalisht) të sjellë as stabilitet, as realitet të avancuar demokratik në Kosovë, por as në Ballkan. E kundërta, siç u shpjegua më sipër tashmë, më shumë dhe më lehtë është e pritshme dhe e ndodhshme.

Edhe sipas marrëveshjeve, të përkohshme e kalimtare të Brukselit dhe Ohrit, “instrumente të vetëmenaxhimit”, ndonëse çështje krejtësisht e brendshme e Kosovës, bëhet çështje ndërshtetërore, duke e bërë edhe Serbinë hisenike dhe padrejtësisht reprezentuese dhe faktorizuese në çështjet e Kosovës, kuptohet nga eksponentët ndërkombëtarë, që janë në cilësi të intermediatorit në çështjet e dialogut më Serbinë.

ASK-ja si entitet, sipas projektstatutit ndërkrijon një tjetër rend kushtetues-juridik, i cili për nga përmbajtja, qëllimet dhe objektivat e tij është në shpërputhje totale dhe flagrante me kushtetutën e Republikës së Kosovës. Përmes një komisioni të imagjinuar, për shembull të arbitrazhit, asociacioni minon, kundërshton dhe anashkalon deri në mosnjohje, përbuzje dhe injorim të rendin kushtetues dhe Kushtetutën e Kosovës në tërësi. Në raste të mosmarrëveshjeve eventuale mes asociacionit eventual dhe institucioneve qendrore, çështjet eventuale kontestuese mes palëve, nuk do të trajtohen fare në institucionet e Republikës së Kosovës dhe as në Gjykatën Kushtetuese ekzistuese të Kosovës, por në të ashtuquajturin komision të arbitrazhit, në të cilin përparësi asimetrike i është dhënë Serbisë, respektivisht asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë dhe Bashkimit European, si palë e tretë. Por, më e rëndësishmja dhe sovranitet në këtë rast rezulton të jetë Bashkimi european dhe Serbia, se a Kosova!

Pra, pashembullsisht dhe papranueshmërisht në rastet kur kemi të bëjmë me shtetet e pavarura dhe sovrane, siç është Kosova, këtu kemi të bëjmë me një propozim, i cili sovranitetin dhe pavarësinë e Kosovës, si shtet sovran dhe të pavarur, e zhbën dhe e zhduk deri në mosekzistim, për ta

dërguar njëherë e mirë në kalendat greke, duke e deleguar atë sovranitet dhe atë pavarësi në nivel dhe vendimmarrje ndërkombëtare dhe patronike.

Në thelb kjo do të thotë bartje deri në humbje totale të sovranitetit nacional. Sa për rikujtim të lexuesit, ky institut çoroditës dhe humbës i sovranitetit të Kosovës (Komisioni i Arbitrazhit), nuk ka qenë i parashikuar as në marrëveshjet e vitit 2013 dhe as në atë të vitit 2015 të Brukselit mes Kosovës dhe Serbisë për asociacionin.

Kjo më tutje do të thotë kthim, humbje apo dorëzim i sovranitetit, të shtetësisë dhe të pavarësisë së Kosovës dhe shndërrimit të saj, jo vetëm sa u përket territoreve me shumicë serbe, por të gjithë territorit të Republikës sonë, në protektorat klasik, apo edhe më thjesht se kaq, kemi të bëjmë me shndërrimin e Kosovës në një guvernë të pavlerë në duart e të huajve.

Asociacioni, me të gjitha ingranazhet e tij strukturore, institucionale, hierarkike dhe përmbajtjesore, me të gjitha veprimet, qëllimet dhe objektivat e tij, paraqet një entitet shtetëror të mirëfilltë në zhvillim, i cili pa asnjë mëdyshje është dizajnuar qëllimisht si i tillë, që ta shemerkojë deri në zhbërje shtetin legal, legjitim, zyrtar dhe ndërkombëtarisht të njohur të Kosovës, por sidomos ta godasë deri në mosekzistim, moszhvillim e mosushttrim të vetëvendosjes, dhe kjo mund të jetë një ndër goditjet vdekjeprurëse më të mëdha, që asociacioni i bën popullit të Kosovës, qytetarëve dhe pavarësisë së saj!

Përfundimisht, asociacioni përmes instrumentit të vetëmenaxhimit në mënyrë krejtësisht kundërkushtetuese dhe kundërligjore përvetëson ingerenca ekzekutive dhe kompetenca të plota vendimmarrëse (shtetërore) në mbi tetë fushëveprimtaritë më jetike dhe më kryesore e që, padyshim, e bëjnë asociacionin një shtet në shtet dhe asgjë më pak.

Dhe përfundimisht, krahas dhe përkundër të drejtave asimetrike shtesë dhe specifike (të veçanta) e speciale, qytetarët e komunitetit pakicë

serb në kundërshtim me kushtetutën dhe me legjislacionin e Kosovës i gëzojnë nëpër komuna në nivel lokal.

Përkundër të drejtave të tjera të garantuara dhe të rezervuara, që po ky komunitet serb gëzon në nivel qendror (në kuvend, e drejta e vetos) asociacioni është niveli i ri i ndërmjetëm specifik dhe special i pushtetit në Kosovë, i krijuar posaçërisht për ta në bazë krejtësisht etnike, që po ashtu është krejtësisht në kundërshtim me kushtetutën dhe ligjet e vendit, në kundërshtim me parimin bazë të unanitetit, në bazë të të cilit është ndërtuar tërë sistemi dhe rendi juridik-kushtetues i Republikës; në kundërshtim me parimin e qytetërimit, në bazë të të cilit është krijuar një shtet i qytetarëve dhe i komuniteteve të barabarta, pra parimi i multietnicitetit etj. Sidoqoftë, asociacioni në fakt, është një sistem instrumental i vetëmenaxhimit, është një entitet-shtet brenda Kosovës, i cili përfundimisht do të mund jo vetëm ta dobësojë e dëmtojë Kosovën dhe rendin e ri të saj kushtetues juridik dhe piramidën institucionale e shtetërore të saj, por edhe thelbin, substancën dhe perspektiven zhvillimore të shtetit të Kosovës etj.

Entiteti-shtet dhe rendi që krijohet brenda këtij entiteti-shtet, është rend hermetik juridik-kushtetues, i cili nuk mund të ndikohet, as cenohet nga jashtë, as të kontestohet dhe as të zhbëhet nga askush, pa pëlqimin e organit të tij përfaqësues, Kuvendit të Asociacionit, dhe askush tjetër. Ai organ vetëm mund ta forcojë dhe avancojë në një shkallë a nivel tjetër të subjektivitetit (në nivel republike p.sh.), sesa ta zbresë a ta zvogëlojë eventualisht! Ai, pra asociacioni, vetëm kërkon, merr, lyp e zgjedh, ndërsa nuk pranon asgjë. Nuk ofron asgjë, përveçse atë që i pëlqen, që i duhet dhe që synon Serbia!

Populli ynë me të drejtë ka thënë: “Dy atllarë me një mullar nuk mund të lidhen”.

Kasta nacional-socialiste dhe kleroshoviniste deri në klerofashizëm e Beogradit, e cila është mësuar me ushqimin dhe ushtrimin e hegjemonisë, majorizimin, imponimin e vullnetit dhe supremacisë shekullore ndaj apo kundër të tjerëve, duke ngërthyer këtu edhe komunitetin serb në Kosovë. Po këtë komunitet në vazhdimësi e ka ushqyer edhe me material toksik, e ka instrumentalizuar, e ka penguar në kohsbitim paqësor me të tjerët, e “ka prangosur” dhe përshtanguar njëkohësisht në ushtrimin e të drejtave të veta, si dhe në procesin e integritimit institucional dhe gjithëjetësor edhe të komuniteteve të tjera pakicë në Kosovë.

Asociacioni në të vërtetë e ka instrumentin më të përshtatshëm për veprim deri në një gjasë apo rast tjetër adekuat, që përmes këtij instrumenti, kinse të vetëmenaxhimit, të rrënjosë, të zhvillojë dhe mbrojë një Serbi tjetër të dytë brendapërbrenda Kosovës, që nëpërmjet këtij instrumenti të vetëmenaxhimit, të zbulojë dhe të zhvillojë një Serbi tjetër sa antagonistë dhe potencialisht antipode, po aq edhe paravane, pandame, konkurrencte dhe një Serbi të dytë në Kosovë.

Prishtinë, shkurt 2024

Fusnotat

1. Veton Surroi, *Emri i autonomisë*, “Koha”, Prishtinë, 2015, f. 14-15.
2. Shih Veton Surroi, *Emri i autonomisë*, f. 16.
3. Shih Veton Surroi, *Emri i autonomisë*, f. 18.
4. Veton Surroi, *Emri i autonomisë*, f. 19.
5. Veton Surroi, *Emri i autonomisë*, f. 27.
6. Veton Surroi, *Emri i autonomisë*, f. 48-49
7. Veton Surroi, *Emri i autonomisë*, f. 42.

8. Veton Surroi, *Emri i autonomisë*, f. 43.
9. Shih më detalisht dispozitat e nenit 57 dhe dispozitat e nenit 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
10. Shih për këtë më gjerësisht dhe saktësisht dispozitën e pikës (h) të nenit 14 të projekt-statutit në trajtim.
11. Tibor Varadi, *Medjunarodno privatno pravo*, Novi Sad, 1987, f. 151-153
B. Eisner, *Medjunarodno privatno pravo*, Zagreb, 1953, f. 20., etj
12. Huber, në veprën e tij “De conflictum legum diversarum in diversis imperiis” (*Mbi kolizionin e ligjeve në perandoritë e ndryshme*) ka formuluar tri aksioma kryesore: a) ligjet e çdo shteti zbatohen brenda kufijve të tij dhe i detyrojnë të gjithë ata, që pushtetit të atij shteti i janë nënshtruar, por nuk i detyrojnë jashtë kufijve të tij; b) konsiderohen si të nënshtruar të pushtetit shtetëror të gjithë ata, të cilët në territorin e tij kanë vendbanimin ose qëndrojnë përkohësisht; c) qeveritë e shteteve nga mirësjellja e xhentilesa bëjnë të mundur që e drejta e një shteti, pasi është zbatuar brenda kufijve të tij, ta ruajë fuqinë e vet ndokund , në qoftë se nuk është në kundërshtim me pushtetin shtetëror ose me të drejtën e sunduesit tjetër ose shtetasve të tij.
13. Antinomia nënkupton konfliktin e krijuar mes normave.
14. Prof. dr. Enver Hasani, “paparaci.com”.

Kumtesë e mbajtur në tryezën shkencore “Konstelacionet gjeopolitike në Ballkan në kontekst të Marrëveshjes së Brukselit [27 shkurt 2023] - Kosovë-Serbi, të organizuar nga Instituti Shqiptar për Gjeopolitikë, më 14.02.2024, në ambientet e Institutit Albanologjik, në Prishtinë.

2.2 Arbër ZAIMI, politolog

Shqiptarë e serbë: traditë e strategji

Brenda Perandorisë Osmane shqiptarët dhe serbët vazhduan traditën e tyre më të vjetër. Individë ambiciozë shfrytëzonin asetet që ofron mjerimi i përgjithshëm për t'u afirmuar, kryesisht si komandantë ushtarakë, por edhe si administratorë rajonalë e imperialë, duke shfrytëzuar arsimin që perandoria ofronte për fëmijët e talentuar që konvertoheshin herët. Shqiptarët, sipas statistikave, del se kanë qenë më të përfaqësuar në këto poste të larta.

“Traditat janë të pashmangshme. Prej tyre nuk arratisesh dot përfundimisht e krejtësisht”, - theksoi filozofi gjerman, Hans-Georg Gadamer, në shekullin e shkuar. Nuk shtrohet pra pyetja, se a do të punosh bazuar në njërin nga traditat, por se në cilën syresh. Të moszgjedhurit e asnjërës i lë njerëzit të ngecur prej padijes në një gjuhë që nuk e kanë krijuar, të ngecur në korniza logjike që nuk i kuptojnë. Parë kësisoj, edhe raporti mes shqiptarëve e serbëve mund të analizohet dhe mund të përpunohet vetëm duke u bazuar te të paktën njëra nga traditat.

Fillimisht, shqiptarët e serbët janë hasur me njëri-tjetrin nën perandoritë bizantine e më pas bullgare, si popuj periferikë në perëndim të Ballkanit, kurse perandoritë në fjalë kryeqendrat i kishin në lindje të atij gadishulli, pra në anën tjetër të botës. Ndër ato pak gjëra që dimë mbi atë periudhë të errët, është fakti se pati individë nga të dyja etnitë, që duke shfrytëzuar ashpërsinë e atyre që jetonin në kushte ekstreme, organizuan çeta malësorësh për të bastisur qendrat administrative dhe karvanët. Plangu dhe

luftëtarët që grumbullonin prijësit u jepte peshë e prestigj familjeve të tyre, disa nga të cilat pa ngurruar të përdorin shantazhin, dhunën, por edhe martesat, arritën të fisnikërohen, pra të certifikohen prej perandorive.

Në këtë shpjegim të mbithjeshtëzuar është e rëndësishme të mbahen edhe sot parasysh këto elemente: popuj të ashpërsuar prej kushteve të mjera ekonomike; të qenit në periferi të perandorive; individë që shfrytëzojnë varfërinë dhe ashpërsinë e përgjithshme si aset; ambicia e vetme, certifikimi i familjes prej perandorisë.

Nga këto familje barinjsh e banditësh të suksesshëm që u fisnikëruan, dolën aristokratët e parë mesjetarë serbë apo shqiptarë. Por edhe historia e shumicës së aristokratëve prej popujve të tjerë europianë nuk është fort e ndryshme. Deri këtu kemi një baraspeshë, me aq sa dimë, por kandari rrëzohet kur njëra nga familjet, ajo e Vojisllavleviqëve, nga bregdeti verior i Malit të Zi të sotëm, u fuqizua më shumë se të tjerat dhe njëra nga degët e saj pasardhëse, Nemanjiqët, arrijnë ta nxjerrin shtetin e perandorinë e tyre, duke shfrytëzuar dekadencën bizantine e bullgare. Perandori i tyre më i famshëm, Dushani, e quante veten zyrtarisht edhe mbret, autokrat dhe perandor i shqiptarëve, përveçse i serbëve, romëve (vllahë e grekë) dhe bullgarëve.

Edhe këtu ka një element që duhet mbajtur mend në analizën tonë: *vetëdija perandorake*. Grekët, bullgarët dhe serbët e kanë dhe e ushqejnë me arsimin e tyre kombëtar vetëdijen e perandorisë së dikurshme. Shqiptarët, boshnjakët, kroatët, sllovenët, vllahët (e rumunët) nuk e kanë një tipar të tillë. Ekzistenca politike e perandorisë të këta popuj prodhoi edhe paralelen e vet ideologjike: kishën, gjuhën, kodifikimet institucionale e ligjore, të të cilat edhe sot reflektohet perandoria.

Më pas në Ballkan erdhi Perandoria Osmane, së cilës më shpejt ia hapën derën grekët, bullgarët e serbët dhe më gjatë i rezistuan shqiptarët. Është po aq interesant fakti, se po shqiptarët ishin të fundit që u shkëputën

nga Perandoria, madje duke luftuar për të edhe pasi u pavarësuan pesë shekuj më vonë. Nëse mund t'i jap një shpjegim kësaj sjelljeje të pazakontë (krahasuar me popujt fqinjë), ai bazohet pikërisht te të qenit popull periferik pa traditë perandorake të vetën (pra, pa kishë specifike, pa gjuhë liturgjike etj.). Dihet se popujt sa më periferikë të jenë (pra, larg qendrave ku grumbullohet pasuria dhe dija e kohës), janë jo aq konservatorë në sensin vleror, por më tepër të frikësuar prej ndryshimeve si çdokush që nuk ka kapacitete të mëdha mbrojtëse.

Brenda Perandorisë Osmane, shqiptarët dhe serbët e vazhduan traditën e tyre më të vjetër - individë ambiciozë i shfrytëzonin asetet që ofron mjerimi i përgjithshëm për t'u afirmuar, kryesisht si komandantë ushtarakë, por edhe si administratorë rajonalë e imperialë, duke shfrytëzuar arsimin që Perandoria ofronte për fëmijët e talentuar që konvertoheshin herët. Shqiptarët, sipas statistikave, del se kanë qenë më të përfaqësuar në këto poste të larta. Për të mos rënë në shpjegime të paqëndrueshme të tipit “ishin më të aftë se të tjerët” ose “shiheshin si vëllezër prej turqve”, mund të shtrojmë hipotezën se pikërisht mungesa e traditës perandorake shqiptare, mungesa e kishës specifike dhe e gjuhës liturgjike u jepte atyre më pak arsye për “nostalgji historike” dhe i bënte më të përshtatshëm për shërbyes perandorakë. Ata nuk kishin “epokë të artë” të prosperitetit ekonomik, të zgjerimit territorial, të sundimit të popujve të tjerë etj. Edhe Moti i Madh i Arbrit, pra koha e Skënderbeut, ishte një kohë rezistence heroike dhe e lavdishme, por jo kohë stabiliteti ose ekspansioni. Mungesa e një “epoke të artë” vërehet edhe tek Eposi i Kreshnikëve. Muji, Halili e agët e Jutbinës janë luftëtarë kufiri, gjithnjë në zgrip të ekzistencës, teksa sarajet e pushtetit, që ata ndonjëherë i vjedhin dhe i djegin e ndonjëherë punojnë për to, kurrë nuk u përkasin atyre.

Popujt ballkanikë dolën prej Mesjetës si popuj të vegjël. Ballkani në Mesjetë ishte bota dhe nxinte brenda dy ose tri perandori, por në kohët moderne ishte thjesht një periferi e pazhvilluar, ku fuqi të tjera të mëdha kishin interesa pozicionalë, më rrallë edhe strategjikë.

Në shekullin XIX, kur Perandoria Osmane ishte në rënie, popujt me vetëdije perandorake ishin të parët që zhvilluan nacionalizmat e tyre, bazuar edhe tek ideologjia e “epokës së artë”. Rol vendimtar në formimin e atyre nacionalizmave luajti, nga njëra anë, Rusia, që përdori elementin ortodoks dhe, nga ana tjetër, Franca napoleonike, që përdori elementin populist, për agjitimin e popujve që synonin çlirim. Por rol luajti edhe tradita e “Reconquista”-s, e cila shënon edhe sot e kësaj dite aspekte të politikës europiane. Grekët, bullgarët e serbët ndërtuan programe kombëtare ekspansive me në mendje zgjerime territoriale sipas perandorive mesjetare. Armiku i tyre nuk ishte vetëm Perandoria, nga e cila donin të shkëputeshin, por edhe “shërbëtorët”. Shpesh në krye të administratës dhe ushtrisë kishte shqiptarë, por kishte edhe të tjerë. Çështja është se serbi, greku e bullgari i myslimanizuar, që shërbente për Perandorinë Osmane, e humbte identitetin e vet të origjinës, që tashmë ishte hegjemonizuar prej nacionalizmit etniko-kishtar, ndërsa te shqiptarët kjo nuk ndodhte. Historianë të ndryshëm, nga E. Hobsbawm e deri te N. Malcolm, kanë vënë re se identiteti etnik i shqiptarëve ishte, në njëfarë mënyre, paranacionalist, i pahegjemonizuar nga ndonjë program kombëtar vetjak. Ai mund t’i shërbejë secilës perandori, të besojë në secilën fe, të luftojë për secilin shtet, madje edhe kundër popullit e vendit të vet dhe prapë mbetet shqiptar.

Kështu erdhën në modernitet shqiptarët, tashmë periferi e periferisë. Nacionalizmi shqiptar u projektua i fundit, në suaza të nevojës emergjente për të shpëtuar nga spastrimi etnik. Lidhja e Prizrenit u mbajt në vitin 1878, sepse me përfundimin në atë vit të Luftës Ruso-Osmane, shqiptarët u

spastruan tërësisht pas gjenocidit që serbët kryen në Sanxhakun e Nishit dhe atij që malazezët kryen në Podgoricë e Spuzhë. As sot atje nuk ka më shqiptarë, teksa pasardhësit e tyre jetojnë kryesisht në Kosovë e në Shkodër, bartës të një tradite të dhimbjes e varfërimit që kanë përjetuar gjyshërit e tyre refugjatë (muhaxhirë). Pas 1912-ës, fat të ngjashëm provuan edhe shqiptarët e Çamërisë, të Maqedonisë së sotme, të Kosovës e Malit të Zi, por edhe ata të Shqipërisë aktuale. Pakkush e di se bandat greke e kanë djegur dy herë jugun e Shqipërisë në 1914, deri në Skrapar e Berat, afër Shqipërisë Qendrore, duke i nxjerrë njerëzit muhaxhirë edhe prej aty. Pakkush e di se Serbia jo vetëm që ka spastruar shqiptarë në troje, p.sh., prej Maqedonisë Lindore e Qendrore, por në po atë kohë ka zbritur deri në Lushnjë, duke masakruar popullin vendas. Për shembull, në Gjuzaj të Lushnjës në vitin 1913 ushtria serbe ka vrrarë gjithë burrat e fshatit. Edhe kjo traditë, pra, ekziston, e na u rishfaq në Reçak, në Krushë e në masakrat e tjera kundër shqiptarëve të Kosovës në vitin 1999.

Nuk jam duke thënë këtu se shqiptarët janë popull engjëllor e fqinjët popuj djallëzorë. Gjasat që mes nesh të ketë kriminelë, bamirës, gjeni, idiotë, indiferentë etj. janë shumë të ngjashme, sepse megjithatë ndajmë rrethana jo fort të ndryshme ekonomike e kulturore pas shekujsh bashkëjetese në Ballkan. Ajo çka jam duke thënë, është se qartazi në historinë e shqiptarëve, ndryshe nga ajo e fqinjëve të tyre, mungon elementi ekspansionist jo vetëm si fakt, por edhe si projekt. Arsyet se pse mungon jam përpjekur t'i shtroj më lart në formë hipotezash.

Zakonisht, kur luftërat fitohen, ato sjellin ndryshime territoriale. Aq shumë mungon elementi ekspansionist në logjikën politike e shtetërore shqiptare, saqë për shembull, në vitin 2002, gjatë e pas konfliktit në Maqedoni, nuk pati asnjë shprehje të interesit për territor nga Shqipëria (nga Kosova jo që jo). Pra, shqiptarët e Maqedonisë e fituan luftën, por nuk morën territor. Çfarë

morën? Ca “të drejta” të padenja, që as sot nuk zbatohen tërësisht e që më shumë shfrytëzohen nga parti të korruptuara politike për të punësuar klientelën partiake.

Këto janë traditat tona ballkanike, që na paravendosen kur trajtojmë raportin shqiptaro-serb. Dhe këto patjetër që ndikojnë në të tashmen, ashtu si dhe në të ardhmen. Por ka edhe tradita ndërkombëtare, që duhen marrë parasysh.

Timothy Garton Ash, në një ese të botuar sivjet, evidenton një traditë specifike: Perandoritë nuk heqin dorë nga territoret pa luftë. Profesori britanik shkruan se edhe Bashkimi Europian, që e sheh veten si “post-perandori”, nuk i ikën këtij rregulli. Themeluesit e Europës së Bashkuar, në vitet ‘50 dhe ‘60 të shekullit të kaluar, flisnin për “Euroafrikë” dhe i konsideronin kolonitë franceze e portugeze në Afrikë si pjesë të strukturës së ekonomisë dhe sigurisë europiane. Ata i mbështetën luftërat e gjata dhe të rënda të Francës e Portugalisë kundër çlirimit dekolonizator. Pra, edhe Europa postmoderne, por edhe Rusia postkomuniste vë në dukje Timothy Garton Ash, e cila në vitet ‘89-‘91 ndoshta besoi se epoka e perandorive kishte marrë fund dhe i çliroi pa luftë territoret që mbante nën sundim, e kuptoi shpejt se e kishte gabim. Në vitin 1992 Rusia e çoi ushtrinë në Moldavi, te Transnistria, e qysh prej asaj kohe është përpjekur të rikthehet kudo që i është dhënë shansi - së fundmi në Ukrainë. Pra, perandoritë nuk dorëzojnë territor pa luftë.

Nëse Timothy Garton Ash ka të drejtë, atëherë mund ta zgjasim argumentin e tij edhe në rrethinën tonë dhe të themi se as Serbia nuk do ta njohë Kosovën pa një luftë, as Rusia nuk do ta lëshojë Serbinë prej sferës së saj të ndikimit pa një luftë. Perëndimorët, që mendojnë se duke i lëshuar Serbisë pak territor në Kosovë do ta shkëpusin atë prej Serbisë, nuk e kanë parasysh se Serbia, edhe kur e ka pasur të gjithë territorin e Kosovës, nuk është shkëputur prej Rusisë e as nuk është ndalur së synuari territore të tjera.

Vetëdija perandorake e Ruisë nënkupton mbajtjen me çdo kosto të Kalonigradit dhe Serbisë si eksklava europiane, teksa Ukrainën synojnë ta bëjnë Bjellorusi. Këtë e di mirë klasa politike dhe e biznesit në Serbi, pavarësisht lojërave. Vetëdija perandorake e Serbisë nënkupton që, sa i përket Kosovës, thajse të gjithë kanë qëndrim të njëjtë me Vuçiqin, pasardhësin e Millosheviqit.

Në perceptimin tradicional që kemi për fuqitë ndërkombëtare, duket sikur vazhdimisht lëkundemi mes konceptit të grekëve të lashtë për qiellin si vend nga buron “rendi i harmonisë hyjnore” dhe konceptit të gnostikëve për qiellin si vend nga buron “rendi i mizorisë hyjnore”. Prej “të favorizuarit nga hyjnitë dashamirëse”, te “të frikësuarit prej hyjnive të pamëshirshme”.

Strategjia, nga përkufizimi, është mjet i atij që krahasimisht peshon më pak. Ai që peshon më shumë zakonisht zgjedh si mjet inercinë, jo strategjinë. Pra, strategjia është ajo që i jep fitoren edhe më të dobët.

Strategjia di të ketë edhe ngecje, që kthehen në gracka kundër atij që i bën. Për shembull, Napoleoni, kryestrateg, hasi një ndër këto gracka në Vaterlo. Ajo grackë përkufizohet në “shumë armiq në shumë fronte” dhe ka marrë edhe strategë të tjerë, jo veç korsikanin shtatshkurtër.

Gracka të tjera të zakonshme të strategjisë janë ato, kur një njeri mendon se mund të jetë vetë zgjidhja për gjithçka (meqë vërtet ka qenë për diçka) ose kur mendon se fitorja do të jetë e mirë për të gjithë (pra, nesër nuk do të ketë më armiq e lufta do të marrë fund njëherë e mirë).

Gracka strategjike më e zakonshme është ajo e “Don Kishotit” ose mësymja ndaj kundërshtarit më të fortë. Kundërshtarin më të fortë e shohin të gjithë, ai bie në sy dhe është e lehtë të shënjestrohet. Mirëpo, pikërisht se është më i forti, është vështirë të rrëzohet. Rruga e shkurtër (e evidentimit të lehtë dhe e shënjestrimit të lehtë) di të të dalë fort gjatë. Prandaj, zakonisht

strategët fillimisht godasin hallkat e dobëta të kundërshtarit, pastaj përpiqen të sulmojnë krahët dhe prapavijën e më të fortit, e jo drejtpërdrejt atë.

Në Bibël është një kundërshebull i kësaj, kur Davidi ia mësyn drejt Goliathit, pra më të fortit kundërshtar, dhe e rrëzon. Mirëpo Davidi, sipas Biblës, e kishte Perëndinë me vete dhe atij, për nga përkufizimi, nuk i hyjnë në punë strategjitë. E së dyti, një gjë që e kanë vënë re disa nga studiuesit e Biblës nga aspekti ushtarak: Davidi po të dështonte me guralecin e parë, nuk do të kishte kurrë më gjasë ta hidhte një të dytë. Strategjia është ajo që e merr parasysh edhe dështimin e së parës dhe gatitjen për të dytën.

Si shqiptarë, teksa është mirë të kujdesemi që të kemi me vete superfuqitë e mëdha, është po aq mirë ta kuptojmë rrethanën tonë strategjike, të heqim dorë nga të qenit David e të mos i përsërisim gabime të njëjta.

III. GJEOPOLITIKA RAJONALE

3.1 Dr. Daut DAUTI

Fajroni në kafenenë e të çmendurve të Ballkanit

“Ballkani i Hapur” ka qenë një lloj kafeneje tipike ballkanike, me të gjitha karakteristikat që ofron hipokrizia. Në këtë kafene Edi Rama më shumë është dukur si kryekamerieri i Vuçiqit, i cili endej nga tavolina në tavolinë për t’i bindur myshterinjtë publikisht, por edhe duke iu pëshpëritur në vesh se, “megjithatë, Vuçiqi është burrë i mirë”.

Organizimet rajonale të karakterit ekonomik, politik e ushtarak janë të nevojshme dhe ato kanë luajtur rol të madh në histori, pasi kanë sjellë zhvillim në sferat për të cilat janë formuar dhe kanë funksionuar. Kjo edhe është arsyeja e themelimit të këtyre organizatave. Por “Ballkani i Hapur” ka qenë organizim, të cilin edhe mendjet më të paarsimuar me njohuri për këtë rajon europian e kanë cilësuar si të pavend. Ky ka qenë një organizim i dyshimtë që nga dita e parë kur doli kjo iniciativë.

Historia ka shënuar disa organizime me karakter të këtillë ekonomik dhe politik, që kryesisht kanë dala si rezultat i refuzimit ose përgjigjes ndaj formimit të organizatave të mëdha ushtarake, politike, ekonomike apo tregtare rajonale, kontinentale e interkontinentale. Ta zëmë, kur Perëndimi formoi NATO-n, Lindja u kundërpërgjigj me Paktin e Varshavës. Si rezultat i këtyre dy organizatave, doli “Lëvizja e të Painkuadruarve”. Kur u formua embrioni i asaj që sot quhet Union Europian, dolën disa organizata të tjera, kryesisht tregtare, si përgjigje ndaj kësaj të parës.

Por, si kundërpërgjigje e çkafit ishte “Ballkani i Hapur”? Ishte kundërpërgjigje ndaj Unionit European, në të cilën vendet e “Ballkanit të Hapur” aspirojnë të bashkohen edhe përkundër ekzistimit të Procesit të Berlinit. Ka edhe një varg pyetjesh tjera të këtilla. Por nuk ka përgjigje të logjikshme, kur kemi parasysh se këtë organizim nuk e përkrahën diplomatët europeanë dhe as ata amerikanë.

Si “baballarë” themelues dhe në ballë të “Ballkanit të Hapur” dolën Edi Rama dhe Aleksandar Vuçiqi. I pari kishte nevojë të madhe për afirmim të Serbisë, duke e nxjerrë nga terri dhe izolimi dhe duke i krijuar kushte për treg të mallrave që pritnin plasman. I dyti, Edi Rama, kishte fare pak arsye që lidheshin me vendin e tij, Shqipërinë. U pa qartë se Rama kishte nevojë të çuditshme për afirmim të personalitetit të tij, duke i mbuluar dështimet që u pasqyruan në ekonominë dhe politikën e Shqipërisë.

Për hir të argumentimit mund të thuhet se zelli i Edi Ramës ka pasur qëllim të mirë. E vërtetë që Ballkani duhet të vihet në baza normale, që do t’i sillnin përparim tërë rajonit dhe në këtë aspekt nuk mund të mohohet roli i rëndësishëm i Serbisë. Por Serbia nuk është demokratizuar dhe, mbi të gjitha, ky vend as që është distancuar nga e kaluara e saj, që shkaktoi gjakderdhje për të satën herë në Ballkan. Prandaj, roli i Serbisë nën udhëheqjen e Vuçiqit mbetet edhe më tutje i karakterit hegjemonist ndaj vendeve fqinje. Si shtesë, Serbia nuk e ka ndryshuar as qasjen e saj në politikën globale ndërkombëtare. Ky vend ka mbetur i vetmi në Europë, që zyrtarisht nuk distancohet nga qëndrimi rus jo vetëm ndaj Ukrainës, por edhe më gjerë.

Duke pasur parasysh këto fakte, “Ballkani i Hapur” ka qenë një lloj kafeneje tipike ballkanike, me të gjitha karakteristikat që ofron hipokrizia. Në këtë kafene Edi Rama më shumë është dukur si kryekamerieri i Vuçiqit, i cili endej nga tavolina në tavolinë për t’i bindur myshterinjtë publikisht, por

edhe duke iu pëshpëritur në vesh se, “megjithatë, Vuçiqi është burrë i mirë”. Myshterinjtë e përhershëm të kësaj kafeneje, që mëtonte të dukej si një klub me pamje të zbehur të “xhentëlmenëve” të Perëndimit, dukeshin të kënaqur me këtë “shërbim”. Myshterinjtë e tjerë, që shikonin nga dritarja, shprehën dyshime, kurse ai kryesori (Kosova) as që u afrua e as nuk e ktheu kokën të shikonte në këtë dritare. Çdo qeveri e Kosovës e ka të qartë se cila duhet të jetë lidhja e ardhshme me Serbinë dhe se “Ballkani i Hapur” nuk ishte aspak përgjigje adekuate për krijimin e një rajoni mbi baza paqësore dhe të ardhme prosperuese.

Është një varg arsyes, që e detyruan Edi Ramën ta shpallte zyrtarisht “fajronin” e kësaj kafehaneje, ku kamerierët dhe myshterinjtë e çmendur dukeshin se ishin angazhuar në një lojë të argëtimit të vetvetes, por më shumë për rehabilitim dhe përmbushje të orekseve hegjemoniste të Serbisë. Pa marrë parasysh “arsyet” e këtij fajroni, pasojat kanë mbetur dhe ato janë të rrezikshme, sidomos për Kosovën. Në këtë “kafehane” Edi Rama nuk e ka përfaqësuar tërësinë e nevojshme të çështjes kombëtare shqiptare. Madje ai ka vazhduar me qëndrimin e tij të injorimit të Kosovës edhe pas fajronit në fjalë.

Qëndrimi i Edi Ramës shpesh është duke u cilësuar si mosmarrëveshje ose problem mes tij dhe Albin Kurtit. Por ky është një problem i përmasave më të mëdha, për shkak se ka krijuar hendek mes dy qeverive, gjegjësisht dy vendeve përkatëse, që në fund të fundit që të dyja janë shqiptare. Qasja e Edi Ramës nuk pushon as me ndërrimin eventual të qeverisë në Prishtinë. Cilado qeveri e Kosovës nuk do të jetë në gjendje të pajtohet me qëndrimin e dorëzimit të pakusht ndaj Beogradit, siç merret si sugjerim i këtij kryeministri të shtetit shqiptar. Pra, Edi Rama me hapat e tij të çuditshëm politikë ka krijuar problemin ndërshqiptar që mund të zgjasë, kurse pasojat serioze të mos sanohen lehtë.

Pra, Edi Rama nuk mundi ose nuk deshi ta luante rolin e faktorit sipas shembullit të Bullgarisë ndaj Maqedonisë së Veriut. Është e pakuptueshme pse ai nuk e zbaton këtë mundësi, kur dihet se është në pozitë më të favorshme dhe më legjitime ndaj Serbisë, sesa është Bullgaria ndaj Maqedonisë së Veriut. Injorimi i Kosovës vetëm sa i komplikon më shumë gjërat. Fakti që dihet, është se tanimë çështja e ngrirë Kosovës me Serbinë si realitet i ri përbën thelbin e problemit të Ballkanit. Ky problem nuk ka mundësi të përfundojë pa pëlqimin ose miratimin e qeverisë së Kosovës ndaj propozimit të tanishëm apo të ndonjë plani tjetër të ardhshëm eventual.

Vonesat e zgjidhjes së këtij problem esencjal, që vijnë si mungesë e vullnetit dhe kompetencës së faktorit ndërkombëtar dhe të cilat i përkrash qeveria e Tiranës janë të gabuara. Dhe, për fat të keq, kjo vonesë, që bëhet me qëllim të akomodimit të kërkesave të paarsyeshme të Beogradit, e shfaqëson Serbinë nga përgjegjësia dhe, si pasojë, i rrit orekset nacionaliste serbe në Kosovë dhe në Bosnjë-Hercegovinë. Si efekt zinxhir rritet edhe nacionalizmi shqiptar në Kosovë dhe gjetiu në rajonet e ish-Jugosllavisë, për shkak se ky nacionalizëm është reagues.

Në këtë rast, si gjithmonë, vjen në shprehje roli i fuqisë ndërkombëtare, që kërkohet në formë të ndërhyrjes (politikë). Por nuk duket se ka ndonjë iniciativë serioze të kësaj bashkësie ndërkombëtare për reagim të duhur, që do t'i rregullonte gjërat që sërish kanë dalë nga vendi ku janë vendosur, pasi nuk e durojnë kallëpin e imponuar në mënyrë të padrejtë. Prandaj, situata tashti na shpërfaqet me karakteristikat, që duken si ato të fillimit të viteve '90 të shekullit të kaluar, që e kapluan ish-Jugosllavinë dhe që prodhuan pasoja të rënda.

Më në fund është koha të kuptohet, se problemet e Ballkanit Perëndimor, që ekzistojnë dhe shfaqen kur u vjen koha, është çështja e pazgjidhur shqiptare, e cila tashti manifestohet në formën e saj të re:

Kosovës. Nuk është i vogël numri i ekspertëve ose njohësve europianë dhe më gjerë, që kanë bërë me dije për këtë problem të injoruar. Por, për çudi, këto këshilla sërish nuk merren me seriozitet. Por, edhe më i çuditshëm është fakti i një kryeministri shqiptar, si Edi Rama, dhe disa shqiptarëve të tjerë, që gjithmonë janë të gatshëm të përkrahin çfarëdo plani ndërkombëtar, edhe kur e dinë se kjo gjë nuk përfundon me sukses. Zaten, ndërkombëtarët problemet e Ballkanit i konsiderojnë si çështje të një kafeneje të të çmendurve. Sa mundësojnë mbylljen e njërës kafene, hapin tjetrën.

3.2 Shaban MURATI

Ndërhyrja brutale e Vuçiqit në formatimin e qeverisë së re në Malin e Zi

Ishte e pazakontë ndërhyrja e hapur brutale e presidentit të Serbisë, Vuçiq, në procesin e tanishëm të formimit të qeverisë së re të Malit të Zi, e cila duhet të krijohet pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 11 qershorit 2023.

Në një deklaratë të tij më 14 korrik, presidenti i Serbisë shpalli papritur, se formimi i qeverisë së re në Mal të Zi kishte përfunduar, dhe se të gjithë: boshnjakët, kroatët, shqiptarët, morën pjesën e tyre, dhe vetëm serbët nuk po arrijnë ta marrin, sepse shihen si “faktor destruktiv”.

Presidenti i Serbisë njoftoi formimin e qeverisë së re malaziasë, sikur ai është guvernator i Malit të Zi, kur procesi ishte në fillimet e tij dhe përfundimin e tij nuk e kishte njoftuar as kryetari i partisë së re, që doli e para në zgjedhjet, Miloško Spajić, i cili po zhvillonte bisedime për këtë çështje me partitë e tjera parlamentare. Nuk e kishte njoftuar as presidenti i Republikës së Malit të Zi, Milatović. Me djallëzi, Vuçiqi zgjodhi ta bënte ndërhyrjen e tij dy ditë pasi presidenti Milatović ishte për vizitë zyrtare në Beograd, dhe kjo krijoi dyshimin sikur presidenti malazez kishte diskutuar përbërjen e qeverisë malaziasë me presidentin e një shteti tjetër, me Serbinë.

Vuçiqi nuk përfilli as faktin zyrtar, që parlamenti i ri malazez, i dalë nga zgjedhjet e fundit, nuk ishte konstituuar ende, dhe zyrtarisht mandatar i formimit të qeverisë nuk e kishte marrë ende mandatin për këtë nga presidenti i Malit të Zi, dhe sesioni i parë i parlamentit të ri do të mbahet më 27 korrik. *Atëherë përse kjo ndërhyrje brutale e presidentit të Serbisë në procesin e formimit të qeverisë së një shteti tjetër të pavarur?*

Media malaziasë “Vijesti” më 24 korrik i cilësonte deklaratat e presidentit Vuçiq “ndërhyrje direkte në punët e brendshme të Malit të Zi”.

Kurse media tjetër malaziase, “Cdm.me”, më 22 korrik shtronte pyetjen: *“Ku e merr të drejtën që të bëjë llogaritë e qytetarëve, të votuesve dhe të ministrave të qeverisë së një shteti tjetër presidenti i një vendi?”*.

Ngutja e ethshme e presidentit serb vjen nga objektivi i tij për të diktuar formimin e qeverisë së re të Malit të Zi, që të jetë qeveri e orientimit dhe e aleancës me Serbinë dhe me Rusinë.

Aktualisht, Mali i Zi ndodhet në një periudhë tepër të vështirë të gjendjes politike dhe gjeopolitike. Po ndodh një përplasje e hapur strategjike dhe gjeopolitike midis rrymave rivale, njëra properëndimore, që është për konsolidimin e anëtarësisë së vendit në NATO, dhe tjetra rryma antiperëndimore, e përfaqësuar nga koalicioni politiko-fetar i partive serbe, kisha ortodokse serbe dhe shërbimet sekrete serbe dhe ruse, për të neutralizuar pjesëmarrjen e Malit të Zi në NATO dhe për të rivendosur lidhjet e ngushta strategjike dhe ushtarake me Serbinë dhe me Rusinë.

Duhet pranuar se filozofia dhe orientimi atlantik dhe properëndimor kanë humbur terren në Malin e Zi, që nga gushti i vitit 2020 i zgjedhjeve parlamentare, kur inxhinieringu elektoral i shërbimeve sekrete serbe dhe ruse solli në pushtetin ekzekutiv forcat antiatlantike, proserbe dhe proruse, e deri në zgjedhjet presidenciale të marsit të këtij viti, ku humbën terren akoma më shumë forcat independentiste me orientim atlantik dhe properëndimor. Tani është beteja e madhe për të fituar pushtetin ekzekutiv me formimin e qeverisë së re, që ka përpara alternativën për ta drejtuar Malin e Zi drejt Serbisë dhe Rusisë apo drejt NATO-s dhe BE-së.

Sheshi i betejës kryesore politike dhe gjeopolitike, jo vetëm malaziase, është bërë procesi i formimit të qeverisë së re në Podgoricë, ku asnjë parti nuk fitoi në zgjedhje shumicë parlamentare, sa të krijonte e vetme qeverinë, por ka nevojën e një koalicioni partish. Serbia dhe presidenti serb, kisha fundamentaliste ortodokse serbe dhe shërbimi sekret serb e rus, kanë

mobilizuar të gjitha instrumentet dhe rrjetet e tyre dhe mjetet e presionit, që të imponojnë një qeveri antiatlantike dhe antiperëndimore, me dominimin e mashës së tyre të koalicionit të partive serbe në Malin e Zi.

Presidenti serb sipas burimeve diplomatike u ka vënë mandatarëve të qeverisë kushtin që qeveria e re të ketë dominim të koalicionit të partive serbe me postet më të rëndësishme në atë qeveri. Mandatari i tanishëm i procesit të krijimit të qeverisë, kryetari i partisë së parë fituese në zgjedhje, Milojko Spajiç, e bëri lëshimin e parë strategjik ndaj Serbisë, kur në mënyrë aprioristike përjashtoi nga pjesëmarrja në qeverinë e re forcat independentiste malaziasë, të cilat dolën të dytat në zgjedhjet e fundit, dhe po e bazon projektin e qeverisë me koalicionin antiatlantik proserb, që doli i treti në zgjedhje.

Përjashtimi i forcave independentiste apriori nga pjesëmarrja në qeverinë e re përputhet me strategjinë antiatlantike të Serbisë dhe të Rusisë. Kjo ka shtuar edhe më shumë dyshimet për taktikat dinake të kryetarit të partisë “Europa now”, për të cilin edhe pa këtë ka dyshime të mëdha për lidhjet E tij serbe, sepse është me shtetësi serbe.

Pikërisht se ka shtetësi serbe, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e përjashtoi Spajiçin nga pjesëmarrja në zgjedhjet presidenciale të 19 marsit të këtij viti. Do të ishte edhe më absurde që kryeministri i ri i një shteti anëtar të NATO-s të ketë shtetësinë e Serbisë.

Më 21 korrik *think tank*-u sloven “Ifimes. org”, në një analizë të tij për situatën pas zgjedhjeve parlamentare në Malin e Zi, tërhiqte vëmendjen: *“NATO-ja ka shprehur shqetësime për informacionin që kryetari i partisë “Europa now”, Milojko Spajiç, përveç shtetësisë malaziasë, ka edhe shtetësinë e Serbisë dhe ka rezidencë në Beograd”*.

Koalicioni i partive serbe, që Spajiçi po e projekton si aleatin kryesor të koalicionit qeveritar, drejtohet nga dy politikanë ekstremistë antiatlantikë

serbë, Andrija Mandiç dhe Milan Knezheviç, të cilët ishin protagonistë në përpjekjen për grusht shteti të 16 tetor 2016 në Mal të Zi, organizuar nga shërbimet sekrete serbe dhe ruse për të rrëzuar qeverinë e ligjshme dhe për të ndaluar hyrjen e Malit të Zi në NATO.

Për këtë veprimtari terroriste antishtetërore, të dy ata u dënuan me burg nga gjykatat e Malit të Zi. Me ndihmën e Serbisë dhe të kthesës regresive proserbe të 30 gushtit 2020, të dy jo vetëm u falën, por sot janë udhëheqësit kryesorë të koalicionit serb në Mal të Zi. Presidenti serb Vuçiç u ka vënë mandatarëve të qeverisë së re kushtin që koalicioni serb i Mandiçit dhe i Knezheviçit të ketë postet më të rëndësishme të ministrit të Mbrojtjes dhe të ministrit të Brendshëm, si dhe postin e kryetarit të parlamentit.

Në bisedimet e fundit për qeverinë e re më 21 korrik midis Spajiçit dhe Mandiçit, mandatarit i ka ofruar koalicionit serb postet e ministrit të Arsimit, të Bujqësisë, të Transportit dhe të Diasporës, gjë që e ka tërbuar Beogradin. Ndaj dhe presidenti serb iu vërsul formuesve të qeverisë së re, me akuzat se kanë përjashtuar serbët nga qeverisja.

Sipas vëzhguesve malazezë, këto përplasje mund të jenë taktika të të dyja palëve për të fshehur procesin e fshehtë të krijimit të një qeverie të re proserbe. Media malaziasë “cdm.me” shkruante më 22 korrik: *“Mali i Zi nuk është në rrugën e integritit në BE, por është në rrugën e integritit të plotë në botën serbe. Kemi një aksion të koordinuar të udhëheqësve shtetërorë të Serbisë për të forcuar aleancën politike ultra të djathtë dhe ultranacionaliste në qeveri, e cila është nën kontrollin e plotë të Beogradit dhe të Moskës”*.

Serbia dhe koalicioni i partive serbe në Mal të Zi kanë shpallur si kusht dhe bazë të procesit të formimit të qeverisë së re formulën e koalicionit qeveritar të dalë nga zgjedhjet e 30 gushtit 2020, që në saje të Beogradit solli në pushtet një qeveri proserbe. Nuk kërkohet as formula e dalë nga zgjedhjet e tanishme parlamentare, por këmbëngulet formula serbe e 30 gushti 2020.

Në një deklaratë për televizionin e Serbisë më 23 korrik, kryetari i Partisë “Demokracia e re serbe”, Mandić, afishoi nga Beogradi kushtin që “qeverinë duhet ta formojnë ata, të cilët fituan më 30 gusht 2020”. E ashtuquajtura formulë e 30 gushtit 2020 është thjesht kopertura për të krijuar një ekzekutiv me një qeveri serbe dhe ruse, siç ishin dy qeveritë e Krivokapiçit dhe e Abazoviçit pas gushtit 2020. Propaganda serbe, ruse dhe ajo filoserbe e disa qarqeve diplomatike në BE, e pompoi 30 gushtin 2020 si një fitore e madhe e demokracisë në Malin e Zi.

Në këtë mashtrim vulgar diplomatik dhe propagandistik ranë dhe qarqet levantine zyrtare në Tiranë dhe në Prishtinë, të cilat nuk dihet se për çfarë interesash u shtynë që të krijojnë tymnaja pseudoeuropianizmi për qeveritë proserbe në Podgoricë. Natyrisht nuk ishin as interesa shqiptarë dhe as interesa atlantikë.

Se çfarë është 30 gushti 2020 në Malin e Zi, e përcakton bukur dhe në mënyrë sintetike shkrimtari i njohur malazez dhe një nga analistët më të mirë të Malit të Zi, Andrej Nikolaidis, i cili më 22 korrik 2023 në një analizë të botuar në mediet malaziase shkruan: *“30 gushti 2020 nuk ishte as “triumf i demokracisë” dhe as i “rrugës europiane”, por ishte një kompletim i kundërrevolucionit klerikal dhe një grusht shteti nga Serbia e Madhe”*.

Në këtë situatë tepër komplekse dhe shqetësuese, me rreziqe të mëdha për kursin e pavarësisë dhe të orientimit atlantik dhe european të Malit të Zi, merr një rëndësi të veçantë roli dhe veprimi profilaktik i NATO-s, në një shtet anëtar të saj, dhe i BE-së në një shtet kandidat të saj. Realisht Mali i Zi ndodhet në një udhëkryq tepër të rrezikshëm. Serbia dhe Rusia nuk janë pajtuar me humbjen e madhe, që pësuan në vitin 2017 me anëtarësimin e Malit të Zi në NATO. Tani Serbia dhe Rusia po bëjnë betejën e madhe, që *de facto* Mali i Zi paralizoi atlantizmin dhe oksidentalizmin e tij dhe vendi të serbizohet me shpejtësi nëpërmjet kishës ortodokse serbe dhe forcave

politike proserbe në atë vend. Duhet pohuar se NATO-ja dhe BE-ja u treguan të mefshtë dhe neglizhentë në vitin 2020, duke besuar se Serbia dhe Rusia ishin tërhequr nga strategjia dhe lufta antiatlatike në Malin e Zi. Serbia dhe Rusia ndërruan metodat, ndaj taktikat e luftës hibride u dolën të suksesshme.

Tre vjet përvojë e hidhur nga kursi i qeverive proserbe në Malin e Zi pas gushtit 2020, duhet t'u kenë mësuar diplomatëve dhe strategëve të NATO-s dhe të BE-së, se Mali i Zi mund t'u rrëshqasë nga duart. Sepse del një pyetje e thjeshtë strategjike: *Si do të ndërtohet një qeveri e re e besueshme e Malit të Zi, kur boshti i koalicionit qeveritar pritet të jetë koalicioni i partive serbe, që janë kundër NATO-s, kundër SHBA-ve, kundër BE-së dhe për aleancë të ngushtë me Rusinë?*

Si mandatar i procesit të formimit të shumicës parlamentare dhe qeveritare, Spajiç më 19 korrik shpalli 10 pikat, ku bazohet platforma e tij për krijimin e qeverisë, dhe ku pika gjashtë ofron kushtin që orientimi i politikës së jashtme të qeverisë së 44-rt do të bazohet në anëtarësinë aktive dhe të besueshme në NATO dhe angazhimi i plotë i integritimit në BE.

Më 24 korrik kreu i koalicionit të partive serbe, Mandić, tha me gjysmë zëri, se koalicioni e pranonte platformën 10 pikëshe, por menjëherë e shoqëroi me kërcënimin se *“do të dështojë çdo eksperiment me ata që bëjnë marrëveshje me disa ambasada dhe me dëshirat e faktorëve jashtë Malit të Zi”*.

Pra, ai akuzoi ambasadat e Perëndimit, të cilat kanë shtuar përpjekjet për t'iu kundërvënë strategjisë së Serbisë dhe të Rusisë për neutralizimin e pjesëmarrjes së Malit të Zi në NATO. Media e njohur malaziasë “cdm.me” shkruante më 22 korrik, se *“SHBA-ja kanë qenë përsosmërisht e qartë dhe BE-ja ka qenë mjaft e qartë: fronti i mëparshëm proserb nuk është pjesë e dëshirueshme e qeverisë së re malaziasë”*.

Kjo barrikadë atlantike dhe perëndimore më e pranishme sesa më parë, e ka trembur Serbinë dhe Rusinë, ndaj presidenti serb Vuçiq dhe kisha ortodokse serbe kanë shtuar mënyrat dhe format e presionit dhe të ndërhyrjes në politikën malaziase.

Kemi një luftë të ashpër gjeopolitike dhe strategjike në zhvillim e sipër, që mund të marrë forma të reja të dëmshme për interesat atlantike, sidomos me ashpërsimin e konfliktit të shkrirë gjeopolitik midis Ruisë dhe NATO-s për luftën në Ukrainë.

Me këtë sy strategjik duhen parë edhe nga Shqipëria zhvillimet e reja në Malin e Zi. Shqipëria ka interes jetik, strategjik, gjeopolitik dhe kombëtar që Mali i Zi të jetë i pavarur, atlantik dhe properëndimor, dhe sa më i shkëputur nga Serbia dhe nga Rusia. Çdo shikim tjetër i zhvillimeve në Malin e Zi do të favorizonte forcat armiqësore antiatlantike dhe antishqiptare nga Beogradi e deri në Moskë.

3.3 Prof. dr. Arben MALAJ

Ballkani Perëndimor, tri prioritetet për Procesin e Berlinit

Para disa ditësh, gjatë vizitës së tij në Shqipëri, Presidenti i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, i pyetur për “Ballkanin e Hapur”, shpjegoi se janë rreth 50 nisma që duhet të organizohen nën ombrellën e Procesit të Berlinit. Programi më i mirë për ekonominë e tregtisë ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor (BP) dhe ku edhe Kosova është anëtare, është CEFTA, e cila synon eliminimin e barrierave tarifore dhe jotarifore. Barrierat jotarifore janë pengesat më të mëdha për ekonominë dhe nxitjen e tregtisë në të gjithë Ballkanin Perëndimor.

Por hapësira gjeografike dhe ekonomike e CEFTA-s, ndërkohë që zgjerohet nga vendet e BP-së, zvogëlohet nga largimi i vendeve që bëhen anëtare të BE-së, si Rumania, Bullgaria dhe Kroacia. “Zgjerimet që na ngushtojnë” janë anëtarësimet në BE të vendeve të CEFTA-s. Më konkretisht, ndërsa popullsia e BP-së është 17,06 milionë banorë, vetëm popullsia e Rumanisë është 19,9 milionë banorë, ndërsa të tri vendet së bashku kanë një popullsi prej 30,8 milionë banorësh ose rreth 13,2 milionë më shumë se 6 vendet e BP-së. Kisha një dilemë nëse “Ballkani i Hapur” do të ishte një stacion për parapërgatitjes së ekonomive të BP-së me momentin e konkurrencës me ekonominë e vendeve të Bashkimit Europian. “Ballkani i Hapur” do të ishte një stacion pritjeje drejt integritit të plotë të vendeve të BP-së, apo një shinë që shpejton rrugëtimin drejt anëtarësimit në BE?”.

Stacioni do të nënkuptonte strategjinë e BE-së për të bashkuar gjashtë vendet dhe për t’i inkurajuar dhe mbështetur ato për të hequr çdo pengesë dhe për të rinovuar bashkëpunimin e tyre. Vendet e BP-së do të prisnin derisa të përmbushnin kriteret e Kopenhagës në fushën e demokracisë, ekonomisë së gjallë dhe respektit për pakicat. Por, si në rastin e pranimit të Rumanisë

dhe Bullgarisë në vitin 2007, me rrezikun e rritjes së ndikimit rus në këto vende, BE-ja vlerësoi se do të ishte më mirë t'i pranonte ato, sesa t'i linte në një situatë ku do të rritej ndikimi negativ nga vendet jomiqësore ndaj BE-së. Integrimi i BP-së nuk është çështje e rritjes së konkurrencës apo një barrë e rëndë për taksapaguesit europianë.

Më konkretisht, për raportet do të krahasojmë Ballkanin Perëndimor me BE-në: (i) popullsia e BE-së vlerësohet në 448,4 milionë njerëz, popullsia e BP-së është rreth 17,6 milionë ose vetëm 3.93% e popullsisë së BE-së; (ii) PBB-ja nominale në vitin 2022 e BE-së ishte 16,6 trilionë dollarë, ndërsa PBB-ja e BP-së ishte vetëm 95 miliardë, ose 0,57 për qind e PBB-së së BE-së (iii), PBB për frymë në terma nominalë dhe realë. Në terma nominalë në BE, GDP-ja për kokë është 33,962 dollarë, në BP është 5400 dhe në Shqipëri 6457. Në terma realë në BE është 28 840 dhe në Shqipëri 18 552. Të ardhurat nominale të shqiptarëve janë vetëm 19% e mesatares së BE-së, ndërsa në terma realë janë rreth 64%; (iv) bujqësia në BE siguron rreth 16% të PBB-së dhe punëson rreth 4% të fuqisë punëtore. Në BP, bujqësia përbën mesatarisht rreth 10% të PBB-së së BP-së. Në Shqipëri, bujqësia prodhon rreth 21,8% të PBB-së dhe punëson rreth 45% të fuqisë punëtore. Sektori i bujqësisë në strukturën e PBB-së në Shqipëri është rreth 13,6 herë më i madh dhe i punësimit në bujqësi rreth 11,2 herë më shumë. Mbështetja buxhetore për bujqësinë është rreth 6% e PBB-së.

Thellimi i procesit të anëtarësimit në BE kërkon synime të qarta dhe ndoshta të harmonizuara politike për të garantuar katër liritë kryesore, të cilat përfshijnë: (i) lirinë e lëvizjes së mallrave; (ii) lëvizjen e lirë të shërbimeve; (iii) lëvizjen e lirë të kapitalit dhe; (iv) lëvizjen e lirë të njerëzve. Në procesin e zgjerimit të BE-së në vitin 2004 me dhjetë vende anëtare të bllokut komunist, vendet anëtare të BE-së kishin frikë nga reagimi nacionalist i partive ekstreme kundër emigrantëve, duke kërkuar një periudhë 7 deri në 9-

vjeçare për të hapur tregjet e tyre të punës. Ironia ishte se në ato vite vendet e BE-së bënë çmos për të parandaluar emigrantët, ndërsa sot përballen me mungesën e fuqisë punëtore. Vendet po lehtësojnë çdo procedurë dhe po tërheqin sa më shumë emigrantë, duke filluar nga mungesa e punëtorëve në shërbimet sociale, për shkak të plakjes së popullsisë dhe në ekonominë e dijes, duke tërhequr mjekë nga vendet e Ballkanit Perëndimor, ndihmësmjekë dhe ekspertë në IT, por edhe punëtorë të thjeshtë. Procesi i Berlinit ka premisa pozitive për të lehtësuar dhe shkurtuar procedurat dhe kohën e anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE.

Prioriteti i parë. Liderët e Ballkanit Perëndimor duhet të unifikojnë prioritetet e përbashkëta përpara takimit në Shqipëri. Ky bashkim duhet të synohet si në takime formale, ashtu edhe në takime joformale dhe pa sistem kujdestarie. Kur Toni Bler u pyet si kryeministër i Britanisë së Madhe, se cilat ishin tri prioritetet e vendit të tij, ai theksoi: “Arsimi, arsimi, arsimi”. Në realitet, BE-ja ka ndihmuar sfidat e arsimit në vendet e origjinës me programe të tilla, si “Tempus” në fillim të viteve ‘90 dhe programi “Erasmus”. Por, aktualisht jemi në një situatë kritike, për shkak të emigrimit masiv të të rinjve nga BP-ja drejt vendeve të BE-së.

Ky emigracion masiv nuk konsiderohet nga vendet e BE-së si problem për to, por si një shpresë për të mbushur mungesën e madhe të mungesave në tregun e tyre të punës me prioritet shërbimet sociale si kohezion social dhe sidomos ekspertët në IT për të mbështetur ekonominë e dijes. Tabela e ndarë në aeroporte dhe universitete të vendeve të BE-së, në vende të BE-së dhe jo të BE-së ngjan me një “Mur të ri të Berlinit”. Problemi është se kapitali njerëzor po zvogëlohet dhe po përkeqësohet në vendet perëndimore të BP-së. Kjo i vështirëson sfidat e tyre për të ngushtuar diferencën e madhe midis vendeve të BE-së dhe vendeve të BP-së.

Sipas studiuesve, kapitali njerëzor është faktori përcaktues në 50% më shumë se çdo faktor tjetër për zhvillimin e vendeve të ndryshme. Heqja e çdo barriere në procedura dhe kosto midis studentëve nga vendet e BE-së dhe studentëve nga vendet europiane do të rrisë ofertën e tregut të punës si për vendet e BE-së, por veçanërisht për vendet e BP-së. Barrierat dhe kostot për studentët e BP-së në Bashkimin Europian janë të shumta të rënda. Liderët e BP-së në mënyrë unanime duhet t'i drejtohen Presidentes së BE-së, Ursula Gertrud von der Leyen, me fjalët e Presidentit Regan, kur në Berlin i kërkoi publikisht Gorbaçovit: “Rrezojeni këtë mur, zoti President”. Muri që ndau studentët e BP-së në joeuropianë në kosto shumë të mëdha arsimimi nga studentët e vendeve të BE-së duhet të kishte rënë dje. Kjo do të rrisë ofertën në tregjet e punës, pasi më shumë studentë nga BP-ja mund të shkollohen në vendet e BE-së, nëse procedurat dhe kostot e tyre do të jenë po aq të ulëta, sa për studentët nga vendet e BE-së.

Prioriteti i dytë i unifikuar është bujqësia, për një mbështetje më të madhe të saj. Fermerët në vendet e BP-së janë nën konkurrencën jo të ndershme nga fermerët e vendeve të BE-së, të cilët marrin mbështetje si nga qeveritë e tyre, ashtu edhe nga politikat mbështetëse dhe rishpërndarëse të BE-së. Bujqësia në vendet e BP-së varion 7-9%, me përjashtim të Shqipërisë që është rreth 21% e GDP-së dhe ku punësohen rreth 45% e fuqisë punëtore totale. Në BE, bujqësia zë vetëm 1,4% të GDP-së dhe janë të punësuar rreth 4% e fuqisë punëtore. Në Shqipëri bujqësia zë 21,8% të GDP-së ose më shumë; në punësim ka rreth 45% dhe në mbështetje buxhetore nga buxheti i shtetit përfiton vetëm 0,6% të GDP-së ose rreth 2% të buxhetit. Pra, bujqësia në Shqipëri, bazuar në kontributin në GDP është rreth 13 herë më e lartë dhe në punësim rreth 11 herë më e lartë. Buxheti afatmesëm i BE-së përlllogaritet rreth 1 274 milionë dhe burimet natyrore ku përfshihet edhe bujqësia zënë rreth 29,2% të totalit të buxhetit ose rreth 374 miliardë.

Prioriteti i tretë i unifikuar është mbështetja tek ekonomia e dijes dhe ekonomia e gjelbër.

3.4 Dr. Selim IBRAIMI, Uashington

Një kthesë ironike në kurriz të shqiptarëve dhe krijimi i aleancës serbo-maqedonase

Qeveria kosovare duhet të mënjanojë një konferencë ndërkombëtare të Fuqive të Mëdha për pjesën veriore ose një Dejton të dytë. Një konferencë e tillë do të kishte pasoja fatale. Takimi i fundit serbo-maqedonas në kuadër të “Ballkanit të Hapur” është një tregues, se një aleancë sllave është në ngritje, e cila tashmë merr formë bashkëpunimi në kuadër të eurointegritimeve. Si duket, maqedonasit kanë dëshirë të hyjnë përsëri nën sundimin modern serb të shek. XXI.

Dështimi i “Ballkanit të Hapur” një vit më pas, tregon se ideja ka qenë e vështirë të implementohet në Ballkanin e vjetër. Kur kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ai maqedonas, Dimitar Kovaçevski, dhe presidenti serb, Aleksandar Vuçiq, pa përjashtuar këtu mbështetës të tjerë të nismës, si kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, në verë të 2022-ës qeshnin bashkë me priftin ortodoks, sot në 2023-ën nuk kanë shumë fjalë të mëdha. Projekti u deklarua i përfunduar pa pasur ende asnjë rezultat. Kryeministri Rama, më në fund, por jo publikisht, e pranoi se “Ballkani i Hapur” është një humbje strategjike për Shqipërinë. Askush nuk besonte se nisma e Ramës, Vuçiqit dhe e Zaevit një ditë do të shkonte në histori për asgjë, të paktën për Shqipërinë. Dhe gjithë kjo ndodhi papritmas, nga njoftimi i kryeministrit Rama, se “Ballkani i Hapur” e ka kryer misionin. Është për t’u habitur se, përveç disa marrëveshjeve të nënshkruara mes shteteve, diçka e rëndësishme nuk ka ndodhur për banorët e rajonit nga kjo nismë. Qytetarët e rajonit ende presin me muaj për një diplomë të marrë në Shqipëri të nostrifikohet në

Maqedoninë e Veriut apo në Serbi. Udhëtarët dhe transportuesit vazhdojnë po ashtu të presin me orë të tëra në vendkalimet kufitare të shteteve të “Ballkanit të Hapur”. Në fund, del se “Procesi i Berlinit” mbetet projekti më serioz ekonomik i integritit të shteteve të Ballkanit në BE. Kur mori hov ky projekt i treshes ballkanike, të gjithë mbështetësit mendonin se ishin në anën e duhur të historisë dhe të tjerët për së koti po shtrojnë disa dilema dhe vërejtje për këtë projekt, i cili në fillim kishte mbështetje të kufizuar nga SHBA-ja dhe BE-ja. Tani është tejet e qartë, se “Ballkani i Hapur” ka dështuar në praktikë. Në fjalimet e liderëve, se një ditë do të konkretizohet me vepra, në fund mbeti vetëm një shfaqje publike për banorët e varfër të rajonit dhe, sidomos, të Shqipërisë. Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut, pa Serbinë, nuk janë në gjendje të drejtojnë “projekte” si “Ballkani i Hapur”. Beogradi, sigurisht, me fuqinë aktuale ekonomike dhe ushtarake, sovranitetin e shteteve pjesëmarrëse në “Ballkanin e Hapur” e konsideron për asgjë. Aktualisht Beogradi vetëm me Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi mund ta zhvillojë lojën e dikurshme të Serbisë jugosllave, duke dominuar popujt sllavë të jugut. Si duket, maqedonasit kanë dëshirë të hyjnë përsëri nën një sundimin të ri modern serb, atë të shek. XXI.

Takimi i fundit serbo-maqedonas në kuadër të “Ballkanit të Hapur” është një tregues se një aleancë sllave është në ngritje, e cila tashmë merr formë bashkëpunimi në kuadër të euro-integrimeve. Që nga viti 1991, pjesa qeveritare proserbe e Maqedonisë së Veriut e ka ëndërruar këtë projekt serbo-maqedonas të integritit në një union të llojit, ku vetëm sllavët e jugut do të janë aktorë. Dhe ja, erdhi koha për maqedonasit dhe serbët të jenë afër bashkimit jo vetëm doganor, por edhe më shumë. Në anën veri-perëndimore të Ballkanit, të krahut serbo-maqedonas, shqiptarët për arsye të ndarjeve historike dhe politikës ditore janë larg formimit të një unioni të përbashkët qoftë ekonomik. Kosova dhe Shqipëria, përkundër disa marrëveshjeve të

nënshkruara, nuk kanë prodhuar gjë konkrete në marrëdhëniet mes dy vendeve. Mungesa e vlerësimit strategjik si për Tiranën, ashtu edhe për Prishtinën zyrtare ka qenë dhe vazhdon të jetë katastrofale për hapësirën shqiptare në Ballkan. Të dy popujt, për nga aspekti psikologjik dhe vullneti kombëtar, janë të papërgatitur për një ndryshim të tillë: bashkim. Shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, për momentin, janë në gjumë të thellë në krahasim me zgjimin kombëtar dhe fetar serbo-maqedonas. Një përfaqësues i partisë shqiptare në pushtet, BDI, Ejup Rustemi, ka marrë pjesë në takimin ndërmjet kryeministrit maqedonas, Dimitar Kovaçevski, dhe kryeministres serbe, Ana Bërnabiq, duke dëshmuar politikën ose linjën zyrtare të partisë së kryetarit Ahmeti (BDI) për forcimin e lidhjes serbo-maqedonase, e duke shkelur në anën tjetër vullnetin e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut. Ngritja e një unioni serbo-maqedonas detyrimisht do të ndikojë shumë te baraspesha etno-fetare në Ballkanin Perëndimor. Në vitet në vijim, gjasat janë të mëdha, që në Ballkan të ketë ndarje të reja, të cilat që tani kanë një pamje të qartë me forcimin në rritje të lidhjeve Shkup-Beograd.

Me tërheqjen e Shqipërisë nga “Ballkani i Hapur” dhe mbetjen aty të Serbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut, ndarja ka shumë gjasa të ndodhë, pavarësisht euro-integrimeve. Serbia, si faktor kryesor në Ballkan, do të mbajë rolin udhëheqës se si rajoni duhet të zhvillohet. Dhe këtu, në veçanti Beogradi, do të pyetet për projektin e përbashkët serbo-maqedonas dhe raportet me BE-në dhe aktorët e tjerë globalë. Në marrëdhëniet me Europën dhe SHBA-në, Serbia dhe Maqedonia e Veriut do të favorizohen shumë me ndihma ekonomike dhe ushtarake, të cilat do të rriten në vitet që vijnë. Baraspesha ushtarake dhe ekonomike do të lëkundet. Kjo do të ketë efekte në Kosovë dhe te popullsia shqiptare në Maqedoninë e Veriut. Shqipëria, për arsye të pozitës gjeografike, nga presioni që do të vijë prej aleancës serbo-maqedonase, do të përpiqet të mënjanojë pasojat negative të

dëmtimit të ekonomisë dhe prodhimit kombëtar, që daton që kur kryeministri Rama u lidh fort me Serbinë, ashtu si dikur diktatori komunist Enver Hoxha nënshkroi një regjim të përbashkët doganor me Jugosllavinë e Titos pas LDB-së, më 27.11.1946.

Dejtoni i dytë në kuadër të rënies së interesit për forcimin e shteteve multietnike në Ballkan

Në kuadër të venitjes së nismës së “Ballkanit të Hapur”, qeveria në Kosovë jeton me shpresë, se SHBA-ja dhe BE-ja do të sillen më mirë me Kosovën. Është e vështirë të thuhet se Uashingtoni është i interesuar më shumë se kaq për Kosovën. Asociacioni Serb në Kosovë (AKS) është detyra kryesore e SHBA-së. Për sovranitetin dhe territorin e Kosovës, se në të ardhmen mund të vihet në rrezik, kjo nuk përbën ndonjë shqetësim për Perëndimin. Pse?! Sepse Uashingtoni dhe BE-ja nuk janë më të interesuar, që në të gjithë Ballkanin të ketë shtete multietnike. AKS-ja mund të shihet si ndërhyrje e jashtme, me një model që do të jetë një mjet politik në këtë fazë të transformimit të disa pjesëve problematike të rajonit deri në bashkëngjitje të këtyre pjesëve në të ardhmen me shtetet plotësisht etnike (amë) në Ballkan. Modeli mund të shërbejë edhe për grupet e tjera etnike në Ballkan, në varësi nga kërkesat e tyre politike për vetëqeverisje. Një situatë e tillë mund t'i ndodhë Bosnjës, e cila sipas vlerësimeve të jashtme nuk ka të ardhme si federatë. Përderisa SHBA-ja dhe BE-ja i kanë ngulur këmbët në AKS-në, qeveria në Prishtinë duhet të mënjanojë një situatë tjetër, që Veriu të mos bjerë plotësisht nën kontrollin e forcave ndërkombëtare, ku Prishtina nuk do të kishte më asnjëfarë autoriteti në veri. Më tej, Prishtina zyrtare duhet të manovrojë, të tregohet e shkathtë dhe jo e ngurtë në leximin e sjelljeve të SHBA-së. Më së paku, qeveria kosovare duhet të shmangë një konferencë ndërkombëtare të Fuqive të Mëdha për Kosovën ose një Dejton të dytë për

Kosovën. Një konferencë e tillë do të kishte pasoja fatale për Kosovën, pasi pjesa veriore përfundimisht do të përfshihej nën kontrollin e serbëve dhe me plot të panjohura për burimet e Kosovës. Në këtë çështje të ndërlikuar mes Kosovës dhe Serbisë duhet pranuar se nuk ka zgjidhje të drejtë. Të dyja palët kanë argumentet që nuk sjellin marrëveshje të qëndrueshme. Por një gjë është e sigurt: një pajtim ose marrëveshje serbo-kosovare do t'u prishte shumë punë rusëve dhe serbëve radikalë. Në veçanti, është e mundur që serbët, përfundimisht, të jenë bindur se stabiliteti në veri është në interes të Serbisë dhe serbëve në veri të Kosovës dhe, më në fund, serbët lokalë do ta pranojnë Kosovën si atdheun e tyre. Ky mbetet skenari më i dëshiruar, që është i afërt edhe me deklaratimet e zyrtarëve të Perëndimit.

Një vështrim historik, që nga pavarësia e Serbisë nga Perandoria Osmane (1878), njohja e saj nga fuqitë botërore e deri në veprimet e sotme, del se Beogradi do të vazhdojë me politikat aktuale për një Ballkan të ri mbi baza etnike dhe fetare. Aktualisht gjendemi në këtë fazë. Ndoshta me një qeveri tjetër Beogradi mund t'i kthehet Europës e këtui Perëndimi do t'u jepte fund përkëdheljeve. Por tani për tani gjërat janë ashtu siç i përshkruam më lart dhe mund të marrin formë në drejtime të ndryshme, në varësi se kur dhe si do të përfundojë lufta në Ukrainë. Duke u marrë me vetveten dhe duke akuzuar Perëndimin se pse është në anën e Serbisë, shqiptarët në Ballkan i rrisin gjasat që ta humbin rolin rajonal në këtë shekull. Duke e ditur se politika e shteteve europiane, me përjashtim të botës gjermanike, historikisht nuk ka qenë në favor të shqiptarëve në Ballkan, atëherë është e njëjta BE sot, e cila, duke mbrojtur interesat ekonomike dhe politike të vetat, nuk i intereson shumë se kush me kë është, por synon ta rrisë sigurinë e vet brenda unionit. Përderisa shqiptarët në Ballkan nuk do ta shohin Europën e sotme nga ky kënd, vajtimet dhe kritikrat se përse BE-ja dhe SHBA-ja nuk janë më me shqiptarët, do të vazhdojnë, duke mos prodhuar asgjë konkrete për

Kosovën, Shqipërinë dhe, aq më pak, për shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, që po shkojnë drejt asimilimit prej partive të tyre, që qeverisin me maqedonasit. Koha është që klithmat të ndërpriten dhe të punohet së bashku me aleatët rajonalë dhe fuqitë botërore, ku interesi ushtarak dhe ekonomik shqiptar mund të rritet me respekt dhe të sjellë forcë dhe pozicione përkatëse në politikën europiane dhe botërore.

3.5 Ante MIRIĆSTU, Zagreb

Humbja e SHBA-së në Mal të Zi apo rënia “hibride” e “skifterit të zi”

“Po i lutem Titos dhe Mosha Jevrejës të më falin që jam kaq budalla”.

“Ai që e pranon të keqen në mënyrë pasive, është po aq i përfshirë në të, sa ai që ndihmon për të kryer të keqen.” – Martin Luther King.

Domethënë, duket që Perëndimi nuk është në gjendje ta ndalë rënien në çrregullim të periferisë së tij?!

Pas pushtimit të Malit të Zi nga koalicioni i madh serb (i madh rus), i personifikuar përmes personazheve të Presidentit të Malit të Zi, Jakov Milatoviq, kryetarit të Kuvendit, Andrija Mandiq dhe kryeministrit, Milojko Spajiq, përmes agjencisë së Putinit dhe Vuçiqit, mund të shtrohet pyetja nëse në Malin e Zi ia ka vlejtur angazhimi i Perëndimit, pra me mbrojtjen e tij..., ndaj ta sqarojmë menjëherë si hyrje në temë:

Distanca e Malit të Zi nga NATO-ja dhe hyrja e tij në orbitën proserbe (që do të thotë në të njëjtën kohë proruse dhe prokineze) hap mundësinë që Rusia dhe Kina të kenë dalje në detin Adriatik, kryesisht përmes portit të Barit. Përkatësisht, Rusia tashmë i ka kërkuar Malit të Zi, që të lejojë hyrjen e marinës ruse në bregdetin malazez, por më pas është refuzuar me vendosmëri nga qeveria e atëhershme properëndimore.

Megjithatë, pritet që Rusia dhe Kina së shpejti ta përsërisin këtë kërkesë, duke qenë se klima politike në Mal të Zi ka ndryshuar. Në këtë kontekst ka pasur spekulime se disa kompani serbe janë të interesuara për të blerë një pjesë pronësore në portin e Tivarit, ndoshta me kapital rus ose kinez. Prandaj Moska dhe Pekini padyshim që do të nxitojnë të përfitojnë nga mbikëqyrja e Vuçiqit mbi atë port. Me këtë, Rusia dhe Kina do të fitonin

një platformë të mirë për të kërcënuar interesat financiarë dhe vlerësues të Perëndimit në të gjithë Mesdheun, si dhe në Afrikën Veriore dhe Lindjen e Mesme. Në të njëjtën kohë, rënia përfundimtare e Malit të Zi nën mbikëqyrjen serbo-ruse paraqet një goditje të fortë për prestigjin e BE-së dhe SHBA-së në mbarë botën.

Domethënë, vetë fakti që politikanët malazezë ia lejuan vetes të injoronin rekomandimin e qartë të Perëndimit (ishte sugjerim) për të mos hyrë në koalicion me partitë ekstremisht proruse gjatë krijimit të një qeverie të re dhe bënë pikërisht të kundërtën, tregon se ky është prestigji i tyre i tronditur rëndë në Ballkanin Perëndimor. Pra, nëse vendet perëndimore tregohen të paafta për ta ndaluar Serbinë e vogël të Vuçiqit, nuk është e vështirë të merret me mend se çfarë përfundimi do të nxjerrin nga kjo Putini, Xi, Khamenei apo Kim Jongu.

Përkatësisht, përfundimi i tyre do të jetë se Perëndimi është dobësuar, që do të ishte një sinjali për fillimin e sulmeve edhe më të forta ndaj interesave amerikanë dhe europianë në rajone të tjera të botës.

Koncesioni kundërproduktiv ndaj Serbisë

Analisti amerikan Janus Bugajski kritikoi Departamentin e Shtetit për politikën e keqe në Ballkanin Perëndimor, veçanërisht në Mal të Zi. Përkatësisht, ai pohoi se mungesa e mbështetjes së SHBA-së për partitë proeuropiane ka ndihmuar në formimin e qeverisë aktuale proserbe/proruse në Mal të Zi.

Sipas Bugajskit, zyrtarët amerikanë të caktuar në ZB nga administrata Biden ose kanë njohuri të kufizuara për historinë e saj të fundit dhe ambiciet e lojtarëve politikë, ose kanë qenë subjekt i mashtrimit dhe dezinformimit, *“ajo që unë do ta quaja korrupsion mendor, edhe pse më parë duke shërbyer në rajon”*.

Prandaj, dorëzimi ndaj Serbisë doli të ishte kundërproduktiv, në radhë të parë për shkak të destabilizimit të vazhdueshëm të vendeve fqinje, si Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Kosova dhe Serbia, Maqedonia, ...d.m.th., për të njëjtën arsye si rezultoi dorëzimi ndaj Kinës në vitet '90, nënshtrimi ndaj Rusisë në fund të dekadës së parë të shekullit XXI të ishte kundërproduktiv, duke iu dorëzuar Iranit për të përfunduar marrëveshjen bërthamore.

Më në fund, në të gjitha këto raste, doli të ishte një qëndrim thellësisht i gabuar, që vendet autoritare, thellësisht antiperëndimore, do të bëhen përfundimisht shtete miqësore nëse vendoset bashkëpunimi ekonomik me to.

Kujt ia la Perëndimi Malin e Zi?

Vladimir Putini e filloi karrierën e tij politike si reformator dhe arriti “të ngrejë” Rusinë pas sundimit të diskutueshëm të Boris Jelcinit. Më konkretisht, në fillim të mbretërimit të tij, ai mbikëqyri kryesisht bumin ekonomik të vendit të tij falë rritjes së çmimit të naftës. Megjithatë, sapo të ardhurat nga nafta filluan të bien, ai bëri një “kthesë”, gjë që ndodhi në fillim të mandatit të tij të tretë presidencial në vitin 2012, pra pasi shpërthyen protestat kundër sundimit të tij (në më shumë se 100 qytete), duke pasur parasysh se ekonomia ruse filloi të lëkundet.

Në këtë kontekst, “New York Times” njoftoi kohët e fundit, se zgjidhja që Putini miratoi në atë kohë ishte “të zhvendoste themelet e legjitimitetit të regjimit të tij nga përparimi ekonomik në patriotizmin e militarizuar”, duke e kthyer Rusinë në një kështjellë “të rrethuar” që vetëm ai mund ta mbrojë. Kështu, ai u kthye nga “një shpërndarës i të ardhurave në një shpërndarës të dinjitetit, kështu që pushtimi i tij në Ukrainë për të

rivendosur atdheun mitik rus ishte një lëvizje e domosdoshme, domethënë e pashmangshme”.

Sigurisht, në këtë kuptim, Moska shfrytëzon edhe “fusha të tjera të minuara gjeostrategjike” në të gjithë perandorinë e saj të vjetër dhe më gjerë... Domethënë, *“Moska ka krijuar/“mbjell” linjat e prishjeve për dekada, madje edhe shekuj, në dhe rreth Rusisë për qëllime perandorake...”*, siç shkruan “Forbes” për të.

“Kuvendi i ri i Podgoricës” me në krye Andria Mandiqin

Kryetari i Kuvendit të Malit të Zi më 30 tetor 2023, “Heroi” i Putinit, siç tha ai, dhe duka çetnik i Vuçiqit, Andrija Mandiq, u zgjodh si lojtari kryesor i vërtetë i Moskës dhe Beogradit në Mal të Zi. Pra, Mandiq është presidenti i ri i parlamentit malazez dhe në bazë të këtij funksioni është anëtar i Këshillit për Mbrojtje dhe Siguri, organi që komandon Ushtrinë e Malit të Zi. Ai është kreu i Demokracisë së Re Serbe, një anëtar i Frontit Demokratik Prorus (DF) të shpërbërë së fundmi, i quajtur tani “Për të ardhmen e Malit të Zi”.

Sipas fjalisë hyrëse, prioritetet e politikës së jashtme të partisë së Mandiqit janë heqja e sanksioneve ndaj Rusisë dhe tërheqja e njohjes së pavarësisë së Kosovës. Po ashtu është kundërshtar i anëtarësimit të Malit të Zi në aleancën e NATO-s. Por siç dihet, Mali i Zi është anëtar i NATO-s që nga viti 2017. Ai është gjithashtu mohues i gjenocidit në Srebrenicë, ndërsa titullin e *Dukës Çetnik* e mban që nga viti 2007.

Ai ka qenë deputet i Kuvendit të Malit të Zi për dy dekada dhe në ditën e sipërpërmendur është zgjedhur kryetar i kuvendit të Malit të Zi me 49 vota, nga gjithsej 81 përfaqësues në parlament. Në këtë kontekst, theksojmë se zgjedhja e Mandiqit është pjesë e një pakete më të gjerë të ndarjes së pushtetit mes serbëve të mëdhenj atje. Gjegjësisht, sipas marrëveshjes së

bërë me shumicën e re proserbe nga kryeministri Milojko Spajiq, partitë (proruse) të DF-së do të mbështesin qeverinë e tij pakicë në parlament dhe në fund të vitit të ardhshëm, do të bëhen zyrtarisht pjesë e saj (duke pritur kthimin e Trump-it në krye të SHBA-ve pas zgjedhjeve të ardhshme presidenciale, të cilat do të mbahen më 5 nëntor 2024).

Në të njëjtën kohë, për ta afruar Mandiqin me lexuesit tanë, gjegjësisht se çfarë kalibri fashist serb është ai, mund të shihet më së miri përmes deklaratave të gazetarit Jadran Kapor, të shkruara për “Dubrovački Vjesnik” më 31 tetor 2023: *“Malazezët zgjodhën një çetnik, pra atë që duan. Por ajo që më zemëroi mbrëmë teksa po shikoja Mandiqin në Kuvendin e Malit të Zi, ishte dialogu i tij me Gjukanoviqin, në të cilin Mandiq tha: “Nëna e askujt nuk qau për Andrija Mandiqin, por ajo qau për shumë nga DPS-ja”.*

Vojvodo, komandant i baterisë së lehtë të artilerisë vetëlëvizëse, ejani në Dubrovnik dhe tregojani këtë nënave të Nikola (18 vjeç) dhe Miha (19) Liban, Joshko Vuković (20), Vladimirka Dopsai (17), Denis Čimić (18), Alen Vasiljević (20), Milenko Kulaš (20), Ivo Mashkarić (36) dhe Jozo Brajović (41), të cilët u vranë nga një predhë mortajr. Tregojani motrës së shokut tim të klasës, Niksha Galov, i cili vdiq në Osojnik, ku keni bërë foto me krenari (me ish-kryeministrin e Malit të Zi, Zdravko Krivokapiq, dhe rezervistë të tjerë). Dhe ku do të donin të bënin sërish foto”.

Marrëdhënia e qeverisë së re në Malin e Zi me BE-në dhe NATO-n

Sipas Davor Gjenerit, pritet që procesi i reformave të anëtarësimit të Malit të Zi në BE të ngrijë edhe më thellë sesa ishte me administratën e Krivokapiqit dhe Abazoviqit (fjala është për dy qeveritë e mëparshme proserbe të Malit të Zi, me shqiptarin Dritan Abazovic në krye, i cili promovoi, ose më mirë punonte, për interesat serbë në Mal të Zi.)

Lidhur me dëmin që i është bërë anëtarësimit malazez në aleancën e NATO-s, nga Vukshiq (Dejan Vukšić, ish-drejtuës proserb/prorus i Agjencisë së Sigurisë Kombëtare /ANB/ nga viti 2020-2022) i procedurës së menaxhimit të të dhënave të klasifikuara, të cilën Mali i Zi, si vend anëtar merr nga shërbimet mike dhe vendet aleate, duhet theksuar se ato nuk mund të përsëriten. (Në atë kohë në Podgoricë qarkullonte një batutë, se gjithçka që NATO-ja dërgon në Mal të Zi është menjëherë në tryezën e ambasadorit rus në Podgoricë.)

Përkatësisht, sipas Gjenerit, pas largimit të Sava Kenterës nga ANB (5 maj 2022 - 7 tetor 2022), Mali i Zi nuk merr më të dhëna përkatëse nga struktura e aleancës së NATO-s, dhe për këtë arsye nuk është anëtar i NATO në “formë të plotë”!

Pasoja për Kroacinë dhe Bosnjë-Hercegovinën, për segmentet e energjisë dhe transportit

Që nga formimi i administratës së Krivokapiqit në vitin 2020 e deri më sot, Republika e Malit të Zi ka bllokuar projektin për ndërtimin e një degëzimi të gazsjellësit TAP (Trans-Adriatic Pipeline), nga Shqipëria në Republikën e Kroacisë, i cili duhet të lidhet me interkonjeksionin për Bosnjën dhe Hercegovinën pranë Imotskit, gjë që do ta çlironte atë vend nga kthetrat e energjisë së Rusisë. E njëjta gjë është edhe me bllokimin e vazhdimin të ndërtimit të autostradës Adriatiko-Joniane! Britanikët (Boris Johnson 2019-2022) dhe amerikanët (Donald Trump 2017-2021) ia lanë Malin e Zi rusëve dhe serbëve.

Shtrohet pyetja: *Cila është agjenda reale e Perëndimit në ZB, pra a ekziston ajo?*

Si përgjigje më e mirë për dyshimin e mëparshëm, do të përcjellim disa fragmente nga një artikull i botuar në Pobjeda të Podgoricës, me autor Nenad

Zeçeviq më 28 tetor 2023, të cilat i konsiderojmë shumë domethënëse (pa hyrë në vërtetësinë e tyre).

Gjegjësisht, sipas këtij artikulli, Perëndimi me pasivitetin e tij mundësoi rrëzimin e properëndimorit Milo Gjukanoviq, i cili në fund të fundit ishte në favor të Ruisë dhe Serbisë.

Kështu, dega ideologjike e Vojisllav Sheshelit, historiani serbomadh Aleksandar Rakoviq deklaroi së fundi në “TV Happy”, se në ndryshimin e qeverisë në Mal të Zi, përveç Serbisë dhe Kishës së Serbisë (KPS), rol të rëndësishëm luajti edhe faktori perëndimor, duke pohuar se “anglezët përmes ambasadës në Beograd morën pjesë në përmbysjen e Gjukanoviqit, ndërsa administrata “Trump” dha dritën jeshile për të”.

Ai gjithashtu tha: *“Unë u takova dy herë me britanikët në Beograd dhe ata ishin për largimin e Gjukanoviqit nga pushteti, por ata kërkuan garanci, se Mali i Zi nuk do të tërhiqej nga NATO-ja”*. Sipas tij, përmbysja e Gjukanoviqit *“është rezultat i një harku kohor të çmuar që ata kishin gjatë sundimit të Trump-it. Gjatë atyre katër viteve na u desh ta rrënonim Gjukanoviqin në Mal të Zi, ta mposhtnim në zgjedhje dhe të krijojmë një organizatë, që thjesht e dërrmo”*, - tha Rakoviq.

Për më tepër, propagandisti i Vuçiqit, Rakoviq, deklaroi se britanikët ishin veçanërisht të interesuar nëse Mali i Zi do të ishte nën presion për t'u larguar nga NATO. *“Kjo ishte e vetmja gjë që kishte rëndësi për ta. Kjo nuk është e rëndësishme për serbët për momentin (të paktën Serbia pak e madhe është më e rëndësishme për ta), dhe për britanikët është e rëndësishme që të mos ngrihet çështja e largimit të Malit të Zi nga NATO-ja. Nuk ishte momenti për të folur për NATO-n. Ishte e rëndësishme që Gjukanoviq të mposhte dhe të mos kishim pengesa nga ajo palë europiane. Ne e dinim që Trump-i dhe qeveria e tij nuk do të pengonin asgjë, sepse Trump “shtyu” Dushko Markoviqin (bëhej fjalë për incidentin që ndodhi midis Presidentit të SHBA-*

së, Trump, dhe kryeministrit C.G. Marković në samitin e NATO-s në Bruksel më 26.05.2017, kur gjatë turneut në ndërtesën e selisë së re të NATO-s, Trump e largoi Markovićin që i qëndronte përballë dhe në “Fox News” (TV) Trump madje u tall me malazetët”.

“Fatmirësisht, - vazhdoi Raković, - atëherë u krijua korniza për përmbysjen e Gjukanoviçit, duke shtuar se pritej që Gjukanoviç të sulmonte Kishën Serbe dhe më pas t'i shërbente hakmarrjes për këtë edhe përmes protestave/çështjeve të udhëhequra nga Kisha e Serbisë, pas së cilës humbi pushtetin në gusht 2020”.

Çfarë mendojnë britanikët për të gjitha këto tani, kjo nuk është e qartë, megjithëse mund të supozohet se ata e kuptojnë se “janë mashtruar”, të paktën në lidhje me pozicionin e Malit të Zi në NATO.

Në vend të konkluzionit

Perëndimi është ngatërruar në “tre e tre” në Malin e Zi dhe Serbi

Gazetarja e BeH-së, Dženana Karup Druško, (*Antena M*), shkruan se ende ka diskutime në BE dhe SHBA, se kush është fajtori për sulmin e fundit terrorist në Kosovë dhe a ishte i përfshirë Vuçiq në të?!

Po ashtu, sipas Karup Drushkos, asnjë nga perëndimorët nuk e ka pyetur veten se ku i ka shpenzuar Vuçiq 500 milionë euro për vitin 2022, që në raportin për buxhetin e Republikës së Serbisë është shënuar si *informacion konfidencial*. Pra nëse, gjoja, nuk dihet se për çfarë i ka shpenzuar Vuçiqi, ndoshta edhe paratë e taksapaguesve të vendeve perëndimore, që investojnë në Serbinë “e reformuar”, duket se duhet pyetur se sa nga ato 500 milionë euro “konfidenciale” janë përdorur për të. financojnë jo vetëm aktivitetet e formacioneve paraushtarake në Kosovë, por edhe për destabilizimin e BeH, CG dhe Maqedonia e Veriut!

Në këtë kontekst, vlen të shtohet dhe të merren në konsideratë edhe “operacionet” e mëdha tektonike të treguara të shërbimeve në ZB, dhe një pretendimi (sigurisht i paverifikuar) nga rrjetet sociale kroate. Domethënë, sipas tij, “largimi dhe arrestimi i huliganëve të BBB-së në Greqi, marshimi i Paveliqit në Osijek dhe Zagreb, mbishkrimet e urrejtjes në Klubin CG dhe përdhosja e memorialit të Smojës edhe në Split, së bashku me idetë fëmijërore të të dy kryetarëve kroatë janë financuar pjesërisht nga “ndryshimi i vogël” nga “fondet konfidenciale” të përmendura më parë”, të paktën siç do të thoshin njerëzit e profesionit, “përmes dorës së dytë ose të tretë, domethënë është vendimtare që dora e parë është naive dhe nuk e kupton kopertinën”?!

Për më tepër, për t'u kthyer në Mal të Zi dhe me ndihmën e Andrej Nikolaidis, le të përpiqemi të parashikojmë sjelljen e ardhshme të autoriteteve proserbe në Mal të Zi. Domethënë, është e mundur që manovra e radhës e Mandiqit të jetë identike me atë të një fyelltari të afërt me kishën e Serbisë dhe çetnikët, të cilët ata e kujtojnë me dashuri edhe sot. Pra, ndërsa po vazhdonte Lufta e Dytë Botërore, ai u hodh kundër partizanëve, por kur lufta mbaroi dhe çetnikët u mundën, ai këndoi: *“Unë po i lutem Titos dhe Moshë Jevrejës të më falin që jam kaq budalla ”*.

Megjithatë, ne nuk jemi në një humor të tillë, duke e ditur se si Putini ia dorëzoi Nagorno Karabakut ortodoks/armen me ftohtësi Azerbajxhanit, sapo e kuptoi se Armenia filloi të bashkëpunonte me SHBA-në, me një masë të pranueshme në Rusi!

Për më tepër, më 16 tetor 2023, “homologu” i Mandiqit në RS/BiH, Milorad Dodik, pas kritikave amerikane për punën e tij, me rastin e sulmit ndaj rendit kushtetues dhe ligjor të BeH-së, “u revoltua” dhe thirri ambasadorin amerikan në Sarajevë. Sigurisht, këtë nuk e bëri pa miratimin e Beogradit dhe Moskës!

Dhe së fundi, nëse e kemi të vështirë të pranojmë suksesin e shërbimeve ruse dhe serbe (FSB dhe BIA) në Mal të Zi, atëherë na shtrohet pyetja: *pse Perëndimi e la Malin e Zi në Lindje?* Mirëpo, për momentin nuk kemi përgjigje për këtë pyetje, kemi vetëm hipoteza të tilla, si: ndoshta Mali i Zi ishte një kompensim për Serbinë për Kosovën, ndoshta synimi është të krijohen shtete më dominuese, si Serbia dhe Shqipëria, që “do të mbikëqyrin” sovranitetin e Malit të Zi, BeH-së, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut) e kështu me radhë!

[*Geopolitika News*, 6 nëntor 2023, përktheu: ISHGJ]

3.6 Dr. Dritë RAFUNA dhe Dr. Agim Krasniqi

Gjeopolitika dhe zhvillimi rajonal në Ballkan

Rëndësia e korridoreve rrugore dhe hekurudhore

Abstrakti

Ballkani është një rajon me një rëndësi të jashtëzakonshme gjeopolitike, ku sfidat dhe rivalitetet gjeopolitike rriten, duke e bërë atë një “udhëkryq” në marrëdhëniet ndërkombëtare. Në këtë kontekst, kjo analizë fokusohet në ndikimin e gjeopolitikës në zhvillimin dhe integrimin rajonal të Ballkanit. Përmes një shqyrtimi të thelluar të historisë së rajonit dhe teorive gjeopolitike, analiza shpalos rëndësinë e Ballkanit si një zonë e rëndësishme për politikën botërore dhe për zhvillimin ekonomik të Europës. Në veçanti, përqendrohet në Korridoret 8 dhe 10, dy korridoret kryesore rrugore dhe hekurudhore që kalojnë nëpër Ballkan dhe që ofrojnë një lidhje të rëndësishme për rajonin me Europën. Analiza përfundon me një vlerësim të rolit të korridoreve në rritjen e lidhjeve ekonomike dhe në përmirësimin e integritetit rajonal në Ballkan.

Rëndësia e korridoreve rrugore dhe hekurudhore në zhvillimin rajonal të Ballkanit

Historikisht, Ballkani Perëndimor ka qenë në qendër e konflikteve dhe, si i tillë, konsiderohet një rajon me një rëndësi të jashtëzakonshme gjeopolitike, ku sfidat dhe rivalitetet gjeopolitike rriten, duke e bërë atë një “udhëkryq” në marrëdhëniet ndërkombëtare. Për afro tridhjetë vjet, rajoni është karakterizuar nga paqëndrueshmëria. Megjithatë, aktualisht, shtetet e këtij rajoni po përballen me një kthesë potencialisht të rëndësishme, të ndikuar nga zhvillimet brenda dhe ndryshimet në rendin ndërkombëtar global. Në

nivel kombëtar, Ballkani Perëndimor duket se po përjeton një përparim ekonomik që nga periudha e konflikteve në vitet 1990 dhe fillimi i viteve 2000. Kjo vërehet në rritjen e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB), rritjen e eksporteve dhe importeve, përmirësimin e klimës së biznesit etj. Në të vërtetë, rajoni nuk është vetëm skenë e betejave të politikave gjeopolitike të një lufte të re të ftohtë, por gjithashtu është në qendër të një gare të vazhdueshme për burimet energjetike, si dhe për zhvillimin dhe kontrollin e rrugëve e hekurudhave. Kjo zonë strategjike është rëndësishme, për shkak të pozicionit të saj si pikë e lidhjes mes Lindjes dhe Perëndimit, Europës dhe Azisë, si dhe mes Europës Qendrore dhe rajoneve të Mesdheut. Përveç kësaj, kjo hapësirë gjendet në një pikë të qendrës së dy lëvizjeve të mëdha gjeopolitike: Lindjes së Afërt dhe asaj Të Largët. [1] Sipas Yves Lacoste: *“Gjeopolitika është një parim themelor në lidhje me rivalitetet territoriale të llojeve të ndryshme të pushtetit. Kjo për të kuptuar se çfarë po ndodh apo çfarë mund të ndodhë”*. Ky citat nga Yves Lacoste përshkruan thellësinë e gjeopolitikës si një parim themelor në kuptimin e rivalitetit territorial dhe pushtetit. [2]

Gjeopolitika si një fushë e studimit që fokusohet në ndikimin e faktorëve gjeografikë në politikë dhe raportet ndërkombëtare, ndër të tjera shqyrton edhe marrëdhëniet midis territoreve, shteteve dhe aktorëve të tjerë në skenën ndërkombëtare, duke u bazuar në pozicionin gjeografik, burimet natyrore dhe karakteristikat territoriale të tyre. Sipas këtij shpjegimi, gjeopolitika na ndihmon të kuptojmë se si dhe për çfarë arsyes ndodhin rivalitetet territoriale, si dhe të parashikojmë zhvillime të mundshme në të ardhmen. Përmes analizës gjeopolitike mund të vëzhgojmë se si faktorët gjeografikë, burimet natyrore dhe struktura territoriale ndikojnë në politikën e jashtme, sigurinë kombëtare, si dhe strategjitë për pushtet e ndikim ndërkombëtar.

Në këtë mënyrë, gjeopolitikën në rajonin e Ballkanit e bëjnë problematike korridoret e rëndësishme paneuropiane, dy prej tyre që kalojnë nëpër Ballkan, Korridori 8 dhe Korridori 10, të cilat janë të veçanta për rëndësinë gjeostrategjike që ofrojnë. Këto dy korridore rrugore janë thelbësore për lidhjen e Ballkanit me rrugët dhe hekurudhat e tjera të Europës, duke përfshirë korridoret energjetike. Kjo lidhje e korridoreve rrugore dhe hekurudhore i jep rajonit një rëndësi të veçantë për zhvillimin ekonomik dhe integrimin rajonal në kuadër të strukturave të përgjithshme të transportit në Europë.

Beteja për korridoret në Ballkan shfaqet si një garë e intensifikuar midis shteteve të rajonit për të siguruar kontrollin e korridoreve të transportit, të cilat janë të rëndësishme për të gjitha shtetet në rajon, jo vetëm për interesat gjeostrategjike të Fuqive të Mëdha, por edhe për interesat e tyre kombëtarë dhe ekonomikë. Kjo betejë për korridoret shprehet në mënyra të ndryshme. Shtetet mund të llojnë në forume ndërkombëtare, si Bashkimi European dhe NATO, për të siguruar mbështetje financiare për projektet e tyre infrastrukturore.

Ata mund të nënshkruajnë marrëveshje dhe bashkëpunime me partnerë të tjerë rajonalë ose ndërkombëtarë për të forcuar pozicionin e tyre në garën për korridoret. Përveç kësaj, politikanët dhe udhëheqësit mund të bëjnë fushatë publike dhe diplomatike për të mbështetur projektet e tyre të korridoreve në sytë e opinionit publik, duke argumentuar për rëndësinë strategjike dhe ekonomike të investimeve në infrastrukturën e transportit. Gjithashtu, konkurrimi për financimin dhe investimet për korridoret shpesh mund të çojnë në rivalitet dhe tensione midis shteteve, duke sjellë ndonjëherë konflikte të interesave dhe sfida diplomatike. Kjo betejë për korridoret është një pjesë thelbësore e sfidave dhe e dinamikave politike në rajonin e

Ballkanit, ku shtetet përpiqen të sigurojnë përparësi për zhvillimin dhe modernizimin e infrastrukturës së transportit në territorin e tyre.

Le të shikojmë për shembull, për Rumaninë, ku Korridori 4 ka një rëndësi të veçantë. Përmes këtij korridori, Gjermania do të lidhet me Detin e Zi, duke e bërë atë një rrugë të rëndësishme strategjike. Pas aneksimit të Krimesë nga Rusia dhe përpjekjeve për aneksimit e portit ukrainas të Mariupolit, Deti i Zi ka rritur rëndësinë e tij si një rrugë alternative për Gjermaninë dhe Europën Qendrore.

Kjo rritje e rëndësisë strategjike vjen pas luftës së Krimesë, ku Deti i Zi u kthye në një pikë hyrëse kryesore për lëvizjen dhe tregtinë detare. Pretendimet e Rusisë në këtë rast janë të lidhura me zgjerimin e influencës së tyre në rajon dhe sigurimin e një pozicioni strategjik në Detin e Zi. Pas aneksimit të Krimesë nga Rusia, ky veprim u konsiderua si një shkelje e sovranitetit të Ukrainës dhe u kundërshtua gjerësisht nga komuniteti ndërkombëtar. Përveç kësaj, përpjekjet për të aneksuar portin ukrainas të Mariupolit tregojnë qëllimin e Rusisë për të kontrolluar dhe dominuar rrugët e tregtisë detare në rajon. Kjo është një pjesë e strategjisë më të gjerë të Rusisë për të rritur ndikimin e saj në Europën Lindore dhe për të rikthyer një lloj hegjemonie në zonën e tyre të interesit. [3] Zotërimi i portit ukrainas të Mariupolit është i rëndësishëm, për shkak të pozicionit strategjik që ka kjo zonë dhe për pasojat të ndryshme që mund të ketë në kontekstin gjeopolitik dhe ekonomik.

Disa aspekte të rëndësishme janë:

- *Kontrolli i korridorit detar:* Mariupoli është një port detar strategjik në Detin e Azovit, i cili është lidhur me Detin e Zi përmes Kanalit të Azovit. Kontrolli i këtij porti mundëson kontrollin e një pjese të rëndësishme të rrugës detare që lidh detet e Europës Lindore me ato të Mesdheut. Kjo rrugë është jetike për tregtinë dhe furnizimin e energjisë për shumë vende.

- *Ndikimi gjeopolitik në luftën për Donbas*: Mariupoli gjendet afër zonës së Donbasit, një zonë tanimë konfliktuale në Ukrainë. Kontrolli i portit mund të ndikojë në ndryshimet në këtë konflikt, duke e bërë një qëllim të rëndësishëm për aktorët që janë të përfshirë në konflikt. Zotërimi i Mariupolit ndryshon dinamikën gjeopolitike në rajon. Shtete apo aktorë të ndryshëm që kanë interes në rajon, po përpiqen të fitojnë kontrollin e këtij porti, për të ndikuar në rrethanat gjeopolitike dhe ekonomike në Europë Lindore. [4]
- *Rëndësia ekonomike*: Mariupoli është një port i rëndësishëm për tregtinë dhe ekonominë e Ukrainës dhe rajonit të Azovit. Kontrolli i tij mund të sjellë përfitime ekonomike të mëdha për ata që e kontrollojnë, duke u bërë një burim i rëndësishëm i të ardhurave dhe zhvillimit ekonomik. Për shkak të këtyre arsyeve, zotërimi i portit ukrainas të Mariupolit ka rëndësi të madhe për të gjithë aktorët e përfshirë në rajon dhe për zhvillimet e ardhshme në Europën Lindore dhe nëpër Detin e Zi.

Për Rusinë, Deti i Zi mbetet i rëndësishëm jo vetëm ushtarakisht, por edhe energjetikisht. Pas lansimit të gazsjellësit të ri rus, “Turkish Stream”, Deti i Zi ishte kthyer në një rrugë alternative për transportin e energjisë nga Rusia në Europë. Kjo bën që zotërimi i kësaj zone të jetë thelbësor për planifikimin strategjik të Ruisë në Europë dhe për sigurinë e furnizimit të energjisë në rajon. Plani i NATO-s për të forcuar praninë e vet në këtë det, duke përfshirë edhe Rumaninë [5] përballë Ruisë, është tregues i rritjes së rëndësisë së kësaj zone për sigurinë dhe stabilitetin e rajonit. Lufta në Ukrainë tregon se kjo zonë po bëhet një fokus i rëndësishëm për sigurinë dhe mbrojtjen e NATO-s në Ballkan.

Gjeopolitikani britanik Halford Mackinder, në punën e tij të njohur të vitit 1919, “Idealet dhe realiteti demokratik - Hulumtimi i politikave të rimëkëmbjes”, ka shkruar për faktorin hapësinor në zhvillimin historik. Në të

Mackinder zhvilloi më tej konceptin e tij për Heartland - një zonë kritike në Euroazi dhe rëndësinë e saj për politikën botërore, të cilën e prezantoi për herë të parë në vitin 1904 në artikullin e tij “The Geographical Axis of History”. Sipas tij, parandalimi i kërcënimit nga Rusia dhe Gjermania për epërsinë në Europën Lindore mund të arrihet duke vendosur një ekuilibër midis tri sistemeve shtetërore, duke përfshirë, përveç Gjermanisë dhe Ruisë, edhe shtetet e ndërmjetme të Europës Lindore. Është e rëndësishme që të ketë ndarje midis Gjermanisë, Ruisë dhe shteteve të pavarura në zonën midis Detit Baltik dhe Mesdheut, që përfshin “shtatë kombe jogjermane” dhe vende të tjera të Europës Lindore. Mackinder-i sugjeron që vendet e kësaj zone tampon duhet të bëhen një “zonë e demokracisë”, duke mbështetur dëshirat e popujve që i banojnë, me ndihmën e shteteve në breg të detit. [6]

Në punën e tij, Mackinder-i gjithashtu argumentonte për rëndësinë e zonës së njohur si “Heartland”, një pjesë e madhe e territorit eurazian, që përmbante burimet natyrore dhe potencialet për fuqi ekonomike dhe ushtarake. Ai besonte se kontrolli i kësaj zone do të jepte dominim të vërtetë botëror. Këtë koncept e përdori më vonë për të përshkruar sfidat dhe rivalitetet në Europën Lindore, duke sugjeruar që stabiliteti në këtë zonë është jetik për paqen dhe sigurinë në Europë. Përveç kësaj, Mackinder-i gjithashtu identifikoi rëndësinë e zonës së detit, duke e parë atë si një barrë mbrojtëse që ndante “Heartland” nga kontinenti i Perëndimit. Ai besonte se kontrolli i kësaj zone nga fuqitë perëndimore do të kishte një ndikim të madh në rregullimin e rivalitetit gjeopolitik në Europë. Kjo teori u bë shumë e rëndësishme për politikën e jashtme dhe strategjinë ushtarake në shekullin XX.

Korridoret rrugore dhe hekurudhore në Ballkan - rëndësia dhe projeksionet gjeopolitike

Korridoret rrugore dhe hekurudhore në Ballkan kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë tema të rëndësishme në kontekstin gjeopolitik të rajonit. Në veçanti, Korridori 8 ka shpërfaqur një rëndësi të veçantë për shtetet e rajonit dhe për partnerët e tyre të jashtëm. Në këtë kontekst, Italia luan një rol kyç në lidhje me këtë korridor, pasi ka interesa të mëdhenj për lidhjet e saj me vendet e Ballkanit.

Në këtë pjesë, do të hulumtojmë rëndësinë dhe projeksionet gjeopolitike të korridoreve në Ballkan, me një fokus të veçantë në Korridorin 8 dhe 10 për ndikimin e tyre në bashkëpunimin rajonal dhe integrimin europian. Për Italinë, Korridori 8 ka një rëndësi të veçantë, pasi përmes Durrësit, ajo do të lidhej me shtete të rëndësishme të rajonit, si Greqinë, Bullgarinë dhe Turqinë. Kjo lidhje rrugore dhe hekurudhore ofron një shtrirje të drejtpërdrejtë me detet Adriatik dhe Detin e Zi, duke e bërë atë një rrugë kritike për tregtinë dhe lëvizjen e mallrave dhe personave mes Italisë dhe vendeve të tjera të Ballkanit. Kjo pjesë e rrugës përfaqëson një korridor vital për transportin dhe lidhjen ekonomike të Italisë me rajonin e Ballkanit, duke shërbyer si një urë e rëndësishme për bashkëpunimin ekonomik dhe shoqëror mes këtyre vendeve. Edhe Greqia e sheh të rëndësishëm Korridorin 8, pasi përmes tij do të lidhej me dy detet e saj, Adriatikon dhe Detin e Zi, duke e bërë atë një korridor kryesor për lidhjen e Greqisë me vendet e tjera të Europës Juglindore. Ky korridor ofron një rrugë të rëndësishme dhe efikase për tregti dhe lëvizje njerëzish e mallrash, duke mundësuar në forcimin e ndikimit politik, ekonomik dhe shoqëror të Greqisë. Pra, rëndësia e Korridorit 8 për Greqinë përforcon qëllimin e saj për të zgjeruar ndikimin e saj me vende të tjera të Europës Juglindore. [7]

Në të njëjtën kohë, Korridori 10 është po aq i rëndësishëm për Greqinë, duke lidhur Budapestin me Athinën dhe duke krijuar një lidhje të drejtpërdrejtë mes Europës Qendrore dhe Greqisë. Serbia gjithashtu e shikon me shpresë këtë korridor, pasi përmes tij do të mund të lidhej me Europën Qendrore dhe Mesdheun. Ndërsa për Kroacinë, edhe pse korridori i Adriatikut, i cili lidh detin Jon me Adriatikon, ka një rëndësi të madhe, Korridori 10 mbetet i rëndësishëm për lidhjen e saj me Europën Qendrore dhe rajonin e Ballkanit. Për shkak të rëndësisë gjeopolitike dhe synimeve strategjike, Serbia po investon në ndërtimin e një linje hekurudhore të shpejtë nga Beogradi në Budapest. Ky investim synon të krijojë një lidhje të shpejtë dhe efikase mes dy qyteteve kyç në rajonin e Europës Qendrore. Po ashtu, Serbia vazhdon të ndjekë projektin e saj lumor të Korridorit Ujor “Danub-Moravë-Vardar-Selanik”, me synimin për të siguruar një rrugë të drejtpërdrejtë nga Europa Qendrore në Mesdhe. Këto projekte shënojnë përpjekjet e saj për të forcuar lidhjet infrastrukturore dhe ekonomike në rajon dhe për të rritur rëndësinë e vet gjeopolitike.

Kështu secili shtet kanë synimet e veta ekonomike, ideologjike, rrjetin e vet të aleancave dhe të klientëve të Botës së Tretë, si dhe përpjekjet e tyre për të krijuar vartësi nga më të ndryshmet. [8]

Rrjeti i korridoreve rrugore dhe rëndësia gjeopolitike për Shqipërinë

Në analizën e marrëdhënieve gjeopolitike, investimeve infrastrukturore dhe të procesit të integrimit rajonal në rajonin e Ballkanit, dy nga elementet kyç janë korridoret rrugore, veçanërisht Korridori 8 dhe Korridori 5. Këto korridore shërbejnë si pika qendrore të interesit për shtetet dhe aktorët ndërkombëtarë në këtë rajon. Për të kuptuar përfshirjen e tyre dhe ndikimin e tyre në zhvillimet e mëtejshme në rast të Shqipërisë dhe Kosovës, është e

rëndësishme të hedhim një vështrim të thellë në rolin e tyre dhe në mënyrën se si ato ndikojnë në dinamikën gjeopolitike dhe ekonomike.

Pra, korridoret rrugore, si Korridori 8 dhe Korridori 5, janë shqyrtime kryesore për të kuptuar marrëdhëniet gjeopolitike, investimet infrastrukturore dhe integrimin rajonal në rajonin e Ballkanit. Për Shqipërinë, Korridori 8 dhe projektet e lidhura me të shërbejnë si rrugë kyç për tregti dhe lëvizje në rajon, duke rritur rëndësinë e saj në skenën gjeopolitike. Korridori 8 përbën bërthamën e infrastrukturës shqiptare që na lidh me BE-në. Kjo pjesë ka të bëjë gjithashtu edhe me përpjekjet e Kosovës për të integruar infrastrukturën rrugore në rrjetin e Europës Juglindore, duke rritur lidhjet ekonomike dhe integrimin rajonal në rajon.

Për Shqipërinë, Korridori 8 mbetet një korridor kyç për interesat kombëtarë dhe ekonomikë të vendit. Përmes këtij korridori, Shqipëria ka mundësinë të lidhet me Greqinë dhe pastaj me shtetet e tjera të Europës Juglindore, duke e bërë atë një rrugë e rëndësishme për tregti dhe lëvizje. Korridori 8 është një nga korridoret kryesore të transportit në Europën Juglindore dhe ka një rëndësi të madhe strategjike për rajonin. Kjo rrugë ofron një lidhje të rëndësishme për tregti dhe lëvizje midis Shqipërisë dhe Greqisë, duke kaluar përmes qyteteve dhe rajoneve të ndryshme në këto dy vende. Korridori 8 shërben si një mjet i rëndësishëm për integrimin ekonomik dhe infrastrukturor të Ballkanit dhe Europës Juglindore në përgjithësi.

Italia ka një interes të madh për Korridorin 8, për shkak të lidhjeve të tij të rëndësishme të tregtisë dhe transportit në Europën Juglindore. Edhe pse Korridori 8 fillon nga Durrësi në Shqipëri dhe përfundon në Selanik në Greqi, Italia mund të ketë qasje në këtë korridor përmes lidhjeve tregtare dhe të transportit që ka me Shqipërinë dhe Greqinë. Italianët mund të shfrytëzojnë këtë rrugë si një korridor të rëndësishëm për të arritur tregjet e

Ballkanit dhe të Europës Juglindore. Kjo lidhje mund të përfshijë përdorimin e portit të Durrësit si një pikë hyrëse në këtë korridor për tregtinë detare dhe rrugët që lidhin Italinë me Greqinë përmes Shqipërisë. Në këtë mënyrë, Italia ka një interes të qartë në zhvillimin dhe promovimin e Korridorit 8, për të siguruar qasje të favorshme në tregjet e lëvizshme të Ballkanit dhe Europës Juglindore. Prandaj Korridori 8 shërben si një element katalizues për rritjen e ndikimit dhe rëndësisë gjeopolitike të Shqipërisë në rajonin e Ballkanit dhe më gjerë në Europë. Ky korridor pothuajse ka një rëndësi të njëjtë për Shqipërinë, siç ka Korridori 10 për Serbinë. Po ashtu, Shqipëria pritet të punojë në bashkëpunim me Kroacinë për të zhvilluar Korridorin 5, njohur si “Ionian-Adriatic highway”, që do të lidhte Shqipërinë me Malin e Zi, Bosnjën, Kroacinë dhe Italinë. Kjo autostradë do të hapë një mundësi të re për lëvizjen dhe tregtinë mes Shqipërisë dhe vendeve të tjera të Ballkanit, duke krijuar mundësi të reja për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik në rajon.

Nga viti 2009, Shqipëria dhe Kosova u lidhën me një autostradë, duke krijuar kështu një korridor kombëtar pa pritur financime nga jashtë vendit. Kjo lidhje rrugore jo vetëm që krijoi një korridor të përbashkët midis dy vendeve, por gjithashtu u lidh deti me tokën, duke shënuar një bashkim kombëtar në një mënyrë të re, pa nevojën për ndryshime kufijsh. Kjo tregon se infrastruktura rrugore, si autostradat, mund të shërbejë si një forcë unifikuese në rajon, duke lehtësuar lëvizjen dhe tregtinë midis vendeve të Ballkanit. Megjithatë, ndërtesat si tunelet dhe urat, në vend që të bashkojnë, ndonjëherë ndajnë. Në rastin e Ballkanit, urat në qytete si Mitrovica, Mostari dhe Shkupi shpesh ndajnë komunitetet dhe identitetet kulturore, në vend që të ndihmojnë në bashkimin e tyre. Brenda Korridorit 8 Shqipëria po kërkon mbështetje financiare për hekurudhën që do të lidhte detin Adriatik me Detin e Zi, (nga Durrësi, përmes Maqedonisë dhe Bullgarisë-Varna). Meqë Deti i

Zi po fiton peshë gjeopolitike si korridori rrugor, ashtu dhe ai hekurudhor, ai 8 do të jetë i një rëndësie të madhe gjeostrategjike. Sidomos pasi që Bullgaria bashkë me Rumaninë po bëhen pikë kyç në strategjinë e re të aleancës verio-atlantike.

Roli i Kosovës në zhvillimin dhe integrimin rajonal në Ballkan

Kosova, si një nga vendet në Ballkanin Perëndimor, ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e infrastrukturës dhe integrimin rajonal në këtë rajon. Roli që ka ndërmarrë Kosova në projektet infrastrukturore, veçanërisht në zhvillimin e Korridorit 10 dhe përpjekjet për integrim, është për të përmirësuar infrastrukturën rrugore dhe hekurudhore, si dhe përpjekjet për të lidhur vendin me vendet e tjera të rajonit. Në këtë, Kosova ka kontribuar në përmirësimin e lidhjeve ekonomike dhe integrimin e Ballkanit, duke krijuar mundësi të reja për bashkëpunim dhe zhvillim në të gjithë rajonin. Kosova është një vend me një pozicion gjeografik të rëndësishëm në Ballkan dhe, si rezultat, ka pasur një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e infrastrukturës dhe integrimin rajonal në këtë rajon. Një nga projektet kryesore infrastrukturore në të cilën Kosova është angazhuar, është zhvillimi i Korridorit 10, një korridor rrugor dhe hekurudhor që lidh vendet e rajonit dhe promovon lëvizjen e lirë të mallrave dhe personave. Në një kohë kur integrimi rajonal është një nga qëllimet kryesore të Ballkanit, përpjekjet e Kosovës për të zhvilluar Korridorin 10 kanë qenë thelbësore për të përmirësuar lidhjet infrastrukturore dhe ekonomike me vendet fqinje. Në këtë drejtim, Kosova ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të investuar në infrastrukturën rrugore dhe hekurudhore, duke përfshirë ndërtimin e autostradave, si Prishtinë-Hani i Elezit dhe Morinë-Prishtinë-Merdare. Ndërtimi i kësaj autostrade ka qenë një hap i rëndësishëm në përmirësimin e lidhjeve rrugore dhe në promovimin e tregtisë dhe lëvizjes së lirë të mallrave

dhe personave mes Kosovës dhe Maqedonisë. Kosova ka qasje në Korridorin 10 përmes luginës së Preshevës në Serbi.

Megjithatë, për momentin, ekzistojnë sfida dhe pengesa, të cilat kanë bërë që lidhjet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në këtë zonë të jenë të kufizuara. Këto pengesa janë lidhur me kontekstin politik dhe problemet e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Prania e tensioneve dhe mosmarrëveshjeve politike kanë bërë që zhvillimi i korridorit në këtë zonë të jetë i kufizuar dhe i penguar. [9] Megjithatë, ekzistojnë përpjekje për të zgjidhur këto çështje dhe për të mundësuar qarkullimin e lirë të mallrave dhe personave në këtë rrugë të rëndësishme.

Në përfundim, roli i Kosovës në zhvillimin dhe integrimin rajonal në Ballkan është i paanshëm. Në vazhdim, përpjekjet e qëndrueshme për të përmirësuar infrastrukturën dhe për të ndërtuar lidhje të forta me vendet fqinje do të krijojnë mundësi të reja për bashkëpunim dhe përparim në të gjithë rajonin. Kosova vazhdon të luajë një rol kyç në udhën drejt një Ballkani më të integruar dhe më të zhvilluar.

Zgjedhja e korridoreve rrugore dhe orientimi gjeopolitik i Maqedonisë së Veriut

Pozicioni gjeopolitik i Maqedonisë së Veriut është i ndërlikuar dhe i ndikuar nga marrëdhëniet me fqinjët, orientimi i jashtëm i politikës së saj dhe përpjekjet për të përmbushur synimet e saj integruese në skenën ndërkombëtare. Vendndodhja gjeografike e vendit në Ballkan e bën atë një aktor të rëndësishëm në strukturën gjeopolitike të rajonit.

Maqedonia e Veriut ka një vendndodhje strategjike në Ballkan, duke u kufizuar me Shqipërinë, Kosovën, Serbinë, Bullgarinë dhe Greqinë. Ky pozicion e bën atë një pikë lidhëse midis Lindjes dhe Perëndimit, duke qenë në qendër të rrugëve të tregtisë dhe transitit në rajon. Në planin gjeopolitik,

Maqedonia ka pasur një histori të ndërlikuar të marrëdhënieve me fqinjët dhe aktorët ndërkombëtarë. Konfliktet dhe tensionet me Serbinë, Kosovën dhe Greqinë kanë ndikuar në politikën e jashtme të vendit dhe strategjitë e saj për sigurinë dhe integrimin rajonal. Faktet tregojnë për një spektër të gjerë të prioritetëve dhe orientimeve gjeopolitike të Maqedonisë, duke përfshirë ndikimet nga marrëdhëniet me Serbinë, Kosovën dhe Shqipërinë. Zgjedhjet infrastrukturore reflektojnë strategjitë e Maqedonisë për integrimin rajonal dhe ndikimin e huaj në zhvillimin ekonomik dhe kulturor të vendit. Vendosija e Maqedonisë së Veriut për të zgjedhur midis Korridorit 8 dhe Korridorit 10 shfaqte dilema gjeopolitike të rëndësishme, duke pasqyruar përpjekjet e saj për të përcaktuar orientimin gjeopolitik të vendit mes Lindjes dhe Perëndimit.

Zgjedhja e Korridorit 8, i cili lidh Italinë, Shqipërinë dhe Bullgarinë, po shënon një bashkim të Maqedonisë së Veriut me Ballkanin Adriatik. Kjo mund të sjellë përfitime për vendin, duke ofruar alternativa të reja për porte detare, si dhe duke rritur lidhjet ekonomike dhe tregtare me vendet e Bashkimit Europian. Në anën tjetër, zgjedhja e Korridorit 10, i cili lidh Budapestin, Beogradin dhe Athinën, do të preferonte një orientim drejt Ballkanit Kontinental ose Danubian. Kjo mund të përcaktohej nga dëshira për të forcuar lidhjet ekonomike dhe politike me vende të tjera të rajonit të Europës Qendrore dhe Verilindore. Për Maqedoninë e Veriut kjo zgjedhje është mjaft e rëndësishme, pasi reflekton marrëdhëniet e saj me fqinjët dhe orientimin e saj gjeopolitik. Ky vendim ka ndikuar në rrjedhën e investimeve infrastrukturore, integrimin rajonal dhe marrëdhëniet me Bashkimin Europian dhe NATO-n. [10]

Maqedonia e Veriut ka dhënë në lidhje me orientimin e saj gjeopolitik, veçanërisht në lidhje me zgjedhjen e korridoreve rrugore për infrastrukturë. Në njëërën anë ka pasur deklarata nga figura politike shqiptare

në Shqipëri, që kanë diskutuar projektet e lidhura me Korridorin 8, duke përfshirë ndërtimin e autostradës Ohër-Kërçovë dhe hekurudhën nga Kërçova në kufirin e Maqedonisë së Veriut me Bullgarinë. Në të njëjtën kohë, Maqedonia ka diskutuar projekte të lidhura me Korridorin 10 në një synim të përbashkët me Serbinë, duke përfshirë ndërtimin e rrugëve nga Ohri në Kërçovë dhe nga Shkupi në Shtip, me mbështetje financiare kineze. Për Maqedoninë, orientimi i prioriteteve rrugore reflekton orientimin e saj gjeopolitik. Për shembull, ndërsa Kosova ka përfunduar ndërtimin e autostradës drejt Shkupit, Maqedonia ka vonesa në ndërtimin e vetëm 13 kilometrave të autostradës nga Shkupi në kufirin me Kosovën, edhe pse kufiri me Kosovën është më afër për Shkupin sesa me çdo qytet tjetër në Maqedoninë e Veriut. Kjo sugjeron një favorizim të lidhjeve me Serbinë ndaj atyre me Kosovën dhe Shqipërinë. Kështu, Maqedonia e Veriut vazhdon të përballlet me ndikimin ekonomik dhe kulturor të Beogradit, duke shfaqur një pozicion, që disa e interpretojnë si kolonizim ekonomik dhe kulturor. Ky fakt ishte theksuar në momentin e shënimit të përvjetorit të luftërave ballkanike në afërsi të Kumanovës, ku presidenti serb dhe zyrtarë të Maqedonisë së Veriut morën pjesë, duke shkaktuar kritika dhe shqetësime lidhur me orientimin gjeopolitik të vendit.

Maqedonia e Veriut është një nga shtetet anëtare të NATO-s. Ajo u bë anëtare e NATO-s më 27 mars 2020, pas ratifikimit të Protokollit të Anëtarësimit në aleancë nga të gjitha shtetet anëtare të NATO-s. Kjo u realizua pas një procesi të gjatë reformash dhe përpjekjesh për të përmbushur standardet e sigurisë dhe të mbrojtjes që kërkohen për anëtarësim në aleancë. Anëtarësimi i Maqedonisë së Veriut në NATO ka rëndësi strategjike për sigurinë dhe stabilitetin në rajonin e Ballkanit dhe për integrimin euroatlantik të vendit. Shtete si Rusia dhe Serbia kanë përdorur taktika të njohura si “lufta hibride”, për të ndikuar në politikat dhe proceset e vendeve të Ballkanit, duke

përfshirë edhe Maqedoninë, për të penguar anëtarësimin e tyre në organizata si NATO-ja. Këto taktika kanë përfshirë përdorimin e mjeteve të ndryshme, si propagandën, ndërhyrjen në medie, financimin e grupeve të interesit dhe shfrytëzimin e tensioneve etnike për të krijuar paqëndrueshmëri dhe për të zbehur përkushtimin e tyre për integritet euroatlantike.

Në rastin e Maqedonisë, këto shtete kanë mundur të ndikojnë në opinionin publik, të mbështesin forcat politike pro ruse dhe serbe ose të të pakënaqurve me qeverinë, dhe të përhapin narrativa kundër integritet euroatlantik. [11] Kjo ka krijuar sfida për autoritetet lokale dhe për procesin e anëtarësimit në NATO, duke sjellë ndërprerje dhe vonesa në udhëtimin drejt aleancës.

Konkurrenca për kontrollin e korridoreve rrugore në Ballkan: Rivaliteti dhe bashkëpunimi i shteteve perëndimore

Përplasjet e vendeve perëndimore, veçanërisht mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe disa vendeve të Bashkimit Europian, kanë të bëjnë kryesisht me sfidat dhe interesat strategjike në Ballkan, përfshirë kontrollin e korridoreve rrugore në rajon. Shtetet perëndimore, sidomos SHBA-ja dhe BE-ja, kanë interesa të ndryshëm në Ballkan dhe shpesh kanë divergjenca përparësish në lidhje me kontrollin e infrastrukturës strategjike si korridoret rrugore.

Disa nga këto përplasje janë:

- **Kontrolli i rrjeteve të transportit:** Shtetet perëndimore janë të interesuara të sigurojnë qasje të lirë dhe të kontrolluar në korridoret rrugore të Ballkanit, për të siguruar qarkullimin e lirë të mallrave dhe personave dhe për të forcuar integritetin rajonal dhe euroatlantik të vendeve të rajonit. Megjithatë, ka pasur debate dhe përplasje në lidhje me investimet dhe kontrollin e këtyre

korridoreve, veçanërisht në rastet kur ndërhyrjet e huaja kanë ndikuar në politikat vendase dhe në proceset e privatizimit.

- **Konkurrenca për influencë:** Shtetet perëndimore ndjekin strategji të ndryshme për të forcuar praninë e tyre në Ballkan dhe për të ndikuar në politikën dhe zhvillimin e vendeve të rajonit. Kjo ka sjellë përplasje dhe rivalitet mes tyre, veçanërisht mes SHBA-së dhe BE-së, për influencë dhe kontroll në korridoret rrugore të Ballkanit. [12]

- **Bashkëpunimi dhe rivaliteti rajonal:** Në nivelin rajonal ka ekzistuar edhe bashkëpunim dhe rivalitet mes vendeve të rajonit për kontrollin e korridoreve rrugore dhe për përfitime nga tregtia dhe investimet në infrastrukturën e transportit. Disa vende kanë përfituar nga bashkëpunimi rajonal për të ndërtuar dhe menaxhuar korridoret rrugore, ndërsa të tjera kanë kërkuar të mbajnë kontroll mbi këto rrjete për të përfituar avantazhe strategjike dhe ekonomike.

Në përgjithësi, përplasjet për kontrollin e korridoreve rrugore në Ballkan janë një reflektim i rivalitetit të interesave strategjike dhe ekonomike të shteteve perëndimore në rajon. Ato janë pjesë e një loje komplekse gjeopolitike dhe ekonomike për të caktuar pozicionin dhe influencën në Ballkan dhe për të përfaqësuar interesat e tyre kombëtarë dhe rajonalë.

Përfundime

Në përfundim, rivaliteti dhe bashkëpunimi i shteteve perëndimore në Ballkan, në kontekstin e kontrollit të korridoreve rrugore, shpreh një dinamikë komplekse gjeopolitike dhe ekonomike. Këto përplasje shfaqin divergjencë në prioritetet dhe synimet e tyre në rajon, veçanërisht në lidhje me sigurinë, stabilitetin dhe integrimin rajonal. Në njërin anë ka një aspiratë për të siguruar qasje të lirë dhe për të kontrolluar korridoret rrugore, për të ndihmuar në zhvillimin ekonomik dhe integrimin euroatlantik të vendeve të

Ballkanit. Në anën tjetër, ekziston rivaliteti për influencë dhe kontroll në këto rrjete strategjike, duke shkaktuar tensione dhe përplasje mes shteteve perëndimore. Megjithatë, nëpërmjet bashkëpunimit dhe rivalitetit rajonal, shtetet në Ballkan po përpiqen të gjejnë ekuilibrin mes përfitimeve ekonomike dhe avantazheve strategjike në kontrollin e korridoreve rrugore. Kështu, kjo dinamikë reflekton një sfidë thelbësore për gjeopolitikën ballkanike dhe për të përfaqësuar interesat kompleksë të shteteve perëndimore në rajon.

Fusnotat

1. Misha Glenney; “The Balkans: Nationalism, War & the Great Powers, 1804-1999”, September 1, 2001.
2. Yves Lacoste; “Gjeopolitika e Mesdheut”, Tiranë 2011, f. 45-66 (Përkthyes Perikli Jorgoni, Liliana Papa).
3. Beçev, D. (nd); “Analiza Strategjike”, shtator 2018: *Kuptimi i ndikimit të Ruisë në Ballkani Perëndimor*. Marrë më 21 mars 2019, nga <https://www.hybridcoe.fi/publications/strategic-analysis-september-2018>. Marrë më 01.03.2024.
4. “The Balkans in the New Geopolitics”, Dimitar Bechev, 2017, f. 11/25
5. “Rumania përfiton ushtrarakisht nga pozita gjeostrategjike e Detit të Zi”.
6. MacKinder, i njohur si një nga themeluesit e shkollës së gjeopolitikës, propozoi konceptin e “Heartland”-it në vitin 1904, në esenë e tij “The Geographical Pivot of History”. Ai argumentoi se “Heartland”-i, një hapësirë qendrore në Eurazi, që përfshin Euroazinë Qendrore dhe Siberinë, është e rëndësishme për dominimin botëror.
7. Banoviç, R.; “Situata në Ballkan: E mirë apo e keqe?”, marrë më 7 korrik 2023: <https://www.forbes.com/sites/rebeccabanovic/2019/01/26/Situation-in-the-balkans-good-or-bad/?sh=25eb83a6588a>.

8. Joshua S. Goldstain, “Marrëdhëniet ndërkombëtare”, përkthyer nga Arian e Teuta Starova, shtëpia botuese “Dituria”, Tiranë 2003, f. 52 - 66.
9. Bartlett, Will; Ker-Lindsay, J.; Alexander, K., & Prelec, T.; (2017). “Emiratet e Bashkuara Arabe si një aktor në zhvillim në Ballkanin Perëndimor: Rasti i investimeve strategjike në Serbi”, *Journal of Arabian Studies*, 7 (1), f. 94-112: <https://doi.org/10.1080/21534764.2017.1322753>
10. Ballin, A., Demircan, O., & Siebenhaar, H.-P. (2017). “Rivalitetet ballkanike: BE, Rusia dhe Turqia luftojnë për ndikim në Ballkan”. Marrë më 28 mars 2024 nga: <https://www.handelsblatt.com/today/politics/balkan-rivalries-eu-russia-and-turkey-struggle-for-balkan-influence/23571850.html>
11. Brady, A.-M. (2015, 26 tetor); “Makina e propagandës së huaj”, marrë më 12 shkurt 2024, nga <https://www.wilsoncenter.org/article/rusian-foreign-propaganda-machine>
12. Shih “The Geopolitics of the Western Balkans: The European Union, Russia, and the United States in the Balkans” nga Janusz Bugajski. Ky libër analizon rivalitetin gjeopolitik në Ballkan dhe rolin e shteteve perëndimore, Rusisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës në rajon.

IV. BOTA

4.1 Gjeneral Piro AHMETAJ

Mësime nga Ukraina: “7 kapacitetet kritike për fatin e luftërave të ardhshme”!

Më 22 shkurt 2022 bota u zgjua e shokuar nga riciklimi i luftës neonaziste, të ndërmarrë nga Rusia putiniste për të pushtuar tërësinë territoriale të një vendi sovran (Ukrainës). Që në krye të herës është nënvizuar, por rreth 19 muaj luftime konfirmuan se agresioni ushtarak i Rusisë putiniste nuk ishte vetëm kundër sovranitetit të Ukrainës, por ishte edhe *“kërcënim serioz ndaj rendit global të sigurisë, si dhe ndaj interesave dhe vlerave transatlantike (USA/UN/NATO/BE)”*.

Paraprakisht po risjellim në vëmendje “6 betejat e humbura nga Rusia putiniste” përgjatë një viti e 7 muaj luftime të përgjakshme në Ukrainë:

1. Kurrsesi nuk e pushtoi Ukrainën, por është struktur e rraskapitur në transhetë e Donbaskut.
2. Humbi betejën për të minuar, ndërsa përkundër kësaj forcoi kohezionin mes vendeve të NATO-s dhe marrëdhëniet transatlantike (SHBA/BE).
3. Humbi betejën për të tronditur rendin dhe mekanizmat e sigurisë globale. Pas 19 muajsh, vetëm soji i Kim Jongut dhe 3/4 të ngjashëm të tij pranojnë t’i japin dorën Putinit.
4. Nuk arriti ta tërheqë Pekinin në një aventurë gjeostrategjike, për të hapur një fronti të ri lufte jo vetëm ndaj Tajvanit.

5. Dështoi për të ndezur fitilat e luftës në Ballkan duke frymëzuar Beogradin zyrtar: *“Deri me agresion ushtarak, jo vetëm sovranitetit të Kosovës, por edhe prezencës së NATO/KFOR-it”*.

6. Përtej izolimit stalinist, ka humbur betejën për të mbajtur kohezionin dhe krenarinë e kombit rus.

Si përfundim, dështimi në 6 betejat e sipërpërmendura shënojnë vetëm fillimin e rrokullimës drejt humbjes turpëruese të luftës dhe diskreditimit gjeopolitike, që pret Rusinë putiniste.

Në vend të parathënies në këtë shkrim kam përzgjedhur mesazhin-epitaf të ish-Presidentit të SHBA-së, John Kennedy, i cili plot 60 vjet më parë (1963) në hapje të Konferencës së parë të Sigurisë së Munihut (MSC) tha: *“T’i hedhim sytë përtej rreziqeve të së sotmes, te shpresat e së nesërmes”*.

Parë në këtë këndvështrim, ndërsa fundi i luftës në Ukrainë mbetet çështje kohe (kur?) institucionet, universitetet, akademitë, kolegjet ushtarake, institutet, qendrat studimore, strategët, kolegët e fushës së sigurisë dhe të mbrojtjes në Uashington, Bruksel dhe në 31 kryeqytetet e vendeve të NATO-s etj., janë duke mirëpeshuar mësimet e nxjerra nga fushëbeteja: *“Jo vetëm për Ukrainën”*, në mënyrë që pas dhe përtej kësaj lufte t’i miradresojnë ato në transformimin e sistemit të sigurisë dhe posaçërisht në domosdoshmërinë e modernizimit të kapaciteteve ushtarake [armatimit, infrastrukturave, personelit dhe rregullave të angazhimit].

Më konkretisht, në vijim po paraqesim shtatë kapacitetet kritike ushtarake, që do të përcaktojnë fatet e luftërave, ndoshta përtej 50 viteve që vijnë:

1. ***Kapacitete të luftës hibride.*** Rëndësia e strategjisë, taktikave dhe kapaciteteve të mbrojtjes nga kërcënimet hibride qëndron në aftësinë për të shfrytëzuar dobësitë e kundërshtarit dhe për të prishur proceset e tyre

vendimmarrëse, duke lejuar përfundimisht një qasje më të shkathët për arritjen e qëllimeve strategjike, në fund të fundit për të mposhtur atë, kundërshtarin, dhe demoralizuar aleatët e tij. Sulmet kibernetike marrin përparësi, pasi mund të paralizojnë infrastrukturën kritike, të prishin komunikimet dhe të depërtojnë në sistemet e armikut. Ndërsa fushatat e dezinformimit mbjellin përçarje, manipulojnë opinionin publik dhe gërryejnë besimin tek institucionet, presionet, sanksionet ekonomike dhe kufizimet tregtare po ashtu imponojnë vështirësi, që minojnë vendosmërinë e kundërshtarit.

2. Kapacitetet e luftës së informacionit synojnë mbrojtjen e hapësirës informative dhe përfshijnë një sërë masash proaktive të domosdoshme për të mbrojtur kapacitet e një vendi të përfshirë në luftë. Lufta e informacionit mbështetet në tri shtylla kryesore:

- *Së pari*, siguria kibernetike përfshin mbrojtjen e të dhënave, të infrastrukturës kritike dhe rrjeteve qeveritare nga hakerat dhe aktorët e tjerë me qëllime armiqësore.

- *Së dyti*, masat dhe kapacitetet kundër dezinformimit për të luftuar dhe ndaluar përhapjen e informacionit të rremë ose mashtrues.

- *Së treti*, rritja e qëndrueshmërisë publike për të vlerësuar në mënyrë kritike informacionin që ata hasin/gjejnë në internet. Pra në thelb, *lufta e informacionit* është një qasje proaktive për të mbrojtur sferën tonë digjitale, si dhe besimin te vlerat demokratike.

3. Kapacitete kundër avionëve pa pilotë (dronëve ose UAV-në gjuhën e NATO-s): masat kundër UAV janë strategji dhe teknologji moderne dhe kapacitete thelbësore të domosdoshme për luftën kundër dronëve, të cilat përfshijnë sisteme të avancuara të radarëve, bllokues të frekuencave të radios dhe raketa antidrone. Për më tepër, zhvillimi kapaciteteve efektive kundër UAV-ve

kërkon një qasje gjithëpërfshirëse mbrojtëse dhe sulmuese me teknologji të avancuar, bashkëpunim ndërkombëtar dhe ndërgjegjësime publik.

4. Kapacitetet për luftën urbane përfshijnë zhvillimin e strategjive, kapaciteteve dhe aftësitë operacionale të përditësuara për sfidat unike të luftimit në mjediset urbane. Në këtë drejtim thelbësore mbetet që:

- *së pari*, trupat duhet t'i nënshtrohen një trajnimit gjithëpërfshirës, që përfshin luftime nga afër, pastrimin e ndërtesave dhe kontrollin e popullatës. Kjo përfshin përmirësimin e aftësive të qitjes dhe përdorimin e teknologjisë, si p.sh., syzet e shikimit natën etj.;
- *së dyti*, lufta urbane kërkon taktika të adaptueshme ndaj forcave armiqësore të fshehura midis civilëve. Armët jovdekjeprurëse, si gaz lotsjellës dhe plumba gome, duhet të përdoren me precizion dhe maturi, për të ruajtur jetën e kalimtarëve të pafajshëm.

5. Kapacitete të mbledhjes së inteligjencës përfshijnë investimin në kapacitetet e avancuara të grumbullimit të informacionit në fusha të shumta, duke përfshirë imazhet satelitore, inteligjencën e sinjaleve (SIGINT) dhe inteligjencën me burim të hapur (OSINT).

6. Kapacitete të lëvizshmërisë strategjike: mbetet një koncept kritik në strategjitë ushtarake dhe të menaxhimit të krizave, që synon të sigurojë një përgjigje të shpejtë dhe efektive ndaj kërcënimeve dhe emergjencave të paparashikuara. Ajo përfshin investimin në aftësinë për të lëvizur me shpejtësi trupat, pajisjet dhe burimet e mbrojtjes. Nga ana tjetër, këto kapacitete luftimi "imponojnë" zhvillimin e forcave të reagimit të shpejtë, të cilat kanë si mision për t'u përgjigjur "në kohë reale" ndaj krizave. Këto forca mund të vendosen për të menaxhuar situata të ndryshme, nga fatkeqësitë natyrore deri te kërcënimet e integritetit territorial dhe interesave kombëtarë. Për të arritur lëvizshmërinë strategjike bëhen investime në

infrastrukturën e transportit, si avionë me dislokim të shpejtë, anije dhe personel të trajnuar mirë.

7. *Kapacitete të mbrojtjes civile*: mbrojtja e civilëve në konfliktet moderne po merr një fokus vendimtar. Kjo është e rëndësishme veçanërisht sot, kur bota bëhet gjithmonë e më e ndërlikuar, dhe media ka një vëmendje të shtuar se çfarë ndodh me njerëzit e zakonshëm në konfliktet e armatosura. Kjo mbrojtje përfshin masa, si krijimi i zonave të sigurta për civilët, ofrimi i ndihmës humanitare dhe ndëshkimi i atyre që dëmtojnë qëllimisht joluftëtarët. Ideja është të kufizohen dëmet e shkaktuara nga konfliktet dhe të parandalohet humbjen e jetëve të pafajshme.

Përfundime

Mësimet e nxjerra nga lufta “jo vetëm për Ukrainën”, demonstrojnë domosdoshmërinë për zhvillimin e “shtatë kapacitetet thelbësore që nevojiten për luftërat e ardhshme, krahas atyre konvencionale. Këto kapacitete mund të shërbejnë gjithashtu edhe si “shportë/paketë kapacitetesh” për t’u përzgjedhur me prioritet nga NATO-ja. Këto kapacitete duhet t’i ketë NATO-ja në tërësi, që merr nga vendet anëtare (ose *force goals*), siç i quan ajo, dhe që të gjitha së bashku mund të përbëjnë një fuqinë ushtarake të planizuar në Konceptin Strategjik të Aleancës, që u miratua në Samitin e Letonisë, në korrik 2023.

Po ashtu si edhe në disa dhjetëra vlerësime strategjike, nga kapaciteti i ekspertit për çështjet e SK-së, rajonit dhe NATO-s, do t’i këshilloja faktorët me peshë politike të Tiranës dhe Prishtinës zyrtare, që “*humbja e luftës, kolapsi ekonomik dhe diskreditimi ndërkombëtar që e pret Rusin putiniste, si dhe mësimet e nxjerra nga lufta “jo vetëm për Ukrainën”, mbeten rrethana (por jo dhurata) të favorshme gjeopolitike në dobi të faktorizimit së RSH-së*

në tavolinat e vendimmarrjeve të mëdha (SHBA/NATO), si dhe për të mbrojtur dhe zhvilluar interesat mbarëkombëtarë në rajon, Mesdhe etj.”!

Po ashtu do të këshilloja aktorët shtetërorë të RSH-së dhe të Kosovës (dy shtete sovraane të një Kombi të vetëm) që, përtej kësaj lufte të konfirmojnë angazhimin afatgjatë dhe vendosmërinë konstante për *“transformimin e sistemit të mbrojtjes mbarëkombëtare; modernizimi e kapaciteteve; përmirësimin e aftësive operationale dhe kulturës së bashkëpunimit mes strukturave shtetërore, në interes të sigurisë së jetës, pronës dhe mirëqenies së qytetarëve; forcimin e besimit në vlerat euroatlantike; mbrojtjen e interesave kombëtarë, si dhe përmbushjen e detyrimeve në NATO”!*

Me këtë rast, do të doja të përcillja publikisht edhe një mesazh për politikëbërësit: Përkushtimi, përvullësia fisnike, sakrificat sublime dhe përgjegjshmëria e spikatur e ushtarakëve, policisë, inteligjencës, mjekëve, infermierëve, personelit të emergjencave civile etj., meritojnë të trajtohen me dinjitet!

*** Shënim për autorin:**

Autori është ekspert për SK, rajonin dhe NATO-n; zëvendës-president i Këshillit të Atlantikut; ish-Këshilltar i Presidentit, zv/SHSHP; përfaqësues ushtarak në SHAPE/NATO.

4.2 Dëtmir BUSHATI

NATO-ja e së nesërmes!

Samiti i vitit të ardhshëm në Uashington përkon me 75-vjetorin e aleancës. Për këtë arsye Këshilli i Atlantikut të Veriut ka marrë detyrën të nisë një reflektim sa më gjithëpërfshirës e të thellë mbi kërcënimet, sfidat, si dhe mundësitë për angazhime me vendet partnere, që do të prezantohet në Samitin e Uashingtonit...

Nëse Samiti i NATO-s i vitit të kaluar në Madrid ishte pa diskutim historik, pasi NATO-ja rigjeti Europën dhe aleatët, solidaritetin mes tyre përballë kërcënimit të Putinit, duke shënuar një pikë kthese në përmirësimin më të madh të kapaciteteve të mbrojtjes për aleancën euroatlantike që nga Lufta e Ftohtë, Samiti i Vilniusit i 11-12 korrikut të këtij viti do të ketë një trashëgimi disi më të komplikuar. Ai do të mbahet mend për përparimin e Suedisë drejt NATO-s, inkurajimin e aspiratave të Ukrainës për anëtarësim në aleancë, planet më të detajuara të mbrojtjes që nga Lufta e Ftohtë dhe angazhimin e vendeve të G-7-ës për mbështetjen ndaj Ukrainës, të cilën çdo vend do ta përcaktojë individualisht në mënyrë të detajuar.

Samiti i NATO-s i vitit të kaluar në Madrid miratoi *konceptin e ri strategjik*, duke shënuar fundin e epokës pas Luftës së Ftohtë dhe fillimin e një epoke të re të tensionimit dhe konfrontimit me Rusinë. Ndërkohë, Samiti i Vilniusit u përqendrua në një detyrë më pak tërheqëse për publikun, por të rëndësishme: atë të zbatimit të prioriteteve dhe vizionit të aleatëve të përshkruara një vit më parë. Komunikata e Samitit përmban një sërë elementesh, duke përfshirë mënyrën e zbatimit të planeve të mbrojtjes të vitit të kaluar, angazhimet për shpenzimet e mbrojtjes, partneritetet më të

strukturuara globale, veçanërisht me vendet e Indo-Paqësorit, sikundër një pasqyrë të objektivave të samitit të vitit të ardhshëm, që do të mbahet në Uashington.

Dihet se Kina u përmend për herë të parë në Samitin e Madridit si një burim “sfidash sistematike” për sigurinë euroatlantike, edhe pse aleanca nuk ndan vijë kufitare me të. Kina u shfaq gjithashtu në mënyrë të dukshme në komunikatën e Samitit të Vilnosit si një “sfidë sistematike” për NATO-n. Ashtu si në Madrid vjet, edhe këtë vit në Vilnus, partnerët e Indo-Paqësorit ishin të pranishëm, shenjë e rëndësisë kjo, që NATO-ja i jep këtij rajoni në epokën e konkurrencës strategjike me Kinën. Për NATO-n ruajtja e *status quo*-së me Kinën është e rëndësishme, pasi një mbështetje materiale e Kinës për Rusinë mund të përshkallëzojë në mënyrë dramatike konfliktin e tanishëm.

Në një mënyrë, Vilnius-i mund të lexohet edhe si një samit për zbatimin e planeve që synojnë ndërtimin e NATO-s të së nesërme. Modeli i ri i forcave të NATO-s, i rënë dakord në Samitin e Madridit, forcon aleancën, duke siguruar deri në 300 000 trupa në gatishmëri të lartë, duke përmirësuar reagimin dhe duke shfrytëzuar ekspertizën rajonale. Thënë ndryshe, NATO-ja po riorientohet dhe ristrukturohet për t'u përballur me një mjedis global më kompleks dhe sfidues. Natyrisht që kjo kërkon më shumë fonde.

Në komunikatën e Samitit të Vilnosit u rikonfirmua angazhimi i kahershëm i Samitit të Uellsit të vitit 2014, për të shpenzuar të paktën 2% të PBB-së në vit për mbrojtjen, si dhe bëhet thirrje për të forcuar zinxhirët e furnizimit dhe industrisë së mbrojtjes në Europë. Duhet pranuar se NATO-ja ende nuk ka arritur ta jetësojë angazhimin e “2% të PBB-së si një dysHEME dhe jo si një tavan”, pasi në fund të fundit u takon shteteve anëtare të angazhohen për financim në nivel kombëtar. Gjithsesi, NATO-ja e bëri të

qartë se, për të përmbushur rolin e saj, anëtarët duhet të kontribuojnë më shumë.

Samiti i Vilnosit ri konfirmoi gjithashtu zgjatjen e mandatit të Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Stoltenberg. Ai e ka udhëhequr aleancën në një periudhë të trazuar gjatë pandemisë, pushtimit rus të Ukrainës, rritjes masive të shpenzimeve ushtarake në të gjithë kontinentin dhe gjatë pranimit të katër anëtarëve të rinj në NATO.

“Bukuresht 2.0”?

Në Vilnius NATO-ja ripohoi mbështetjen për Ukrainën, duke deklaruar se “e ardhmja e Ukrainës është në NATO”, por pa hedhur një hap përpara, krahasuar me Samitin e Bukureshtit të vitit 2008. Shpresat e Ukrainës për një rrugë konkrete drejt anëtarësimit në NATO, ndonëse nuk u përmbushën, nuk u venitën. Duke krahasuar komunikatat e Vilniusit dhe Bukureshtit, mund të thuhet se Kievi mori një “Bukuresht 2.0” ose ndoshta një “Bukuresht +”. Është afruar më shumë me NATO-n, por vetëm pak. Vilnusi nuk ishte ndalesa e fundit për udhëtimin e Ukrainës në NATO, por mund të konsiderohet një “urë” midis Madridit dhe Samitit të Uashingtonit të vitit të ardhshëm.

Megjithëse NATO-ja mbështet aspiratën e Ukrainës për anëtarësim, ka mosmarrëveshje brenda aleancës në lidhje me kushtet dhe afatin kohor të pranimit të saj. Për një pjesë të rëndësishme të aleatëve, në krye të të cilëve është SHBA-ja dhe Gjermania, procesi i anëtarësimit të Ukrainës në NATO është një çështje e maturisë gjeopolitike dhe shmangia e një konflikti të drejtpërdrejtë me Rusinë. Pak a shumë me të njëjtën logjikë refuzohet edhe vendosja e zonës së ndalim-fluturimit mbi Ukrainë. Për mbështetësit më të zjarrtë të Ukrainës, veçanërisht ata gjeografikisht më afër kërcënimit rus, procesi i anëtarësimit në NATO është një çështje e detyrimit strategjik dhe

moral ndaj një populli që, për mrekulli dhe me kosto të madhe njerëzore, po i bën ballë luftës dhe ambicieve revanshiste të Rusisë.

Rruga e Ukrainës drejt anëtarësimit në NATO ka shkuar përtej nevojës për Planin e Veprimit të Anëtarësimit. Ky veprim nga ana e NATO-s vjen në përputhje me praktikën e ndjekur me Finlandën dhe Suedinë në procesin e anëtarësimit. Qysh prej aneksimit të paligjshëm të Krimesë nga ana e Rusisë në vitin 2014, Ukraina është bërë gjithnjë e më e ndërveprueshme dhe e integruar politikisht me aleancën. Mbështetur në komunikatën e Samitit të Vilnosit, ministrat e Jashtëm të NATO-s do të vlerësojnë rregullisht progresin e Ukrainës përmes Programit Kombëtar Vjetor të përshtatur. Gjithashtu, mbledhja e Këshillit të riemërtuar dhe të rikonstituuar NATO-Ukrainë në Vilnus, përveçse një mesazh politik, është një hap ndihmues për procesin e anëtarësimit të Ukrainës në NATO.

Në mbështetje të Ukrainës, Samiti i Vilnosit miratoi një paketë shumëvjeçare mbështetjeje, e cila do ta ndihmojë Ukrainën të rindërtojë sektorin e saj të mbrojtjes dhe sigurisë, në mënyrë që të mund të mbrohet kundër agresionit të mëtejshëm. Ky proces mendohet të sigurojë ndërveprueshmëri më të mirë mes forcave të armatosura të Ukrainës me forcat e NATO-s. Megjithatë, duhet pranuar se aleatët europianë “kanë eksportuar” në Ukrainë një industri armatimesh të fragmentuar. Gjithsesi, gjatë 18 muajve të luftës Ukraina ka bërë hapa të mëdhenj në fushën ushtarake, duke u shkëputur nga epoka sovjetike. Për pasojë, sot Ukraina është më e integruar me NATO-n se kurrë më parë.

Fituesi i vërtetë

Nëse ka një fitues të vërtetë të Samitit të Vilnosit, ai është presidenti i Turqisë, Erdogan, i cili siguroi lëshime nga aleatët, si dhe Suedia, për zgjerimin e një marrëveshjeje të tregtisë së lirë midis BE-së dhe Turqisë.

Kohët e fundit Suedia ndryshoi Kushtetutën e saj për të miratuar legjislacionin e ri kundër terrorizmit. Ajo ra dakord të ekstradojë disa prej turqve që akuzohen nga Ankaraja.

Mbështetja e Erdoganit për Ukrainën, duke përfshirë shitjen e dronëve ushtarakë, shihet me simpati në perëndim. Erdogani është i vetmi udhëheqës brenda radhëve të NATO-s, që komunikon drejtpërdrejtë si me presidentin rus, ashtu dhe me atë ukrainas, çka përforcon rolin e tij unik brenda aleancës. Gatishmëria e tij për të hequr kundërshtimet ndaj hyrjes së Suedisë në NATO, siç bëri para do kohësh për Finlandën, i ka dhënë atij një pozicion kyç në hapësirën euroatlantike. Duke mbështetur përmbylljen e shtrirjes së NATO-s në veri të Europës, çka i jep NATO-s një avantazh strategjik përkundëjt Ruisë, Turqia njëkohësisht i kujtoi Ruisë, se Perëndimi është më i rëndësishëm për të sesa Rusia.

Përmes kësaj lëvizje, Turqia fitoi premtim për blerjen e avionëve luftarakë F-16 nga SHBA-ja. Në vitin 2017, Turqia injoroi kundërshtimet e SHBA-së dhe bleu sisteme raketore S-400 nga Rusia, çka u shoqërua me sanksione nga ana e Uashingtonit. Tani Turqia do të blejë 80 avionë luftarakë të rinj F-16 nga SHBA-ja, të cilët konsiderohen të nevojshëm për të përmirësuar inventarin ekzistues të forcës ajrore turke.

Erdogani e dinte se Vilniusi ishte momenti i duhur për të nxjerrë sa më shumë përfitime nga Perëndimi dhe sidomos nga SHBA-ja. Konkurrenca e ashpër gjeopolitike me Kinën dhe Rusinë, konfigurimi i një grupi të rëndësishëm shtetesh që përbëjnë boshtin e ashtuquajtur “Jugu Global”, të cilët nuk janë të linjzuar me Perëndimin në luftën që po zhvillohet në Ukrainë, nuk i jep SHBA-së mundësinë e një distancimi nga Turqia, pavarësisht kritikave publike për gjendjen e demokracisë, lirive themelore dhe të drejtave të njeriut.

Ky është momenti për një afrim më të madh mes Turqisë dhe Perëndimit. Mbetet të shihet nëse do të shënohet progres në procesin e liberalizimit të vizave me BE-në për shtetasit turq dhe nëse do të riaktivizohet procesi i anëtarësimit të Turqisë në BE. Erdogan dëshmoi se Turqia është një partner i pazëvendësueshëm për Perëndimin, duke treguar solidaritet me Ukrainën përmes nënshkrimit të marrëveshjeve të reja për mbrojtjen dhe rindërtimin me presidentin Zelenski dhe riatdhesimin e komandantëve ushtarakë ukrainas që po mbaheshin në Stamboll, si pjesë e një marrëveshjeje të shkëmbimit të të burgosurve me Rusinë. Këto veprime zemëruan Kremlinin. Mirëpo Erdogani e di mirë se me një Rusi të paqëndrueshme në pragun e tij dhe me një ekonomi të trazuar në shtëpi, Turqia ka nevojë për marrëdhënie më të mira me Perëndimin. Për më tepër, përmes këtij afrimi, krijohet mundësia që Turqia jo vetëm të jetë më e linjësuar në raport me Ukrainën, por edhe të kundërshtojë Rusinë në Siri dhe Detin e Zi, çka nuk është pak për Perëndimin.

75-vjetori i Aleancës

Samiti i vitit të ardhshëm në Uashington përkon me 75-vjetorin e aleancës. Për këtë arsye Këshilli i Atlantikut të Veriut ka marrë detyrën të nisë një reflektim sa më gjithëpërfshirës e të thellë mbi kërcënimet, sfidat, si dhe mundësitë për angazhime me vendet partnere, që do të prezantohet në Samitin e Uashingtonit.

Shqetësimet për një Rusi revanshiste, si dhe për një Kinë ekspansioniste në planin ushtarak dhe teknologjik, pritet ta mbajnë NATO-n të angazhuar nën udhëheqjen e SHBA-së. Europa është në të njëjtën linjë me SHBA-në në njohjen e sfidës që paraqet Kina. Por që Europa të jetë në gjendje të mbrohet më mirë dhe të mos varet vetëm në mbështetjen amerikane, ajo duhet të investojë burime serioze në mbrojtje.

Rusia është një ekonomi relativisht e vogël, nga e cila Europa varej kryesisht për pak më shumë se një të tretën e nevojave të saj për naftë dhe gaz. Zëvendësimi i papritur i këtyre furnizimeve për shkak të luftës në Ukrainë, ka zvogëluar rritjen ekonomike, ka shkaktuar një rritje të inflacionit dhe ka vonuar rimëkëmbjen e Europës nga pandemia. Një shkëputje e papritur nga Kina do të ishte më e shtrenjtë, sepse Europa është më e varur nga Kina sesa ishte nga Rusia para shpërthimit të luftës në Ukrainë. Kina është burimi më i madh i mallrave të importuara për BE-në dhe njëkohësisht destinacioni kryesor i eksporteve europiane. Kombinimi i blerjes së gazit natyror më të shtrenjtë nga SHBA-ja apo vendet e Gjirit Persik, me humbjen e aksesit në tregun fitimprurës të Kinës për makinat dhe produktet e luksit mund të shkaktojë dëme të mëdha për ekonominë europiane.

Ëndrra e Europës pas Luftës së Ftohtë për një “paqe të përjetshme” është fshirë si pasojë e luftërave në ish-Jugosllavi dhe atyre në lindje të kontinentit. Siguria, fuqia dhe prosperiteti i saj në të ardhmen tani varen nga fakti nëse dhe sa shpejt do të veprojë për të adresuar dobësitë, pasi shkalla e sfidës është përtej aftësive të çdo vendi europian që vepron i vetëm. Europa mund të bëhet stratege e rëndësishme dhe më e integruar duke bashkëvepruar me SHBA-në. Vështruar nga ky kontekst, Samiti i Uashingtonit vitin që vjen do të qartësojë më tej pikëpamjet e aleatëve për çështjet e mësipërme, duke përgatitur NATO-n në përballimin e sfidave të një bote gjithnjë e më komplekse, e në të njëjtën kohë të jetë në gjendje të tejkalojë pyetjet e mbetura pa përgjigje në Vilnius.

4.3 Prof. dr. Gazmend PULA

“Pax Americana” dhe fleksibiliteti i nevojshëm politik

Disa refleksione lidhur me fleksibilitetin më të nevojshëm dhe më të theksuar të kryeministrit Kurti ndaj kërkesave pothuajse ultimative euroamerikane. Pse politika kërkon racionalitet, mençuri e maturi dhe përgjegjësi të plotë?

Me pak humor dhe analogji, pak a shumë goditëse, veçanërisht sipas analogjisë së “kumbullave të tejtharta”, e që faktorët e mëdhenj globalë u imponojnë dhe i detyrojnë madje edhe shtetet e forta, përfshirë edhe fuqitë e mëdha, si Gjermania, Japonia, Franca, që të mos flasim për shtetet minore europiane apo latino-amerikane, që të “gëlltisnin” të tilla “thartira kumbullash”, madje edhe kur janë shumë të tharta dhe të hidhura. Dhe madje-madje edhe të thonë, edhe të “pohojnë” se u pëlqejnë dhe se qenkan “jashtëzakonisht të shijshme”!

Dhe atë e imponojnë formalisht dhe diplomatikisht me fjalë, slogane dhe argumentime të bukura dhe joshëse, që në fakt i detyrojnë me qasje: “Ose do të jesh me ne, ose je me armikun”; ose në zhargonin amerikan anglez “It’s our way or the highway”. Dhe tërë këtë e aplikojnë si ndaj miqve dhe aleatëve, ashtu edhe ndaj armiqve dhe kundërshtarëve, domethënë: “Ose do të jesh me ne, ose me ata”. Këtë e praktikojnë gjithnjë si pjesë të “dietës disiplinueso-terapeutike”, politiko-diplomatike, detyrueso-koercive, që sipas tyre, është dhe do të jetë e dobishme gjoja edhe për ata vetë!

Dhe ashtu “i disiplinonjë” dhe i rreshtojnë si pula të lagura, si vasalë ordinerë, “ushtarë të dëgjueshëm të tyre” dhe pionierë të uniformuar me shami madje! E lëre pastaj shtetet e vogla si Kosova, që, përkatësisht, na

kanë çliruar vetë dhe që praktikisht na kanë në varësi dhe nën diktat të plotë! Sepse po të duan, e po t'u leverdisë në plan dhe interes më të gjerë, ata ose na dhe ju bëjnë “punën” si Irakut, Sirisë, Libisë, Libanit, Jemenit, Somalisë dhe “gjithësisë”.

E ne, Kosova dhe shqiptarët përgjithësisht, definitivisht s'kemi nevojë për diçka të tillë! Aq me tepër që ne, në fakt, dhe jo vetëm në këtë periudhë, ne jemi nën mbrojtje, varësi dhe protektorat të tyre të plotë si aleatët dhe çlirimtarët tanë! Dhe ata, aktualisht, tani për tani, kanë disa prioritete të tjera, shumë më të rëndësishme (lexo “Invazioni dhe shpartallimi i Ukrainës nga Rusia, si superfuqia më e madhe bërthamore në botë”), si rrezikimi shumë serioz i rendit aktual botërorë të dominuar nga hegjemonia amerikane unipolare/njëpolare - dhe rivendosja e një ekuilibri të ri botëror multipolar/shumëpolësh që po zëvendësohet, respektivisht po vendoset në vend të dominimit hegjemon unipolar amerikan të quajtur kollokuialisht “Pax Americana” ose “Paqja Zotërues Amerikane”.

Dhe tentim-pengimi i këtij riekulibrimi, ribalancimi dhe riformësimi të rendit aktual botëror nga rendi unipolar gjer tani nën dominimin pothuajse të plotë amerikan globalisht, që tani qartazi po zhbëhet, po dobësohet, po shpërbëhet dhe po shkërmoqet me shpejtësi nga sfida dhe kontestimi rusokinez dhe nga shtetet e tjera të ashtuquajtura “Global South” ose “Jugu Global”, kjo çështje, përkatësisht parapengimi i kësaj çështjeje, ka prioritet dhe rëndësi pothuajse të pakontestueshme për amerikanët.

Dhe kjo jo vetëm në plane rajonale, por, në radhë të parë, në global gjeostrategjik dhe gjeopolitik! Ngase “Pax Americana”, përkatësisht “Rendi Global Amerikan” tanimë është i përballur, i kontestuar fuqishëm si i rrezikshëm në planin ushtarak nga Rusia, në radhë të parë si rivali dhe kundërshtari më i fuqishëm ushtarak i Amerikës, që ka arritur ta tejkalojë atë në teknologjinë më të avancuar raketore hipersonike bërthamore që godasin

me shpejtësi 1-25 fish më shpejt se zëri, domethënë 10 mijë deri në 25 mijë kilometra në orë, dhe që lëvizin jo më në trajektore balistike standarde drejtvizore-parabolike, por, në trajektore tërësisht të paparashikueshme dhe arbitrare stokastike, dhe prej së cilave thjesht nuk ka mbrojtje kundërraketore, as amerikane dhe as edhe ndonjë tjetër, fakt ky që është i dëshmuar dhe pranuar edhe nga nivelet më të larta të ekspertizës ushtarake amerikane. Madje kjo teknologji raketore hipersonike ruse ka tejkaluar atë amerikane për një gjeneratë të tërë dhe po vijon më tej - dhe atë jo vetëm në Ukrainë, që është aktualisht vetëm poligon i ballafaqimit dhe i testimit indirekt amerikano/NATO-ist me rusët, por ka qartazi edhe makro e megareperkursionet potencialisht kërcënuese edhe globalisht.

Por, njëkohësisht, Amerika tani është e sfiduar rëndë edhe nga Kina në planin global ekonomik, në të cilin tanimë e ka tejkaluar Amerikën qenësisht në planin e vëllimit të zhvillimit dhe prodhimit industrial cilësor, si dhe në të ardhurat dhe fuqinë blerëse për kokë banori ndërkombëtarisht, të quajturin “Power Purchasing Parity” (PPP). Dhe brenda kësaj dekade, Kina parashihet ta tejkalojë Amerikën edhe në nivelin e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik-industrial, madje edhe përkrah Prodhimit Bruto Shtetëror apo “Gross Domestic Product” (GDP). Po ashtu edhe në planin akademiko-arsimor dhe shkencor.

Pale pastaj se aty tani është edhe India me zhvillim të vullshëm ekonomik me shkallë rritjeje të GDP-së prej më se 5-6% në vit, dhe atë për më shumë se 10 vjet dhe vazhdon të jetë në rritje të vazhdueshme të mëtejme, me të cilën tanimë e ka tejkaluar edhe Britaninë ish-imperiale dhe kolonizatore dhunuese, grabitqare dhe të pamëshirshme më se njëshekullore të Indisë. Me GDP-në prej rreth 5 mijë miliardë dollarësh, India tanimë është fuqia e pestë në botë, dhe duke vazhduar të ketë këtë rritje të mëtejme të shpejtë, së shpejti do ta tejkalojë edhe Japoninë dhe Gjermaninë, duke kaluar

kështu në vendin e tretë më të fuqishëm në botë, dhe kjo jo vetëm për nga GDP-ja!

Për të mos folur pastaj për fuqitë e mëdha rajonale, si Turqia, Irani, Koreja Veriore që është edhe fuqi nukleare, ndonëse ekonomikisht mjaft e varfër, Pakistani po ashtu bërthamor apo Brazili, Indonezia etj., të cilave as edhe Amerika superfuqi nuk po arrin më t'i imponojë dhe t'i detyrojë që të zbatojnë interesat e veta globale dhe bilaterale amerikanë!

Dhe për këto konsiderata, interesa dhe prioritete të pakontestueshme primare dhe prioritare amerikane, përkatësisht të tentim-ruajtjes së dominimit të tyre global amerikan, përmes të ashtuquajturës “Pax Americana”, qoftë përmes forcës së tyre në venitje të qartë ushtarake, ekonomike apo edhe politike, e për shkak të perceptimit global të asaj politike imperiale amerikane, si një politikë hegjemonie koercive globale në kundërshtim me normat demokratike botërore të kodifikuara në Kartën e Kombeve të Bashkuara.

Prandaj, ne shqiptarët përgjithësisht, dhe veçanërisht Kosova, duhet që me dashamirësinë, falënderimin, angazhimin dhe mirënjohjen tonë më të madhe, të plotë dhe të përhershme, të kemi respekt të pakontestuar, të parezervë dhe përkrahje e konsideratë të plotë dhe të pakusht politiko-taktiko-operativ aktual dhe të pandërprerë ndaj politikës dhe konsideratave, interesave dhe sugjerimeve praktiko-politike amerikane!

Me racionalitet e mirëkuptim të plotë, si faktor të pjekur dhe të mençur politiko-veprues shqiptar në përkrahje të plotë, pa atë “nëse” dhe “ose” - ose siç thonë gjermanët “ohne wenn und aber”, dhe të tillë duhet të jemi, të mbetemi dhe të dëshmojemi pandërprerë. Sepse, siç thotë shprehja popullore: *“Zoti dhunën dhe forcën nuk e don, por dhuna dhe forca Zotin nuk e pyet fare, fare madje”!*

Për ta përmbledhur, politikën dhe jetën reale e përcaktojnë *raporti i forcave* dhe *raporti i interesave* dhe jo aq shumë *parimet, drejtësia* apo *etika*, nëse mund të bëhet fjalë për to në këtë kontekst. Sepse po të ishte ashtu, shqiptarët nuk do të ishin ende popull i ndarë, dhe Kosova nën Serbi mbi 100 vjet! Kosova dhe pjesa shqiptare e Maqedonisë, madje së paku që nga Lufta e Parë Ballkanike, që nga tetori 1912.

Dhe ç' është e vërteta, nuk është se jemi ne të vetmit të tillë si popull i ndarë. Ja ku janë kurdët, gjermanët, palestinezët, koreanët! E deri vonë edhe vietnamezët, që u ribashkuan vetëm falë luftës dhe sakrificave marramendëse të tyre prej mëse 4 milionë viktimave, të vrarëve. Nga amerikanët imperialë të kohës, si dhe nga disa nga aleatët e tyre vasalë të bashkëngjitur, për të mos folur për milionat e tjerë të plagosur dhe të gjymtuar, pale pastaj për shkatërrimin e vendit dhe dërrmimin e tërësishëm të popullit të goditur.

Ashtu si koreanët, të cilët patën po aq viktima në luftën e tyre të 1953-it, ku u bombarduan dhe u shkatërruan, po ashtu nga amerikanët imperialë të kohës me aleatët e tyre vasalë, saqë nuk mbeti gur mbi gur dhe as caqe për t'u bombarduar më në atë shtet dhe një popull i shkatërruar me themel. Dhe përkundër gjithë atij viktimizimi, koreanët nuk arritën të ribashkohen as sot e kësaj dite, dhe mbetën popull i ndarë.

Për gjermanët të mos flasim. Pasi e humbën luftën, u bombarduan dhe u bënë copë-copë nga anglo-amerikanët e kohës, të shtyrë në masë të madhe nga Churchill-i revanshist, madje edhe atëherë kur lufta praktikisht kishte përfunduar dhe gjermanët po përgatiteshin për t'iu dorëzuar aleatëve perëndimorë. Bombardimet anglo-amerikane ndaj tyre vazhduan pamëshirshëm, madje me bomba zjarrvënëse, sa dhjetëra qytete gjermane i dogjën dhe i shkatërruan në tërësi, së bashku me popullatën gjermane civile.

Po kështu bombarduan edhe qytete që nuk kishin fare forca ushtarake, bashkë me popullsinë e tyre.

Praktikisht e bombarduan dhe e shkatërruan në përmasa të bombardimit atomik të tipit japonezo-hiroshimian, parë nga numri i viktimave dhe i shkatërrimeve. Edhe tokat gjermane po ashtu i copëtuan dhe i grabitën. 15 milionë gjermanë i dëbuan pamëshirshëm në pastrim masiv etnik dhe gjenocidin masiv e tronditës nga tokat e tyre etnike, që ua dhanë të tjerëve, kryesisht polakëve tanimë shumë agresivë politikisht, madje edhe ndaj vetë gjermanëve. Vepruan njësoj si me japonezët, që i bombarduan me bomba atomike në Hiroshimë dhe Nagasaki, sërish nga anglo-amerikanët imperialë të kohës. Dhe kjo kryesisht vetëm për demonstrim dhune dhe fuqie pushtuese dhe imperiale, hakmarrje të tmerrshme ndaj vendit dhe popullit, si dhe për frikësuar dhe kërcënuar direkt faktorët të tjerë të mëdhenj gjeostrategjikë dhe ushtarakë të kohës.

Për t'i frikësuar dhe kërcënuar indirekt faktorët dhe aleatët më të fuqishëm të luftës, madje-madje edhe atyre aleatëve që kishin pësuar numrin e pakrahasueshëm më të madh të viktimave dhe shkatërrimeve, me disa dhjetëra milionë vetëm të vrarëve, pa llogaritur këtu të plagosurit dhe të gjymtuarit. Sipas statistikave dhe deklarimeve historiografike, të vrarë nga makineria hitleriane e luftës ishin 39 milionë rusë dhe popullatë tjetër në ish-Bashkimin Sovjetik. Ata ishin të vrarët që bartën barrën dhe peshën e pakrahasueshme më të madhe të fitores aleate në Luftën e Dytë Botërore, për të mos folur për të plagosurit, të gjymtuarit dhe shkatërrimin pothuajse të plotë të vendit, si dhe viktimat e tjera të pafundme dhe të panumërta gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Madje bombardimet atomike të amerikanëve në Hiroshima dhe Nagasaki u realizuan, edhe pse lufta praktikisht ishte kryer. Japonezët po u dorëzoheshin amerikanëve dhe po përgatisnin edhe kapitullimin formal për

t'u dorëzuar amerikanëve, siç e pasqyron edhe realiteti aktual i Japonisë dhe i Gjermanisë, si aleatë të paepur dhe të dëgjueshëm të Amerikës. Për të vazhduar me çështjen e filluar, përkatësisht për parimet, drejtësinë, çlirimin dhe vetëvendosjen, patjetër që duhet thënë se ia vlen dhe duhet luftuar, madje fuqishëm dhe paepur. Por, gjithnjë duke pasur parasysh rrethanat aktuale. Dhe kjo specifikisht dhe veçanërisht në kuptim të raporteve të forcave, si të atyre vetjake dhe atyre aleate, ashtu edhe të raporteve të interesave, sërish si të atyre vetjake, ashtu edhe atyre aleate.

Sepse siç thotë populli: *“Nëse dhe kur të hidhen miqtë dhe përkrahësit e parespektuar sa dhe si duhet - apo akoma më keq kundërshtarët, jo veç që ta bëjnë, por edhe një thes kashte ta teprojnë”*. Dhe për diçka të tillë, ne shqiptarët definitivisht nuk kemi nevojë. Fare, fare, madje! Prandaj politika do racionalitet, mençuri, maturi dhe përgjegjësi të plotë, ashtu si edhe jeta, përgjithësisht. Dhe përveç synimit, luftimit dhe angazhimit për drejtësi, dinjitet e burri, edhe në kuptimin e përmendur më lart, të konsideratës dhe respektimit të plote të raportit të forcave dhe të interesave, që kostoja e përgjithshme e realizimit të objektivave tanë madhorë kombëtarë dhe shtetërorë të jetë mundësisht sa më e vogël, ndërsa arritjet dhe sukseset në realizimin e objektivave të popullit dhe vendit të jenë sa më të mëdha. Dhe patjetër që do të jenë! Qoftë edhe nëse në tërësinë e tyre, mund të jetë edhe nëse vijnë me ndonjë vonesë, qoftë edhe paksa më të madhe.

4.4 Mario STEFANOV, Zagreb

Rusia përmes Serbisë po përpiqet të tërheqë Ballkanin në një luftë të përgjakshme

Qëllimi kryesor i Moskës është të dalë në detin Adriatik

Përpjekja e fundit për të nisur një konflikt ushtarak në Kosovë dështoi dhe tani Rusia dhe aleatët e saj mund të presin përpjekje të reja për të aktivizuar krizën në Ballkan. Gjërat kanë shkuar aq larg, sa edhe presidenti bjellorus, Lukashenko, i bën thirrje Serbisë të ndërmarrë veprime më konkrete.

Lufta në Ukrainë, e shkaktuar nga agresioni rus në shkallë të plotë, po përshkallëzohet në mënyrë të parashikueshme si në kohë, ashtu edhe në hapësirë. Paaftësia e Ukrainës për ta kthyer debaklin fillestar ushtarak rus në fitoren e saj i lejoj rusët të nguliteshin në pozicionet që kishin arritur, ta zvarrisnin luftën pafundësisht dhe ta shfrytëzonin atë për qëllimet e Ruisë dhe aleatëve të saj në shkallë globale. Rusia, si pjesë e përshkallëzimit të qëllimshëm të luftës, po mbledh vendet në armiqësi të hapur ose konflikt të heshtur me Perëndimin, të gjitha nën mbrojtjen strategjike të Kinës në sfond, me synimin për të përmbysur rendin ekzistues ndërkombëtar dhe për të krijuar një lloj botë të re, shumëpolare, në të cilën, sipas Ruisë dhe aleatëve të saj, ndikimi i SHBA-së dhe i Perëndimit nuk do të dominonte më.

Me këtë qëllim, Rusia po përpiqet të aktivizojë sa më shumë pika krizash në mbarë botën dhe konflikte të ngrira, në mënyrë që ta largojë vëmendjen nga Ukraina dhe të shtrijë forcat e Perëndimit në disa zona të veçanta. Lindja e Mesme u aktivizua me sukses me ndihmën e aleatit të Ruisë, Iranit, nëpërmjet ndërmjetësit të saj, organizatës terroriste “ Hamas”.

Kompleksin e krizës ballkanike, të pazgjidhur prej tri dekadash, politika ruse po përpiqet gjithnjë e më shumë ta aktivizojë përmes Serbisë si ndërmjetëse. Përpjekja e fundit për të nisur një konflikt ushtarak në Kosovë dështoi dhe tani Rusia dhe aleatët e saj mund të presin të ndërmarrin përpjekje të reja për të aktivizuar krizën në Ballkan. Gjërat kanë shkuar aq larg, sa që edhe presidenti bjellorus, Lukashenko, po i bën thirrje Serbisë që të ndërmarrë veprime më konkrete në emër të Rusisë.

Hap i gabuar

Në një situatë të tillë, në mesin e nëntorit u publikua deklarata e presidentit ukrainas, Zelenski, se “Rusia ka një plan afatgjatë të veprimit shkatërrues në Ballkan, ku do të ketë një shpërthim të ri”. Zelenski paralajmëron: “Kushtojini vëmendje Ballkanit! Më besoni, ne marrim informacion. Rusia ka një plan afatgjatë: Lindjen e Mesme dhe shpërqendrimi tjetër do të jetë Ballkani”. Ai shtoi gjithashtu se “Rusia do të sigurohet, që një vend ballkanik të shkojë në luftë me një tjetër”.

Zelenski, duke zbuluar ujë të nxehtë, pa dyshim që po dërgon një mesazh që i drejtohet ekskluzivisht Kroacisë dhe Serbisë, sepse vetëm ato kanë potencial për luftë në Ballkan. Meqenëse Serbia nuk është partnere e Kievit dhe nuk ka arsye ta trajtojë atë, Zelenski në fakt po i dërgon një mesazh Kroacisë, e cila mbështet dhe ndihmon Ukrainën. Nëse largimi i tij nuk do të ishte dakorduar, ose të paktën i njoftohej më parë palës kroate, në atë rast do të kishte formën e një lloj presioni, sepse Zelenski në mënyrë indirekte do ta përfaqësonte veten si një faktor për mbrojtjen e Kroacisë dhe parandalimin e një lufte të re në Ballkan. Informacioni i inteligjencës në dispozicion të shërbimeve të tij, logjikisht, duhet të transmetohet përmes kanaleve profesionale, larg syrit të publikut, te miqtë dhe aleatët e Ukrainës, veçanërisht Kroacia mike, së cilës ata i referohen. Prandaj paraqitja e tij

publike nëse nuk është rënë dakord, është e papërshtatshme, ashtu si njoftimet e tij të mëparshme publike për planet për një ofensivë ukrainase nuk ishin të dobishme për përpjekjet ushtarake të Ukrainës. Një deklaratë publike, nëse nuk është e koordinuar me partnerët dhe aleatët, të cilëve u referohet, nuk është e saktë dhe është kundërproduktive. Duhet të përsëritet se dihet se si trajtohet një informacion i tillë dhe vendi i tij nuk është në hapësirën mediatike, por Ukraina duhet ta ndajë atë në mënyrën e duhur me partnerët që e ndihmojnë atë të mbrohet nga agresioni rus. Mirëpo Zelenski, nëse do të shfaqej i pavarur, pa dyshim donte të thoshte: nëse nuk vazhdoni të na mbështesni në luftën kundër agresionit rus, do të keni agresion në oborrin e shtëpisë tuaj.

Zbulimi i ujit të nxehtë

Në thelb, Zelenski nuk tha asgjë të re. Ajo që ka ndodhur për gati dy dekada dhe tani po intensifikohet, në kuadrin e luftës në Ukrainë, janë përpjekjet e Rusisë për të destabilizuar Ballkanin Perëndimor apo Europën Juglindore.

Ndërsa në Lindjen e Mesme prej vitesh po zhvillohet një luftë për kontrollin e korridorit të rëndësishëm strategjik që lidh Europën dhe Bashkimin European me Lindjen e Mesme dhe përtej Azisë, në juglindje të Europës, politika ruse, nëpërmjet ndërmjetësve të saj, të Serbisë dhe entitetit boshnjak Republika Sërpska, po përpjeket të hapë një front për të kontrolluar portat europiane të atij korridori dhe, në të njëjtën kohë, të aktivizojë krizën në sfondin e vendosjes së NATO-s.

Moska po shtyn gjithnjë e më shumë dinamikën e krizës në Ballkan, thellë pas linjave të para të planit të NATO-s, pas krahëve të Rumanisë dhe Bullgarisë, si pjesë e procesit gjeopolitik të konfrontimit rajonal dhe global të Moskës me Perëndimin. Ata kanë publikuar informacione për atë që duan të arrijnë në Ballkan në mënyrë mjaft eksplicite në vitet e kaluara në botime

zyrtare dhe gjysmëzyrtare dhe në analizat e *think-tank*-eve të tyre me ndikim. Për të parashikuar lëvizjet e ardhshme të Rosisë në Ballkan, mjafton t'i hedhim një sy asaj që kanë publikuar vetë rusët.

Gjeopolitikanët rusë, të lidhur ngushtë me majat e fuqisë politike ruse dhe krijuesit e vërtetë të politikës ruse ndaj Europës Juglindore, kanë paraqitur fare hapur modalitetet specifike të kësaj politike në studimet e *think-tank*-eve të tyre prej vitesh. Kështu, instituti rus *Katehon*, i cili u themelua dhe financohej nga miliarderit Konstantin Malofejev, i afërt me presidentin rus Putinit, më 23 janar 2016 publikoi veprën e autorit të nënshkruar si Jafe Arnold nën titullin “Bosnja 2016: Fati i Republikës Sërpska është fati i Serbisë dhe Rosisë”, i cili analizon rëndësinë strategjike të Republikës Sërpska dhe Serbisë për politikën ruse në Europën Juglindore.

Integrimi euroaziatik

Jafa Arnold pohon se “zona e ish-Jugosllavisë është bërë edhe një herë fushëbeteja e projekteve gjeopolitike kundërshtarë të Perëndimit Atlantik, të udhëhequr nga BE-ja dhe SHBA-ja, dhe e projektit për integrimin euroaziatik, i udhëhequr nga Rusia. Ballkani është çelësi i të dy projekteve, ku “rihapet edhe fronti boshnjak”. Sipas Arnold-it, integrimi vendimtar i Serbisë në agjendën gjeostrategjike të Rosisë në Europën Juglindore do t'i mundësonte politikës ruse të bënte atë që nuk ka mundur ta bëjë kurrë në histori: hyrjen në Detin Mesdhe dhe hapjen e derës për depërtimin e gjeoekonomisë dhe gjeopolitikës ruse në opsionet e shprehura në projektin euroaziatik për Europën Qendrore dhe Juglindore. Në të njëjtën kohë, Republika Sërpska dhe presidenti i saj miqësor ndaj Moskës, Dodik, janë që të dy shkaktarë të dinamikës gjeopolitike, që do ta bënte të mundur këtë dhe një mjet presioni ndaj Beogradit, nëse ai do të niste seriozisht rrugën e integritit euroatlantik.

Analiza e Arnold-it bazohet në punën e analistit politik serb, Stevan Gajić, nga Instituti i Beogradit për Studime Europiane, i cili gjithashtu botoi një ese të *Katehon*, nën titullin “Pse Bosnja është e rëndësishme për Rusinë”, në gusht 2015. Gajić argumenton se “pozicioni gjeopolitik i Bosnjës e bën atë një fushë të luftës intensive për ndikim, dhe në dritën e marrëdhënieve të sotme me Perëndimin, duhet të jetë një nga fokuset e strategjisë ruse. Pas një periudhe tërheqjeje gjeopolitike, Rusia vendosi të kthehej në Gadishullin Ballkanik, megjithatë, ndryshe nga shekulli i 19-të, në gjendjen aktuale Rusia mund të llogarisë vetëm të serbët si një faktor i besueshëm, sepse ata janë e vetmja forcë politike në gadishull, që nuk është pjesë e NATO-s dhe e BE-së”.

Gajić paralajmëron se kjo është “e mundur, vetëm nëse serbët në Ballkan bëhen dukshëm më të fortë politikisht, ushtarakisht dhe ekonomikisht” dhe përfundon: “Duket se kjo është bërë e qartë edhe për Kremlinin, duke gjykuar nga sjellja e tij në rajon”. Ndryshe, *think-tank* *Katehon* është themeluar, me qëllim promovimin e integritit euroaziatik, dhe analistët që marrin pjesë në punën e tij janë të lidhur drejtpërdrejt me aparatit shtetëror dhe agjencitë e inteligjencës ruse.

Financimi i separatistëve

Themeluesi dhe kryetari i bordit mbikëqyrës të *Katehon*, miliarderi Konstantin Malofeev, është lidhur nga Bashkimi Europian, Ukraina dhe SHBA-ja, me financimin e separatistëve rusë në Ukrainën Lindore. Figura qendrore e *Katehon*-it është gjeopolitiku i njohur rus, Aleksandër Dugin, anëtar i dhomës këshillimore të Presidentit të Dumës dhe pedagog në Universitetin Lomonosov të Moskës. Ai konsiderohet si krijuesi i idesë së integritit euroaziatik dhe një nga krijuesit e doktrinës së politikës së jashtme ruse.

Në kuadrin e marrëdhënieve gjeopolitike në Europën Juglindore, është e vështirë të anashkalohet artikulli i Dugini i publikuar në portalin rus “Evrazia.com”, me titullin **“Duke i kthyer serbët në histori, Republika Sërpska do t’i bashkohet Serbisë - me ju Rusia zgjohet dhe forcohet”**. Në të Dugini bën thirrje për lidhje shekullore ortodokse dhe gjeopolitike ndërmjet serbëve dhe rusëve, kështu që teksti fillon në mënyrë patetike:

“Ne nuk kemi dëgjuar asgjë për Serbinë për një kohë të gjatë dhe Serbia është dhimbja jonë. Një vend trim, i palëkundur, ortodoks dhe i magjepsur deri në vdekje, i ekspozuar ndaj mundimeve, një popull krenar sllav, që nuk uli kokën para zotërinjve osmanë apo rendit të ri botëror amerikan. Serbët janë i vetmi komb që i do vërtet rusët. Ai kujton gjithçka dhe fal gjithçka. Ata që e njohin historinë e popullit të madh serb, e kuptojnë se ajo nuk do të përfundojë kurrë. Ai merr goditje të tmerrshme nga fati, por çdoherë ngrihet përsëri. Serbët janë të ngjashëm me ne në atë çështje, kur ne arrijmë në vijën e fundit, madje shkojmë pas saj, por pastaj i kthehemi betejës historike - pas disfatave, revolucioneve dhe kohëve të vështira. Kështu marrin frymë gjinjtë sllavë: thith - nxjerr. Kur nxjerr frymën, bota dridhet”.

Pas lajkave dhe vërshimeve melodramatike të dashurisë vëllazërore, të cilat shkaktuan tallje edhe të një pjese të opinionit dhe qarqeve të ekspertëve serbë, Dugini kalon në çështje konkrete të gjeopolitikës lakuriq, e vetmja gjë që e intereson vërtet në të gjithë historinë dhe shprehet: *“Qëllimi i të gjithë serbëve është vendosja e unitetit. Dhe iniciatori më serioz i këtij procesi është pikërisht Banja Luka, kryeqyteti i Republikës Sërpska. Ky krijim politik është unik - ai arriti të mbrojë pavarësinë e tij nga nacionalizmi boshnjak i Sarajevës, i mbështetur nga Perëndimi, për të ruajtur strukturën shoqërore, kulturën, arsimin, administratën dhe fenë serbe. Në të njëjtën kohë, Republika Sërpska në kohën e Milorad Dodikut*

nuk ndoqi rrugën e Serbisë, e cila vitet e fundit gjithnjë e më shumë, qoftë edhe e detyruar, ka luajtur ashtu siç luan Perëndimi”.

Rajoni kyç

Në rubrikën me nëntitullin domethënës “Kundërofensiva jonë në Ballkan”, Dugini shtjellon më tej agjendën e politikës ruse të veprimit nëpërmjet ndërmjetësve serbë: *“Çfarë mund të presim nga Milorad Dodik? Shumëçka. Është e vështirë të thuhet se cilat tema u diskutuan në takimin e tij me presidentin Vladimir Putin. Në tërësi, gjeopolitika gjithsesi tregon një plan veprimi. Në fazën aktuale të tensionuar të përballjes së bllokut ruso-ortodoks me Perëndimin, veçanërisht në dritën e dramës ukrainase dhe betejës së dëshpëruar për Novorusinë, do të ishte logjike të kryhej një goditje hakmarrëse në Ballkan. Republika Sërpska zë vendin kryesor në arkitekturën strategjike të Ballkanit. Nëse fillon aty, do të nisnin të gjitha proceset në rajon”.*

Kështu, parashikimet e Duginit janë plotësisht në përputhje me analizën e Jafa Arnold në tekstin e *Katehon-it*, “B&H, 2016: Fati i Republikës Serbe është fati i Serbisë dhe Rusisë” nga janari 2016. Aleksandar Dugini thekson më tej, se mund të pritet një referendum për pavarësinë e Republikës Serbe dhe daljen e saj nga Bosnja dhe Hercegovina, si dhe thotë hapur: “Ky është skenari i Krimesë. Etnikisht dhe kulturalisht, ky territor është tërësisht serb dhe ortodoks, kufijtë e komunave janë vendosur fort gjatë operacioneve të luftës në vitet 1990. Të drejtat e askujt nuk do të vuajnë”. Atëherë, sipas Duginit, mund të pritet “fillimi i procesit të ribashkimit me Serbinë”, i cili sipas tij mund të ndryshojë rrënjësisht politikën në Serbi dhe ta pengojë atë nga anëtarësimi i mëtejshëm në Bashkimin Europian dhe NATO: *“Duke parë një hap kaq vendimtar të Republikës Sërpska në drejtim patriotik do të inkurajohen qytetarët e*

Serbisë. Pas kaq shumë disfatash, dramash, humbjesh e dëmsh, do të bëhet pararojë e një agimi të ri...

Krahu patriotik antiperëndimor i shoqërisë serbe befas do të forcohet. Në rrethana të tilla, marrëdhëniet me Rusinë gjithashtu do të zhvillohen ndryshe. Pas Krimesë, Moska humbi iluzionet e fundit në lidhje me Perëndimin dhe vendosmëria e saj për të ndërtuar politikën e saj u rrit shumëfish. Prandaj, afrimi me Serbinë, e cila po hyn në një raund të ri të historisë së saj, këtë herë do të jetë një shans unik për Rusinë për të forcuar pozicionin e saj në Europë... Beogradi tani është shumë i përfshirë në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Europian. Prandaj nevojitet një faktor shtesë për harmonizimin e nevojshëm të politikave të Moskës dhe Beogradit. Ai faktor është Milorad Dodik”.

Një agim i ri

Dugini nuk ndalet vetëm në mbulimin gjeopolitik të Serbisë nga Rusia, por edhe te procesi agresiv i ndërtimit të pozicioneve të reja ruse në pjesën e butë të orarit të NATO-s dhe BE-së, që përhapet më tej në të gjithë Europën Lindore, ndaj ai shprehet hapur: *“Nëse vjen, është e vërtetë që do të lansohet e gjithë Europa Lindore, ku jetojnë shumë popuj ortodoksë. Nëse do të ketë një bazë të mirë në Ballkan, Rusia do të jetë në gjendje të krijojë një bllok vendesh ortodokse në Europë me serbët, të cilëve mund t'u bashkohen rumunët, bullgarët, maqedonasit dhe grekët në rrethana të caktuara. Kjo mund të jetë përgjigjja jonë asimetrike ndaj rrethanave komplekse në Novorusia dhe zhvillimit logjik të procesit të nisur nga Pranvera Ruse”.*

Aleksandar Dugini sqaroi shumë qartë dhe me zë të lartë pa asnjë dyshim të gjitha elementet e agjendës gjeopolitike të Ruisë në Europën Juglindore. Sido që të jetë, pavarësisht nëse Dugini është vetë ai kur paraqet dhe mbron teza të tilla apo jo, fakti është se ai është i afërt me kryesinë

politike dhe ushtarake ruse, në lidhje të drejtpërdrejtë me agjencitë ruse të inteligjencës dhe me ndikim të madh të krijuesit e vendimet strategjike të politikës së jashtme. Është gjithashtu e pamohueshme, që pas avokimit të tij të vazhdueshëm për integrimin euroaziatik, u themelua vërtet Bashkimi Ekonomik Euroaziatik. Edhe pse shumë talleshin me të edhe atëherë, duke i konsideruar idetë e tij në kufirin e dijeve fantastike politike, megjithatë idetë e tij bëhen realitet përmes veprimit të politikës shtetërore ruse. Prandaj, sado e pabesueshme të jetë ajo që thotë, duhet marrë jashtëzakonisht seriozisht dhe kur analizohen prezantimet e tij, duhet të hidhen gjithmonë të gjitha shprehjet imagjinative të emocioneve dhe objektivisht të nxirren teza që zbulojnë thelbin e vërtetë të asaj që përfaqëson dhe mbron Dugini. Politika ruse në Europën Juglindore, nga pozicioni i dikurshëm mbrojtës i mbajtur nga instrumentet e “fuqisë së butë” të performancës diplomatike dhe ekonomike, tani duke filluar luftën ruse në Ukrainë dhe duke tërhequr këmbëzën për ndarjen e Republikës Serpska nga Bosnja dhe Hercegovina, filloi një lojë të ashpër dhe shkoi në ofensivë.

Përpyetje për revansh

Politika serbe në thelb nuk është në gjendje të përballet me disfatën strategjike ushtarake dhe politike të idesë së Serbisë së Madhe, si me efektet faktike të kolapsit të saj epokal, ashtu edhe me pasojat materiale dhe etike të përpyekjes së dhunshme për ta realizuar atë në rrënojat e ëndrrës së saj të dështuar në një kthesë historike. Ajo u përpoq të ripërsëriste të njëjtën model të pasuksesshëm të Serbisë së Madhe të modifikuar vetëm përmes agjendës së Memorandumit 2 të AASHS [SANU-së]. Moska, duke përdorur në mënyrë aktive një politikë të tillë serbe, të nxitur nga ëndrrat për një revansh strategjik në Ballkan dhe dëshira për një përpyetje të re për të realizuar konceptin e mposhtur serbomadh, këtë herë nën kujdesin e opsioneve

gjeostrategjike të Rosisë, po përpiqet në çdo mënyrë, në përputhje me atë që Zelenski thotë publikisht, për të aktivizuar kompleksin e pafund të krizës dhe për të filluar një konflikt lufte në Ballkan.

Ata duan të krijojnë një Perandori të re Bizantine

Në sfondin e aktiviteteve politike, ekonomike dhe ushtarake ruse në Ballkan, megjithatë janë motive shumë më të zakonshme - interesat e tyre gjeostrategjike rajonalë në konfrontim me Perëndimin. Ato janë një relikte e aspiratave të vjetra perandorake ruse për të zotëruar pellgun e Detit të Zi, ngushticat strategjike të Bosforit dhe të Dardaneleve, duke u lidhur me trupat ortodokse në Ballkan nga Rumania përmes Serbisë në Greqi, duke shpërthyer në detin e ngrohtë të Mesdheut dhe duke krijuar përfundimisht një formë të një mini-Bizanti të ri. Sado e pabesueshme të duket, Perandoria Ruse ishte afër këtij qëllimi njëqind vjet më parë, kur gjatë Luftës së Parë Botërore, me aleatët e saj francezë dhe britanikë planifikoi ndarjen e pasluftës të territorit gjerman. Aleat i Perandorisë Osmane. Sipas marrëveshjes sekrete britaniko-franceze *Sykes-Picot* të vitit 1916, në të cilën u bashkua edhe Rusia, për kontributin e saj në fitoren supozohet të fitonte kontrollin mbi Bosforin dhe Dardanelet dhe mbi pjesë të bregut të Detit të Zi, që do t'i mundësonte lidhjen me shtetet mike ballkanike. Me shpërthimin e revolucionit, qeveria e re komuniste e nxori Rusinë nga lufta dhe botoi publikisht në gazetën "Pravda" një kopje ruse të traktatit, duke dashur të tregonte karakterin imperialist të luftës. Ndoshta e vetmja ekskluzive e botuar ndonjëherë nga "Pravda" nuk e pengoi zbatimin e marrëveshjes, kështu që britanikët dhe francezët, duke iu përmbajtur marrëveshjes, ndanë me të vërtetë pjesën e tyre të plaçkës në zotërimet turke të Lindjes së Mesme. Fatkeqësisht, historia ka treguar se gjithçka ndryshon, përveç luftës për pasuri dhe interesave të përjetshëm gjeopolitikë të popujve, grupeve dhe

entiteteve të tyre shtetërore. Ose siç do të thoshte shkrimtari i famshëm amerikan, Mark Twain: *“Historia nuk përsëritet, por rimon në mënyrë të përsosur”*.

Geopolitika News, Zagreb, 6 dhjetor 2023

4.5 Peter MARKO TASE [Berat-Çikago]

Paraguaj: Nepotizmi i Kaballeros shkërmoq burimet e universitetit “UNE”

Në vitin 2014, Universiteti Kombëtar i Lindjes në Paraguaj (UNE) ishte një ndër pesë institucionet më të mira publiko-private të arsimit të lartë në mbarë vendin. Dhjetë vjet më parë, nën udhëheqjen e rektorit, prof. dr. Viktor Britez Chamorro [1], “UNE” siguroi burime të bollshme financiare nga Qeveria e Presidentit Horacio Manuel Cartes Jara, duke i mundësuar universitetit të kishte kanalin e tij televiziv, të prezantonte diplomacinë ekonomike të Paraguajt në Amerikën e Veriut, përforcimin e kërkimeve në Industrinë e Energjisë së Rinovueshme dhe ofroi bursa për studentët, për të kryer kërkime në bujqësi dhe industri ushqimore jashtë vendit (SHBA dhe Euroazi). Në qershor 2016, “UNE” mirëpriti dr. Harold J. Krent, dekan i Çikagos, “Kent College of Law: (*Illinois Institute of Technology - IIT [Instituti Teknologjik i Illinoisit]*) [2], duke qenë vizita e parë ndonjëherë e një udhëheqësi të një universiteti amerikan në historinë e vendit, që nga vdekja e Gjeneralit Alfredo Stroessner Matiauda, aleatit më besnik të SHBA-së gjatë Luftës së Ftohtë (1954-1989).

Sot, “UNE” në Ciudad del Este, Paraguaj, nën udhëheqjen e rektorit dr. Osvaldo de la Cruz Caballero dhe miqve të tij, Julio César Meaurio Leiva dhe Gerónimo Manuel Laviosa González, është bërë shembulli kryesor se si korrupsioni gërryen cilësinë e arsimit të lartë dhe dëmton ndjeshëm interesin publik në nivelet më të ashpra.

Ndërsa Presidenti Santiago Peña Palacios ka shpallur hapur një luftë të paprecedentë kundër nepotizmit, trafikut të ndikimit dhe korrupsionit, rektori Cruz Caballero dyshohet se ka ndarë burime të mëdha buxhetore për

të përfituar drejtpërdrejt anëtarët e familjes dhe bashkëpunëtorët e tij të ngushtë, që ndihmojnë në ruajtjen e feudit të tij të paprecedentë; veprime që janë një kërcënim i qartë për zhvillimin ekonomik të rajonit Alto Paraná. Zoraida Caballero Salinas është vajza e rektorit Osvaldo de la Cruz Caballero (UNE). Është raportuar se ajo iu bashkua Universitetit si profesoreshë asistente në Fakultetin e Shkencave Ekonomike (FCE) në vitin 2016, e përzgjedhur nga lista e kandidatëve që bordi drejtues i këtij fakulteti propozoi për punësim në Këshillin e Lartë të “UNE”-së, i cili drejtohej nga babai, Osvaldo de la Cruz Caballero, në atë kohë duke shërbyer si zëvendësrektor. Rasti i vajzës së Caballeros, i raportuar nga grupi mediatik “La Nacion” në Asuncion, është një nga shumë individë që dyshohet se janë punësuar në mënyrë të parregullt nga drejtuesit kryesorë të “UNE”-së. [3]

Rasti i Zoraida Caballero Salinas bie në sy mes të afërmeve të zyrtarëve të lartë të Universitetit Kombëtar të Lindjes (UNE), të cilët favorizohen me emërim brenda institucionit. Nëse është e vërtetë, sugjeron se ajo është përzgjedhur në mënyrë të parregullt mes 105 kandidatëve të kualifikuar.

Në rezolutën e lëshuar për pozicionin e saj, përmendet se Bordi Drejtues i Kolegjit të Shkencave Ekonomike FCE miratoi kandidatët që plotësonin “kërkesat e dokumentacionit, meritës dhe aftësive që përputhen me kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Konkursit të Kryesisë së Institucionit”. Megjithatë, detaje të mëtjshme nuk dihen rreth pikëve të marra nga secili kandidat dhe çfarë kushtesh janë përmbushur.

Në listën e propozuar nga Këshilli i FCE-së vërehet se vajza e rektorit ishte e vetmja kandidate për pozicionin e asistentit të Metodologjisë dhe Teknikës së Kërkimit të vitit të dytë, seksioni B i diplomës *Administrim Biznesi*, duke siguruar pozicionin që kishte më vonë miratimin e këshillit të udhëhequr nga babai i saj, sipas raportimeve.

Një moment tjetër i çuditshëm është se në të njëjtin vit, Zoraida iu bashkua edhe Shkollës së Studimeve të thelluara të “UNE”-së, ku ishte profesoreshë kërkimore deri në vitin 2017, megjithëse rezultatet e kërkimit të saj nuk dihen. Shkolla pasuniversitare e “UNE”-së drejtohet nga Gerónimo Manuel Laviosa González, një ish-rektor, i cili ka mbushur moshën e pensionit, por megjithatë dyshohet se vazhdon të marrë një rrogë të madhe për kurset që ai nuk jep mësim dhe për ndërmarrjen e projekteve kërkimore që nuk publikohen kurrë. Në analizën e tij të fundit mbi Paraguajin, Eduardo Álvarez Rodríguez, president dhe CEO i “Puentias” thotë: *“Për të krijuar duhet të besosh. Ky është një kilometër zero i gjithçkaje ose pothuajse i çdo gjëje. Besoni!”*

Vizita e fundit zyrtare e Presidentit Santiago Peña në Spanjë sigurisht që i ka mahnitur të gjithë. Nga Madridi, kryeqyteti i modës në Europë, Santiago Peña ka prezantuar projektin e vendit të tij, atë të një kombi të përgatitur për të pohuar veten para botës, një fener rajonal i stabilitetit politik dhe ekonomik në qendër të Mercosur. [4] Nën drejtimin e Caballero-s, komuniteti i studiuesve dhe i studentëve në “UNE” ka pushuar së besuari këtë.

Për më tepër, një tjetër individ i favorizuar duket të jetë Carlos Mancuello Egusquiza, vëllai i dekanit të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, Rafael Mancuello Egusquiza, i cili në vitin 2019 (vetëm një vit pasi vëllai i tij mori detyrën si dekan) u bë drejtues i zyrës në Drejtorinë e Kërkimeve dhe 6 muaj më vonë ai mori një pozicion mësimor me kohë të plotë të barabartë me 6,3 milionë Gs., të ardhura që, duke shtuar orët e tij të mësimdhënies, gjeneruan një shpërblim prej 12,6 milionë G. (përafërsisht 2 000.00 dollarë në muaj).

“UNE” vazhdon të vuajë nga administrimi i paskrupullt i burimeve publike. Caballero duhet të japë dorëheqjen dhe zyra e prokurorit të përgjithshëm të Paraguait, dr. Emiliano Rolón Fernández duhet të hapë menjëherë një hetim.

Referencat

1. <https://foreignpolicynews.org/2014/06/07/victor-britez-chamorro-banality-evil/>
2. <http://www.une.edu.py/web/index.php/rectorado/219-une-distingue-como-visitante-ilustre-a-decano-de-instituto-norteamericano>
3. <https://www.lanacion.com.py/investigacion/2024/03/01/hija-del-rector-de-la-une-se-acomodo-en-la-universidad-con-ayuda-del-padre/>
4. <http://www.une.edu.py/web/index.php/institucional/directivos/rectorado>
5. <http://70.36.107.45:3000/perversa-gestion-del-rector-de-la-une-hace-aplazar-a-la-universidad-ante-la-aneaes-diario-tnpress.html>
6. <https://www.moopio.com/estudiantes-preparan-manifestaciones-contranepotismo-del-rector-y-su-pandilla-en-la-une-diario-tnpress.html>
7. <https://www.lanacion.com.py/voces/2024/03/03/pena-palacios-el-puente-de-paraguay/>

V. GJEOEKONOMI

5.1 Akademik Anastas ANGJELI

Sfidat e BE-së për politikat antikrizë - përballë një recensionit të mundshëm

Çfarë po ndodh?

Tri vitet e para të kësaj dekade ishin plot me sfida të papritura: pandemia, lufta midis Rusisë dhe Ukrainës, kriza e çmimeve të lëndëve të para, kriza e energjisë, kriza e inflacionit, zhvillimi i vrullshëm i teknologjisë dhe IA, ndryshimet në tregun e punës, këto të shoqëruara nga politika ekonomike dhe monetare të kundërta. Kësaj i është shtuar së fundmi edhe një front i ri konflikti, i hapur pas sulmit të Hamasit kundër Izraelit më 7 tetor.

Dhe kjo në një rajon që kushtëzon nivelin energjetik të të gjithë Europës. Më shumë se kaq ngjarje, në një kohë kaq të shkurtër, rrallë kanë ndodhur në historinë e njerëzimit, sa për pasojë s'ka as analiza të thelluara të mendimit ekonomik. Megjithatë, një angazhim gjithnjë e më i madh i qeverive dhe Bankave Qendrore në identifikimin e politikave ekonomike të përshtatshme në situata të caktuara, ka qenë dhe mbetet i pranishëm. Kjo ka bërë që nga njëra anë të kemi politika ekonomike të emetimit monetar dhe rritjes së borxhit publik (periudha e pandemisë) dhe, nga ana tjetër, politika të shtrëngimit monetar në funksion të luftës kundër inflacionit.

Siç theksojnë shumë ekonomistë, “kalimi nga dushi i ngrohtë në atë të ftohtë” po e bën të pamundur një parashikim real të potencialeve të zhvillimit. Jo më kot FMN-ja dhe bankat qendrore europiane po ndryshojnë çdo tre muaj parashikimet e tyre për ritmet e rritjes në Europë dhe SHBA, pse jo edhe për ekonominë globale. Eurozona po kalon një ndalesë të rritjes

që nga tremujori i katërt i 2022-ës dhe rikuperimi po vonon dhe nuk parashikohet as në vitin 2023. Është i dukshëm ngadalësimi i konsumit familjar, të cilat kanë filluar të ndiejnë peshën kryesore të rritjes së çmimeve.

Kjo gjë çoi në rritjen e normave të interesit, shtrëngimi i kushteve të kredisë, që përkthehet jo vetëm në rritje të kostos së parave për familjet dhe bizneset, por edhe në një kujdes gjithnjë e më të madh të bankave në disbursimin e kredive. Industria po tërhiqet dhe po tregon shenja ngadalësimi në të gjithë Europën. Inflacioni në muajin gusht rezultoi i qëndrueshëm në 5,3% në terma trendi, por nuk pati rënie neto në çmimet e energjisë dhe ushqimit të freskët.

Në tetor, shkalla e papunësisë si mesatare e zonës ka mbetur e pandryshuar, por nuk ka pasur rritje të ndjeshme të papunësisë në krahasim me muajt paraardhës. Indeksi i përbërë i besimit ekonomik ra ndjeshëm në Francë dhe Gjermani, më pak në Itali, ndërsa në Spanjë është rritur. Megjithatë, Europa në përgjithësi nuk ka shifra regresioni, (me përjashtim të Gjermanisë me 0,5% për dy tremujorë rresht, që mbetet ekonomia më e fuqishme e BE-së), të gjitha vendet e tjera të zhvilluara europiane kanë një rritje shumë të ulët, që fillon nga 0,2% dhe mbaron në 2%.

Kjo kryesisht në ato vende, ekonomia e së cilave zë vetëm 7% të GDP-së europiane. Pavarësisht premtiveve të Bankës Qendrore Europiane, niveli i inflacionit parashikohet i lartë dhe shenja për uljen e normave të interesit gjatë vitit 2024 nuk janë shumë pozitive, sidomos për gjashtëmujorin e parë. E njëjta gjë u duk edhe në shifrat që vendet kryesore të Eurozonës përdorën për të ndërtuar bilancet e vitit të ardhshëm. Pra, perspektivat për Eurozonën vazhdojnë të jenë të pafavorshme.

Të gjithë specialistët pranojnë që Europa do të hyjë në recension dhe, pavarësisht mohimit të vazhdueshëm të guvernatores Christine Lagarde, shenjat nuk duket të jenë shumë pozitive. Megjithatë, parashikimi i fundit i

Bankës Qendrore Europiane për Eurozonën është për një rikthim të rritjes tremujore në 0,1 për qind në tre muajt e fundit të këtij viti, 0,3 për qind në tremujorin e parë të vitit 2024 dhe më pas një periudhë prej 0,4 për qind rritje. FMN-ja këtë javë parashikoi se rritja më e madhe europiane do të bënte një rikthim modest nga 1,3 për qind këtë vit në 1,5 për qind vitin e ardhshëm.

Mësime nga krizat e së kaluarës

Për arsye simbolike ose të thjeshta komoditeti, tri krizat kryesore ekonomike të epokës bashkëkohore mund të lidhen me një ngjarje, që mund të datohet në një ditë të caktuar.

- ***E para është 24 tetori 1929***, “e enjtja e zezë” e bursës së *Wall Street*, me një rënie të saj me minus 46,6%. Bota financiare ndali. Filloi kriza më e madhe që njerëzimi kishte parë deri atëherë dhe pasojë e saj ishin nazizmi dhe Lufta e Dytë Botërore. Si model krize në mendimin tim modest nuk është përsëritur, pavarësisht se historianët e krahasojnë vazhdimisht me elemente të krizave moderne. Imazhi simbolik i shembjes së tetorit 1929, krahas atij (me sa duket më mitik se real) i financierëve që kryejnë vetëvrasje duke u hedhur nga maja e shumëkatëshave të NY-së, jepet nga radhët e gjata të të papunëve para zyrave të punës. Ajo mund të gjendet në fotografi të ndryshme të kohës, si dhe në një nga skenat hapëse të filmit “King Kong”, publikuar në kulmin e depresionit, në mars 1933.
- ***Ngjarja e dytë*** ndodhi më 16 tetor 1973, kur shtetet arabe anëtare të OPEC-ut (Organizata e Vendeve Eksportuese të Naftës) njoftuan një rritje prej 70% të çmimit të naftës. Ngjarja ra në sy, sepse ishte krejtësisht e papritur, por më e paharrueshme do të jetë rritja me mbi 120% të çmimit të fuçisë e vendosur në datën 23 dhjetor e në vijim. Të dyja ishin një hakmarrje ndaj vendeve

perëndimore, që mbështetën Izraelin dhe kishin si pretekst politik luftën e katërt arabo-izraelite, që shpërtheu më 6 tetor.

Sot ky fenomen është i krahasueshëm pjesërisht me gjendjen aktuale, por deri tashti çmimet e naftës kanë pasur një rritje logjike, në kushtet alogjike të situatës në Lindjen e Mesme. Nëse në tetor të vitit 1973 Lufta e Ftohtë ndikoi në një stanjacion të gjatë, sot të panjohurat janë shumë më të mëdha. Le të shpresojmë që armëpushimi të mos sjellë makthe të së kaluarës. Për krizën e naftës të dimrit 1973-‘74, imazhi që bie në sy është ai i së dielës në rrugët e qyteteve europiane të zbrazura nga makinat me njerëzit që përdornin vetëm biçikletat, pasi përdorimi i makinave u ndalua ose u dekurajua për të ulur konsumin e karburantit.

- **Ngjarja e tretë** është falimentimi i kompanisë financiare “Lehman Brothers”, i cili ndodhi të hënën më 15 shtator 2008. Megjithatë, kriza bankare ishte paralajmëruar në Europë dhe në SHBA nga shenjat e qarta të një viti më parë, të cilat tashmë po preknin tregun e aksioneve.

Më në fund, sekuenca e parë disa herë në televizion e punonjësve të “Lehman Brothers”, që largoheshin me nxitim nga zyrat e tyre me kutitë, në të cilat kishin mbledhur gjërat e domosdoshme, duhet të jetë qartë e pranishme në kujtesën e të gjithëve. Ishte një krizë, e cila gjeneroi një krizë borxhesh ende të pashëruar dhe ende me risk për vendet që u prekën nga ajo në vitin 2011-2012.

Karakteristikat e kësaj krize dhe paralelet me krizat e kaluara. Si të përballemi?

Cilat mund të jenë karakteristikat e pritshme të kësaj krize? Me çfarë mund ta krahasojmë atë? Çfarë mund të bëjë BE-ja për ta kapërcyer atë? Prandaj le të shohim historinë, të shkuarën, që të parashikojmë të ardhmen. Janë pesë tendenca globale për vitet e ardhshme, që Europa ka evidentuar për

ekonominë e saj dhe që i ka vendosur në bazë të të gjitha programeve europiane për të ardhmen e afërt. Më konkretisht këto tendenca janë:

1. E para: “Një popullsi dhe një shoqëri më e vjetër, ku shtresa e mesme dalëngadalë po humb dominimin e saj dhe ku pabarazia po rritet me ritme shumë të shpejta”. (“Për të pasur një ekonomi të aftë për të mbështetur një shoqëri të plakur në ritmin që kemi në Europë, duhet të kemi produktivitet shumë më të lartë”, - Draghi).

2. E dyta: “Një proces gjithmonë dhe më i brishtë i globalizimit që po udhëhiqet kryesisht nga “G3 ekonomik” (SHBA, EU, Kina). Sipas Draghi-t, “ekonomia europiane ka humbur konkurrencën në 20 vitet e fundit, jo vetëm për Shtetet e Bashkuara, por për Japoninë, Korenë e Jugut dhe, natyrisht, Kinën. Në shumë fusha teknologjike, ne kemi humbur praninë, kemi humbur gjurmët”.

3. E treta: “Një revolucion industrial (4.0) dhe teknologjik i paparë dhe shumë i paparashikuar”.

4. E katërta: “Një ndërthurje shumë e çuditshme midis zhvillimit ekologjik dhe energjive të rinovueshme nga njëra anë dhe një lufte shumë të egër për lëndët e para dhe burimet natyrore nga ana tjetër” (Ndryshimet klimatike dhe ekonomia e gjelbër).

5. Dhe e fundit, një nga pamjet që nuk arrijnë të fiksohen dhe përfaqësojnë: forma të pushtetit që ndryshojnë, raporte forcash që transformojnë tregun dhe një multinacionalizëm, që integrohet me vështirësi. Më thjesht: ndryshim, ndryshim, ndryshim! Natyrisht, çdo parashikim mund të përmbajë devijime dhe doza të mëdha gabimi. Ekonomistët ndryshe nga të gjithë të tjerët kanë një element të pandryshueshëm vlerësimi, që janë shifrat, prandaj përmes tyre dhe historisë mund të kuptojmë zhvillimet afatshkurtra.

Megjithatë, saktësia e shifrave të së ardhmes shpesh është e pasigurt dhe kështu, aty “ku dominon ndryshimi, vdes statistika”. Përballë këtyre

tendencave, BE-ja doli me një program ekonomik deri në vitin 2030, ku ofron disa rrugë të reja për zhvillimin e qëndrueshëm, për ta bërë ekonominë e BE-së më konkurruese. Negociatat për të aplikuar marrëveshje tregtare edhe me vendet jashtë BE-së duket se po bëhen domosdoshmëri. BE-ja, për të rifilluar një zhvillim të qëndrueshëm, do t'i duhet të ketë një rritje mbi 1,2% të GDP-së së eksporteve me SHBA-në, Japoninë, Indinë, Azinë dhe Kinën, Brazilin dhe Afrikën. Gjithashtu, ajo do të duhet të jetë në qendër të rritjes më të dendur të marrëveshjeve tregtare në botë për nga madhësia, siç janë Shtetet e Bashkuara, Japonia, India, Kanada etj.

Tashmë është e qartë se eksportet brenda vendeve të BE-së nuk janë zgjidhje për të dalë nga gjendja aktuale dhe zhvillimi do të jetë i fshehtë. Përtej kësaj, Bashkimi Europian do të duhet të përballet me një seri çështjesh të rëndësishme politike. Katër zgjedhje do të jenë veçanërisht të rëndësishme dhe ato kanë të bëjnë me OBT-në, Kinën, Rusinë dhe Afrikën. Në këtë drejtim mund të pritet një rifillim të negociatave me OBT-në, veçanërisht nëse raundi i Dohas përfundon në dekadën e ardhshme. Një nga prioritetet e BE-së do të ishte vendosja e një agjende të re, që përfshin çështjet që lidhen me globalizimin, si p.sh., konkurrenca, subvencionet dhe shërbimet shtetërore. Shumica e analistëve e identifikojnë Kinën si treg me potencialin më të madh të rritjes për Europën. Kina shfaqet në krye të listës së vendeve me potencial të lartë për negociata dhe investime dypalëshe, për shkak të barrierave të konsiderueshme që qëndrojnë në rrugë për hyrjen e kompanive të huaja në tregun kinez.

Krahas përpjekjeve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të shumta tregtare, rifillimi i negociatave me Rusinë (në varësi të përfundimit të luftës në Ukrainë) dhe mbështetja e një zgjidhjeje të drejtë do të përfaqësonte një hap të rëndësishëm drejt stabilizimit. Përtej interesave rreptësisht ekonomikë, marrëdhënia me Rusinë do të fitojë rëndësi nga pikëpamja gjeopolitike, për

shkak të lidhjeve me elemente të veçanta për disa çështje energjetike dhe sfidat e modernizimit të ekonomisë ruse. Afrika mund të përfaqësojë një prioritet të rëndësishëm komerciale për Europën.

Ngritja ekonomike e Afrikës Veriore dhe Subsahariane mund ta çojnë Bashkimin European të përmbysë qasjen e tij drejt këtyre rajoneve: objektivat e zhvillimit dalëngadalë do t'u linin vendin interesave ekonomikë të lidhur me aksesin në treg dhe integrimin ekonomik. Në këtë mënyrë, deri në vitin 2030 do të ishte e mundur të nisnin negociatat dypalëshe ambicioze me Afrikën Subsahariane që synojnë shtetet shumë premtuese, përkatësisht Nigeria, Angola, Kenia dhe Republika Demokratike e Kongos. Nëse ky është vetëm plani strategjik i BE-së në globalizimin e saj ekonomik, nuk duhet të harrojmë suksesin e politikave që kanë filluar të zbatohen sidomos pas pandemisë.

Më i rëndësishmi nga të gjithë programet është “Next generation EU”, ku arsimi, shkenca, shëndetësia dhe digjitalizimi janë shpresat kryesore të zhvillimit. Siç thamë më lart dhe, mbi të gjitha, duke marrë parasysh shpenzimet shtesë për rritjen dhe forcimin e NATO-s, Bashkimi European ka nevojë për një ringjallje të fortë ekonomike. Agjenda e përshkruar më lart parashikon një mjedis të ri rregullator, që favorizon investimet në kapitalin njerëzor dhe inkurajon risi në ekonominë prodhuese. Janë të nevojshme rritjet më efektive të sigurisë sociale, për të mbështetur fleksibilitetin të tregut dhe për të luftuar pabarazinë në rritje.

Gjithashtu, BE-së do t'i duhet të forcojë dhe të zgjerojë Eurozonën, të luftojë në të njëjtën kohë idetë dhe tendencat drejt copëtimit dhe dobësimit të tregut të brendshëm european. Tregu i vetëm për mallra dhe shërbime është larg të qenit i plotë, për shkak të rezistencës nga interesat e vetjake të vendeve të caktuara dhe synimi për të ruajtur *status quo*-në nuk është në drejtim të zhvillimit. Ka një rritje në çekuilibër joefektiv brenda Bashkimit

European, sidomos midis ekonomive të bazuara kryesisht në shërbime dhe ekonomive industriale.

A do të jenë edhe në të ardhmen këta të fundit në gjendje të tërheqin më shumë vendet e tjera, për t'i integruar edhe ato në një zinxhir prodhues, qoftë dhe bujqësor? BE-ja po përpiqet me të gjitha forcat, që teknologjitë bazë digjitale dhe industriale, që po evoluojnë me shpejtësi, të nxitura edhe nga informacioni në kohë reale, të krijojnë bazën për një përhapje të platformave dhe mjete të tjera për të gjithë, kudo dhe për çdo qëllim. Falë këtyre projekteve do të fokusohemi, sa më parë dhe sa më shpejt, drejt një “shoqërie të dijes”(të gjithëdijshme).

Pa dyshim që në kushtet e sotme parashikimi i zhvillimeve të ardhshme nuk është i lehtë. Ndryshimet globale (gjeopolitike e gjeoekonomike) gjithnjë e më komplekse, po çojnë në konkluzionin, se ritmi dhe thellësia e analizave, strategjia duhet të intensifikohen, dija duhet të rritet dhe vendimmarrja duhet të kushtëzohet prej saj. Dhe kjo bëhet më e domosdoshme, tani që *“pika e fillimit të këtij recensionit është goxha e lartë - nuk kemi pasur kurrë një papunësi kaq të ulët”*. Prandaj mund të kemi një recension, por ndoshta nuk do të jetë destabilizues.

VI. HISTORI

6.1 Nga dr. Mark PALNIKAJ

Konferenca e Bujanit në historiografinë shqiptare dhe ndërkombëtare

Hyrje

Konferenca e Bujanit u mbajt në shtëpinë e Sali Manit, në fshatin Bujan të Krasniqit, nga data 31 dhjetor 1943 deri në datën 2 janar 1944. Vendimi për mbajtjen e kësaj konference është marrë në mbledhjen e datës 4 deri 6 nëntor 1943 në malin e Sharrit. Deri në vitin 1990 për këtë konferencë është folur pak në ish-Jugosllavi, kurse në Shqipëri është mbajtur në heshtje për 46 vjet.

Pas vitit 1990 janë mbajtur disa konferenca dhe janë shkruar një numër shumë i madh shkrimesh, kryesisht nëpër gazeta dhe televizione, por edhe në libra të veçantë. Konferenca të tilla pas vitit 1990 janë mbajtur me rastin e 50-vjetorit, 70-vjetorit, 75-vjetorit, por edhe disa konferenca studimore të veçanta, ku janë analizuar vendimet dhe pasojat që pati kjo konferencë.

Një nga simpoziumet më serioze ka qenë ai që u mbajt më 7 janar 1994 në sallën e Muzeut Historik Kombëtar në Tiranë, ku pati një pjesëmarrje të gjerë, me studiues shumë seriozë nga Shqipëria, Kosova dhe vende të tjera. Referatet dhe materialet e tjera të këtij simpoziumi përkujtimor u botuan të plota, me seriozitetin që kanë merituar, nga Instituti i Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë, nën titullin “Konferenca e Bujanit”.

Studiues të ndryshëm, në varësi nga pozicioni dhe formacioni politik ku bënin pjesë, kanë shkruar duke sjellë këndvështrime pro dhe kundër kësaj konference, duke e vlerësuar ose jo dhe duke e cilësuar si një mbledhje

komunistësh, ku, sipas tyre, u shitën interesat kombëtarë. Studiues të vëmendshëm, të pandikuar nga subjektet politike, e kanë vlerësuar shkencërisht, duke marrë në analizë çdo gjë të lidhur me rrethanat politike, ushtarake dhe ekonomike të kohës dhe duke arritur në konkluzione shkencore për efektet që pati kjo konferencë.

Duke pasur parasysh faktin që të gjithë studiuesit pjesëmarrës në këtë konferencë shkencore ndërkombëtare për “Konferencën e Bujanit” janë njohur me punimet kryesore të botuara tashmë për këtë konferencë, në këtë rast nuk do të zgjatem të përsëris ato që janë thënë në shumë konferenca të mëparshme, por shkurtimisht do të mundohem të sjell një panoramë të trajtimit të kësaj konference në Shqipëri, Kosovë dhe në arenën ndërkombëtare.

Për këtë më duhet të pozicionohem shkurt dhe qartas në tri pika:

- a. Si është trajtuar kjo konferencë nga dita e mbajtjes së saj deri në vitin 1990 nga faktorët politikë shqiptarë, posaçërisht nga Partia Komuniste Shqiptare, e cila më vonë është quajtur Partia e Punës së Shqipërisë, e cila deri në vitin 1990 është konsideruar pozicion zyrtar i shtetit shqiptar dhe i partisë në pushtet.
- b. Si është trajtuar kjo konferencë në ish-shtetin e quajtur Jugosllavi nga mbajtja e saj deri në vitin 1999, vit kur Kosova është çliruar nga zgjedha serbe.
- c. Si është trajtuar kjo konferencë në arenën ndërkombëtare nga mbajtja e saj deri në vitin 1999.

Konferenca e Bujanit në dritën e zhvillimeve politike të kohës

- **Konferenca e Bujanit në optikën politike shqiptare**

Konferenca e Bujanit zgjati nga data 31 dhjetor 1943 deri më 2 janar 1944 në shtëpinë e Sali Manit, bajraktar i fisit Krasniqi dhe përkares i Frontit

Nacionalçlirimtar me të gjithë rrethin e tij familjar dhe miqësor. Në atë kohë mjetet teknike dhe njerëzit e shkolluar ishin me pakicë. Për të shkruar dokumentacionin dhe rezolucionin e kësaj konference është caktuar Hajdar Dushi, njeri i shkolluar dhe njohës i pesë gjuhëve të huaja. Shtëpia e Sali Manit ishte tip kulle me ambiente me sipërfaqe të kufizuara. Dhoma e miqve ishte vënë në dispozicion të përfaqësuesve të ftuar, kurse dhoma e gjumit e mikpritësit ishte vënë në dispozicion të Hajdar Dushit, për të shtypur me makinë materialet e nevojshme për konferencën. Në kushtet e vështira të asaj kohe, rezolucioni u shtyp në pesë kopje dhe u firmosën të gjitha nga të gjithë pjesëmarrësit.

Sipas të dhënave që kemi, katër kopje u morën nga përfaqësuesit e Kosovës, sepse objekti kryesor i kësaj konference ishte problemi i bashkimit të Kosovës me Shqipërinë. Një kopje iu dorëzua delegatëve nga trojet e Shqipërisë politike, që në konferencë ishin në pakicë. Këtë kopje e mbajti për afro 16 vjet delegati Mehmet Bajram Mulosmani dhe është kopja e vetme që kemi, sepse katër kopjet e tjera nuk e dimë se ku kanë përfunduar, por që nga ajo kohë asnjëra prej tyre nuk është publikuar. Kësaj çështje do t'i kthehemi më poshtë në shkrimin tonë.

Pas përfundimit të konferencës nga pala kosovare u njoftuan shtabi i Jugosllavisë i kryesuar nga Josip Broz Tito dhe Shtabi i Ushtrisë Nacional Çlirimtare të Shqipërisë i kryesuar nga Enver Hoxha.

Më 4 dhjetor 1943, udhëheqësi jugosllav, Tito, duke folur para gazetarëve anglezë për marrëdhëniet me Frontin Nacional Çlirimtar, në pjesën për Kosovën deklaroi se *“ardhmëria e Kosovës do të rregullohet me plebishit dhe kufijtë, nëse është nevoja, do të rregullohen në të mirë të Shqipërisë”*.

Nga ana e shtabit të Titos reagimi ishte i menjëhershëm dhe kritik qoftë për vendimet që ishin firmosur, qoftë për ata që ishin pjesëmarrës. Nga

materialët që kemi në dorë tani pas tetëdhjetë vjetësh, na rezultojnë se udhëheqësi jugosllav Tito kur u njoftua zyrtarisht, pak kohë më pas ishte shprehur se “është e parakohshme”. Në kushtet e luftës kundërshtimi me tone më të forta mund të kishte pasojë të rrezikshme për qëndrimin e shtabit të Kosmetit, i cili vepronte si një pol i veçantë i shtabit qendror jugosllav të luftës. Titoja kundërshtimin ekstrem të kësaj konference e ruajti për ta demonstruar pas një viti, në vitin 1945 në një mbledhje të mbajtur në qytetin e Prizrenit. Ata që e kishin firmosur u detyruan ta mohonin këtë konferencë, të distancoheshin nga vendimet e saj dhe të bënin autokritikë për “shkarje në pozitë të nacionalizmit shqiptaromadhi”. Në rast të kundërt, ata u kërcënuan me zhdukjen e tyre me anë të vrasjes.

Në Shtabin Nacional Çlirimtar të Shqipërisë kjo konferencë nuk u kundërshtua dhe njoftimi për mbajtjen e saj u botua në gazetën e Partisë Komuniste Shqiptare “Zëri i Popullit” të datës 7 shkurt 1944, duke përshëndetur pjesëmarrësit dhe vendimet e saj. Po në muajin shkurt të vitit 1944, në gazetën “Bashkimi”, që ishte në varësi të këtij shtabi, u botua edhe një pjesë e rezolutës.

Deri në vitin 1981 në asnjë organ të shtypit shqiptar kjo konferencë nuk u zotua më në gojë dhe nuk u kushtua asnjë lloj vëmendjeje, edhe pse ishte ngjarje me rëndësi kombëtare për kombin shqiptar. Për Konferencën e Pezës organizoheshin çdo vit festime me pjesëmarrje masive në këtë fshat. Për Konferencën e Bujanit, edhe më e rëndësishme për fatet e kombit, u mbajt heshtje e plotë. Nuk u shkrua asnjë rresht dhe nuk u mbajt asnjë takim që ta përkujtonte. Në vitin 1968 u botua “Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë” me 420 faqe dhe me një tirazh prej njëqind mijë kopje. Autorësinë e këtij botimi e kishte Instituti i Studimeve Marksiste Leniniste pranë Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë. Në asnjë faqe të këtij botimi nuk përmendej Konferenca e Bujanit, as vendimet e saj. Shpesh e kam analizuar

me mendjen time, nëse ka qenë një harresë dhe një mosnjohje nga ana e hartuesve të këtij libri apo një lënie e qëllimshme, pa u përfshirë në këtë botim. Këtë nuk mund ta them me saktësi, por më poshtë do të sjell një fakt interesant për këtë problem.

Në vitin 1981, studentët e Universitetit të Prishtinës u ngritën në demonstrata, të cilat për pjesëmarrësit e këtij simpoziumi janë të njohura. Qëndrimi zyrtar i shtetit shqiptar nëpërmjet zëdhënësës së vet, Partisë së Punës së Shqipërisë, ishte në mbështetje të këtyre demonstratave dhe të demonstruesve. Për këtë u botuan në organin kryesor të kësaj partie, “Zëri i Popullit”, dy artikuj redaksionalë, me nga dy faqe në mbështetje të këtyre demonstratave, por pa e përmendur Konferencën e Bujanit.

Por në shtypin jugosllav të kohës, nga ana e organeve zyrtare të shtetit të asaj kohe u tha se këto demonstrata ishin të frymëzuara nga irredentistët shqiptarë dhe ishin të ndikuara nga vendimet e Konferencës së Bujanit. Këto publikime ndiqeshin me vëmendjen më të madhe nga ana e qeverisë shqiptare dhe e Partisë së Punës. Duke mos pasur asnjë informacion arkivor për këtë konferencë, ata iu drejtuan organeve në varësi të tyre, si Arkivi i Shtetit, Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste dhe Instituti i Studimeve të Marrëdhënieve Ndërkombëtare pranë Ministrisë së Jashtme.

Meqë në asnjërin nga këto institucione nuk kishte kurrfarë informacioni as të shkruar e as me gojë, u ngarkua zëvendës drejtori i Institutit të Studimeve të Marrëdhënieve Ndërkombëtare pranë Ministrisë së Jashtme, z. Vladimir Prela, për të sjellë informacion. Vladimiri ishte tropojan, djali i atdhetarit Bajram Hoxha, familje me origjinë shqiptare nga Kolashini i Malit të Zi. Familja e tij ishte mbështetëse e luftës nacionalçlirimtare dhe e shtetit të kohës. Edhe ky nuk kishte asnjë lloj informacioni për këtë konferencë, por iu drejtua për ndihmë korrespondentit të gazetës “Zëri i Popullit” për Tropojën, Z. Halil Buçpapa.

Siç ma ka konfirmuar me gojën e tij, edhe Halili nuk kishte asnjë lloj informacioni, por për një tropojan nuk ishte e vështirë të merrje informacion për këtë problem, sepse ishin me qindra personat dëshmitarë të kësaj konference që kishin qenë, përveçse pjesëmarrës me mandat në këtë konferencë, edhe në mbështetje të saj si rojë e armatosur e këtij grupimi, punonjës shërbimesh në funksion të mbarëvajtjes së saj etj.

Këtu del në pah kopja e pestë e rezolucionit, që ishte e ruajtur nga Mehmet Mulosmani.

Ky person kopjen e vet ia kishte dhuruar me dedikim me shkrim dhëndrit të tij nga fisi Gashi, z. Osman Gega, një veteran i Luftës Nacionalçlirimtare, burrë shumë fisnik dhe i ditur, në atë kohë Drejtor i Shërbimeve Komunale të qytetit Bajram Curri. Kopjen e tij, z. Mehmet Bajram Mulosmani, pjesëmarrës dhe firmëtar i rezolucionit të konferencës, ia dhuroi mikut të tij me një përkushtim të shkruar një faqe me këtë përmbajtje:

“Konferenca e Parë e Këshillit Nacional Çlirimtar për Kosovë e Metohi, 31. XII. 1943 dhe 2. I.1944:

Shokut Osman Hysen Gega, me qëllim që në bibliotekën t'ande e të djemve tu të gjindet dokumenti me randsi, ku përfaqësuesit e Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit, me pjesëmarrje të delegatëve të Malsis, të Serbisë e Malit të Zi vendosin të përforcohet lufta Nacional Çlirimtare e në shlibim Kosova me rrafshin e Dukagjinit të vetvendosi, dmth të bashkohet me Shqiprinë nanë ose të shkojë me popujt e Jugosllavisë. Asht nji me origjinalin. (Kolonel Mehmet Bajram Mulosmani) Tiranë, 26-9-1962, ora 14:30”.

Kujtimet e pjesëmarrësve dhe kjo kopje e rezolucionit shërbeu për t'u përdorur në përgjigje të propagandës së egër të shtetit jugosllav të dirigjuar nga nacionalistët serbomëdhenj. Tani kjo kopje ruhet në Arkivin Qendror të Shtetit Shqiptar në Tiranë.

- **Konferenca e Bujanit dhe trajtimi i saj nga Jugosllavia**

- *Cili ishte qëndrimi ndaj Konferencës së Bujanit në vitet 1944-1945 në Jugosllavi?*

KQ i PKJ-së, pasi u njoh me vendimet e Konferencës së Bujanit, tërhiqte vëmendjen: “...sot nuk duhet të flitet për bashkimin me Shqipërinë, sepse në këto momente nuk është fjala për caktimin e kufijve mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë, që të dyja të pushtuara nga Gjermania, por që të dyja këto vende, me luftë të armatosur, të çlirohen prej pushtuesit fashist”.

Siç shihet, ndonëse përgjigjja e udhëheqjes jugosllave është e kujdesshme dhe e shprehur me gjuhë diplomatike, nënteksti i saj ishte i qartë: ajo nuk ishte dakord me Rezolutën e Konferencës së Bujanit, me të drejtën e popullit në Kosovë për të vetëvendosur vetë për fatin e tij, se me cilin shtet do të ishin ata pas përfundimit të Luftës.

Në një letër tjetër të KQ-së të PKJ-së, drejtuar KK të Kosovës më 28.3.1944, kërkohet largimi nga terreni i Kosovës i kuadrove dhe lënia aty vetëm e një numri minimal të celulave. Në këtë mënyrë atyre do t’u hiqej mundësia të propagandonin vendimet e Konferencës së Bujanit dhe kuadrot shqiptarë do të zëvendësoheshin me kuadro serbë e malazezë.

Më 18 qershor 1944, KQ i PKJ-së urdhëronte: “*Treva juaj nuk paraqet ndonjë krahinë kompakte, prandaj të hiqet emri Komiteti Krahinor dhe të mbetet Komiteti Qarkor*”. Kjo do të thoshte të kishte më pak kompetenca udhëheqja e Kosovës. Po përgatitej terreni që ajo të mos kishte varësi nga KQ i PKJ-së siç e kishte deri në këtë kohë...

Në Konferencën e Tretë të KQ-së të PK-së për Kosovën, më 28.3.1945, u komunikua kalimi i varësisë nga KQ i PKJ-së te PKJ-ja për Serbinë. Synimi ishte i qartë: ***Kosova duhej t’i jepej Serbisë.***

Vendimi për vendosjen e administratës ushtarake në Kosovë, më 8.2.1945 është rrjedhojë e vendimeve të padrejta në kurriz të çështjes shqiptare, për të cilat udhëheqja jugosllave kishte dijeni. Serbët po përgatiteshin me çdo mjet (edhe me forcën e armëve) të mbanin patjetër Kosovën koloni të tyre si në vitet para Luftës së Dytë Botërore. Më 2 shtator 1944 Shtabi Kryesor i Kosovës u shndërrua në Shtab Operativ dhe më 14 shtator 1944 u vu nën varësinë e shtabit Kryesor të UNÇJ-së për Serbinë.

Më 1 nëntor 1944, diplomati ti “Foreign Office”, i ngarkuar me problemet shqiptaro-jugosllave, shprehej: *“Ne nuk duhet të njohim përfshirjen e Kosovës në Shqipëri. Unë mendoj se ne duhet të bëjmë gjithçka, që të ndalojmë dhënien e këtij rajoni Shqipërisë”*. Në qarqet e udhëheqjes jugosllave në vitin 1944 flitej për dy variante për zgjidhjen e çështjes kosovare:

- a. Rrafshi i Dukagjinit me qytetet Pejë, Gjakovë, Prizren deri në Fushë-Kosovë t’i jepeshin Shqipërisë, kurse pjesa tjetër e Kosovës, duke përfshirë Mitrovicën, Podujevën, Prishtinën, Gjilanin t’i jepeshin Serbisë.
- b. Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit t’i bashkoheshin Shqipërisë, që ajo pastaj të hynte në Federatën Jugosllave.

Por asnjëri prej varianteve nuk i kënaqte orekset e pangopura të shovinistëve serbë, të cilët kërkonin medoemos që Kosova t’u përkiste atyre dhe vetëm atyre për ta shfrytëzuar, grabitur dhe kolonializuar si para vitit 1941. Është kjo arsyeja që Eduard Kardeli në këtë kohë shprehej: *“Më e natyrshme do të ishte që Kosova dhe Metohia t’i bashkoheshin Shqipërisë, mirëpo meqë raportet e forcave në Shqipëri nuk janë dominuar ende nga Lëvizja Nacionalçlirimtare si në Jugosllavi, edhe situata në Ballkan është e*

komplikuar... Tani për tani nuk vjen në konsideratë që Kosova dhe Metohia t'i bashkohen Shqipërisë”.

Me dinakëri dhe hipokrizi ai përpiqet të gjejë arsyet dhe shkaqet përse Kosova duhet të jetë përsëri pjesë përbërëse e Jugosllavisë jashtë dëshirës e vullnetit të shqiptarëve në Kosovë, të cilët në atë kohë përbënin 70 për qind të popullsisë në atë trevë.

Duke e arsyetuar më tej këtë ide, Eduard Kardeli në takimin me Titon dhe Bakariçin, deklaroi: *“Në qoftë se do të merrej çfarëdolloj vendimi për Kosovën, në bazë të kuptimit abstrakt të parimit të vetëvendosjes deri në shkëputje, kjo do të dobësonte shumë luftën tonë në Serbi dhe do t'i shërbente Drazha Mihajloviçit, si dhe forcave shoviniste të Serbisë si argument i fuqishëm për të na akuzuar se po e copëtojmë Jugosllavinë”.*

Baza reale e asgjësimit të Rezolutës së Mbledhjes së Bujanit

Sipas udhëheqjes së lartë jugosllave dhe serbe, parimi i vetëvendosjes së shqiptarëve në Kosovë ishte diçka abstrakte, jashtë realitetit dhe kohës dhe, si i tillë, ai nuk mund të realizohej. Është kjo arsyeja që udhëheqja e ngushtë e KQ-së së PKJ-së më 18 shkurt 1945 miratoi propozimin e Eduard Kardelit dhe vendosi përfundimisht, që “Kosova dhe Metohia t'i bashkëngjiten Serbisë”. Për të realizuar këtë duhej goditur dhe asgjësuar Rezoluta e Mbledhjes së Bujanit, të bëheshin ndryshime në Kryesinë e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar për Kosovën dhe Metohinë e dalë prej saj. Në kryesinë e Bujanit ishin zgjedhur 9 vetë, sipas raporteve të popullatës në Kosovë: 7 shqiptarë, 1 serb, 1 malazez. Për t'i ndryshuar këto raporte u propozua që kryesia, nga 9 vetë të bëhej 11, me pretekstin se Fadil Hoxha, Ali Shukriu dhe Pavlo Joviçeviqi ishin të ngarkuar me probleme ushtarake, dy shqiptarë dhe një serb nga kryesia ishin vrarë. Pra, duheshin zgjedhur 5 anëtarë të rinj dhe me metodën e kooptimit u futën në kryesi pesë serbë dhe

malazezë, duke ndryshuar edhe raportin nga 7:2 për shqiptarët në 6:5 për serbët dhe malazezët. Kështu po përgatiteshin kushtet për të ndryshuar vendimet e Konferencës së Bujanit.

Në Konferencën e Këshillit Popullor të Kosovës (19-24 mars 1945), ku morën pjesë 400 vetë, Xhavit Nimani tha se *“Titoja i kishte falur kosovarët që kishin marrë pjesë në qëndresën e udhëhequr nga Shaban Poluzha”*. Halim Spahija dhe Ramiz Cërnica e kundërshtuan këtë dhe theksuan se Kosova dhe viset e tjera shqiptare duhej të shkonin me Tiranën.

Vendim tragjik i Kuvendit të Prizrenit - i paligjshëm

Një pjesë e shqiptarëve të Kosovës, që kishin votuar pro rezolutës së Konferencës së Bujanit, duke qenë nga organizatorët kryesorë të saj, po e braktisnin atë. Kjo ishte e pafalshme dhe pati pasoja tepër negative për fatin dhe të ardhmen e Kosovës.

Pati edhe shqiptarë nga Kosova që nuk i ndryshuan qëndrimet e tyre ndaj vendimeve të Konferencës së Bujanit, por i mbrojtën me forcë dhe sakrifica. Për t'i bindur këta dhe për qëllime demagogjike, Titoja më 6.4.1945 u takua me një delegacion shqiptar. Përfaqësuesit e Kosovës folën për rolin destruktiv të V. Popoviqit (sekretar i Komitetit të PKJ-së së Gjilanit), për vrasjet e shqiptarëve në Kosovë. Ata parashtruan edhe shqetësimet e shqiptarëve të Kosovës, duke theksuar se ata kërkojnë të dinë: *“Përse Kosova të jetë nën Jugosllavinë, kur dihet se Shqipëria e ka nisur luftën më parë nga të tjerët dhe vetë është çliruar? Përse të mos vemë me Tiranën, derisa na kanë thënë të vetëvendosim?”*. Titoja, u premtoi atyre se *“shqiptarët në Jugosllavi do të kenë të drejtat që një popull e bëjnë popull”*. Ai i akuzoi shqiptarët në Kosovë, se *“ata e kishin ndihmuar armikun”* dhe krahas kartës demagogjike tundi edhe kartën e forcës, duke deklaruar para tyre se *“nuk është e mjaftueshme bindja, por duhej të qëroheshin ata që nuk*

bindeshin". Pra edhe ata duhej të bindeshin, në të kundërtën do të ndëshkoheshin rëndë. Ashtu ndodhi. Nëntë nga pjesëmarrësit më të rëndësishëm të takimit u likuiduan nga OZN-ja me akuzën *e komplotit kundër shtetit*.

Përfaqësuesit e shqiptarëve të Kosovës në takimin me Titon kërkuan nga ai që t'u lejohej referendumi. Jo vetëm që ai nuk u lejua, por gati të gjithë meshkujt u dërguan në frontet e luftës - prej Sremit deri në Adriatik. Kjo ua lehtësoi punën brigadave jugosllave për të nënshtruar dhe ripushtuar Kosovën.

Në kuvendin e Prizrenit, që u mbajt më 8-10 korrik 1945, u hodh poshtë Rezoluta e Mbledhjes së Bujanit. Në këtë Kuvend morën pjesë 137 delegatë (33 ishin shqiptarë ose 24,08%, 71 serbë e malazezë 52,82%). Për 33 delegatët shqiptarë (24,08%) nuk është dhënë përkatësia kombëtare.

Referatin e mbajti Xhavit Nimani, në të cilin shtrohej pyetja: *"Përse masat e gjera popullore nga Kosova dëshirojnë të bashkohen me Serbinë Federale"*. Përgjigjja ishte kjo: *"Para së gjithash, për arsye se populli serb, duke u ngritur i pari në luftë kundër okupatorit, njëkohësisht ka luftuar edhe hegjemonistët serbomëdhenj, kundër atyre që janë më së shumti fajtorë për të gjitha të këqijat që u janë bërë popujve të Kosovës"*. Në Kuvend u mor vendimi: *"Këshilli Popullor i Kosovës deklaroi në mënyrë të njëzëshme se banorët e këtij qarku, po ashtu si gjithë popujt e Jugosllavisë, nuk kanë pranuar kurrë copëtimin e qarkut të vet, as të Jugosllavisë, të bërë nga okupatorët dhe shpreh dëshirën që Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit t'i bashkohen Serbisë Federale"*.

Ky vendim tragjik ishte i paligjshëm për këto arsye:

- 1. Ai u mor në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme.*
- 2. Delegatët nuk u zgjodhën në mënyrë demokratike dhe si të tillë, nuk mund të përfaqësonin interesat dhe aspiratat e popullit të Kosovës.*

3. Në zgjedhjen e delegatëve nuk u mor për bazë popullsia sipas përkatësisë kombëtare. Shqiptarët, të cilët përbënin 68,5% të popullsisë të Kosovës, u përfaqësuan me 24.08% delegatë, kurse serbët e malazezët, edhe pse si popullsi ishin 27,5%, u përfaqësuan në kuvend me 51,82% të delegatëve. Pra, vendimi për bashkimin e Kosovës me Serbinë ishte një vendim që e morën serbët dhe jo shqiptarët.

Një nga organizatorët kryesorë të Konferencës së Bujanit dhe të Kuvendit të Prizrenit, Fadil Hoxha, është shprehur: “Më 10 korrik 1945... ligjërisht dhe në mënyrë demokratike, njëherësh anulohet dhe pjesa e gabueshme e Rezolutës, e miratuar në Konferencën e Bujanit”.

Atë që ai e quan “nen të gabueshëm”, parimin e vetëvendosjes së shqiptarëve në Kosovë, është vendimi më i rëndësishëm historik, për të cilin u flijuan dhe luftuan mijëra kosovarë. Se sa lirisht e në mënyrë demokratike u mor vendimi për bashkimin e Kosovës me Serbinë përsëri, e theksuam më sipër.

Duke pasur parasysh vendimin e Kuvendit të Prizrenit, në Rezolutën e miratuar në seancën e parlamentit jugosllav (KANCJ), të mbajtur më 7-10 gusht 1945, thuhet: “Kosova dhe Dukagjini në mbledhjen e zhvilluar më 10 korrik 1945 në Prizren, kanë miratuar rezolutën, në të cilën territori i Kosovës dhe i Dukagjinit i bashkëngjitet Serbisë Federale”.

Nga kjo mbledhje të bëjnë përshtypje dy momente:

- Së pari, në këtë forum Kosova u përfaqësua me 15 deputetë, kurse Vojvodina dy herë më pak, me 30 deputetë, çka flet për trajtimin diskriminues të Kosovës në raport edhe me Vojvodinën, por edhe për frikën që kishin autoritetet jugosllave nga revolta popullore e shqiptarëve. Kjo tregon edhe për përpjekjet e tyre, edhe pse antidemokratike, për të realizuar aneksimin e Kosovës Serbisë.

- *Së dyti*, dokumentin e nënshkroi Ivan Ribari, i cili ka qenë kryetar i parlamentit mbretëror në vitet 1920-1923, kur u dogjën 182 fshatra shqiptare në Kosovë dhe u vranë 40 000 kosovarë.

- *Çfarë mund të pritej nga një parlament i tillë?*

Në këtë dokument antishqiptar, antidemokratik, e ka zanafillën lufta e shqiptarëve në Kosovë, në vitet 1945 e deri në vitin 1999. Ky është qëndrimi jugosllav, përkatësisht i nacionalistëve serbë për Konferencën e Bujanit në vitin e parë pas mbajtjes së kësaj konference. Në simpoziumin e mbajtur në Tiranë më 7 janar 1994 janë shkruar për këto probleme dhe nuk do të ndalemi të japim hollësi, sepse gjithçka është sqaruar në librin përmbledhës të temave të mbajtura. Shteti jugosllav besoj se mori dhe mbajti të burgosura në arkivat e vet famëkeq katër kopjet e rezolucionit të përmendura më lart dhe për aq sa pati mundësi, nuk lejoi asnjëherë të flitej publikisht për këtë konferencë deri në vitin 1981. Më datë 13 dhjetor 1988, Dhoma Federative Jugosllave, me vendim të veçantë, i hodhi poshtë vendimet e Konferencës së Bujanit dhe e cilësoi një “akt i pavlefshëm”.

Etiketimi dhe mosvlerësimi i Konferencës së Bujanit është miopi politike

Ky veprim i Dhomës Federative të Jugosllavisë dhe i atyre që e drejtonin tregon dy gjëra:

- *Së pari*, tregon paditurinë e tyre, sepse një akt që ishte firmosur 44 vite më parë nuk mund të zhbëhej pas kaq vitesh, sepse ai kishte ndodhur dhe ishte një fakt i kryer dhe i firmosur kolektivisht pa asnjë kundërshtim nga të gjithë pjesëmarrësit.
- *Së dyti*, ky veprim tregon se sa i rrezikshëm ishte ky dokument për politikën nacionaliste serbomadhe dhe sa i rëndësishëm ishte për ndjenjat kombëtare të popullit shqiptar, që banonte në trojet e veta në Dardaninë e lashtë, që tani quhej Kosovë.

Vetëm ky fakt është i mjaftueshëm për të treguar se sa gabim bëjnë disa politikanë miopë të kombësisë shqiptare, të cilët e kanë etiketuar këtë konferencë, pjesëmarrësit dhe vendimet e saj si antishqiptare dhe antikombëtare. Nëse do të ishte e tillë, siç e etiketojnë ata, kjo konferencë nuk do të kundërshtohet me forcë kaq të madhe nga lobi serb në Jugosllavinë e asaj kohe.

Konferenca e Bujanit në arenën ndërkombëtare

Nga shtetet e tjera të interesuara për politikën dhe marrëdhëniet midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë, më të interesuara kanë qenë qeveritë e shteteve, si SHBA-ja, Rusia, Anglia dhe Greqia. Shtetet e tjera kanë pasur interesa të papërfillshëm për këto marrëdhënie.

Qeveria ruse pas vitit 1948 është marrë shumë me marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, por qëndrimet e tyre kanë mbetur në suazën e marrëdhënieve diplomatike dhe nuk janë publikuar asnjëherë në organet e shtypit. Pas vitit 1990, studiues të ndryshëm nga Kosova, por kryesisht nga Shqipëria kanë studiuar në arkivat rusë qëndrimet e këtij shteti për këto marrëdhënie. Nga punimet publikuara nga studiuesit Shaqir Vukaj dhe Pëllumb Xhufi janë bërë të njohura shumë qëndrime të Rusisë për marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave dhe posaçërisht për Kosovën. Pasi ato janë të botuara dhe janë në dispozicion të studiuesve dhe të publikut të gjerë, nuk e shoh me arsye të ndalem veçanërisht dhe të përsëris mendimet e tyre.

Qeveria e Mbretërisë së bashkuar në këtë konferencë ka pasur një oficer të vetin, që quhej Hendzi, i cili ka qenë i pranishëm gjatë gjithë kohës së mbajtjes së konferencës dhe ka qenë në dijeni të të gjitha vendimeve që janë marrë aty.

Në atë kohë, qëndrimi i kosovarëve ndaj italianëve dhe gjermanëve nga ana e anglezëve është konsideruar i gabuar, sidomos pas formimit të batalionit “Skënderbeg” me kosovarë. Masakra e Tivarit besoj se u krye nga serbët me miratimin në heshtje të palës angleze. Edhe me palën greke, për sa i takon Shqipërisë, anglezët mbështesnin pretendimet greke dhe gjatë luftës u kishin premtuar mbështetje në pretendimet e tyre për Vorio-Epirin.

Tani këto probleme u takojnë historianëve t’i zbardhin me dokumente.

Prishtinë, 8 dhjetor 2023

VII. INTERVISTA

7.1 Albert V. NIKOLLA

Shqiptarët janë shumë të vjetër, në mos fillimi

Gjuhëtari shqiptar me famë europiane, Albert V. Nikolla, komenton studimin e revistës “Science”, me konkluzionet mbi vjetërsinë e gjuhës shqipe.

Intervistë me Albert V. Nikollën

Intervistoi: dr. Mujë Buçpapaj

- Në numrin e fundit të revistës shkencore “Science”, revista më e rëndësishme shkencore në botë, gjuha shqipe përmendet si një ndër tri gjuhët që kanë rrjedhur direkt nga proto-indo-europianishtja. Në fakt, ju e keni thënë në të gjitha intervistat tuaja, që gjuha shqipe është vetë proto-indo-europianishtja?

AVN: Jo, nuk e kam thënë unë një gjë të tillë! E ka thënë vetë babai i shkencës gjermane, poliglotti Gottfried Wilhelm Leibniz, që në fillim të shekullit XVIII. Unë thjesht e kam përsëritur këtë fakt në mënyrën time shkencore. Këtu kam parasysh një shënim të këtij kolosi, që gjendet te libri “Opera Philologica”, që daton më 13 janar 1714 dhe që u zbulua e ribotuar më 1989, nga studiuesi Georg Olms, në Vjenë. “U gëzova shumë kur më ra në dorë një *Fjalor i Gjuhës Shqipe*. Me anë të këtij libri, ne mund të shohim se si ka qenë gjuha e ilirëve të lashtë! (...) **/Atti yne/* (ati ynë) korrespondon me gjuhën shqipe dhe është e njëjtë në shqip. Por ka edhe pak fjalë të gjuhëve gjermanike, si **/seet/ (dhet) për tokë, */enandeyenée/ (a na nder*

jene; e na nder jem, kuptimi semantik: *na falni*) dhe */ndetekech/(nder të kesh)* gjithashtu”. Siç shihet në shënimet e tij, ai e lidhte shqipen edhe me keltishten e vjetër: Sipas tij fjala **/hund/* lidhej me fjalën e gjuhëve gjermanike dhe gjendet edhe në keltishten e vjetër. Kjo fjalë e shqipes ka dhënë fjalën */hundt/(qen)* në gjermanishte, pasi qeni si kafshë dallohet nga përdorimi i hundës, në ndjekjen e gjahut. Gjithashtu edhe fjala **/krahë/* e shqipes ka lidhje me fjalën **/craben/(gaforre)* të keltishten, pasi gaforrja ka krahë”. Megjithëse semantika në kohën e Leibniz-it nuk njihej si metodologji kërkimi gjuhësore, Leibniz-i me inteligjencën e tij e aplikoi “konceptin e prejardhjes së fjalëve nga derivacioni”.

- M.B: Zoti Nikolla, këto lloj studimesh nuk janë publikuar në shqip, dhe aq më pak të jenë studiuar në Fakultetin e Filologjisë?

- AVN: Fatkeqësisht, jo! Shkolla shqiptare ka përgatitur gjuhëtarë të rangut të dobët dhe deri në vitin 2010 edhe unë isha i tillë. Studimet në institutin “Rogier Guilbert” në Bruksel me hapën sytë. Nevojitet të dihet nga shqiptarët, se studimet mbi “rolin mesianik të gjuhës shqipe”, nuk fillojnë me Petro Zhejin, por me akademikun e madh francez, Louis Benllœw, (filolog francez, i lindur në Erfurt më 15 nëntor 1818 dhe vdiq në Dijon në shkurt 1900) një ndër gjuhëtarët më të mëdhenj të shekullit të kaluar, i cili ishte i mendimit se shqipja ishte një gjuhë shumë e vjetër sesa ajo që konsiderohej indo-europianishte, dhe i atribuonte shqipes statusin e një gjuhe paragreke. Petro Zheji si një njohës i shkëlqyer i frëngjishtes, e zhvilloi më tej veprën e mrekullueshme të Benllœw-t, duke shtuar “teorinë e algoritmeve në gjuhë” me shembuj konkretë nga shqipja.

M.B: Nga vinin bindjet e Benllœw-t rreth shqipes?

AVN: Nga Volteri që ishte një adhurues i madh i shqiptarëve, e sidomos nga vepra e Leibniz-it. Duhet ta dini se Gottfried Wilhelm Leibniz është

themeluesi i Albanologjisë dhe në Akademinë shqiptare mungon busti i tij. Ai që i dashuruar me gjuhën shqipe, që në momentin e parë që ra në kontakt me të. Si kryetar i Akademisë Prusiane të Shkencave, filozofi gjerman Gottfried Wilhelm Leibniz-i ishte i pari që zbuloi lidhje të drejtpërdrejta të gjuhës shqipe me gjuhën fillestare *skythe*, por edhe kelte e gale, duke i akorduar kështu shqipes rol themelues në gjuhët europiane. Eruditi i pashembullt në historinë botërore, Leibniz-i mendonte se shqipja ishte jo vetëm burimi i gjuhëve indoeuropiane, por edhe më gjerë. Veprën e tij do ta pasonte një ndër figurat më të mëdha të shekullit XIX në Francë, akademiku Louis Benllœw, i cili pas trajtimit që i bëri shqipes në veprën “La Grèce Avant les Grecs” (Greqia para grekëve) më 1877, duke e renditur me një vjetërsi me gjuhën hebraike, lidiane dhe frigo-joniane, i dha shqipes indirekt rolin e një gjuhe fillestare. Por tezën e tij e zhvilloi më tej, sidomos në veprën e tij të posaçme kushtuar gjuhës shqipe: “*Analyse de la Langue Albanaise*” (Analizë e gjuhës shqipe) më 1879, ku i përmbahet vijës së tij, se gjuha shqipe e kalon klasifikimin e të qenit gjuhë proto-indo-europiane, dhe duhet studiohet me matrica. Ky akademik nuk është i vetmi që e mbështet këtë tezë. Sipas pjesës dërmuese të gjuhëtarëve më mëdhenj të Europës dhe të botës, shqipja është një gjuhë unitare (speciale), që përfaqëson degën më të vjetër të gjuhës indo-europiane, e rrjedhur nga gjuha fillestare paleo-proto-indo-europiane, PPIE. Nga konkluzionet e Leibniz-it pati një ndikim shumë të madh Franz Bopp, i cili i kushtoi një vepër të veçantë gjuhës shqipe.

-

M.B: Mund të na thoni se cili nga gjuhëtarët e sotëm e mbështet këtë tezë, që e merr shqipen si referencë vjetërsie?

- **AVN:** Baskologu Mishel Morvan, për të vërtetuar vjetërsinë e gjuhës baske, e nxjerr atë si një degëzim prehistorik të shqipes. Sipas tij, mes shqipes dhe

baskishtes ka përkime të jashtëzakonshme, si **[ara]* (*shqip*), **[arura]* në greqishten e vjetër; [aran] (luginë me ara) në gjuhën baske dhe [aranake] (lugine) në gjuhën sarde. Gjuha paleo-sarde arvëreshe paraqet edhe forma substrate pararomane: **/zerru/(derr)*, e njëjtë me *baskishte/zerril'*". Edhe kjo fjalë lidhet me shqipen substratike **/derr/?*). Termin **/aran/(luginë)* e gjejmë gjithashtu në juglindje të Francës: **/Val d'Aran/ (Bouches-du-Rhône*, si dhe *var* veriperëndim të Katalonjës (tautologji nga demotivimi i termit më të vjetër). Në mënyrë të ngjashme, elementi toponimik paraokitan **/kuk, suk, tuk/ (lartësi)* (*juk* - në vendin bask, **/tschugg/* në alpet zvicerane) gjendet në shqipen substratike me **/jūk (gegnisht > kodërzë e vogël, por edhe */sūk/* (në të folmet e Matit, Tropojës dhe Dibrës dhe **/çukë/* (toskërisht). Interesante është të shihet se këto fjalë hasen edhe në hungarisht **/csúcs / (kodër)* në hungarisht, **/kukk/ (kokë)* dhe në dravidisht: **/kuight-kii/ (koka)* - malajzian **/chuck/*. Duke qenë se paleo-sardishtja është një variant i shqipes së vjetër, kemi të bëjmë me një të dhënë shkencore me vlerë të jashtëzakonshme.

- M.B: Pse mendoni se janë të rëndësishme studimet e Michel Morvan-it për gjuhën shqipe?

- **AVN:** Sepse baskologu Michel Morvan-i, ashtu si dhe Babinjoti i gjuhës greke, gjuhën shqipe e kanë referencë shkencore të dorës së parë për etimologjinë komperative dhe zbulimet e vërteta shkencore, dhe nuk janë ndikuar aspak nga dokrrat e shkollës pansllaviste. Studimet e thella komperative të specialistit të gjuhës baske, Mishel Morvan, dhe fjalët e përbashkëta të shqipes me gjuhën baske, por edhe studime të mëparshme që lidhen me gjuhën hebraike të Giuseppe Crispi-t, mbi lidhjen e shqipes me hebraishten, e nxjerrin shqipen paleo-proto-indo-europiane- PPIE. Gjuhëtari i madh european shprehet qartë: “Nuk është rastësi që shqipja ofron krahasimin e termave më interesantë, që përforcon faktin e ekzistencës së një

shtrese leksiku paleo-proto-indo-europian. Mund të thuhet me siguri, se i gjithë Ballkani futet kështu i konfiguruar në të njëjtën zonë gjuhësore substratike. Në shqip gjejmë nocione para-kelte si /mal, */kok/, si dhe instrumentin muzikor të quajtur */gaide/, që është i njëjtë edhe në baskishte */gaite/. Këto shembuj turbullues tregojnë se problemi bask i kalon relacionet e mundshme me Kaukazin dhe duhet zgjidhur në kuadrin e kërkimeve nostratike”. Fjala /gaite/ do të thotë */dhi/ në gjuhën kelte, por në dialektet e shqipes gjejmë format */gai/ dhe */dhai/ në Mirditë, Mat e Dibër, që emërton *dhinë* si kafshë, e që ka shërbyer si nocion për emërtimin e kësaj vegle primitive që na vjen nga epoka e gurit. Duke qenë se shqipja ka lidhje me gjuhët e vjetra dhe motivon etimologjikisht të gjithë leksikun e tyre, është mjaft e rëndësishme të thuhet se Michel Morvan-i, nëpërmjet studimeve të tij komparative vërteton faktin se gjuha shqipe dhe paleo-sarde (një variant i ilirishtes ose i popujve të detit) janë mjaft e afërta me baskishten, siç tregohet nga vepra e E. Blasco Ferrer-it, mbi toponiminë e Sardenjës, veçanërisht në rajonin e largët të Barbagjias dhe Nuoros, të cilat gjatë milenerëve i rezistuan procesit të asimilimit nga kultura latine.

- M.B: E ku qëndron lidhja mes Benlloew-t dhe Morvan-it në studimet e tyre, dhe pse kjo dyshe franceze ka dhënë konkluzione thelbësore për gjuhën shqipe?

- AVN: Benlloew në veprën e tij “*Analyse de la Langue Albanaise*”, nisur nga elemente të brendshme strukturale shprehet qartë, se “format dhe lakimet e njëjësit dhe shumësit në brendësi të vetë shqipes, por dhe idiomat puro të saj gjenden si të stacionuara në gjuhët bullgare, rumune, në disa dialekte të gjuhës italiane dhe në greqishten e re, gjë që tregon se gjuha shqipe duhet të jetë folur në prehistori në të gjitha këto vende, duke lënë shenjat e saj mbi peizazhin e gjuhëve të reja”. Pra, gjuha shqipe jo vetëm që nuk ka huazuar,

por ka krijuar strukturat gramatikore të këtyre gjuhëve të reja. Këtë e vërteton edhe fakti se Bopp-i, punën e tij të parë shkencore e kreu me përemrin vector të gjuhës shqipe, ndërsa Morvan-i i jep dimension origjinar (nostratik) shqipes, në interes të gjuhës baske.

M.B: Po ju, si mendoni rreth këtyre tezave tanimë të provuara shkencërisht me botimin e revistës më të rëndësishme shkencore të botës “Science”?

AVN: Faktin që gjuha shqipe ishte një vazhdim direkt i variantit ilirisht të indo-europianishtes, u hodh si tezë shkencore pas vitit 1709 nga Leibniz-i, dhe fill pas kësaj shqipja u konsiderua si “Gjuha e ilirëve të lashtë” në mënyrë të pakundërshtueshme nga të gjithë gjuhëtarët e kontinentit. Gjithçka u bazua mbi origjinën e emrit “Alban” dhe “Alba-Noi”, që studiuesit gabimisht mendonin se vjen nga greqishtja e vjetër */alpha/*, (*άλφα*) të cituar për herë të parë nga Ptolemeu në shekullin II para Krishtit. Por duke qenë se varianti hebraik i **/alef/* (*ל*) është më i vjetër sesa ai grek, dhe meqenëse qyteti quhej **/Alba-Noi/* (*Ylli i Noes* - qyteti i themeluar nga profeti Noe), del që të jetë një qytet i kohërave fenikase (paragreke) dhe e lidh këtë qytet ilir me civilizimin sumero-hebraik. Sa i takon emrit **/Alba-Noe/*, nëse mbështetemi në studimet metalinguistike (diakronike dhe strukturale) dhe mbi matricat gjuhësore që fsheh brenda vetes toponimia e emërtimit, ai saktësisht pasqyron origjinën fillestare të fjalës **/al-pha/*, bazuar në alternimin tingëllor të njohur në shqipe **/p/b/* dhe anasjelltas **/b/p/*, kemi të bëjmë me kuptimin semantik të shqipes gege **/al-ba/-*/al-pa/* **/yll i plotë/* **/yll* që shihet/ apo **/yll* i shndritshëm, e cila duhet pranuar se ka dhënë **/álfa/* (*άλφα*) edhe në greqishten e vjetër. Kjo do të thotë se qyteti është paragrek dhe mendohet të jetë ndërtuar përgjatë epokës së civilizimit **/Iliro-Etruks/*, rreth 1600-1100 vite para Krishtit. E gjithë toponimia paragreke e

zonës përreth, si */t'Uran/ (gjyshi i Zeusit - i ardhur nga qielli), e cila me parashtesën */t/, ka dhënë */Turam/ perëndinë etruske, nga ku vjen etimologjia e emrit */Tiranë/, por edhe emri */Kron-Krua Kruj/, që sipas të gjitha gjasave ka qenë tempulli i adhurimit të banorëve të */Alba-Noi/, ose vendi ku mbretëroi mbreti mitologjik, babai i Zeusit */Kron/, gjë që vë në pah në mënyrë të pakundërshtueshme faktin, se kemi të bëjmë me një civilizim paragrek, që ka lidhje me popujt nostratikë.

- M.B: Një problem i madh ka qenë mungesa e shkrimeve në gjuhën shqipe. Ju si mendoni për këtë?

- AVN: Në Itali kemi shkrime mesape dhe japige, dhe mendoj se ka edhe në Shqipëri, por duhet të klasifikohen, pasi janë pranuar si shkrime ilire. Kemi gjithashtu “Kodikët e Artë të Beratit”, të cilët janë në ilirishten e shekullit VI pas Krishtit, dhe që janë pikënisje e gjenezës arbërore. Shkrimet e gjetura në sitet arkeologjike shqiptare janë konsideruara si greke, ndërkohë që arkeologë amerikanë e europianë kanë qeshur me këto konstatime amatoreske të akademirucëve tanë. “Fëmia Hyjnëron” në Apoloni konsiderohet si mbishkrim grek... Apo “Dilli a ata” (*Dielli është ati*) gjetur në Rodos konsiderohet si shkrim grek. Ndërkohë, qytetet e Ilirisë janë ndërtuar nga mjeshtrë grekë, por kanë qenë punëtorë si në Apoloni (rreth 200 punëtorë) dhe Durrës (rreth 500 punëtorë), ashtu edhe marokenët, që kanë marrë pjesë në ndërtimin e Parisit. Thjesht kolonë, ndërtues kolonash të paguar nga ilirët e pasur. Të gjitha sitet e mëdha arkeologjike greke, si Athina, Sparta dhe Dodona janë të rrethuara me fshatra arvanite shqiptare dhe na qenkan greke! Madje s to edhe sitet e Apolonisë, Durrësit dhe Butrintit, ku kanë jetuar ilirët e lashtë! Këto përralla i ha populli i pashkolluar dhe kalamajtë e klasës së parë, por jo njerëzit e ditur. Ka rreth dy

shekuj, që po na fyejnë inteligjencën tonë si shqiptarë me falsifikime historike.

M.B: E, megjithatë, shqipja po ngjit shkallët, derisa të shpallet si gjuhë fillestare? Ju duket kjo një utopi?

AVN: Të gjithë shkencëtarët e mëdhenj të gjuhësisë botërore e kanë pranuar dhe kanë kontribuar hapur në favor të origjinës iliro-trake të shqiptarëve përfshirë Johann Thunmann (1774), Ritter Von Xilander (1835), Franz Bopp (1850), Jakob Fallmerayer (1857), J. Von Hahn (1870), Paul Kretschner (1896), Norbert Jokl (XXe siècle), Maximilian Lambertz (XXe siècle) etj., për të vazhduar me anglezët William Leak dhe Stewart Mann, danezin Holger Pedersen, italianin Angelo Masci, austriakët G. Mayer, H. Olberg dhe R. Solta, francezin A. Ducellier, pa harruar kroatët e mirënjohur Milan Sufflay, Radoslav Katicic, Alexandre Stipcevic etj. Kohët e fundit janë gjuhëtarët Brian D. Josef nga SHBA-ja dhe James Clackson nga Anglia, të cilët në studimet e tyre kanë avancuar tezën shkollareske, duke e nxjerrë shqipen një gjuhë shumë më të vjetër sesa qarqet politike të shekullit XX. Por ka pasur edhe gjuhëtarë pa ndonjë peshë të madhe, siç është rasti i R. B. Gueiouchev, të cilët kanë pretenduar se shqiptarët janë me origjinë kaukaziane, dhe në veçanti nga Albania e Kaukazit. Por Leipniz-i nuk ka lënë asnjë dilemë rreth ilirëve dhe lidhjes së tyre me epirotët. Ai thotë hapur dhe qartë: *“Ilirët e lashtë ishin me origjinë kelte. Ata përdorën një gjuhë të lidhur ngushtë me gjermanishten dhe galishten. Është evidente se relikte të saj ruhen në gjuhën moderne, veçanërisht në atë epirote, nga të cilat kam parë ekzemplarë të botuar”*. Nëse për përkrahësit e prejardhjes iliro-trake ka dokumente të mjaftueshme në gur, si ato dako-muze, mesape, japige etj., por dhe të thëna nga historianët e antikitetit, përfshirë këtu edhe depistimet gjenetike të popullatës, për tezën e prejardhjes së shqiptarëve nga Kaukazi

nuk ka studime komperative të dy gjuhëve, nuk ka të dhëna historike nga historianët dhe nuk ka depistime gjenetike. Kështu që kjo tezë qëndron në nivelin e një fantazie të disa gjuhëtarëve pa ndonjë peshë të madhe. Megjithatë, ekziston mundësia që fiset trako-ilire të jenë shpërngulur në drejtim të këtyre zonave, gjatë fushatës pushtuese të Aleksandrit të Madh, siç është edhe rasti i hundëzakëve në malet e Pakistanit dhe */Vanët/ në veri të Indisë.

M.B: A ka ndonjë shënim në ndonjë enciklopedi të rëndësishme rreth shqiptarëve, e sidomos lidhjes së ilirëve me etruskët?

AVN: Po ju jap një citim të Enciklopedisë Britanike të fillimshekullit XX, ku thuhet qartë se: “Shqiptarët, me sa duket, janë raca më e lashtë në Europën Juglindore. Historia dhe legjenda nuk japin asnjë shënim të mbërritjes së tyre në Gadishullin Ballkanik. Ata janë ndoshta pasardhës të emigrantëve më të hershëm arianë, të cilët në kohët parahistorike përfaqësoheshin nga ilirët, maqedonasit dhe epirotët. Maqedonasit dhe epirotët besohet se kanë formuar bërthamën e popullsisë tirreno-pellazge, parahelene, e cila banonte në pjesën jugore të gadishullit dhe i shtrinte kufijtë e saj deri në Traki dhe Itali. Ilirët ishin gjithashtu “pellazgë”, por në një kuptim më të gjerë. Nga këto raca farefisnore, të cilat shkrimtarët grekë i përshkruajnë si barbarë ose johelene, ilirët dhe epirotët ishin përkatësisht paraardhësit e gegëve ose veriorëve dhe toskëve, ose jugorët të epirotëve. “Via Egnatia”, të cilën Straboni (VII. fragmenti 3) e përshkruan si kufirin midis ilirëve dhe epirotëve, praktikisht korrespondon me rrjedhën e Shkumbinit, që tani ndan gegët dhe toskët. I njëjti gjeograf (v. 2. 221) shprehet se epirotët quheshin edhe pellazgë (Zeusi pellazg adhurohej në Dodonë (Homeri, II. XVI. 234), dhe lagja e shenjtores quhej “Pellazgji”, Herodoti II. 56). Kuptimi i termit “pellazgjik” megjithatë është shumë i errët për të dhënë një bazë për spekulime etnografike në kohën e Herodotit dhe mund të ketë ardhur tashmë për të treguar një periudhë dhe

jo një racë. Emri *tosk* është ndoshta identik me *Tuscus*, *Etruscus*, ndërsa forma *Tyrrhenus* ndoshta lidhet me fjalën “Tiranë”, – përcakton në “Encyclopaedia Britannica” *Eleventh Edition* (1910).

M.B: Ku gabon rryma shkollareske dhe indo-europeanistët e rinj, kur thonë se shqipja është një gjuhë që ka huazuar rreth 93 për qind të fjalorit të saj?

AVN: Gjuhëtarët e mëdhenj të shekullit XIX, për të ndërtuar indo-europeanishten e tyre, u bazuan mbi disa gjuhë të vjetra, si shqipja primitive, sanskritishtja, galishtja, keltishtja etj. Gjeneratat e reja të gjuhëtarëve, me fjalët që shqipja e vjetër i ka dhënë proto-indo-europeanishtes, mundohen të nxjerrin origjinën e fjalëve të shqipes bazuar në shqipen standarde të vitit 1972 . Ky stil kërkimi etimologjik, përveçse është joshkencor, mbi të gjitha është qesharak dhe diskriminues. Një gjuhë nostratike, që ka fjalë të panumërta me hebraishten kaldaike dhe baskishten dhe gjuhën paleosarde, nuk mund të jetë një gjuhë e derivuar! Jean Jacque Hublain, në një bisedë telefonike në fillim të vitit 2022, kur i parashtrova këtë lloj kërkimi paradoksal dhe indiotesk, më tha tekstualisht: “As lopëve të çmendura angleze nuk u falet një gabim i tillë, jo më gjuhëtarëve që u japin mësim studentëve, gjeneratës së ardhshme të gjuhëtarëve”.

M.B: Nga ana tjetër shtrohet pyetja: pse është i nevojshëm ky kërkim etimologjik dhe struktural mbi gjuhën shqipe?

AVN: *Arsyeja e parë*: nuk mund të ketë një panoramë të kompletuar të gjuhësisë europiane, pa një etimologji të plotë e të saktë të gjuhës shqipe e, mbi të gjitha, të varianteve të saj gege, toske e arvanite, të cilat janë variante të vjetra fillestare të paleo-proto-indo-europeanishtes. Nëse e anashkalojmë

këtë element, kërkimeve gjuhësore do t'u mungonte pikënisja gjuhësore e studimeve mbi gjuhën.

Arsyeja e dytë: pjesa dërmuese e kërkuesve që janë marrë me gjuhën shqipe, nuk ishin shqiptarë, por me kombësi të tjera, që do të thotë se shqipja nuk ishte gjuha e parë dhe më e rëndësishmja në komunikimin mes tyre . Kjo lë të nënkuptohet se, me gjithë dashurinë dhe punën shkencore që ata bënin në interes të shqipes, nuk kanë mundur ta kuptojnë në masën e duhur karakterin fillestar, muzikal dhe fjalëformues të kësaj gjuhe e, mbi të gjitha, nuk i njihnin të gjitha dialektet e kësaj gjuhe, veçanërisht varianteve gegë, toskë e arvanitika.

M.B: Po pse veç të huajt janë marrë me shqipen? Tezat e gjuhëtarëve zyrtarë shqiptarë janë rrënuar dhe pothuajse asnjëherë nuk merren seriozisht nga institucionet shkencore europiane dhe amerikane?

AVN: Për arsye se gjuha shqipe ishte një gjuhë e ndaluar të shkruhej e të flitej me “ferman” në Perandorinë Otomane, në mungesë të një shkolle shqiptare mbi gjuhësinë, do të ishte shkolla gjermane, me dy personalitetet më të mëdha të saj, Gottfried Wilhelm Leibniz dhe Franz Bopp, që do të themelonin albanologjinë mbi baza shkencore, jopolitike dhe jonacionaliste. Duke e parë rëndësinë që paraqiste shqipja në rrafshin indo-europian, studiues të tjerë do të ndiqnin traditën e re të Holger Pedersen, Max Vasmer, Trunman etj., që do të merreshin me origjinën e gjuhës shqipe dhe pozicionimin e saj në pemën gjenealogjike. Më pas do të pasonin studiues të shumtë me origjinë hebraike, ku spikatën Norbert Jokl dhe Erich Hamp, ky i fundit si nihilist. Sa i takon Shkollës Lindore, deri më tani ka rënë në sy sidomos rusi Vladimir Orel, i cili do të merrej me etimologjinë e shqipes, por nisur nga pozitat e shkollës *Gramatiste Lindore*, që konsiderohet e paplotë, gati krejtësisht e pasaktë dhe e manipuluar për interesa pansllavistë,

tendenciozë dhe tashmë e tejkaluar. As vepra e Leibniz-it, as vepra e Bopp-it, as e Benllöw-it nuk studiohet në Shqipëri. Ka një censurë të plotë në universitetet shqiptare rreth kësaj vepre madhore, që bazohet mbi shkencën e vërtetë gjuhësore, e cila vazhdon edhe sot, për arsye që, sipas gjasave, janë politike dhe agjenturore. Deri këtu ka arritur mjerimi i Akademisë së Shkencave dhe kjo është një situatë tragji-komediane për të qeshur dhe qarë edhe vetë “Gomari i Babatasit”.

M.B: Mendoni se të gjithë studiuesit sllavë kanë qenë të gabuar dhe të politizuar?

AVN: Jo, s’mund ta them këtë! Pati dhe gjuhëtarë me origjinë sllave, që nuk u ndikuan nga kjo shkollë nacionaliste, ku mes tyre haset gjuhëtari më i mirë i huaj në studimet etimologjike të shqipes prehistorike Georgi Georgiev, i cili zbuloi lidhjet e forta të shqipes së sotme me shkrimet dake (Meosia Danubiane) dhe kulturën karpaticane Vinça, gjë që provohet edhe me shkrimin e parë simbolik në botë “*p’dor*” dhe figurën e xhubletës në piktogramet e Vinçës, duke vërtetuar se gjuha ilire dhe ajo trake ishin gjuhë motra, pavarësisht nga gabimi që bëri, duke thënë se shqipes i mungonin termat detarë. Shqipja ka më shumë se çdo gjuhë tjetër terma detarë, duke filluar me fjalën */*Det*/ të përbashkët me gjuhën *skythe*, që është e një fjalëformimi me formën */*deltë*/ (sipas Leibniz-it).

M.B: Nga gjuhëtarët shqiptarë, kush ka qenë në vijën e Leibniz-it e Bopp-it?

AVN: Korifeu i shqiptarizmës, Pashko Vasa! Nuk ka pasur e as do të ketë më një burrë të ditur si ai mes shqiptarëve. Është një ndër themeluesit e gramatikës së shqipes. Në parathënien e librit të tij “Grammaire Albanaise: A L’Usage De Ce: ux Qui Desirent Apprendre Cette Langue Sans L’Aide D’Un

Maitre (1887), ribotuar nga *Kesinger' Legacy Reprint 2010 USA*, bazuar edhe mbi veprën e Leibniz-it dhe Bopp-it, shprehet me kompetencë shkencore se “*Populli shqiptar, pa dyshim është më i vjetri nga të gjithë popujt që banonin në Europë. Askush nuk mund ta kundërshtojmë këtë vjetërsi në krahasim me gjuhët e tjera simotra, sepse shkenca e gjuhësisë e ka përcaktuar tashmë se ajo rrjedh drejtpërdrejt nga pellazgët, ku popull primitiv origjina e të cilit humbet në mjegullën e historisë*”. Konkluzioni i tij ishte një konkluzion shkencor tërhequr nga vepra e Herodotit, Aristotelit, Platoni dhe Strabonit.

M.B: Ku ka konsistuar puna juaj studimore, në drejtim të shqipes?

AVN: Në gjuhën shqipe ka elemente leksikore dhe karakteristika të ngjashme me gjuhët që gjeografikisht janë afër, me të cilat formon një bashkim gjuhësor ballkanik. Por numrin më të madh të elementeve të saj prejhistorike i ka me gjuhët e largëta gjeografikisht, si ajo proto-sarde, katalane, galiciane e bretone, të cilat janë simotrat e saj proto-indo-europiane. Por çuditërisht shohim elemente të shumta të përbashkëta të gjuhës shqipe me gjuhë të nivelit nostratik, konkretisht me gjuhën baske, ku gjenden fjalë të tilla, si **/Kôk/ (kokë) Suk* (shqiptohet *Suuk*) (*kodërz e vogël*), derr (*txerri-bask*) e mijëra elemente të tjera. Këto elemente leksikore i ka vënë në dukje specialisti i gjuhës baske, Michel Morvan. Por surpriza më e madhe është se gjuha shqipe, nga ana etimologjike, sqaron se është gjuha shqipe varianti i saj gegë, që shpjegon nga ana etimologjike me anë të etimonëve të gjitha fjalët e mësipërme. Sepse fjala **/koka/* rrjedh nga fraza primitive **/ka ôkë/ (ka mend)*, sepse fjala **/okë/* në shqipen gege do të thotë **/mend/* dhe shënjon semantikisht **/kokën si objekt/*, por ka qenë njëkohësisht edhe njësi matëse primitive **/një okë/*, **/ dy okë/*. Ky sistem ka dhënë edhe fjalën shqipe **/shokë/*, formim etimonal me bashkim nga togfjalëshi **/shu(m) okë/*

= */shokë/. Fjala */kokë/ ka një përdorim të madh në shqip dhe përdoret edhe për numërimin e kafshëve, si /pes kokë/dhjetë kokë/ etj. E njëjta logjikë etimologjike mund të zbatohet edhe për fjalën */sūk/ e baskishtes, që shpengohet me shqipen */s'a uī/ plus prapashtesën */k/, që jep */sauik/ = */sūk/ (tokë mbi ujë - tokë e thatë - kodrinëz/, të cilën e gjemë si toponimi afër Tiranës së sotme */Sauk/.

Gjuha shqipe është një gjuhë aksiale, me një mekanizëm kentum në dialektin gegë, ndërkohë që në dialektin toskë kalojmë drejt sistemin “satem” me elemente trako-lidiane (Ballkani i Jugut dhe Azia e Vogël). E njëjta fjalë është e shqiptuar */Sūk/, me */u/ të gjatë dhe pa zanore fundore sipas modelit kentum në shqipen gege, dhe */sūkë/ me **u** të gjatë dhe zanore fundore sipas modelit satem në toskërisht. Interesant është të shihet përshkallëzimi */jūk/ (shungë në kokën e njeriut), */mollūk/ (xhungë sa një kokërr molle) */çūk/ (kodërz e vockël me bar), */sūk/ (kodër mesatare), */shuk/ (e bërë si çukë), dhe */çufkë/ (kodërzë flokësh), që në baskishte nuk gjenden me këtë diversitet. Për të përcaktuar lidhjet etimologjike që shqipja ka me gjuhët e tjera proto-indo-europiane është e domosdoshme për të ndërtuar matematikisht sipas teorisë gjuhësore të matricave gjuhësore historinë metagjuhësore të fjalëve të shqipes që nga fillesa primitive (fonologjia universale e pandryshueshme që vjen nga gjenetika njerëzore) deri në probabilitetet matematikore të kombinimit të fonemave në sfondin fonemik të kombinimit të matricave, sipas rregullave gramatikore që lejojnë ligjet gjuhësore.

M.B: Thuhet se një ndër problemet që ka shqipja është fjalori i përbashkët me gjuhën arumune? Cili është mendimi juaj?

AVN: Duhet të kemi parasysh se romakët krijuan koloni tregtare gjatë rrugëve që rindërtuan, dhe popullata ilire që u vendos aty, për arsye tregtare,

filloi të mësonte latinishten zyrtare. Pra, kemi të bëjmë me vëllezërit tanë dygjuhësh. Janë një numër i madh kërkuesish, si Walter Porzig, Eric Hamp apo Bernard Sergent, që vënë në dukje ekzistencën një leksiku të konsiderueshëm në gjuhën shqipe me “prejardhje” arumune dhe vllahe, apo dhe leksiku i përbashkët me rumanishten, që na bën të mendojmë për një origjinë pjesërisht karpatiane të gjuhës shqipe, e cila ka evoluuar paksa më në Lindje sesa sot, konkretisht në republikën aktuale të Maqedonisë së Veriut, e mbështetur kjo në kulturën megalitike të qytetit të Shkupit dhe zonave përreth, dhe në Serbinë Meridionale (kultura megalitike e Nishin, ku përfshihet edhe kultura Vinça, Tartaria e Dylon. Por kjo hipotezë nuk ka dhe shumë bazament, sepse fiset doko-myzo-gëte (popullata e vjetër e Rumanisë aktuale) ishin gjithashtu tribu të ardhura nga grupi i gjuhëve proto-ilire B (ose pikënisja e gjuhëve të grupit trak), pra ishin pjesë integrale e grupit të gjuhëve ilirike në Gadishullin Ilirik dhe, ana tjetër, të dhënat mbi fiset ilirike datojnë duke filluar me *Shkrimet e Shtyllës Abydos* të faraonit Ramses II, i cili përmend fiset *dardane, dardane, ardiane, achene (asheane), sikule* dhe *ligure*, të cilat morën në betejën e Kadeshit, të etiketuar së bashku si “popujt e detit” përkrah hittitëve, vëllezërve të tyre në Azinë e vogël. Shkrimi në shtyllën e Abydosit ka një rëndësi të madhe jetike për vjetërsinë e popullit shqiptar, dhe njëkohësisht vërteton se etnia shqiptare është shumë më e vjetër sesa etnia greke, sido që termin e parë mbi ekzistencën e etnisë shqiptare në formën e saj të parë si **/Gig/ (geg)*, na e jep Eposi i Gilgameshit në vargun e dytë të tij, kur heroi i veprës i drejtohet Zotit të tij me frazën e famshme: “*En dim gig-ki*” (*e un di geg*).

M.B: Ju për të kryer etimologjinë tuaj mbështeteni te gegërishtja, ndërkohë që origjina e të parëve tuaj rrjedh nga Ohri, pra keni një gjenezë toske?

AVN: Po, si origjinë të lagët jemi ohërjanë nga familja Gropa, dhe e kam për nder. Kam zgjedhur shqipen gege, nisur thjesht nga fakti që kjo formë e shqipes nuk ka pësuar rrotacion. Sa u takon raporteve të brendshme të shqipes, raporteve mes dialektit gegë dhe atij toskë, nuk mund të thuhet se njëri dialekt është më i vjetër se tjetri, pasi burimi fillestar është i njëjtë. Duke u bazuar në raportet që na jep gjeologjia, paleontologjia dhe arkeologjia, duhet pranuar se vendi ku kanë jetuar 3 deri në 5 mijë njerëzit e parë *gig* (gegë), që kanë folur gjuhën arkaike shqipe, janë zonat përreth malit të Tomorit, ku ka dhe artefakte të shumta me gurë stralli 45-48-mijëvjeçarë, të punuar si maja shigjetash dhe mbetje njerëzore, ku për shqiptarët e Greqisë këto mbetje gjenden në Peloponez. Me ngrohjen e klimës dhe shkrirjen e akullit para 12 mijë vjetësh në fund të paleolitikut të vonë, popullsia *gige* (gege) u shpërnda në të gjithë Gadishullin Ilirik dhe kulminoi me prodhimin e parë të një kulture botërore, siç ishte kultura karpatiane *vinça*, nga ku kemi edhe shkrimin e parë. Krahu tjetër i shtegimit të këtij populli primitiv ishte drejt Sumerisë (kultura sumere) dhe drejt Kinës, kultura tokariane (rruga tregtare prehistorike e mëndafshit). Është interesante të thuhet se artefaktet ose shkrimet e ndryshme në gjuhët *vinça*, *sumere*, *tokariane* e *kopre* zbërthehen me shqipen primitive gege dhe korrespondojnë saktësisht me kufijtë aktualë të gjuhëve indo-europiane.

M.B: A ka forma të tjera shkencore që vërtetojnë këto teza, të cilat duhet thënë se janë shumë të avancuara?

AVN: Arkeologjia gjithnjë e më shumë po konfirmon tezën, se vendbanimet e vjetra në Shqipëri janë origjina e zhvillimit teknologjik dhe bujqësor për gjithë territorin europian dhe ka të njëjtën moshë me ato të Azisë së Vogël dhe Zonën Arabike. Rezultatet e kërkimeve mes arkeologëve shqiptarë dhe atyre të Universitetit të Bernës në Zvicër, kanë konfirmuar se vendbanimi i

palafiti në Lin në Pogradecit është më i vjetri në Europë. Kjo përkon me periudhën para-vinça, dhe tregon se përparimi teknologjik i njeriut të sedentarizuar prehistorik është realizuar në saje të një ligjërimi gjuhësor më të zhvilluar, më praktik dhe më fleksibël. Arkeologu zviceran, Albert Hafner, duke vënë në dukje matjet e kryera rreth vjetërsisë së vendbanimit, ka vënë në dukje se bëhet fjalë për vendbanime prehistorike të krijuar mbi 8 mijë vjet më parë, e që mund të konsiderohet pa frikë si më i vjetri në kontinentin europian, pasi vendbanimet në Itali dhe në Zvicër janë rreth 2 mijë vite më të reja. Ndërkohë, shtëpitë prej guri rezultojnë të jenë ndërtuar rreth 5800 vite para Krishtit. Arkeologu Hafner ka konfirmuar: *“Kemi që në vitin 2021 që gërmojmë dhe ndjekim gjurmët që na çojnë deri në 5800 vite para Krishtit. Po gërmojmë për drunjtë e ujit më të vjetër në Europë. Në Zvicër kemi gjetur 6000 vite të vjetër, ndërsa këtu kemi gjetur deri në 8000 vite të vjetër. Banorët këtu kanë qenë fermerë. Nga gjetjet mund të themi që është palafiti më i vjetër në Europë”*. Pra, nuk jam veç unë, është gjithë bota arkeologjike, gjuhësore dhe gjenetike që bie dakord në një pikë: shqiptarët janë shumë të vjetër, për të mos thënë fillimi.

8. KOMENTI

8.1 Akademik Artan BORIÇI*

Një komb një qëndrim, jo një komb e dy luftëra

Në kontekstin e një lufte çlirimtare në Kosovë, që do të çonte në pavarësinë e Kosovës pas një faze tranzitore, edhe Shqipëria ndodhej përballë një trysnie të lartë serbe. Çdo njeri bashkohet me tezën, se pavarësia e Kosovës do të sillte një ringjallje të virtyteve të kombit shqiptar dhe çeljen e rrugës drejt prosperitetit dhe baraspeshë me fqinjët. Në këtë mënyrë prishet një baraspeshë shekullore në dëm të shqiptarëve, gjë që nuk mund të pranohet nga fqinjët tanë.

Një gjë është e qartë për Serbinë, por edhe për Greqinë deri diku: pavarësia e Kosovës është një vepër e pandalshme, e parë në perspektivë. Në rrethanat kur Serbia mbetet shteti i fundit diktatorial në Europë, ka një interes të shtuar atlantik për zgjidhje të shpejtë të problemit kosovar, interes të cilin as Serbia dhe as Greqia nuk mund ta ndalin.

Duket se viti 1999 do të jetë një vit i rëndësishëm në Kosovë dhe për këtë shtetet fqinje janë në një trysni të madhe për përballimin e një disfate të tyre në favor të së drejtës shqiptare. Është e palogjikshme të mendosh se këto dy shtete, në mos edhe të tjera nuk kanë vënë në dispozicion të gjithë arsenalin e tyre për të penguar faktorin shqiptar në Ballkan drejt prosperitetit. Nëse pavarësinë e Kosovës s'do të mundin ta pengonin ato, veçanërisht Serbia, do të synojnë destabilizimin e Shqipërisë. Rastet e rrëzimit të shtyllave të tensionit të lartë që janë konfirmuar në shtypin shqiptar janë vepër e Serbisë. Nga ana tjetër, Millosheviqi deklaroi se për vitin 1999 ai pret një Kosovë multietnike, që do të thotë spastrim etnik të shkallës së gjerë.

Përveç larjes së hesapeve me shqiptarët e Kosovës, ai dëshiron që konfliktin ta mbajë në Shqipëri, duke shpërngulur kosovarët me dhunë drejt Shqipërisë. Qëllimi final duket se është një kaos si ai i 1977-ës dhe më pas një ndërsim i shqiptarëve ndaj njëri-tjetrit. Në atë rast komuniteti ndërkombëtar do të dërgonte një “Alba 2” me qëndrim shumë të gjatë dhe askush nuk mund të pengonte asimilimin e ngadaltë të një prej pjese të shqiptarëve në kultura të tjera, një proces që për disa politikanë shqiptarë gjen shprehje në optikat e tyre të integritit.

Sot, pas më shumë se gjysmë shekulli shqiptarët kanë të drejtën e tyre për t’u integruar me vendet e përparuara të kontinentit. Kjo është një kërkesë natyrore e çdo shqiptari, por mënyra drejt integritit është shumë e rëndësishme. Kjo theksohet veçanërisht, sepse në kushtet e varfërimit total të shqiptarëve, asimilimi i ngadaltë i një pjese të shqiptarëve në një hapësirë kohore prej disa brezash, nuk mund të shitet si proces integrimi të shqiptarëve në Ballkan.

- **Së pari**, shqiptarët humbasin identitetin gjuhësor dhe me të, më vonë, edhe kulturor. E ky lloj integrimi nuk është ai për të cilin shteti shqiptar ka kuptim të ekzistojë.

- **Së dyti**, integrimi fillon lokalisht dhe nuk mund të kuptohet pa partnerë pak a shumë të barabartë, e shqiptarët sot nuk janë të përgatitur për këtë, prandaj duhet të krijojnë mekanizma të mbrojtjes së identitetit edhe në këto kushte.

Një mekanizëm është uniteti i brendshëm shqiptar, që sot duhet më shumë se kurrë. Ne, shqiptarët, nuk mund të eliminojmë ndikimin e shpërthimit të luftës në Kosovë, por, së paku, duhet të jemi në gjendje që një bartje e luftës nga Kosova në Shqipëri të mos i ndryshojë asaj thelbin, të jetë luftë e një kombi për të fituar të drejtën e tij në të dyja anët e kufirit. Bartja e luftës duke ndryshuar palët në konflikt me të kaluar kufirin është e papranueshme: historia nuk do të na falë një luftë vëllavrasëse.

** Në kujtim dhe nderim të akademikut Artan Boriçin, kësaj mendjeje të ndritur të shkencës shqiptare, që pandemia e mori para kohe, po risjellim këtë analizë të publikuar fillimisht te “Gazeta shqiptare”, Tiranë, më 15 janar 1999*

8.2 Melazim KOCI

Athina dhe Beogradi synojnë përcarjen e faktorit shqiptar

Samiti i Athinës i ftuar nga kryeministri Micotakis ishte vetëm “maja e ajsbergut” të një projekti afatgjatë, që sërish shpërfaqti koordinimin greko-serb, për përcarjen dhe marginalizimin e faktorit shqiptar në Ballkan. Mosftesa për kryeministrin Edi Rama nuk mund të justifikohet me rastin Beleri” dhe është evidente që, pos të tjerash, kishte synim thellimin e përcarjes ndërshqiptare.

Mjerisht, përcarja Tiranë-Prishtinë kishte filluar shumë më herët dhe fillimet i ka të “Ballkani i Hapur”, që para do kohësh u braktis njëanshëm nga Edi Rama. Kërkesat e sërishme të Beogradit, Shkupit dhe disa faktorëve të tjerë të jashtëm që “Ballkani i Hapur” të mbetet i gjallë, paralelisht me “Procesin e Berlinit”, katërçipërisht e bëjnë të qartë se ky projekt tinëzar dhe antishqiptar nuk ka asnjë funksion tjetër, pos përcarjes së Kosovës dhe Shqipërisë. “Ballkan i Hapur” nuk është gjë tjetër, pos ide e vjetër e politikës serbomadhe “Ballkani - ballkanasve”, përmes së cilës aktualisht marginalizohet Kosova, ndërsa në plan afatgjatë synohet përjashtimi i fuqive të mëdha nga zgjidhja e kontesteve në këtë rajon. Rikthimi i “Procesit të Berlinit”, që ka bazament gjashtë subjekte të barabarta shtetërore, ka goditur në themel “Ballkanin e Hapur” dhe fuqizon faktorin shqiptar (dy subjekte shtetërore) dhe, rrjedhimisht, ka frikësuar boshtin Athinë-Beograd.

Në këtë prizëm duhen analizuar dhe vështruar manovrimet e Athinës dhe Beogradit, që synojnë rol liderist në Ballkan. Nëse synimi i Athinës për liderizëm në Ballkan deri diku mund të kuptohet (anëtare e NATO-s dhe BE-së), ndonëse jo edhe të miratohet, synimi i Serbisë për të aktruar liderin e Ballkanit është falsitet. Deklarimet e disa diplomatëve për pozitën qendrore

të Serbisë në Ballkan dhe, rrjedhimisht, koncesionet që i bëhen, janë shpifje. Ato bëhen “për të zbutur” përkohësisht Beogradin dhe për të shmangur një konflikt tjetër në Ballkan, deri në përfundim të luftës në Ukrainë. Pa dalje në det, e rreshtuar pas Rusisë dhe e rrethuar nga vendet anëtare të NATO-s, Serbia është shumë larg të qenit faktor dhe qendër e Ballkanit.

Parë nga këndi i gjeopolitikës, pozicionin qendror në Ballkan e disponojnë Shqipëria dhe Kosova, sepse bashkërisht kontrollojnë hapësirën që shtrihet nga Otrantoja deri te Maja e Paçiqit. Këtu qëndron dhembja dhe frika e Athinës dhe e Beogradit.

Synimi i Serbisë për të aneksuar Veriun e Kosovës nuk ka objektiv vetëm pasuritë minerare, por edhe Majën e Paçiqit, prej nga kontrollohet i gjithë Ballkani.

- A do të dinë shqiptarët të kapitalizojnë këto favore gjeopolitike?

Fillimisht do të duhej të ruanin dhe thellonin aleancën me garancinë e sigurisë dhe demokracisë në Ballkan, Europë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Hapi tjetër është flakja e përçarjes në raportet Tiranë-Prishtinë, që pos të tjerash, po e kultivojnë Athina dhe Beogradi.

Kohët e fundit Shqipëria dhe Kosova po të hartojnë piketa të përbashkëta në politikën e jashtme dhe kjo nuk duhet të frikësojë askënd, sepse ne jemi nën ombrellën e sigurisë euroatlantike (Shqipëria - anëtare e NATO-s, Kosova - zgjatim i NATO-s).

Si fillim do të mjaftonte që Tirana zyrtare të rikonfirmojë se, në asnjë rrethanë, nuk ka kthim të “Ballkani i Hapur”, ndërsa Prishtina të lërë pas hatërmbetjet e viteve të fundit.

Duke qenë unikë dhe të bashkuar zëmë pozicion qendror në Ballkan, sa as Greqia dhe aq më pak Serbia nuk mund të mos na marrin në konsideratë.

8.3 Emin AZEMI

Perëndimi po ia vesh lëkurën e qengjit ujkut të dikurshëm të Millosheviqit!

Perëndimi gabon, që nuk po e ndihmon Serbinë, por Vuçiqin, duke e lënë vathën e deleve në gojën e ujkut dhe me këtë, pa nevojë, po humb kohë dhe para. Serbia mund të demokratizohet një ditë, por pa Vuçiqin, prandaj Perëndimi duhet ta ndihmojë atë të bie sa më shpejt nga pushteti. Në të kundërtën, Serbia një ditë ka rrezik të shndërrohet në një vathë ujqish të tërbuar.

Raportet Kosovë-Serbi nuk po komplikohen. për shkak të qëndrimeve të forta të Kurtit, por për shkak të qasjes së njëanshme e joproportionale të Perëndimit ndaj këtyre raporteve. Nëse para 24 vjetësh Perëndimi e bombardoi Serbinë për ta larguar atë nga marshimi hegjemonist në Kosovës, sot i njëjti Perëndim po e dekonstruktin kauzën e vet të drejtë. I njëjti Perëndim po ia vesh lëkurën e qengjit ujkut të dikurshëm të Millosheviqit.

Duke e mbështetur qorrazi një pinjoll të Millosheviqit në Beograd (lexo: *një këlysh ujku*), Perëndimi nuk po e ndihmon Serbinë që të largohet nga Rusia, por po ia zgjat jetën një regjimi autokratik, i cili u ngrit kryesisht duke pasur frymëzim politik antiperëndimore të Kremlinit.

Perëndimi po gabon që nuk po ndihmon dot Serbinë, por Vuçiqin, duke e lënë vathën e deleve në gojën e ujkut dhe, me këtë, po humb kohë dhe para pa pasur nevojë. Serbia mund të demokratizohet një ditë, por pa Vuçiqin, prandaj Perëndimi duhet të japë ndihmën e tij që ai të bie sa më shpejt nga pushteti. Në të kundërtën, Serbia një ditë ka rrezik të shndërrohet në vathë ujqish të tërbuar.

Perëndimi ka përvojë të mjaftueshme se si duhet të sillet në rrethana të caktuara me politikanët serbë. Millosheviqi ishte një shembull shkollor, që i kujton Perëndimit mendësinë e një politike, e cila nuk e njeh dialogun, por vetëm forcën e bombave të NATO-s. Vuçiqi tani po sillet njësoj, si Millosheviqi dikur, ndërkohë që Perëndimi ka ndryshuar. Vuçiqi refuzon të vërë sanksione ndaj Rusisë dhe trash miqësinë me kinezët; instrumentalizon serbët e Kosovës për llogari të “botës serbe”; kontrollon dhe shantazhon mediet dhe intelektualët; aeroportin e “Surçinit” në Beograd e ka shndërruar në parajsë transiti të hajdutëve të kamur të Kremlinit që ndodhen në listat e zeza amerikane; u krijon kushte që, pa u penguar, mediet e Putinit, “Sputnik” dhe “Russia Today”, të helmojnë eterin etj.

As vetë Vuçiqi nuk ka pritur se Perëndimi do të jetë kaq zemërgjerë me të edhe pas krejt këtij qëndrimi antiperëndimor që ka ai. Vuçiqi thjesht po habitet me katarsisin negativ të Perëndimit, i cili ka zgjedhur të kompensojë politikat e drejta ndaj Kosovës me njëfarë shfajësimi absurd ndaj Serbisë. Prandaj Vuçiqi pa asnjë pengesë “ka marrë peng” policë në territorin e Kosovës dhe urdhëron huliganët të rrahin gazetarët shqiptarë të Prishtinës. Vuçiqi tani e di saktësisht se çfarë qëndrimi do të mbajë Perëndimi pas çdo padrejtësie që i bëhet Kosovës. Prandaj ai përmes Listës Serbe ngulfat pluralizmin politik të serbët e Kosovës, duke minuar çdo urë bashkëpunimi konstruktiv me Qeverinë e Kosovës. Kjo e fundit po sillet normalisht, si çdo qeveri, që ka synim të pastër administrimit e të gjithë territorit, përmes ligjeve dhe rregullave të mirënjohura demokratike.

Në veriun e Kosovës aktualisht kryqëzohen dy mendësi politike: ajo mesjetare e përfaqësuar nga politika proruse e Vuçiqit dhe ajo Perëndimore demokratike e përfaqësuar nga Albin Kurti.

Disa burokratë të Brukselit, me në krye Josef Borrellin, kanë zgjedhur të mbështesin politikën mesjetare proruse të Beogradit në Kosovë dhe të

shantazhojnë politikën properëndimore të Qeverisë në Prishtinë. Borreli dhe Lajçaku në fakt nuk kanë lidhje me parimet demokratike mbi të cilat është ngritur Europa e Bashkuar, sepse ata, para se të jenë europianë, parapëlqejnë të jenë spanjollë dhe sllovakë. Me valixhet diplomatike të BE-së ata kontrabandojnë thërmija të rrezikshme të mendësisë politike të vendeve të tyre, që nuk e njohin shtetin e Kosovës. Për rrjedhojë, Borreli dhe Lajçaku janë duke ia nxirë imazhin Europës demokratike, e cila është bërë peng i një politike të jashtme, që vazhdon ta shohë Kosovën me syzet e Vuçiqit!

Shkup, qershor 2023

IX. RECENSIONE

9.1 Dr. Elvis HOXHA

Për dijen autoktone të ambasadorit Shaban Murati

Librat e ambasadorit Shaban Murati janë përherë një rast i veçantë i përqendrimit të të dhënave historike dhe diplomatike. Personalisht për mua janë rileximi i ngjeshur i një informacioni të përqendruar. Një reflektim i tillë profesional ma kursen kohën e një pune në një rrafsh krejt tjetër.

Duke mos qenë e mundur të mbuloj gjithçka në lidhje me sasinë e përditshme të informacionit dhe me përjetësinë e cilësisë së dijes, llojet speciale të librave vendosin në hapësirën e pak ditëve ngjarje që kanë zënë kohë dhe që, për t'u përdorur mirë, kanë nevojë për korrektësinë kronologjike. Secili prej nesh është ose duhet të jetë në vetvete kolektiv disiplinash.

Besoj se në kushte të tjera ambasadori nuk do të na propozonte kronika analitike, por vetëm monografi mbi temat. Në aktualitetin tonë të cekët, ambasadori Murati na vë në letër atë çka i mungon kujtesës institucionale, kujtesës historike, kujtesës gjeopolitike dhe kujtesës në të drejtën ndërkombëtare. Nga fusha ime do të preferoja të lexoja monografi, por nga këndi i ndërgjegjes publike aktuale ndaj tërësisht qasjen e ambasadorit. Ndaj dhe më poshtë do të konsideroj dy librat, që po analizoj si përfaqësues të gamës ku lëviz reflektimi i ambasadorit, gamë në të cilën gjejmë një lëndë sa të re për shkak të harresës, po aq edhe të domosdoshme, për shkak të mungesës. Lokalizimi i faktit, si lëndë gjithnjë e re dhe si moment që thyen perceptimin, kërkon një aftësi specifike.

Nuk është hera e parë që përdor enumeracionin e fakteve për të dëshmuar vlerat e librave të z. Murati. Faktet që përzgjedh nuk janë

shteruese, por mjaftojnë, në opinionin tim, për të ilustruar përthyerjet e mendimit në një të tashme aktive. Perceptimi kyç që na ofrohet nga tekstet e ambasadorit Murati lidhur me diplomacinë mund të thuhet shkurt: e shkuara është më afër sesa duket. Do të thosha se dy librat ndryshojnë në optikën e tyre: do të vlerësoja se “Antitabu për filozofinë filotabu shqiptare” ka përbërësit e ditarit historiko-politik, ndërsa “Aleanca e duhur Shqipëri-Kroaci” ka përbërësit e ditarit gjeopolitik.

Shënime mbi librin “Antitabu”

Në letërsi librat me fakte janë të shpeshtë, por jo shumë shpesh ata arrijnë të ndërtojnë faktologji. Dhe nuk është radhitja e fakteve që dështon, por më shumë lokalizimi i diçkaje si fakt. Fakti përcaktohet, në mbarësinë e vet si fakt, nga aftësia e perceptimit. Ndërsa vetë aftësia e perceptimit varet nga dija e fushës. Nga dija e fushës kalohet tek aftësia për të shquar simptomat. Në fund të fundit, të dish do të thotë të dish të shohësh, të dish çfarë të shohësh, të dish të gjykosh mbi çka sheh.

Ky mund të jetë fare mirë përcaktimi i autoktonisë së dijes. Autoktonia sjell mbi fushat atë faktologji lokale, që e bën një shkrimtar të domosdoshëm. Në shoqërinë tonë, aktorët autoktonë të dijes janë shumë të rrallë. Por ç’ mund të na ofrojë autoktonia e dijes?

- Aftësi shqyrtimi të së drejtës kombëtare nisur nga e drejta në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare.
- Njohje të thellë informuese, sidomos nga rajonet që prodhojnë rrezik ekzistencial.
- Përvojën e zbatimit në misionin si ambasador të një ndjeshmërie estetike dhe aftësia për të krijuar emfazën e nevojshme për rrokjen e kuptimit.
- Aftësi të shtrimit logjik dhe ekonomik të problemit.

Të gjithë këto pika shërbejnë si momente përbërëse të dijes autoktone dhe sjellin natyrshëm faktologjinë në shkrimet e z. Murati. Nga ky pozicion autoktonie ne mund të ndërtojmë një përvojë tjetër, rrëfenjën e kthjellët të humbjes së ekzistencës në përfaqësim.

Dy vëllimet e librit “Antitabu” lëvizin nëpër dëshmi telegrafike, por të thukëta, mbi aleancën e madhe mes ligësisë përfaqësuese dhe injorancës masive në lidhje me çështjet publike dhe politikën e historisë. Nëse injoranca masive e ka burimin te pasiviteti dhe prodhon kompleksin e inferioritetit, ligësia është aktive dhe zbeh rolin e subjektit.

Z. Murati e artikulon kompleksin e inferioritetit, zhbërjen e institucionalizuar të përfaqësimit në qindra tekste të vogla dhe kuptimplote. Janë telegrame që i dërgohen lexuesit emergjent. Veç të tjerash, propozimet e tipit “Këshilla për miqtë” janë një akt i kulluar pedagogjie për vëmendjen.

Në këtë paraqitje, rëndësinë e dy librave do ta shpreh përmes shembujsh ose faktesh, duke qenë i vetëdijshëm se nuk janë aspak shterues. Shembujt më poshtë janë temat më të shpeshta në shënimet e ambasadorit Murati.

Shembull 1: Ne përkujtojmë viktima dhe heronj, por kurrë nuk themi se cili ishte armiku, që i prodhoi viktimat tona dhe kundër të cilëve luftuan deri në vetëmohim heronjtë tanë. Akti i pari që ndërmerr një shtet i papërgjegjshëm institucionalisht, është prodhimi i një historiografie anonime: shumë luftë, por pa armiq.

Shembull 2: Ne biem në cikle të mbyllura, duke kërkuar me ngulm “Ballkan të Hapur”. Cikli që po përmbillet në këtë dekadë është ai i kalimit nga Titoja te Vuçiqi, duke konsumuar besnikëri perandorake ideologjike (Rusi e Kinë, Stalin e Mao) në bazë të të cilëve prodhuam viktima së brendshmi. Nga integrimi i ekonomik me Jugosllavinë në 1946-ën, te “Ballkani i Hapur” në vitin 2020, me qëllimësitë tona zyrtare të importuara duket se ekzistenca e

shqiptarëve është mjet për projektet jugosllave, projektet e sllavëve të jugut. Pra, jemi një popull, që shërben sipas regjimeve, shqiptarë si lëndë e parë për afirmimin e sllavëve të jugut. Le ta konsiderojmë si qark të shkurtër, por si kurth të përjetshëm.

Shembull 3: Ne nuk marrim kurrë mësim nga sjelljet e shteteve, por shpikim teprinë e shtetit në lidhje me shqiptarët dhe mangësinë e shtetit në lidhje me ndërkombëtarët. Pra, prirja e shteteve tona është zvogëlimi i kombit në mënyrë shtetërore.

Shembull 4: Ne e paraqesim botën si një perandori, në të cilën fatalisht jemi viktimë, autoktonisht viktimë - vetia e vetme që kemi si autoktonë. Ne rrekemi për shtetet tona, por që këto shtete t'u japin frymë perandorive të tjerëve. Për ta përmbyllur në mënyrë koherente këtë kurth që i bëjmë vetes, ne duhet ta reduktojmë më së pari shoqërinë shqiptare në grumbull krahinash. Pra, së jashtmi viktimë perandorake, së brendshmi agresivë krahinorë.

Shembull 5: Nën emrin “shkencë” ne themelojmë një masë njohurish që flasin për mohimin e vetes. Më vjen keq që shprehem kështu, por ky është përdorimi më i ndyrë i subjektit: me shkencën dhe historiografinë ne organizojmë zhdukjen e subjektit tonë. Pasiviteti i shoqërisë prodhon papërgjegjshmërinë e përfaqësimit. Ky përfaqësim i dobët bëhet së brendshmi pushtet i nënshtrimit të potencialeve, kurse së jashtmi objekt i nënshtruar pa dijen më të vogël të reciprocitetit. Pasivitetit të shoqërisë i kundërvihet autoktonia e shkencës. Dhe meqë autoktonia e shkencës është albanologjia, kohët e fundit Akademia e Shkencave ndërmori sulmin dhe eliminimin e Institutit të Antropologjisë, ashtu si qeveria zhduku në mënyrë sistematike të gjitha qendrat e artit dhe institutet. Kështu që shohim se si shkenca jonë institucionale është kundër autoktonisë, me një shënjes të madh: shkenca jonë zyrtare u vendos dyfish kundër kombit: me mënjanimin

e Kosovës nga të drejtat e pavarësisë dhe integritetit territorial; me harrimin e Kosovës si çështje kyç.

Shembulli 6: Dija jonë zyrtare, që nuk është kurrë vetëdije, e bën një popull të deklarohet kundër vetvetes nëpërmjet gojës së udhëheqësit të vet. Kompleksi i inferioritetit, i edukuar në dekada, e kthen këtë popull në refugjat potencial ose mercenar aktiv. Nëse ju lexoni me vëmendje rilindësit shqiptarë, Shaban Murati bëhet drejtpërdrejt anëtar me të drejta të plota i aradhës së rilindësve. Ndërkohë shteti, institucionet shkollore deri tek akademia prodhojnë një histori, ku gjejnë frymëzim vetëm kontabiliteti i mercenarit dhe fataliteti i refugjatit.

Shembulli 7: Lehtësia dhe efektiviteti me të cilët z. Murati analizon sjelljen e armikut na shpie në konkluzionin se, me punë sistematike dhe kolektive, është shumë e thjeshtë të jemi shtet normal, ku mund të organizohen burimet dhe inteligjencat individuale. Përkundër kësaj qëndron indiferenca e përgjithësuar e opinionit ndaj terminologjisë, vendosja në pritje të përcaktimit nga të tjerët, zgjedhja për të mos zgjedhur një qëndrim.

Shembulli 8: Ligësia operon me format e levantianëve kozmopolitikë dhe trashëgimtarëve të komunistëve tashmë pa ideologji. Të dy shpallin se kurthi historik është Kosova, dhe se shpëtimi është një Botë Lindore.

Shembulli 9: Zhbërja institucionale në tri dekada, por me hapa të shpejtë në dekadën e fundit: dëmtimi i përfaqësimit të Kosovës, dëmtimi i kufijve të Shqipërisë me detin, dëmtimi i njësisë politike të truallit me varreza ushtarësh grekë, dëmtimi i jugut të Shqipërisë me idenë e një asociacioni të mundshëm grek për të relativizuar dhe përgjithësuar Republikën Sërbska në veri.

Shqipëria zyrtare zotëron dijen enciklopedike të vogëlsisë së vet, duke shfaqur pareshtur shenja përuļjeje ndaj shtetit grek në jug, nga i cili merr si përgjigje ligjin e luftës dhe mohimin e masakrës ndaj popullsisë çame, dhe

një shteti në veri, Serbisë, nga e cila merr si përgjigje mosnjohjen e gjenocideve të kryer mbi shqiptarët, në veri e në lindje të kufijve tanë londinezë.

Shembulli 10: Dëmtimi zyrtar i anëtarësimeve tona në strukturën euroatlantike të NATO-s me dy sjellje:

1. përkëdhelje e Greqisë që mban ligjin e luftës, akt me të cilin ne vetë e shtyjmë shtetërisht NATO-n në paradoks;
2. përkëdhelje e Serbisë me projekt të hapur ndaj jugosllavizmit, projekt i përbashkët me shtetin kundër NATO-s, projekt me të cilin ne vëmë në dilemë NATO-n në lidhje me anëtarësinë tonë.

Ne fyejmë të gjitha federimet që janë jetike për ne. I tillë është fjalimi njëorësh i kryeministrit Rama në Këshillin e Europës, pikërisht kur Kosova po përgatiste aplikimin për anëtarësim në Këshillin e Europës. Për shqiptarët e tabuve, “Ballkani i Hapur” prej Serbisë është më i rëndësishëm se europianizimi i Kosovës së pavarur.

Shembull 11: Shpërbërja e popullit shqiptar në pakica, me cense të shpikura e të sponsorizuara, ndërkohë që lihen pa mbrojtje pakicat tona në shtetet që na rrethojnë.

Shembull 12: Krijimi i një populli imagjinar, atij jugosllav, duke dëmtuar zyrtarisht, në çdo rast që ofrohet, popullin shqiptar në vijimësinë e vet fizike dhe historike. Me deklaratën e tre liderëve të “Ballkanit të Hapur”, në 18 dhjetor 2021, e cila nis me fjalët “Dëshira e popullit tonë...”, ambasadori Murati na dëfton një prej akteve më të përsëritura, edhe pse më i papërgjegjshmi i aleancave me armikun ekzistencial. Në vend të dhjetëra notave të protestës që duhet të kishte bërë Ministria e Jashtme për deklaratat serbe dhe greke, ne bëjmë deklaratat kundër qeverive në Kosovë. Për këtë, Z. Murati formulon konstatimin e rëndë dhe të rëndësishëm: “Zhbërja e kombit nis me mohimin e shumicës së kombit”.

Shembulli 13: Shumë shpesh rikthehen në shënimet e ambasadorit dëshmitë se për marrëdhëniet mes shteteve të shqiptarëve është e domosdoshme dakordësia e Serbisë, ndërsa për marrëdhëniet e Shqipërisë me Serbinë, Kosova është një prani e tepërt ose edhe e panevojshme.

Shembulli 14: Detyrat që nuk ka kryer shteti shqiptar në cilësinë kushtetuese të shtetit shqiptar, përkundër mbrojtjes së paepur për Serbinë në të gjithë organizmat ndërkombëtarë, ku ajo ka forcën e fjalës. Pra, në Perëndim, falë deklaratave të përfaqësuesit të Republikës së Shqipërisë, ndërkombëtarët njohin një popull shqiptar, që nuk përkon aspak me popullin shqiptar.

Le të themi se korruptimi i politikës shqiptare në çdo rrafsh ka nisur me korruptimin e idesë së kombit. Ndaj, cilido prej nesh, që habitet se përse ne jemi shoqëri e korruptueshme, harron se ne kemi lindur dhe jemi edukuar, në mënyrë sistematike, shkencore, historiografike dhe arsimore, me idenë e kombit të korruptuar: me pranimin fatal të idesë së kombit të ndarë që në pikënisje.

Shkenca zyrtare është e themeluar mbi idenë e korruptuar të kombit, e ka instaluar këtë korruptim në vullnetin e popullit, funksionin e shtetit dhe reflektimin e shoqërisë. Kosova po tregon një shembull të ri, i cili nuk i shërben aspak kryeministrit aktual të Republikës së Shqipërisë dhe as idesë së “Ballkanit të Hapur”.

Për të gjithë faktologjinë lidhur me mangësitë shtetformuese, shënimet e ambasadorit Murati i takojnë një pedagogjie sa efektive, aq edhe të domosdoshme. Unë i përdora në mënyrë shumë të shpejtë e të shkurtër, por ju mund të zbuloni vetë tema të tjera, përmes shembujsh të tjerë.

Lëvizje në rrafshin e librit “Aleanca e duhur Shqipëri-Kroaci”

Tjetër temë, tjetër gamë. Ky është rasti i një libri që u kushtohet marrëdhënieve rajonale, specifikisht marrëdhënieve me Kroacinë si me një model në sjelljen diplomatike dhe juridike sovrane. Përdorimi si model është dhe vektori kryesor i miqësisë. Modeli me të cilin vendosim marrëdhënie përbën karakterin e marrëdhënieve ose, ndryshe, subjekti me të cilin vendosim një marrëdhënie, është modeli i vetë marrëdhënieve. Për publikun e gjerë, që jeton kohën politike dhe diplomatike në kontekstin klaustrofob të debateve dhe replikave, që mbushin çdo mbrëmje studiot televizive, të përfytyrimit të politikës në inteligjencën afatshkurtër të analistëve, librat e ambasadorit janë riaftësimi i mendimit, janë një forcim i imunitetit të vetëdijes.

Tema e këtij libri është e hapur që në titull: nëse duam një Ballkan të paqes dhe drejtësisë, atëherë aleanca orientuese perëndimore, integruese në rrafshin gjeopolitik, strategjik, ekonomik, ushtarak, politik, demokratik, historik, është ajo mes Shqipërisë, Kosovës dhe Kroacisë. Çdo aleancë tjetër e imagjinuar është dëm në kohë, në energji dhe të ardhme. Pa kujtesën institucionale, ne rrezikojmë të përvetësojmë imagjinatën e rrezikshme të ndonjë bashkëpunimi të dëmshëm.

Strategjia e çdo pushteti të përkohshëm në Republikën e Shqipërisë ka lindur dhe është ushqyer në cektësinë afatgjatë të shoqërisë. Kjo do të thotë se ajo ka vendosur aleancën e moshës së shkurtër të një pushteti në harresën e armikut historik. Tema që rend nëpër tekstet e z. Murati është përdorimi i gabuar i aleancave: aleancat zyrtare kanë qenë mohim i historisë së armiqësisë.

Ku e ka burimin kjo cektësi afatgjatë? Natyrshëm, në devizën që korruptimi i brendshëm duhet të vazhdojë si korruptim i jashtëm. Dhe për këtë nevojitet ushtrimi afatgjatë i vesit të cektësisë.

Kjo cektësi na vjen vetëm burimisht nga harresa e faktit, nga mungesa e prirjes për faktologji. Të rrethuar prej medieve, që fabrikojnë qëndrimin më imediat dhe replikat më imediate, ne kthehemi në një shoqëri që njësohet me vendin e harresës së librave më memorialë. Në medie na fabrikohet ditë për ditë e njëjta metodë: *telenovela*. Kjo metodë ka për funksion zhdukjen e arsyes, ndërsa për sukses ka rrënimin e shkakësisë së ngjarjeve. Vijimësia e saj mbështetet mbi harresën dhe ngatërresën. Telenovela përkëdhel mungesën e vullnetit për ndjeshmëri dhe besnikëri të lartë... ndaj vetes. Ajo i kundërvihet filmit të vërtetë duke mobilizuar shijen për banalitetin. Debati i përditshëm ka për mision të përkëdhelë përtacinë për të lexuar librat memorialë. Mediet janë ndihmësi kryesor i heshtimit politik dhe publik të kombit në mënyrë zyrtare në opinionin e brendshëm. Misioni i tij është i qartë: publiku duhet të projektojë mbi veten vetëm çka është banale në skenën publike.

Ndihmësi i dytë i heshtimit politik dhe publik në opinionin e jashtëm, është diplomacia jonë. Me sinqeritet, me ndërgjegje të qartë, me njohje të sendit e deklaroj fare thjesht se ne kemi dhe kemi pasur masivisht ambasadorë me kompleks të fortë inferioriteti. Ky kompleks inferioriteti ka si synim të lehtësojë kompleksin e dhunës që shefi i madh ushtron ndaj shoqërisë sonë. Një diplomaci e heshtur jashtë, vë në gjumë një popull brenda. Cektësia e shoqërisë është ushqyer dhe ka ushqyer mungesën e diplomacisë: kompleksi i inferioriteti ndaj të huajit është besnikëri ndaj një kryetari shteti me kompleksin e superioritetit ndaj popullit të vet.

Kosova duhet të dërgojë urgjentisht librat e zotit Shaban Murati në të gjitha ambasadat tona. Diplomatët tanë duhet t'i lexojnë sistematikisht. Mund t'u garantoj se një diplomat që lexon libra të tillë, të shkruar nga z. Murati e nga një numër i vogël studiuesish të tjerë, nuk do të mbartë më me

vete asnjë kompleks inferioriteti. Ai do të kuptojë se krenaria e dijes dhe fuqia e faktit flasin edhe në shqip. Kjo është dija sovrane.

Kështu që me lehtësi, në komunikimin e çdo rendi, diplomati ynë do të mposhtë lehtësisht çdo interlokutor, çdo bashkëbisedues europian që, në të vërtetë, nuk di sistematikisht asgjë për Shqipërinë, Kosovën apo kushtin e shqiptarëve në Maqedoni të Veriut, Mal të Zi e Serbi. Mjafton që diplomati ynë t'i radhisë një ndërkombëtarit nja 10 fakte dhe do të fitojë kohë, prani dhe rëndësi, për aq kohë sa ndërkombëtarit do t'i duhet të gjejë ndonjë këshilltar e ca përgjigje. Ndërkohë, diplomati ynë do të ketë kohë të aktivizojë njohjen e vet në lidhje me dhjetëra fakte të tjera. Kjo është loja agresive në diplomaci, në diplomacinë e faktit. Këtë ne nuk e kemi bërë kurrë. Për ne diplomacia është arti i urtësisë, jo në kuptimin intelektual të reflektimit, por në kuptimin moral të përvulësisë. Diplomati ynë duhet të jetë i zgjuar e jo i sjellshëm.

E them sërish, ne nuk i kemi lexuar librat e rilindasve. Emri i rilindësit nuk ekziston në mediet shqiptare. Sjelljet e rilindasve tanë nuk janë shembull që studiohet nga diplomatët gjatë edukimit të tyre. Analitika rilindëse nuk bën pjesë në edukimin shkollor. Vetëm në kohë lufte ne e ngjallim përkatësinë rilindëse.

Sipas një vëzhgimi filozofik, çdo kohë e ringjalljes është një neoklasicizëm (Badiou). Çdo përfytyrim që e nxjerr një komb si të domosdoshëm në peizazhin botëror është një rilindje, qoftë edhe romantike. Rilindësit janë aty dhe në çdo kohë. Rilindësit nuk janë në të shkuarën, janë gjithmonë mes nesh. Lypset t'i mendojmë dhe vlerësojmë librat, ata që na rilindin si libra, si libra rilindësish. Zyrtarisht, misioni shtetëror është të shuajë ekzistencën e tyre duke e vendosur emrin e Rilindjes mbi formacionin ekzekutiv të ndonjë partie, mbi qeverinë e saj. Jo! Rilindësi është subjektim, dhe vetëm subjektim.

Gjatë gjithë kohës së këtij reflektimi, unë mbaj në mend se fakti që kemi një ambasador të tillë, një shkrimtar mbi marrëdhëniet ndërkombëtare dhe mbi peshën institucionale, përbën modelin e duhur të diplomacisë: atë të zbulimit të temave të gjithkohshme, pra të Rilindjes. E meqë puna rilindëse është e çdo dite, edhe diplomacia është punë e përditshme, jo punë e urgjencës. Me ndërhyrjet tona shoqërore, diplomatike dhe mediatike, sidomos nga Republika londineze, në vend që të sulmonim qeverinë e Kosovës, ne duhet të sulmonim çdo opinion, sado minimal, të prodhuar në qarqet ndërkombëtare mbi natyrën e moderuar të udhëheqjes serbe. Ambasadori Murati e ndërton në mënyrë të përbashkuar vëzhgimin e tij, në të dy Republikat tona. Kjo është vetia e dytë e një vështrimi rilindës.

Perceptimi rilindës nuk e pranon shumësin e qenies shqiptare. Shënimet e ambasadorit qartësojnë se politika e integritit europian të shqiptarëve nuk është punë provincash, por çështje kombëtare.

Pika e tretë e një perceptimi rilindës qëndron në një mësim më global. Ne duhet të kuptojmë se duhej t'i shpallim zyrtarisht shoqërisë europiane, se as që duhet ta çojë ndër mend anëtarësimin e Serbisë në Europë. Duhet ta themi kudo, se në një rast të tillë, bashkë me Serbinë, në truallin e Europës, do të integrohen varrezat masive të pazbuluara dhe rrugët me emra kriminelësh gjenocidalë.

Kjo nuk është vetëm punë e qeverive tona, por punë e shoqërisë, e medieeve, qoftë edhe e mërgatës. Ndaj dhe duhet të përsërisim, se zvetënimin zyrtar, politik dhe publik i interesave të kombit shkon bashkë me cektësinë e përfytyrimit politik të shoqërisë. Rilindësit e kuptonin se çlirimi nga perandoria kërkonte një kalim nëpër temat iluministe, pra në Europën më të pastër të kohës së tyre. Nuk po e vonoj më shumë hyrjen në lëndën e fakteve apo simptomave, sepse ç'kam për të thënë gjendet si e gjitha në veprën e

ambasadorit si simptomatologji. Janë simptomat, ato që na shtyjnë të mendojmë.

Le të lexojmë lidhur me Kroacinë dhe aleancën dhe le të përthyejmë mendimet me ambasadorin tonë. Faktet mbi peshën e sjelljes kroate dhe mbi mungesën tonë në aleancën e domosdoshme në Gadishullin Ballkanik po i japim në formë telegrafike, por në rëndësinë e tyre do të qëndrojmë ca më gjatë:

1. Le të ndalojmë në rastin e lirimit të drejtuesve të luftës çlirimtare të Kroacisë prej Gjykatës Ndërkombëtare Penale për krimet në ish-Jugosllavi. Mendoni distancën e sjelljes mes përfaqësuesve shqiptarë dhe atyre kroatë. Luftëtarët kroatë lirohen nga akuzat, ndërsa tanët, dy dekada më pas, shkojnë me dhjetëra përpara gjyqit. Ky dallim vjen si rezultat i dallimit në sjelljet tona. Ne mendonim se, përmes ministrit të Drejtësisë në Kosovë apo edhe kryeministrit në Shqipëri, ka kaluar koha e luftës dhe se është koha për amnisti të përgjithshme e për paqe të përhershme. Ne e vendosëm zyrtarisht simetrinë mes xhelatit dhe viktimës, gjë që Kroacia nuk e bëri kurrë. Sot Kroacia është anëtare e Bashkimit Europian. Kroacia ka mbërritur në këtë stad, sepse nuk nguronte të dërgonte në Parlamentin Europian notë proteste për gjuhën e famëkeqit Sheshel. Parlamenti Europian miratonte rezolutën, ku i kërkonte qeverisë serbe të dënonte gjuhën e Sheshelit. Kroacia e njeh mirë diçka: një shtet që nuk e korrupton dëshmorin dhe viktimën e vet, nuk mund të korruptojë institucionet e tij.

Kështu që sot, falë gjuhës sonë institucionale të dy dekadave, Serbia ka mundësi të projektojë terrorizmin mbi viktimat, që bëri dy dekada më herët, ndërsa çlirimtarët tanë janë diku në Europë, në bankën e të akuzuarve. Duke mos e vendosur Kroacinë si aleate, duke mos ndërtuar planin e një aleance të duhur, ne bëmë të kundërtën në rrafshin e vlerësimit të luftës dhe krimeve, të çlirimtarëve dhe armikut.

Duke shpallur publikisht, brenda dhe jashtë, në medie dhe konferenca, kudo ku na jepej pra rasti dhe fjala, amnistinë e krimit të të tjerëve, ne bëmë vetë që pesha e krimit, 20 vite më pas, të bjerë mbi ne, duke vërtetuar se krimi, ashtu si energjia, shndërrohet dhe këmbehet, por nuk zhduket. Ne shpallëm, mediatikisht dhe publikisht, në vend të gjenocidit serb, amnistinë për krimet dhe harresën për historinë, duke treguar se shtetërisht ne kemi frikë nga mosha e pjekur. 20 mote na dukeshin shumë.

Përmes institucioneve tona ne deklarua se nuk duam të kalojmë qoftë edhe dy dekada në moshën shtetërore të reflektimit të krimeve që janë kryer mbi njerëzit tanë. Deviza zyrtare e harresës është e thjeshtë: “Kanë kaluar 20 vjet tashmë”. Me shtet ne deklarojmë se memoria jonë institucionale nuk e duron një periudhë më të gjatë se 20 mote. Por kjo është njësoj si të deklarojmë se dija jonë shtetërore e ka autoktoninë të krahasueshme me dy dekada.

Nuk bëhet fjalë për foshnjëri dhe naivitete. Mungesa e aleancës me Kroacinë dhe thirrja e amnistisë shkojnë bashkë sipas një politike të koordinuar kundër kombit shqiptar dhe paqes. Mediet dhe zyrtarët tanë më të lartë të dy republikave shqiptare na thanë se kanë kaluar 20 vjet prej luftës dhe krimeve. Lypset vetëm pak *sens komun*: qoftë edhe në jetën time si person përmbahen dy 20-vjeçarë e gjysmë. Asnjë inteligjencë normale nuk mund ta gëlltisë faktin, që unë mund të harroj se ç’bëhej e ç’bëja 20 vite më parë.

Si mundet që diçka që unë nuk e harroj individualisht, do të mund ta harroj shtetërisht në moshën e një kombi që përmban breza të tërë viktimash e dëshmorësh? Një shtet që harron krimet, ka harruar viktimën dhe dëshmorin e vet. Nuk është, pra, diçka rastësore, që në të dy republikat tona harrimi dhe heshtimi përfshin tërë aktet e larta që nga Rilindja e deri tek Epopeja e UÇK-së. Sjellja e Kroacisë duhet të ishte aleancë e vendosur me shembullin e mirë. Por siç dihet nga i gjithë publiku shqiptar, aleanca e

parapëlqyer nga pushteti në Tiranë nuk është Kroacia, por Serbia e Vuçiqit. Dhe, nëse ndërtohet një rrafsh i tillë aleance, kjo do të thotë se nuk po synohet lartësimi i çlirimtarëve tanë, por amnistia e krimeve të aleatit jo të duhur, ose armikut historik.

Le të kalojmë në shembullin e dytë.

2. Lokalizimi i faktit nga ambasadori me emrin “operacioni Shtorm në Kroaci” mund të lexohet me indiferencën e kureshtjes së ftohtë. Si i tillë, ai nuk ofron asgjë më shumë, se një detaj në dijen tonë enciklopedike. Por një lexues më aktiv dhe më i integruar shqiptar e kupton idenë e fortë të ambasadorit Murati lidhur me stabilitetin e një rajoni të tërë.

Le ta lexojmë më qartazi. Operacioni “Shtorm” pati një efekt për rajonin, për Perëndimin dhe sidomos për ne shqiptarët: një “Republikë Sërpska” më pak. Kështu lypset ta lexojmë. Krajina nuk u bë “Republikë Sërpska”. Një “Republikë Sërpska” më pak në Ballkan, një rast më pak për luftë në të ardhmen. Një përbërës më pak në maninë e serbëve për “Botën Serbe”. Operacioni “Shtorm” është kontributi i madh për stabilitetin rajonal. Efektet e këtij kontributi duhet t’i mendojmë thellë, për të kuptuar se rajoni mund të ishte më keq. Kroacia nuk lejoi që e tashmja të paraqitej edhe më e vështirë. Ky dallim në gjendjen e faktit nuk duhet të anashkalohet pa vlerësimin dhe kuptimin e duhur. Kroacia, në vend që të ishte një faktor i cenueshëm në rajon, tashmë është një faktor i fuqishëm. Ndaj na duhet aleanca me të. Po aty duhet të kuptohet edhe më mirë nga ne, se si duhet të shmangim deri në fund përpjekjet e Serbisë, Ruisë dhe aleatëve të tyre ndërkombëtarë për prodhimin e Zajednicës në Kosovë si qendëzim strategjik të luftës së ardhshme.

3. Shembulli i tretë është modeli kroat i anëtarësimit në BE, që përmban disa elemente e që duhet t’i kthenim në pyetjet drejtuar organizmave tanë të përfaqësimit për të gjetur se përse ne nuk jemi ende pjesë e Bashkimit

European. Po i rendis shkarazi, duke respektuar sadopak shkallën e rëndësisë, përbërësit e politikës kroate, disa prej të cilëve marrin peshë në librin “Aleanca e duhur”.

Shkarazi, pra, është vendimtar shkatërrimi i çdo mundësie të rikthimit të jugosllavizmit, me burim të nostalgjia ksenofobe serbe dhe melankolia europiane; vendosja e një standardi zhvillimor, demokratik dhe përfaqësues në një rajon që ka mbi supë emrin “fuçi baruti”; lufta kundër korrupsionit institucional të shtetit dhe spastrimit të gjyqësorit; realizimi korrekt i procesit të zgjedhjeve; zgjidhja normale e çështjes së kufijve me fqinjët dhe sjellja e drejtë me historinë e tyre; sjellja e drejtë me vlerësimin gjyqësor të luftës së vet; qëndrimi i dinjitetshëm me institucionet europiane të çdo rangui.

Duket se, në çdo drejtim, Republika e Shqipërisë është prapa, ndërsa Kosova po hedh hapa të shpejtë e, madje, të guximshëm vetëm kohët e fundit. Kroacia mund të jetë modeli më i afërt ekzistencial për ta përafëruar aparatit e sjelljes së dy shteteve tona shqiptare. Pra, mund të themi se Kroacia shërben edhe si model për gjendjen politike të brendshme të shqiptarëve. Por mund të themi se përvoja kroate tregon gjithashtu pikat dhe linjat e veprimit që të shpjen në integrim, gjëra që Republika e Shqipërisë për tri dekada, dhe ajo e Kosovës për dy dekada, i kanë pas dore. Aleanca e shprehur në “Ballkanin e Hapur” dëshmon thjesht se një republikë të korrupsionuar i nevojitet si aleatë një republikë e korrupsionuar. Ramës i nevojitet Vuçiqi.

Në këtë kuptim, ambasadori Murati ka të drejtë në mënyrë themelore që ta risjellë në plan të parë aleancën me Kroacinë si aleancën më të duhur, si në kuptimin e modelit që

duhet ndjekur, por edhe të aleatit që cilëson natyrën e republikave tona. Mendimi i një aleance i shërben sa një pedagogjie diplomatike, po aq edhe një riformatimi politik të brendshëm.

4. Nga mënyra e ndërtimit, libri “Aleanca e duhur” na dëfton edhe diçka: agresivitetin diplomatik të Serbisë sa herë që një shtet çlirohet prej ëndrrës së saj për një botë serbe. Shkëputja e Sllovenisë në fillim, si dhe përmbushja e shkëputjes së Kroacisë me hyrjen në BE dhe NATO, e përshpejton dhe e bën më agresive Serbinë në ëndrrën e vet.

Kështu që këtej e tutje, Serbisë i ka mbetur të përdorë edhe deri agresionin në tri shtetet rrethuese të saj. Surpriza më e këndshme për Serbinë është sjellja e Republikës së Shqipërisë që ka pranuar të regjistrohet, përmes zërit të zellshëm të kryeministrave të vet, në projektin jugosllav, aty ku kanë thirrur përherë Serbia ose europianët jugonostalgjikë.

Nuk dihet se përse Shqipëria, e cila duhet ta nxirrte veten jashtë rrethit të shteteve ish-jugosllave, paraqitet zellshëm e para në projektet e botës sllave, të cilat i liston si nisma të vetat. Z. Murati e ka regjistruar në tërësinë e librave të tij këtë dëshirë morbide të një republike shqiptare me vesin në strukturën shpirtërore. Por le ta citojmë shkurt vesin në politikën e jashtme të Shqipërisë sa i takon horizontit jugosllav: *“Përse kryeministri serb Nikolla Pashiç e përfshiu në marrëveshjen e tij me Ahmet Zogun bashkimin doganor mes dy shteteve; përse Titoja e përfshiu bashkimin doganor të dy shteteve në marrëveshjen e tij me Enver Hoxhën; përse Aleksandër Viçiq shpluhuros një marrëveshje shekullore për bashkim doganor e tregtar, të cilën e shet si ide të re në vitin 2016?”*. Këto pyetje që duhet t’i shtronte historiografia jonë, i shtron ambasadori ynë. Sepse ambasadori mund të shquajë atë që historia zyrtare e mban si vesin e vet. Vesi ynë ushqen përgjatë një shekulli horizontin jugosllav të Serbisë.

Emrat e bujshëm, si “Ballkani Perëndimor”, vendosen gjithnjë në bazë krahasimesh të pamundura, si për shembull me vendet nordike dhe me Beneluksin, për të na treguar se janë mashtrime që mund të fitojnë vetëm falë tabuve të paracaktuara nga ne vetë si kufizime për inteligjencën tonë. Çfarë nuk dëgjuan veshët tanë, por, për sa gojët e përfaqësuesve tanë nuk flisnin, serbët dhe bashkëpunëtorët e tyre në Perëndim mund të sajnin formula deri edhe si Unioni Ballkaniko-Perëndimor, me parlamentin dhe policinë e përbashkët.

Vesi i një shteti të vogël, kur është një ves apo cen afatgjatë, mund të sëmurë edhe perceptimet më fuqiplote. Për të ndërtuar një gjeodezik të dëmshëm politik, nuk ka nevojë që shteti mbartës i vesit të jetë i madh dhe i fuqishëm. Mjaft që të jetë i vendosur strategjikisht në nyja gjeopolitike. Pozita e rëndësishme gjeografike është e fatbardhësi apo fatkeqësi, sipas natyrës kushtetuese të politikës së vendit në fjalë.

Kështu që kur luante mençuria dhe vigjilenca e Kroacisë kundër nismave të këtij lloji, pra në horizontin e kthjelltësisë kroate, kryeministri Rama nuk mund të gjente ndonjë gjë më të vyer se deklarimi mbi Jugosllavinë si planeti i lirisë për shqiptarët gjatë regjimit komunist.

5. Në libër kuptojmë gjithashtu, se strategjia serbe organizohet në dy etapa: një herë punon për degradimin e shtetësisë së shtetit fqinj, në një hap të dytë harton propozime për nisma të përbashkëta. Që prej Platonit e dimë se për me qenë kriminel, duhet të jesh më së pari i pacipë dhe gënjeshtar. Mendimin se ekzistojnë kriminelët e moderueshëm, kriminelët e besës apo mashtruesit e njerëzishëm, mund ta dëgjojmë vetëm duke shprehur mosaprovimin tonë të menjëhershëm. Që një shtet të jetë i besueshëm, duhet të gëzojë standardet demokratike, standardet e integriteteve, orientimin gjeopolitik liberal-demokratik. Nga përvoja kroate mësojmë se gënjeshtarit serbe rriten në përpjesëtim me heshtjen tonë ndaj emrave dhe drafteve që shpik Europa.

Rasti i Kroacisë na mëson edhe të vëmë re shpesh, se burokratët e BE-së, për mungesë imagjinatë, vullneti dhe dijeje historike, përmes emërtimeve që vendosin mbi sajësat e Ballkanëve të bashkuara kërkojnë të zëvendësojnë nismën e tyre themelore të Europës së Bashkuar. Si shqiptarë ne kemi gjithsesi diçka në dorë: mund t'u themi se në vizionin tonë Europa nuk mund ta zëvendësojë vetveten me bashkime të llojeve të tjera, sepse i vetmi integrim ku ne mendojmë të marrim pjesë si shoqëri është Europa e Bashkuar. Kroacia dinte të punonte për një edukim të tillë, ndaj dhe sot prej një dekade është anëtare e Europës së Bashkuar. Ndërsa ne, duke edukuar zyrtarisht mungesën e besimit te vetja, rrënimin e politikës publike, korrupsionin e institucioneve qeveritare, dobësimin e shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi, patëm vetëm një shpërblim: kotësimin në rrafshin e Bashkimit Europian.

6. Ambasadori na adreson edhe në një natyrë tjetër të aleancës me kroatët, kësaj here në prizmin e përfytyrimeve të dinjitetit historik. Kroacia është i vetmi vend në Ballkan, që nuk ka pse të vjedhë historinë e dikujt tjetër. Asaj nuk i lypset pushtimi i ndonjë të shkuare historike. Ndërkohë serbët edhe maqedonasit (njëri duke vjedhur Konstandinin e tjetri duke rrëmbyer Justinianin) kërkojnë të pushtojnë historinë, për të legjitimuar territoret e fituara me agresion dhe gjenocid.

Formula e pushtuesit është kjo: në fillim ka për strategji të pushtojë të tashmen, më pas të pushtojë të shkuarën, në fund të bëjë fatale të ardhmen. Duke mos pasur nevojë të rishpikin historinë, kroatët edhe në kuptimin dhe planin historik janë aleanca jonë e duhur.

7. Këtë pikë mund ta quaj *pika e vonësës*. Libri "Aleanca e duhur" nis me nënshkrimin shumë të vlefshëm, të datës 16 shkurt 2017, të partneritetit strategjik mes ministrave të Mbrojtjes së Shqipërisë dhe Kroacisë, e njoftuar edhe te sekretari i NATO-s. Ambasadori Murati liston motivet e këtij

partneriteti strategjik. Marrëveshja për partneritetet strategjik përbënte përgjigjen e duhur ndaj partneritetit strategjik Rusi-Serbi, ndaj aneksimit të Krimesë si shembull që mund të përhapej ndaj rritjes së ndikimit rus në Ballkan dhe ndaj shndërrimit të Serbisë në bazë logjistike të Rusisë.

Duke e risjellë këtë fakt si hyrje në libër, ambasadori na dëfton se jemi në një vonesë prej 6 vitesh lidhur me këtë partneritet, 10 vite lidhur me aleancën me Kroacinë, një shtet i BE-së, 14 vite me një anëtar të NATO-s i cili ka të njëjtët interesa në fushën e sigurisë. Po e quaj këtë vonesë subjektive. E nënvizoj për të vënë në dukje, se është një vonesë më e dëmshme se çdo vonesë objektive. Si e tillë, ajo përbën një gabim logjik moral, që vjen prej faktit se kur hap një udhë të mirë dhe nuk e ndjek, vonesa, duke qenë subjektive, nuk është thjesht vonesë, por kthehet menjëherë në faj publik dhe kombëtar.

Vonesat tona dhe aleancat e vlefshme e të papërdorura riaktivizojnë ëndrrat më të këqija të armikut dhe nxitin dembelinë burokrate të perëndimorëve. Po aty shtyhet pa afat edhe integrimi i mendimit tonë politik. Për pasojë projektohet si mision mbi një brez të ardhshëm, dhe më të largët me aktualizimet, mendimi i integritetit tonë në vetvete. Ky integrim i fundit ka përbërësit e vet: integritetin në ekzistencë, integrimin tonë në bashkime të rangut europian, integritetin në shprehje, në deklaram. Vonesa në ekzistencë, në të tashmen e aleancës, dhe vonesa në shprehje në të ardhmen perëndimore të orientimit tonë përbëjnë dy shtresat e vonesës sonë subjektive.

Një veti të dytë të vonesës duhet ta kemi në vëmendje e ta pedagogjizojmë për politikën dhe diplomacinë e ardhshme: vonesa nuk është sterile, ajo është pjellore, por për të keqen tonë. Prandaj dhe ambasadori Murati gjatë librit sjell shumë shembuj për të treguar se Serbia kërkon të anëtarësohet në nismat ballkanike, jo për t'u integruar, por:

1. për të prodhuar sa më shumë vonesa në lidhje me integrimin e shteteve të tjerë të Ballkanit në Europë;

2. për të lehtësuar rritjen e ndikimit ruso-kinez mbi BP-në.

Gabimi i ndërkombëtarëve të Perëndimit është se mendojnë se me kësi bashkimesh rajonale do ta nxitin Serbinë të shpejtojë hapin drejt BE-së. Duke mos aderuar në nisma të tilla, si rasti i “Ballkanit të Hapur”, ne e pengojmë burokracinë e Europës t’i lejojë vetes iluzione të tilla. Vonesat që vijnë prej mendjlehtësisë burokratike të Europës do t’i quaja *vonesa objektive*.

Një nga aleancat më të vyera kundër këtyre iluzioneve, zakonisht në Komisionin Europian, është shtrirja e bashkëpunimit mes Shqipërisë, Kosovës dhe Kroacisë. Kjo aleancë është më e duhura për të relativizuar fuqinë e Serbisë në Ballkan. Aleanca e kthjellët me kroatët do ta shuajë gabimin tonë subjektiv dhe do të nxisë rrënimin subjektiv dhe objektiv të ëndrrës serbomadhe.

Le ta themi hapur: fuqia e Serbisë, për hir të vonesës së shtetit shqiptar në aleancat e duhura dhe në shtetndërtim, është frika e BE-së. Ndërkohë, le të ndiejmë se frika e BE-së e ka një pjesë të madhe të burimit të saj në vonesën tonë subjektive. Nuk ekziston asnjë objektivitet, që të mos e ketë rrënjën e tij në ndonjë subjektivitet.

9. Përmes leximit të librave të ambasadorit Murati mund të përvetësojmë edhe vlerësimin e faktorëve psikologjikë në lëndën e veprimit diplomatik, qoftë edhe të përmasës së shteteve. Kështu që do të vëmë re se aleanca jonë me Kroacinë mund të ketë edhe efekte, që nuk i kemi marrë parasysh më herët.

Rritja e bashkëveprimit me Kroacinë e bind këtë të fundit të jetë e shprehur më vendosmërisht në BE. Këtu duhet të nënvizojmë faktin e dallimit mes Kroacisë dhe Sllovenisë. Sllovenia duke u ndier më e mbrojtur dhe duke e

veçuar veten historikisht prej Ballkanit, është edhe më indiferente ndaj fatit të Ballkanit. Kroacia, edhe pse anëtare e Bashkimit European, është ende e kapur prej intrigës ballkanike. Për të fituar edhe më siguri, asaj do t'i nevojiteshin shqiptarë më të integruar dhe më të sigurt në vete. Me shqiptarë më të fuqishëm, ajo do të ishte më e fuqishme në BE dhe më e lirë në Ballkan.

9. Në aspektin e komunikimit diplomatik, ne duhet të arrijmë t'i bindim eurodeputetët mbi dëmin që u sjellin atyre burokratët e Komisionit. Ne duhet t'u shtrojmë e t'u shtojmë argumentet se çdo Ballkan i ceneshtëm nga Serbia është një dëm i brendshëm për vetë shtetet e Europës. Duhet t'i bëjmë të kuptojnë se integrimi i shqiptarëve është domosdoshmëri për stabilitetet e tyre të brendshme, dhe jo vetëm shpërblim e fitim për shqiptarët. Në këtë rrafsh, le të theksojmë po ashtu, se integrimi i Kroacisë në BE e bën vetë Europën më të drejtë ndaj shqiptarëve... nëse ne dimë ta përdorim dhe nuk humbim më kohë si deri tani.

Ndërkohë, përmes komunikimit mund të arrijmë edhe një rezultat tjetër. Bashkimi European mund të kthjellohet e të kuptojë një herë e mirë, se nuk mund të ndëshkojë shtete e popuj të tjerë për fajet e Serbisë, veprim i kryer disa herë, qoftë edhe tani së fundmi.

Nuk janë pak shembujt në librin "Aleanca e duhur", që sjellin këtë gabim të Europës dhe ndërkombëtarëve të tjerë ndër vite. Le të kujtojmë frazat që rikthehen në gjuhën e emisarëve: Olli Rehn thoshte në 2005-ën, se ishte i kënaqur me progresin e Serbisë. Mos harroni se në Serbi ishte vlarë pak më parë kryeministri Gjingjic. Para do kohësh dëgjuam shprehjen se Vuçiqi është një bashkëpunëtor i frytshëm. Në kësi rastesh, ne nuk duhet të heshtim, por të themi të vërtetën.

10. Në këtë rrjedhë, leximi i librave të Shaban Muratit na lehtëson të shohim se si përsëriten taktikat e Serbisë. Z. Murati na kujton se loja me hartat është

kryer edhe nga Millosheviqi në restorantin londinez, ku darkonte me Tuxhmanin një çerek shekulli më herët. Millosheviqi e vizatoi hartën mbi mbulesën e tryezës së restorantit dhe, paralel me oreksin e vaktit, nisi të ndante territoret e shteteve fqinje. Ne kemi treguar se kemi udhëheqës që bien në lojëra vaktesh. Ky nuk është thjesht fati ynë i keq, por fataliteti i zgjedhjeve tona të cekëta.

Kujtesa institucionale nuk është vetëm e brendshme, por edhe e jashtme. Nëse këmbëngulim, ne do t'i dëshmojmë elementit ndërkombëtar se sa më shumë e lë ritmin e integritit të shteteve të Ballkanit në shpejtësinë dhe standardet e Serbisë, aq më shumë ajo i lë zonë të lirë Ruisë. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti është deklaruar disa herë para përfaqësuesve ndërkombëtarë, ku ka thënë pak a shumë se çdo vendosje në distancë të baraslarguar mes Brukselit dhe Moskës, është deklarim pro Moskës, dhe njëherësh shpërdorim i zemërgjerësisë Europiane.

Adresimin e gabuar të zemërgjerësisë europiane ne e kemi të regjistruar në historinë tonë si shtete dhe komb. Duke mos e nënvlerësuar kurrë njohjen tonë të historisë, ne bëjmë një nga shpalljet më të larta të subjektivitetit politik dhe diplomatik: u bëjmë të ditur europianëve se ne dimë për veten më shumë se ç'dinë për ne europianët. Sipas kodit logjik platonian, europianët duhet të dinë për ne dijen që prodhojmë ne për/mbi veten.

11. Duke e falënderuar zotin ambasador për faktin se na shtyn të shquajmë se konceptet fantazmë kanë gjithsesi efekte konkrete, po ndalem pak edhe në një pasojë tjetër të këtyre koncepteve. Fakti e kërkon më ngulm që të hiqet dorë progresivisht nga koncepti francez i Ballkanit Perëndimor. Për kontekstin ku shpien këto koncepte fantazmë mjafton të citoj një metaforë të z. Murati: “Integrimi paraprak rajonal është si pëlhura e Penelopës”.

Por këtu duhet të lexojmë edhe produktin psikologjik të dëshpërimit. Konceptet fantazmë sigurisht që shpiken për të rikrijuar ndonjë Jugosllavi proruse dhe për ta afruar Rusinë e Kinën në qendër të Europës. Por dëmi i shtuar dhe i paretrefektuar mirë nga ana e projektuesve është degdisja në dëshpërim e të gjithë shteteve mes nesh dhe Lindjes. Nuk ka bashkëpunues më të madh për projektet armiqësore sesa dëshpërimi. Ruisë e Kinës i nevojitet dëshpërimi në zonat mes tyre dhe Perëndimit. Nëse mes Europës Perëndimore dhe Azisë shtrihet një zonë dëshpërimi, ajo zonë do të kthehet në ruso-kineze e jo në demokratike-liberale. Dëshpërimi është arma më hibride kundër demokracisë.

Po i risjell edhe një herë faktet dhe sjelljet: presidentja e Kroacisë bëri thirrje të hiqej ky term dhe të zëvendësohej me “Europa Juglindore” edhe kur kishin kaluar 15 vite, pothuaj në të njëjtën kohë, në vend të mbështetjes për qëndrimin kroat, nga Shqipëria erdhi e kundërta, mbështetja për nismën serbe të “Ballkanit të Hapur”; nga Rusia, Lavrovi përsëriti thirrjen e vitit ‘97 për rikthim të NATO-s në kufijtë e mëparshëm, thirrje që rusët e përsërisin me forcë dhe bindje aktualisht me gjuhën e agresionit mbi Ukrainën.

Pra, nëse serbët marrin përsipër të pakësojnë fuqinë e fqinjëve të tyre në NATO, Ruisë ky fakt i shërben, sepse e do Bullgarinë dhe Rumaninë, si dhe vendet baltike, pa NATO. Edhe këtu përgjigjja më e fortë vjen nga figura e Kroacisë si shembulli më i mirë i domosdoshmërisë së NATO-s në rrafshin e stabilitetit.

Në peizazhin e “Aleancës së duhur” zë fill një zgjerim së brendshmi i Europës, që e shtyn jashtë e larg botën sllave. Aleanca me Kroacinë do ta bindë Bullgarinë të mos ketë asnjë element të saj proruse. Rumaninë po ashtu. Aleanca Shqipëri-Kroaci është vektori më i drejtë i veprimit gjeopolitik demokratik dhe liberal. Kjo aleancë është semantikisht dhe

substancialisht shkatërrimi i çdo përpjekjeje për rikthim të forma të jugosllavizmit. Në libër unë nuk lexoj vetëm se ç'është bërë dhe ç'po bëhet në rrafshin e kësaj aleance, por më shumë se ç'duhet të ndodhë në të ardhmen.

Dhe kjo imagjinatë mund të shprehet në pyetjen: *Ç'mendim gjeopolitik rajonal dhe botëror prodhohet në qëllimësinë tonë kur mendojmë sipas kësaj aleance?* Sa për teknokratët e BE-së si dhe eurodeputetët e saj, leximi sipas një aleance të tillë është kthjellim më i thellë i aleancës Serbi-Rusi.

Duhet të mësojmë po ashtu në rendin praktik, që të luajmë me dy shpejtësitë: njëra parimore, që thotë se integrimi është sipërmarrje individuale e shteteve, tjetra, që është shpejtësi e propozuar nga qëndrime taktike, thotë se Ballkani Perëndimor duhet të integrohet në bllok. Kur Kosova të hedhë hapa më tej në integrim, atëherë ajo duhet ta braktisë mbështetjen e taktikës dhe t'i bashkohet tërësisht parimit. Deviza e dytë, ajo e taktikës, bën që të ngadalësohet integrimi i Ballkanit.

Sot që flasim, 53% e serbëve janë shprehur kundër integrit në BE dhe vetëm 35% e tyre pro. Unë mund ta kuptoj se është e papranueshme psikologjikisht për BE-në një Serbi që nuk joshet prej saj. Me sa di unë, Bashkimi Europian nuk është themeluar si bashkim psiko-patologjik. Pra, nuk mund të kuptoj se si BE-ja mund të vijojë në habinë e saj. Një ditë ky bashkim i madh do të zgjohet me një psikologji aktive dhe do ta kuptojë se Serbia nuk ka vend në BE. Vetëm atëherë Bashkimi Europian do t'i kthehet idesë që e solli në jetë, duke mos qenë më vendi ku gëlon psikologjia dhe shkëmbimi i interesave.

Ne duhet të pranojmë se ideja e çdo integrimi të brendshëm në Ballkan përmban në thelbin e vet, në çdo nxitje të ndonjë lobi europian, një dozë të lartë racizmi. Duke u larguar prej vlerësimit të aftësisë integruese individuale të shteteve ballkanike, europianët e këtij lloji u largohen vlerave

dhe na vendosin si kusht dhe horizont, përpara dhe kudo, bashkimin përmes tregtisë. Ata e zëvendësojnë pafuqinë e tyre për zgjerim në bazë të vlerave me fiksonin e një tregtie që bashkon të pabashkueshmen, duke shprehur po aty një padije të thellë në sinoniminë mes kampit komunist dhe bllokut jugosllav.

Monedha nuk mund të mbushë hapësirat që janë krijuar nga qindra mijërat e viktimave të etnocideve. Shqipëria ka qenë komuniste, por jo jugosllave. Kryeministri i Republikës londineze ua ka lehtësuar këtë gabim europianëve dhe ndërkombëtarëve në përgjithësi. Përkundrazi, rezistenca e qeverisë së Kosovës po kthehet në punë pedagogjike mbi vetë ndërkombëtarët e BE-së. Më lejoni tani të kaloj në një hamendësim më të gjerë lidhur me veprën, për të treguar se dija autoktone e ambasadorit Murati nuk është i vetëm. Por para se të nis këtë hamendësim, duhet të deklaroj edhe një herë dy devizat e moralit politik, që propozon z. Murati e që i ndaj unë dhe një organizatë e tërë ku bëj pjesë: *“Fqinjësia nuk mund të vendoset mbi interesin shtetëror dhe kombëtar”*, *“Integriteti territorial dhe sovraniteti kombëtar janë më të rëndësishëm se integrimi europian”*. Nëse i zotërojmë devizat tona të veprimit, atëherë të jemi të sigurtë se do të integrohemi në Europë.

Që në pikënisje unë isha i qartë mbi idenë se duhet të evidentojmë po ashtu një stil, jo thjesht të shkrimit, por të vështirimit. Siç e thashë pra në nisje, në çdo kontribut të zotit Shabani mbi analizën e diplomacisë ndihet aftësia e tij për me prodhuar faktologji. Le ta quajmë faktologji aftësinë për të lokalizuar, në mjedisin e turbullt, tepër kompleks e rrethor të ngjarjeve të përditshme, diçka që shërben si fakt, si pikënisje reflektimi.

Në filozofi termi *fakt*, i preferuari i dijes anglo-saksone, nuk është lehtësisht i integrueshëm në proceset tona të njohjes dhe ndërgjegjësimit. E pra, për të lokalizuar faktin, ose për të thënë se ç’ nuk është fakt, do të thotë

të kesh një aftësi të veçantë perceptimi. Çdo qenie percepton, por perceptimit i lypset një dije, një dije e fushës. Dija e fushës është problematike, sepse aty priten mes tyre një dije dhe një prirje: dija që e marrim nëpër vendet e specializuara dhe prirja që orienton përvojën. Ne jemi ndoshta një nga vendet në botë me më shumë vende të specializuara, universitete, por me më pak regjistrim të përvojës së prirur, përvojës së orientuar.

Aspekti i fushës është problematik, sepse dija e fushës në përgjithësi përvetësohet në mënyrë abstrakte, pa ndonjë lidhje me terrenin. Marrëdhënia zë fill kur nisim e krijojmë gradualisht ndërgjegjen mbi aftësinë dhe mundësinë për të prodhuar dije autoktone të fushës. Implikimi i përvojës në dije krijon fushën. Po e ripërsëris, intriga mes fushës së dijës dhe fushës së përvojës prodhon autoktoninë. Këtu qëndron prurja e librave të zotit Shaban Murati. Në bazë të perceptimit të tij, perceptim që ka kaluar nga fusha e dijës te fusha e përvijimit gjatë një gjysmë shekulli, fusha është prirur drejt interesit kombëtar të diplomacisë.

Kur deklarojmë se kemi dije, sasi të madhe dijesh dhe dije të fushës, nuk jemi deklaruar aspak mbi natyrën autoktone të tyre. Natyrshëm, dija autoktone dhe po aty perceptimi sovran i lëmit, i përket drejtpërdrejt dhe menjëhershëm poetit. Fakti i poetit gëzon ndoshta cilësinë më të lartë të perceptimit. Lypset pra, një shije poetike kudo nëpër disiplinat, që ato të prodhojnë autoktoninë e tyre. Përmes dijës autoktone dhe perceptimit sovran mund të lokalizojmë asi faktesh, që për nga vlera e tyre marrin fuqinë e simptomës. Vëllimi i shkrimeve të zotit Shaban Murati është leximi i simptomave. Diçka mes mjekësisë dhe poetikës. Ashtu si për mjekun, edhe këtu diagnoza fillon me simptomën.

Analiza e dy librave, të largët mes tyre sa dhe ura historiko-ideologjike që mbahet mes Tiranës dhe Prishtinës, mund të na shërbejë edhe për një përqendrim më të fortë të disiplinimeve të autoktonisë: libri

“Antitabu” përshkruan në formë ditari cenin e shqiptarit në lëndën e *bon sensit* publik; libri “Aleanca e duhur Shqipëri-Kroaci” përllëgarit cenin në lëndën e *bon sensit* diplomatik. Vesi qëndron, pra, në lëndën e brendshme të identitetit dhe atë të jashtme të aleancës. Po përdor cilësorin *bon sens*, sepse kemi të bëjmë pikërisht me dëme në aspektin formal të logjikës.

Kur zotërojmë ndjeshmërinë, zotërojmë aftësinë për të lokalizuar simptomat. Kjo është identike me aftësinë perceptuese që shquan përmes lëndës së mjegullt gjeopolitike. Sepse kjo lëndë shkon prej medieve të rajoneve më armiqësore ekzistenciale për shqiptarët, deri te sjellja jonë, si i tretë i vetëpërrjashtuar prej marrëdhënies në botën... e diplomacisë. Ambasadori është sigurisht njohësi më i detajuar i botës ruse nga na vjen integralisht rreziku.

Po përfitoj nga rasti i duhur për t’u ndalur pak në pikën e marrëdhënies mes subjektivitetit dhe aleancës. Rëndon ne rrekemi ta harrojmë armikun, nën idenë se jemi besnikë të ndonjë aleati. Kur, në fakt, të jesh besnik i ndonjë aleati do të thotë të jesh njohës shumë i madh i armikut. Aleatit i nevojitesh kur ti e njeh shumë mirë armikun tënd. Në analizën e shkruar përgjatë tri dekadash ambasadori Murati e ndjek dhe e shtjellon këtë temë reflektimi. Ju ftoj në një lloj imagjinate të thjeshtë dhe të shkurtër.

Një njohës i mirë i marrëdhënies ndërkombëtare i ngjan një patologu, ose më mirë një mjeku të përgjithshëm. Ai nuk e sheh botën vetëm nga perspektiva e mbyllur e politikës ekzekutive, por e vlerëson edhe si rezultat i mbetjeve që mund të prodhojë rajoni përrethues. E sheh ekzekutivin edhe si përcaktim të kontakteve me ndonjë ekosistem.

Ambasadorët tanë, të cilët duhet të jenë psiko-motorë të zgjatur në mjedisin e huaj, nga padija lidhur me zejen e tyre shkëputen prej trupit. Ne i dërgojmë që ata të na dëftojnë se si mund t’ia përshtasim mjedisin trupit, ndërsa ata shëtisin nëpër mjedis pa kodin e trupit prej nga vijnë. Në zonën e

përvojës harresa e trupit është e lehtë kur nuk e kemi të stërvitur perceptimin sovran.

Ambasadori Murati, i një lloji krejt tjetër, një kohë drejtues i Akademisë Diplomatike dhe i sektorit në Ministrinë e Jashtme, ambasador në disa vende të kulturave të ndryshme, ka studiuar mjedisin. Duke vëzhguar zonat ku prodhohet politika më antishqiptare, ka zbuluar edhe direktivat e sjelljes që do t'i rekomandojë trupit të cilit i përket. Direktivat kanë të bëjnë me publikën (“Antitabu”) dhe me aleancat (shembulli i Kroacisë).

- *Së pari*, nga reflektimi i tij afatgjatë unë nxjerr si tezë se aleanca nuk është aleati. Kjo do të thotë, në një hap të dytë, se subjektiviteti është më i fortë e më unanim tek armiku. Prej një pamjaftueshmërie afatgjatë në reflektim, ne e kemi vendosur subjektin tek aleati, duke ia hequr armikut. Rastin më të shprehur të këtij gabimi zyrtar prof. Donik Sallova e thekson duke cituar një moment tek “Antitabu”: *“Kemi shkruar për të gjithë heronjtë dhe viktimat tona, pa përmendur kurrë armikun, atë që i vrau”*. Kaq i trashë është gabimi, faji! E zhdukim armikun zyrtarisht dhe historiografikisht si subjekt.

- *Së dyti*, sa më shumë e fshehim armikun, aq më shumë e përmendim aleatin. Duke e bërë aleatin subjekt, përmes përsëritjes së emrit të tij, ne relativizojmë subjektivitetin e tij, dhe po ashtu absolutizojmë njëjtësinë e përhershme të botës. Zhdukja e armikut si subjektivitet, subjekt pa subjektivitet i aleatit, vjen si vijimësi e heshtur dhe e paqtë e botës.

Ambasadorët tanë kanë të drejtë të shëtisin në një botë që mendohet e qetë. Jo më kot para do vitesh, shumica e tyre dhe e analistëve në medie na deklarorin se nuk do të kishte më luftë. Rezultati politik dhe publik ishte zhdukja e vetes si subjekt. Këtu qëndron thembra e Akilit.

Carl Schmidt bënte të qartë se (në gjeopolitikë si fusha ku është reduktuar politika aktuale nëpër plotësinë e shekullit XX) ekziston vetëm një subjekt,

që prodhon fushën e ekzistencës së vetes, subjekt ky i vendosur në nocionin e armikut dhe në dallimin mik-armik. Ndërsa shteti shqiptar, në mënyrë institucionale, pra shteti substancial i shqiptarëve, e ka zhdukur apo tretur figurën e armikut në dijen e fushës.

Në bazë të një dijeje naive, përfaqësimi i shqiptarëve ka menduar një botë që është e mbushur me aleanca. Idili i një bote të paqtë i ka ndihmuar republikat zyrtare të shqiptarëve të jenë të dhunshme mbi vullnetet e vetë shqiptarëve. Në horizontin cinik intim të gjeopolitikës, përfaqësimi politik dhe diplomatik shqiptar vepron si në trevat tona, ashtu edhe në ato armiqësore, i drejtuar nga ideja se mund të relativizohet armiku.

Relativizimi i armikut nuk është i mundur përmes harresës së subjektit të tij. Çdo përpjekje e jona për të relativizuar armikun është një faj. Zhveshja e armikut prej subjektit përfundon në humbje të vetes si subjekt, pra si fuqi perceptimi dhe sjelljeje. Opinioni ynë se bota na përgjigjet përherë në formën e aleancës me amerikanët, ka qenë një strategji, përmes së cilës ne kemi zbehur veten, kemi zbrazur aleatin prej kompleksitetit të subjektivitetit të tij. Po ashtu si historia jonë nuk i përmban emrat e armiqtve, që na detyruan të kemi heronj, edhe diplomacia jonë e zhvesh së brendshmi aleatin.

Fusha e përcaktimit të armikut dhe njohja e kompleksitetit dhe e kundërthënive brenda aleatit kanë sjellë vetëm një produkt: *zbehjen e karakterit gjenocidal të Serbisë*. Këtu na vjen në ndihmë libri “Aleanca e duhur Shqipëri-Kroaci”. Aty kuptojmë se themelimi i një aleance është shumëformësh, me shumë përbërës afatgjatë. Sepse vetë marrëdhënia e aleancës është subjektivitet, çka do të thotë se Amerika është aleate, kur më parë aleate është Kroacia, Bullgaria, Gjermania, Austria, Britania. Duke rendur te maja e aleancës, ne shpallnim hapur sekretin e vesit tonë,

mangësinë tonë të madhe publike, përtacinë tonë themelore në lidhje me shtetimin: *punën e përditshme*.

Dhe kësisoj, nga gabimi i lidhjes me majën e aleancës, e parë jo si marrëdhënie subjektive, por si objektivitet i pagabueshëm, ne kaluam në fajin e menjëhershëm, në idenë e “Ballkanit të Hapur”. Duke ia hequr subjektin armikut, ne e kthejmë në fushë të ekzistencës sonë, në kusht të mundësisë sonë. Do të më falni për përsëritjen e njëjës prej temave. Por, tanimë, në aspektin e armikut si i vetmi subjekt në gjeopolitikë, më duhet të përsëris në lidhje me Ballkanin. Kjo do të thotë se ka rëndësi vendimtare se në ç’njësi gjeografike na hedh cinikisht gjeopolitika dhe si e sa ne i përgjigjemi pozitivisht këtij projektimi. Studiuesi Shqipërim Pula e risjell në vëmendje faktin, se z. Murati lokalizon gabimin afatgjatë të diplomacisë sonë, anëtarësimin tonë të heshtur zyrtar në Ballkanin Perëndimor.

Por ç’është ky Ballkan, kjo njësi gjeografike, që i ka shërbyer metaforës së “fuçisë së barutit” në kokën përtace të çdo europiani, nëse në atë rajon të botës Serbia e ka nisur përherë luftën dhe shqiptarët asnjëherë? Zoti Murati ka ngulmuar prej vitesh në atë se, nuk ka asnjë kuptim, që shteti shqiptar të pranojë automatikisht e pa një fije reflektimi përkatësinë në Ballkanin Perëndimor. Termi “Ballkan Perëndimor” u shpik në Francë në vitin 2000 nga po ata që e kanë përmendur më shpesh nëpër histori, se Ballkani është fuçi baruti. Kjo ide me autorë dashakeq u pranua nga ne me lehtësinë e papërballueshme të indiferencës.

Ndërkombëtari i përhershëm vjen e na dëfton se të cilës përkatësi jemi. Por kur? Atëherë kur Sllovenia nuk pranon as përkatësi gjeografike me gadishullin e Ballkanit. Kur Kroacia shmang çdo lidhje me Ballkanin Perëndimor, sepse nuk mund të qëndrojë lehtësisht në gjeografinë e krimin të Serbisë. Ajo e kupton se hyrja në ndonjë linjë të paqartë do të krijojë paqartësi të reja. Dhe ja, Serbia organizon “Ballkanin e Hapur”, ku

Shqipëria, me mangësinë e saj në subjekt, në perceptim e vetëdije, merr përsipër të zëvendësojë Slloveninë, madje të kërcënojë Kosovën.

Kjo e fundit na qenka një emër i mundshëm për të përmbushur gjashtëshen e domosdoshme të të imagjinarit jugosllav për çdo Ballkan. E kërcënuar nga vetë Shqipëria, ndoshta ajo do të zëvendësojë Kroacinë tashmë europiane, pra jashtëballkanike. Shteti shqiptar i kryeministrit Rama synon ta tërheqë me vete Kosovën në humnerën e desubjektivitetit. Përmes shtetit substancial të shqiptarëve, Ballkani duhet të ruajë numrin e përbërësve të tij. Pasi i ka hequr Serbisë subjektin prej armiku, masën armiqësore ndaj ekzistencës së shqiptarëve, Republika e Shqipërisë dhe kryeministri i saj duan ta përputhin Ballkanin me projektin e përhershëm serb të Jugosllavisë. Nostalgjia serbomadhe dhe jugosllave e armikut, lënda e subjektit të tij, në kushtet kur ne vetëfshihemi si subjekt, i vjen në ndihmë gjendjes morbide të ndërgegjes europiane, gjendjes melankolike. Melankolia, kjo gjendje e dobët e subjektit, që kaplon Europën, krijohet prej zonave të paqarta të vetëdijes nëpër trevat e saj. E një nga këto treva, që e mundësojnë dobësimin e Europës, jemi ne shqiptarët. Të lehtësojmë prodhimin e zonave të mbyllura me emra të famshëm të hapjes, “Ballkan i Hapur”, ne i kemi shtënë në tru Europës se jemi projekt i hapur për rusët dhe goxha i paaftë për të qenë perëndimorë. Ky është përshkallëzimi.

E nisëm me heqjen e subjektit prej armikut dhe përfunduar me njësimin e një rajoni të tërë si Ballkani në projektin e sllavëve të jugut. Ua humbëm subjektivitetin të gjitha entiteteve publike dhe armiqësore, që prej armikut... deri tek aleati. Ngase kur shuam subjektin e armikut, me po të njëjtin akt ne e shtymë aleatin të mos na paraqitej më i tillë. Dhe ai na klasifikoi në kampin e sllavëve. Sepse ne nuk ditëm të përsërisim presidenten kroate në përcaktimin e saj të tetë viteve më parë: “Ne jemi Europa Juglindore jo Ballkani Perëndimor”. Por, si rëndom, ne nuk e

zotëronim as reflektim e as perceptim. Ca kohë më pas, kryeministri i Shqipërisë do të shpallte bujshëm se ne (shqiptarët) jemi pjesë e “Ballkanit të Hapur”.

Z. Murati na sjell gjithnjë paragjendjen diplomatike shqiptare. Kjo do të thotë se, përmes kryeministrit të tyre, shqiptarët jo vetëm e legjitimonin Ballkanin Perëndimor, por dhe se ky Ballkan ishte një projekt i hapur. E dihet se Ballkani mund të jetë i hapur vetëm në dy forma. Ose sipas linjës shqiptare, drejt Perëndimit, ose sipas linjës serbe, do të thotë drejt Lindjes. Nga ana tjetër, dihet historikisht se një Ballkan në vetvete, i drejtuar nga Serbia, është projekt i mbyllur për shqiptarët. Dhe kështu, pasi Serbia ka mbyllur të tashmen, po i kthehem pyetjes së studiuesit Shqipërim Pula: “Çfarë u duhet për të mbyllur të shkuarën?”. Çfarë i duhet ende? Të vjedhë, të grabisë tërë të shkuarën autoktone shqiptare? Ta marrë për vete e me vete në humnerën e saj sllavo-imperiale? Duke e mbyllur të tashmen, duke vjedhur të shkuarën, ajo e bën fatale të ardhmen e shqiptarëve. Ky është projekti serb, subjektiviteti i armikut, të cilin përpiqemi ta harrojmë në mënyrë zyrtare. Librat e zotit Shaban Murati ndjekin pikë për pikë të gjitha simptomat e sëmundjes që mbartim si republikë e pavarur prej më shumë se një shekulli. Për këtë arsye nuk ka pasur asnjë promovim të tij në Ministrinë e Jashtme të Shqipërisë dhe për këtë arsye ka pasur dy promovime në Ministrinë e Jashtme të Kosovës.

Ne duhet të kuptojmë se si krijohet subjektiviteti. Subjektiviteti i vetes është një temë që e kam trajtuar në aspektin e filozofisë, madje në një ligjëratë në fakultetin filozofik të Prishtinës, në vitin 2010. Subjektiviteti i një trupi qëndron te plaga e tij. Përse plaga? Sepse një trup është i ndërgjegjshëm vetëm te plaga. Aty ndien trupi që është trup. Aty fuqizohet imuniteti si veprimtari e vërtetë e trupit, te plaga. Trupi ekziston te plaga.

Shqipëria e shëruar, republika e pavarësuar prej pazarit të fuqive, është trupi i sëmurë, sepse nuk ka asnjë plagë, sepse përvetësoi amnezinë duke u kthyer në anestezik, anestetik. Pa ndjeshmërinë, pa dijen e fushës dhe lëndës, republika londineze nuk ka asnjë ndjeshmëri sovrane dhe politike. Republika e Shqipërisë është një entitet anestezik, anestetik. Si trup i rehatuar, relativizon virusin, relativizon armikun, relativizon ekosistemin. Nuk sheh subjektivitet aleancash, por subjekt aleati. Nuk shquan subjekt armiku, por punon harresën e vetes. Ndaj dhe te plaga qëndron ndërgjegjja e një kombi. Pra, është krejt normale që Ministria e Jashtme e Kosovës, sado e paqartë të ketë qenë nëpër vite, duke qenë Ministria e Jashtme e plagës së kombit, ndërmerri nismën e promovimit të librave të ambasadorit Murati.

Të dimë po ashtu, se ne jemi të plagosur krejt në Shqipëri, në Republikën Londineze, kjo do të thotë tanimë, se pikërisht dijen e zotit Murati duhet ta propagandojë Kosova në Shqipëri. Përgjithësimi i plagës është dija autoktone. Ky është sekreti strategjik: Shaban Muratin, Hysamedin Ferajn, Abdi Baletën, Enis Sulstarovën, Krenar Zejnon e të tjerë që mund t'i harroj tani, në Shqipëri duhet t'i bëjë të njohur Kosova. Projekti është i hapur. Të gjithë ethet e mendimit në Shqipëri duhet t'i ngjallë Kosova, ashtu siç po kthehet ajo në politikën e jashtme në model të organizimit të mendimit sovran në Shqipëri. Plaga e bën trupin trup. Sot shqiptarët e republikës londineze, falë qeverisjes aktuale në Kosovë, po e kuptojnë se nuk e kanë zotëruar kurrë lëndën e qeverisjes dhe institucionit. Plaga është trupi. Kjo ka qenë dhe do të jetë teza ime bazë: ***shteti amë është Kosova.***

Le të jemi të kthjellët në ndërgjegje! Studiuesit e llojit Murati janë vetëdije e Kosovës, e lindur dhe e rritur në Shqipëri. Çdo njeri që ka punuar në Shqipëri për Kosovën është i lidhur me Kosovën jo në bazë të ideologjive perandorake, por i lidhur në bazë të një zbulimi personal gjatë së shkuarës së vet. Kështu që Kosovës i duhet të koordinojë ndërgjegjet personale,

historiko-familjare, që janë prodhuar rastësisht në Shqipërinë Londineze, për t'i kthyer në ushtrinë e vet cerebrale kombëtare. Kjo është detyrë e institucioneve të Kosovës.

Njerëzit duhet ta lexojnë faktologjinë. Ajo çka ndodh me plagën dhe cerebralin, duhet të ndodhë me studimin. Ekzistenca e mendimit të cilësuar strukturon trurin dhe konsumon shumë më pak energji stomaku, mbijetese. Imperative është themelimi i fushës sovrane të dijes. Duhet të vendosen bashkë librat, që kanë folur për veprimtaritë e heshtura në mënyrë zyrtare nga institucione që kanë dashur të heshtin reflektimin historial. Libra të kësaj natyre duhet të promovohen e të lexohen. Hysamedin Feraj ka shkruar ndoshta thirrjen më të fortë epistemologjike mbi të pafilozofuarën shqiptare. Le të vendosim në këtë rrafsh edhe të padiplomatizuarën shqiptare, që gjendet e shpërndarë në veprat e z. Murati. Sepse, siç kam pëlqyer të them më herët, duhet të zgjatojmë frazën e Marksit: *diplomacia është shprehje e koncentruar e politikës, kurse politika është shprehje e koncentruar e ekonomisë.*

9.2. Prof. dr. Enika ABAZI

Një kontribut i rëndësishëm për mendimin strategjik

Recension për librin e dr. Sadri Ramabajës: “Rivaliteti shekullor: Gjeopolitika postmoderne-rikthimi te vetvetja”, botim i shtëpisë botuese “Onufri”, Tiranë 2024, f. 486

Sipas Richard N. Haass, bota po shkon drejt “epokës së jopolaritetit” (age of nonpolarity). Kjo situatë karakterizohet nga dominimi jo i dy, i tri apo edhe i disa shteteve, por nga dhjetëra aktorë, të cilët zotërojnë dhe ushtrojnë lloje të ndryshme pushteti, duke kthyer kështu normat historike të funksionimit të multiverseve të veçanta. Duke lëvizur drejt kësaj epoke, politika botërore duket se po udhëton drejt së shkuarës, nëse i referohemi John Mearsheimer-it. Për perspektivën realiste, multipolariteti, në të cilin balancimi i fuqive karakterizohet nga dinamika të pasigurisë në rritje, mund të çojnë përsëri në konflikte të mëdha për të njëjtat arsye si në vitet 1914 dhe 1939. Situata aktuale është komplekse, sidomos po të kemi parasysh se në nivel ndërkombëtar jemi në një proces rikonfigurimi të poleve të fuqisë dhe zonave të ndikimit, duke e bërë më të vështirë orientimin politik të vendeve të Europës Juglindore dhe zgjidhjen përfundimtare të çështjes së Kosovës. Kjo situatë komplikohet më tej nga interesat e përzier të fuqive të ndryshme në rajon. Pas aneksimit të Krimesë nga Rusia në vitin 2014 dhe pas përshkallëzimit të luftës në Ukrainë, rendi i gjërave duket se ka ndryshuar ndjeshëm edhe në Europë. Ironikisht, duke pasur parasysh luftën e Krimesë në vitin 1856, duket se përmbysjet e mëdha në Europë gjithmonë fillojnë aty.

Në një situatë të tillë gjeopolitikisht komplekse dhe të paqëndrueshme, libri i dr. Sadri Ramabajës, “Rivaliteti shekullor:

Gjeopolitika postmoderne - rikthimi te vetvetja”, ofron një shqyrtim të thelluar të peizazhit gjeopolitik në përgjithësi, çështjes shqiptare në rajonin e trazuar të Ballkanit, vetëvendosjes së Kosovës në veçanti, si dhe të sfidave aktuale dhe mundësive për të ardhmen e rajonit.

Libri thellohet në kompleksitetin e faktorëve historikë, kulturorë dhe politikë, që kanë ndikuar në formësimin e peizazhit gjeopolitik të Kosovës. Një nga aspektet më bindëse të librit është shqyrtimi gjithëpërfshirës i kontekstit historik që rrethon çështjen e Kosovës, shpalljen dhe pavarësimin e saj në vitin 2008. Autori gjurmon me përpikëri të kaluarën e trazuar të rajonit, që nga statusi shekullor i Kosovës si udhëkryq perandorish e deri te konfliktet më të fundit, që kanë përcaktuar identitetin e saj modern. Ramabaja duke adoptuar një qasje të tillë, u ofron lexuesve një kuptim të nuancuar të tensioneve të rrënjosura thellë, që vazhdojnë të formësojnë realitetet gjeopolitike të rajonit dhe të Kosovës.

Për më tepër, autori lundron me mjeshtëri në rrjetin e ndërlikuar të përfshirjes ndërkombëtare në Kosovë, duke theksuar rolin e lojtarëve kryesorë, si Shtetet e Bashkuara, Rusia dhe Bashkimi Europian. Përmes një analize realiste të manovrave diplomatike dhe interesave gjeopolitikë të faktorit ndërkombëtar, Ramabaja hedh dritë mbi dinamikat komplekse që kanë ndikuar në trajektoren e formësimit të çështjes së Kosovës dhe asaj shqiptare në skenën europiane dhe botërore.

Për më tepër, libri ofron njohuri të vlefshme për sfidat e vazhdueshme me të cilat përballlet Kosova, duke përfshirë çështjet e qeverisjes së brendshme, tensionet etnike dhe politike, si dhe sfidat e zhvillimit ekonomik. Duke i shqyrtuar këto sfida përmes një lenteje gjeopolitike, autori sqaron ndërlidhjen e dinamikave lokale dhe forcave globale, duke u ofruar lexuesve një kuptim gjithëpërfshirës të kompleksitetit gjeopolitik të çështjes së Kosovës dhe asaj shqiptare në rajon në përgjithësi.

Një nga pikat e forta të librit qëndron në qasjen e ekuilibruar të tematikave të trajtuara. Në vend që t'i nënshtrohet thjeshtimit të tepërt apo anësisë ideologjike, autori paraqet një analizë të nuancuar, mbështetur në fakte, që pranon natyrën e shumanshme të realiteteve gjeopolitike. Kjo qasje i lejon lexuesit të zhvillojë një kuptim më të nuancuar të çështjeve në shqyrtim, pa kufizimet e të menduarit binar ose agjendave partiake.

Libri “Rivaliteti shekullor: Gjeopolitika postmoderne - rikthimi te vetvetja” jep një kontribut të rëndësishëm në të menduarin strategjik, një sferë shpesh e anashkaluar. Në një sërë sythesh, autori thellohet në rëndësinë e konsideratave gjeopolitike për çështjen shqiptare, Kosovën dhe rolin e komunitetit ndërkombëtar.

Sythet e hapjes e nxitin lexuesin të kuptojnë pse mendimi gjeopolitik është thelbësor dhe se si ndikon ai në veprimet dhe politikat në shkallë kombëtare dhe globale. Autori argumenton bindshëm, se të kuptuarit e dinamikës gjeopolitike është vendimtare për lundrimin e sfidave komplekse të botës moderne. Një nga pikat kryesore të librit është eksplorimi i kundërshtimit të pavarësisë së Kosovës dhe raporti i saj me konceptin e “zonave të ndikimeve”. Përmes një analize të përpiktë, autori hedh dritë mbi mënyrën se si faktorët gjeopolitikë kanë formësuar peizazhin politik të Kosovës, duke sjellë në vëmendje presionet e jashtme dhe sfidat në politikën e brendshme. Libri thellohet gjithashtu në implikimet e konfliktit në Ukrainë për çështjen shqiptare dhe konsolidimin e pavarësisë së Kosovës. Duke tërhequr paralele mes dy konteksteve, autori ofron njohuri të vlefshme për pasojat e mundshme të tensioneve gjeopolitike globale e rajonale mbi interesat shqiptarë. Më tej, autori shqyrton në mënyrë kritike realitetin e ndarë politik në Kosovë dhe dukurinë e vetëmashtrimit politik të disa aktorëve të spektrit të brendshëm politik.

Përballja me çështjet e brendshme dhe nxitja e unitetit në libër konceptohen si efektive në përballimin e kërcënimeve të jashtme. Analizat kushtuar veriut të Kosovës nxjerrin në pah rëndësinë strategjike të veriut të Kosovës dhe nevojën për politika, të cilat kanë prioritet interesat kombëtarë.

Në këtë libër shqyrtohet gjithashtu roli i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së) në formësimin e trajektores së përpjekjeve shtetndërtuese në Kosovë. Për më tepër, autori propozon Aleancën e Sigurisë *Kosovë - SHBA*, si një zgjidhje praktike për të adresuar shqetësimet e sigurisë në Kosovë, pasi ajo forcon infrastrukturën e sigurisë së Kosovës, ndihmon në përballimin në mënyrë efektive të kërcënimeve të jashtme dhe në parandalimin e krizave të mundshme përpara se ato të përshkallëzohen. Dr. Ramabaja ofron një analizë të kthjellët të zhvillimeve në fushën e diplomacisë, duke vënë në pah pasigurinë e situatës dhe pasojat e mundshme të ngërçeve diplomatike.

Më tej autori thellohet në kompleksitetin e marrëdhënieve BE-Balkan dhe Kosovë në veçanti. Përmes një shqyrtimi kritik, autori sqaron duke hedhur dritë mbi sfidat që pengojnë angazhimin dhe bashkëpunimin efektiv për zgjidhjen e sfidave. Ringjallja e rivalitetit shekullor serbo-shqiptar, e ndriçuar nga zhvillimet në Ukrainë, merr një vëmendje të veçantë në këtë libër. Autori tërheq paralele midis armiqësive historike dhe dinamikave bashkëkohore gjeopolitike, duke nënvizuar natyrën komplekse të konflikteve rajonale. Në këtë kuadër, në këtë libër prezantohet koncepti i *Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe* (Zajednica - në gjuhën serbe), si një katalizator potencial për të ndezur tensionet dhe për të prishur paqen e brishtë në Kosovë dhe, më tej, edhe në rajon.

Në vazhdim analiza pasurohet me detaje dhe fakte mbi rikalibrimin strategjik të politikës së jashtme të Serbisë, dhe rigjallërimin e doktrinës “Bota Serbe”. Duke analizuar manovrat e fundit diplomatike të Serbisë, në

libër ofrohen perspektiva të vlefshme për të kuptuar jo vetëm ndryshimin e qëndrimit gjeopolitik të Serbisë, por edhe implikimet e saj në dinamikën rajonale dhe kompleksitetin e aleancave dhe balancave në Ballkan. Nëpërmjet vëzhgimeve të nuancuara, Ramabaja ofron një vlerësim të matur të kapacitetit të Kosovës për të lundruar në sfidat gjeopolitike, duke theksuar nevojën për prirje realiste.

Në këtë vepër ofrohet një shqyrtim i hollësishëm i tensioneve dhe i sfidave midis Ruisë dhe Perëndimit, duke sjellë në vëmendje ndikimin e tyre në politikën globale dhe ndërgjegjësimin e nevojës për një strategji të qëndrueshme dhe efektive për të trajtuar këto sfida në rajonin e trazuar të Ballkanit dhe më gjerë. Interesant në libër është dhe vështrimi realist dhe shumëdimensional i kompleksitetit të luftës hibride në rajonin e Ballkanit, duke identifikuar sfidat dhe mundësitë për të arritur një stabilitet të qëndrueshëm dhe një proces politik të qartë dhe të integruar. Me interes është trajtesa e sfidës së qeverisjes në kushtet e dezinformimit, që sjell në vëmendje rëndësinë e transparencës dhe të integritetit në procesin politik.

Ringjallja e rivalitetit shekullor serbo-shqiptar, e ndriçuar nga zhvillimet në Ukrainë, merr një vëmendje të veçantë në këtë libër. Autori tërheq paralele midis armiqësive historike dhe dinamikave bashkëkohore gjeopolitike, duke nënvizuar natyrën komplekse të konflikteve rajonale. Në vend të konkluzioneve, libri ofron një shqyrtim interesant dhe të detajuar të proceseve në formësim të krijimit të një rendi të ri botëror, duke identifikuar tendencat kryesore, sfidat dhe rolin e konflikteve dhe të krizave të përhershme në formimin e rendit të ri botëror, aktorët kryesorë në arenën ndërkombëtare dhe atë rajonale, implikimet e tyre në arenën ndërkombëtare në përgjithësi dhe në çështjen e Kosovës në veçanti dhe mundësitë për një të ardhme më të qëndrueshme dhe të paqtë në Ballkan dhe në arenën ndërkombëtare.

Në përfundim duhet theksuar se libri ofron një eksplorim gjithëpërfshirës e të kryqëzuar të gjeopolitikës së madhe e rajonale dhe interesave mbarëshqiptarë në të dy kontekstet. Me analizën e tij të thellë dhe rekomandimet pragmatike, libri shërben si një burim i vlefshëm për politikëbërësit, studiuesit dhe këdo që është i interesuar të kuptojë dinamikën gjeopolitike të Ballkanit, çështjen e Kosovës, asaj mbarëshqiptare dhe më gjerë.

Paris, mars 2024

9.3 Dr. Sadri RAMABAJA

Kultura politike në ndryshim: një jetë në shërbim të Kombit

Recension për librin e dr. Luljeta Pulës “Rrëfimi i një jete për Kosovën”, botim i shtëpisë botuese “Koha”, Prishtinë 2020, f. 577

Ndryshimet në rrafshin e kulturës politike në memorien politike të dr. Luljeta Pulës kanë përfshirë të gjitha shtresat e shoqërisë në përmasa të mëdha, duke filluar me demonstratat e 1968-ës deri në luftën e UÇK-së së vegjëlisë për liri. Ato kanë reflektuar nga një brez te tjetri, nga lëvizja gandiste e shpifur e viteve ‘90-të te guximi qytetar për përballje me apartheidin në dekadën e fundit të shekullit XX. Në literaturën profesionale *fenomeni i kulturës politike* si pjesë e një realiteti të gjerë politik, ndër studiuesit tanë është trajtuar fare pak dhe atë kryesisht nga dojani Gani Bobi në dy veprat e tij të njohura, si: “Paradoks kulturor” (1986) dhe “Konteksti i vetëkulturës” (1994).

Libri i dr. Luljeta Pulës që na vjen në trajtën e memuarëve politike, është pa dyshim një margaritar i llojit të vet, që do të jetë në shërbim të studiuesve të mendimit politik e kulturor ndër ne. Libri është i strukturuar si një tërësi e ndarë në 38 njësi, shto kësaj dhe një përmbledhje foto-dokumente, ku pasqyrohen disa prej shkrimeve dhe njoftimeve të shtypit të kohës për aktivitetin publik politik të autores së librit gjatë dekadës së fundit të shekullit XX, të cilat, siç thotë autorja, shpëtuan rastësisht. Ndërkaq, njësi të veçanta si këta: *Takimi im i parë me Shqipërinë - Zhgënjimi më i madh i jetës sime, 1981; Kthesa më e madhe historike e Kosovës; Referati i plotë në simpoziumin për helmimet në Zagreb - qershor 1990; Deklarata e pavarësisë dhe historia e saj; Farsa politike e luftës ideologjike në Kosovë; Shajnë*

Fadil Hoxhën e komunistët që “tradhtuan” Kosovën në atë kohë, e sot bëjnë pazare me tokën e Kosovës; Viti 1997 - kthesë serioze e Lëvizjes; Linçi i Likoshanit; E keqja kishte pllakosur Kosovën e lirë... janë njësitë ku është derdhur gjithë dëshmia historike e kësaj epoke, me penelata ngjyrash e emocionesh krijuese të autores së librit, dr. Luljeta Pula.

Ajo që e pasuron shumë këtë libër memoriesh janë edhe portretet dhe gjykimi shumë racional e kritik mbi personalitete të jetës politike e shtetarë tanë, qofshin ata të periudhës së socializmit militant [1944-1991] në Shqipërinë politike, siç do ta cilësonte Ukshin Hoti këtë epokë, apo ata të komunizmit jugosllav të kësaj periudhe në Kosovë, e deri te figurat politike të fazës së parë të tranzicionit demokratik në Shqipëri e dekadën e parë të pasluftës në Kosovë, përfshi edhe shpalljen e pavarësisë, si ngjarja më kulmore në historinë tonë moderne, pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë më 28 Nëntor 1912.

Teksa po lexoja me vëmendje të shtuar kapitullin “*Farsa politike e luftës ideologjike në Kosovë*”, ku autorja merr guximin dhe vë pikën mbi i, do të thosha të munguar në Kosovë, nuk kisha si mos t’i kthehem një eseje që kisha shkruar vite më parë me një titull paksa specifik: *Gandizmi i munguar i Rugovës*. Ndërkaq, në disa njësi radhësh të librit, autorja dr. Luljeta Pula mbarështron disa nga ndeshtrashat e shoqërisë sonë në procesin e ndërtimit të Republikës, respektivisht demokratizimit të kulturës politike dhe përfundime me peshë dhe me shumë interes për lexuesit.

Demokracia parlamentare është produkt historik i përballjeve mes grupimeve politike konservative dhe atyre liberale. Të ushqyerit e saj me aktivizim qytetar ka bërë që ajo të marrë elemente të demokracisë reale. Pushtimi i tempullit të demokracisë (Kuvendit) në lindje në Kosovë, nga oligarkët e olhokratët për një periudhë fare të shkurtër, ka bërë që Republika të shndërrohet në peng, ndërkaq demokracia formale të jetë edhe më e

brishtë. Për rrjedhojë, qytetaria në Republikën e zënë peng mbetet peng u i parë. Ajo duhej të lirohej më 14 shkurt 2021, që të çlirohet Republika.

Partikularizimi i forcës politike si strategji

Suspendimi i statusit të autonomisë që kishte Kosova në kuadër të kushtetutës jugosllave të vitit 1974 shpërfaqti dukshëm dy rrymat ekzistuese të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë, jo vetëm në Beograd, por edhe gjatë në nivel Federate, duke përfshirë edhe Kosovën. Këtë fakt e mësojmë edhe më mirë teksa lexojmë faqe të tëra të këtij libri, që sjellin kujtimet nga vitet e rinisë dhe formimit atdhetar e politik të autores së librit, duke filluar nga demonstratat e vitit 1968, kur ajo ishte nxënëse, e deri tek ato të pranverës së madhe të 1981-ës, ku na shfaqet sërish si pjesëmarrëse aktive e deri te jeta intensive e angazhimit të saj politik në dekadën e fundit të shekullit XX. Por, siç kisha vënë në pah në një ese pararendëse, në Kosovë ndërkohë ishte profiluar edhe poli i tretë i LKJ-së.

Rryma e ashtuquajtur “nacionalistë institucionalë”, të cilët pretendonin se përfaqësonin interesat e “nacionalizmit institucional shqiptar”, pavarësisht edhe lojalitetit që dëshmonin në raport me ruajtjen e Federatës Jugosllave, do të transformohet pothuajse e tëra në LDK, duke i hapur rrugë me këtë akt, qoftë edhe pa paramendim, homogjenizmit të jashtëzakonshëm të popullit.

Ana pozitive e ideologëve të LDK-së në këtë fillim të formësimit të saj si forcë politike, ishte se do të pamundësojnë që në strukturat e saj të pozicionohen elemente të rrymës radikale projugosllave, por as edhe ata të polit të tretë, që identifikoheshin me Azem Vllasin etj. që pretendonin të riktheheshin në skenë përmes PSD-së. Element të këtij poli do ta gjejnë ndërkohë veten më shumë te fraksioni i Partisë Socialdemokrate që do ta

krijojë ideologu i LDK-së, siç mësojmë në kapitujt ku autorja trajton këtë fenomen.

Në anën tjetër, struktura revolucionare po vazhdonte të shëronte “plagët e rënda” që kishte marrë në nëntor-dhjetorin e 1984-ës dhe ishte në kërkim të rrugëve për veprim konkret, duke ndërtuar celulat e para të gueriles. Udhëheqësit e saj kryesorë, Fadil Vata, Afrim Zhitia, Bardhyl Mahmuti, Sabri Kiçmari... atëbotë ishin ende tejet të rinj` për ta përballuar atë kthesë që kishte sjellë historia.

Koha kërkonte korifenj të mendimit, intelektualë të guximshëm, siç ishte Ukshin Hoti, që jo rastësisht mbahej peng në burgjet serbe. Kjo është koha, kur autorja e librit kishte refuzuar një ofertë që i ishte bërë nga një krah i ilegales revolucionare, duke konsideruar se kontributi i saj më i madh për çështjen kombëtare, kauzën e lirisë, ishte jeta aktive me studentë dhe komunikimi interaktiv me shoqërinë nga pozitat e legalitetit. Parë nga këndvështrimi i sotëm, duke marrë në konsideratë edhe krahun e ilegales që i kishte bërë ofertën për angazhim të drejtpërdrejtë tok me forcat revolucionare, vendimi i zonjës Pula ka qenë i drejtë. Dekada që do të pasojë, do të kërkonte që në krye të betejave do të viheshin gjeneralë, siç ishte Fehmi Lladroci. Por ai në pamundësi të zbatimit të projektit për marshim e zbarkim me brigadën e tij nga frontet e luftës në Kroaci, e që kishte rreth 1500 luftëtarë, që në fakt shestohej të ishte bërthama e UÇK-së, që pledonte t’i sillte në Çiçavicë e gjetkë në malet e Kosovës, detyrohet të mërgojë në Gjermani, për t’iu kthyer Kosovës pas rënies së Adem Jasharit me Jasharët e tjerë, sërish pas vonesave të shkaktuara nga puçistët, që tashmë e kontrollonin UÇK-në! [1]

LPK-ja atëbotë, kur Serbia ishte e zhytur thellë në frontin e luftës në Perëndim (në Kroaci e Bosnjë), ishte tepër e dobët që të mobilizonte popullin dhe të hapte frontin e jugut. Ndërkaq, LDK-ja nuk ishte e përcaktuar

politikisht për luftën si mjet për çlirim. Ajo me kohë ishte pozicionuar për reformë politike pa alternativë! Prandaj po kultivonte artin e durimit, në fakt aktin e poshtërimit publik, me idenë që faktori i jashtëm, demokracinë perëndimore, do t'ia impononin Serbisë kthimin e autonomisë së suspenduar. Ky objektivi i krerëve të LDK-së, që në aparençë dukej realist dhe, megjithëse në heshtje, i pranueshëm edhe për popullin, shpejt do ta shndërronte LDK-në në forcën politike dominante dhe me ndikim madje edhe në rrafshin kombëtar. Këto fakte dr. Luljeta Pula i trajton në disa prej pjesëve qenësore të librit. Pesë vitet e para të funksionimit të LDK-së si lëvizje popullore (1989-1995), ajo, megjithatë, në terren do të shndërrohej në forcë kohezive kombëtare dhe do të luajë rol pozitiv në organizimin e mbijetesës. Në dobi të këtij kohezioni shkojnë paradoksalisht edhe të dhënat e terrenit. Fillimi i kësaj periudhe do ta gjente zonjën Pula në krye të Shoqatës së Gruas, që vepronte si mekanizëm autonom brenda LDK-së, që do të arrijë pikën kulmore, duke aktivizuar një armatë të tërë të femrës kosovare në dobi të kauzës kombëtare, si asnjëherë më parë. Natyrisht, duke u imponuar në kuptimin më pozitiv të fjalës, kjo shoqatë gradualisht po fitonte peshën e vet brenda LDK-së, duke tërhequr edhe luftën speciale mbi drejtuesen e saj.

Në këto rrethana të reja të krijuara në terren, partikulariteti i shoqërisë shqiptare në parti politike nuk do t'i mjaftonte Beogradit për realizimin e platformës së tij në raport me Kosovën.

Në terren, aty ku aplikohej loja, respektivisht imitimi i demokracisë, nuk mund të kontrollohej çdo gjë. Siç dihet tashmë, në skenën e atij pluralizmi alogjik e për shumëçka absurd, do të imponoheshin dhe profiloheshin edhe forca politike me orientim koherent kombëtar, siç ishin Partia Parlamentare, Partia e Unitetit Kombëtar (UNIKOMB-i) dhe PSD-ja, që ndërkohë drejtonte zonja Luljeta Pula. Sidoqoftë, ky fakt do të shfrytëzohet nga Beogradi si

mundësi shtesë, që të nxiste e stimulonte rivalitet midis partive për çështje në thelb banale, siç ishte gara (zgjedhjet e 24 majit 1992) për Parlamentin dhe për pushtetin inekzistues! Reagimi i zonjës Pula kundër atyre zgjedhjeve nuk kishte si të ishte ndryshe nga ai që ajo artikuloi në kumtesën e PSD-së, duke i cilësuar ato zgjedhje si gafë të llojit të vet politik.

Disi ngjashëm kishin vepruar turqit për të shmangur idenë e lirisë në pjesë të tëra të Shqipërisë së okupuar. “Turqit nuk ia arritën t’i pushtojnë fiset malësore me forcën e armëve, prandaj ata, gjatë shek. 17-të, filluan të emërojnë bajraktarët dhe të krijojnë bajraçet në Malësi, me qëllim që të dobësojnë autoritetin e krerëve të fisit dhe fuqinë e tij. Bajraktarëve turqit u jepnin dhurata, rroga e dekorata të ndryshme dhe këta e kishin për detyrë të merrnin pjesë me njerëzit e bajrakut në luftëra të ndryshme që bënin turqit në Ballkan ose më larg”. [2]

Ashtu si bajraku më i madh turk në shek. 17-të, edhe LDK-a si partia më e madhe legale në Kosovë në gjysmën e dytë të dekadës së saj të parë të funksionimit (1995-1999), përveçse do të shndërrohej në autoritet më të lartë politik në vend dhe në një masë “përfaqësuese” e interesave të “komunitetit shqiptar” në Serbi, duke zotëruar një lloj pushteti moral, ajo do të aplikojë “fuqinë” e “shtetit paralel” imponues në lëmin e arsimit dhe në atë sociale e shëndetësore, duke qenë kështu edhe më afër popullit. Krerët e saj, pavarësisht nivelit akademik që kishin, rezononin me logjikën e bajraktarit të shekullit 17-të! Bajrakut, alias LDK-së i përkiste, siç gjykonin ata, “*prirja e përgjegjësia e parë ndër punë të brendshme e të jashtme... në kohë lufte dhe paqe*” [3], thekson studiuesi nga më të veçantit të asaj epoke, Bernardin Palaj, teksa hedh dritë për rolin e Bajrakut nën pushtimin turk.

Ky diferencim politik e ky kontroll i rreptë në lëmin e sigurisë nga ana e Serbisë, do t’i shtrëngojë rrathët çdo ditë e më tepër. Ai do të shoqërohet vazhdimisht me arrestime të kujtdo që do të guxonte të bënte

ndonjë veprim në lëmin e organizimit me karakter çlirimi. Janë të njohura arrestimet masive të fraksionit të parë të LPK-së, të njohur si Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK), por edhe i pjesëtarëve bërthamë të dy ministrive të Qeverisë “Bukoshi”: asaj të Mbrojtjes dhe asaj të Punëve të Brendshme. Ndërkaq, autorja e librit këtë diferencim politik do ta përjetojë si një linçim klasik, pas fjalimit të saj historik, të përmbledhur në një fjali lapidare, të mbajtur në Likoshan, teksa po varroseshin viktimat e masakrës serbe në Likoshan. *“Fajtor për këtë që po i ndodh popullit tonë është jo vetëm regjimi kriminal i Millosheviqit, jo vetëm injorimi i turpshëm i faktorit ndërkombëtar ndaj çështjes së Kosovës, por edhe lëvizja politike e Kosovës, me në krye Ibrahim Rugovën”*. Kjo ishte fjalia perlë, që do ta dëgjonin mijëra qytetarë, një pesë e trupit diplomatik që kishte ardhur në këtë varrim të llojit të vetë, por që do të përcillej gjithsesi edhe në kancelaritë e botës perëndimore.

Ishte ky konstatim tepër realist, që dilte nga shpirti i qashtë i një shqiptareje intelektuale, rrjedhimisht jokoniunktural e shumë i guximshëm, që do të shënjojë edhe pikën e kthesës në karrierën e saj politike, duke e shndërruar atë në një zonjë të madhe, por të mënjanuar nga skena politike! Me këtë mënjanim të saj tani e tutje, që po impononin qarqet reaksionare dhe kolona e pestë që kishte impenjuar thellë brenda LDK-së, gjithsesi humbëse ishte klasa politike kosovare.

Ringjallja e traditës luftarake në dritën e integritit socio-politik

Ashtu siç kishte ndodhur me institucionin e Bajrakut nën pushtimin turk, që gradualisht i ishte “dorëzuar traditës së vendit”, edhe anëtarët e këtyre partive, pjesë e pushtetit legal pluripartiak në Serbi, do t’i japin gjak rezistencës që u ngrit në nivelin e UÇK-së të strukturuar në brigada, që për bërthamë *de facto* kishte Këshillat Popullorë të LPK-së dhe strukturat bazë të

LKÇK-së. Me të drejtë, konkludon studiuesi ynë Gani Bobi, *“veprimi i rrafshit popullor të integritit socio-kulturor ka arritur që të krijojë forma krejt të ndryshme me ato që janë imponuar nga pushtuesit. Kjo jo vetëm që duhet të merret parasysh për institucionet e veçanta që janë themeluar e stimuluar nga pushtuesit e që gjatë kohës janë kthyer kundër tyre...”* [4]

Historia politike e Kosovës, jo vetëm ajo e kuazipluralizmit të dekadës së fundit të shek. 20-të, por edhe e asaj kur funksiononin institucionet e KSAK-së (1974-1981), e tumir këtë tezë, ndërkaq LDK-ja si fenomen politik e sforcon atë, meqë aktivizimi politik i qindra e mijëra veprimtarëve të saj në terren do t'i japë shpirt mbijetesës së kësaj pjese të Kombit në këtë krahinë të Shqipërisë së okupuar. Ajo armatë aktivistësh, që besonin e vepronin në të mirë të institucioneve të shtetit (qoftë ai edhe paralel), meritojnë respekt. Këtë respekt për këtë armatë aktivistësh, sidomos atyre që vepronin në kuadër të Shoqatës së Gruas brenda LDK-së, që zonja Pula drejtonte, e ka shprehur disa herë edhe vetë autorja në këtë libër.

Duket që pikërisht kjo frymë dominante në mesin e aktivistëve të LDK-së, do të jetë vendimtare në kohë lufte, e në çastin më kritik do të pamundësonte krijimin e qeverisë kuislinge në pranverën e vitit 1999, kur po tentonte ta krijonte Beogradi me ngulm. Por u mbetet historianëve, pas krijimit të mundësive për shfrytëzimin e arkivave, që të gjejnë arsyet reale pse Serbia nuk kishte tentuar më herët (gjatë dekadës së aparteidit, 1989-1999) të krijonte qeverinë kuislinge legale me seli në Prishtinë. Le të kujtojmë se Gjermania e Hitlerit, kudo ku kishte instaluar aparatin e saj ushtarak e të ndjekjes gjatë gjithë LDB-së, madje edhe në Francën e “kombit të madh” ia kishte arritur të instalojë qeveritë kuislinge. Historia gjithsesi do të hedhë dritë, nëse ky dështim i Serbisë në pranverën e vitit 1999 ishte arsyeja themelore që do ta likuidonte prof. Fehmi Aganin. Ka zëra që pohon se kishte refuzuar postin e kryeministrit në atë qeveri kuislinge, që i duhej

Beogradit ta shfrytëzonte si truk për ndërprerjen e bombardimeve nga NATO-ja, duke ia imponuar Serbisë vënien në lëvizje të “Planit B”, që nënkuptonte tërheqjen e Ibrahim Rugovës në Beograd dhe depërtimin e tij më pas në Itali. [5]

Rambujsja dhe rezervati indian i Meksikës

Konferenca e Dejtonit (1995), pas tri vitesh luftë dhe gjenocidit serb ndaj kombit boshnjak, e kornizoi disi projektin që do t’i jepte fund luftës, duke imponuar paqen e brishtë dhe një shtet të dobët. Bosnja edhe pas tridhjetë vjetësh, në të gjitha analizat serioze, vazhdon të cilësohet si “shtet i dobët” ose edhe më keq, si “shtet në dështim”. Teksti i marrëveshjes që i ishte imponuar palës shqiptare për ta nënshkruar Konferenca e Rambujesë, në rast se do t’i mungonte aneksi B, me çka do të mund të ishte i pranueshëm për palën serbe, Kosovës ia rezervonte *de facto* statusin e rezervatit që kishin dikur indianët në Meksikë.

Beogradi do të shtrëngohet ta nënshkruajë “aktin e kapitullimit” pikërisht në Kumanovë më 9 qershor 1999. Vini re se çfarë inercioni bart në kurrizin e saj historia: pushtimi i Kosovës nga armata serbe i kishte hapur portat e betejës tepër të përgjakshme në Kumanovë më 24 tetor 1912. Në pamundësi që të kthehet te Marrëveshja e Rambujesë, Serbia projektonte idenë e amplifikimit të strategjisë së aplikuar ndaj Bosnjës, ndarjen e saj, respektivisht federalizimin dhe imponimin e statusit të shtetit në dështim.

Pak pas LDB-së, saktësisht në vitin 1948, filozofi francez Zhan-Pol Sartri (Jean-Paul Sartre), kishte publikuar një artikull në trajtën e një trakti, ku nënvizonte paradoksin politik të kohës, teksa konkludonte se, si popull, “kurrë nuk kemi qenë aq të lirë sesa gjatë pushtimit gjerman”, meqë vetëm atëherë populli francez ia kishte arritur të shprehte “gjestin e angazhimit subjektiv tërësor”.

Në pjesën e dytë të dekadës së apartheidit në Kosovë (1995-1999), që përkon me periudhën postdejtoniane, gjithë investimi i LDK-së, që përmes rrugëve të veprimit liberal- reformist, duke u prezantuar si partner bashkëpunues i qendrave vendimmarrëse, dukej se do të shkonte dëm, lufta do të jetë e pashmangshme. Në përballje me këtë rrjedhë të ngjarjeve, njëri nga themeluesit e LDK-së, aktualisht kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve e Kosovës (ASHAK), do të vlerësojë edhe pesëvjetëshin e parë të ekzistencës së LDK-së, si “Vite të humbura”. [6] Por, nëse më tutje analizohet edhe rrjedha e pjesës së mbetur të asaj dekade nën apartheidin serb dhe sjelljet e LDK-së dhe dekada si tërësi, jo vetëm se do të mund të cilësohej si “dekadë e humbur”, por ajo do t’i humbiste kuptimin edhe përcaktimit të Sartrit, meqë qëndrimi i LDK-së do të na rezultojë absurd. Në këto rrethana, në vend që ne si popull të ishim të lirë në ndërtimin e “subjektivitetit tërësor” në shërbim të homogjenizimit në frontin e luftës, siç sugjeron në sa e sa kumtesa e prononcime të saj PSD-ja, respektivisht drejtuesja e saj, zonja Luljeta Pula, vazhduam të ishim të bindur ndaj gurusë dhe LDK-së, duke e fragmentarizuar qëndresën deri në absurd dhe duke sabotuar çfarëdo organizimi real çlirimtar. [7] Rrjedhimisht, po vazhdohej të ngrihej tashmë maja e “piramidës së vetëmashtrimit”. Rugova do të vazhdojë më tutje “të fshihet prapa idesë së madhe të pavarësisë së Kosovës, por asnjëherë realisht nuk u angazhua për çlirimin e saj”. Ndërkaq, për t’i larguar nga skena oponentët e mundshëm politikë, ai do të përdorë skemën e antikomunizmit, duke i quajtur ata si “marksistë-leninistë, jo aq sa për t’i satanizuar, sa për ta paraqitur kauzën shqiptare si komplot marksist-leninist”, pavarësisht faktit se “dy mandate ishte sekretar i organizatës së LKJ-së pranë Institutit Albanologjik”. [8] Ndërkaq, jo rastësisht “më 1990 në Kongresin Amerikan ai kërkoi zyrtarisht autonomi për Kosovën... gjatë dëshmisë që ata organizuan për Kosovën. Në fjalimin e tij, në Kongresin Amerikan, Rugova

ndër të tjera, tekstualisht tha: “Shqiptarët insistojnë që, krahas demokracisë të kenë edhe autonominë, edhe pavarësinë në kuadër të Federatës Jugosllave”. [9] Më tutje, nga fundi i këtij kapitulli, autorja na risjell në vëmendje se “askush, ama bash askush, jo vetëm nuk e kritikoi paraqitjen dhe kërkesën e tij atje, por nuk u mor fare me të, sikur të mos kishte ndodhur fare. [10] Kjo po ndodhte, sipas autores, meqë *“kulti i tij ishte aq i fuqishëm, ...aq e vetëkuptueshme amnistia ndaj çdo gjëje që vinte nga ai... por një dehje me të, për fat të keq e për çudi të madhe, vazhdon edhe sot kur ai nuk është më”*. [11]

Por, pavarësisht se i tillë ishte, i shndërruar në një lloj guruje i Kosovës, ai nuk do të shndërrohej në figurë përbashkuese për të gjithë as në momentin crucial historik, meqë i tillë, i pranueshëm për të gjithë, si ishte Gandhi, Rugova nuk do të jetë kurrë. Ai nuk do ta pranojë asnjëherë UÇK-në si strukturë politiko-ushtarake çlirimtare.

Qytetërimi hindu i Gandit si mjet politik dhe “refuzimi estetik” i Rugovës

Programi jo i dhunshëm i Gandit, sipas intelektualëve si Nehru, në thelb ofronte rrugëdaljen e duhur nga bllokimi që i kishin bërë Kongresit dy vijat politike që deri atëherë, kishin treguar paaftësi për zgjidhjen e nyjës së ngërçit: ajo e dhunës (e Tilakut) dhe e dyta, e konstitucionalistëve të brishtë që ishte praktikuar nga Kongresi. 9 gandi, gjithnjë sipas B. Moore, prekte një tel shumë të ndjeshëm të qytetërimit hindus dhe e bënte atë në atë mënyrë, që *de facto* e nguliste vendin në opozitë me britanikët, pra pa i kërcënuar interesat e shoqërisë indiane.

Tendenca për ta imituar Gandin përmes organizimit të “sistemit paralel”, respektivisht “shtetit paralel”, do të dështojë tërësisht pas Konferencës së Dejtonit. Ajo tendencë, në njërën anë kishte dëmtuar rëndë

karakterin kryengritës të shqiptarit si qenie njerëzore aktive, në anën tjetër kishte lënduar keq e seriozisht dinjitetin e tij, pra palcën e vertikales së kombit. Përmes aplikimit të të ashtuquajturit “refuzim estetik” në sferën e politikës reale, duke i dorëzuar pa farë rezistence institucionet legale e publike, ndërmarrjet ekonomike e korporatat e fuqishme si “Trepça”, KEK, AGROKOSOVA etj., duke i pozicionuar shqiptarët si bllok në rolin e opozitës ndaj shtetit serb, por pa e cenuar fare aparatit represiv, funksionimin dhe sovranitetin e shtetit mbi Kosovën. Kjo rezulton të ketë qenë arsyeja qenësore përse shteti serb toleronte të “funksiononin” mekanizmat e “shtetit paralel”, ndërkaq liderit të tij, Ibrahim Rugovës, i krijonte hapësirë veprimi, jo rrallë duke e përcjellë shpurën e tij deri në aeroportin e Shkupit, si të ishte njëri nga ministrat e Millosheviqit!

Por, në dallim nga Gandhi që krijoi e shpalosi në vazhdimësi programin e tij të veprimit, Ibrahim Rugova *de facto* “funksionoi” pa program veprimi! Këtë fakt e vë në pah jo një herë edhe autorja e librit, z. Luljeta Pula. Por ajo, si një fisnike e racës arbërore, e pohon jo pa dhimbje, se do të donte që të ishte jo e vërtetë ajo që profesor Qosja shkruan për gurunë e Kosovës. *“Në valën e dhunës dhe terrorit e krimeve kundër njerëzimit, kryetari i kësaj partie më të madhe e më jetëgjatë të Kosovës [Ibrahim Rugova v.a.] do të bëjë marrëveshje më 28 prill të vitit 1999 me zbatuesin besnik të politikës së Millosheviqit, në atë kohë kryetar i Serbisë, Millan Millutinoviçin, për krijimin e qeverisë kuislinge shqiptare. Dhe kjo marrëveshje tradhtare do të nënshkruhet në ndërtesën e Kuvendit e të Qeverisë së dikurshme të Kosovës. Me atë rast “solemn” kryetari i partisë shqiptare do t’i çojë dhurata kriminelit Millan Millutinoviç... [12]*

Në Perëndim, në qarqet intelektuale, janë të mirënjohura dy shtylla, mbi të cilat ishte ngritur programi i Gandit:

- objektivi i pavarësisë;

- metoda jo e dhunshme e mosbashkëpunimit (*Satyagraha*, që njihet edhe si “Rezistencë pasive”. [13]

Këtë program veprimi Gandhi e mbarështronte qartë në fjalimet dhe shkrimet e tij. Në Indi ai program njihet me emrin “Suadeshi”. Mungesa e një programi të qartë politik, madje edhe në prag të luftës, e sjell LDK-në, e më specifikisht Ibrahim Rugovën, në përplasjen më serioze pikërisht më 1 tetor 1997 me Unionin e Studentëve të UP-së, por edhe me lëvizjen revolucionare, që tashmë kishte strukturuar bërthamat e para të UÇK-së. Intenca e studentëve për ta thyer *status quo*-në ishte jo vetëm e ligjshme, por edhe në përputhje me frymën revolucionare që po ndërlidhte Lëvizjen Studentore me UÇK-në në Lindje. Kësaj ngjarjeje zonja Luljeta Pula i ka kushtuar njërin prej kapitujve më të mirë të librit që mban titullin “*Viti 1997 - kthesë serioze e Lëvizjes*”.

“Në kohën kur faktori ndërkombëtar po këmbëngulte në mënyrën më arrogante të mundshme për mbajtjen e Kosovës nën Serbi, - shprehet autorja e librit, - në skenë del UÇK-ja, që do të gëzojë menjëherë mbështetjen e studentëve.” Me të drejtë, autorja e librit, në atë periudhë që po hynte Kosova, konstaton: “*Funksionimi përmes partive politike në ato rrethana ishte një nonsens dhe një absurd.*” [13] Gjithçka ndryshoi më 1 tetor të vitit 1997. Protestat masive që organizuan studentët e Universitetit të Prishtinës me në krye Albin Kurtin, për lirim të objekteve të universitetit, u shndërrua në “*një kthesë më serioze në lëvizjen politike të Kosovës, e cila përfundimisht dhe në mënyrë të imponuar ndryshoi rrjedhën e saj.*” [14] Prandaj ajo ngjall shpresë edhe tek autorja, meqë atë ajo e cilëson edhe si “*një ringjallje kombëtare dhe një rikthim i dinjitetit të nëpërkëmbur.*” [15]

Por, siç e ka stivuar këtë ngjarje historia si pikë kulminante në pragun e luftës në Kosovë, do të duhej ta stivonte edhe sjelljen e LDK-së ndaj saj, si pikën më kulminante të turpit politik.

Kjo sjellje e Ibrahim Rugovës, në thelb, nuk kishte të bënte fare me frymën gandiste, siç pretendonin ca intelektualë oportunë të oborrit dje dhe vazhdojnë këtë melodramë ligjërimi edhe sot. Duke arsyetuar atë sjellje të tij obskurantiste, jo rrallë tentonin ta cilësonin LDK-në si një vazhdimësi e Lidhjes së Prizrenit, duke fyer inteligjencien e çdo dëgjuesi dhe lexuesi kritik.

Në këto rrethana, një shtresë intelektualësh dhe veprimtarësh nacionalist progresiv, si Halil Alidemaj, Ukshin Hoti, Bashkim Mazreku, Bajram Kosumi, Beadin Hallaqi etj. do të krijonin Partinë e Unitetit Kombëtar (UNIKOMB), ose do të merrnin drejtimin e Partisë Parlamentare. Ndërkaq në prag të Konferencës së Rambujesë dhe gjatë saj, tok me Lëvizjen Demokratike të Bashkuar (LDB), që do të themelohej më 1998 e do të drejtohej nga profesor Rexhep Qosja, Hydajet Hyseni e Mehmet Hajrizi, do të arrijnë të shndërrohen në faktor të kohezionit politik e kombëtar, për aq sa do të lejonin rrethanat.

Sidoqoftë, në prag të luftës, më tutje LDK-ja do t'ia dalë edhe për shkak të karizmës së Ibrahim Rugovës, por edhe meqë gëzonte mbështetje në qarqe të ndryshme politike europiane, sidomos në Romë e Paris, që ta ruajë kursin e moderuar politik, duke mos tërhequr assesi fuqinë e zjarrit mbi vete.

Në këtë periudhë, për fat të keq, nuk do të mungojnë as cilësimet e Rugovës për UÇK-në si “forcë terroriste” dhe e nxitur nga Beogradi, [16] duke mos ngurruar që t'i bëjë thirrje edhe FBI-së dhe Interpolit për të hetuar atentatin ndaj ish-rektorit serb të UP-së. Por në këtë linjë ai, sidomos në komunikim me gazetarë e diplomat të huaj, do të vete edhe më larg, duke e cilësuar UÇK-në si sajësë të Serbisë! [17] Sidoqoftë, atë qetësi “në prag të furtunës”, që dominonte në Kosovë deri në vjeshtën e vonë të 1997-ës, saktësisht deri më 28 Nëntor 1997, do ta shkërmoqë shpejt dalja për herë të parë në skenë e UÇK-së. Brenda pak muajsh LDK-ja, *de facto*, do të shkrihet

në strukturat e shoqatës humanitare “Nëna Terezë” [!]. Ndërkaq, si forcë politike ajo tashmë ishte pothuajse inekzistente. Lideri i saj, Ibrahim Rugova, do të shndërrohej në një peng të llojit të vet, ashtu siç do të përfundojë edhe si politikan e lider “sui generis”, i pashoq në të gjithë historinë tonë moderne.

Përfundime

Në këtë kapërcyell të shekullit XX, kur Kosova po i nënshtrohej apartheidit [1989-1999], kultura politike, si pjesë e ADN-së së vegjëlisë së këtij populli, do ta ringjallë traditën luftarake dhe do të kontribuojë në rigjetjen e rrugëve për mbijetesë.

Gandi u vra në vitin 1948. Rugova si politikan, *de facto* që “vrrarë” atë ditë kur, me shpurën e tij, kishte lënë Prishtinën dhe ishte nisur për Beograd, duke e lënë Kosovën në shkrumb e hi (1999), ndërkaq në mbrëmje u pa në takimin e tij më komprometues me presidentin serb, Slobodan Millosheviqin. Vajtja e Rugovës nga Beogradi për në Romë dhe qëndrimi i tij për disa javë tërësisht i izoluar, i ngjan më shumë një stivimi mumiesh në morg, për t’u rinxjerrë nga atje për qëllime eksperimentimi e studimi, siç ishte vepruar me trupin e Fricit të gjetur në Alpet e Austrisë. Ringjallja e tij pas luftës kishte karakter misionar politik dhe ishte në funksion të eksperimentimit, por që pjesërisht mund të vlerësohet i dështuar. Misionin e tij do ta vazhdojë “Gjarpri” i shtëpisë, që ishte katapultuar fillimisht në krye të UÇK-së, ndërkaq pas vdekjes së Rugovës, edhe në krye të Republikës! Thuhet se çdo popull ka udhëheqjen që e meriton. Një varg rrethanash e koniunkturash të brendshme të bëjnë ta kuptosh durimin e mosreagimin kolektiv. Por jo edhe ta justifikosh atë, do të konkludojë autorja e librit teksta do të trajtojë fenomenin e katapultimit në krye të Republikës të Hashim Thaçit. Pa ekuivok, ajo atë e cilëson si “eksponentin kryesor të së keqes që kishte pllakosur Kosovën” në njëzet vjet pas luftës, duke e cilësuar edhe si

“figurën më kontraverse të historisë sonë të re”. Duke cituar Veton Surroi, ajo pajtohet me tezën e tij, se “Hashim Thaçi është përgjegjësi kryesor për kapjen e shtetit, vjedhjen e tij, varfërimin e tij material, mendor e shpirtëror, zbrazjen e tij prej një të dhjetës së popullatës për dhjetë vjet pavarësi, humbjen e konsensusit politik dhe humbjen e perspektivës së të rinjve brenda tij” [18]. Fundi i Rugovës, pavarësisht burbujës shtetërore, megjithatë ishte i natyrshëm. Fundi i “Gjarprit” duket do të jetë tragjik. Fitorja e VV-së më 14 shkurt 2021 për shumëçka është e përmasave kapitale për Republikën. Ajo fitore prandaj kishte përmasat e një revolucioni demokratik të heshtur. Nusprodukt i saj është ambienti i ri politik. Ajo fitore ka filluar t’i çlirojë ngadalë, por në mënyrë të sigurt energjitë pozitive të qytetarëve në të gjitha rrafshet. Në këtë ambient kultura politike mund të selitet ashtu siç e meriton ky brez. Në këto rrethana të reja që po krijohen, prof. dr. Luljeta Pula - Beqiri edhe përmes këtij libri si dëshmi e llojit të vet për historinë moderne të Kosovës, ishte dhe mbetet një protagoniste, pa të cilën nuk mund të shkruhet historia e re e Kosovës. Ajo hyn në radhën e asaj armate të rinjsh e personalitetesh, që po e bënin vetë historinë, duke e konsideruar politikën si mision, pikërisht në kapërcyellin e ndeshtrashave më të mëdha, kur Serbia po përgatiste funeralin e saj. “E harruara” Luljeta Pula-Beqiri me këtë libër-testament, e ka shlyer borxhin moral për brezat që vijnë. Ata duhet të flasin për borxhet që Kosova i ka asaj.

Referenca

-
- 1 Bedri Islami, *Përjetësia e dyfishtë*, Tiranë 2008.
 - 2 Mark Krasniqi, *Lugu i Baranit*, ASHAK, Prishtinë 1984, f. 45.
 - 3 Bernardin Palaj, *Organizimi i Bajrakut*, Tiranë 1943, f. 328.
 - 4 Gani Bobi, *Paradoks kulturor*, Prishtinë 1986, f. 57.

<https://www.abendblatt.de/archiv/1999/article204585375/Musste-Fehmi-Agani-sterben-weil-er-nicht-zu-brechen-war.html>

